Tema të zgjedhura nga e drejta kushtetuese

BIBLIOTEKA **BESA**

Recensues:
Prof. dr. Faik Brestovci
Prof. dr. Hajredin Kuçi

Redaktor:
Dr. jur. Getoar M. Mjeku

Botues:
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" • Prishtinë, Kosovë
Shtëpia botuese "Jalifat Publishing" • Hjuston, Teksas, ShBA

Dizajni dhe radhitja:
Plisi.org

Këshilli Botues i Universitetit të Prishtinës e lejoi botimin dhe përdorimin e këtij teksti me Vendimin nr. 3/592, datë 21.11.2016

ISBN 978-9951-00-185-4

© 2016, autori dhe botuesit ruajnë të gjitha të drejtat

Shtypur në Prishtinë, Kosovë

Prof. dr. Enver HASANI

TEMA TË ZGJEDHURA NGA E DREJTA KUSHTETUESE

Univ. Prishtinës ❁ *Jalifat Publishing*
Prishtinë Hjuston

Viktimave të dhunës seksuale
në luftën e fundit në Kosovë (1998–1999),
pavarësisht gjinisë
e përkatësisë kombëtare

Përmbledhja e përmbajtjes

Kapitulli I. **AMENDAMENTIMET KUSHTETUESE QË ÇUAN NË HUMBJEN E AUTONOMISË SË KOSOVËS DHE FILLIMI I LINDJES SË SOVRANITETEVE POPULLORE NË REPUBLIKAT E KRAHINAT ISH-JUGOSLLAVE 1**

I. DISA ÇËSHTJE LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR TË KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS NË DRITËN E NDRYSHIMEVE KUSHTETUESE NË RSFJ 4

II. SOVRANITETI DHE VETËVENDOSJA 9

III. VETËVENDOSJA DHE RASTI I KOSOVËS 18

Kapitulli II. **KUSHTETUTA E KAÇANIKUT 41**

I. DEMAGOGJI E NJË (PROJEKT) KUSHTETUTE 42

II. BAZË E RENDIT MODERN DEMOKRATIK 48

Kapitulli III. **KAPACITETI GJYSMËSHTETËROR I KOSOVËS PËR TË HYRË NË MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE, GABIMET E SHKENCËS JURIDIKE NË KOSOVË DHE KORNIZIMI I IDENTITETIT HISTORIK TË KOSOVËS NGA NJË INTELEKTUAL BRITANIK 57**

I. MBI MOMENTET KYÇE TË RRJEDHËS SË KRIZËS JUGOSLLAVE DHE REAGIMIN E BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE NDAJ SAJ: ASPEKTE JURIDIKO-POLITIKE 60

II. GABIMET E NJË SHKENCE JURIDIKE 81

III. SHPREHJE E PIKËPAMJEVE INDIVIDUALE 127

IV. "UNGVIBUS ET ROSTRIS" 132

V. NJË LIBËR ME RËNDËSI TË VEÇANTË 136

Kapitulli IV. **MBI MARRËDHËNIET ME GJYKATËN SUPREME DHE VENDIMET QË BËNË HISTORINË E GJYQËSISË KUSHTETUESE NË KOSOVËN E PAVARUR DHE SOVRANE 145**

I. Marrëdhënia ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme të Kosovës 149

II. Mekanizmi i ankesave individuale si mjet për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe lirive të njeriut: rasti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës 167

III. Vendimet kryesore që e bënë historinë kushtetuese në Kosovë 191

IV. Kontrolli kushtetues dhe preventiv (paraprak) i amendamenteve kushtetuese dhe mbrojtja nga shkarkimi i shefit të shtetit: rasti i Kosovës 214

***Kapitulli V.* CILËSITË THEMELORE TË SISTEMIT KUSHTETUES KOSOVAR, STATUSI I TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE IDENTITETI KUSHTETUES I KOSOVËS SOT 265**

I. Veçoritë themelore të sistemit kushtetues në Kosovë 268

II. Të drejtat fundamentale në Kosovë 300

III. Aspekte komparative të identitetit kushtetues të Kosovës 348

Literatura 377

Treguesi 413

Tryeza e përmbajtjes

Përmbledhja e përmbajtjes vii

Tryeza e përmbajtjes ix

Dy fjalë lexuesit xvii

Falënderime xix

Shkurtesa xxiii

***Kapitulli I.* AMENDAMENTIMET KUSHTETUESE QË ÇUAN NË HUMBJEN E AUTONOMISË SË KOSOVËS DHE FILLIMI I LINDJES SË SOVRANITETEVE POPULLORE NË REPUBLIKAT E KRAHINAT ISH-JUGOSLLAVE 1**

I. DISA ÇËSHTJE LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR TË KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS NË DRITËN E NDRYSHIMEVE KUSHTETUESE NË RSFJ 4

II. SOVRANITETI DHE VETËVENDOSJA 9

III. VETËVENDOSJA DHE RASTI I KOSOVËS 18

Hyrje 18

1. Historiku i vetëvendosjes 19

2. Vetëvendosja pas mbarimit të Luftës së Ftohtë 25

3. Shpërbërja e ish-Bashkimit Sovjetik 26

3.1. Republikat Baltike 26

3.2. Republikat e tjera 27

4. Shpërbërja e ish-Jugosllavisë 28

4.1. Gjashtë republikat jugosllave 29

4.2. Rasti i Kosovës 32

Përfundim 35

Kapitulli II. **KUSHTETUTA E KAÇANIKUT 41**

I. DEMAGOGJI E NJË (PROJEKT) KUSHTETUTE 42

a. Synohet heqja praktike e autonomisë 43

b. Të drejtat e njeriut duhet mbrojtur me institucione 46

II. BAZË E RENDIT MODERN DEMOKRATIK 48

Kapitulli III. **KAPACITETI GJYSMËSHTETËROR I KOSOVËS PËR TË HYRË NË MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE, GABIMET E SHKENCËS JURIDIKE NË KOSOVË DHE KORNIZIMI I IDENTITETIT HISTORIK TË KOSOVËS NGA NJË INTELEKTUAL BRITANIK 57**

I. MBI MOMENTET KYÇE TË RRJEDHËS SË KRIZËS JUGOSLLAVE DHE REAGIMIN E BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE NDAJ SAJ: ASPEKTE JURIDIKO-POLITIKE 60

Hyrje 60

1. Reagimi fillestar i BE-së dhe KSBE-së 61

2. Reagimi i BE-së dhe KSBE-së ndaj krizës në Kroaci 64

3. Reagimi fillestar i KS të OKB-së 66

3.1. Misioni i Vance-it dhe aksionet e mëtejshme të BE-së 67

3.2. Njohja ndërkombëtare e republikave të ish-RSFJ — kushtet për njohje, përkatësisht vënien e marrëdhënieve diplomatike të përcaktuara nga BE 70

4. Konferenca e Londrës dhe reagimi i mëtejmë i Komisionit Badinter lidhur me suksedimin dhe kontinuitetin e ish-RSFJ 73

5. Kriza në Bosnjë dhe reagimi i bashkësisë ndërkombëtare 75

Përfundim 78

II. GABIMET E NJË SHKENCE JURIDIKE 81

Hyrja 81

1. Mbi të drejtën për vetëvendosje ashtu siç është shtjelluar nga autorët e librit dhe konceptin komunist të kësaj së drejte 83

2. Vilajeti i Kosovës si "shtet konfederal", siguria dhe identiteti i sotëm i Kosovës 84

3. Glorifikimi dhe fetishizimi i Kushtetutës së vitit 1974 89

3. Koncepti komunist si bazë e së drejtës për vetëvendosje dhe pasojat e tij 98

4. Suksesioni (trashëgimi), *uti possidetis*, kontinuiteti shtetëror-juridik i Serbisë me ish-Jugosllavinë dhe bazat në të cilat duhet të mbështetet sot e drejta e Kosovës për vetëvendosje 102

4.1. Suksesioni (trashëgimi) dhe uti possidetis 102

4.2. Kontinuiteti 109

4.3. Baza juridiko-ndërkombëtare e vetëvendosjes së Kosovës dhe popullit të saj 113

Përfundimi 121

III. SHPREHJE E PIKËPAMJEVE INDIVIDUALE 127

IV. "UNGVIBUS ET ROSTRIS" 132

V. NJË LIBËR ME RËNDËSI TË VEÇANTË 136

Hyrje 136

1. Veçoritë dalluese mes shqiptarëve dhe serbëve; vendi dhe roli i Kishës Ortodokse Serbe në ngritjen e nacionalizmit serb 137

2. Aspektet legale të çështjes së Kosovës 138

3. Konferenca e Bunjajt (1943-44) 140

4. Çështja e bashkësisë hebraike në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore 141

Përfundim 143

***Kapitulli IV*. MBI MARRËDHËNIET ME GJYKATËN SUPREME DHE VENDIMET QË BËNË HISTORINË E GJYQËSISË KUSHTETUESE NË KOSOVËN E PAVARUR DHE SOVRANE 145**

I. MARRËDHËNIA NDËRMJET GJYKATËS KUSHTETUESE DHE GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 149

Hyrje 149

1. Kushtetutshmëria dhe vlerësimi i kushtetutshmërisë 150

2. Kontrolli gjyqësor në Kosovë 155

a. Roli dhe pozita e Gjykatës Supreme në sistemin juridik të Kosovës. 158

b. Fushëveprimi dhe përmasa e kontrollit gjyqësor në Kosovë 160

3. Trendet e përgjithshme të vlerësimit të kushtetutshmërisë në Kosovë. 165

Përfundime 166

II. Mekanizmi i ankesave individuale si mjet për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe lirive të njeriut: rasti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës 167

Hyrje 167

1. Juridiksioni *in concreto* i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës: analizë e historikut 169

2. Shterimi i mjeteve juridike efektive dhe standardet e tjera të ndërlidhura me lejueshmërinë në vështrim të juridiksionit *in concreto* të Gjykatës Kushtetuese 174

3. Fushëveprimi dhe natyra e vlerësimit *in concreto* 181

Përfundim 189

III. Vendimet kryesore që e bënë historinë kushtetuese në Kosovë 191

Hyrja 191

1. Vështrim i përgjithshëm i punës së Gjykatës dhe juridiksionit të saj 193

2. Rasti i RTK-së 196

3. Rasti i Logos së Prizrenit 197

4. Tregimi për dy presidentët 199

5. Rasti AKP 209

Përfundim 212

IV. Kontrolli kushtetues dhe preventiv (paraprak) i amendamenteve kushtetuese dhe mbrojtja nga shkarkimi i shefit të shtetit: rasti i Kosovës 214

Hyrje 214

1. Historiku i një vendimi, forma dhe përmbajtja e tij 219

2. *Il regne et ne gouverne pas* 233

3. Uniteti juridiko-kushtetues i popullit dhe dallimi i tij nga uniteti sociologjiko-politik 245

4. Kushtetutat mbrojnë shefin e shtetit, jo individin *ad hominem* 255

Përfundim 262

Kapitulli V. **CILËSITË THEMELORE TË SISTEMIT KUSHTETUES KOSOVAR, STATUSI I TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE IDENTITETI KUSHTETUES I KOSOVËS SOT 265**

I. VEÇORITË THEMELORE TË SISTEMIT KUSHTETUES NË KOSOVË 268

Hyrje 268

1. Vendi dhe rëndësia e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe e së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi 272

2. Karta kosovare mbi të drejtat e njeriut: vendi dhe rëndësia e saj 281

3. Natyra e Gjykatës Kushtetuese dhe lloji i juridiksionit të saj 286

4. Faktori ndërkombëtar: roli i tij në procesin e kushtetutëbërjes dhe në kuadër të sistemit kushtetues 292

Përfundim 298

II. TË DREJTAT FUNDAMENTALE NË KOSOVË 300

1. Zhvillimi i të drejtave të njeriut 301

1.1. Gjatë kohës së komunizmit 302

1.2. Pas vitit 1990 303

2. Ndikimi i dokumenteve të huaja me karakter kushtetues 305

3. Ndikimi i instrumenteve ndërkombëtare 306

2.1. Epërsia e zbatimit të së drejtës ndërkombëtare mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut 307

3.2. Nuk ka dualizëm në lëmin e të drejtave dhe lirive fundamentale .. 310

3.3. Lex Mitior në lëmin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut 313

4. Nocioni dhe funksionet e të drejtave fundamentale 315

4.1. Koncepti i të drejtave fundamentale dhe interpretimi i tyre 316

4.2. Të drejtat dhe detyrimet fundamentale 317

5. Marrëdhënia juridike në lëmin e të drejtave fundamentale 320

5.1. Bartësit e të drejtave fundamentale 320

5.1.1. Personat fizikë (natyrorë) 320

5.1.2. Shtetasit 321

5.1.3. Të huajt 321

5.1.4. Personat juridikë/grupi i personave pa zotësi juridike 322
5.2. Kujt i adresohen të drejtat dhe liritë njerëzore? 322
5.2.1. Pushteti publik 323
5.2.2. Të tjerët 323
5.3. Ndikimi i të drejtave fundamentale 324
5.3.1. Caqet e mbrojtjes së të drejtave fundamentale 324
5.3.1.1. Mbrojtja për sa i përket ligjvënësit 324
5.3.1.2. Mbrojtja sa i përket akteve të administratës 326
5.3.1.3. Mbrojtja sa i përket akteve të juridiksioneve të tjera 326
5.3.1.4. Mbrojtja sa i përket veprimet të personave privat 327
6. Kufizimet e të drejtave fundamentale 328
6.1. Autoriteti në ngarkesë të kufizimeve të të drejtave fundamentale . 328
6.2. Parimi i proporcionalitetit dhe kufijtë e tjerë që kufizojnë të drejtat dhe liritë e individit 330
7. Realizimi i të drejtave fundamentale 331
7.1. Drejtësia kushtetuese 331
7.2. Avokati i Popullit 332
8. Përmbajtjet e ndryshme të konceptit mbi të drejtat fundamentale 334
8.1. E drejta për mbrojtje dhe e drejta për përfaqësim 334
8.2. Mbi "të drejtat negative" (e drejta për të mos i takuar një religjioni ose e drejta për të marrë pjesë në një asociacion) 337
8.3. Të drejtat fundamentale si "garanci institucionale" (garanci siç janë ato lidhur me pronën private, qeverisjen lokale të komuniteteve, autonominë e universiteteve etj.) 339
8.4. Të drejtat fundamentale si bazë e detyrimeve shtetërore (në rend të parë legjislativit) për të mbrojtur aktivisht (në mënyrë eficiente përmes legjislacionit) vlerat e garantuara me të drejtat fundamentale 340
8.5. Mbrojtja e të drejtave fundamentale përmes rregullave të procedurës së organizatave 341

8.6. Mbrojtja e ekzistencës së të drejtave fundamentale (garantimi i "përmbajtjes thelbësore" të të drejtave fundamentale) dhe kufijtë tjerë të kufizimit të të drejtave fundamentale 343

9. Shteti social dhe transicioni 344

10. Natyra juridike e të drejtave fundamentale 347

III. Aspekte komparative të identitetit kushtetues të Kosovës 348

Hyrje 348

1. Definimi, vendi dhe roli i identitetit kushtetues në përgjithësi 350

2. Llojet e identiteteve që bazohen në modelin e caktuar kushtetues dhe vendi i Kosovës në këtë aspekt 356

3. Llojet e identiteteve që lindin gjatë kushtetutëbërjes dhe vendi i Kosovës në këtë mes 360

4. Identiteti i lindur gjatë interpretimit kushtetues 366

Përfundim 374

Literatura 377

1. Libra 377

2. Artikuj 385

3. Dokumente dhe materiale të tjera 402

Treguesi 413

Dy fjalë lexuesit

Libri që sot keni para jush, *Tema të përzgjedhura nga e drejta kushtetuese*, paraqet përmbledhje të shkrimeve dhe artikujve akademikë të botuara në Kosovë dhe në botën e jashtme, me fillim nga viti 1988, kur nisën diskutimet për ndryshimet kushtetuese në nivel të Republikës së Serbisë. Këto ndryshime kulmuan më 23 mars 1989 me heqjen e autonomisë së Kosovës dhe integrimin e plotë të tërë segmenteve të jetës kushtetuese, socio-politike dhe ekonomike në sistemin serb. Instalimi i diktaturës serbe në Kosovë u pasua me represione sistematike ndaj popullsisë shumicë, si dhe me një konflikt të armatosur përmasash ndërkombëtare (1998-1999), në të cilin populli shumicë mori armën për të mbrojtur dinjitetin e nëpërkëmbur: lufta e pabarabartë e UÇK-së me forcat serbe të diktatorit Sllobodan Millosheviq kulmoi me ndërhyrjen e NATO-s, veprim që çoi në çlirimin përfundimtar të Kosovës më 10 qershor 1999.

Në rrethanat e tilla — të një dekade lufte të popullit shqiptar, njëherë në mënyrë paqësore, nën udhëheqjen e liderit historik dr. Ibrahim Rugova, pastaj përmes qëndresës së armatosur, që nisi më 1998 në Prekaz të Skenderajt, nën udhëheqjen e heroit Adem Jashari — në Kosovë u zhvillua edhe veprimtaria akademike. Kjo kohë do të mbahet mend në analet evropiane si koha kur një popull i tërë u mobilizua për të organizuar jetën paralele socio-politike, ekonomike dhe kulturore, duke sfiduar me shumë sukses strukturat represive të regjimit serb. Në këto kushte u botuan shkrime e vepra të të gjitha llojeve, kryesisht nëpër revistat e pakta akademike, por edhe në shtypin ditor të kohës. Ky ka qenë konteksti i botimit të shumicës së shkrimeve që sot i ofrohen lexuesit. Ato prekin aspekte të llojllojshme të jetës së popullsisë shumicë në kushtet e okupimit të tërësishëm serb.

Në fillim të çdo kapitulli, para se lexuesi të shkojë në përmbajtjen e artikujve që riprodhohen në këtë libër, kemi dhënë një sfond historik për secilin punim, për kohën dhe motivet e shkrimit të tij, për vendin dhe datën e botimit, e për të gjitha aspektet e asaj që mund të quhet sociologjia e shkrimeve të përmbledhura. Këtë e kemi bërë me qëllim që lexuesi ta ketë më lehtë jo vetëm për të përzgjedhur se çka do të lexojë nga kjo antologji, por edhe për të fituar një pasqyrë sado pak të qartë për teknologjinë e secilit shkrim. Shpresojmë se me këtë qasje do të arrijmë t'ia kursejmë kohën dhe mundin lexuesit,

duke i bërë më pak të mundimshme përsiatjet që kërkon një tekst të ri. Nganjëherë vështirë që racionalizohen përsiatjet, pikërisht për shkak të kaosit që ndien lexuesi në fillim të një vepre të re. Duke pasur këtë parasysh, u urojmë lexim të këndshëm të gjithë atyre që marrin mundin për ta shkoqitur këtë libër, i cili i kushtohet të gjitha viktimave të dhunës seksuale të luftës së fundit në Kosovë (1998-1999), pa dallim race e etnie, kombi, feje apo gjinie.

Autori, nëntor 2016

Falënderime

Sfida më të madhe që e has çdokush pas mbylljes me sukses të një pune është si dhe kë ta falënderojë, si t'i përmendë të gjitha ata që e kanë ndihmuar në lindjen e produktit final. Kjo jo pse njeriu pas një produkti intelektual synon të fshehë përgjegjësinë për gabimet eventuale, të cilat çdoherë janë të autorit, por pse njeriu shpesh bën lëshime të paqëllimshme, të cilat mund të duken si mosmirënjohje ndaj atyre që e kanë ndihmuar që nga dita e parë e punës. Këtë sfidë e kemi hasur edhe ne më rastin e shkrimit të këtyre rreshtave falënderues për të tjerët. Në njërën anën, ekziston ndjenja e pasjes së aq shumë borxhi për të gjithë atë që kanë ndihmuar në produktin final që sot gjendet para jush; në anën tjetër, renditja sipas radhës meritore të krejt atyre që ndihmuan në këtë libër paraqet një punë vërtet Sizifi. E megjithatë, ne vendosëm t'i themi disa falënderime dhe të marrim mbi supe krejt rrezikun e keqkuptimit dhe hyrjes në hak të shumëkujt që na ka ndihmuar në përfundimin me sukses të këtij libri.

Në rend të parë, më duhet të them se falënderimi krejt i pafund, ani se mund të duket i dalë nga motivet e mia meskine, shkon për Burbuqen, bashkëshorten time, dhe për fëmijët: Kastriotin, i cili me nipat tanë të dashur jeton prej vitesh në Finlandë (ku punon dhe studion në të njëjtën kohë), dhe Vatanin e Dënesën, të cilët ka kohë që kanë filluar të studiojnë dhe, për pasojë, të mirëkuptojnë mungesën e gjatë të ngrohtësisë prindërore të autorit të këtyre rreshtave. Çdo punë intelektuale serioze kërkon një sakrificë. Lum ata që kanë mirëkuptimin e familjes, si puna ime që e kam pasur prore dhe pa asnjë rezervë, aq sa në sytë e tjerëve nganjëherë është dukur si një marrëzi. Burbuqja, bashkëshortja ime, ka meritë të posaçme për durimin dhe përkushtimin e pafund që ka treguar çdoherë kur unë kam hyrë në lexim e shkrim të ndonjë teksti, pa asnjë kusht. Aq shumë jam i llastuar me mirësjelljen e saj, aq sa kam përshtypjen sikur të sillej ndryshe qoftë edhe një minutë do ta merrja si një shaka të saj ndaj meje. Faleminderit shumë, Buqe!

Nuk mund të mos i falënderoj me po aq përkushtim, sinqeritet intensiv dhe krejt të hapur, recensentët e librit, profesorin Faik Brestovci dhe kolegun Hajredin Kuçi. Profesor Kuçi udhëhoqi Komisionin për Hartimin e Kushtetutës së Kosovës gjatë viteve formative të shtetit të ri të Kosovës. Profesor Faik Brestovcit, pas atyre të cilëve si pasojë e lidhjes së gjakut u detyrohem çdo

gjë, i kam borxh më së shumti për ngritjen time profesionale. Kur në vitin e largët 1987, prof. Faiku pranoi që unë të jem asistent i tij dhe bashkëpunëtor i ngushtë, post të cilin mbajtja me nder e dinjitet deri në ditën e shkuarjes së tij në pension më 2007, atëherë çdo gjë ndryshoi në jetën time intelektuale. Hapja e rrugëve për progres individual intelektual në mënyrë institucionale ka qenë një ëndërr për ata që vinin nga komunat e tjera që cilësoheshin provinca — si puna ime, ani se Mitrovica kishte një pedigre të mirë në nivel ishjugosllav. Vështirësia qëndronte jo aq shumë na prejardhjen provinciale sa në prejardhjen nga nomenklaturat komuniste të kohës. Pranimi në jetën universitare e atyre si unë që nuk i takonin nomenklaturës përbënte një përjashtim. Këtë përjashtim, e pashë me sytë e mi, e bëri prof. Faik Brestovci në tetorin e vitit akademik 1987. Tek unë, ai krijoi një ndjenë borxhi, të cilin kurrë nuk kam pasur mundësi t'i rikthej si duhet dhe sa duhet.

Kolegut Hajredin Kuçi, profesorit të respektuar të së drejtës, i jam mirënjohës jo vetëm për leximin e dorëshkrimit, por edhe për sugjerimet e bëra në shkrim e sipër të këtij libri. Këto sugjerime më ndihmuan që t'i jap librit një shije të hollë, e cila sigurisht që do të kishte munguar në rrethanat e tjera. Në veçanti, për mua ka qenë me vlerë të madhe diskutimi me kolegun Kuçi për disa nga detajet e hartimit të Kushtetutës së Kosovës, në fuqi nga 15 qershori i vitit 2008. Ato hollësi njeriu nuk mund t'i mësojë ndryshe pos nga goja e atyre që kanë qenë akterë të gjallë përgjatë tërë ecurisë së draftimit. Akter i tillë ka qenë prof. Kuçi. Narracioni i tij, si kryetar i Komisionit, ka një peshë më të rëndë, gjë që kemi provuar ta reflektojmë edhe në tekstet akademike të shkruara pas nxjerrjes së Kushtetutës të Kosovës. Këto tekste jepen në këtë libër të pandryshuara.

Kur gjashtë muaj më parë fola me mikun tim të madh, shqiptaro-amerikanin Ramiz Tafilaj, për mundësitë e botimit, hasa në mirëkuptimin e tij të parezervë. Shtëpia e tij botuese "Jalifat Publishing", në Hjuston të Teksasit, mori përsipër të nxjerrë këtë dhe librin simotër nga lëmi i së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Me Ramizin u pajtuam që krejt fitimet nga shitja e dy librave t'u shkojnë — pa dallim race e etnie, kombi, feje apo gjinie — viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë (1998-1999). Vetëm ata që kanë punuar me Ramizin dinë të tregojnë për zemërgjerësinë e tij dhe natyrën e butë që nuk ka kulturë njeriu që mund ta keqkuptojë e aq më pak ta refuzojë. Nuk ka fjalë që mund ta shprehë falënderimin tonë për mbështetjen që na ka dhënë miku ynë tej Atlantikut: Ramizi e ka bërë të mundshme që ky libër sot ta shoh dritën e vet.

Dr. jur. Getoar Mjeku, një avokat i shkëlqyer, i shkolluar në ShBA, ka qenë me autorin tërë kohën dhe ka pasur durim të hollë për të ndjekur çdo gabim si në strukturën e tekstit dhe në përmbajtjen e tij. Një ndër dobësitë e mëdha që ka ky autor është refuzimi i përhershëm për të lexuar tekstet e veta pas dorës së parë të tyre, diçka që përbën një hendikep të madh në çdo përpjekje intelektuale, sepse puna e mirë dhe gabimet shihen dhe zbulohen në leximet e tjera. Këtë mangësi timen e ka mënjanuar Getoari duke u marrë kohërisht me tekstin në dorëshkrim shumë më gjatë se vetë autori. I jam mirënjohës aq shumë Getoarit. Nuk kam fjalë për keqardhjen të cilën e ndiej për mundimin e pafund që i kam shkaktuar duke ia lënë në barrë korrigjimin e gabimeve konstante të teksteve të mia.

Mbledhja e shkrimeve të autorit, të botuara para vitit 1992, ka qenë një sfidë e madhe. Për këtë më kanë përkrahur Drejtori i Bibliotekës Nacionale, prof. dr. Sali Bashota, dhe shoku im i gjeneratës, Nazim Bërbatovci. I ndjeri Bardh Hamza, mungesën e të cilit e ndiej çdo ditë dhe më rri mbi kokë si aureolë së bashku me zërin e tij të butë, ka ndihmuar shumë në gjetjen e teksteve në arkivin e tij privat. I lehtë i qoftë dheu i Kosovës mikut tim Bardh Hamza, dhe këto falënderime i marrtë si shkëndija të miqësisë sonë që kemi pasur për së gjalli. Prof. Bashotës, intelektualit të mirë e të butë, dhe mikut tim, Nazimit, u dërgojmë falënderime të pafundme për ndihmën që kanë dhënë për të gjetur punimet e autorit të botuara para vitit 1992.

Prof. Bekim Bejta, një mik imi i vjetër, ka pasur durimin dhe mirësinë për leximin e dorëshkrimit tim. I jam mirënjohës për sugjerimet e dhëna në stilin dhe në përmbajtjen e tekstit. Elokuencën e sugjerimeve të prof. Bejtës kam provuar ta reflektoj në librin që sot gjendet para jush.

Në fund, krejt atyre që nuk i përmend këtu u jam mirënjohës: ata që në vazhdimësi kanë lexuar pjesët e caktuara të këtij libri, që më kanë dhënë ide dhe materiale për t'i përdorur në këtë libër, atyre që kanë mbështetur që libri t'i kalojë sa më shpejt procedurat burokratike për të dalë si tekst universitar, si dhe atyre që më kanë inkurajuar për në një përmbledhje të vetme të shkrimeve të mia të përzgjedhura. Janë shumë dhe nuk di kah t'ia nis me falënderimet. Më mirë po e lë me kaq: i falënderoj të gjithë ata të cilët më ndihmuan aq shumë që ky libër sot të jetë në duart e lexuesit.

Autori, nëntor 2016

Shkurtesa

APJ — Armata Popullore e Jugosllavisë (ushtria e ish-RSFJ-së)
BE — Bashkimi Evropian ose Bashkësia Evropiane
BRSS — Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike
CASIN — *Center for Applied Studies in International Negotiations*, Qendra për Studime të Aplikuara në Negociata Ndërkombëtare, Gjenevë
DBShTN — Drejtoria e Bashkëpunimit Shumëpalësh dhe e Traktateve Ndërkombëtare, MPJ e Shqipërisë
E drejta — Revistë akademike e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, e cila në kohën e ish-Jugosllavisë botohej me rezyme në gjuhët shqipe dhe serbe, kurse tani botohet shqip dhe me rezyme anglisht
EPC — *European Peace Conference*, Konferenca Evropiane për Paqe në Jugosllavi
FMN — Fondi Monetar Ndërkombëtar
GIZ — *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit*, Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GjEDNj — Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjND — Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
IMPP — *Institut za medjunarodnu politiku i privredu*, Instituti për politikë dhe ekonomi ndërkombëtare, Beograd
KAÇKJ (AVNOJ) — Këshilli Antifashist i Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë (*Antifašističko vijeće narodnog oslobodjenja Jugoslavije*)
KEDNj — Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEF — Këshilli Ekzekutiv Federativ, ish-Jugosllavi
KEK — Korportata Energjetike e Kosovës
KFOR — *Kosovo Force*, ushtria e NATO-s në Kosovë
KS i OKB — Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
KSAK — Krahina Socialiste Autonome e Kosovës, emërtim i sanksionuar me Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974
KSBE — Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KVDT — Konventa e Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve e vitit 1980
LKJ — Lidhja Komuniste e Jugosllavisë, organizatë udhëheqëse e ideologjisë komuniste, e shkatërruar me shpërbërjen e ish-Jugolsllavisë
MPJ — Ministria e Punëve të Jashtme

NATO — *North Atlantic Treaty Organization*, Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
OKB — Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE — Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PSSP — Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së
QIK — Qendra për Informim e Kosovës (1990-1999)
RFJ — Republika Federale e Jugosllavisë, e përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi, themluar në prill 1992 nga diktatori serb Sllobodan Millosheviq
RSFJ — Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
RSS — Republika Socialiste e Serbisë
ShBA — Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SKS — Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene (1918-1945)
UÇK — Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UE — Unioni Evropian ose Bashkimi Evropian sot (dikur i njohur si Bashkësia Evropiane, shkurt BE, para lidhjes së Traktatit të Mastrihtit në vitin 1993, përkatësisht deri me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës në vitin 2009)
UNMIK — *United Nations Interim Administration Mission in Kosovo*, Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, themeluar më datën 10 qershor 1999 në bazë të Rezolutës 1244 të KS të OKB-së të së njëjtës datë. Mandati i tij akoma është në fuqi në aspektin formal, meqë nuk ka vendim të ri të KS të OKB-së për ta mbyllur këtë mision ndërkombëtar në Kosovë.

Kapitulli I

AMENDAMENTIMET KUSHTETUESE QË ÇUAN NË HUMBJEN E AUTONOMISË SË KOSOVËS DHE FILLIMI I LINDJES SË SOVRANITETEVE POPULLORE NË REPUBLIKAT E KRAHINAT ISH-JUGOSLLAVE

Sfondi historik: Gjatë viteve 1988-1990 në ish-Jugosllavi ishin bërë ndryshime kushtetuese të të gjitha niveleve — federative dhe në nivel të Kosovës. Ato që u bënë në nivel të Kosovës më 23 mars 1989, që përfundimisht çuan në humbjen e autonomisë së Kosovës të përcaktuar më 1974, ishin vetëm finalja e një loje lufte serbe për dominim jo vetëm në Kosovë por në tërë ish-Jugosllavinë. Kjo luftë, e nisur nga diktatori serb Sllobodan Millosheviq, pati filluar në Fushë-Kosovë në prill 1986, kur tirani në ngritje u premtoi serbëve një jetë më të mirë dhe më të sigurt. Në fakt, serbët lokalë, kudo që jetuan në ish-Jugosllavi, përveç në Serbi, paguan çmimin më të shtrenjtë të kësaj politike hegjemoniste të diktatorit serb dhe të elitës intelektuale serbe që e mbështeti tërë kohën.

Në Kosovën e asaj kohe — pra në Kosovën kur bëheshin ndryshimet kushtetuese të nivelit federal, në Republikën e Serbisë dhe në ish-Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës — roli i juristëve ka qenë parësor, nisur nga rrethanat historike në të cilat ishte krijuar elita intelektuale e administrative kosovare. Të paktë kanë qenë ata juristë, për fat të keq, të cilët ecën vertikalisht dhe i dolën para makinerisë primitive të juristëve serbë, të cilët arsyetonin ndryshimet kushtetuese dhe rrënimin e autonomisë së Kosovës dhe marrjen e të drejtave të shqiptarëve si popull shumicë me një diskurs mbi shtetin mesjetar serb dhe të drejtën e Republikës së Serbisë për të rikthyer kontrollin total mbi Kosovën. Më 1988, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës botoi një përmbledhje të diskutimeve mbi amendamentet kushtetuese[1], duke përfshirë edhe diskutimin e autorit të këtyre rreshtave, të cilin po e riprodu-

[1] Shih monografinë e veçantë me titull *Diskutime për Amendamentet Kushtetuese në Kushtetutën e RS të Serbisë dhe KSA të Kosovës* II, botuar nga Instituti për Kërkime Juridike dhe Shoqërore i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë, tetor 1988).

kojmë këtu si pjesë të parë të këtij kapitulli.[2] Ky botim paraqet krejt mjerimin intelektual, padijen dhe inferioritetin e një pjese të komunitetit juridik kosovar. Për fat të keq, një pjesë e tyre, më datën 23 mars 1989, kur përfundimisht u rrënua çdo aspekt i autonomitetit, hapur doli në mbrojtje të pozicioneve mesjetare serbe dhe dukshëm ndihmoi në miratimin e amendamenteve kushtetuese, të cilat Republikës së Serbisë i dhanë letrat në duar për të integruar çdo cep të vendit nën juridiksionin serb deri më 10 qershor 1999, kur trupat e NATO-s rrënuan këtë sovranitet serb ndaj Kosovës dhe popullit të saj shumicë.

Periudha e pas-23 marsit 1989 u pasua me diskutime për vetëvendosjen, llojet e saj, të drejtat e njeriut dhe të drejtat e minoriteteve, terme këto që asnjëherë më parë nuk ishin dëgjuar në diskursin kosovar dhe më gjerë në ish-Jugosllavi. Gradualisht u ravijëzuan dy blloqe e koncepte të vetëvendosjes dhe, për pasojë, të modelit të shtetit që duhej sanksionuar me një kushtetutë të re federative. I pari ishte veriu i ish-Jugosllavisë, Sllovenia e Kroacia, me Kosovën së bashku, i cili mbronte idenë për vetëvendosjen si koncept dinamik, si një e drejtë për kontratë sociale që kurrë nuk konsumohet, të cilën mund ta rinegociojë qytetari kurdo që vlerëson se i janë cenuar të drejtat e liritë themelore të garantuara nga natyra e njeriut si qenie e lirë. I dyti diskurs ishte i kundërt me këtë dhe përqafohej nga Serbia dhe aleati i saj i asaj kohë, Mali i Zi. Sipas serbëve e malazezëve, vetëvendosja ishte ushtruar njëherë me rastin e formimit të ish-Jugosllavisë më 1918 dhe ishte testuar sërish më 1945 kur u bë ridefinimi i shtetit jugosllav, ashtu që më nuk mund të kishte asnjë debat tjetër përveç diskutimit të asaj që njihej si vetëvendosje e brendshme. Kjo vetëvendosje, sipas konceptit serbo-malazez, nuk përkonte aspak me vetëvendosjen e brendshme sipas modelit perëndimor, ku qytetarit dhe grupeve të ndryshme etnike, gjuhësore, fetare dhe të ngjashme u njihej e drejta e rregullimit të lirë të sistemit të tyre qeverisës. Koncepti serbo-malazez fliste vetëm për vetëvendosjen e brendshme sipas së cilës serbët duhej të bënin rregullat e lojës dhe të ishin udhëheqës absolutë të valles së kombeve e popujve që jetonin në ish-Jugosllavi.

Për këtë arsye, pas amendamenteve kushtetuese, pasuan konfliktet e luftërat e armatosura kundër hegjemonisë serbe. Kjo rezistencë violente e joserbëve kundër kësaj hegjemonie me kohë vetëdijesoi malazezët që mos të shërbenin si një vegël e verbër në duart e regjimit diktatorial të Sllobodan Millosh-

[2] Enver Hasani, "Disa çështje lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në dritën e ndryshimeve kushtetuese të RSFJ", ibid. fq. 241-246.

eviqit po t'i riktheheshin shtetësisë së tyre, që ishte më e vjetër se ajo serbe. Ky kthim filloi gradualisht, por pika kyçe ishte arritja e Marrëveshjes së Dejtonit në nëntor 1995, me të cilën u ndal lufta dhe dhuna në Bosnjë-Hercegovinë dhe u nis shkatërrimi i sistemit të Sllobodan Millosheviqit. Që nga ky vit, u pa qartë se realizimi i vetëvendosjes, asaj interne dhe eksterne, do të bëhej sipas standardeve të shoqërive euro-atlantike, perëndimore, dhe jo sipas recetës mesjetare serbe. Kjo qe bërë e qartë nga Komisioni Badinter për ish-Jugosllavinë gjatë viteve 1991-1993, i cili diskutohet këtu në vijim dhe në kapitullin tjetër pas këtij. Mirëpo, u desh një luftë dhe konflikt i armatosur që çoi në gjenocid ndaj popujve joserbë që të kuptohej se vetëvendosja nuk mund të realizohej njëanshëm dhe jashtë disa kritereve të paracaktuara juridiko-kushtetuese dhe juridiko-ndërkombëtare të pranuara botërisht. Kjo është arsyeja që në këtë kapitull po riprodhojmë punimet kryesore mbi vetëvendosjen, i pari i botuar tanimë në vitin e largët 1990[3].

Punimi i fundit i këtij kapitulli titullohet "Vetëvendosja dhe rasti i Kosovës"[4] dhe është botuar shumë vite më vonë se shkrimi i parë që jepet në seksionin III. Këto dy punime me një distancë kohore të tillë janë përzgjedhur për të treguar konsistencën tonë intelektuale në lidhje me aspektet e brendshme dhe të jashtme të asaj që njihet si vetëvendosje e popujve. Vetëvendosja, si parim dhe si normë, më vonë do të jetë edhe objekt studimi i thellë në disertacionin tim të doktoratës, botuar në Vjenë më 2003, ku kam argumentuar gjerësisht se ky parim dhe kjo e drejtë nuk mund të shikohen si të ndara nga integriteti territorial dhe stabiliteti i shteteve. Po ashtu, një analizë e shpejtë e punimeve tona të mëhershme në këtë vend si dhe krahasimi i tyre me tezat bazike të disertacionit qartë zbulojnë që ka pasur një vijueshmëri besnike në diskursin tonë dje dhe sot derisa po e shkruajmë këtë libër.

[3] Enver Hasani, "Sovraniteti dhe Vetëvendosja", *Fjala* viti XXIII, nr. 24 (Prishtinë: tetor 1990).

[4] Enver Hasani, "Vetëvendosja dhe rasti i Kosovës", *E drejta/Law* viti XXIII, nr. 4 (Prishtinë, 1997).

I. Disa çështje lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në dritën e ndryshimeve kushtetuese në RSFJ

Marrëdhëniet ndërkombëtare përfshijnë tërësinë e marrëdhënieve në lëmenj të ndryshëm: politik, juridik, ekonomik, kulturor, ushtarak e të tjerë. Të gjitha format e marrëdhënieve gërshetohen ndërmjet vete dhe ndikojnë në njëra-tjetrën (marrëdhëniet politike në ato ekonomike dhe anasjelltas). Ato janë në zhvillim permanent dhe si të tilla orientojnë dhe përkufizojnë esencën dhe brendinë e normave juridiko-ndërkombëtare më detalisht dhe më për së afërmi. Marrëdhëniet ndërkombëtare esencialisht ndikojnë në parimet dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare. Nga esenca e tyre, marrëdhëniet ndërkombëtare dallohen nga të gjitha marrëdhëniet e tjera shoqërore për atë se si të tilla lindin nga kundërthënia, e cila del si pasojë e ndarjes së hapësirës unike, hapësirë kjo e cila mundëson dhe ofron kushtet për zhvillim dhe ekzistencë të shoqërisë njerëzore — prodhimtarisë së saj materiale[5].Këto marrëdhënie janë rezultat i ndarjes politike të hapësirës në tokë mes shoqërive të përkufizuara politikisht — shteteve. Si të tilla, ato janë edhe marrëdhënie politike. *Marrëdhëniet ndërkombëtare janë politike jo vetëm për nga forma por edhe për nga përmbajtja.*

Çdo shoqëri e organizuar në shtet, kufizohet me ndërvarshmërinë, e cila lind si pasojë e kushteve jo të njëjta, si pasojë logjike e ndarjes politike të hapësirës. *Në këtë gërshetim të ndërvarshmërisë dhe vetëmjaftueshmërisë, lindin forma të ndryshme bashkëpunimi që synojnë baraspeshën e përpjekjeve dhe mundësive reale.* Një subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare qëndron në një shkallë të ulët apo të lartë të ndërvarshmërisë, në raport me subjektet e tjera. Vetë ky fakt tregon se marrëdhëniet ndërkombëtare janë domosdoshmëri dhe imperativ i kohës. Ndërvarshmëria është baza mbi të cilën lindin marrëdhëniet ndërkombëtare.

Duke u nisur nga ky fakt, Federata, si shtet dhe bashkësi shtetërore e kombeve të bashkuara vullnetarisht dhe republikave te tyre socialiste dhe të krahinave autonome, që bazohet në pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës pu-

---

[5] Vojin Dimitrijević & Dragoslav Stojanović, *Medjunarodni odnosi* (Naučna Knjiga: Beograd, 1979) fq. 21.

nëtore dhe të gjithë njerëzve punues (neni 1 i Kushtetutës së RSFJ të vitit 1974), politikën e jashtme të Jugosllavisë në kuadër të parimeve të përmbajtura në pjesën e përgjithshme të Kushtetutës në fjalë, e përcakton vetë ajo (Federata), përmes organeve të saj (neni 281, al. 1, pika 7, i Kushtetutës së RSFJ të vitit 1974). Në nenin e sipërpërmendur të Kushtetutës së RSFJ të vitit 1974 thuhet që, në mes tjerash, "Federata, përmes organeve të saj, [...] mbron shtetasit e RSFJ dhe interesat e tyre si dhe interesat e personave juridikë të vendit në botën e jashtme [...]". Kjo në teorinë e së drejtës ndërkombëtare njihet si "mbrojtje diplomatike", e cila në shtetet bashkëkohore me rregullim federativ iu lihet në kompetencë organeve federative, gjë që është e logjikshme, duke u nisur nga konstruksioni i brendshëm i Federatës si shtet i përbërë.

Në pikën 2 të projektamendamentit XXXIII në Kushtetutën e Republikës së Serbisë, në mes tjerash, thuhet se RSS realizon bashkëpunim ndërkombëtar me interes për republikën si tërësi, sa i përket:

> mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të punonjësve dhe qytetarëve të Republikës Socialiste të Serbisë në botën e jashtme; plotësimit të interesave dhe përparimit të bashkëpunimit me të emigruarit — pjesëtarët e kombit serb dhe të kombeve e të kombësive të tjera, të cilët jetojnë në Republikën Socialiste të Serbisë; realizimin e të drejtave te pjesëtarëve të kombit serb, i cili si pakicë kombëtare jeton në vendet fqinje; përmendoret kulturore dhe çështjet e tjera që janë me interes për historinë dhe kulturën e kombit serb [...].

Nga kjo dispozitë e këtij projektamendamenti fitohet përshtypja, së pari, se RSS synon që të zëvendësohet në vend të Federatës, krejt në kundërshtim me dispozitën e cekur të nenit 28, pika 7, të Kushtetutës se RSFJ të vitit 1974, që normon çështjet e mbrojtjes së ashtuquajtur diplomatike. Në vijim të kësaj, së dyti, sikur fitohet përshtypja se prejudikohet mosefikasiteti i organeve të Federatës lidhur me mbrojtjen e shtetasve të saj dhe të personave juridikë të vendit. Veç kësaj, jemi të mendimit se ky definim është në kundërshtim të hapët edhe me politiken e jashtme të përcaktuar të Jugosllavisë, siç përcaktohet në parimet themelore të Kushtetutës në fuqi të vitit 1974, sepse çështja e bashkëpunimit kulturor të Jugosllavisë dhe mbrojtjes së vlerave kulturore të mbarë njerëzimit pa marrë parasysh përkatësinë nacionale, fetare, raciale etj., nuk mund të vihet në pyetje e as që është vënë ndonjëherë deri më tani, duke u nisur nga angazhimi i vendit tonë, veçanërisht në kuadër të programeve të UNESCO-s, por edhe në kuadër të organizatave të tjera që i referohen kësaj çështje. Theksimi i kriterit nacional, në vend te atij klasor dhe të shtetë-

sisë së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, më duket se është i tepërt në këtë projektamendament.

Nga ana tjetër, projektamendamenti XXIX në Kushtetutën e RSFJ të vitit 1974 në asnjë rast nuk ka prejudikuar, e aq më pak të ketë pasur për qëllim "avancimin" e RSS për qëllimet e rregullimit të këtyre çështjeve. Qëllimi i tyre ka qenë dhe mbetet realizimi konsekuent dhe precizimi i pozitës kushtetuese të Republikës së Serbisë dhe Krahinave Socialiste Autonome të Kosovës dhe Vojvodinës në pajtim me parimet themelore të Kushtetutës së RSFJ të vitit 1974, gjë që shihet nga projektamendamentet XXV, XXIX, XXXII, XXXVI dhe XXXVII në Kushtetutën e RSFJ. Kjo është thënë kështu në vetë arsyetimin e projektamendamenteve në fjalë, të cilat i referohen marrëdhënieve në Federatë, të drejtave dhe detyrave të Federatës dhe organizimit të Federatës[6].

Në kuadër të Kuvendit Federativ, i cili është paramenduar dhe paraqet qendër të vendosjes dhe gërshetimit të interesave lidhur me interesat e përbashkëta, pra, edhe të atyre nga lëmi i marrëdhënieve ndërkombëtare, vendimet të cilat merren aty duhet të jenë rezultat i harmonizimit të qëndrimeve të bashkësive shoqëroro-politike, para së gjithash, republikave socialiste dhe krahinave socialiste autonome. Në dy deceniet e fundit në shoqërinë tonë janë evidente përpjekjet dhe synimet që, edhe në lëmin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të politikës së jashtme të inkuadrohet një numër sa më i madh i subjekteve, të cilët do të mund të merrnin pjesë në jetën ndërkombëtare, pra të cilat do të kenë edhe përgjegjësi të caktuar[7]. Amendamentet federative, republikane dhe krahinore të viteve 1967, 1968 dhe 1969, gjegjësisht 1971 dhe 1972, paraqesin etapa të rëndësishme në zgjerimin e faktorëve të cilët marrin pjesë në përcaktimin dhe realizimin e politikës së jashtme të Jugosllavisë dhe të marrëdhënieve të saj ndërkombëtare, veçanërisht në pjesëmarrjen dhe përgjegjësinë e republikave dhe të krahinave autonome. Praktika e deritanishme e ekskluzivitetit të Federatës në lëmin e politikës së jashtme dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, që nga viti 1946 e deri në aprovimin e amendamenteve të sipërcekura, ngritet në një të drejtë dhe detyrë të përbashkët të të gjitha republikave dhe krahinave socialiste autonome (siç thuhet në parimet themelore të Kushtetutës së RSFJ të vitit 1974, parimi I dhe parimi VII në veçanti).

---

[6] Gazeta e përditshme *Borba* (Beograd, janar 1988), botimi special me titull "Šta se menja u Ustavu SFRJ", fq. 20.

[7] Shih më shumë për këtë në Aleksandar Magarašević, "O demokratizaciji spoljne politike u Jugoslaviji", *Anali Pravnog Fakulteta u Beogradu* nr. 2 (Beograd, 1973).

Në pajtim me këtë që u tha më lart, në projektamendamentin XL të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, përcaktohet se Krahina Socialiste Autonome e Kosovës realizon bashkëpunimin ndërkombëtar për të gjitha çështjet me interes për organizatat dhe bashkësitë vetëqeverisëse, punonjësit dhe qytetarët dhe kombet e kombësitë e Krahinës me organet dhe organizatat e shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare në kuadër të politikës së përcaktuar të jashtme të RSFJ dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, e kur kjo është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë, në kuadër të realizimit të bashkëpunimit ndërkombëtar të Republikës[8]. Ky projektamendament paraqet zbërthim konsekuent të projektamendamentit XXIX në Kushtetutën e RSFJ të vitit 1974 veçanërisht të alinesë 2 të tij, kurse në alinenë 3 të projektamendamentit në fjalë është thënë se "republikat dhe krahinat autonome bashkëpunojnë ndërmjet veti në realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, kurse me organet federative organizojnë programin dhe realizimin e bashkëpunimit të tyre ndërkombëtar". Po aty është thënë më tej se "Krahinat autonome harmonizojnë programin dhe realizimin e bashkëpunimit të tyre ndërkombëtar edhe me Republikën Socialiste të Serbisë".

Në vijim si sipër, si plotësim të projektamendamentit XL në Kushtetutën e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, e me qëllim të zbërthimit dhe akceptimit konsekuent të alinesë së 3-të të projektamendamentit XXIX në Kushtetutën e RSFJ të vitit 1974, propozoj që të parashihet si një aline e veçantë edhe kjo si vijon:

> Krahina Socialiste Autonome e Kosovës në realizimin dhe pjesëmarrjen e saj në bashkëpunimin ndërkombëtar si më lart është edhe përgjegjëse për një gjë të tillë.

Ky propozim bëhet jo nga shkaku se një gjë e tillë nuk është paraparë me parimet themelore të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës të vitit 1974, të cilat përbëjnë pjesën e saj integrale, por për hir të përcaktimit konsekuent të bazës juridike të përgjegjësisë së Krahinës edhe në këtë lëmi. Fitohet përshtypja, gjë e cila shihet edhe nga arsyetimi i projektamendamentit XXXIII në Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë që diskutohet sot këtu, se ide udhëheqëse në formulimin e projektamendamentit në fjalë, kanë qenë lëshimet eventuale të KSAK lidhur me politikën e jashtme të përcaktuar dhe me bashkëpunimin ndërkombëtar ndaj RPS të Shqipërisë, të cil-

[8] Pasusi i fundit ka të bëjë me rregullimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në kuadrin e funksioneve të RSS sipas nenit 300 të Kushtetutës së Republikës së Serbisë.

at janë konstatuar si të tilla në forumet kompetente në të kaluarën[9]. Nga tërë kjo që u tha deri më tani, propozoj edhe dy gjëra si vijon:

a. që gjatë harmonizimit të qëndrimeve lidhur me këtë çështje, të merret parasysh koncepti themelor që Federata është subjekti i vetëm i së drejtës ndërkombëtare dhe marrëdhënieve që zhvillohen mbi këtë bazë dhe që kompetencat e kufizuara të njësive federale, sikundër do të thoshte prof. S. Avramov, mos të kuptohen ashtu sikur ato janë subjekte të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, por të kuptohen në atë mënyrë që ato si të tilla (pra republikat dhe krahinat autonome) marrin pjesë në përcaktimin dhe realizimin e politikës së jashtme të RSFJ dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, të përcaktuara nga Kuvendi i RSFJ, pra, si kreatore të një politike të përbashkët ndaj çështjeve ndërkombëtare në kuadër të të drejtave dhe detyrave të tyre si dhe të parimeve themelore të Kushtetutës së RSFJ dhe të vetë Kushtetutës lidhur me këtë çështje;
b. që Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës t'i mundësohet baza juridike për pjesëmarrjen e saj (në kuadër të politikës së jashtme të përcaktuar nga Kuvendi i RSFJ dhe kur kjo është në interes të RSS si tërësi) në bashkëpunimin ekonomik ndërkombëtar, kulturor dhe format tjera të bashkëpunimit.

Këto i propozojmë nga shkaku se RSFJ vetëm në këtë mënyrë mund të marrë pjesë në përsosjen dhe zhvillimin e proceseve tekniko-teknologjike të botës bashkëkohore, ndarjen ndërkombëtare të punës, dhënies së kontributit të saj në proceset politike të popujve të ndryshëm për çlirim nacional e social në pajtim me parimet e Kartës së OKB-së dhe parimeve të Lëvizjes së Mosinkuadrimit. Se një proces të tillë demokratik e përkrah dhe e synon vendi ynë shihet edhe nga mbledhja e fundit ministrore e vendeve të painkuadruara, mbajtur në Nikozi (Qipro) prej 7 deri 10 shtator të këtij viti (1988) dhe besimi që iu dha në të.

Së fundi, si pasojë logjike e tërë kësaj del se, krahas ruajtjes së vlerave themelore të arritura duhet gjetur zgjidhje të reja për shoqërorizimin dhe deetatizimin e mëtejmë të politikës së jashtme, të këtij funksioni kaq të rëndësishëm, por gjithherë duke respektuar specifikat e krahinave autonome, të cilat

[9] Stevan Đorđević, *Republike i pokrajine u medunardnim odnosima jugoslovenske federacije* (Naučna Knjiga: Beograd, 1985) fq. 180-187.

gjenden në kuadër të RSS dhe të cilat janë njëkohësisht elemente konstitutive të federatës sonë.

II. Sovraniteti dhe vetëvendosja

Objekt trajtimi në këtë punim do të jetë çështja e sovranitetit përgjithësisht, duke nënkuptuar këtu vetvetiu të drejtën për vetëvendosje, si pertinencë imanente të sovranitetit si nocion. Shtjellimet tona këtu do të orientohen në të drejtën për vetëvendosje si dimension i sovranitetit, andaj edhe nocionin e sovranitetit e kemi konceptuar në kuptimin e tij më të ngushtë — të së drejtës për vetëvendosje. E shohim të rrugës që përkohësisht të theksojmë, para se të flasim për sovranitetin si nocion gjuhësor, se sovraniteti nënkupton atë që populli (kombi) është apo ka të drejtë për vetëvendosje në të gjitha sferat e jetës së tij dhe, *vice versa*, e drejta e popullit për vetëvendosje është e drejtë sovrane, e patjetërsueshme e tij për të përcaktuar kursin e zhvillimit të vet të përgjithshëm (në të gjitha dimensionet).

Fjala *sovranitet*, si nocion gjuhësor etimologjikisht rrjedh nga italishtja *sovranità*, që d.m.th. pushteti më i lartë shtetëror, pavarësia e plotë e një vendi, ndërsa fjala *sovran* nga latinishtja — *sovrano*, që d.m.th. kryesor, i pakufizuar[10]. Në kuptimin përshkrues, nocioni gjuhësor i sovranitetit nënkupton "të drejtën që gëzon çdo popull e çdo shtet për të vendosur në mënyrë të lirë e të pavarur për çështjet e veta dhe për marrëdhëniet me shtetet e tjera, pa iu nënshtruar asnjë ndërhyrjeje, urdhri ose kontrolli nga të tjerët". Në anën tjetër, fjala sovran ka këto kuptime: "një, që gëzon sovranitet apo që ka të bëjë me sovranitetin; nën dy, që është i lirë dhe i pavarur për të ushtruar pushtetin më të lartë pa iu nënshtruar dikujt tjetër; dhe, së fundi, që i përket dikujt me të drejtë dhe me ligj apo që qëndron më lart se çdo gjë tjetër"[11].

Sovraniteti është një nocion mjaft kompleks dhe në pikëpamje teorike kontrovers. Kështu, p.sh., në një pjesë të teorisë mohohet me arsyetimin se është inkompatibil me sistemin e përgjithshëm të shkencës (Leon Duguit), zhvillimin e bashkësisë ndërkombëtare (Hugo Preuss), apo për arsye se është e pamundur që të vërtetohet në mënyrë precize përmbajtja e tij (J.W. Garner).

---

[10] Mikel Ndreca, *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja* (Rilindja: Prishtinë, 1986) fq. 650.
[11] Androkli Kostallari, *Fjalor gjuhës së sotme shqipe* (Rilindja: Prishtinë, 1981) fq. 1777.

Mirëpo, që nga koha e konceptimit teorik të sovranitetit, arkitekt ideor i së cilës është Jean Bodin (Zhan Boden, 1530-1596), e gjer më sot, si çështje imanente shtrohet ajo se kujt i takon *suprema potestas* (pushteti suprem), përkatësisht kush janë bartës të sovranitetit: populli, kombi, shteti apo qytetari. Thënë me fjalë të tjera, cila formë e rregullimit të shoqërisë në shtet, përkatësisht cila formë e sanksionimit juridiko-kushtetues të raporteve ndërnjerëzore dhe ndërmjet popujve ofron garanci për zhvillim dhe prosperitet demokratik të të gjithëve[12]. Kjo nga shkaku se në konceptimin e sovranitetit, siç do të shihet në vijim, duhet nisur jo nga koncepti thjesht pragmatik, përkatësisht pa u futur në përmbajtjen juridiko-filozofike të këtij fenomeni mjaft kompleks.

Teoria dhe praktika e vendeve kapitaliste sovranitetin dhe të drejtën për vetëvendosje e ka konceptuar në mënyrë klasike (tradicionale), pra si nocion shumëdimensional politik, juridik, ekonomik etj., pa futur në të qasje ideologjike. Në pikëpamje të burimit të tij, në vendet perëndimore i është dhënë përparësi bazës natyrore, përkatësisht bazamentit të së drejtës natyrore të sovranitetit dhe së drejtës për vetëvendosje. Rrjedhimisht, teoria perëndimore ka krijuar dhe përqafuar konceptin klasik të "sovranitetit të pakufizuar", përkatësisht kufizimin e tij vetëm në interesin e përbashkët dhe, në raste konkrete e taksativisht të njohura në pikëpamje juridike. Përkundrazi teoria politike dhe praktika e vendeve socialiste vazhdimisht ka theksuar në mënyrë diskrete natyrën klasore të këtij fenomeni, dallimet të cilat ekzistojnë ndërmjet qasjes borgjeze dhe marksiste të këtij nocioni. Këto ide, të cilat në tërësi bazohen në shqyrtime ideologjike, do të arrijnë kulminacionin e tyre teorik vetëm në vitet pesëdhjetë të këtij shekulli dhe do të shërbejnë si bazë e teorisë, siç e quajtën teoricienët italianë "*la teoria e famigerata della sovranità limitata*" (teoria famëkeqe mbi sovranitetin e kufizuar të vendeve socialiste) (shih autorët rusë: Tunkin, Korovin, Bilisçenko, Usenko etj.). Sipas këtyre autorëve komunistë, koncepti tradicional i sovranitetit aplikohet edhe sot në marrëdhëniet ndërmjet shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore-ekonomike.

Çdo futje e elementeve ideologjike në konceptimin e sovranitetit domosdo që shpie në deformime esenciale me pasoja praktike. Një definim të tillë ideologjik të sovranitetit dhe të së drejtës për vetëvendosje e kemi pasur edhe në RSFJ. Kështu, p.sh., Kushtetuta e fundit e vitit 1974 në parimet themelore (IV) ka paraparë si parim të rendit dhe të sistemit shoqëror-politik "sovranit-

---

[12] Smilja Avramov, "Suverenost u suvremenoj doktrini i praksi", *Jugoslovenska Revija za Medjunarodno Pravo* nr. 1-3 (IMPP: Beograd, 1979) fq. 29.

etin e popullit punues dhe vetëqeverisjen". A është bartës i sovranitetit populli jopunues [sic]? A janë bartës të sovranitetit ata që nuk punojnë me mjetet në pronësinë shoqërore dhe rrjedhimisht, si të tillë, nuk kanë të drejta vetëqeverisëse [sic]? Në makroplanin jugosllav, e drejta e kombeve për vetëvendosje (duke nënkuptuar këtu edhe shkëputjen) ka qenë e kufizuar me "interesat e bashkësisë së gjerë socialiste vetëqeverisëse, pasojat e së cilës kanë qenë praktike: disa popujve, p.sh., kroatëve dhe sllovenëve, një kohë të gjatë u është imponuar sovraniteti i kufizuar në interes të "tërësisë territoriale dhe interesave të bashkësisë socialiste jugosllave (lexo: serbo-sllave)", ndërsa të tjerëve, p.sh., shqiptarëve, u ka sjellë robërinë dhe okupimin klasik. Teoria mbi sovranitetin e kufizuar në teorinë jugosllave (lexo prapë: serbo-sllave) është paraqitur me një emërtim tjetërfare: "teoria mbi sovranitetin e konsumuar", përkatësisht si "teoria mbi të drejtën e konsumuar për vetëvendosje". Në raport me pjesën jugore të "bashkësisë socialiste", integriteti territorial dhe sovraniteti i bashkësisë jugosllave akoma përdoren si alibi për dhunë e represion shtetëror, duke mos harruar këtu frazat shoqëruese si relikte të real-socializmit mbi "armiqtë e popullit", "nacionalistët shqiptarë" etj. Termi "kundërrevolucion" u hoq nga përdorimi, pasi u vërejt se bota e qytetëruar perëndimore me të nënkuptonte një lëvizje përparimtare për të drejta njerëzore dhe sovranitet popullor pa elemente ideologjike.

E drejta e popullit për vetëvendosje ose ekziston ose nuk ekziston. Mund të qëndrojë teza se populli është sovran ose është i robëruar, nën mandat, kujdestari apo protektorat ndërkombëtar, dhe kështu me radhë. Mirëpo, asnjëherë nuk mund të qëndrojë teoria mbi të ashtuquajturin sovranitetin apo të drejtë e konsumuar për vetëvendosje. Kjo teori, e lansuar më herët dhe e aktualizuar sërish këto dy vitet e fundit në Republikën Socialiste të Serbisë, nuk ka arritur efektet e pritura. Përkundrazi, në pjesët e tjera të Jugosllavisë, vitet e fundit u forcua vetëdija nacionale, si pasojë e koncepteve hegjemoniste serbomëdha. Mbrojtja kolektive e një pjese të "sovranitetit dhe të integritetit territorial të bashkësisë socialiste jugosllave (lexo: serbo-sllave)", në emër të ideologjisë komuniste, në esencë u tregua si tentim i legalizimit të së drejtës për intervenim ushtarako-policor edhe në pjesët e tjera të Jugosllavisë, pra jo vetëm kundër Kosovës dhe jo vetëm kundër shqiptarëve.

Kërkesa për vetëvendosje është një dimension i rëndësishëm i kërkesës për liri në botën e sotme. Ajo është kërkesë e qenies njerëzore për t'u identifikuar me grupet e caktuara etnike, të cilat arrijnë t'i shtyjnë përpara më së mi-

ri synimet e tyre qoftë individuale apo grupore[13]. Në kuptimin më të gjerë, kërkesa për vetëvendosje mund të ndahet në dy kategori themelore:

a. kategoria e parë përfshin kërkesat për krijimin (formimin) e një entiteti të ri shtetëror; kjo është kërkesë e grupit brenda një entiteti tanimë ekzistues për të formuar entitetin e ri shtetëror nga pjesa e entitetit paraekzistues;
b. kategoria e dytë përfshin kërkesat që nuk përmbajnë kërkesën për entitet të ri shtetëror, por theksojnë si vijon: kërkesat e një entiteti për të qenë i lirë nga dhuna e jashtme (p.sh., rasti momental i Sllovenisë); kërkesat e entitetit për të përmbysur sunduesit e vet efektivë dhe për të krijuar qeverinë e re në tërë entitetin (e drejta për revolucion); dhe, së fundi, kërkesat e grupit brenda një entiteti për mbrojtje të veçantë dhe autonome.

Ky punim ka të bëjë në rend të parë me kategorinë e parë, përkatësisht me kërkesën e kolektivitetit brenda një entiteti ekzistues për të formuar një entitet të ri nga pjesa e entitetit paraekzistues dhe gjithandej për të formësuar dhe ruajtur procesin e vendosjes së brendshme dhe marrëdhëniet e jashtme. Duke u nisur nga ky segment i së drejtës për vetëvendosje, Kuvendi i Kosovës, si organ i vetëm legjitim i popullit shumicë të Kosovës, më 7 shtator 1990 miratoi *Rezolutën* në të cilën thuhet si vijon:

> DUKE U NISUR NGA E DREJTA PËR VETËVENDOSJE, duke respektuar vullnetin sovran të popullit shqiptar të shprehur në mënyrë plebishitare në tërë Kosovën, mbi subjektivitetin juridik-politik dhe formën e realizimit të atij subjektiviteti të shprehur në DEKLARATËN KUSHTETUESE të 2 korrikut 1990, Kuvendi i Kosovës në mbledhjen e përbashkët të të tri dhomave të mbajtur më 7 shtator 1990 në Kosovë, ka miratuar dhe ka shpallur KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS me të gjitha dokumentet përcjellëse, dhe ka sjellë Ligjin mbi bashkimin politik të qytetarëve; Ligjin mbi zgjedhjet dhe vendimet e tjera të nevojshme për punën e Kuvendit të Kosovës dhe vendosjen në Kuvendin e Jugosllavisë.

Nga aspekti i së drejtës ndërkombëtare, vlen të thuhet se dy paktet ndërkombëtare — Pakti mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Pakti mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966) i kanë lënë vend të duhur normimit të parimit të vetëvendosjes. Këto dokumente ndërkombëtare, në fjali të

---

[13] Lung-chu Chen, "Self-Determination: An Important Dimension of the Demand for Freedom", *American Society for International Law Proceedings* 75 (April 1981) fq. 89-90.

njëjta, proklamojnë, në nenin e tyre të parë, si vijon: "Të gjithë popujt kanë të drejtën e vetëvendosjes. Në bazë të kësaj së drejte, ata lirisht përcaktojnë statusin e tyre politik dhe lirisht synojnë zhvillimin e tyre ekonomik, social dhe kulturor."

Parimi i vetëvendosjes, ç'është e vërteta, ka qenë i afirmuar dhe i riafirmuar, në planin ndërkombëtar, edhe më herët që nga miratimi i Deklaratës Orientuese mbi Njohjen e Pavarësisë së Vendeve dhe Popujve Kolonialë (1960). Megjithatë, ka qenë miratimi i Deklaratës mbi Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare, të cilat kanë të bëjnë me Marrëdhëniet Miqësore dhe Bashkëpunimin mes Shteteve në pajtim me Kartën e OKB-së (1970). Shumë rezoluta tjera janë nxjerrë më pastaj që kanë konfirmuar normimet si më sipër të parimit të vetëvendosjes dhe realizimin e tij në praktikë.

Në vijim, si më sipër, lidhur me të drejtën për vetëvendosje dhe sovranitet në teorinë dhe në praktikën bashkëkohore, janë paraqitur disa çështje të diskutueshme:

a. kush është i denjë (ang. *eligible*) për vetëvendosje;
b. në çfarë mënyre realizohet ajo (me dhunë apo në mënyrë paqësore);
c. a është parimi i vetëvendosjes në kundërshtim me integritetin territorial të entitetit ekzistues shtetëror.

Së pari, duhet theksuar se unanimisht përqafohet pikëpamja se vetëm popujt/kombet kanë të drejtë për vetëvendosje, ndërsa pakicat kombëtare (ang. *national minorites*) nuk e kanë këtë të drejtë. Nocioni "pakicë kombëtare" askund nuk definohet me dokumente ndërkombëtare. Ajo çka zakonisht ndodh është logjika që sipas enumeracionit negativ numërohen (përshkruhen) konditat të cilat duhet të përmbushë një kolektivitet etnik për t'u trajtuar si komb, kurse të tjerët konsiderohen si minoritete. Karta e OKB-së, në nenin 1(2) përmend "vetëvendosjen e popujve" (ang. *selfdetermination of peoples*) dhe gjithandej i lë dyert e hapura gjerësisht për argumentin për atë se kush ka të drejtë për vetëvendosje — kush konstituon njësinë (entitetin) vetjake vetëvendosëse.

Në praktikën e OKB-së, disa nga faktorët bazë në përcaktimin e "popullit/kombit" që ka të drejtën për të ushtruar vetëvendosjen, kanë qenë: faktorët sociologjikë, gjeografikë, historikë, psikologjikë, dhe politikë. Në një pjesë të teorisë, këto kritere bazë të "popullit/kombit" janë ndarë në kritere objektive

dhe subjektive[14]. Mirëpo, dëshirat e popullit, elementi subjektiv, si dhe kërkesat, synimet dhe veçoritë e një kolektiviteti, parimisht kanë pasur vlerë të madhe. Nga kjo del se populli duhet vetë të përcaktojë veprimtarinë e ekzistencës së tij të përbashkët dhe të vendosë kriteret për përkatësinë grupore. Këtu nuk mund të ketë vend për diktat nga jashtë: një popull nuk mund të urdhërojë se populli tjetër nuk është i denjë për të qenë popull/komb. Kësisoj nuk është e drejtë e serbëve për të vendosur atributet e nevojshme për formimin e popullit shqiptar e as për shqiptarët për të vendosur anasjelltas. Sikundër që një individ, në anën tjetër, nuk mund të hyjë pa leje (dëshirë) dhe ta detyrojë popullin për ta pranuar atë në gjirin (krahun) e tij. Këtu kemi parasysh çdoherë kriterin "shumicë e popullit" (*majority of people*) në një territor gjeografikisht kompakt. Teoria dhe praktika juridiko-politike jugosllave (lexo: serbo-sllave) në këto troje, në raport me shqiptarët, kanë një pikëpamje unike: shqiptarët janë pakicë kombëtare dhe, rrjedhimisht, duhen trajtuar, përkatësisht duhen futur në "kornizat" e standardeve juridiko-ndërkombëtare mbi pakicat kombëtare. Kjo do të thotë se sovraniteti dhe e drejta e popullit shqiptar për vetëvendosje është inkompatibile me vetë qenien e tij si "pakicë kombëtare". Argumentet për këtë janë thjesht të natyrës pragmatike dhe formalo-juridike.

Sovraniteti shtetëror bazohet në monopolin e dhunës fizike të shtetit, i cili monopol e bën shtetin të pavarur nga jashtë dhe nga brenda. Sovraniteti popullor, ndërkaq, është një nocion që ka të bëjë me popullin e jo me shtetin. Ndërsa sovraniteti nacional është veçori e kombit: derisa populli është tërësia e qytetarëve të cilët bien nën të njëjtin pushtet shtetëror, përkatësia nacionale është përkundrazi i pavarur nga aparati shtetëror[15]. Nga ky sqarim qartë shihet se retorika për sovranitetin dhe të drejtën e popullit shqiptar në Kosovë për vetëvendosje janë çelësi që ka udhëhequr popullin shqiptar që nga vitet 30 të shek. XIX (koha e vetëdijesimit nacional të shqiptarëve që ka filluar me Tanzimatin) e gjer më sot. Këtë veçori nuk kanë mundur t'ia marrin as Shën Stefani (1878), as Kongresi i Berlinit (1878), as Konferenca e Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha në Londër (1912-13), as Traktati i Versajës (1919), as Kushtetuta e Vidovdanit (1920), as Protektorati i Italisë (1939), as okupimi gjerman (1941), as "Rezoluta për aneksimin e Kosovës e Metohisë në Serbinë Federale" (Prizren: 1945), as kushtetutat jugosllave pas Luftës së Dytë Botërore

[14] Yoram Dinstein, "Collective Human Rights of Peoples and Minorities", *International and Comparative Law Quarterly* vol. 25, issue 1 (January 1976) fq. 103.
[15] Radomir Lukić, *Uvod u Pravo* (Naučna Knjiga: Beograd, 1981) fq. 37.

(1946, 1963, 1974), përfshirë në fund këtu edhe Kushtetutën "më demokratike" të Republikës të Serbisë (datë 28 shtatorit 1990). Nga kjo del se gabon rëndë kryetari i Kryesisë së RSFJ, Borisav Joviq, kur deklaron në mbledhjen vjetore të 45-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (shtator 1990) se: "shqiptarët janë pakicë kombëtare dhe se për këtë arsye nuk kanë të drejtë të formojnë shtetin e vet dhe nuk kanë të drejtë për shkëputje". Kjo për shkaku n se, siç e thamë më herët, statusin e pakicës kombëtare nuk mund t'ia caktojë askush askujt me dekret: sa e sa herë është thënë në teori ndërkombëtare se nocionin pakicë kombëtare duhet përdorur me kujdes të duhur[16]. Jo vetëm kaq: edhe faktorët objektivë rrethanorë dëshmojnë një gjë të tillë. Kështu, ta zëmë, nëse merret parasysh numri, atëherë shqiptarët janë populli i tretë në Jugosllavi. Nëse merret parasysh elementi i ashtuquajtur "shtetformues", atëherë duhet thënë se mbi 53.000 luftëtarë nga Kosova kanë marrë pjesë në luftën kundër fashizmit italian dhe nazizmit gjerman. Në pikëpamje gjeografike, Kosova pa dyshim se paraqet një tërësi gjeografike më vëllimore dhe me popullsi më kompakte se, ta zëmë, Mali i Zi, Maqedonia dhe republikat e tjera të Jugosllavisë. Sikundër mund të vërehet, në teorinë dhe praktikën juridiko-politike të Jugosllavisë, si kriter merret kontinuiteti shtetëroro-juridik i Serbisë dhe Malit të Zi me Jugosllavinë e Versajës (1918-1945), në njërën anë, dhe Jugosllavisë së pas-Luftës së Dytë Botërore, në anën tjetër. Për periudhën para Luftës së Parë Botërore, në teori, Prof. Dr. Gavro Peraziq pohon se prej Kongresit të Berlinit e deri më 1912 bëhet fjalë për kufijtë ndërmjet Turqisë Otomane dhe Malit të Zi, prandaj Kosova kurrë nuk ka qenë dhe nuk mund të jetë njësi shtetërore, sidomos jo e shtetit shqiptar[17].

Këto kritere për vlerësimin dhe vështrimin e çështjes së popullit shqiptar në këto troje janë pragmatike dhe thjesht formalo-juridike, të cilat në literaturën dhe në praktikën e sotme qytetëruese nuk merren parasysh. Shqiptarët kanë qenë dhe janë sovran, asnjëherë nuk kanë qenë të administruar, si p.sh., nga Lidhja e Kombeve apo ndonjë institucion tjetër ndërkombëtar, aq më pak nga popujt e tjerë. Ka kaluar koha e kalkulimeve mbi gjoja "paaftësinë" e shqiptarëve për vetorganizim, të cilat dikur i servoheshin Evropës.

Së dyti, për sa i përket metodës, *plebishiti* paraqet një praktikë mjaft të dobishme gjykuar nga përvojat e vendeve të tjera. E drejta për vetëvendosje ka konotacionin e vet ekonomik, social dhe kulturor, por vetë esenca e saj

---

[16] Për një kritikë të tillë, shih më shumë në Yoram Dinstein, "Collective Human Rights of Peoples and Minorities", fq. 113.

[17] Dr. Gavro Perazić, *Skadarsko jezero i rijeka Bojana u medjunarodnom pravu* (CID: Titograd, 1981) fq. 23-24.

konsiston në statusin politik të popullit përkatës. Kjo esencë nënkupton se populli, nëse dëshiron, ka të drejtë për t'u pavarësuar nga dominimi i jashtëm, përkatësisht ai mund të krijojë shtetin sovran në territorin në të cilin jeton dhe përbën shumicën. Kjo vlen për të gjithë popujt nën dominim të huaj, pa marrë parasysh statusin juridiko-politik të dominimit. E drejta ndërkombëtare moderne përshkruan vetëvendosjen e cila është e shoqëruar (ngarkuar) me barot politik dhe psikologjik, mirëpo ajo nuk ka përgjigje për pyetjen se në çfarë mënyre do të vihej në jetë ajo, pra vetëvendosja, në rast se populli tjetër në po atë entitet shtetëror do të kundërshtonte një gjë të tillë. Kjo do të gjejë shprehje sidomos në shtetet me strukturë heterogjene nacionale, të cilat nuk janë të bazuara në parimet liberale apo ku është i rrënjosur fanatizmi dhe mostoleranca, e cila nuk mund të zbutet me asgjë (p.sh., struktura jotolerante e Jugosllavisë si shtet që nga 1918 e gjer sot). Gjendja e tillë shpie domosdo në luftë civile. Në situatën e tillë, kur parimi i vetëvendosjes si *lex desiprata* bie në kundërshtim me *lex lata* të entitetit shtetëror ekzistues, dialogu politik dhe plebishiti janë alternativë e vetme dhe e dëshirueshme, kundruall forcës dhe dhunës.

Deri te lindja e suksesshme e Bangladeshit si shtet i pavarur më 1971, gjerësisht vlerësohej në botën bashkëkohore se parimi i vetëvendosjes nuk përfshin domosdo të drejtën për shkëputje në kuptim të thyerjes grupore me dhunë të një entiteti ekzistues shtetëror. Suksesi i Bangladeshit rrënjësisht ka ndryshuar shpresat e popujve. Populli shqiptar i Kosovës u përcaktua për plebishit dhe dialog politik, në realizimin e së drejtës së patjetërsueshme për vetëvendosje. Në Rezolutën e Kuvendit të datës 9 shtator 1990 është cekur vullneti i shprehur në mënyrë plebishitare i popullit shqiptar në tërë Kosovën lidhur me statusin e tij politik në mënyrë që mbi këtë bazë të ndërtohet jeta e përbashkët me të tjerët në Jugosllavi, gjë që është konfirmuar edhe në nenin e parë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili thotë si vijon: "Republika e Kosovës është shtet demokratik i kombit shqiptar dhe i pjesëtarëve të kombeve të tjera dhe i pakicave kombëtare, të shtetasve të vet: serbëve, myslimanëve, malazezëve, kroatëve, turqve, romëve e tjerëve që jetojnë në Kosovë."

Sikundër shihet, Kuvendi i Kosovës nuk ka bërë reduktimin e statusit politik të asnjë kombi në pakicë kombëtare, sepse një gjë e tillë është e pamundshme. Nuk është cilësi veçuese e kombit statusi i tij kushtetues-juridik.

Së treti, doktrinat juridike operojnë lidhur me komplementaritetin ndërmjet vetëvendosjes dhe integritetit territorial. A është konflikti ndërmjet integritetit territorial dhe vetëvendosjes i papajtueshëm? Thënë me fjalë të tjera, a do të jetë vetëvendosja relevante në rast të secesionit? Natyrisht se po, sepse

vetëvendosja është një proces i vazhdueshëm i popujve për të farkuar dhe shprehur identitetin e tyre të ndarë dhe për t'ia përshtatur atë kushteve të ndryshueshme. Shikuar në retrospektivin historik të shqiptarëve, ajo paraqitet si çështje e bashkimit të "*katër kalemave*" (katër ish-vilajeteve të Perandorisë Osmane: Kosovës, Janinës, Manastirit dhe Shkodrës).

Esenca e mirëfilltë e vetëvendosjes është hulumtimi për identitet të përgjithshëm dhe përpjekja e pareshtur për t'u bashkuar me qeniet e tjera të barabarta në synimet e përbashkëta për pjesëmarrje maksimale në pushtet, respektim reciprok dhe në të gjitha vlerat e tjera universale njerëzore. Vetëvendosja është hulumtimi i vazhdueshëm për modelin e jetës së përbashkët që është më e dëshirueshmja për të ngritur cilësinë e jetës për të gjithë ata që janë të përfshirë në kuptim, ta zëmë, të sigurisë, respektit të veçantë, pushtetit të ndarë etj. Derisa të lëvizin proceset sociale, qenia njerëzore nuk do të pushojë së kërkuari identitetin individual dhe grupor, për të gjetur mënyra të bashkëpunimit ose mosbashkëpunimit me individë dhe kolektivitete të caktuara etnike. Vetëvendosja nuk është marrëdhënie e shkurtër (ang. *one-shot affair*), apo marrëdhënie "blic". Synimi për pavarësi nga varësia nuk i mbyll aspiratat njerëzore për të kërkuar identitet adekuat grupor dhe bashkim me qëllim mbrojtjen dhe realizimin e të gjitha vlerave të rëndësishme. Kjo është shprehur qartë edhe në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku janë përmbledhur të gjitha këto synime natyrore të popullit shqiptar që, së bashku me tjerët, të kërkojë rrugë dhe kritere tjera të jetesës së përbashkët në këtë nënqiell. Gjithnjë e më shumë po bëhet e qartë se përkrahja e parezervë e integritetit territorial nuk është veçori që duhet ruajtur kur populli i cili kërkon liri është subjekt i privimit sistematik të të drejtave njerëzore në shkallë të gjerë. Parimi i integritetit territorial nuk mund të shërbejë si mburojë për tiranët, diktatorët dhe udhëheqësit totalitarë. Integriteti territorial nuk mund të bëhet paravan prapa të cilit arsyetohen mohimet njerëzore ose bëhen të përhershme. Sot bota është mjaft e ndërvarur, qeniet njerëzore jetojnë në afërsi të mëdha, aq sa për të lejuar dhe arsyetuar *doktrinën e juridiksionit ose të integritetit territorial* që të shërbejë si një instrument i shtypjes dhe i robërimit të popujve. Perandoritë lindin dhe bien, shtetet nacionale shkojnë e vijnë, mirëpo aspiratat e njeriut për mirëqenie, për liri dhe dinjitet njerëzor do të ngelen të forta (Woodrow Wilson).

Së katërti, duhet theksuar fort se *e drejta natyrore është bazamenti mbi të cilin qëndron dhe ekziston e drejta për vetëvendosje dhe sovranitet popullor, për të lidhet kuptimisht dhe merr fizionomi të caktuar dhe konkrete.* Fillimisht, sovraniteti dhe e drejta e popujve për vetëvendosje kanë qenë të koncep-

tuara si kategori juridike dhe politike, mbi bazën e të "drejtës hyjnore dhe natyrore". Ky koncept paraqet triumfin e individualizmit mbi konceptin universal të botës së ndërtuar nga ana e Kishës Katolike. Ky triumf ka nisur në teori me filozofin Jean Bodin, i cili në veprën e tij të njohur *Les Six Livres de la Republique* (1576), ka definuar sovranitetin (shtetëror) si pushtet më të lartë të shtetit mbi shtetasit, të pakufizuar me ligje. Mirëpo, fjalën "të pakufizuar" ai nuk e merr në kuptimin e saj absolut. Në të vërtetë, Bodin bën dallim ndërmjet ligjit dhe së drejtës, sepse sovran do të thotë të jesh mbi ligjet e vendit dhe pasjen e mundësisë për ndërrimin e tyre. Si anëtar i bashkësisë së gjerë njerëzore, ndërkaq, sovrani (kombi) i nënshtrohet "së drejtës hyjnore dhe natyrore", e cila i obligon të gjithë popujt. Më vonë, me kalimin e kohës, është kaluar në ekstremizëm subjektiv në interpretimin e së drejtës natyrore nga ana e teoricienëve borgjezë, ashtu që ka ardhur deri te krijimi i së drejtës pozitive nga ana e shtetit, por gjithsesi në bazë të vlerave kryesore të së drejtës natyrore. Në këtë mënyrë, është krijuar një sintezë e frytshme ndërmjet së drejtës natyrore dhe pozitive, rezultatet e së cilës, më vonë, janë inkorporuar në të gjitha dokumentet ndërkombëtare që vlejnë sot e kësaj dite, duke filluar nga Deklarata mbi Pavarësinë e ShBA-së (1776), Deklarata e Francës mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit (1789), si dhe të gjitha dokumentet tjera në planin ndërkombëtar. Zakonisht si shembull për citim shërben Deklarata e Francës, e cila në nenin e parë thekson se njerëzit lindin, mbesin të lirë dhe të barabartë në të drejta, kurse në nenin e tretë konfirmon se "çdo sovranitet esencialisht bazohet në popull, ashtu që asnjë trup, asnjë individ, nuk mund të ushtrojë pushtetin i cili nuk buron nga populli. Kjo ka shërbyer si bazë e të gjitha dokumenteve ndërkombëtare në këtë lëmi, si dhe bazë për implementim të brendshëm në planin kushtetues-juridik. Duke u nisur nga kjo që u tha, përpiluesit e Kushtetutës së Republikës së Kosovës kanë inkorporuar në tekstin e saj në tërësi germën dhe frymën e këtyre dokumenteve.

III. Vetëvendosja dhe rasti i Kosovës

Hyrje

Me qëllim të pasjes së një pasqyre sa më të qartë rreth natyrës, caqeve dhe kontekstit të zbatimit të vetëvendosjes, si parim dhe si e drejtë, ne diskutojmë

këtu edhe çështjet që kanë të bëjnë me historikun e vetëvendosjes, si edhe mënyrën e zbatimit të saj në vitet e pasmbarimit të Luftës së Ftohtë. Pa një qasje të tillë as që është i mundur kuptimi i vetëvendosjes në kontekstin kosovar, pra, si mohimi i njohjes së Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur, ashtu edhe njohja e saj në kohët që vijnë. Në vijim të kësaj, kapitulli i parë i kushtohet paraqitjes së ideve kryesore dhe të dokumenteve në nivel nacional, që si të tilla kanë shtruar rrugën e zhvillimit dhe përfshirjes definitive të vetëvendosjes si parim dhe si e drejtë. Këto çështje kapin periudhën deri në mbarim të Luftës së Ftohtë. Kapitulli i dytë ka të bëjë me kohën e pasmbarimit të Luftës së Ftohtë. Ne diskutojmë disa nga çështjet e vetëvendosjes, ashtu si janë parë nga vetë akterët dhe teoricienët ndërkombëtarë lidhur me caqet e zbatimit të vetëvendosjes, përkatësisht bindjet se ajo ishte e zbatueshme kryesisht brenda kontekstit kolonial. Çështja e shpërbërjes së ish-Bashkimit Sovjetik, si një nga federatat socialiste, do të jetë objekt i kapitullit të tretë dhe i referohet zbatimit, për herë të parë, të vetëvendosjes jashtë kontekstit kolonial. Në kapitullin e katërt dhe të fundit të këtij shkrimi, vëmendje e veçantë i kushtohet bazës mbi të cilën ka qëndruar zbatimi i vetëvendosjes në rastin e ish-Jugosllavisë.

Rasti i Kosovës dhe mosrealizimi i vetëvendosjes, me kuptim pavarësinë e plotë të saj, po ashtu është futur në këtë pjesë. Rasti i Kosovës është i rëndësishëm për arsye politike për faktin e stabilitetit rajonal dhe rolin kyç të Kosovës në të. Kuptimi i drejtë i mosinkurajimit nga ana e bashkësisë ndërkombëtare i lidershipit kosovar për rrugën violente me qëllim të arritjes së pavarësisë nxjerr në pah faktorët politikë që kanë qenë prapa stabilitetit rajonal dhe rolin e Kosovës në të. Mosinkurajimi i llojit violent të vetëvendosjes së Kosovës, me kuptim pavarësinë e plotë të saj, ka qenë hap i gabuar dhe i padrejtë nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, sepse Kosova ka plotësuar dhe plotëson të gjitha parakushtet e parashikuara në Kriteret e Njohjes të Bashkësisë Evropiane (tani Unioni Evropian: UE), të datës 16 dhjetor 1991 dhe të operacionalizuara në Mendimin e Komisionit të Arbitrazhit për ish-Jugosllavinë (Komisioni Badinter), të dhëna në vitet 1991-1993.

1. Historiku i vetëvendosjes

Dëshira për vetëvendosje është e vjetër. Ideja për vetëvendosjen, si një e drejtë, është moderne, përfshirë edhe dokumentet mbi këtë. Të parat ide dhe dokumente të kësaj natyre kanë qenë të nivelit nacional, por që kanë pasur

një ndikim të madh jashtë kufijve ku kanë lindur apo kur janë përpiluar. Nga lloji i fundit, më i rëndësishmi është Deklarata mbi Pavarësinë e ShBA-së (1776), pa harruar këtu edhe idetë e Revolucionit Francez (1789) që u inkorporuan në Deklaratën mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit.

John Locke (Xhon Lok) vuri bazat e së drejtës për vetëvendosje, duke e nxjerrë këtë nga supozimi i të drejtave natyrore të individëve. Nga ky doli konkluzioni se individët kanë të drejtën e lënies se bashkësive politike me të cilat ata nuk pajtoheshin dhe se shumica kishte të drejtën e rezistimit të tiranëve. Qasje tjetër qe nisur nga Jean-Jacques Rousseau (Zhan-Zhak Ruso) dhe doktrina e tij mbi sovranitetin popullor. Revolucioni Francez dramatizoi idenë e demokracisë si sovranitet popullor dhe shtetin si i përbërë prej një kombi. Në shekullin XIX, ideologjia zyrtare zakonisht trajtonte shtetet dhe kombet si të barasvlershme. Ky koncept, megjithatë, u sfidua nga lindja e nacionalizmit etnik dhe shtetet ranë në konflikt me të drejtat nacionale dhe kundërvënien e këtyre të drejtave shteteve ekzistuese.

Idetë e Leninit mbi vetëvendosjen e popujve po ashtu kanë pasur një efekt mobilizues gjatë Revolucionit të Tetorit (1917) dhe një kohë të gjatë pas tij[18]. Në shtetet ish-socialiste dhe në doktrinën e tyre është menduar sikur "mendimi klasik marksist ka qenë shumë i kujdesshëm lidhur me parimin dhe të drejtën e popujve për vetëvendosje"[19]. Në këto vende besohej se vetëvendosja mund të zbatohej vetëm në kontekstin kolonial[20]. Kjo pikëpamje u tregua si e gabuar pas mbarimit të Luftës se Ftohtë, dhe ishin pikërisht këto shtete, ku vetëvendosja, në njërën prej formave të saj, u realizua apo mohua. Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, presidenti Woodrow Wilson (Vudro Vilson) paraqiti, në njëmbëdhjetë pikat e tij famoze, parimin e vetëvendosjes si një ideal të demokracisë, përkundër asaj që në pikën e dymbëdhjetë ai kishte propozuar që Serbia të ketë dalje në det, pa pasur shumicën e popullsisë përgjatë tij[21]. Kjo ide u fundos si pasojë e ndërlikueshmërisë etnonacionaliste të Evropës dhe insistimit të perandorive evropiane për ruajtjen e kolonive.

---

[18] Vladimir Ibler, "Pravo naroda na samoodredjenje i zloupotreba tog prava", *Politička Misao* vol. XIX, no. 2 (Zagreb, 1991) fq. 53, 55.

[19] Ernest Petrić, *Pravica do samoodločbe* (Založba Obzorja: Maribor, 1984) fq. 241-247.

[20] Dr. Milan Bulajić, *Pravo naroda na samoodredjenje u Društvu Naroda i Ujedinjenim Nacijama: 1917-1962* (Naučna Knjiga: Beograd, 1963) fq. 9.

[21] S. Albert Colliard, *Droit international et histoire diplomatique: Document choisis* (Dalloz: Paris, 1948) fq. 314-315; Vladimir-Djuro Degan, "Samoodredjivanje naroda i teritorialna cjelovitost država u uvjetirna raspada Jugoslavije", *Naša zakonitost* no. 4 (Zagreb, 1992) fq. 544.

Si rast kontestues, që kërkonte zgjidhje të menjëhershme, ndërkaq, vetëvendosja u lajmërua në praktikën e organeve ndërkombëtare të kohës vetëm më 1919, në rastin e njohur të Ishujve Oland (*Aaland Islands case*), popullsia e të cilëve kërkonte të bashkohej me Suedinë, jo me Finlandën[22]. Në këtë rast praktik u konfirmua se nuk ekziston një normë e së drejtës ndërkombëtare për sa i përket vetëvendosjes dhe, si e tillë, nuk haset as në Konventën e Lidhjes së Kombeve. Konventa në fjalë ka injoruar këtë koncept. Dështimi i saj për të zhvilluar një koncept të qartë për të drejtën e vetëvendosjes ka lehtësuar abuzimin e saj nga ana e Gjermanisë naziste. Meqenëse nazizmi diskreditoi idenë e shtetit komb, pra, e shtetit të bazuar në etnicitet, pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore ideja mbi shtetin e tillë u kuptua si një ideologji. Më pas, ideja e vetëvendosjes pati qenë e derivuar nga lufta, e kuptuar sikur të ishte zhvilluar për hir të demokracisë dhe të drejtat e kombeve, gjithnjë me kuptim shtetet ekzistuese të kohës. Në këtë kuadër, Karta e Kombeve të Bashkuara konfirmoi në nenet 1 dhe 55 se qëllimet e saj konsistonin në zhvillimin e marrëdhënieve miqësore mes kombeve, duke u bazuar në respektin për parimin dhe vetëvendosjen e popujve[23].

Si pasojë e realitetit politik gjatë Luftës së Ftohtë, vetëvendosja u pa si e barabartë me vetëvendosjen e shteteve dhe se zbatimi i saj jashtë shteteve ekzistuese u quajt i vlefshëm vetëm nëse ndodhte në kontekstin kolonial. Mirëpo, vetëvendosja ka shumë faqe dhe nuk paraqitet vetëm në formën e vet antikoloniale, ashtu si perceptohej kjo nga rusët në Konferencën e San Franciskos më 1945 dhe siç u sanksionua më pastaj në dy nenet e para të konventave të OKB-së mbi të drejtat e njeriut të vitit 1966. Në vijim të kësaj filozofie, ajo nuk figuronte as në Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut të vitit 1948.

Koncepti i vetëvendosjes, ashtu si ka ekzistuar gjatë Luftës së Ftohtë, është promovuar për herë të parë në vitet '60. Në këtë vit u miratua Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së mbi Njohjen e Pavarësisë Vendeve dhe Popujve Kolonialë. Kjo nënkuptonte se tani e tutje vetëvendosja do t'i takonte, në teori dhe praktikë, vetëm atyre që luftonin kundër sundimit kolonial. Jashtë këtij konteksti, u mendua atëherë, vetëvendosja nuk mund të zbatohej. E drejta për legjitimim ndërkombëtar të shteteve të reja të dala nga sundimi kolonial u arrit përmes zbatimit të parimit të a.q. *uti possidetis*, që

[22] F.L. Kirgis, Jr., "The Degrees of Self-Determination in the United Nations Era", *American Journal of International Law* vol. 88, no. 2 (1994) fq. 304.
[23] F. Michael, "Democracy and Dynamite: The Peoples' Right to Self-Determination", *Political Studies*, vol. XLIV, no. 4 (September 1996) fq. 747.

kërkonte nga këto shtete të reja ruajtjen e kufijve që kishin pasur në ditën e fillimit të pavarësisë së tyre. Në anën tjetër, ishte pikërisht kjo rregull që pengonte të tjerët brenda këtyre shteteve të reja për të paraqitur kërkesën për vetëvendosje mbi baza etnike e në forme secesioni (e drejta eksterne për vetëvendosje)[24].

Nën presionin perëndimor, por edhe për faktin se të gjithë "popujt" ekzistues të kohës ishin gjetur nën juridiksionin e shteteve sovrane, anëtare të OKB-së, u konsiderua si i domosdoshëm përcaktimi i saktë i marrëdhënies mes vetëvendosjes dhe integritetit territorial të shteteve. Në vijim të kësaj, më 1970 Asambleja e Përgjithshme zgjeroi zbatimin e konceptit të vetëvendosjes përtej caqeve koloniale, duke miratuar Deklaratën mbi Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare lidhur me Marrëdhëniet Miqësore dhe Bashkëpunimin mes Shteteve në pajtim me Kartën e OKB-së (GA Rez. No. 2625-XV). Aty thuhet se, *inter alia*, "hyrja në çdo status politik të përcaktuar lirisht nga vetë populli paraqet një mënyrë të vënies në jetë të së drejtës për vetëvendosje"[25]. Deklarata mohoi se kishte për qëllim autorizimin ose inkurajimin e shpërberjes së shteteve sovrane, duke theksuar se:

> Asgjë në paragrafët e mësipërm nuk mund të konsiderohet se autorizon ose inkurajon veprimet që do të shpërbënin ose prishnin, pjesërisht ose në tërësi, integritetin territorial ose unitetin politik të shteteve sovrane të pavarura, sjelljet e të cilave janë në pajtim me parimin e vetëvendosjes dhe të drejtat e barabarta të popujve ashtu si është përshkruar më sipër dhe që kanë qeveritë përfaqësuese të të gjithë popullsisë brenda territorit të tyre pa asnjë dallim sa i përket racës, bindjeve fetare ose ngjyrës.
>
> Çdo shtet duhet të përmbahet nga format e veprimit që kanë për qëllim shpërbërjen ose dëmtimin e pjesshëm ose në tërësi të integritetit territorial dhe unitetin nacional të shteteve ose vendeve të tjera.[26]

Nga këta paragrafë mund të vërehet se qëllimi i Deklaratës ka qenë harmonizimi i parimit të vetëvendosjes dhe të drejtave të barabarta me atë të integritetit territorial të shteteve sovrane dhe vendeve. Ky problem ka mbetur i njëjtë edhe në fillim të procesit të shpërbërjes së ish-federatave socialiste, pra

---

[24] J.M. Sorel & R. Mehdi, "L'*uti possidetis* entre la consecration juridique et 1a pratique: essai de reactualisation", *Annuaire Français de Droit International* vol. XL (Paris, 1994) fq. 12-40.
[25] Cf. parimi i pestë me radhë i Deklaratës, "parimi i të drejtave të barabarta dhe vetëvendosjes së popujve".
[26] Dy paragrafët e fundit të parimit të pestë me radhë si më sipër.

edhe të ish-Jugosllavisë[27]. Nga një interpretim i lirë i kësaj pjese të Deklaratës mund të nxirret konkluzioni se nga shtetet ekzistuese kërkohet harmonizimi konstant i rendit të tyre të brendshëm dhe promovimi i të drejtave për të gjithë qytetarët dhe grupet e me qëllim të pengimit të kërkesave secesioniste brenda territorit të tyre apo çdo forme tjetër të përmbysjes së regjimeve në mënyrë të dhunshme. Këtu, me këtë rast, vlen të theksohet se vetëvendosja është përdorur në kuptimin territorial dhe joetnik.

Në mënyrë të ngjashme, edhe Deklarata e Vjenës e vitit 1993 ka paraparë formulimet si më sipër. Dallimi është se kjo e fundit i referohet "qeverisë që nuk përfaqëson tërë popullsinë brenda territorit të vet, pa asnjë dallim, çfarëdo qoftë ai" dhe se hap mundësinë edhe për vetëvendosjen etnike. Këto dokumente, edhe pse nuk kanë forcë të obligueshme legale, megjithatë, shënojmë se si të tilla reflektojnë një *opinio juris* të bashkësisë aktuale ndërkombëtare lidhur me çështjen në fjalë.

As në Aktin Final të Helsinkit (1975) dhe as në Kartën e Parisit për Evropën e Re (1990) nuk u afirmua vetëvendosja etnike, përkundër asaj që Karta e Parisit ka disa theksa të rëndësishëm ndaj detyrave të shteteve për mbrojtjen e entiteteve etnike dhe të drejtave të tyre brenda shteteve ku ata ekzistojnë.

Çështja kryesore gjatë tërë kësaj kohe, por edhe sot, ka qenë dhe mbetet ajo e definimit se cilët janë "popujt" ndaj të cilëve shtrihet vetëvendosja. Në shikim të parë duket shumë i lehtë definimi i termit në fjalë, mirëpo ata nuk mund të vetëvendosin përderisa dikush nuk e ka përcaktuar më parë se cilët janë "popujt" që kanë të drejtën e vetëvendosjes[28]. Dhe, ai që vendos për këtë, gjykuar sipas praktikës së veprimit të shteteve dhe organizatave ndërqeveritare, është vetë bashkësia ndërkombëtare. Kjo nga arsyeja e thjeshtë se, edhe pse vetëvendosja paraqet një të drejtë, zbatimi i saj ka implikacione politike dhe për këtë nevojitet një palë e tretë për të vendosur caqet, përkatësisht se cilat janë subjektet e autorizuara për të vetëvendosur[29]. Me fjalë të tjera, praktika e shteteve dhe e organizatave ndërkombëtare tregon se ato vetë përcaktojnë se cilët janë të autorizuarit për vetëvendosje dhe rastet e fundit te shpërbërjes së ish-federatave socialiste dëshmojnë një konstatim si ky. Duke qenë kështu, atëherë edhe fokusi i bashkësisë ndërkombëtare ka qenë dhe është i orientuar kah njësitë e vetëvendosjes, të cilat, përveç që janë "popuj", ato

---

[27] Laura Silber & Alan Little, *The Death of Yugoslavia* (Penguin Books: London, 1995) fq. 147.
[28] Sir Ivor Jennings, *The Approach to Self-Government* (Cambridge UP, 1956) fq. 56.
[29] P. Dallier & A. Pellet, *Droit international public* (Dalloz: Paris, 1994) fq. 400-402.

kanë edhe një baze të caktuar territoriale, fakt ky i dëshmuar shkencërisht[30]. Në këtë kategori të njësive më të drejtën për vetëvendosje hyjnë:

1. territoret nën mandat, kujdestari, si territore që nuk vetadministrohen në kuptim të Kreut XI të Kartës së OKB-së;
2. shtetet, përveç atyre pjesëve të cilat edhe vetë janë njësi vetëvendosëse;
3. entitetet e veçanta territoriale, popullsia e të cilave i nënshtrohet një represioni dhe dhune të vazhdueshme shtetërore (e ashtuq. *carence de souveraineté*);
4. territoret e tjera ndaj të cilave palët vetë pajtohen se duhet zbatuar referendumi ose format e tjera të deklarimit të vullnetit e me qëllim të korrektimeve minore të vijave kufitare.

Në literaturë, pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, gabimisht është menduar se njësitë federale dhe format e tjera të organizimit të shteteve federale paraqesin njësi të ndara (të veçanta) të vetëvendosjes[31]. Dhe, kjo nuk është aspak e vërtetë, ngaqë këto raste bien nën kategorinë e dytë si më sipër dhe fare nuk çon peshë niveli i tyre i pavarësisë nga strukturat qendrore të pushtetit federal. Sikur të ishte ashtu si mendohet, atëherë pyetja elementare do të ishte se çka do të bënin popujt e robëruar që jetojnë nën ndonjë shtet unitar, pra, jofederal?! A kanë këta të drejtën për vetëvendosje, në kuptimin e pavarësisë, apo duhet që pambarimisht të durojnë robërinë vetëm për faktin se jetojnë në një shtet unitar që nuk përcakton administrativisht njësitë potenciale për vetëvendosje?! Shkurt, mendojmë se rregullimi i brendshëm kushtetues nuk çon peshë shumë në sensin e përcaktimit definitiv se kush është i autorizuar për vetëvendosje dhe se me rëndësi është pasja e një baze solide dhe kompakte territoriale të banuar me shumicë nga një popullatë që dëshiron realizimin e së drejtës për vetëvendosje, në kuptim të pavarësisë së plotë, por që kontrollon efektivisht territorin e vet. Kjo qasje është konfirmuar edhe në mendimet numër 1, 2 dhe 3 të Komisionit Badinter për ish-Jugosllavinë dhe që, *mutatis mutandis*, vlejnë edhe për rastet e tjera nëpër ish-federatat socialiste. Problemi i Çeçenisë në Kaukaz është shembulli më i qartë i zbatimit të kësaj logjike që mohon të drejtën për vetëvendosje vetëm pse nuk është entitet federal i tipit republikë.

---

[30] James Crawford, *The Creation of States in International Law* (Oxford UP: Oxford 1979) fq. 84 102.

[31] Benedict Kingsbury, "Self-Determination and Indigenous People", *American Society of International Law — Proceedings of the 86th Meeting* (Washington DC, April 1-4, 1992) fq. 369-370.

2. Vetëvendosja pas mbarimit të Luftës së Ftohtë

Deri më 1989-1990, vetëvendosja ka qenë në gjendje të fjetur dhe është zbatuar vetëm në kontekstin kolonial. Kjo nuk do të thotë se nuk ka ekzistuar baza legale për zbatimin e saj edhe jashtë këtij konteksti, dhe Deklarata e vitit 1970, e cekur më sipër, parashikonte zbatimin e vetëvendosjes edhe brenda shteteve ekzistuese sovrane dhe të pavarura, të cilat nuk përfaqësojnë vullnetin e tërë qytetarëve.

Në fillim, sikur u duk se rrëmuja në Evropë dhe Bashkimin Sovjetik nuk do të sjellte shumë probleme lidhur me zbatimin e vetëvendosjes: Gjermania Demokratike u absorbua nga ajo federale dhe fare nuk u shtrua problemi i trashëgimit (suksedimit) të saj. Mirëpo, shpërbërja e Bashkimit Sovjetik dhe, më vonë, e ish-Jugosllavisë dhe rënia e komunizmit si një sistem vlerash e riaktualizuan vetëvendosjen në versionin e saj më të ashpër. Në disa raste, zbatimi i saj nuk qe i dhunshëm, si, p.sh., në Çekosllovaki, kurse në rastet e tjera u tregua tepër i dhimbshëm (ish-Jugosllavia dhe Bashkimi Sovjetik). Kjo është arsyeja që ne vendosem ta ndajmë këtë shkrim në dy pjesë: e para i dedikohet ish-Bashkimit Sovjetik, kurse e dyta ish-Jugosllavisë, si rasti më tragjik i zbatimit të dhunshëm të vetëvendosjes. Sigurisht që krahasimi me rastet e tjera, ku zbatimi i vetëvendosjes nuk u shoqërua me dhunë *en masse*, do të jetë objekt diskutimi këtu.

Mbarimi i Luftës së Ftohtë ka intensifikuar brengat për vetëvendosjen. Unioni Evropian (atëherë Bashkësia Evropiane) që në fillim të reagimit të saj ndaj krizës në ish-Jugosllavi dhe Bashkimin Sovjetik u bazua në vetëvendosjen si parim, që përmblidhet në sintagmën "shprehje e lirë e vullnetit politik".

Që në fillim, Bashkësia Evropiane supozoi se vetëvendosja dhe zbatimi i saj është dhe duhet të jetë kompatibil me sundimin e ligjit, demokracinë dhe të drejtat njerëzore dhe të minoriteteve. Në anën tjetër, vetëvendosja si parim qe baza mbi të cilën u mbështetën akterët politikë të involvuar në prishjen e strukturave qendrore shtetërore të këtyre dy vendeve e me qellim të legjitimimit të kërkesave të tyre politike për pavarësi. Vënia në pyetje e kufijve ekzistues të komuniteteve politike brenda këtyre dy vendeve ishte forca çrregulluese e regjimit të ri ndërkombëtar. Kjo shkaktoi frikë të tmerrshme në vendet perëndimore dhe shtroi nevojën e harmonizimit të parimit të integritetit territorial me parimin e vetëvendosjes dhe kështu gjendja u kthye në fillim, ashtu si edhe sot, pra, në përcaktimin se kush janë njësi të autorizuara për vetëvendosje dhe si mund të realizohet vetëvendosja në praktikë. Sundimi i ligjit, demokracisë dhe respekti për të drejtat e njeriut e të minoriteteve ishte

dhe mbeti mënyra e përcaktuar për realizimin e vetëvendosjes, kurse entitetet territoriale të tipit republikë federale u inkurajuan në rrugën e tyre për pavarësi. Të parat ishin dhe mbeten kritere korrektuese të zbatimit të vetëvendosjes ndaj të dytave. Tjerat raste u lanë më në heshtje, por nuk u harruan tërësisht.

3. Shpërbërja e ish-Bashkimit Sovjetik

Në dhjetor të vitit 1918, Republika Socialiste Federative Sovjetike (RSFS), trashëgimtare e ish-Perandorisë Ruse, njohu sovranitetin e Estonisë, Lituanisë dhe Letonisë. Pas këtij akti, tri republikat baltike u njohën si anëtare të Lidhjes së Kombeve[32]. Kjo situatë ka zgjatur deri më 1940, kur ato u aneksuan nga Bashkimi Sovjetik, mbi bazën gjoja të vullnetit politik të shprehur nga vetë ato, kurse si bazë legale shërbeu Pakti Molotov–Ribbentrop i vitit 1939. Ky rast e bën të veçantë shpërbërjen e ish-Bashkimit Sovjetik dhe e dallon atë nga rastet e tjera, për sa i përket bazës legale të së drejtës për vetëvendosje. Në vijim të kësaj, edhe shpërbërja e ish-Bashkimit Sovjetik përfshin katër raste të zbatimit të vetëvendosjes: 1. Shtetet Baltike; 2. Republikat që tanimë ishin anëtare të Kombeve të Bashkuara (Bjellorusia dhe Ukraina); 3. Federata Ruse dhe 4. Republikat e tjera që u bënë anëtare të Komonuelthit të Shteteve të Pavarura. Këto të fundit janë me të vërtetë shtete të reja dhe kanë realizuar vetëvendosjen, në kuptim të pavarësisë së plotë, për herë të parë. Edhe pse Gjeorgjia nuk ka marrë pjesë në Marrëveshjen e Alma-Atas, prapëseprapë bie në kategorinë e sipërme.

3.1. Republikat Baltike

Në dhjetor të vitit 1989, autoritetet qendrore sovjetike ndërmorën hapin e parë të denoncimit të pavlefshmërisë së Marrëveshjes Molotov–Ribbentrop të vitit 1939. Kjo shtroi rrugën për eliminimin e pengesave dhe të pasojave legale dhe të tjera për realizimin e vetëvendosjes në favor të republikave baltike. Duke bërë këtë, autoritetet sovjetike tërthorazi e pranuan se shtetet baltike kishin të drejtën për vetëvendosje sipas së drejtës ndërkombëtare dhe jo asaj kushtetuese. Fill pas kësaj, këto shtete nxorën aktet e tyre për të shpallur

[32] Antonio Cassese, "Self-Determination of Peoples and Recent Break-Up of USSR and Yugoslavia", në Ronald St. John MacDonald (ed.), *Essays in Honor of Wang Tieya* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1994) fq. 131-144.

si ilegal aneksimin e tyre të Luftës së Dytë Botërore dhe shpallën pavarësinë e tyre të humbur[33]. Këtu nuk flitej për atë nëse ato kishin të drejtën për vetëvendosje, por si të realizohej ajo: përmes lidhjes së një marrëveshjeje me ish-Bashkimin Sovjetik para se të shpallej pavarësia nga ai apo kjo gjë të bëhej në mënyrë të njëanshme, siç bëri Lituania në mars të vitit 1990 dhe të tjerat pas saj. Opinioni ndërkombëtar i kohës, shkencor dhe politik, ishte në favor të asaj se rruga e dytë qe e drejtë dhe se fjala ishte për të a.q. okupim i prolonguar, përkatësisht se bëhej fjalë vetëm për restaurim të pavarësisë së humbur[34]. Meqenëse aneksimi i vitit 1940 kishte qenë në kundërshtim me vullnetin politik të këtyre popujve, atëherë u shtrua nevoja e mbajtjes së referendumeve për pavarësi, si forma ndërkombëtarisht të pranueshme të shprehjes së vullnetit politik, si bazë e parimit politik të vetëvendosjes. Lituania e bëri këtë në shkurt 1990, kurse Letonia dhe Estonia në mars 1991. Edhe pse perëndimorët në fillim ishin të pavullnet për njohjen e këtyre shteteve, pas dështimit të puçit ushtarak të 21 gushtit 1991, ato u njohën ndërkombëtarisht, përfshirë edhe nga vetë Bashkimi Sovjetik. Formulimi i Deklaratës mbi Njohjen e Shteteve Baltike nga ana e Bashkimit Evropian më 27 gusht 1991 tregon se ato ishin konsideruar si shtete ndërkombëtarisht të njohura dhe se tani vetëm duhej njohur restaurimi i pavarësisë se humbur më 1940[35].

3.2. Republikat e tjera

Nëse rasti i sipërcekur i vendeve baltike tregon sadokudo se nuk ka pasur shumë dyshime rreth bazës legale të zbatimit të parimit të vetëvendosjes, dymbëdhjetë republikat e tjera janë ndeshur me probleme të tjera legale dhe politike gjatë procesit të pavarësimit të tyre nga Bashkimi Sovjetik. Shënojmë që në fillim se është i drejtë konstatimi i dhënë se pavarësimi i tyre ka ndodhur si rrjedhojë e veprimit të forcave centrifugale nga brenda dhe jashtë domenit legal të së drejtës ndërkombëtare dhe asaj të brendshme[36]. Ashtu si në rastin e sipërcekur, edhe këtu shtrohej çështja e mënyrës së vënies në jetë të parimit politik të vetëvendosjes (mbajtja ose mosmbajtja e referendumeve

---

[33] M. Bothe & Ch. Schimdt, "Sur quelques questions de succession posses par la dissolution de l'URSS et celle de la Yugoslavie", *Revue générale de droit international public* tome XCVI (Paris, 1992) fq. 816-817, 821-822; Antonio Cassese, ibid. 131-14L.

[34] Cf. Adam Roberts, "Prolonged Military Occupation", *American Journal of International Law* vol. 84 (1990) fq. 44-103; Antonio Cassese, ibid. fq. 131-141.

[35] Cf. Colin Warbrick, "Current Developments: Public International Law — Recognition of States", *International and Comparative Law Quarterly* vol. 42, part 2 (1992) fq. 473-482.

[36] Antonio Cassese, ibid. fq. 138.

për pavarësi dhe vlefshmëria e tyre). Kjo ishte gjendja e së drejtës ndërkombëtare të kohës, por që nuk do të thotë në asnjë mënyrë se vetëvendosja nuk ishte e drejtë e njohur ndërkombëtarisht. Cilat qenë subjektet (njësitë) e autorizuara për vetëvendosje ishte pikëpyetja që kërkonte zgjidhje dhe referendumet për pavarësi shërbyen si përgjigje ndaj kësaj pyetjeje[37]. Jo vetëm që ishte kërkesë e bashkësisë ndërkombëtare mbajtja e referendumeve, por edhe në vetë ish-Bashkimin Sovjetik u nxor një ligj për të përcaktuar modalitetet e zbatimit të parimit të vetëvendosjes dhe u parashikua një gjë e tillë. Referendumet u mbajtën në periudhën mars-dhjetor 1991, gjë që solli deri te Marrëveshja e Alma-Atas e datës 16 dhjetor 1991. Ligji i 7 prillit 1990, ndërkaq, lidhur me skemën e referendumeve (*Soviet Referendum Scheme*) kurrë nuk u vu në jetë si pasojë e zhvillimit të ngjarjeve në terren.

4. Shpërbërja e ish-Jugosllavisë

Ish-Jugosllavia ka qenë shtet i përberë nga tetë entitete territoriale: gjashtë republika federale (Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Sllovenia, Serbia, Mali i Zi dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë — IRJM) dhe dy krahina autonome (Kosova dhe Vojvodina).

Rasti i ish-Jugosllavisë, nga pikëpamja e së drejtës kushtetuese ka qenë krejt e ndryshme nga ai i Bashkimit Sovjetik. Këtu në asnjë dispozitë kushtetuese nuk flitej për të drejtën e shkëputjes, kurse pjesa jooperative (preambulare) e ish-Kushtetutës së vitit 1974 fliste për barazinë e kombeve dhe të kombësive, si dhe të republikave dhe të krahinave autonome si entitete territoriale të definuara. Aty flitej vetëm për atë se vetëvendosja ka shërbyer si pikënisje në ristrukturimin e ish-Jugosllavisë në federatë socialiste pas Luftës së Dytë Botërore, kurse zbatimi i saj i mëtejmë ka qenë i rezervuar vetëm jashtë kufijve të atij shteti, duke e përcaktuar realizimin e saj në këtë mënyrë si një nga objektivat e politikës së jashtme të ish-Jugosllavisë. Kjo gjendje kushtetuese kësisoji, me të drejtë u ka dhënë arsyen disa studiuesve të pohojnë se ish-Jugosllavia ka qenë një lloj inkarnacioni i së drejtës për vetëvendosje *vis-à-vis* botës së jashtme, kurse në diskursin politik e kushtetues ish-jugosllav, veçanërisht në Serbi, u krijua teza për të a.q. konsumim të së drejtës për vetëvendosje[38]. Me këtë nuk zbulohen veçse dy gjëra. Së pari, ish-Jugosllavia, si një vend komunist dhe njëri nga themeluesit e Lëvizjes së Mosinkuadrimit

[37] Cf. Vladimir Ibler, ibid. fq. 60.
[38] Cf. Antonio Cassese, ibid. fq. 140·141; Vladimir Ibler, ibid. fq. 67-68.

në Botën e Tretë, ka përkrahur të a.q. vetëvendosje komuniste dhe atë jashtë kufijve të shteteve ekzistuese, kryesisht në ish-kolonitë. Së dyti, në ish-Jugosllavi të gjithë ishin minoritet kundrejt njeri-tjetrit: serbët, shqiptarët, kroatët, sllovenët, maqedonët etj., ishin në mënyrë të njëjtë pakicë etnike ndaj të tjerëve. Mbi këtë bazë as e drejta për shkëputje, me kuptim pavarësinë, nuk ka qenë e paraparë në Kushtetutën e vitit 1974, për dallim nga neni 78 i Kushtetutës së vitit 1977 të ish-Bashkimit Sovjetik. Në vijim të kësaj, edhe realizimi i vetëvendosjes në ish-Jugosllavi, në të gjitha format tanimë të njohura, ka qenë realizuar si pasojë e veprimit stihik të forcave centrifugale nga brenda dhe rrënimit të strukturave qendrore të pushtetit federal. Në rrethanat e tilla, u pati bërë një përpjekje brenda ish-Jugosllavisë që realizimi i vetëvendosjes të jetë sa më i kontrolluar, ku serbët në veçanti anonin kah vetëvendosja etnike dhe ruajtja e hegjemonisë së deriatëhershme, gjë që ishte në kundërshtim me qëndrimin e kohës të bashkësisë ndërkombëtare. Një analizë sado e cekët e Ligjit të ish-Jugosllavisë të 20 janarit 1992 për mënyrën e realizimit dhe llojin e vetëvendosjes, si dhe të a.q. Kritere për Njohje të Shteteve të Reja në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik (Kriteret për Njohje, datë 16 dhjetor 1991) e provon qëndrueshmërinë e konstatimit si më sipër.

4.1. Gjashtë republikat jugosllave

Ashtu si në ish-Bashkimin Sovjetik, edhe në ish-Jugosllavi, mbajtja e referendumeve për ose kundër pavarësisë, si një formë e shprehjes demokratike të vullnetit politik, u quajt si një fakt i domosdoshëm. Mbajtja e tyre është bërë në periudhën dhjetor-shkurt 1992. Vojvodina qe i vetmi entitet territorial që nuk e bëri këtë, kurse Serbia dhe Mali i Zi krijuan më 27 prill 1992 të a.q. Republika Federative e Jugosllavisë, pa mbajtur ndonjë referendum ose ndonjë formë tjetër deklarimi demokratik të vullnetit politik që do të pranohej ndërkombëtarisht. Mënyra e tillë e krijimit të këtij shteti qe bërë me të vetmin qëllim që Serbia dhe Mali i Zi të trashëgonin vazhdimësinë e qenies shtet (*statehood*) me ish-Jugosllavinë, gjë që sot e kësaj dite nuk është pranuar nga askush. Përveç kësaj, legjitimiteti dhe legaliteti ndërkombëtar i kësaj kreature u sfidua nga bashkësia ndërkombëtare edhe mbi baza të tjera. Kështu, në maj të vitit 1992, shtetet anëtare të Bashkësisë Evropiane (BE) theksuan se jo vetëm që ajo nuk ishte kontinuitet i ish-Jugosllavisë, por, edhe si e tillë, duhej të plotësonte po ato kushte që ishin kërkuar për njohjen ndërkombëtare të ish-republikave jugosllave, tani shtete sovrane dhe të pavarura. Ky

pozicion u përkrah edhe nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së me rezolutën numër 777 të datës 19 shtator 1992.

Dallimi kryesor ndërmjet ish-Bashkimit Sovjetik dhe ish-Jugosllavisë ka qenë dhe mbetet i lidhur me procedurën e zbatimit të vetëvendosjes, përkatësisht që në rastin e fundit qe krijuar një proces monitorues ndërkombëtar për këtë çështje dhe bazohej në Komisionin Badinter për ish-Jugosllavinë, puna e të cilit filloi në shtatorin e vitit 1991 në kuadër të Konferencës së Hagës për Jugosllavinë. Ky komision ka dhënë mendimet e veta në periudhën kohore prej vitit 1991-1993 dhe, *mutatis mutandis*, janë zbatuar edhe ndaj ish-Bashkimit Sovjetik. Mirëpo, për dallim nga serbët, rusët kryesisht pranuan vetëvendosjen territoriale e joetnike, duke lënë jashtë kufijve mbi 20 milionë rusë etnikë.

Në tri opinionet e para, Komisioni Badinter shqyrtoi disa çështje të përgjithshme legale të së drejtës ndërkombëtare, siç janë suksesioni (trashëgimi) i shteteve, vetëvendosja dhe parimi i a.q. *uti possidetis* (shqip: të takon ajo që posedon). Në opinionet e tjera prej nr. 4-7, Komisioni u mor me çështjet konkrete të njohjes ndërkombëtare të ish-republikave jugosllave, duke u bazuar në Kriteret për Njohje të datës 16 dhjetor 1991. Përveç opinioneve nr. 1 (nëntor 1991) dhe nr. 2 deri 7 (janar 1992), Komisioni dha edhe opinionet nr. 8 deri 10 në korrik të vitit 1992, lidhur me kompetencën e vet për të gjykuar subjektivitetin juridik ndërkombëtar të ish-Jugosllavisë dhe jovazhdimësinë e saj me të a.q. RFJ (Serbi dhe Mali i Zi). Këtu ne nuk flasim për çështjet e reparacioneve te luftës dhe çështjet tjera lidhur me këtë, të cilat kanë qenë objekt i opinioneve të dhëna nga Komisioni Badinter në verën e vitit 1993. Komisioni ka pushuar se ekzistuari me vetë Konferencën ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, por që opinionet e tij kanë qenë të një rëndësie vendimtare në ratifikimet dhe zgjidhjen e krizës në ish-Jugosllavi në vitet që pasuan.

Tri opinionet e para diskutohen këtu më detalisht, meqë janë të një rëndësie të përgjithshme për temën tonë, kurse ato të tjerat vetëm zihen ngoje shkarazi, ngaqë paraqesin pasojë logjike të këtyre tri opinioneve. Në opinionin e parë të datës 29 nëntor 1991, publikuar më 7 dhjetor 1991, theksohej se ish-Jugosllavia gjendet në procesin e shpërbërjes dhe se nuk i plotëson kriteret e pjesëmarrjes dhe të përfaqësimit, të domosdoshme për një shtet federal. Nisur nga kjo gjendje, vetëm republikat federale u inkurajuan si entitete që kishin të drejtën e shkëputjes, përkatësisht se vetëm ato kishin të drejtën e likuidimit (shpërbërjes) së ish-Jugosllavisë si federatë. Ose, e thënë ndryshe, vetëm ish-republikat jugosllave kishin të drejtën e suksedimit (trashëgimit) të ish-Jugosllavisë, ku asnjëra prej tyre nuk konsiderohej si

trashëgimtare (suksesore) e shtetit pararendës, qëndrim ky që më vonë u elaborua deri në detaje në mendimet numër 8-10 të Komisionit. Siç mund të vërehet, ky inkurajim nuk ishte i drejtuar edhe ndaj entiteteve territoriale të tipit autonom.

Opinionet dy dhe tre qenë dhënë në përgjigje të një pyetjeje të parashtruar nga Serbia lidhur me atë nëse popullsia serbe e Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacisë kishte të drejtën për vetëvendosje, me kuptim pavarësinë e plotë, si dhe nëse kufijtë e brendshëm administrativë mes ish-republikave jugosllave mund të konsideroheshin si kufij ndërkombëtarë. Nga këto pyetje të Serbisë, mund të shihen qartë synimet e politikës zyrtare serbe kundrejt të tjerëve në ish-Jugosllavi. Komisioni në opinionin e dytë nuk njohu të drejtën e popullsisë serbe që jetonte në Bosnjë-Hercegovinë dhe Kroaci për vetëvendosje, me kuptim pavarësinë e plotë, duke i konsideruar ata vetëm si minoritete që u njihej e drejta në zgjedhje të shtetësisë së tyre. Ky dallim në mes shtetësisë dhe etnisë u quajt në literaturë i njëjtë me atë të parashikuar me Marrëveshjen e Mastrihtit të Bashkësisë Evropiane (BE) të dhjetorit 1991[39]. Komisioni potencoi lidhjen mes të drejtave të minoriteteve dhe të drejtave të popujve dhe theksoi se të gjitha bashkësitë e tjera etnike, fetare ose gjuhësore kanë të drejtën e njohjes së identitetit të tyre dhe të drejtën e gëzimit të "të gjitha të drejtave njerëzore dhe lirive themelore të njohura nga e drejta ndërkombëtare". Në opinionin e tretë, Komisioni e elaboroi këtë në mënyrë më të detajuar. Në të vërtetë, ai i kushtoi shumë rëndësi parimit të respektimit të kufijve administrativë të ish-republikave jugosllave në momentin e fitimit të pavarësisë. Kjo çështje u diskutua edhe në opinionet e mësipërme, ku thuhej se "e drejta për vetëvendosje nuk duhet të përfshijë ndryshimet e kufijve ekzistues në kohën e fitimit të pavarësisë". Ky konkluzion për mosndryshimin, përkatësisht respektimin vetëm të kufijve administrativë të ish-republikave, qe nxjerrë me referim në nenin 5 të Kushtetutës së ish-Jugosllavisë së vitit 1974, i cili ka njohur si të paprekshëm edhe kufijtë administrativë të ish-krahinave autonome.

Në katër opinionet e tjera, të dhëna me radhë nga Komisioni, kujdes i duhur i qe dhënë faktit nëse referendumet për pavarësi ishin mbajtur apo jo dhe nëse ish-republikat jugosllave kishin bërë zotimet publike për respektimin e të drejtave njerëzore individuale, të drejtave të grupeve dhe të minoritet-

[39] Alain Pellet, "The Opinions of the Badinter Arbitration Committee: A Second Breath for Self-Determination of Peoples", *European Journal of International Law* vol. 3, issue 1 (1992) fq. 180.

eve, si dhe zotimet për sundimin e ligjit dhe të demokracisë. Me këtë qasje Komisioni ka treguar se vetëvendosja dhe realizimi i saj janë të lidhura me sistemin perëndimor të vlerave të shprehur si në konceptet e sipërme (të drejtat e njeriut dhe të minoriteve, sundimi i ligjit dhe i demokracisë). Së këndejmi, konstatimi i sipërcekur i Xhejms Krofordit (James Crawford), i dhënë në librin e sapocituar të tij, edhe pse shumë kohë më herët, lidhur me faktin se e drejta për vetëvendosje është e bazuar territorialisht dhe jo etnikisht, del tërësisht i drejtë.

4.2. Rasti i Kosovës

Kosova, e banuar me popullsi shqiptare prej mbi dy milionë dhe territorialisht e definuar me rreth 11,000 kilometra katrorë, ka qenë pjesë e një shteti tanimë të shpërbërë — ish-Jugosllavisë. Në momentin e shpërbërjes së tij, si entitet territorial i veçantë dhe i banuar me shumicë prej mbi 90 për qind me shqiptarë, Kosova pas vitit 1990 ka ndjekur rrugën e njëjtë si edhe entitetet e tjera territoriale për t'i ikur dominimit dhe hegjemonisë serbe. Kështu, më 2 korrik 1990, Kuvendi i Kosovës aprovoi Deklaratën Kushtetuese që përcaktonte Kosovën si entitet të barabartë legal dhe politik me ish-republikat jugosllave, duke e eliminuar dhe refuzuar fuqishëm pozicionin e imponuar juridiko-kushtetues të Kosovës sipas Kushtetutës së vitit 1974. Më 7 shtator 1990, po ai kuvend nxori Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që është edhe sot në fuqi, bazuar në parimin politik të vetëvendosjes, në barazinë dhe sovranitetin politik e territorial. Kjo ka koinciduar përafërsisht edhe me prononcimin e Komisionit Badinter, i cili menjëherë pas këtij rasti pati theksuar se ish-Jugosllavia gjendej në procesin e shpërbërjes. Edhe Kosova, përkatësisht qeveria e saj legale dhe legjitime parashtroi aplikimin për njohje ndërkombëtare më 21 dhjetor 1991, drejtuar Komisionit Badinter për ish-Jugosllavinë. Mirëpo, përgjigje pozitive nuk ka pasur, ngaqë nuk është konsideruar se plotësonte kushtin themelor të qenies shtet në të drejtën ndërkombëtare - kontrollin efektiv të territorit të vet[40]. Së fundi, në maj të vitit 1992 u mbajtën zgjedhjet e para të lira në Kosovë, mbi bazën e dokumenteve juridiko-kushtetuese si më sipër dhe u zgjodhën organet e pushtetit: Kuvendi, Kryetari dhe Qeveria e Republikës. Kjo njëherësh qe edhe rrumbullakësimi i anës juridiko-kushtetuese të procesit të pavarësisë së Kosovës, ashtu siç kishte qenë rasti edhe me ish-republikat e tjera.

---

[40] Colin Warbrick, ibid. fq. 480.

Ana politike e procesit të pavarësimit të Kosovës, ndërkaq, është më ndryshe dhe bazohet në fakte të brendshme dhe ndërkombëtare. Në të parat bien fakti i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe mënyra e sundimit të Kosovës që nga ajo kohë e tutje. Në të dytat futet vetëm kategoria e ruajtjes së paqes dhe stabilitetit në rajon.

Ish-Jugosllavia, e krijuar më 1918 si mbretëri dhe e ridefinuar në federatë socialiste më 1945, ka pushuar së ekzistuari më 1992, dhe nuk ka qenë kontinuitet juridiko-ndërkombëtar i mbretërive serbe dhe malazeze të para-Luftës së Parë Botërore[41]. Gjithashtu, pas shpërbërjes së saj më 1992, asnjëra nga ish-republikat jugosllave, tani shtete sovrane dhe të pavarura, nuk gëzojnë të drejtën e suksedimit (trashëgimit) juridiko-ndërkombëtar të ish-Jugosllavisë: të gjitha konsiderohen si të barabarta në këtë aspekt. Ky është qëndrim i prerë i bashkësisë ndërkombëtare, nga i cili nuk ka pasur shmangie deri sot dhe as që mund të ketë në të ardhmen.

Siç u tha më lart, në rastin e shpërbërjes së ish-federatave socialiste është zbatuar parimi kolonial *uti possidetis*, pra, është nisur nga prezumimi se kufijtë e caktuar administrativë (ish-kufijtë e republikave federale) gëzojnë mbrojtjen ndërkombëtare, nëse plotësohen kushtet e tjera të qenies shtet (popullsia, territori dhe kontrolli efektiv i tij nga ana e një qeverie të zgjedhur në mënyrë të ligjshme). E drejta për shpërbërjen e strukturave qendrore të ish-federatave socialiste ka rrjedhur nga natyra represive e regjimeve ish-komuniste, pra, është krijuar fiksioni mbi barazimin e këtyre strukturave represive shtetërore me ato të ish-metropoleve.

Kosova, si territor i definuar me një sipërfaqe si më sipër, pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, i ka hyrë restrukturimit të vet kushtetues-juridik, duke u barazuar në këtë aspekt me ish-republikat jugosllave. Definimi i saj territorial nuk ka qenë kontestues, bazuar në nenin 5 të ish-Kushtetutës së vitit 1974, ndërkohë që statusi i saj juridiko-kushtetues ka qenë i imponuar dhe jashtë vullnetit të popullsisë së saj shumicë. Disa vjet para shpërbërjes së ish-Jugosllavisë Kosova ka qenë e administruar nga një qendër në Beograd dhe sipas sistemit kolonial të guvernatorëve, por që nuk është konsideruar si i tillë për shkak të njohjes ndërkombëtare të ish-Jugosllavisë si shtet dhe si subjekt i vetëm ndërkombëtar i atij territori dhe asaj popullsie. Pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, represioni në Kosovë dhe sundimi i saj kolonial kanë qenë ob-

[41] Për një analizë brilante të kësaj çështjeje, shih Stevan Djordjević, *O kontinuitetu država sposebnim osvrtom na kontinuitet Kraljevine Jugoslavije i NDR Jugoslavije* (Naučna Knjiga: Beograd, 1963). Në këtë libër autori jep tërë argumentet teorike dhe praktikën e veprimit te shteteve në të drejtën ndërkombëtare të kohës lidhur më këtë çështje.

jekt diskutimi ndërkombëtar, gjë që është konfirmuar në më se tetëdhjetë dokumente të dhëna nga OKB-ja, OSBE-ja, UE-ja dhe KE-ja, pa llogaritur këtu qindra të tjera të nxjerra nga NGO të ndryshme dhe shtete individuale apo grupet e shteteve, siç është rasti me Grupin e Kontaktit për ish-Jugosllavinë. Megjithatë, përkundër tërë kësaj, pavarësia e Kosovës nuk është njohur, besojmë për arsyen e mungesës së kontrollit efektiv të territorit nga ana e qeverisë së saj legale dhe e strukturave të tjera të zgjedhura nga popullsia shumicë e Kosovës. Kjo është arsyeja e vërtetë, sado që në literaturë dhe në praktikën ndërkombëtare të këtyre viteve është thënë se pavarësia e Kosovës do të rrezikonte sigurinë dhe paqen në rajon. Në fakt, kjo e dyta ka qenë dhe mbetet pretekst për mosnjohje dhe pasojë e moskontrollit efektiv të territorit të Kosovës nga ana e strukturave legale e legjitime shtetërore të Republikës.

Para se të kalojmë në këtë çështje, vlen të theksohet se nga kjo që u tha del qartë se edhe përdorimi i dhunës për arritjen e pavarësisë është i kufizuar në pikëpamje hapësinore dhe kohore. Në rastin e parë, ajo nuk quhet si e ligjshme nëse del jashtë kufijve administrativë të ish-republikave federale. Për entitetet e tjera territoriale të tipit jorepublikë federale, kjo nuk është thënë shprehimisht, mirëpo gjykuar sipas praktikës ndërkombëtare, në rastin e Çeçenisë, projektimi i forcës me qëllim të arritjes së pavarësisë është i lejueshëm edhe në rastet si këto dhe kundër një sistemi represiv që nuk përfaqëson vullnetin e popullsisë shumicë të territorit të dhënë dhe administrativisht të definuar. Në pikëpamje kohore, ndërkaq, dhuna me qëllim të arritjes së pavarësisë mund të ushtrohet kundër strukturave represive shtetërore, të cilat janë krijuar si rezultat i përdorimit të forcës dhe paraqesin pjesë të një procesi politik akoma të papërfunduar të prishjes së strukturave të mëhershme shtetërore që dikur kanë qenë ndërkombëtarisht të njohura, siç është rasti me të a.q. RFJ (Serbi dhe Mal i Zi), e cila pretendon se është trashëgimtar i vetëm i ish-Jugosllavisë. Njohja ndërkombëtare kolektive e kësaj kreature do të paraqiste momentin e mbarimit të kufirit kohor që legjitimon përdorimin e ligjshëm të forcës kundër kësaj kreature të dhunshme. Jemi të mendimit dhe të bindur njëkohësisht se njohja e saj kolektive ndërkombëtare nuk mund të bëhej pa zgjidhjen e të gjitha çështjeve kontestuese të ish-Jugosllavisë, pra edhe të njohjes të së drejtës për vetëvendosje të Kosovës, me kuptim pavarësinë e plotë. Kohëzgjatja e realizimit të kësaj së drejte është çështje tjetër dhe nuk pengon aspak këtë proces të pavarësimit dhe legjitimitetin e përdorimit të forcës nga ana e popullsisë shumicë.

Ruajtja e paqes dhe e stabilitetit rajonal, me kuptim mosnjohjen e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur, çdo ditë e më shumë po kthehet në të kund-

ërtën e saj: pikërisht mosnjohja e pavarësisë së Kosovës paraqet faktorin kryesor destabilizues në Ballkan. Në mesin e regjioneve potencialisht të rrezikuara nga pavarësia e Kosovës, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM) ka zënë dhe zë vendin kryesor në agjendat ndërkombëtare. Kohëve të fundit, pas fillimit të agresionit të hapur serb ndaj Kosovës dhe rezistencës së armatosur të popullit të saj, ka filluar të kristalizohet pikëpamja për njohjen e pavarësisë së Kosovës, si mjet i vetëm i frenimit të ekspansionit serb dhe i rrënimit të projektit për Serbinë e Madhe. Në vijim të kësaj dhe duke marrë parasysh luftimet dhe rezistencën vetëm në territorin e Kosovës e me qëllim çlirimin nga agresori serb, kanë pasuar edhe simpatitë dhe përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare. Askush deri sot nuk e ka vënë dhe as që do të vërë në pyetje legjitimitetin e përdorimit të forcës nga ana e UÇK-së dhe popullit shumicë në Kosovë.

Përfundim

1.

Idetë filozofike të Locke-ut e Rousseau-it si dhe dokumentet e tjera të nivelit nacional, përkatësisht Deklarata Amerikane për Pavarësinë e vitit 1776 dhe Deklarata Franceze për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit kanë vënë themelet e parimit të vetëvendosjes. Idetë e Leninit dhe të Revolucionit të Tetorit gjithashtu kanë pasur një ndikim të madh në zhvillimin e mëtejshëm të këtij parimi. Në formën e tij konkrete, parimi në fjalë është ndeshur dhe njohur si prezent nga ana e bashkësisë ndërkombëtare vetëm në rastin e Ishujve Oland, më 1919. Këtu, në këtë rast, bashkësia ndërkombëtare nuk ka pranuar se ai paraqet një pjesë përbërëse të normave të së drejtës ndërkombëtare të kohës.

Kanë qenë nenet 1 dhe 55 të Kartës së OKB-së (1945) ato që për herë të parë njohën ekzistimin e parimit të vetëvendosjes, por jo edhe të drejtën për vetëvendosje. Ky parim u quajt i barabartë me vetëvendosjen e shteteve ekzistuese të kohës, gjendje që ka vazhduar deri më 1960, kur është miratuar Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së mbi Njohjen e Pavarësisë Vendeve dhe Popujve Kolonialë. Përkundër kësaj, vetëvendosja akoma kufizohej në zbatimin e saj praktik, përkatësisht se vënia e saj në jetë quhej ndërkombëtarisht legjitime vetëm nëse ndodhte brenda kontekstit kolonial.

Depërtimi i dytë i rëndësishëm në sensin e zgjerimit të caqeve të zbatimit të vetëvendosjes u bë më 1970. Këtë vit, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së

miratoi Deklaratën mbi Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare lidhur me Marrëdhëniet Miqësore mes Shteteve e në pajtim me Kartën e OKB-së. Si në rastin e parë, edhe këtu, vetëvendosja u paramendua në mënyrë territoriale dhe joetnike. Sidoqoftë, Deklarata ishte një hap përpara, meqë parashikonte se shtetet duhet të harmonizonin vazhdimisht rregullat e tyre të brendshme legale dhe t'i promovonin të drejtat e qytetarëve të vet dhe grupeve me qëllim pengimin e kërkesave për shkëputje brenda territoreve dhe juridiksionit të tyre.

As Akti Final i Helsinkit (1975) e as Karta e Parisit për Evropën e Re (1990) nuk kanë shkuar më tutje në promovimin e parimit dhe së drejtës për vetëvendosje në sensin e parashikimit të tyre në favor të entiteteve etnike brenda shteteve ekzistuese. Në dokumentin e fundit, megjithatë, u bë një progres i vogël në drejtim të vënies së detyrimeve për shtetet ekzistuese për të mbrojtur entitetet etnike dhe të drejtat e tyre. Përfundimisht, deri tash vetëm Deklarata e Vjenës (1993) ka lidhur përfaqësueshmërinë e qeverisë *vis-à-vis* qytetarëve të vet, pa asnjë dallim çfarëdo qoftë ai, me të drejtën e vetëvendosjes.

Aktualisht, por edhe më herët, çështja më kontestuese ka qenë se cilët janë "popujt" që kanë të drejtën për të vetëvendosur. Kjo nuk do të thotë se ekzistimi i vetëvendosjes, si rregull e së drejtës pozitive ndërkombëtare, si e drejtë dhe parim, kontestohet nga ndokush. Përkundrazi, ajo njihet, por çështje është se kush duhet të përcaktojë subjektet e autorizuar për vetëvendosje dhe mënyrën e zbatimit të saj praktik. Tash për tash, gjykuar sipas praktikës ndërkombëtare, bashkësia ndërkombëtare përcakton se cilat janë subjektet e autorizuar dhe mënyra e zbatimit të vetëvendosjes. Kjo praktikë tregon se subjektet në fjalë janë vetëm entitete vetëvendosëse të tipit territorial dhe jo popujt vetë për vete që jetojnë brenda këtyre territoreve, veçanërisht jo popujt në kuptimin etnik të këtij termi.

2.

Me dështimin e komunizmit dhe mbarimin e Luftës së Ftohtë, parimi i vetëvendosjes është rishfaqur në një formë të re. Deri atëherë ai pati qenë i fjetur. Fillimisht u besua se zbatimi i tij nuk do të të paraqesë asnjë problem serioz. Ky besim u bazua në ribashkimin paqësor të të dy Gjermanive. Mirëpo, ngjarjet në ish-Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavi treguan se zbatimi i tij konkret është problem shumë i komplikuar. Shih për këtë arsye, bashkësia ndërkombëtare bëri disa përpjekje me qëllim të pajtimit të parimit të vetëve-

ndosjes me atë të integritetit territorial të shteteve, ngaqë tani shtrohej zbatimi i tyre jashtë kontekstit kolonial.

3.

Në rastin e ish-Bashkimit Sovjetik, parimi i vetëvendosjes u zbatua në dy mënyra të ndryshme. Në rend të parë, këtu qe rasti i rikthimit (restaurimit) të pavarësisë së humbur të shteteve baltike, përkatësisht fjala qe jo për krijimin e shteteve të reja, por për ringjalljen e pavarësisë së tyre të humbur më 1940. Së dyti, 12 republikat e tjera të ish-Bashkimit Sovjetik bazuan kërkesën për vetëvendosje në nenin 78 të Kushtetutës së vitit 1977. Megjithatë, kjo kërkesë u legjitimua nga vetë Bashkimi Sovjetik dhe bashkësia ndërkombëtare vetëm pasi u nënshkrua Marrëveshja e Alma-Atas, më 16 dhjetor 1991, si pasojë e veprimit të forcave centrifugale nga brenda. Nga kjo rregullativë e brendshme del se vetëm republikat e tipit federal ishin të autorizuara për vetëvendosje. Entitetet e tjera territoriale nuk u quajtën të autorizuara për të vetëvendosur.

4.

Rasti i ish-Jugosllavisë dallon nga ai i Bashkimit Sovjetik për disa arsye. Së pari, këtu nuk ka ekzistuar e drejta kushtetuese për shkëputje (secesion). Mbi bazën e kësaj, në diskursin politik dhe në praktikën shtetërore serbe qe krijuar e a.q. teoria mbi të drejtën e konsumuar për vetëvendosje, e cila nënkuptonte mohimin të tjerëve të së drejtës për vetëvendosje. Edhe këtu, si në rastin e Bashkimit Sovjetik, qenë bërë disa përpjekje për rregullim të brendshëm të procedurës për realizimin e së drejtës për vetëvendosje. Si në Bashkimin Sovjetik, edhe në ish-Jugosllavi është konsideruar nga ana e bashkësisë ndërkombëtare si e domosdoshme mbajtja e referendumeve për pavarësi, me qëllim legjitimimin e së drejtës për vetëvendosje.

Referendumet qenë mbajtur në periudhën kohore prej vitit 1990 deri më 1992. Serbia, Mali i Zi dhe Vojvodina janë entitetet territoriale të ish-Jugosllavisë, në të cilat nuk është bërë asnjë referendum për pavarësinë ose ndonjë mënyrë tjetër të deklarimit të vullnetit politik që pranohet ndërkombëtarisht. Në vend të kësaj, Serbia dhe Mali i Zi, më 27 prill 1992, kanë krijuar dhunshëm të a.q. RFJ, me shpresë se do të njiheshin si trashëgimtarë të vetëm të ish-Jugosllavisë. Kjo pikëpamje është refuzuar qartë nga ana e bashkësisë ndërkombëtare deri sot dhe rezoluta nr. 777 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së paraqet pikën nisëse të referimit për një refuzim të tillë të bashkësisë ndërkombëtare.

Së dyti, në rastin e ish-Jugosllavisë qe krijuar një lloj procedure monitoruese për të mbikëqyrë dhe kontrolluar procesin e pavarësimit të atyre që dëshironin një gjë të tillë. Kjo procedurë është bazuar në Komisionin Badinter të Konferencës për ish-Jugosllavinë, e cila filloi punën në shtator të vitit 1991.

Në opinionin e parë të datës 29 nëntor 1991, Komisioni theksoi se Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë ishte në procesin e shpërbërjes dhe se e drejta për likuidimin e shtetit në fjalë u takonte vetëm republikave të tipit federal. Ky inkurajim për realizimin e së drejtës për vetëvendosje nuk u dha për entitetet e tjera të tipit jorepublikë federale. Në përgjigje serbëve, ata u konsideruan si minoritet dhe, rrjedhimisht, të drejtat e tyre duheshin siguruar dhe mbrojtur nga e drejta pozitive ndërkombëtare, sado që nga ky definim u hoq dorë në Dejton (1995), ku serbët u definuan si komb shtetformues i Shtetit të Bosnjë-Hercegovinës. Vlen të thuhet këtu se në ish-Jugosllavi asnjëri prej popujve nuk quheshin se janë minoritet, as serbët kundër kroatëve, shqiptarët kundër të tjerëve, sllovenët, kroatët, maqedonët, boshnjakët etj.; që të gjithë ishin minoritet ndaj njëri-tjetrit, ashtu siç kuptohet ky term në të drejtën ndërkombëtare.

Në opinionin e tretë, Komisioni lidhi çështjen e vetëvendosjes me atë të kufijve administrativë të ish-republikave jugosllave, duke iu dhënë këtyre mbrojtjen ndërkombëtare. Aty u krijua prezumimi legal *uti possidetis*, ashtu si me rastin e ish-kolonive, me referencë nenin 5 të Kushtetutës së ish-Jugosllavisë të vitit 1974. Shënojmë këtu se Komisioni nuk ka konsideruar si të pacenueshëm territorin e ish-krahinave autonome, të cilat përmenden në atë nen, nisur nga arsyetimi se ato nuk plotësonin kushtin elementar të qenies shtet në të drejtën ndërkombëtare — kontrollin efektiv të territorit të tyre. Kosova, duke qenë një entitet i definuar territorialisht dhe nga ana e strukturës etnike (mbi 90 për qind e banuar me shqiptarë), shpalli pavarësinë e saj në shtatorin e vitit 1991 dhe mbajti zgjedhjet e lira presidenciale e parlamentare më 1992 dhe 1998. Megjithatë, Komisioni refuzoi kërkesën për pavarësi të Kosovës, të parashtruar nga Qeveria e Kosovës, mbi bazën e argumentit të mungesës së kontrollit efektiv të territorit të saj ditën e shpalljes së pavarësisë.

Represioni i vazhdueshëm në Kosovë ndaj popullsisë së saj shumicë, me qëllim mohimin e realizimit të së drejtës për vetëvendosje, ka pasur për rrjedhojë lindjen e fenomenit të UÇK-së dhe masivizimin e saj të shpejtë. Kjo strukturë ushtarake është një nga gjymtyrët kryesore të kryerjes së atij misioni që quhet kontroll efektiv i territorit, si kusht për njohjen ndërkomb-

ëtare të Kosovës. Kjo nuk do të thotë assesi që bashkësia ndërkombëtare duhet të presë që një gjë e tillë të ndodhë në krejt Kosovën. Përkundrazi, ajo duhet të bëjë një gjë të tillë si në rastin e IRJ të Maqedonisë, Kroacisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, nëse mendon të pengojë agresionin dhe ekspansionin e mëtejmë serb, i cili synon krijimin e Serbisë së Madhe. Arsyetimet e deritanishme për mosnjohje të Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur, të bazuara në ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit rajonal, veçanërisht frika nga destabilizimi i IRJ të Maqedonisë, duhen braktisur njëherë e përgjithmonë, nisur nga fakti i thjeshtë se humbja e shqiptarëve në Kosovë domosdo se do të ketë për pasojë rrënimin e shtetit të ri, IRJ të Maqedonisë. Nëse serbëve u është njohur e drejta për *lebensraum* (hapësirë jetësore) në emër të realpolitikës, atëherë është logjike që shqiptarët do të projektojnë forcë në atë shkallë sa për të krijuar një hapësirë të re jetësore në Ballkan, sigurisht jo brenda kufirit të Republikës së Shqipërisë (për arsye që mund të vetëkuptohen). Konfliktet e pas-Luftës së Dytë Botërore deri sot nuk kanë qenë pasojë e zbatimit të vetëvendosjes, por pikërisht rezultat i mohimit ose mosinkurajimit të saj, qoftë nga ana e shteteve sovrane apo nga vetë bashkësia ndërkombëtare.

Kapitulli II

KUSHTETUTA E KAÇANIKUT

Sfondi historik: Në këtë kapitull janë përfshirë shkrimet e botuara në gazetën *Fjala* të Prishtinës, javore e cila më pastaj u bë ditore si pasojë e mbylljes nga ana e pushtetit serb të të gjitha gazetave që kundërshtonin regjimin e diktatorit serb Sllobodan Millosheviq. Kjo kohë përkon edhe më kohën kur revistat e pakta akademike që ishin krijuar me aq mund e sakrificë nga fakultetet e Universitetit të Prishtinës u mbyllën dhe nuk ngeli asnjë vend tjetër për botim veçse në gazetat e revistat ditore që akoma nuk i kishte shuar regjimi serb.

Këtu riprodukohen në tërësi dy shkrime jashtëzakonisht mirë të pranuara në atë kohë nga qarqet akademike të shkencave sociale. I pari shkrim flet për projektkushtetutën e Republikës së Serbisë, kurse i dyti për Kushtetutën e Kaçanikut, njërin ndër dokumentet më shpresëdhënëse të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Për këtë arsye i kemi vënë edhe këtë titull këtij kapitulli sepse vërtetë përbën fillimin e një identiteti tjetër kushtetues të shqiptarëve në Kosovë, krejt i ndryshëm nga ai që ishte imponuar nga ish-RSFJ, e cila kryesisht ka qenë e dominuar nga serbët. Edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës e 15 prillit 2009 shkon në konfirmimin e tërësishëm të këtij identiteti kushtetues. Prandaj, lirisht mund të thuhet se sot në Kosovë ekziston Republika e Dytë, duke u cilësuar si Republika e Parë pikërisht ajo që u themelua në Kaçanik dhe që u bë simbol i identitetit perëndimor kushtetues të Kosovës dhe banorëve të saj shumicë.

Siç mund të vërehet, në të dyja shkrimet redaksia i pati hequr fusnotat, me plotë të drejtë. Kjo sepse natyra e një reviste javore/dyjavore, apo e një gazete ditore, nuk i duron poshtëshënimet dhe citimet doktrinare. Për fat të keq, dorëshkrimi i dy punimeve që sot riprodukohen këtu kanë humbur gjatë luftës së fundit në Kosovë (1998-1999), si shumë gjëra me vlerë, jetë dhe fate njerëzore, që janë humbur në këtë luftë. Për këtë shkak, nuk kemi mundësi t'i riprodhojmë fusnotat në dy tekstet në vijim.

Punimi i parë u quajt "Demagogji e një (projekt) kushtetute", botuar në *Fjala*, viti XXIII, nr. 16 (gusht 1990), kurse i dyti "Bazë e rendit modern demokratik", botuar në *Fjala*, viti XXIII, nr. 20 (shtator 1990).

Punimi i dytë për Kushtetutën e Kaçanikut, sikundër shihet, është botuar dy javë pas shpalljes së saj më 7 shtator 1990, në një klimë mjaft të tensionuar të asaj kohe. Dorëshkrimi i punimit, ndërkaq, është dorëzuar për botim dytri ditë pas shpalljes së Kushtetutës së Kaçanikut.

Këto dy punime, të cilat pasojnë këtu në këtë kapitull, kanë qenë të parat të botuara rreth kësaj lëmie. Vetëm më vonë, shumë muaj më vonë, kanë pasur debatet publike, të cilat, për çudi, tani bëheshin nga ata që muaj më parë kishin qenë të heshtur ose aktivisht kishin arsyetuar ndryshimet kushtetuese serbe me të cilat rrënohej autonomia e Kosovës. Këto dy punime i ofrohen lexuesit sërish, të pandryshuara, për të gjykuar vetë nëse ka pasur kuptim rezistimi intelektual ndaj diskursit serb juridik që fliste për të drejtën e vetëvendosjes së popujve si për një të drejtë të konsumuar — pra, sipas serbëve, me vetë formimin e Jugosllavisë më 1918 dhe ridefinimin e saj komunist më 1945, çdo e drejtë për vetëvendosje ishte shkrirë në këtë shtet dhe si e konsumuar më nuk mund të aktivizohej nga askush. Ky koncept serb reflektohej më së miri në ndryshimet kushtetuese në Kushtetutën serbe që pasuan në fund të vitit 1990, të cilat janë objekt diskutimi këtu poshtë. Këto ndryshime çuan vitin në vijim në luftërat e përgjakshme në veri të shtetit tanimë të zhdukur.

I. Demagogji e një (projekt) kushtetute

Kuvendi i RS së Serbisë, si organ më i lartë i kësaj njësie federale jugosllave, paraqiti për diskutim publik deri më 1 shtator 1990 Projektkushtetutën e RSS. Duke qenë se (Projekt) Kushtetuta e re (më tej shkurt: Projekti) paraqet për Kosovën *res inter alios acta*, kjo, në anën tjetër, nuk përjashton mundësinë që individualisht dhe me kompetencë profesionale t'i "hidhet një sy" projektit në fjalë, me të vetmin qëllim që të demaskohet (me forcën e argumenteve profesionale) një politikë thjesht demagogjike, e cila synon që "frytet" e saj t'i sanksionojë me aktin më të lartë juridik, përkatësisht me kushtetutë. Çështjet të cilat do t'i trajtojmë këtu kanë të bëjnë para së gjithash me Serbinë, të ngushtë apo të gjerë, ajo çfarë edhe është në praktikë, si *de facto* ashtu edhe *de jure*, nisur nga fakti se më nuk mund të përfshijë Kosovën si pasojë e nxjerrjes nga Kuvendi i Kosovës së Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990, me të cilën Kosova u definua si njësi e pavarur federale-konfederale në vartësi të zhvillimeve politike në RSFJ tani e tutje. Këtu në veçanti do të tra-

jtohet tendenca që ka të bëjë me synimet e fshehjes së një politike ditore ultranacional-socialiste prapa normave kushtetuese të modelit modern evropian, përkatësisht standardeve moderne juridiko-kushtetues, siç janë, p.sh., "sovraniteti popullor" dhe "liritë, të drejtat dhe detyrat e njeriut dhe të qytetarit". Kjo praktikisht nuk është asgjë tjetër (duke marrë parasysh gjendjen reale të popullit shqiptar në Jugosllavi) veçse një cinizëm dhe demagogji juridiko-politike dhe kushtetuese, *sui generis*. Ka dy synime që mëtohet të arrihen: i pari është heqja e autonomisë së Kosovës dhe e dyta cenimi sistematik i të drejtave të popullit shumicë në Kosovë.

a. Synohet heqja praktike e autonomisë

Në nenin 2 të Projektit në Kushtetutën e RSS thuhet se "sovraniteti i takon popullit". Me popull, sipas Projektit nënkuptohet populli i ashtuquajtur "shtetkrijues" (lexo: serb). Kjo shihet hapur nga neni 1 i Projektit ("RSS është shtet i popullit serb [...]"). Kjo do të thotë që jo *demosi*, por *etnosi* (lexo prapë: serb) përbën substratin primar të RSS.

Në nenin 5 të Projektit synohet heqja praktike e autonomive, në mënyrë që statusi (pozita) e kombit shqiptar (si etnos autokton në këto troje) të reduktohet me dekret dhe me kushtetutë në nivel të pakicës kombëtare dhe kështu gjoja të bëhet njëfarë harmonizimi i normave kushtetuese me standardet ndërkombëtare, të cilat iu referohen pakicave kombëtare (minoriteteve). Me këtë, përveç anës formalo-juridike dhe kushtetuese, Deklaratës historike të Kuvendit të Kosovës të datës 2 korrik, harrohet edhe fakti se shqiptarët përbëjnë popullin e tretë në Jugosllavi për nga numri. Për më tepër, harrohet se është *jus non scriptum* sipas *opinio juris*-it ndërkombëtar, që statusi i minoritetit përcaktohet në raport me kombet (popujt) e tjerë me të cilat minoriteti jeton në bashkësi shtetërore, përkatësisht në raport me numrin e tyre. Nuk do mend se një koncept i tillë juridiko-kushtetues heq rrënjët e veta nga mendimi politik i kohës së formimit të shtetit borgjez serb (Ilija Garashanin), "frytet" e të cilit mbi barazinë natyrore të shtetasve të vet i dinë dhe ende i kanë në kujtesë të freskët shqiptarët e shtetit të sotshëm jugosllav.

Në pjesën "optimiste" të teorisë kushtetuese-juridike të Serbisë përqafohet qëndrimi se në kushtetutat e njësive federale jugosllave është përzier sovraniteti nacional dhe popullor dhe se mu në këtë përzierje duhet kërkuar burimi i problemeve. Megjithatë, këtu nuk është fjala për ndonjë përzierje, por për sovranitetin popullor (*demos*); nuk mund të bëhet fjalë aty ku niset

nga pabarazia e haptë juridiko-politike e shtetasve të shtetit të njëjtë (shqiptarët në Kosovë dhe më gjerë në Jugosllavi). Refreni i zbrazët për sovranitetin e popullit i kuptuar si *demos* nëpër tekstet kushtetuese nuk do të thotë shumë kur një sërë dispozitash të tjera juridike pengojnë realizimin e sovranitetit popullor (rasti i tentimit të reduktimit *de facto* të autonomisë tanimë të reduktuar të Kosovës dhe mosnjohja e Deklaratës së Kuvendit të Kosovës të datës 2 korrik 1990).

Historia juridiko-politike dhe kushtetuese dëshmon se aty ku është formuar shteti, shtetasit e të cilit strukturalisht janë të homogjenizuar në pikëpamje nacionale në nivel të lartë, çështja e sovranitetit popullor e kuptuar si *demos* është politikisht irrelevante (përveç deri diku në marrëdhëniet ndërkombëtare). Aty ku nuk ka homogjenitet nacional, ndërkaq, tentimet e konstitucionalizimit të sovranitetit nacional në emër të sovranitetit popullor i kuptuar si *demos* i kombit më të madh, domosdo që duhet të përfundojnë ose në fraza juridikisht të pavlefshme ose në privilegje juridike raciste, diskriminuese dhe jodemokratike në dobi të kombit të madh. Në raport me shqiptarët dhe Kosovën, pikërisht këtu qëndron synimi i nenit 5 të Projektit në fjalë.

Edhe pse nocioni i shtetit në historiografinë dhe në politologjinë serbe është koncipuar (sikundër edhe gjetiu) duke u nisur nga pikëpamja patrimoniale se "sundimtari mban si shtet të vetin tërë tokën në të cilën sundon kurse e ka të trashëguar nga babai ose nga paraardhësit". Sot, megjithatë, pikëpamja moderne për shtetin nuk bazohet në prezumimin se shteti i takon kujtdoqoftë. Kjo shihet nga fakti se definicioni më i përhapur thotë se "shteti është lloj i organizimit të shoqërisë njerëzore" (Enciklopedia e ELJ Zagreb, MCML VII, 2, fq. 149). Ky standard në kuptimin e shtetit modern reflektohet edhe në vetë emërtimet e organizatës së tillë, kudoqoftë në botë. Kjo nënkupton se shteti nuk është diçka që dikush e mban (posedon) apo i takon ndokujt. *Shteti në thelb është një gjendje e marrëdhënieve ndërnjerëzore*. Prandaj, po që se në një shtet të gjithë shtetasit kanë të drejtat e njëjta politike dhe të drejta të tjera, atëherë një shtet është në masë të njëjtë shtet edhe i pjesëtarëve të kombit të madh edhe i pjesëtarëve të kombit më të vogël. Parimi i sovranitetit nacional mund të realizohet pa parimin e sovranitetit popullor i kuptuar si *demos*, siç është rasti, p.sh., me Rumaninë, Sllovenínë etj., mirëpo parimi i sovranitetit popullor nuk është e mundur të realizohet *pa parimin e barazisë së plotë nacionale, pra barazia e shtetasve të kuptuar edhe si etnos*.

Parimi i shprehur në nenin 5 të Projektit të Kushtetutës së RSS në praktikë do të mbetet një letër e vdekur, pa asfarë efekti. Zbatimi i tij praktik është i mundur vetëm përmes shoqërimit me represion, siç po ndodh aktualisht me zbatimin e dispozitave të amendamenteve të 23 marsit 1989 në Kushtetutën e KSAK. Me këto amendamente është bërë trasimi i mëtejmë juridik-kushtetues i rrugës së etnocentrizimit serb, kurse tani me Projektin e Kushtetutës së RSS tentohet konstitucionalizimi dhe legalizimi definitiv i tij. Në këtë etnocentrizëm serb etnosi vetjak është masa e vetme dhe ekskluzive dhe strumbullari matës dhe kryesor i çdo interesi në Jugosllavi.

"RSS është shtet demokratik i popullit serb dhe i popujve të kombeve dhe të kombësive të tjera që jetojnë në të, i mbështetur në dominimin e drejtësisë e në drejtësinë sociale" (neni 1, al. 1, i Projektit). Shtrohet pyetja, pas një definimi të tillë të shtetësisë, ku në rend të parë vihet kombi (serb), çfarë efekti dhe kuptimi kanë dispozitat e neneve 11-53 të Projektit, të cilat kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat njerëzore?

Të drejtat njerëzore dhe respektimi i tyre janë themel i demokracisë moderne dhe i shtetit juridik në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Shteti juridik nuk konsiston vetëm në respektimin e kushtetutës dhe të ligjit, si dhe të dispozitave të tjera, sepse, po të ishte ashtu edhe shtetet fashiste dhe totalitare do të mund të konsideroheshin si shtete juridike në kuptimin modern të sotshëm. Edhe këto shtete kanë respektuar kushtetutat e ligjet e tyre, të cilat kanë shprehur një vullnet të një ideologjie fashiste ose totalitare në kohën dhe në hapësirën e caktuar. Kushtetuta si një akt kardinal, së bashku me dispozitat e tjera juridike, rregullon marrëdhëniet ndërnjerëzore. Nëse ajo nuk i normon ato marrëdhënie në mënyrë reale dhe objektive, atëherë vetvetiu ato mund të jenë vetëm kundërproduktive, siç po ndodh tani me Kosovën. Vetëm me represion në emër të "shtetit juridik" nuk mund të zbatohen normat e tilla. Përdorimi i forcës është komponent i shtetit të njëmendtë juridik, sepse "nervi" i çdo shoqërie të organizuar në shtet është pushteti ekzekutiv, aparati i dhunës, mirëpo çështjet e përdorimit të dhunës nuk mund të jenë në kompetencë ekskluzive vetëm të një ideologjie nacionale. Edhe pse formalisht akoma cilësohet si ideologji socialiste, komuniste etj., *de facto* kemi të bëjmë me nacional-socializëm serb që nuk mund të dallohet fare nga fashizmi dhe ideologjitë e tjera reaksionare. Përdorimi i forcës shtetërore vetëm ndaj pjesëtarëve të një kombi tjetër, shqiptarëve, po ndodh në mes të Evropës.

Të drejtat e njeriut nuk janë temë interesimi vetëm për socializmin. Momentalisht, çështja e tyre askund nuk shtrohet më me ngulm sesa në vendet socialiste. Qëndrimi ndaj të drejtave njerëzore është akt testimi civilizues *sui*

generis i një rendi epokal të interaksionit shoqëror si nga brenda (ndaj shtetasve të vet) ashtu edhe nga jashtë (ndaj anëtarëve të tjerë të bashkësisë ndërkombëtare). Kjo gjë vlen edhe për tërë Jugosllavinë në kohën që po vjen, qoftë si federatë apo konfederatë. Në literaturën juridike të vendeve socialiste përgjithësisht ekziston uniteti në pikëpamje vetëm lidhur me një çështje: selia materiale e të drejtave njerëzore gjendet në domenin e së drejtës kushtetuese. Nga një logjikë e tillë është nisur, sipas bindjes sime të thellë, edhe teoria kushtetuese juridike në Serbi me rastin e përpilimit të Projektit në fjalë. Mirëpo, duhet ekzistuar disa prezumime të nevojshme dhe elementare në mënyrë që në kuadrin e rendit të caktuar kushtetues të bëhet fjalë kuptimisht për të drejtat e njeriut ashtu që ne të mbështetemi me kompetencë dhe besim në rendin e caktuar kushtetues. Lidhur me çështjen e parë vlen tërë ajo që u tha në pikën e mësipërme të këtij artikulli, me një plotësim se ndërmjet rendeve të ndryshme jodemokratike nuk ekzistojnë dallime esenciale në pikëpamje të peshës dhe të intensitetit të shkeljes së të drejtave të njeriut. Kështu, p.sh., gjendja e të drejtave të njeriut të shqiptarëve dhe shkelja e tyre esencialisht nuk dallohen pas Luftës së Dytë Botërore në raport me gjendjen para Luftës së Dytë Botërore. E njëjta situatë dhe gjendje ka qenë edhe gjatë sundimit otoman, luftërave ballkanike etj.

b. Të drejtat e njeriut duhet mbrojtur me institucione

Lidhur me çështjen e të drejtave të njeriut duhet thënë se në rendin kushtetues të një shoqërie të organizuar në shtet, *të drejtat njerëzore duhet patjetër të kenë prioritet absolut*, gjë që kjo nuk është kështu kur merret parasysh neni i parë i Projektit, sepse kombin serb e vë në qendër të vëmendjes së rregullimit kushtetues, pa qenë të vetëdijshëm se askush pa marrëdhënie me të tjerët vetvetiu nuk mund të ekzistojë. Mu nga mbrojtja e të drejtave njerëzore rendi kushtetues dhe juridik nxjerrin kuptimin dhe ekzistencën e tyre.

Në vijim si më sipër, rendi kushtetues duhet të mundësojë *interpretimin konstant* të përmbajtjes dhe të vëllimit të të drejtave njerëzore. Nëse e shikojmë gjendjen e rendit kushtetues në Serbi gjer më 2 korrik 1990 dhe implikimet që kanë pasur në Kosovë, pa u mbështetur fare në të dhëna empirike por vetëm në fakte notore, mund të konstatojmë se asnjëherë nuk është shtruar çështja e interpretimit në fjalë, edhe pse vazhdimisht janë shkelur dhe po shkelen të drejtat më elementare të shqiptarëve në Kosovë (dhe më gjerë). Përkundrazi, Kuvendi i Kosovës para 23 marsit 1989 dhe në përbërjen

e tillë, duke u vënë në shërbim të një politike antishqiptare e jo si organ më i lartë i pushtetit, jo vetëm që nuk është kujdesur për një gjë të tillë, porse me mënyrën e vet të punës e të injorimit të vullnetit të popullit ka sjellë daljen e masave popullore në rrugë (për të demonstruar kështu pakënaqësinë për padrejtësitë e bëra) dhe ka qenë e vetmja mënyrë e "interpretimit" të ish-rendit kushtetues të ish-KSA të Kosovës.

Pas 23 marsit 1989 ekziston një shpresë e vogël që e ka krijuar mendimi i Gjykatës Kushtetuese të Jugosllavisë për kundërkushtetutshmërinë e dispozitës për ndalimin e qarkullimit të patundëshmërive dhe të përdorimit të alfabetit cirilik në territorin e të ashtuquajturës "Serbi unike" (lexo: Serbia e Madhe). Gjykata Kushtetuese e Jugosllavisë, megjithatë, nuk ka konsideruar se ekziston ndonjë parregullsi në mënyrën e miratimit të amendamenteve të 23 marsit 1989, në ndërkohë që bota e qytetëruar tanimë ka dhënë interpretimin e vet se miratimi i tyre ka qenë i shoqëruar me shkeljen masive të të drejtave të shqiptarëve (vrasjet, persekutimet, burgosjet, izolimet e njohura për opinionin tonë dhe ndërkombëtar).

Vetëm Deklarata e Kuvendit të Kosovës e datës 2 korrik 1990 paraqet garant, përkatësisht se *vetëm operacionalizimi i saj i mëtejmë mundëson interpretimin konstant të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe krijon parakushtet kushtetuese të mbrojtjes institucionale të të drejtave të shqiptarëve (edhe të tjerëve)*, për çka do të flitet në vijim.

Të drejtat e njeriut duhet siguruar në formën e mbrojtjes institucionale. Çdo definim, i cili *a priori* që në fillim konsideron kushtetutën si vlerë të vetëm një populli, përjashton mundësinë e mbrojtjes institucionale të popullit tjetër, pa marrë parasysh nëse popujt tjerë përmenden pas të parit, i cili e konsideron veten si "kushtetutëdhënës". Mbrojtja institucionale ekziston vetëm atëherë kur njeriu si individ dhe si pjesëtar i një kombi /populli njëkohësisht mund të marrë pjesë në institucionet e shoqërisë dhe të pushtetit në mënyrë që institucionalisht të ketë mundësi, së bashku me tjerët, për ta kontrolluar atë "nervin" që quhet forcë shtetërore, në mënyrë që ajo të mos keqpërdoret (sikur tani kundër shqiptarëve në Kosovë dhe më gjerë në Jugosllavi).

Të drejtat e njeriut duhet shtruar në formë diskursi. Kjo në të vërtetë nënkupton se është i domosdoshëm sigurimi i kushteve që rivlerësimi dhe ndryshimi i konceptit të të drejtave njerëzore (ndryshimi i interpretimit, kufizimi i të vjetrave, futja e të drejtave të reja njerëzore) të jetë rezultat i shqyrtimit racional me pjesëmarrje të barabartë të interesave të të gjithë anëtarëve të bashkësisë politike që po synon të cilësohet si shtet-juridik dhe demokratik.

Kriteret universale juridike dhe politike të bashkësisë ndërkombëtare janë ato që përcaktojnë cilësinë dhe shkallën e ekzistencës dhe të shkeljes së të drejtave të njeriut në një shoqëri të caktuar. Prandaj, përpjekjet penguese të qarqeve politike-kushtetuese të RS të Serbisë në këtë drejtim janë të kota dhe demagogjike. E konsiderojmë me vend dhe të qëlluar pikëpamjen e shprehur në teorinë jugosllave, se është e nevojshme një "Marrëveshje e Helsinkut" brenda Jugosllavisë, për të dalë pastaj në Evropën e Re që është duke u krijuar tani.

Pa marrë parasysh definimin e RSS në nenin 1 të Projektit, kapitulli i Projektit për të drejtat e njeriut do të kishte efekt juridik dhe praktik vetëm atëherë kur, një shembull brutal, pas çdo fjalie që proklamon ndonjë liri apo drejtë të njeriut, të ishte futur edhe fjalia "veçanërisht shqiptarëve u garantohet kjo ose ajo e drejtë, përkatësisht detyrë". Kjo nga fakti se në Republikën e "Jogurt Revolucionit" shqiptarët janë të diskriminuar në veçanti, ashtu që të drejtat e shqiptarëve duhet mbrojtur në mënyrë që shqiptarët të binden për synimet "vëllazërore" të fqinjit të tyre shekullor. Po ashtu, në veçanti dhe domosdo shqiptarët duhen ftuar në dialog dhe marrëveshje të re jugosllave të tipit të Helsinkit sepse në të kundërtën çështja shqiptare do ta rëndojë përherë ndërgjegjen kombëtare të brezave të ardhshëm të sllavëve të jugut, dhe jo vetëm të tyre. (Fusnotat i hoqi Redaksia.)

II. Bazë e rendit modern demokratik

Kushtetuta dhe rendi kushtetues janë dokumente dhe premisa të shtetit modern juridik, si në aspektin transhistorik ashtu edhe në atë liberal demokratik. Sipas konceptit të parë, kushtetutë (dhe shtet juridik) mund të quhet secili model i organizimit të pushtetit në çdo shtet ku shtete konsiderohen krijesat e njëjta që nga Babilonia deri te Republika Franceze, kurse në etapën e mëvonshme, edhe krijesa monstruoze fashiste dhe diktaturat e tjera. Ndërkaq, koncepti demokratiko-liberal bazohet në faktin historik të "luftës për kushtetutë", kur janë nxjerrë kushtetutat e reja dhe dokumentet, kartat, deklaratat etj., të cilat u kanë paraprirë kushtetutave moderne. Sipas këtij koncepti, nocionet kushtetutë dhe shteti juridik janë ngushtuar për nga përmbajtja dhe koha.

Para së gjithash, termi "kushtetutë" do të jetë i pazbatueshëm në shoqëritë mesjetare, kurse rendit të shteteve moderne do t'i parashtroheshin edhe

disa kushte esenciale, për të cilat në veçanti do të flitet në vijim dhe të cilat do të duhej të plotësoheshin po që se pretendohet një rend modern kushtetues dhe shtet i mirëfilltë juridik. Ndërsa në pikëpamje përmbajtjesore, nuk ka kushtetutë si akt me rëndësi socio-politike dhe juridike po që se ajo nuk është konfirmim dhe pasqyrë reale e raporteve në pushtet dhe ndaj pushtetit (Jovan Gjorgjeviq), me kusht që paraprakisht në ato raporte të kenë marrë pjesë në mënyrë të barabartë të gjithë anëtarët e bashkësisë shtetërore.

Të gjitha kushtetutat e vendeve real-socialiste, pa marrë parasysh kalkulimet e ndryshme teorike, i takojnë grupit të konceptit transhistorik, duke përfshirë këtu edhe Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974. Ndërsa në RS të Serbisë, shikuar historikisht, koncepti transhistorik i teorisë dhe i praktikës kushtetuese, i cili edhe tani ofrohet në (Projekt) Kushtetutën e re të Serbisë, heq rrënjët e veta nga mesjeta (Perandoria e Dushanit) dhe gjysma e dytë e shekullit të kaluar (Ilija Garashanin). Ky koncept bazohet në "legjitimitet historik" mbi pjesët e Mbretërisë së Dushanit (dhe më vonë të Perandorisë Otomane në Ballkan), dhe ka mbi 80 vjet që bën përpjekje të pareshtura për të "dëshmuar" se Kosova është "tokë serbe" në të gjitha pikëpamjet. Në njëfarë mënyrë këtu kemi të bëjmë me një "reinkarnacion" *sui generis* të teorisë dhe të praktikës juridiko-politike ultradjathtiste serbe. Kuptohet, jo vetëm në raport me Kosovën, por edhe më gjerë.

Kushtetuta dhe rendi kushtetues, përveç të drejtave dhe lirive njerëzore të përcaktuara juridikisht dhe politikisht, përfshijnë edhe disa kuptime që janë *condition sine qua non* të kushtetutës dhe të rendit kushtetues në kuptimin demokratiko-liberal. Ato kanë të bëjnë me: legjitimitetin kontraktues (me marrëveshje) të rendeve juridiko-politike; shtetin juridik, përkatësisht "sundimin e së drejtës" dhe jo sundimin e njerëzve mbi njerëz; ndarjen e pushtetit; drejtësinë procedurale; institucionin e publikut dhe sistemin shumëpartiak pluralist; demokracinë kushtetuese dhe *res humana*.

Ideja e konstitucionalizmit modern fillon në bashkësinë politike me marrëveshje, përkatësisht me kontratë sociale (Rousseau, Locke), ku njerëzit bashkohen në një bashkësi shoqërore dhe krijojnë shtetin në mënyrë që të drejtat e tyre natyrore t'i forcojnë dhe jo t'i tjetërsojnë. Qëllimi i bashkësive politike është zgjerimi dhe jo humbja (shkrirja) e interesave origjinere (prejardhëse) të individit dhe të kolektivitetit si tërësi në të cilin bën pjesë individi (etnik/nacional në rend të parë, por edhe fetar, gjuhësor etj.). Nga kjo del se kushtetuta në kohët moderne demokratike duhet të jetë shprehje e vullnetit të lirë të të gjithë anëtarëve të bashkësisë politike dhe e kolektivitetit si tërësi. Për këtë arsye kushtetutat moderne dhe lufta për kushtetutë tradicionalisht

fillon me një deklaratë mbi të drejtat njerëzore, të cilat do t'i mbajë rendi kushtetues ose do t'i përpunojë më tutje. Kjo deklaratë, në pikëpamje kohore dhe cilësore, i paraprin kushtetutës moderne, dhe ka kuptimin e kontratës (marrëveshjes) sociale, e cila më pastaj operacionalizohet në tekstin kushtetues. Kjo vlen edhe për sistemet anglo-saksone, njëjtë si për sistemin kontinental të kushtetutshmërisë.

Deklarata e 2 korrikut 1990 e Kuvendit të Kosovës dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës e datës 7 shtator 1990 duhet të shikohen në kuptimin e mësipërm. Deklarata e 2 korrikut 1990 i ka paraprirë Kushtetutës së Republikës së Kosovës të datës 7 shtator 1990. Kjo është kështu si në pikëpamje kohore ashtu edhe në përmbajtje cilësore e të brendisë së dy teksteve që diskutohen. Është krejt e natyrshme që duke u nisur nga kjo pikëpamje dhe duke u mbështetur në Deklaratën e 2 korrikut 1990, Kuvendi (tërësisht legjitim) i Kosovës ka sjellë (miratuar) Kushtetutën e Republikës. Në pikëpamje sociopolitike, Deklarata e 2 korrikut 1990 cilësorisht paraqet plebishit të llojit të vet, i cili është implementuar në të njëjtën frymë në preambullën e Kushtetutës së Republikës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës paraqet pasqyrën në të cilën shihet legjitimiteti socio-politik i ridefinuar, kontrata (marrëveshja) e re sociale, ndërsa Rezoluta e Kuvendit të Kosovës, miratuar më 7 shtator 1990, përmes së cilës Kuvendi i Kosovës fton njësitë federale të Jugosllavisë (dhe shtetet sovrane të Evropës dhe botës) për ta njohur Republikën sovrane të Kosovës, nuk është asgjë tjetër veçse një kërkesë për dialog dhe marrëveshje të re shtetërore në nivel jugosllav dhe kërkesë e sërishme për riverifikim të legjitimitetit në një shoqëri të ardhshme të organizuar në shtet të përbashkët që quhet Jugosllavi. Në favor të këtij konstatimi flet vetë formulimi i nenit 2 të Kushtetutës së Republikës, në të cilin thuhet si vijon: "Republika e Kosovës si shtet është anëtare e bashkësisë së Jugosllavisë". Në arsyetimin e nenit në fjalë është thënë:

> Duke u nisur nga vendosmëria e kombit shqiptar në Jugosllavi për jetë të përbashkët me kombet e tjera të Jugosllavisë dhe pakicat kombëtare, me Kushtetutë përcaktohet pozita e Republikës së Kosovës si shtet në kuadër të Bashkësisë Jugosllave. Një pozicion i tillë është përcaktuar duke u nisur nga opsioni dominant për rregullimin e ardhshëm të Jugosllavisë. [...] Nëse nuk realizohet ky opsion, por Jugosllavia mbetet e organizuar si shtet federativ, atëherë duhet riformuluar zgjedhjen e ofruar në nenin 2 të Kushtetutës së Republikës [...].

Në anën tjetër, përveç sa më sipër, në pikëpamje juridiko-kushtetuese Kushtetuta normon marrëdhëniet socio-politike, veçanërisht ato në pushtet

dhe ndaj pushtetit; normon të drejtat njerëzore sipas standardeve civilizuese juridiko-kushtetuese (nenet 42-79, pjesa III e Kushtetutës së Republikës së Kosovës). Nga kjo shihet se Kushtetuta nuk paraqet vetëm "mjegull verbale" prapa së cilës shihet absolutizmi i kombit më të madh, por një normim civilizues i të drejtave njerëzore dhe sovranitetit nacional.

T'i kthehemi sërish legjitimitetit të rendit juridiko-politik. Rendi kushtetues, i mbështetur në Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974, me të drejtë është thënë në teori se ka qenë demokratizues, por jo edhe demokratik, gjë që ka krijuar lëkundje të sistemit politik socialist jugosllav. Autonomiteti i (ish) KSA të Kosovës ka qenë një domosdoshmëri dhe logjikë historike në zhvillimin social, kulturor, politik dhe ekonomik të shqiptarëve. Shikuar nga aspekti i legjitimitetit dhe i kontratës (marrëveshjes) sociale si bazë e rendit të dhënë juridiko-politik, një gjë e tillë nuk ka mundur të gjejë shprehje në Kosovë siç ka ndodhur në sistemet tjera socialiste. Kjo vlen edhe për të drejtat njerëzore, të cilat, në emër të "interesit të bashkësisë socialiste", i ka garantuar Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974 (e cila *de facto* nuk është më në fuqi), por që këto të drejta, në praktikë, janë në esencë mohim i vetvetes. Mbase nisur nga kjo ka pasuar iniciativa e Kryesisë së RSFJ-së, mbështetur në Kushtetutën e vitit 1974, për të filluar dialogun ndërmjet kombeve dhe kombësive lidhur me rregullimin e ardhshëm të Jugosllavisë. Këtë ftesë shqiptarët e kuptuan si ftesë të sinqertë për kontratë (marrëveshje) të re sociale, përkatësisht si ftesë për legjitimitet të ri shtetëror-politik, ndërsa iniciativën e këtij organi për t'i hyrë ndryshimeve kushtetuese me të cilat rrënohej subjektiviteti politik i KSA të Kosovës dhe i shqiptarëve, e kuptuan si hipokrizi politike dhe diskriminim nacional. Sikundër e vërtetoi Lorenco Valla, duke folur për Kishën dhe Papatin në Mesjetë, se e ashtuquajtura *Karta e Konstantinit* ishte falsifikim, po ashtu edhe Kryesia e RSFJ-së dhe KEF-it vërtetuan se nuk janë të sinqertë në synimet e tyre ndaj Kosovës dhe shqiptarëve. Në anën tjetër, prapë edhe një digresion, sikundër që *Koncili i Lateranit* më 1512 e dënoi tezën për dy të vërteta si heretike, KEF-i, më 18 shtator 1990, dhe Kryesia e RSFJ-së, më 20 shtator 1990, dënuan Kushtetutën e Republikës së Kosovës si akt antikushtetues (lexo: herezi politike antiserbe), pa hyrë në vlerësimin e legjitimitetit të saj juridik dhe socio-politik. Burgosja e këtyre ditëve e delegatëve legjitimë të Kuvendit të Kosovës dhe e anëtarëve tjerë të qeverisë legjitime kosovare, përfundimisht dëshmoi tërë vrazhdësinë e politikës së aktit të kryer, e cila po udhëhiqet kundër shqiptarëve në Jugosllavi me dekada të tëra.

Në çdo rend kushtetues modern duhet ditur *a priori* kufijtë e lirisë individuale dhe kolektive, përkatësisht vendi dhe koha e kufizimit të tyre. Kjo në

pikëpamje juridiko-teknike quhet siguria juridike e qytetarëve. Një institut të tillë e njeh edhe 42 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili thotë se liritë dhe të drejtat njerëzore janë të kufizuara vetëm me të drejtat dhe liritë e njëjta të të tjerëve. Sikundër shihet, këtu nuk gjendet fraza mbi liritë dhe të drejtat "e kufizuara në interes të bashkësisë socialiste", apo ndonjë parafrazim tjetër ideologjik. Liria e lëvizjes dhe e qëndrimit mund të kufizohet vetëm me ligj, nëse këtë e kërkon zhvillimi i procedurës penale, pengimi i sëmundjeve ngjitëse ose interesi i mbrojtjes së vendit, thuhet në nenin 47 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Diskursi kushtetues mbi liritë e të drejtat e garantuara më kushtetutë bëhet akoma më i qartë në nenin 79, al. 1, i cili përcakton se liritë dhe të drejtat e garantuara me kushtetutë nuk mund të merren e as të kufizohen (neni 79, al. 1.). Realizimi i tyre kryhet (zbatohet) në bazë të kushtetutës (neni 79, al. 2) etj. Nga këto dispozita që i sollëm këtu, si dhe nga dispozitat e tjera për të drejtat njerëzore, është evidente se të drejtat njerëzore janë të normuara sipas standardeve ndërkombëtare dhe nuk janë lënë në mëshirën e vlerësimit arbitrar (të lirë), gjë që paraqet esencën e teorisë (anglosaksone) për sundimin e së drejtës (*rule of law*), jo të njerëzve, përkatësisht esenca e teorisë gjermane për shtetin juridik (*Rechtsstaat*). Lidhur me këtë duhet përkujtuar mendimi i njohur i filozofit francez Monteskie, i cili e përshkon frymën e Kushtetutës së Kosovës, kur thotë se janë dy të këqija, njëra kur populli nuk u nënshtrohet ligjeve, dhe tjetra, kur popullin e prishin vetë ligjet. E keqja e dytë, gjithnjë sipas Monteskiesë, është e pashërueshme sepse gjendet në vetë ilaçin. Shteti juridik konsiston në atë që veprimtaria quhet legjitime dhe manifestim i vullnetit shtetëror nëse në formësimin dhe krijimin e saj kanë marrë pjesë të gjitha subjektet e bashkësisë si tërësi. Duke u nisur nga ky botëkuptim, Kushtetuta e Republikës në preambullën e saj ka parashikuar sigurimin e plotë të të drejtave të pjesëtarëve te nacionaliteteve të tjera, të cilët jetojnë në Republikën e Kosovës, kurse në nenin 104, al. 2, parashikon formimin e Komisionit për Liritë dhe të Drejtat Qytetare dhe Barazinë Nacionale (si trup të përhershëm të Kuvendit të Republikës). Kjo është një risi pikërisht si pasojë e gjendjes reale në Kosovë sepse çdo mohim i njërës nga të drejtat themelore njerëzore, siç është e drejta për bashkëpjesëmarrje në vendosjen për të mirën e bashkësisë politike që quhet shtet, është tirani, diskriminim dhe diktaturë.

Meqenëse kushtetuta dhe ligji, për shkak të përgjithësimeve të shpeshta, janë të gjykuar për dykuptimësi dhe joprecizitet, interpretimi i tyre në fazën e zbatimit nuk mund të ndihmojë shumë për të penguar ndërhyrjen në procesin e vendosjes politike. Këto çështje janë rrahur mjaft në tryeza shkencore

dhe publike në Jugosllavi, veçanërisht në anën e tyre formale-juridike. Kështu, ta zëmë, bukur gjatë është kontestuar (kundër)kushtetutshmëria e neneve si vijon të Ligjit Penal të RSFJ: 133 ("delikti verbal"), 114 ("kundërrevolucioni"). Këtu hyjnë edhe dispozitat juridike nëpër ligjet republikane dhe krahinore të punëve të brendshme që kanë të bëjnë me "kufizimin e lirisë së lëvizjes". Përderisa këto çështje gjetiu në Jugosllavi janë trajtuar vetëm si përjashtime, të cilat kanë zgjuar interesimin e teorisë, në Kosovë në mënyrë sistematike që nga viti 1981, e në formën më brutale në mars të vitit 1989, dhe aktualisht kur akoma po ndodhin izolimet e intelektualëve dhe punëtorëve ekskluzivisht shqiptarë. Normalisht që teoria juridike jugosllave mbeti pa përgjegje (me disa përjashtime të vogla), ndërsa populli shqiptar si më legjitim e dha interpetimin e vet, të cilin e pranoi bota e qytetëruar: nuk ishte fjala për mosprecizitet të ligjit, interpretim të gabuar apo përgjithësim, por për mbisundim të politikës mbi të drejtën, mbisundim i politikës antishqiptare dhe diskriminuese, e cila në emër të kushtetutës, të ligjit e të shtetit juridik po shndërrohet në diktaturë njënacionale shoveniste.

Për t'i mënjanuar të gjitha këto në një shtet modern juridik me rend kushtetues demokratik, ekziston ndarja e pushtetit, e cila nën parullën *checks and balances* mundëson paanësinë e gjyqeve në atë masë në të cilën është i mundur kontrolli gjyqësor i vendimeve administrative si dhe institucionalizimi i pavarësisë organizative dhe funksionale të gjyqeve nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ. Këto postulate pa dyshim se i ka sanksionuar Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kështu, ta zëmë, në pjesën VII të Kushtetutës (Organet Republikane: nenet 96-126), është përqafuar sistemi i kombinuar i unitetit të pushtetit me disa zgjidhje më karakteristike për sistemin e ndarjes së pushtetit. Kështu edhe është arsyetuar kjo pjesë e Kushtetutës. Pushteti legjislativ është përfaqësuar nga Kuvendi i Republikës, si organi më i lartë përfaqësues, njëjtë siç është rasti me sistemet e tjera moderne juridike (neni 97 i Kushtetutës). Kuvendi është njëdhomësh dhe ka 130 deputetë (neni 98, al. 1.), të cilët zgjidhen në zgjedhjet e lira, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë (neni 98, al. 2). Kryesia e Republikës është organ përfaqësues i Republikës së Kosovës (neni 107).

Organ i pushtetit ekzekutiv është Qeveria Republikane (neni 112), e cila për punën e vet i përgjigjet Kuvendit (neni 106 i Kushtetutës). Atë e përbëjnë kryetari, nënkryetarët dhe ministrat (neni 113, al. 1).

Bartës të funksionit administrativ janë ministritë (neni 117, al. 1), të cilat janë të pavarura në kryerjen e kompetencave të përcaktuara me kushtetutë

dhe ligj (neni 117, al. 2), ndërsa për punën e vet ministri i përgjigjet Kuvendit dhe Qeverisë (neni 117, al. 5, e Kushtetutës).

Funksionin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat e rregullta si organe të pushtetit shtetëror (neni 118, al. 1), ndërsa me ligj mund të formohen edhe llojet e tjera të gjyqeve për zgjidhjen e kontesteve të caktuara (neni 118, al. 2). Gjyqet janë të pavarura dhe gjykojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit (neni 119). Garantohet parimi i publicitetit në punën e gjykatave (neni 120). Sikundër shihet, me këto dhe dispozitat tjera, të cilat duhet të operacionalizohen më tej me ligje, sigurohet pavarësia e gjyqeve si parakusht esencial i zbatimit të ligjshmërisë, të lirive dhe të drejtave njerëzore, si dhe i funksionimit të shtetit juridik (pjesë dhe arsyetimi i Kushtetutës). Si organ i pavarur i ndjekjes së kryesve të veprave penale dhe të tjerave është Prokuroria Publike (neni 125 i Kushtetutës).

Rregullsia procedurale konsiston në respektimin e të drejtave të njeriut kundër keqpërdorimeve të pushtetit shtetëror. Në sistemin i cili mundëson realizimin e plotë të drejtësisë procedurale pamundësohen ndikimet jashtinstitucionale (p.sh., mitingjet) në vendimet institucionale. Drejtësia procedurale realizohet në rrjetin e gjerë të institucioneve procedurale demokratike (p.sh., dispozitat për kompetencën, udhëheqjen e procedurës, afatet e ndryshme për aktivitetin e të gjithë pjesëmarrësve etj.). Demokracia kushtetuese liberale në esencë është sundim i procedurave të paracaktuara më parë. Këtë frymë e përshkon edhe Kushtetuta, e cila, ta zëmë, në nenin e saj 44, ka thënë si vijon: "jeta e njeriut është e pacenueshme", ndërsa në al. 2 të po këtij neni, thuhet se "askush nuk mund të privohet nga liria përveç rasteve dhe procedurës së caktuar me ligj, në bazë të vendimit të gjykatës kompetente". Në nenin 46 të Kushtetutës janë përcaktuar rastet, koha dhe procedura e paraburgimit. Ky institucion në sferën e së drejtës së procedurës penale njihet si institucioni i ashtuq. *habeas corpus*, i cili së pari është zbatuar në Angli në vitin 1679, në bazë të *Habeas Corpus Act*-it të po atij viti. Ky ligj në Angli ka futur qysh atëherë procedurën e sigurt dhe mjetet adekuate juridike për mbrojtjen e lirisë dhe të dinjitetit të njeriut, kurse sot paraqet institucionin e pashmangshëm të të gjitha sistemeve juridike civilizuese.

Dispozitat e cekura më parë, së bashku me të tjerat, në Kushtetutën e Republikës paraqesin bazën e mirëfilltë për realizimin e plotë të drejtësisë procedurale në të gjitha sferat e jetës. Gjithashtu vlen të thuhet se edhe ky institut në teorinë juridike jugosllave është trajtuar vetëm "si mundësi eventuale e keqpërdorimit, madje në raste të rralla, pa u përmendur Kosova dhe shqiptarët". Kjo nga shkaku që sot mund të thuhet në mënyrë apodiktike se në so-

cializëm, pra edhe në RSFJ, nuk janë të mundshme reformat socio-ekonomike dhe politike në frymën e Evropës pa ndryshime rrënjësore të procedurave të formalizuara të legjitimitetit të pushtetit. Prandaj, sot, në prag të shek. XXI, në qendër të Evropës, njeriu shqiptar duhet të rrijë në ankth e frikë se do të mund të "nëpërkëmbet" nga ndonjë nen apo aline, nga sa e sa ligje të "shtetit juridik" serb, madje në emër të "mbrojtjes së socializmit dhe të rendit socialist të përcaktuar me kushtetutë e ligj" (po ashtu socialiste, kurse *de facto* pravosllavo-socialiste). Nuk është fjala për raste, por për dukuri.

Ideja për bashkësinë shtetërore të bazuar në kontratë (marrëveshje) sociale mbështetet në idenë për vëllimin e njëjtë të lirisë së anëtarëve të bashkuar (preambulla e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 42). Nëse ekziston ndonjë e drejtë morale, atëherë ajo është e drejta natyrore e të gjithëve për të qenë të lirë. Barazia dhe liria e anëtarëve të bashkuar presupozon se çdo anëtar, pavarësisht dhe pa ndërhyrje të të tjerëve, mund t'ia ndërtojë vetes konceptin për shoqërinë. Duke qenë se, parimisht, është i pamundur reprezentimi i interesave individuale, atëherë shtrohet nevoja për disa institucione të ndërmjetësimit. Dy nga më të rëndësishmet janë institucioni i publikut (gjatë ushtrimit të punëve shtetërore) dhe i pluralizmit partiak. Dy këto institucione garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kështu, ta zëmë, në nenin 18 të Kushtetutës është përcaktuar se puna e organeve të pushtetit shtetëror është publike. Publiciteti i punës së organeve të pushtetit mund të përjashtohet vetëm në rastet e përcaktuara me ligj. Ky nen më tej riprodukohet edhe në çështjet e tjera të punës së organeve konkrete të pushtetit (Kuvendi, ministritë, gjykatat etj.).

Me qëllim të sigurimit të kushteve për organizimin dhe ushtrimin e pushtetit mbi baza demokratike, me Kushtetutë, nenet 55 dhe 56, zbatohet pluralizmi partiak, ashtu që njihet e drejta universale e qytetarëve për t'u organizuar në parti politike, lidhje, lëvizje dhe shoqata të qytetarëve. Liria e bashkimit publik në shoqata dhe parti politike bën pjesë, sikundër dihet, në parimet konstituive të rendit modern kushtetues dhe shtetit juridik demokratik. Individi i vetmuar, pa përkrahjen e qytetarëve të bashkuar në pikëpamje institucionale dhe publike, ka gjasa të vogla për t'iu kundërvënë me sukses keqpërdorimit të forcës shtetërore. Çdo monopol politik, ideologjik, nacional etj., e pamundëson këtë segment të rendit modern kushtetues. Shtrohet pyetja: a mund të bëhet fare fjalë në Kosovë, tani për tani, për rend kushtetues kur me dhunë janë suprimuar të gjitha gjymtyrët e pushtetit legal!? Kjo gjë vlen edhe për rendin kushtetues të RSFJ-së, pjesë përbërëse e të cilit ka qenë edhe KSA e Kosovës (tani Republika e Kosovës). Teoriku i njohur anglez,

Palmerson, duke iu përgjigjur deputetëve anglezë, të cilët mbështeteshin në kushtetutë për të mbrojtur të drejtat politike të punëtorëve, pati thënë: "jam i gatshëm t'i jap një dhuratë të mirë atij i cili ma sjell një kopje të kushtetutës angleze". U mor vesh, në Britani ka një kushtetutë të pashkruar. E përdorëm këtë metaforë për të treguar simbolikisht mungesën, në raport me Kosovën dhe shqiptarët si pjesë konstituive e Jugosllavisë, të kushtetutës e cila akoma është në fuqi *de jure* (Kushtetuta e vitit 1974). Kjo sepse për Kosovën dhe shqiptarët ka vetëm një kushtetutë, Kushtetuta e 7 shtatorit 1990, miratuar në Kaçanik, në të cilën duhet të bazohet rendi i ri juridiko-kushtetues, kurse gjithçka tjetër është transhistorike, qoftë për nga forma, qoftë për nga përmbajtja. Ndërsa, ajo që quhet nga zyrtarët e shtetit serb si "shtet juridik" dhe "rend kushtetues" nuk është asgjë tjetër veçse formë e çoroditur e tij përkatësisht anarki, represion dhe terror shtetëror i një shteti okupues pa legjitimitet socio-politik dhe juridiko-politik. Aty ku nuk ka të drejtë moderne dhe institucione moderne publike-juridike, nuk ka as të drejtë publike demokratike.

Demokracia moderne kushtetuese kërkon zhvillimin e institucioneve parlamentare në të cilat në mënyrë të rregullt dhe të normuar do të kryhej faza kryesore e finalizimit të dialogut politik dhe e procesit legjitim të vendosjes. Kjo vlen në veçanti për Kuvendin, i cili sipas Kushtetutës cilësohet si organi më i lartë përfaqësues dhe ngërthen të gjitha kategoritë e parlamentarizmit modern (nenet 96-106). Pastaj vjen në shprehje Kryesia e Republikës, e cila në Kushtetutë me nenet 107-111 u pamundëson elitave nacionale që të shfrytëzojnë demokracinë si formë të forcimit ose të multiplikimit të fuqisë grupore nacionale ose individuale, përkatësisht pamundëson prodhimin e "divizioneve" politike, luftën e "shenjtë" propaganduese kundër kombeve të tjera, grupeve të tjera apo individëve. Me një fjalë, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të drejtat e njeriut dhe institucionet tjera civilizuese janë sanksionuar si *res humana* dhe jo si çështje të cilat i takojnë monopolit të një ideologjie, kombi, klase apo partie! (Fusnotat i hoqi Redaksia.)

Kapitulli III

KAPACITETI GJYSMËSHTETËROR I KOSOVËS PËR TË HYRË NË MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE, GABIMET E SHKENCËS JURIDIKE NË KOSOVË DHE KORNIZIMI I IDENTITETIT HISTORIK TË KOSOVËS NGA NJË INTELEKTUAL BRITANIK

Sfondi historik: Në këtë kapitull diskutojmë disa aspekte mjaft të rëndësishme që lidhen me iluzionet e diskursit në Kosovë në periudhën deri në pavarësimin e saj definitiv më 17 shkurt 2008, por që ka qenë mjaft i theksuar në periudhën 1991-1997. Fillimi i luftës në Kosovë më 1997 dhe mbyllja e saj me sukses më 10 qershor 1999 (kur në vend hynë trupat e NATO-s si triumfuese, së bashku me popullin shumicë dhe UÇK-në) lanë nën hije çdo diskurs shterp dhe naiv që fliste për pozitën juridiko-kushtetuese të Kosovës në kuadër të RSFJ-së si bazë të vetme dhe të pashmangshme për realizimin e vetëvendosjes së popullit shumicë. Në fakt, këtu bëhej një ngatërrim mes pozitës së Kosovës brenda ish-RSFJ-së në aspektin e lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare në sektorë të caktuar me kapacitetin e saj real për të qenë subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare. Këtë konfuzion e krijonin kolegët nga komuniteti juridik, kryesisht arsimtarë të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, atëherë akoma i vetmi institucion i llojit të tillë ndër shqiptarët në ish-Jugosllavi, por që u bart në elitën politike vendimmarrëse kosovare dhe më gjerë. Kjo jo vetëm që nuk ishte e saktë, por edhe dilte si qesharake në sytë e miqve tanë ndërkombëtare me të cilët autori i këtyre rreshtave ishte në kontakt të vazhdueshëm, duke qenë diplomat i efektivit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë që nga nëntori i vitit 1992 e deri në mbarimin e luftës në qershor 1999.

Për të provuar sadopak që të ndihmohet tejkalimi i këtij diskursi, ky autor kishte bërë disa shkrime për përdorim intern për nevojat e kryeministrit të Republikës së Kosovës në mërgim, prof. dr. Bujar Bukoshi. Kur kishte parë se kjo nuk po jepte rezultatin e duhur, atëherë u ishte kundërvënë edhe në publik në mediat e shkruara të kohës kolegëve nga Fakulteti Juridik për t'u treguar se botimi i marrëzisë juridike në emër të shkencës edhe në gjuhët e huaja tejkalonte çdo masë racionale të debatit. Kur u bë polemika, e cila jepet në

vazhdim këtu poshtë, shumëkush e mirëpriti sepse, në ndërkohë që gjërat po përkeqësoheshin në Kosovën e pesë viteve të para pas shpalljes së Kushtetutës së Kaçanikut, diskursi naiv dhe shterp rreth Kosovës dhe vendit të saj në ish-RSFJ akoma po vazhdonte sikur ish-RSFJ të ishte ende gjallë si shtet. Megjithatë, vetëm më 1999, në kulmin e luftës për mbijetesë të popullit të Kosovës, u botua një libër me rëndësi kolosale për identitetin tonë historik në kontinuitet, i cili tregonte qartë se Kosova asnjëherë në aspektin juridik-ndërkombëtar nuk kishte qenë pjesë e Serbisë si shtet. E kemi fjalën këtu për librin *Kosova: një histori e shkurtër* të autorit Noel Malcolm (Noel Malkolm), recensionin e të cilit e pata bërë akoma pa dalë në dritë botimi për publik falë njërit prej mentorëve të mi në studimet e doktoratës në Universitetin Bilkent të Ankarasë, profesorit të mirënjohur Norman Stone (Norman Stonë). Prof. Stone, si mik i ngushtë i autorit, kishte pasur privilegjin që të ketë në dorë një kopje të librit për "lexim provues", të cilin Malcolmi ia kishte kërkuar ta bënte duke gjetur një studiues vendor të kësaj lëmie. Mua më ra fati dhe e bëra këtë recension, të cilin më vonë e botova në Kosovë në revistën *E Drejta/Law*, viti XXIII, nr. 4, më 1997[42]. Sado që numri i kësaj reviste është i vitit kalendarik 1997, duhet sqaruar për lexuesin se kjo revistë, si pasojë e kushteve të rënda të okupimit serb të Kosovës përgjatë viteve 1990-1999, nuk ka mundur të dalë asnjëherë me kohë dhe si duhet. Kjo edhe për faktin se Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës ka punuar në mungesë dramatike të mjeteve financiare dhe të kushteve minimale për jetë të mirëfilltë akademike, ashtu që çdoherë numrat e kësaj reviste të vetme akademike për çështje juridike në Kosovë kanë dalë me disa vite vonesë. Është krejt e sigurt se unë recensionin në fjalë e kam bërë në mars të vitit 1999, në ndërkohë që lufta e NATO-s dhe UÇK-së kundër forcave serbe të diktatorit Sllobodan Millosheviq ka qenë në kulmin e saj. Populli shqiptar i Kosovës në këtë periudhë po përjetonte ditët më të vështira në historinë e tij të fundshekullit XX.

Ajo çfarë të çudit edhe sot është se libri i Noel Malcolmit vazhdon akoma të jetë një ndër librat më pak të qarkulluar ndër intelektualët dhe nuk mësohet në asnjë program të shkollave kosovare dhe më gjerë nëpër botën shqiptare në Ballkan. Recensionin e këtij libri e japim në shkrimin e fundit të këtij kapitulli, ashtu siç ka qenë i botuar në atë kohë[43], në ndërkohë që ky kapitull fillon me punimin e titulluar "Mbi momentet kyçe të rrjedhës së krizës ju-

[42] Enver Hasani, "Një libër me rëndësi të veçantë", *E Drejta/Law* viti XXIII, nr. 4 (1997).

[43] Argumentet juridike mbi bazën e së drejtës për vetëvendosje të Kosovës të dhëna nga ky autor në tërësi përputhen me argumentet tona të cilat i kemi shpalosur në shkrimet në vijim, të cilat riprodhohen këtu, në veçanti në shkrimin "Gabimet e një shkence juridike".

gosllave dhe reagimin e bashkësisë ndërkombëtare ndaj saj: aspekte juridiko-politike". Këtë studim analitik, përmes drejtorit të DBShTN të MPJ-së së Shqipërisë, zt. Dervish Dumi (në këtë detyrë nga 1992 deri më 1995), ia pata dërguar kryeministrit të Republikës së Kosovës në mërgim, prof. dr. Bujar Bukoshi (në detyrë nga 1992 deri më 1999), i cili asokohe qëndronte i strehuar në Gjermani[44].

Nën seksionin II të Kapitullit, i titulluar "Gabimet e një shkence juridike"[45], jepet shkrimi i gjatë polemizues me autorët e respektuar: tani i ndjeri akademik Esat Stavileci, prof. dr. Arsim Bajrami, si dhe prof. dr. Blerim Reka. Ky shkrim polemik pasohet nga reagimi i kolegëve ndaj shkrimit tim nëpër gazetat ditore të kohës[46], ku edhe qe botuar shkrimi im fillestar, si dhe përgjigjja ime në reagimin e tyre[47], në mënyrë që lexuesi i sotëm ta shohë nëse ka pasur kuptim dhe rëndësi teorike, praktike dhe intelektuale një ballafaqim i tillë i argumenteve në mes nesh.

Lexuesi sot e ka fare të lehtë ta vërejë se mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Kosovën, i dhënë trembëdhjetë vjet më vonë, katërcipërisht ka vërtetuar tezat për llojin, formën dhe përmbajtjen e vetëvendosjes së Kosovës që ne kemi mbrojtur në këtë shkrim polemik të titulluar, jo rastësisht, si "Gabimet e një shkence juridike"[48].

---

[44] Enver Hasani, "Mbi momentet kyçe të rrjedhës së krizës jugosllave dhe reagimin e bashkësisë ndërkombëtare ndaj saj", dërguar në *Gjermani* më 7 shkurt 1995 në numrin e faksit: + 49 730 97 470. Në fakt, zt. Dervish Dumi e kisha lutur që këtë material t'ua dërgonte të gjitha partive politike në Kosovë, gjë të cilën e kishte bërë me shumë kënaqësi, duke m'i dërguar fletëkthesat e fakseve të pranuara në Kosovë nga shefat partiakë të kohës.

[45] Enver Hasani, "Gabimet e një shkence juridike", *Rilindja*, botimi i Tiranës, fejton në 14 vazhdime, nga 1 korrik 1997 deri më 16 korrik 1997.

[46] Esat Stavileci, Arsim Bajrami dhe Blerim Reka, "Pse nuk dëshirojmë të polemizojmë me Enver Hasanin" dhe "Shprehje e pikëpamjeve individuale", *Rilindja*, botimi i Tiranës (28 gusht 1997) fq. 11.

[47] Enver Hasani, "Ungvibus et Rostris", *Rilindja*, botimi i Tiranës (4 shtator 1997) fq. 10.

[48] "Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo (Request for Advisory Opinion)", General List No. 141, *International Court of Justice* (ICJ), 22 July 2010, në rrjet: http://www.refworld.org/docid/4c5151002.html (e qasur së fundi më 2 qershor 2016).

I. Mbi momentet kyçe të rrjedhës së krizës jugosllave dhe reagimin e bashkësisë ndërkombëtare ndaj saj: aspekte juridiko-politike

Hyrje

Në zinxhirin e krizës së ish-RSFJ, përkatësisht të shpërbërjes së saj në kuptimin e së drejtës ndërkombëtare, rasti i Kroacisë dhe Sllovenisë ka tërhequr reagimet e para të bashkësisë ndërkombëtare në drejtim të njohjes së tyre si subjekte juridiko-ndërkombëtare. Kështu, më dt. 27 shtator 1990, parlamenti slloven deklaroi pavlefshmërinë e të gjithë legjislacionit federal në territorin slloven. Në referendumin e mbajtur më dt. 23 dhjetor 1990, 88,5 për qind e votuesve sllovenë optuan për pavarësi. Një ditë më parë, parlamenti kroat deklaroi supremacinë e legjislacionit të tij mbi atë të ish-RSFJ.

Bisedat e zhvilluara në pranverën e vitit 1991 mes ish-republikave të ish-RSFJ e me qëllim të krijimit të të a.q. federatë asimetrike dështuan si pasojë e politikës ekspansioniste të Serbisë. Në po atë kohë, përkrahja e integritetit territorial të ish-RSFJ nga ana e shteteve me influencë dhe organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe ShBA-në, BE-në dhe KSBE-në (tani OSBE-ja) padyshim se patën forcuar lidershipin serb me në krye Sllobodan Millosheviq e veçanërisht me mosnjohjen ndërkombëtare të pavarësisë së Kroacisë dhe Sllovenisë.

Nga dt. 24 qershor 1991, pas disa përpjekjeve të dështuara në bisedime lidhur me secesionin ose federatën e a.q. asimetrike, kryeministri i atëhershëm i ish-RSFJ, Ante Markoviq, u tërhoqi vërejtjen autoriteteve në Zagreb dhe Lubjanë se "qeveria federale do të përdorë të gjitha mjetet në disponim që të ndalojë republikat (Sllovenine dhe Kroacinë) për të ndërmarrë hapa të njëanshëm për pavarësi të plotë". Megjithatë, Sllovenia dhe Kroacia deklaruan pavarësinë nga ish-RSFJ një ditë më vonë, më dt. 25 qershor 1991. Dy ditë më pas, më dt. 27 qershor 1991, forcat e armatosura të ish-APJ-së u drejtuan për sulm kundër forcave të armatosura të Sllovenisë. Autoritetet në Slloveni proklamuan "gjendjen e luftës" dhe apeluan në bashkësinë ndërkombëtare për ndihmë, duke përfshirë këtu edhe aksionin e BE-së, KSBE-së dhe të OKB-së.

Këtu përfundon substrati faktik i ngjarjeve si çështje e brendshme e ish-RSFJ dhe fillon faza e reagimit të bashkësisë ndërkombëtare ndaj krizës në ish-RSFJ. Këto, dhe vetëm këto, ngjarje në Slloveni dhe Kroaci kanë qenë kompetente për bashkësinë ndërkombëtare dhe reagimin e saj, e assesi ato të cilat janë zhvilluar në pjesët e tjera të ish-RSFJ.

1. Reagimi fillestar i BE-së dhe KSBE-së

As BE-ja e as KSBE-ja fillimisht nuk qenë gati për krizën në ish-RSFJ (të paraqitur si më lart). Anëtarët e BE-së qenë gati për të filluar fazën finale të bisedimeve të cilat do të shpienin në Samitin e Mastrihtit (*Maastricht Summit*) të dhjetorit 1991. Megjithatë, BE-ja u involvua në krizën jugosllave edhe përkundër faktit se ish-RSFJ nuk qe anëtare e saj.

Brenda 72 orëve, troka e ministrave të jashtëm të BE-së (Italisë, Luksemburgut dhe Holandës) dërguan dy misione të shpejta në ish-RSFJ. Negociatorët e BE-së morën premtimet e njëpasnjëshme për ndërprerjen e armiqësive në Slloveni, mirëpo dhuna vazhdonte. Në mesnatën e qershorit të v. 1991, kryesia e radhës së BE-së kaloi nga Luksemburgu në Holandën, dhe menjëherë më pastaj, qeveritë e BE-së dërguan misionin e tretë, kësaj radhe të kompozuar nga diplomatët e lartë të Luksemburgut, Holandës dhe Portugalisë e me qellim të monitorimit të ndërprerjes së zjarrit në Slloveni, të premtuar më herët.

Këshilli i Evropës, në ndërkohë, thirri një mbledhje urgjente të KSBE-së si pasojë e vazhdimit të dhunës në Slloveni. KSBE-ja po transformohej nga mekanizmi për "ruajtjen e stabilitetit të krizave" në Evropën e Luftës së Ftohtë në organizatë të qëndrueshme dhe të aftë për të ofruar procedurat e përshtatshme për sigurinë kolektive në Evropë. Teksti origjinal i Aktit Final të KSBE-së (1975), i karakterit jodetyrues, afirmoi në Parimin I të drejtën e çdo shteti në barazi formale (legale), integritet territorial, liri dhe pavarësi politike. Mbrojtja e integritetit territorial të shteteve qe definuar gjerësisht në Parimin IV, i cili në terminologji është i huazuar nga neni 2(4) i Kartës së OKB-së. Referenca në integritetin territorial konfirmon një obligim drejtuar shteteve, por jo edhe popujve. Ai është një obligim për mosintervenim nga ana e shteteve të tjera (jashtë kontekstit kolonial) në konfliktet e brendshme dhe është i sforcuar më tej në Parimin VI të Aktit Final të Helsinkit. Në të kaluarën, parimet e sipërcekura, si pjesë e së a.q. e drejtë zakonore ndërkombëtare, kanë shërbyer dhe penguar përpjekjet e brendshme për secesion. Me fillimin

e armiqësive në Sllloveni, lidershipi serb e kuptoi këtë si *carte blanche* për realizimin e qëllimeve të tija — riunifikimin e ish-RSFJ me anë të përdorimit të forcës si "e drejtë legjitime" në kuptimin dogmatik të fjalës dhe interpretimit të dispozitave të sipërcekura.

Edhe përkundër këtij konfuzioni konceptual në anën e serbëve, KSBE dhe BE reaguan relativisht me vendosmëri në përpjekjet për shuarjen e akteve të dhunës në ish-RSFJ. Anëtarët e KSBE-së thirrën mbledhjen e Komitetit Konsultativ të Qendrës së re të porsaformuar për Pengimin e Konfliktit (*Consultative Committee of the Conflict Prevention Centre*), e i cili komitet është i autorizuar për t'u mbledhur në rastet kur ekzistojnë "aktivitete ushtarake jo të zakonshme"[49]. Në Deklaratën e dhënë më 1 korrik 1991, Komiteti nënvizoi rëndësinë e ndërprerjes së menjëhershme dhe komplete të armiqësive, implementimin e shpejtë të zotimeve të dala nga bisedimet mes palëve në konflikt, si dhe kthimin në kazerma të njësive të ish-APJ-së dhe të forcave të mbrojtjes territoriale të Sllovenisë[50].

Dy ditë më vonë, më 3 korrik 1991, një organ tjetër i ri u involvua në konflikt — Komiteti i Zyrtarëve të Lartë (*Commitee of Senior Officials*, CSO). Ky organ u formua në bazë të Kartës së Parisit për Evropën e Re dhe të rregullave të miratuara në mbledhjen e Berlinit të Këshillit të KSBE-së, mbajtur vetëm disa javë më parë. Në bazë të konkluzioneve të mbledhjes së Berlinit (21 qershor 1991), Komiteti i Zyrtarëve të Lartë qe ngarkuar të merrej "me situatat serioze të jashtëzakonshme të cilat mund të lindin si pasojë e cenimit të ndonjë prej parimeve të Aktit Final ose si rezultat i çrregullimeve të mëdha, të cilat rrezikojnë paqen, sigurinë ose stabilitetin në rajon". Komiteti i Zyrtarëve të Lartë, në mbledhjen e cekur në Pragë (3 korrik 1991) miratoi një apel urgjent për paqe duke përdorur një gjuhë mjaft të fortë, përkatësisht duke u tërhequr vërejtjen palëve se "çdo qasje në përdorimin e forcës në krizën aktuale në Jugosllavi vazhdon të jetë absolutisht e papranueshme". Edhe pse Komiteti i Zyrtarëve të Lartë nuk ka të drejtë që të ndërmarrë vendime juridikisht të obligueshme dhe vetëm apeloi urgjentisht ndaj palëve në konflikt, prapëseprapë ai dha pamjen se po e kanalizonte autoritativisht situatën konfliktuoze në kuadër të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare.

---

[49] Shih "Charter of Paris for a New Europe", UN Doc. A/45/859 (1990) fq. 20, dhe "Supplementary Documment to Give Effect to Certain Provisions Contained in the Charter of Paris for a New Europe", ibid. fq. 43, 47.

[50] "Chairman's Statement on the results of the Meeting of the Consultative Commitee of the Conflict Prevention Center" (1 July 1991).

Ditën vijuese, Komiteti i Zyrtarëve të Lartë, duke vepruar së bashku me përpjekjet për ndërmjetësim të BE-së, ofroi misionin e shërbimeve të mira në dispozicion të të gjitha palëve në ish-RSFJ[51]. Edhe pse ekzistimi i "palëve të interesuara" në konflikt qe njohur sërish, pranimi i misionit të shërbimeve të mira qe kërkuar vetëm nga ish-RSFJ (qeveria federale) si subjekt i së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Komiteti i Zyrtarëve të Lartë dhe ekipi ndërmjetësues i BE-së me këtë rast përqafuan dy parime: ndërprerjen e armiqësive dhe kthimin në pozitat paraprake të të gjitha forcave të armatosura, si dhe suspendimin e deklaratës sllovene për pavarësi për periudhën tremujore. Marrëveshja formale mbi pikat e cekura u arrit nga ana e subjekteve në fjalë, por vetëm pasi që BE-ja më 5 korrik 1991 vendosi embargon mbi eksportin e armëve dhe suspendoi ndihmën ekonomike prej një miliard dollarësh amerikanë ndaj ish-RSFJ. Dy ditë më vonë, ndërmjetësuesit e BE-së nxorën një marrëveshje në Brijoni me të cilën parashihej tërheqja e forcave të ish-APJ-së në kazerma si dhe çarmatosja e milicisë sllovene. Por, tërheqja e tyre u bë vetëm pas zgjidhjes së Stipe Mesiqit kryetar të kryesisë së ish-RSFJ më dt. 19 korrik 1991, plotësim ky i cili nga pjesët e tjera të ish-RSFJ (Sllovenia nuk mori pjesë) u konsiderua nga aspekti juridik si "kompletim i Kryesisë së RSFJ".

Në ndërkohë, një mision monitorues prej 50 vëzhguesish pati qenë dërguar atje në pajtim me Memorandumin e Mirëkuptimit, nënshkruar në Beograd më dt. 13 korrik 1991 nga ana e përfaqësuesve të BE-së, Qeverisë së ish-RSFJ, Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Sllovenisë. Megjithatë, armiqësitë në Kroaci shpërthyen në viset e banuara me shumicë serbe. Serbët në këto regjione qenë të përkrahur nga ish-APJ, e cila e ngriti dukshëm involvimin e saj në konflikt, kurse zyrtarët serbë të ish-federatës jugosllave, si Borisav Joviq ta zëmë, bashkësisë ndërkombëtare ia bënin me dije në mënyrë të vendosur se "vazhdonte ekzistimi i kontinuitetit të RSFJ me Mbretërinë SKS ('jugosllave' që nga viti 1929)"[52]. Por, siç do të shihet në vijim, kjo pikëpamje serbe qe hedhur poshtë së pari nga BE-ja dhe shtetet e saj anëtare, më pas edhe nga shtetet anëtare të KSBE-së (tani OSBE).

[51] "Offer of CSCE Good Offices Mission to Yugoslavia" (Prague, 4 July 1991).
[52] "Address of Dr. Borisav Jović in the Assembly of the SFRY" (19 March 1992), botuar në *Review of International Affairs* (1 July 1992).

2. Reagimi i BE-së dhe KSBE-së ndaj krizës në Kroaci

Herët në gushtin e vitit 1991, dhuna në Kroaci u ngrit në atë masë që ministri i jashtëm i Luksemburgut, Zhak Po (Jacques Poos), pati deklaruar se "ndoshta do të duhet ta shqyrtojmë mundësinë e dërgimit të forcave ushtarake për ndarjen e palëve atje". Kjo pikëpamje qe përshëndetur edhe nga Hans van den Broek (Hans van den Bruk), ministri holandez i punëve të jashtme dhe kryetar i trojkës së BE-së, ministri gjerman i jashtëm, Hans-Dietrich Genscher (Hans Ditrih Gensher), si dhe nga presidenti francez François Miterrand (Fransua Miteran) dhe Sekretari i Përgjithshëm i Unionit të Evropës Perëndimore, Willem van Eekelen (Vilem van Ekelen). Bashkimi Sovjetik, në përpjekjet e veta për ruajtjen e integritetit vetanak nga sfidat e shteteve baltike dhe entiteteve të tjera, qe i vetmi që një gjë të tillë e konsideronte si akt intervenimi ndaj ish-RSFJ-së. Dërgimi i forcave ushtarake për ndarjen e palëve në konflikt, megjithatë, nuk ka qenë asnjëherë një opsion real. Kjo nga shkaku se, siç do të shihet nga reagimi i KS të OKB-së, për një gjë të tillë nevojitej pëlqimi edhe i Serbisë (krahas pëlqimit të qeverisë federale të ish-RSFJ).

E vetmja ishte Gjermania që me plot të drejtë konstatoi se njohja e Kroacisë do ta "ndërkombëtarizonte" krizën dhe do t'i mundësonte BE-së, përkatësisht do t'i jepte të drejtë anëtarëve të saj dhe të bashkësisë ndërkombëtare në përgjithësi, për t'u futur në Kroaci pa pëlqimin dhe autorizimin e autoriteteve federale të ish-RSFJ (atëherë akoma si subjekt i vetëm i së drejtës dhe bashkësisë ndërkombëtare).

Pas refuzimit serb për dhënien e pëlqimit për vendosjen e forcave ndërkombëtare, BE-ja braktisi një ide të tillë dhe vendosi të kërkonte ndihmën e forcave paqeruajtëse të OKB-së. Serbia, në ndërkohë, eskaloi ndërhyrjen e saj ushtarake në Kroaci në mënyrë pafundësisht dramatike.

Më 27 gusht 1991, BE-ja, duke vepruar përmes një takimi ministror, u mblodh në Bruksel dhe lëshoi një deklaratë me të cilën, përveç vendosjes për thirrjen e një konference evropiane për paqe, shprehu shqetësimin e saj për shkallën e dhunës në Kroaci, dhe përkujtoi "të gjithë ata që janë përgjegjës për dhunën e cila po ushtrohet se BE-ja është e vendosur të mos njohë ndryshimet e kufijve të cilat nuk janë rezultat i mjeteve paqësore dhe marrëveshjes". Deklarata shprehu keqardhjen e BE-së për kapjen e armëve nga forcat e parregullta serbe dhe përkrahjen që po u jepte ish-APJ, si dhe ftoi "Kryesinë e RSFJ që të ndërpresë përdorimin *ilegal* të forcave nën komandën e saj"[53].

---

[53] "EPC Declaration of 27 August 1991" *EPC Press Release* 82/91 (Brusseles).

Me këtë, BE-ja pranoi, siç e pati pranuar edhe KSBE-ja në apelin e saj urgjent për ndërprerjen e armiqësive më datën 3 korrik 1991, se Kroacia ishte *subjekt* i së drejtës ndërkombëtare kundër së cilës mund të ekzistonte "përdorimi *ilegal* i forcës". Rrjedhimisht, enklavave serbe në Kroaci (të a.q. Krajinave), BE-ja nuk ua njohu të drejtën për ndihmë ushtarake nga ish-APJ si dhe të drejtën e përdorimit të forcës (dhunës) për realizimin e qëllimeve të tyre, dhe aktet e tilla i shpalli *jolegale*. Në deklaratën e sipërcekur, BE-ja ftoi palët në konflikt që të pranojnë konferencën e saj të paqes dhe formimin e një arbitrazhi si mënyrë të vetme për zgjidhjen e konflikteve. Konferenca duhej t'i ftonte të gjithë kryetarët e ish-republikave (dhe ish-krahinave autonome, mirëpo Sejdo Bajramoviq, në emër të Kosovës, mori pjesë vetëm njëherë meqenëse Serbia vërejti herët trendët e shpërbërjes së ish-RSFJ dhe mundësinë që Kosova të legjitimohej ndërkombëtarisht), përfaqësuesit e federatës së ish-RSFJ (për palën jugosllave), përkatësisht qeverinë dhe kryesinë e saj.

Siç mund të vërehet, kjo deklaratë e BE-së pranoi se "RSFJ" ekzistonte edhe më tej si shtet e jo vetëm si kuptim gjeografik. Por, në të njëjtën kohë, me këtë deklaratë, BE-ja u kërcënua se do t'i vendoste sanksionet kundër atyre entiteteve të cilat nuk do t'i pranonin propozimet e saja të cekura më sipër, duke filluar që nga data l shtator 1991. Edhe njëherë vlen të theksohet këtu se sanksionet ekonomike kërcënoheshin ndaj palëve të cilat nuk ishin, asnjëra prej tyre, anëtare të BE-së. Me po këtë deklaratë qe vendosur që BE-ja të rriste numrin e forcave vëzhguese prej 50 në 200 anëtarë e me qëllim të vëzhgimit të marrëveshjes për ndërprerjen e zjarrit në Kroaci. Çështja e tërheqjes së ish-APJ-së dhe e ardhmërisë së ish-RSFJ-së, ekzistenca kontinuele e së cilës presupozohej, qe dërguar për shqyrtim në Konferencën e Paqes. Konferenca, e thirrur në bazë të deklaratës së sipërcekur, u mbajt në Hagë më dt. 7 shtator 1991 nën kryesinë e Lordit Carrington (Lord Kerington). Mandati i Konferencës pati qenë i definuar më shumë nga BE-ja se sa nga vetë palët, në bazë të një deklarate tjetër ministrore të dt. 3 shtator 1991. Ai mandat konsistonte në "sigurimin paqësor të plotësimit të aspiratave të popujve jugosllavë, në bazë të principeve vijuese: nuk ka ndryshim me forcë të kufijve, mbrojtjen e të drejtave të të gjithëve në Jugosllavi dhe, së fundi, marrjen parasysh të të gjitha kërkesave legjitime dhe aspiratave të të gjithëve"[54].

Në kohën kur situata në Kroaci u keqësua edhe më tepër, përkundër një marrëveshjeje në mes anëtarëve të KSBE-së për suspendimin e dërgesave në

[54] "Extraordinary EPC Meeting — Declaration on Yugoslavia", *Press Release* (The Hague, 3 September 1991).

armatim në ish-Jugosllavi, përfundimisht u vendos thirrja e mbledhjes së KS të OKB-së për datën 25 shtator 1991, me qëllim që të diskutohej kriza në ish-RSFJ, për datën 25 shtator 1991.

3. Reagimi fillestar i KS të OKB-së

Reagimi i parë i KS të OKB-së për nga procedura (rrjedha) e tij dhe rezoluta e miratuar aty, paraqet një çështje që meriton analize të veçantë dhe si e tillë ishte me pasoja kruciale për zhvillimin e mëvonshëm të ngjarjeve rreth shpërbërjes së ish-RSFJ.

KS i OKB-së u mblodh në bazë të kërkesës së bërë nga Austria (letra e dt. 19 shtator 1991 — UN Doc. S/23052), Kanadaja (letra e dt. 19 shtator 1991 — UN Doc. S/23053), Hungaria (letra e dt. 20 shtator 1991 — UN Doc. S/823057) dhe, për çudi, vetë ish-RSFJ (letra e dt. 24 shtator 1991 — UN Doc. S/23059). Në këtë mbledhje të KS të OKB-së nuk u bë mbështetja në nenin 2(4) të Kartës së OKB-së dhe as që pati sugjerime për thirrjen e Kroacisë dhe Sllovenisë (apo ndonjë republike tjetër të ish-RSFJ), kurse statusi i delegacionit të ish-RSFJ nuk qe vënë në pyetje.

Më datën 25 shtator 1991, KS i OKB-së nxori një rezolutë, rezolutën nr. 713, e cila ka një rëndësi të madhe për tri arsye: *e para,* vetë ish-RSFJ u pajtua me thirrjen e mbledhjes në fjalë, duke e bërë kërkesën e cekur më sipër; *e dyta*, përfaqësuesi i ish-RSFJ thirri KS të OKB-së për futjen e embargos së armeve kundër të gjitha palëve, përkatësisht kundër shtetit të cilin ai e përfaqësonte; dhe, *e treta*, përfaqësuesi i ish-RSFJ deklaroi se "parimi i vetëvendosjes po shkrihet në nevojën e ndarjes së tij në përbashkësi" dhe se "Jugosllavia nuk mundet më, thjesht, të riparohet [...]. Ajo [ish-RSFJ — vërejtja jonë, E.H.] duhet ridefinuar." Duke e shprehur brengosjen e tij për luftimet në ish-Jugosllavi dhe pasojat e konfliktit për vendet fqinje, përfaqësuesi i ish-RSFJ, në po atë mbledhje, deklaroi se "vazhdimi i kësaj situate paraqet kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare". Ky konstatim (i cili u quajt si i pa precedent dhe solomonik) i përfaqësuesit të ish-RSFJ plotësoi kushtin e nenit 39 të Kartës së OKB-së, duke e futur në lojë kështu Kreun VII të Kartës së OKB-së.

Rezoluta 713 në preambulën e saj theksoi, në kontekst të Kreut VIII të Kartës së OKB-së, përpjekjet e BE-së dhe KSBE-së dhe rikonfirmoi se parimi "i mishëruar në Kartën e OKB-së [i cekur edhe në Deklaratën e KSBE-së të dt. 3 shtator 1991 — vërejtja jonë, E.H.] se përfitimet territoriale ose ndryshi-

met e bëra me forcë në Jugosllavi nuk janë të pranueshme". Në fakt, parimi i sipërcekur nuk përmendet në Kartën e OKB-së por në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së mbi Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me Marrëdhëniet Miqësore dhe Kooperimin mes Shteteve e në pajtim me Kartën e OKB-së, rezolutë që konsiderohet si një akt interpretativ autentik dhe autoritativ i Kartës së OKB-së në mënyrë[55].

Në pjesën operative të Rezolutës në fjalë të KS të OKB-së shprehet përkrahja e KS-së dhënë përpjekjeve kolektive për paqe të BE-së dhe KSBE-së. Këshilli i Sigurimit kërkoi nga të gjitha palët në konflikt që të respektojnë marrëveshjet për ndërprerjen e zjarrit dhe që konfliktet t'i zgjidhin përmes bisedimeve në Konferencën Evropiane për Paqe. Këshilli i Sigurimit vendosi gjithashtu, në bazë të Kreut VII-te të Kartës së OKB-së, që të gjitha shtetet "me qëllim të krijimit të paqes dhe të stabilitetit në Jugosllavi do të zbatojnë embargon komplete dhe gjenerale të armëve dhe të pajimeve të tjera ushtarake ndaj të gjitha palëve në Jugosllavi". Procedimi i kësaj çështjeje në KS të OKB-së lidhur me këtë rezolutë zbulon një pikë me rëndësi. Në të vërtetë, siç ishte rasti me kurdët në Irakun verior, kërcënimi i paqes dhe sigurisë ndërkombëtare i cili mundëson, në pikëpamje procedurale, veprimin në bazë të Kreut VII të Kartës së OKB-së nuk është e domosdoshme të kërkohet dhe të gjendet në vuajtjet e individëve, grupeve ose popujve brenda ish-RSFJ, por para së gjithash në rrezikun (kërcënimin) për territoret (vendet) fqinje.

Moment tjetër me rëndësi në këtë kontekst është konfirmimi i tërthortë i zbatueshmërisë të të a.q. parimit *uti possidetis juris* jashtë kontekstit kolonial, duke i mbrojtur kësisoj kufijtë administrativë ose federalë nga ndryshimi i dhunshëm. Kjo qasje për herë të parë qe iniciuar nga Deklaratat e BE-së dhe KSBE-së, të cilat u cekën më sipër.

3.1. Misioni i Vance-it dhe aksionet e mëtejshme të BE-së

Menjëherë pas miratimit të Rezolutës nr. 713 nga KS të OKB-së, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së krijoi kontaktet me Lordin Carrington (kryesues i Konferencës Evropiane për Paqe), pastaj me përfaqësuesit e BE-së dhe KSBE-së, përfaqësuesit e vendeve fqinje të ish-RSFJ dhe me ish-ministrin e jashtëm jugosllav. Më dt. 2 tetor 1991, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së apeloi tek të gjitha palët që të reduktojnë armiqësitë dhe të kooperojnë me

[55] "Declaration on Principles of International Law Concerning Friendly Relations and Co-operation among Statës in accordance with the Charter of the United Nations", G.A. Res. 2625, Annex, 25 UN GAOR, Supp. (No. 28), U.N. Doc. A/5217 at 121 (1970).

BE-ne dhe Lordin Carrington. Ai po ashtu kërkoi nga Cyrus Vance (Sajrus Vens) që të veprojë si i dërguar i tij special.

Në këtë fazë të krizës në ish-RSFJ, për qëllimet e kësaj analize, të rëndësisë kryesore janë reagimet "në letër" të personave të sipërcekur të bëra në emër të bashkësisë ndërkombëtare. Këto reagime "në letër" më vonë (e deri në ditët e sotme) do të trasojnë rrugën e "së drejtës për vetëvendosje", përkatësisht rrugën se kujt dhe si mund të realizohet ajo e drejtë në territorin e ish-RSFJ.

Kështu, Van den Broek dhe Lordi Carrington, në emër të Konferencës Evropiane për Paqe, kryesuan një takim tjetër në Hagë, i cili ishte përcjellë edhe nga kryetarët e Serbisë dhe Kroacisë, si dhe nga ish-Sekretari i Mbrojtjes i ish-RSFJ. Më 4 tetor 1991, Van den Broek lexoi një deklaratë me të cilën palët e cekura zotoheshin për zgjidhje politike të problemit dhe njohje të pavarësisë së atyre republikave të cilat dëshironin një gjë të tillë, në kuadrin e një marrëveshjeje gjenerale e cila do të përfshinte elementet vijuese:

a. bashkimin asimetrik ose aleancën e republikave sovrane dhe të pavarura;
b. lidhjen e marrëveshjeve adekuate për mbrojtjen e minoriteteve, duke përfshirë këtu edhe të drejtat e njeriut dhe statusin e mundshëm special për disa regjione; dhe
c. mosndryshimin me dhunë dhe të njëanshëm të kufijve[56].

Kjo deklaratë më vonë u përpunua në një dokument tjetër të titulluar "Aranzhimet për Zgjedhjen Gjenerale", kurse më 25 tetor 1991, Lordi Carrington i propozoi Konferencës së Paqes që pikat e sipërcekura të Aranzhimeve për Zgjedhjen Gjenerale t'i merrte parasysh me rastin e zgjidhjes së konflikteve në fjalë dhe t'u jepte palëve (serbe dhe kroate) afatin deri më 5 nëntor 1991 që t'i pranojnë si të tilla. Në ndërkohë, qenë përgatitur sanksionet ekonomike të BE-së (që nga fundi i tetorit) për sa i përket marrëveshjeve të kooperimit dhe koncesioneve tregtare.

Nga 4 nëntori i vitit 1991, një ditë para skadimit të afatit të BE-së, Konferenca e Carringtonit kishte përgatitur një dokument të titulluar si "Projekt-Konventë për Marrëveshje", me të cilën edhe formalisht sqaroheshin dhe ridefinoheshin parimet e vëna në "Aranzhimet për Zgjedhjen Gjenerale". Kjo projekt-konventë përfshinte katalogun më të detajuar të të drejtave të minoriteteve dhe të atyre njerëzore, si dhe parashikonte krijimin e strukturave au-

[56] Res. no. 713 (25 September 1991), UN Doc. S/23169 (1991).

tonome, duke përfshirë në to funksionet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në ato regjione ku minoritetet përbëjnë shumicën lokale. Këto regjione duhej të ishin (sipas këtij dokumenti) të demilitarizuara në mënyrë permanente. Ky propozim për demilitarizim, në fakt, paraqitet si risi e vetme në atë fazë të zhvillimit të krizës në ish-RSFJ.[57]

Serbia refuzoi të pranonte këtë projekt-konventë, ashtu që BE i futi sanksionet e premtuara në rast refuzimi të dokumentit[58]. Përveç kësaj, BE kërkoi nga KS i OKB-së që të vej një embargo të naftës dhe të adoptojë masa plotësuese me qellim të rritjes së efektshmërisë së embargos së armëve. Sekretari i përgjithshëm i OKB-së më 6 nëntor 1991 deklaroi se "vetëm OKB-ja ka autorizim dhe tagër për vënien e sanksioneve kundër Jugosllavisë"[59]. Kësaj radhe, KS i OKB-së nuk u mor me vënien e masave të reja plotësuese. Për më tepër, më 27 nëntor 1991, KS i OKB-së adoptoi rezolutën me të cilën shprehet besimi se Sekretari i Përgjithshëm do të vazhdojë kontaktet me të gjitha palët në konflikt sa më shpejt që të jetë e mundur e me qëllim të furnizimit të KS të OKB-së me rekomandimet përkatëse, përfshirë këtu edhe vendosjen e forcave paqeruajtëse të OKB-së[60].

KSBE-ja përkrahu këtë politike të BE-së dhe KS të OKB-së duke theksuar se "vendosja e forcave paqeruajtëse nuk guxon në asnjë mënyrë të përkrahë fitimet territoriale të bëra me forcë "[61]. Kjo nënkuptonte se nuk do të ketë legalizim të fitimeve territoriale të bëra me forcë. Përkundër gjithë kësaj, serbët në Kroaci tanimë po kontrollonin një të tretën e territorit kroat, kurse KS i OKB-së vetëm më dt. 21 shkurt 1992 përkrahu propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për forcat paqeruajtëse (13.870 personel ushtarak e policor dhe 519 personel civil), dhe duke u thirrur në nenin 25 të Kartës së OKB-së, KS vendosi të formojë të a.q. Forcat Mbrojtëse të OKB-së (UNPROFOR) me qëllim të vendosjes së menjëhershme të tyre[62].

---

[57] "Treaty Provisions for the Convention" (1991).
[58] "EC COMM'N — Week in Europe" (7 November 1991).
[59] Letër kryesuesit të Këshillit të Sigurimit, UN Doc. NS-41/91.
[60] Res. no. 721 (27 November 1992), UN Doc. S/23239, annex (1991).
[61] "CSO Resolution: Support for UN Action on Yugoslavia" (29 November 1991).
[62] Res. no. 743 (21 February 1992), UN Doc. NS 11/92.

3.2. Njohja ndërkombëtare e republikave të ish-RSFJ — kushtet për njohje, përkatësisht vënien e marrëdhënieve diplomatike të përcaktuara nga BE

Më 15 janar 1992, Kryesia e Konferencës për Paqes në Jugosllavinë deklaroi se, në dritën e këshillës së dhënë nga Komisioni i Arbitrazhit, BE-ja dhe anëtarët e saj kanë vendosur të procedojnë me njohjen e Sllovenisë dhe Kroacisë. Gati gjashtë muaj u deshën që anëtarët e BE-së t'i njohin Sllovenínë dhe Kroacinë, duke treguar kështu se këto dy republika gëzojnë mbrojtjen e së drejtës ndërkombëtare.

Para kësaj qasjeje të miratuar nga Kryesia e Konferencës, mbledhja ministrore e po kësaj konference miratoi në Bruksel, më dt. 16 dhjetor 1991, të a.q. *Kritere për Njohjen e Shteteve të Reja në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik* (*Guidelines on the Recognition of New States in Eastern Europe and in the Soviet Union*). Kjo mbledhje ministrore e konferencës si e jashtëzakonshme miratoi disa kushte për njohje të cilat në esencë nuk ndryshojnë nga ato të propozimit të cekur të Carringtonit dhe të cilat deri më sot kanë qenë baza kryesore për njohjen ndërkombëtare të reja në truallin e ish-vendeve socialiste[63].

Kushtet për njohje ndërkombëtare, sipas dokumentit në fjalë, janë:

a. respekti për dispozitat e Kartës së OKB-së dhe për zotimet e propozuara në Aktin Final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për Evropën e Re, veçanërisht respektimi i sundimit të ligjit, demokracisë dhe të drejtave njerëzore;
b. sigurimet për të drejtat e grupeve etnike dhe nacionale dhe minoritetet në pajtim me zotimet e parapara në kuadrin e KSBE-së;
c. respekti për pacenueshmërinë e të gjithë kufijve, të cilët mund të ndryshohen vetëm me mjete paqësore dhe me marrëveshje të përgjithshme;
d. përqafimi i të gjitha zotimeve relevante për sa i përket armatimit dhe mospërhapjes së armeve nukleare, sikundër edhe i zotimeve për sigurinë dhe stabilitetin regjional; dhe
e. zotimi për zgjidhjen me marrëveshje të të gjitha çështjeve lidhur me suksedimin si dhe të mosmarrëveshjeve regjionale, përfshirë këtu edhe procedurën e arbitrazhit kur kjo quhet e nevojshme.

[63] EPC Press Release 128/91 (16 December 1991).

Kjo deklaratë e BE-së (mbi kushtet e njohjes) përfundonte me paragrafin vijues: "Zotimi ndaj këtyre parimeve hap rrugën për njohje nga ana e BE-së dhe anëtarëve të saj dhe për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike" me shtetet të cilat njihen. Në një deklaratë tjetër të po të njëjtës ditë, BE-ja vuri edhe ca kushte plotësuese për sa i takonte ish-RSFJ[64].

Ne të vërtetë, aty Bashkësia konfirmoi se "nuk do t'i njohë entitetet të cilat janë rezultat i agresioni". Me këtë rast, BE po ashtu ftoi të gjitha republikat ish-jugosllave të deklarojnë deri më 23 dhjetor 1991 nëse:

1. dëshironin të njiheshin si shtete të pavarura;
2. pajtoheshin me kriteret e cekura si më sipër për njohjen ndërkombëtare;
3. pranonin dispozitat e Projekt-Konventës së Carringtonit, veçanërisht ato për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e grupeve etnike dhe nacionale; dhe
4. aprovojnë involvimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe të KS të OKB-së, sikundër dhe vazhdimin e Konferencës për Paqe në ish-Jugosllavi.

Me kërkesën e Greqisë u fut edhe kërkesa për Maqedoninë, e cila kishte të bënte me heqjen dorë nga kërkesat territoriale.

Ky katalog kaq i gjerë i kritereve për njohje të shtetësisë është mjaft i gjerë dhe tejkalon kriteret standarde për njohje të parapara në Konventën e Montevideos mbi të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve, datë 26 dhjetor 1933, dhe në të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare. Edhe pse disa nga kushtet e paraqitura shprehin disa prej kritereve objektive të cilat duhet plotësuar për njohjen e shtetësisë së një entiteti, shumica prej tyre, megjithatë, janë vënë si një mjet politik për plotësimin e interesave të BE-së. Vlen të ceket këtu se pikërisht në bazë të këtyre kritereve është bërë njohja ndërkombëtare e republikave të ish-BRSS-së (p.sh., komonuelthi i formuar mes ish-republikave sovjetike në bazë të Marrëveshjes së Alma-Atas më 8 dhjetor 1991 dhe ndarja e Çekosllovakisë më 1 janar 1993).

Pas vënies së këtyre kritereve për njohje, përkatësisht për vënien e marrëdhënieve diplomatike me këto shtete nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, Serbia ndërmori iniciativën për të kërkuar nga Komisioni i Arbitrazhit (i njohur për ne si Komisioni i Badinterit) një mendim lidhur me statusin legal (juridik) të ish-RSFJ (ne atë fazë të atëhershme të zhvillimit të ngjarjeve). Dhe, Komisioni konstatoi se:

---

[64] EPC Press Release 129/91 (16 December 1991).

a. RSFJ është në procesin e shpërbërjes;
b. është përgjegjësi e republikave që të zgjidhin problemet e suksedimit të cilat dalin gjatë këtij procesi e në pajtim me parimet dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare, duke pasur parasysh veçanërisht të drejtat njerëzore dhe të drejtat e popujve dhe të minoriteteve; dhe, së fundi,
c. është e drejtë e atyre republikave të cilat dëshirojnë të jetojnë së bashku që të formojnë asociacionin shtetëror demokratik sipas dëshirës së tyre[65].

Para se të shqyrtojë çështjen e njohjes së republikave të ish-RSFJ, Komisioni i Badinterit shqiptoi edhe dy vendime (mendime) të tjera me zbatim të përgjithshëm për situatën në ish-RSFJ. Më 20 nëntor 1991, sipas iniciativës serbe, Lordi Carrington kërkoi një opinion (mendim) lidhur me faktin nëse kufijtë e brendshëm mes Serbisë dhe Kroacisë, në njërën anë, dhe mes Serbisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, në anën tjetër, mund të konsiderohen si kufij ndërkombëtarë sipas së drejtës ndërkombëtare.

Mendimi i Komisionit iu njohu republikave mbrojtjen e kufijve të jashtëm të tyre në bazë të Kartës së OKB-së, Deklaratës së Asamblesë se Përgjithshme mbi Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me Marrëdhëniet Miqësore dhe Bashkëpunimin mes Shteteve, si dhe Aktin final të Helsinkit (Mendimi nr. 3, para. 2). Komisioni definoi territorin e mbrojtur të republikave në bazë të parimit të a.q. *uti possidetis* dhe atë për herë të parë jashtë kontekstit kolonial, dhe theksoi se përdorimi i forcës nuk mund të këtë efekt juridik (legal). Këtu vlen të theksohet se ky mendim ishte konsistent me deklaratat dhe qëndrimet e cekura më herët të BE-së, KSBE-së, sikundër dhe me veprimet e mëvonshme të KS të OKB-së, kurse kjo e drejtë nuk u qe akorduar republikave baltike, të cilat deklaruan pavarësinë vetëm një vit me parë.

Çështje e dytë, sërish e iniciuar sipas kërkesës serbe, kishte të bënte me atë nëse popullsitë serbe në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë ishin titullarë të së drejtës për vetëvendosje. Komisioni në Mendimin nr. 2, të datës 11janar 1992, konkludoi se në praktikën aktuale e drejta ndërkombëtare nuk definon konsekuencat precize të së drejtës për vetëvendosje e as caqet e aplikimit të saj. Në anën tjetër, e drejta për vetëvendosje në asnjë mënyrë nuk nënkupton modifikimin e kufijve ashtu siç kanë ekzistuar në momentin e pavarësisë (pa-

[65] "Conference for Peace in Yugoslavia: Arbitration Commision Avis. No. 1" (7 December 1991).

rimi i a.q. *uti possidetis juris*), përveç sipas marrëveshjes së përgjithshme. Më tej, Komisioni konfirmoi se të gjithë anëtarët e minoritetit janë të autorizuar që të përfitojnë nga të drejtat e minoriteteve dhe ato njerëzore të përcaktuara në konventat ndërkombëtare. E kuptuar në këtë mënyrë, e drejta për vetëvendosje përbën korpusin e të drejtave njerëzore, interpretim ky, gjithnjë sipas Komisionit, i konfirmuar në nenet e para të të dy konventave për të drejtat njerëzore të vitit 1966. Rrjedhimisht, "në bazë të marrëveshjeve në mes republikave, anëtarët e popullit serb në Bosnjë dhe Kroaci mund të fitojnë njohjen e shtetësisë sipas dëshirës së tyre me të gjitha të drejtat që dalin nga ajo njohje *vis-à-vis* shteteve përkatëse". Në fund fare, Komisioni natyrshëm konkludoi se serbët në Bosnjë dhe Kroaci gëzojnë të drejtën e të a.q. përfitimit nga të gjitha të drejtat që u njihen minoriteteve dhe grupeve etnike nga e drejta ndërkombëtare dhe dispozitat e Projekt-Konventës së sipërcekur të Lordit Carrington.

Ndërkaq, pas paraqitjes së kërkesave për njohje, Komisioni dha mendimin se republikat të cilat aplikuan (të gjitha me përjashtim të Serbisë dhe Malit të Zi) i plotësojnë kushtet për njohje si shtete të pavarura (Mendimet nr. 4, 5, 6 dhe 7, të dt. 11 janar 1992). Në të gjitha këto mendime, Komisioni iu referua të a.q. Kritereve për Njohje të BE-së, të cekura më sipër, me përjashtim që me rastin e Bosnjës u kërkua mbajtja e një referendumi, gjë e cila nuk ishte kërkuar më parë nga BE-ja dhe, me rastin e Maqedonisë, Komisioni refuzoi kërkesën e Greqisë për ndërrim të emrit, duke theksuar se emri aktual nuk implikon pretendime territoriale ndaj asnjë shteti tjetër (Mendimi nr. 6, 1 janar 1992). Kërkesa jonë, pra e Kosovës , e paraqitur brenda afatit të përcaktuar nga BE-ja për njohje ndërkombëtare, nuk u mor parasysh si pasojë e kritereve të sipërcekura të caktuara më herët. Para se të kalojmë në krizën rreth Bosnjë-Hercegovinës si dhe reagimin juridiko-politik të bashkësisë ndërkombëtare ndaj saj, vlen të thuhen dy a tri fjalë edhe për Konferencën e Londrës dhe aktivitetin e Komisionit të Arbitrazhit deri më atë datë, pra, deri më 26 gusht 1992.

4. Konferenca e Londrës dhe reagimi i mëtejmë i Komisionit Badinter lidhur me suksedimin dhe kontinuitetin e ish-RSFJ

Me fillimin e krizës boshnjake në prill të vitit 1992, përpjekjet diplomatike për gjetjen e zgjidhjes politike të konfliktit në ish-RSFJ vazhduan edhe më intensivisht. Më 24 korrik 1992, KS i OKB-së ftoi BE-në që në bashkëpunim

me Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së të shqyrtojë mundësinë e zgjerimit dhe intensifikimit të Konferencës Evropiane për Paqe. BE-ja, më pastaj, ftoi Sekretarin e Përgjithshëm që ta kryesonte (bashkë me Kryeministrin e Britanisë se Madhe si kryetar aktual i Këshillit të Ministrave të BE-së) Konferencën Ndërkombëtare mbi ish-Jugosllavinë, e cila u mbajt në Londër nga 26-28 gusht 1992.

Konferenca miratoi Deklaratën mbi Parimet për Zgjidhjen me Marrëveshje të Problemeve në ish-Jugosllavi dhe nxori një numër të aranzhimeve të tjera (të cilat këtu nuk na hyjnë në punë). Aty, gjithashtu, u formua i a.q. Komiteti Drejtues (*Steering Commitee*) i bashkëkryesuar nga i deleguari special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Cyrus Vance, dhe nga mediatori i BE-së, Lordi Owen (Oven, i cili e zëvendësoi Lordin Carrington në këtë post). Ata filluan punën më 18 shtator 1992 në Gjenevë, duke përfshirë këtu edhe punën e gjashtë grupeve punuese të formuara me atë rast. Kam përcjellë punën e Komitetit Drejtues përmes Misionit të Shqipërisë në Gjenevë dhe jam mjaft i informuar për synimet e të tjerëve ndaj Kosovës.

Në lidhje me Konferencën në fjalë, janë tri momente të rëndësisë primare për ne. *E para,* në Deklaratën e lartcekur mbi principet është thënë shprehimisht se puna e kësaj konference bazohet tërësisht mbi materialet dhe punën e asaj të parës. Kjo shihet në disa raste edhe në nominimet personale, si p.sh., Komisioni i Arbitrazhit sërish drejtohet nga Robert Badinter, i cili vazhdon punën dhe ekziston në format të njëjtë. E *dyta*, derisa Konferenca Evropiane për Paqe në Jugosllavi ishte shërbim i mirë (*good offices*), ashtu që vendimet e saj, në pikëpamje juridike, nuk patën forcën obliguese (sipas rregullit), vendimet e konferencës së dytë, kësaj aktuale, kanë një natyrë tjetër, sepse kanë forcë obliguese po aq sa edhe vendimet e OKB-së. Rrjedhimisht, të gjitha përsiatjet e BE-së, KSBE-së dhe të shteteve anëtare veç e veç lidhur me krizën në ish-RSFJ kanë për referencë zgjidhjen e krizës në kuadrin e Konferencës Ndërkombëtare mbi ish-Jugosllavinë, apo të konferencës së dytë. Kjo nënkupton edhe aktivitetin e të a.q. Grupit të Kontaktit. Dhe, e *treta*, çështja e Kosovës u trajtua në kuadrin e Grupit të Punës për Bashkësitë Nacionale dhe Minoritetet, me një dallim që, duke parë tërë seriozitetin e çështjes së Kosovës, arkitektët e saj në momentin e fundit krijuan (në kuadrin e grupit të sipërcekur) nëngrupin e quajtur Grupi Special për Kosovën.

Tërë kjo si më sipër u bë me referencë, para së gjithash, dokumentet e sipërcekura dhe qëndrimet e BE-së. Konferenca, për dallim nga konferenca e parë, si qëllim të vetin shpalli edhe "avancimin e së drejtës për vetëvendosje të popujve", duke nënkuptuar këtë në rend të parë të drejtën për pavarësi të

ish-republikave jugosllave. Kjo vërehet nga fakti se Grupi për Suksedim të ish-Jugosllavisë, në të gjitha dokumentet e tij gjer më sot, përjashtoi trajtimin e Kosovës si entitet me të drejtën për suksedim. Kjo u bë sërish duke pasur si referencë materialet dhe punën e Konferencës Evropiane për Paqe në Jugosllavi, veçanërisht mendimet e Badinterit të dt. 4 korrik 1992.

Sipas kërkesës së kryesuesve të Konferencës, Komisioni Badinter, në mendimin e vet nr. 8, të dt. 4 korrik 1992, konfirmoi se procesi i dezintegrimit të ish-RSFJ është kompletuar dhe se duhet deklaruar që RSFJ nuk ekziston më. Në të njëjtën kohë, lidhur me atë se si duhet rregulluar çështjet e suksedimit të dala nga ish-RSFJ, Komisioni Badinter, në mendimin nr. 9, të datës 4 korrik 1992, deklaroi se tani e tutje ekzistojnë shtetet e reja të krijuara mbi territorin e ish-RSFJ dhe se ato janë tani substitutet e saj. Të gjitha janë suksesore të ish-RSFJ dhe askush nuk ka të drejtën në kontinuitet juridik me ish-RSFJ. Në mendimin nr. 10, po ashtu të datës 4 korrik 1992, lidhur me po këtë çështje, Komisioni Badinter ka konstatuar se vendimi i Serbisë dhe Malit të Zi i prillit 1992 për të krijuar entitetin e ri të quajtur "Jugosllavi" nuk quhet valid duke marrë parasysh edhe Rezolutën e KS të OKB-së nr. 757 (1992) sipas së cilës "kërkesa e RFJ (Serbia dhe Mali i Zi) për kontinuitet legal me ish-RSFJ nuk pranohet në mënyrë gjenerale". Mirëpo, shton më tej Komisioni, ai entitet (Serbia dhe Mali i Zi ose e a.q. RF e Jugosllavisë) plotëson të gjitha kriteret për të qenë shtet i ri.

5. Kriza në Bosnjë dhe reagimi i bashkësisë ndërkombëtare

Siç u cek më sipër, referendumi i 1 marsit të vitit 1992, edhe pse u bojkotua nga serbët, plotësoi kushtin "e mbetur" të stipuluar në raportin e Komisionit të Badinterit për njohje ndërkombëtare, përkatësisht për vënien e marrëdhënieve diplomatike me Bosnjë-Hercegovinën. Referendumi konfirmoi dëshirën e 2/3 të votuesve për pavarësi. Për të konsoliduar pozitën e saj legale kundruall kërcënimeve për luftë civile dhe intervenimit serb, Bosnjë-Hercegovina aplikoi për anëtarësim në OKB dhe kërkoi njohjen ndërkombëtare nga ana e shteteve individuale. ShBA-ja, në ndërkohë, e cila më herët ishte më kritike ndaj njohjes së hershme të Sllovenisë dhe Kroacisë (të nxitura nga Austria dhe Gjermania) tani bëri presion në BE-në dhe shtetet anëtare të saj për një lëvizje më të shpejtë në këtë drejtim.

Deklarata e përbashkët e ShBA-së dhe BE-së e dt. 10 mars 1992 apelonte për një përgjigje pozitive kërkesës për njohje të Bosnjë-Hercegovinës dhe

"ashpër kërkoi nga të gjitha palët në Bosnjë-Hercegovinë që të përqafojnë aranzhimet kushtetuese të cilat do të parashihnin zhvillimin harmonik dhe paqësor të kësaj republike brenda kufijve ekzistues"[66].

Para se të themi dy a tri fjalë për aranzhimet kushtetuese të sipërcekura, përveç kësaj që u tha, edhe e a.q. Marrëveshja e Uashingtonit do të diskutohet në vijim për shkak se: e *para,* çështja e ndërtimit kushtetues të Bosnjë-Hercegovinës sipas Marrëveshjes së Sarajevës të datës 18 mars 1992 reflekton respektimin besnik të kritereve të përcaktuara nga bashkësia ndërkombëtare për njohjen ndërkombëtare të ish-republikave jugosllave, përkatësisht vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me to; e *dyta*, Marrëveshja e Uashingtonit e 18 marsit 1994 paraqet diskrepancën më drastike mes "kritereve të premtuara" dhe përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare për të mos ndryshuar principet e proklamuara, duke krijuar kësisoj entitete të cilat absolutisht nuk i përgjigjen raporteve reale në terren, por bëhen "me vullnetin e të gjitha palëve". Marrëveshja e Uashingtonit, për këtë arsye, përbën një moment interesant që duhet sqaruar këtu.

Më dt. 18 mars 1992, në Sarajevë u nënshkrua Deklarata e Parimeve për Aranzhimet e Reja Kushtetuese për Bosnjë-Hercegovinën[67]. Kjo deklaratë u përqafua nga tri grupet etnike (myslimanët, kroatet dhe serbët) në takimin e Sarajevës nën kryesinë e José Cutiliero-s (Zhuze Kutilieru) — diplomat portugez, i cili përfaqësonte trojkën e BE-së. Sipas kësaj deklarate, Bosnjë-Hercegovina do të jetë shtet i përbërë prej tri njësive konstitutive të bazuara mbi parimet nacionale e duke marrë parasysh kriteret ekonomike, gjeografike dhe të tjera. Kufijtë ekzistues të Bosnjë-Hercegovinës do të mbesin të pandryshuar dhe sovraniteti do të qëndrojë në qytetarët e kombeve mysliman, serb dhe kroat si dhe në kombet e kombësitë e tjera, të cilat e realizojnë atë [sovranitetin — vërejtja jonë, E.H.] përmes pjesëmarrjes qytetare nëpër njësitë konstitutive dhe organet qendrore të Republikës". Vetëm dhjetë ditë pas arritjes së marrëveshjes lidhur me këtë deklaratë, serbët e Bosnjës u tërhoqën nga ajo[68]. Kundërshtimi serb, si dhe shpërthimi i luftës (dhunës) në pjesët e territorit të përcaktuara nga serbët për t'u përjashtuar nga njohja ndërkombëtare, nuk frikësoi ministrat e jashtëm të BE-së nga marrja e vendimit për njohjen e Bosnjës më dt. 6 prill 1992.

---

[66] "US-EC Declaration on the Recognition of the Yugoslav Republics", Brussels (10 March 1992).

[67] "Statement of Principles for New Constitutional Arrangments for Bosnia and Hercegovina", *Review of International Affairs* (Belgrade, 1 April 1992) fq. 11.

[68] "Serbs Opt for Own Constitution", *The Independent* (28 March 1992) fq. 15.

Përparimi i shpejtë i forcave serbe në afër 73 për qind të territorit të Bosnjë-Hercegovinës dhe veçanërisht hyrja (më vonë) e palës kroate në luftë kundër forcave të Qeverisë së Bosnjës detyruan bashkësinë ndërkombëtare që të rivlerësojë kriteret e njohjes së shteteve të reja. Hyrja në luftë e palës kroate pati për pasojë kualifikimin e luftës në Bosnjë si "luftë civile". Ajo paraqiti kushtin e domosdoshëm të një kualifikimi të tillë me pasoja tragjike për Bosnjë-Hercegovinën, duke i mohuar asaj të drejtën për ndihmë nga jashtë (nga shtetet e tjera), meqenëse sintagma për agresion nga shteti tjetër nuk mund të aplikohej më juridikisht. Rrjedhimisht, një zhvillim i tillë i ngjarjeve çoi në lidhjen e Marrëveshjes së Uashingtonit, ndërsa politikisht edhe në formimin e të a.q. "Grupi i Kontaktit", si një trup ndihmës për ruajtjen dhe respektimin e kritereve të bashkësisë ndërkombëtare lidhur me Bosnjë-Hercegovinën.

Se kjo është kështu, shihet edhe në paragrafin e katërt të Marrëveshjes së Uashingtonit për Federatën e Bosnjë-Hercegovinës (mars 1994) ku thuhet: "Vendimet mbi statusin kushtetues të territoreve të Republikës së Bosnjë-Hercegovinës me shumicë serbe do të merren në vijim të negociatave për zgjidhjen paqësore dhe në kuadrin e Konferencës Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë." Në pjesën hyrëse të kësaj marrëveshjeje, ndërkaq, është thënë se "të poshtëshënuarit janë pajtuar që të krijojnë Federatën në territoret e Republikës së Bosnjë-Hercegovinës me shumicë boshnjake dhe kroate si dhe konfederatën ndërmjet Republikës së Kroacisë dhe Federatës së Bosnjë-Hercegovinës."

Krejt në fund, kur bashkësia ndërkombëtare vërejti se paragrafi i katërt (i cituar më sipër) paraqiste "pazar pa të zotin e shtëpisë" si pasojë e përparësisë evidente ushtarake të serbëve, edhe atyre kjo bashkësi u detyrua t'ua njohë të drejtën për konfederatë, d.m.th., realizimin e së drejtës për vetëvendosje. Me fjalë të tjera, serbëve të Bosnjë-Hercegovinës, nga pakica kombëtare (Komisioni i Badinterit) dhe qytetarët e barabartë pjesëmarrës në sovranitetin e Bosnjë-Hercegovinës (Parimet Kushtetuese të Sarajevës të datës 18 mars 1992), iu njoh e drejta për konfederatë me Serbinë si një e drejtë e patjetërsueshme për vetëvendosje. Përshtypja e autorit të këtyre rreshtave është se çdo analizë e dokumenteve të tjera, përveç këtyre këtu, të shpie në të njëjtat konkluzione.

Përfundim

1.

Të gjitha përfundimet e kësaj analize i kemi tërhequr sipas shprehjes së vjetër "dil në fshatin fqinj për të kuptuar si të vejnë punët tua". Kjo sepse çdo zgjidhje e krizës në ish-RSFJ do të bazohet në zgjidhjet respektive të çështjeve të hapura në territorin e ish-Jugosllavisë që nga momenti i shpërbërjes së saj.

2.

Qëllimi i kësaj analize ishte të prezantonte në mënyrë kronologjike momentet kyçe të krizës në ish-RSFJ dhe, kryesisht, për të dëshmuar se shpërbërja e saj nuk është bërë jashtë kornizave juridiko-ndërkombëtare, të përcaktuara që më parë. Këto korniza, që në i quajmë juridiko-ndërkombëtare, kanë edhe premisa të theksuara politike dhe si tërësi mund të ndahen në dy grupe:

a. të parat i referohen të a.q. E Drejta e Përgjithshme Ndërkombëtare; dhe
b. te dytat i referohen të a.q. E Drejta e BE-së dhe KSBE-së, të krijuara specifikisht pas krizës jugosllave.

Këto të dytat pozitën e Kosovës *in abstracto* e ndrydhën dhe e degraduan edhe më tej duke e futur atë në kuadrin e standardeve sterile të pakicave kombëtare dhe "përfitimet me të larta që ato gëzojnë sipas së drejtës ndërkombëtare".

Parimi dhe e drejta për vetëvendosje të popujve nuk u mohua në parim". Mirëpo, BE-ja dhe më vonë organizma të tjerë (KSBE-ja dhe OKB-ja) definuan kriteret politike se kush ka të drejtë për vetëvendosje, kurse Komisioni Badinter i ngriti ato në nivel të "se drejtës" ose "të ligjit ndërkombëtar". Dhe, serbët e Bosnjë-Hercegovinës, duke shfrytëzuar me mjeshtëri forcën joobliguese të këtyre "letrave" dhe jokompetencën e BE-së për vënien e tyre, ngritën pozitën e tyre prej minoritetit në komb me të drejta të barabarta si dhe të tjerët (e drejta për konfederatë me Serbinë).

Në këtë kontekst, formimi i një grupi ekspertësh nga ana jonë me qëllim të analizimit edhe më të detajuar të dokumenteve të dhëna nga ana e bashkësisë ndërkombëtare (të cilat paraqesin një lloj Jalte *sui generis*) e quaj si të domosdoshme në këtë fazë të zhvillimit të ngjarjeve. Një analizë e tillë sado e shkurtër do të kontribuonte në gjetjen, *lege artis*, të modaliteteve për pavarësinë e Kosovës.

Po ashtu, në vijim si më sipër, një gjë e tillë do t'i nxirrte si iluzore pikepamjet të cilat të drejtën tonë për pavarësi e mbështesin në rrjedhat e Luftës së Dytë Botërore dhe dokumentet e miratuara atëherë (AVNOJ/KAÇKJ, Konferenca e Bunjajt etj.). Përkundrazi, e drejta jonë për pavarësi do të arsyetohej më bindshëm dhe sipas së drejtës ndërkombëtare nëse thuhet, ta zëmë, se Kosova më 1918 ka hyrë në ish-Jugosllavi jo si pjesë e Serbisë, por si pjesë e ish-Jugosllavisë dhe se nuk ka pasur kontinuitet mes Mbretërisë Serbe dhe Mbretërisë SKS (jugosllave). Në anën tjetër, në aspektin e së drejtës kushtetuese do të ishte më në rregull që pozitën tonë kushtetuese në momentin e shpërbërjes së ish-RSFJ të arsyetonim sipas parimit të të a.q. "të drejta të fituara", kurse kërkesën për pavarësi të Kosovës si avancim natyror i të drejtave tanimë të fituara deri në momentin e shpërbërjes së ish-RSFJ.

3.

Nëse mbrojtja e integritetit territorial i referohet shteteve në kuptimin e obligimit për mosndërhyrje ndaj shteteve ekzistuese (neni 2, para. 4, i Kartës së OKB-së) dhe jo popujve, atëherë duhet kuptuar se Serbia dhe Mali i Zi (e ashtuquajtura "Jugosllavi") nuk është shtet në kuptimin e së drejtës ndërkombëtare dhe se bashkësia ndërkombëtare nuk ka obligim për mbrojtjen e integritetit territorial të këtij "entiteti". Tek e fundit, Bosnjë-Hercegovina mbeti pa këtë mbrojtje edhe pse e njohur në pikëpamje ndërkombëtare dhe, për më tepër, e drejta e serbëve për konfederatë me Serbinë dëshmon definitivisht rrënimin e të gjitha parimeve mbi të cilat u bazua zgjidhja e krizës në ish-RSFJ. Po ashtu, zhvillimet e fundit në një vend tjetër të botës — në Federatën Ruse, përkatësisht në Çeçeni — më së miri dëshmon joparimësinë dhe anakroninë e kritereve për njohje (të cekura më parë). Zhvillimet e fundit në Rusi padyshim do ta detyrojnë bashkësinë ndërkombëtare për t'i ridefinuar ato parime që përmendëm më sipër.

Në këtë kontekst, nëse bashkësia ndërkombëtare nuk ka reaguar në nivelin e kërkesave tona për pavarësi (Kushtetuta e Kaçanikut, referendumi, zgjedhjet e lira të mbajtura në Kosovë) të parashtruara edhe formalisht Komisionit Badinter nga Qeveria e Republikës së Kosovës (në të njëjtën kohë me republikat e tjera të ish-RSFJ, përveç Serbisë dhe Malit të Zi), atëherë do të thotë se imponimi ynë ka qenë jobindës.

Në vijim si më sipër, mendimet për fuqizimin e kursit politik në Kosovë dhe insistimet tona për njohjen ndërkombëtare të Kosovës duhen shqyrtuar me kujdesin e duhur.

4.

Sikundër shihet nga gjendja faktike e gjërave dhe nga parimet elementare të së drejtës ndërkombëtare lidhur me këtë çështje, për suksedimin u takon të debatojnë vetëm atyre të cilëve kjo e drejtë u është njohur. Komisioni Badinter Kosovës nuk ia njohu këtë të drejtë, sepse kishte defekt në definimin e pozitës së saj kushtetuese sipas kushtetutës së fundit në fuqi të ish-RSFJ të vitit 1974. Kosova nuk u cilësua si entitet-republikë edhe pse prerogativat e saj ishin të republikës. Jo formalisht, si argument u mor ekzistimi i entiteteve të njëjta në ish-BRSS dhe mungesa e ligjit të Kosovës për shtetësinë gjatë kohës sa ishte nën ish-RSFJ (e ashtuquajtura shtetësia dytësore, të cilën me rastin e shpërbërjes së shteteve të përbëra, p.sh., federatave, e trashëgojnë me automatizëm qytetarët e shtetit të ri që krijohet). Kur jemi te kjo çështje, përkatësisht tek shtetësia si çështje konkrete që ne do ta ndeshim, duhet bërë kërkesë pranë Konferencës Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë që të dënojë normimin e kësaj materie nga ana e të ashtuquajturës Jugosllavi (Serbi-Mali i Zi). Kjo nga shkaku se çështja e suksedimit të ish-RSFJ-së është ende e pazgjidhur dhe se shtetësia përfshihet në suksedimin e ish-RSFJ-së (Grupi për Suksedim ka ndërprerë veprimtarinë e tij prej më se një viti). Pra, ne duhet të insistojmë që bashkësia ndërkombëtare të mos njohë efektet juridiko-ndërkombëtare të një ligji eventual mbi shtetësinë e së ashtuquajturës Jugosllavi (Serbi-Mali i Zi). Kjo është e drejtë dhe detyrë e bashkësisë ndërkombëtare meqenëse na ka mënjanuar nga diskutimi për këto çështje.

5.

Premtimi i dhënë nga Konferenca Evropiane e Paqes për ish-Jugosllavinë se "do të merren parasysh kërkesat legjitime të te gjithëve në Jugosllavi" dhe "qëllimi për avancimin e së drejtës për vetëvendosje" i proklamuar nga Konferenca e Londrës, apo konferenca e dytë (1992) paraqesin shembuj tipikë të lojës joparimore të bashkësisë ndërkombëtare në varësi nga raporti i forcave (në kohën dhe hapësirën e dhënë këtu).

Konsiderojmë pra se ne duhet më shumë të tregojmë se ligjet serbomalazeze nuk janë të efektshme në Kosovë, çka paraqet kusht të domosdoshëm për njohje ndërkombëtare. Me fjalë të tjera, modalitetet e rezistencës sonë dhe gjetja e tyre janë mjeti i vetëm për avancimin e së drejtës sonë për vetëvendosje dhe marrjen parasysh të kërkesave tona legjitime. Përndryshe, thellësisht jemi të bindur se thirrja edhe e një konference tjetër ndërkombëtare për zgjidhjen globale të krizës në ish-RSFJ (si rast hipotetik) do të bazoh-

et mbi dokumentet e dy konferencave të mëparshme për sa i përket çështjes së Kosovës dhe shqiptarëve në ish-RSFJ.

II. Gabimet e një shkence juridike

Hyrja

Në njërin prej informatorëve ditorë të muajit nëntor 1996, botim i *Qendrës për Informim të Kosovës*, pata rastin të lexoj se në Prishtinë u bë promovimi i librit me titull *Kosova: Political, Constitutional and International Law Arguments* [Kosova: argumente politike, kushtetutese dhe juridikondërkombëtare] (Prishtina, 1996), të koautorëve dr. Esat Stavileci, mr. Blerim Reka dhe dr. Arsim Bajrami (vetëm në gjuhën angleze, 154 faqe). Titulli i librit, siç mund të vërehet, ishte aq sfidues saqë mezi prisja ta lexoja përmbajtjen, me shpresë se do të gjeja syzhenë e librit. Mirëpo, krejt çka gjendej aty në atë botim të *Qendrës për Informim të Kosovës* ishte e dhënë në mënyrë mjaft të kondensuar. Fjalët miradije të disa pjesëmarrësve në promovim të librit se fjala ishte për një "sihariq të këndshëm" më bënë edhe më kurioz që sa me parë ta lexoja vetë këtë libër, gjithnjë me shpresë se nuk do të jetë i njëjtë në përmbajtje me shkrimet e autorëve të cekur të shkruara pas vitit 1990, të cilat janë dhënë me shënimet bibliografike në fund të librit.

Në pamundësi fizike për të arritur deri të libri në fjalë, për shkak të mungesës sime nga Kosova që nga viti 1992 kur nisa punën si këshilltar ligjor i Kosovës i akredituar në MPJ të Shqipërisë nga Qeveria e dr. Bujar Bukoshit në ekzil, me një vonesë të konsiderueshme, më në fund, sigurova një kopje të tij. Edhe pse i dedikuar kryesisht për lexuesin e huaj, për "*non-Albanian reader*", siç thuhet në libër (fq. 15), ngaqë kjo do të thotë se vetëm ata që nuk janë shqiptarë mund ta lexojnë, vendosa ta lexoj thjeshtë për të shuar kureshtjen prej lexuesi. Pas një leximi të kujdesshëm, menjëherë vërejta se nuk ka ndonjë dallim të madh nga shkrimet e mëparshme, të cilat autorët, ndërkaq, i citojnë vazhdimisht gjatë shtjellimeve në këtë libër. Nuk munda e të mos i kujtoj fjalët e kryetarit aktual të Gjykatës së Hagës, juristit të njohur, Antonio Cassese (Antonio Kaseze), të thëna në hyrjen e librit të tij me titull *Self-Determination of Peoples: A Legal Reappraisal* [Vetëvendosja e popujve: rivlerësim juridik] (Cambridge University Press: Cambridge, 1996): "Citimin e pu-

nimeve të mia të mëhershme nuk e kam bërë për faktin se jam narcisoid, por sepse kam dashur t'i rishikoj edhe njëherë qëndrimet e mia të mëhershme." E tillë ishte edhe pritja ime fillestare për prirjet e autoreve të librit për t'iu referuar veprave të tyre të mëhershme. Pas leximit të librit, pashë se nuk bëhet fjalë për një gjë të tillë, andaj edhe në këtë shkrim as që iu kam referuar atyre, nisur nga logjika se "tërësia ngërthen pjesën".

Çdo shkencë serioze duhet të këtë synim integrimin me njohuritë e mëparshme, ashtu që rezultatet e saj të "futen dhe murosen në murin e njohurive të përbashkëta"[69] dhe, më tutje, "çdo gjë me rëndësi është thënë më herët nga dikush tjetër, por që edhe ata vetë nuk e kanë zbuluar"[70]. Jo vetëm që ky mesazh, sipas meje, nuk ishte reflektuar në këtë libër, por edhe ajo literaturë e përdorur është interpretuar aq gabimisht dhe pavend saqë konkluzionet e librit nuk kanë mundur të jenë tjera veçse të gabuara. Në vijim të kësaj ka lindur edhe ideja e titullit të këtij shkrimi: "Gabimet e një shkence juridike", nxitur në veçanti nga pikëpamjet e autorëve për Vilajetin e Kosovës si "njësi konfederale *sui generis*" (e llojit të veçantë)[71] dhe arsyetimin e gjenezës së pavarësisë dhe qenies shtet të Kosovës mbi bazën e Konferencës së Bunjajt, Kuvendit të Prizerenit, shembullit të të a.q. AVNOJ (shqip: Këshilli Antifashist i Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë), sikundër dhe mbi bazën e lëvizjeve të tjera nacionaliste (djathtiste) në Kosovë gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore[72]. Dihet që ka pasur dallime të skajshme mes lëvizjeve nacionaliste (djathtiste) të shqiptarëve në Ballkan, për sa i përket konceptit të së drejtës për vetëvendosje, kundruall atyre majtiste (komuniste), gjë që e bën të pamundur futjen e tyre nën kornizë të njëjtë, qoftë edhe në emër të shkencës juridike. Për këtë ne nuk do të flasim në këtë shkrim. Objekt i këtij shkrimi do të jetë argumentimi i ngatërrimit, nga ana e autorëve, të së drejtës eksterne për vetëvendosje dhe formave të manifestimit të saj (e drejta për shtet të pavarur, për integrim me një shtet tjetër, dhe e drejta për asociim, gjithashtu me një shtet tjetër sovran) me qenien shtet (ang. *statehood*) në të drejtën ndërkombëtare, i cili ka pasur për rrjedhojë edhe argumentimin joadekuat, për të mos thënë absurd, të së drejtës për vetëvendosje të Kosovës dhe popullit të saj nga ana e

---

[69] Alfrend North Whitehead, *The Organization of Thought* (Greenwood, 1974) fq. 3.
[70] Gerald R. Adams & Jay D. Schveneveldt, *Understanding Research Methods* (Longman: New York, 1985) fq. 3.
[71] Cf. dr. Esat Stavileci, mr. Blerim Reka dhe dr. Arsim Bajrami, *Kosova: Political, Constitutional and International Law Arguments* (Kosovo Information Center: Prishtina, 1996) fq. 19–20, 55–56.
[72] Cf. ibid. fq. 19-21, 50–61 etj.

autorëve të librit. Për këto dhe çështjet lidhur me këtë do të flasim në vijim të shkrimit.

Ky shkrim është një "qasje tjetërfare" e arsyetimit të kërkesës për njohjen e së drejtës për vetëvendosje dhe qenien shtet të Kosovës dhe popullit të saj, për të cilën fjalën përfundimtare sigurisht që do ta japë vetë lexuesi. Mënyra e arsyetimit të kërkesës për vetëvendosje dhe formave të realizimit të kësaj së drejte, ndërkaq, ka pasoja praktike[73], ashtu që ky shkrim edhe nuk duhet kuptuar vetëm si polemike e thjeshtë shkencore. Jam i bindur thellë për rrezikun se e drejta për vetëvendosje nuk mund të përmblidhet lehtë në një tërësi për faktin se, siç thotë një ekspert i njohur i kësaj fushe, G. Alfredson, "shumica e teksteve ndërkombëtare janë të paqarta, praktika e shteteve është jo aq konsistente, kurse shkrimet e studiuesve janë zakonisht kundërthënëse dhe nuk ofrojnë ndihmë shumë të madhe"[74]. Me këtë "rrezik" parasysh, mbes me shpresë se ky shkrim do të kuptohet si nxitje për "qasje tjetërfare" të këtij problemi ndër ne dhe asgjë tjetër.

Nëse ky do të jetë fati i këtij shkrimi, atëherë do ta quaj se ka pasur efekt pozitiv. Nëse ndodh e kundërta, ndërkaq, nuk më mbetet veçse t'i përsëris fjalët e Hugo Grocit, të thëna në përmbylljen e librit të tij monumental *E Drejta e Luftës dhe e Paqes* (1625): "mos qoftë e thënë e tërë kjo që kam pohuar këtu, nëse bie ndesh me pietetin, moralin e mirë, Urdhrin e Shenjtë, Konkordin e Kishës, ose me çdo aspekt tjetër të së vërtetës".

1. Mbi të drejtën për vetëvendosje ashtu siç është shtjelluar nga autorët e librit dhe konceptin komunist të kësaj së drejte

Po të lexohet me kujdes libri në fjalë, atëherë do të shihet se mesazhi kryesor që dëshirohet të bartet tek lexuesi është argumentimi i së drejtës për vetëvendosje të Kosovës dhe popullit të saj, duke përdorur argumente absurde, që nga ai i Vilajetit të Kosovës e deri tek statusi i fundit i Kosovës sipas Kushtetutës së vitit 1974 të ish-Jugosllavisë — entitetit të fundit të sllavëve të jugut (me përjashtim të bullgarëve), mesazh të cilin autorët nuk kanë arritur të bartin. Moskuptimi i përmbajtjes së nocionit "titull juridik" (tapi, siç thuhet

[73] Cf. K. Shehadi, "Ethnic Self-Determination and the Break-Up of States", *Adelphi Paper* no. 283 (1993) fq. 4-21.

[74] Gudmundur Alfredson, "Different Forms and Claims to the Right of Self-Determination", në Donald Clark & Robert Williamson (eds.), *Self-Determination: International Perspectives* (St. Martin's Press: New York, 1996) fq. 58.

në gjuhën e përditshme) ose "titull juridik sovran" (titull që i njeh të drejtën një entiteti për të ushtruar pushtetin shtetëror mbi një territor dhe popullsi të dhënë, ashtu siç kuptohet kjo në të drejtën aktuale ndërkombëtare) ka pasur për rrjedhojë faktin që autorët t'i ngatërrojnë pikat e referimit të së drejtës për vetëvendosje të Kosovës dhe popullit të saj. Në mesin e këtyre pikave të gabuara të referimit, Vilajeti i Kosovës (1868), Kuvendi i Prizerenit (1945) dhe Kushtetuta e vitit 1974 zënë një vend të theksuar në shqyrtimet e autorëve në fjalë. Si rrjedhojë e pikës së fundit të referimit, autorët përdorin në mënyrë skajshmërisht të gabuar nocionet, siç janë, *uti possidetis* (shqip, "të takon ajo që posedon"), "suksedimi" (trashëgimi) i shteteve në të drejtën ndërkombëtare, "pavarësia" e shtetit në të drejtën ndërkombëtare dhe, së fundi, "okupimi" në të drejtën ndërkombëtare.

Në shtjellimet vijuese do të përfshihen çështjet e mësipërme, gjithnjë duke pasur parasysh qëndrimet e autorëve të librit.

2. Vilajeti i Kosovës si "shtet konfederal", siguria dhe identiteti i sotëm i Kosovës

Duke ngatërruar gjenezën e sovranitetit dhe të pavarësisë së Kosovës, si shtet në lindje e sipër (*in statu nascendi*), përkatësisht qenien e saj shtet me kontinuitetin historik të jetesës së shqiptarëve në trojet e tyre etnike, që nga antika e deri më sot, autorët nxjerrin konkluzionin mjaft të çuditshëm lidhur me Vilajetin e Kosovës. Mbi bazën e ligjit turk të vitit 1868, siç e thonë vetë autorët në këtë libër, arrihet deri tek përfundimi se: "Ky [Vilajeti i Kosovës — vërejtja jonë, E.H.] kishte statusin e një shteti konfederal në kuadrin e Perandorisë Osmane". Qenia shtet (*statehood*) e Kosovës së asaj kohe, thuhet më tej në libër, më së miri dëshmohet nga karakteri shtetëror i Vilajetit të Kosovës dhe funksionimi i organeve të pushtetit shtetëror, përfshirë këtu të gjitha format e manifestimit, siç janë legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori, si dhe nga vetë bartësi i atij pushteti (cf. dr. Esat Stavileci, fq. 19-20). Ngjashëm edhe autori tjetër, mr. Blerim Reka, i cili thotë: "Çka ishte tjetër Vilajeti i Kosovës, [i krijuar, dhe jo *contested*, siç thuhet në libër, sepse kjo d.m.th. i/e kontestuar — vërejtja jonë, E.H.] me ligjin turk të vitit 1868, me tërë sistemin e tij të pushtetit (përveç politikës së jashtme dhe ushtrisë, të cilat ishin në kompetencë ekskluzive të Portës së Lartë)?" (cf. mr. Blerim Reka, fq. 56). Si

burim literature, autorët citojnë librin *Vilajeti i Kosovës*[75], pa dhënë faqet konkrete të referimit. Nuk është aspak e vërtetë se në atë libër gjendet një konstatim i tillë dhe as që mund të arrihet shkencërisht deri tek një përfundim i tillë. Kjo nuk është veçse një fiksion i pabazuar i autorëve. Përveç faktit se historikisht, politikisht, si dhe nga ana juridike ky është një konstatim i gabuar, autorët as që e kanë të qartë se ai ligj nuk ka qenë turk. Ai, pikë së pari, ka qenë akt legal i një perandorie, i Perandorisë Osmane, në atë kohë pa Parlament, kurse aktet legale turke janë nxjerrë vetëm pas Luftës së Parë Botërore, kur është formuar Republika e Turqisë dhe kombi i sotëm turk nga babai i kombit, Mustafa Kemal Pasha Ataturku.

Politikisht shikuar, ndërkaq, teza e autorëve në fjalë krijon përshtypjen tek lexuesi i huaj, i cili është njohës solid i Kosovës dhe çështjes shqiptare, se Kosova ka lëvizur nga vendi apo se ka ndërruar emrin në "ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë". Sigurisht që nuk është as njëra e as tjetra. Fakti qëndron në atë se trojet etnike shqiptare, pra edhe Kosova, kanë ardhur duke u rrudhur për arsye të grabitjes së tyre me forcë nga vendet fqinje. Në këtë drejtim do të duhej shtjelluar kontinuitetin dhe identitetin e lëvizur socio-politik dhe fizik të Kosovës dhe jo me ndihmën e argumenteve legale të pushtuesve të huaj.

Në teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare ekzistojnë disa koncepte, siç janë "raporti i forcave", "siguria", "aleancat", "interesi nacional" etj., përmes të cilave shpjegohen marrëdhëniet mes shteteve dhe popujve. Konceptet juridike luajnë një rol të caktuar, mirëpo për rastin që ne flasim vetëm sa ngatërrojnë punë. Prej këtyre koncepteve, të cilat janë të lidhura ndërmjet vete, neve këtu na intereson vetëm ai i sigurisë dhe i raportit të forcave. Mbi bazën e këtyre koncepteve mund të shpjegohen lindja, zhvillimi dhe zhdukja e sistemit otoman të vilajeteve në përgjithësi, pra edhe të atij të Kosovës me Shkupin si qendër administrative. Si pasojë e këtij koncepti të sigurisë, identiteti socio-politik dhe fizik i Kosovës ka ndryshuar dukshëm edhe pas rënies sonë nën robërinë dhe juridiksionin serb (1912), përkatësisht jugosllav (1918), duke marrë forma të ndryshme të përkatësisë administrativo-politike: "obllast", "okrug", "krahinë autonome", por kurrë republikë. U mor vesh, përjashtim bëjnë vitet e paspërfundimit të Luftës së Ftohtë, kur filloi lindja e krijimit të shtetit të Kosovës. Ky identitet i imponuar socio-politik dhe fizik i Kosovës, pa harruar këtu edhe Konferencën e Bunjajt (1943-44) dhe Ku-

[75] Shukri Rrahimi, *Vilajeti i Kosovës* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1969).

vendin e Prizerenit (1945), nuk është që nuk është kundërshtuar nga shqiptarët gjatë shekujve. Raporti i forcave në rajon ka qenë i tillë që nuk ka lejuar veçse zëvendësimin e pushtuesve të trojeve etnike shqiptare. Shqiptarët kurrë nuk kanë pranuar okupimin e tokave të tyre nga të huajt, siç pohon dr. Esat Stavileci në fq. 45, dhe as që çështja shqiptare nuk është zgjidhur asnjëherë për faktin se "nuk kanë pasur intelektualë për mbrojtjen e kauzës së tyre", ashtu që tani "qendrat ndërkombëtare të vendosjes duhet të komunikojnë drejtpërsëdrejti me inteligjencien shqiptare" (cf. dr. Esat Stavileci, fq. 45). E vërteta gjendet në faktin se raporti i forcave në rajon, e jo arsyet e sipërcekura, kanë qenë vendimtare për lejimin e ndryshimit të statusit socio-politik dhe fizik të trojeve etnike shqiptare në dobi të vendeve fqinje: Greqisë, Serbisë dhe Malit të Zi[76].

Tani duhet vazhduar, pas këtij digresioni të shkurtër, diçka me konkretisht lidhur me çështjen e Vilajetit të Kosovës. Ky ka qenë një produkt i konceptit të sigurisë së Perandorisë Osmane, ashtu që identiteti socio-politik dhe fizik i Kosovës si vilajet është krijuar vetëm në një moment të dhënë historik, i cili është fillimi i reformave në Perandorinë Osmane në dobi të elementit të krishterë, pra jo në dobi të asnjë "kombi" të Perandorisë. Koncepti osman i sistemit të a.q. "milet" ka përjashtuar elementin nacional: të gjitha subjektet e Perandorisë qenë ndarë në "myslimanë" dhe "të krishterë". Motivi dhe arsyeja kryesore e reformimit të sistemit "milet" ka qenë pengimi i tendencave separatiste dhe përçarëse për Perandorinë Osmane, si pasojë e nacionalizmit në rritje të subjekteve të saj.

Për t'i bërë ballë ndjenjës nacionale në rritje tek popujt e ndryshëm të Ballkanit, pas Luftës së Krimesë (1853-1856), si dhe për të favorizuar elementin e krishterë, më 18 shkurt 1856, fillojnë reformat e Perandorisë Osmane, të cilat kanë përfshirë edhe sistemin "milet". Këtë ditë, pra më 18 shkurt 1856, në Stamboll u bë i njohur nga sulltani edikti i a.q. *Hati humajun*. Një javë më vonë, përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha nënshkruan Traktatin e Parisit në të cilin u tha se "njihet vlera e lartë e Ediktit dhe garantohet pavarësia dhe integriteti territorial i Portës së Lartë". Në zbatim të këtyre reformave, që zgjaten prej vitit 1856 e deri më 1877, u angazhuan Ali e Fuad Pasha. Zbatimi eksperimental i pjesës qe kishte të bënte me riorganizimin provincial të sistemit "milet" dhe, rrjedhimisht, edhe me formimin e vilajeteve iu besua Mithat Pashës. Për këtë qëllim u nxor edhe ligji i vitit 1864, me Ballkanin qendror

[76] Cf. më shumë për këtë në Carl Brown, *Imperial Legacy: The Ottoman Imprint in The Balkans and the Middle East* (Columbia UP: New York, 1996) fq. 54-551.

si vilajeti i parë, përfshirë këtu edhe pjesën më të madhe të Bullgarisë. Objektivi kryesor ishte riorganizimi dhe rigrupimi i provincave perandorake në njësi më të mëdha dhe vënia e tyre nën kontrollin direkt të valiut (guvernatorit) fuqiplote — njeriut të zgjedhur me kujdesin më të madh nga vetë Porta[77]. Sulltani besonte se, krahas reformave në sistemin fiskal dhe religjioz (riorganizimi i popullsisë ortodokse në raport me kishën), të filluara me ediktin e sipërcekur, do ta përfitonte besnikërinë e elementit jomysliman[78]. Mirëpo u arrit efekti i kundërt: lëvizjet nacionale vetëm sa u ngritën më shumë, kurse shtypja dhe despotizmi i çdo lëvizjeje nacionale ishin veçoritë e pushtetarëve otomanë nëpër vilajete[79].

Siç mund të shihet nga ky shqyrtim i shkurtër, shkaku dhe arsyeja kryesore e krijimit të sistemit të vilajeteve ka qenë krijimi i sigurisë nga valët e nacionalizmit, fillimisht në radhët e popujve të krishterë, ndërsa më vonë edhe ndër popujt tjerë varësisht nga koha e zgjimit të tyre nacional. Sistemi tejet i centralizuar dhe tiranik i pushtetit në vilajete, i cili është ushtruar nga valiu (guvernatori) në emër të Sulltanit, nuk ka mundur të mos përfshinte edhe trojet etnike shqiptare, për shkaqe dhe arsye të njëjta me ato që i cekem më sipër, por assesi për t'i "konfederalizuar" shqiptarët ose për t'i bashkuar ata në një vilajet të vetëm. Përkundrazi, Porta qe treguar shumë e kujdesshme që t'i ndante fizikisht territoret etnike shqiptare, fillimisht në tri (Janina, Manastiri dhe Shkodra) e më vonë në katër vilajete (plus Vilajeti i Kosovës)[80], në mënyrë që secili prej tyre të kishte në përbërje njerëz kombësish të ndryshme për t'i nxitur ata kundër njëri-tjetrit. Përveç kësaj mënyre të kontrollit të lëvizjeve nacionale, zyrtarët e Portës herë pas here nxisnin përçarjen mes fiseve të Veriut. Në të njëjtën mënyrë, ata i përdornin edhe bejlerët e Jugut, duke i rezervuar vetes, në të gjitha rastet, rolin e arbitrit, sepse të gjithë i drejtoheshin zyrtarëve të portës për mbështetje kundër fraksioneve dhe popujve të ndryshëm rivalë[81]. Në kohën e pas-Lidhjes së Prizrenit, kur lëvizja nacionale shqiptare mori të gjitha tiparet e një lëvizjeje moderne nacionaliste sipas

---

[77] Cf. Stanford J. Shaw, "The Origins of Representative Government in the Ottoman Empire: An Introduction to the Provincial Councils 1839-1878", në Winder R. Bayly (ed.), *Near Eastern Round Table 1967-1968* (New York UP: New York, 1969) fq. 96; Basil Kondis, *Greece and Albania: 1908-1914* (Institute for Balkan Studies: Thessaloniki, 1976) fq. 19.
[78] Cf. L.C. Stavrianos, *The Balkans Since 1453* (New York UP: New York, 1958) fq. 381-392.
[79] Cf. Roderic H. Davidson, *Reform in the Ottoman Empire 1856-1876* (Princeton UP: Princeton, 1963) fq. 158-161.
[80] Cf. Basil Kondis, ibid. fq. 20.
[81] Cf. Bernd Jurgen Fieber, *Mbreti Zog dhe pjekja për stabilitet në Shqipëri* (Toena: Tiranë, 1996) fq. 54.

modelit evropian, kërkesë kryesore e liderëve nacionalë të shqiptarëve ishte bashkimi i katër vilajeteve në një të vetëm (ose bashkimi i "katër kalemave", siç thuhet në *Gjarpërinjtë e Gjakut* të shkrimtarit disident shqiptar Adem Demaçi).

Siç vërehet, sigurimi i jetës së Perandorisë Osmane dhe sundimi më i lehtë i popujve të Ballkanit kanë qenë dhe janë shkaqet dhe arsyet kryesore për futjen e sistemit të vilajeteve dhe jo "konfederalizimi i territoreve" siç pohojnë autorët në mënyrë krejt naive, pa marrë parasysh se për të cilat territore dhe popuj është fjala. Është hera e parë që lexoj se perandoritë mund të kenë për bazë rregullimin konfederativ, u mor vesh fjala është për periudhën moderne të nocionit shtet në të drejtën ndërkombëtare, e cila fillon me Paqen e Vestfalisë (1648). Pas leximit të kësaj çfarë thonë autorët shqiptarë në librin që është objekt kritike këtu, njeriu nuk di se ku duhet futur idetë moderne pro dhe kundër "federatës vullnetare" të Jean-Jacques Rousseau-it (Zhan-Zhak Ruso, 1712-1778) dhe Immanuel Kant-it (Imanuel Kant, 1724-1804). Mund të ndodhë që edhe sulltanët osmanë të jenë frymëzuar nga këta dy autorë modernë perëndimorë kur kanë nisur reformat që çuan në themelimin e vilajeteve osmane më 1878 e tutje?!

Identiteti socio-politik dhe fizik i Kosovës dhe i trojeve etnike të kohës së vilajeteve është pasojë e sigurisë, të cilën Porta ka dashur ta krijojë nga rreziku i elementit shqiptar, si dhe rreziku i nacionalizmit në rritje tek popujt e Ballkanit të asaj kohe. Kjo nuk mund të shpjegohet mbi baza juridike, e veçanërisht jo mbi bazën e konceptit të konfederatës si shtet i përbërë. Vilajetet u "zbuluan" për të centralizuar më tej dhe për forcuar më shumë identitetin e Perandorisë Osmane, si shtet në shkatërrim e sipër, e jo të identitetit të subjekteve dhe popujve të saj. Si të tilla, vilajetet kurrë nuk janë bazuar në kriterin nacional, i cili ka qenë i panjohur për Perandorinë Osmane. Për më tepër, ato kanë pasur për qëllim shprishjen e identiteteve nacionale, pra edhe të atij shqiptar. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë në asnjë mënyrë se ato e kanë arritur këtë qellim. Krejt çfarë është arritur si pasojë e sistemit të vilajeteve konsiston në faktin se formimi i tyre ka penguar zhvillimin nacional të shqiptarëve si komb[82].

Si dëshmi se shkaqet dhe arsyeja e sigurisë kanë qenë shkak i këtij fenomeni shërben edhe fakti se mbi të njëjtën bazë është bazuar edhe aneksimi i trojeve shqiptare nga Serbia, Greqia dhe Mali i Zi gjatë Luftërave Ballkanike (1912-1913). Vetëm atëherë kur u arrit marrëveshja, datë 23 gusht 1912, mes

[82] Cf. Basil Kondis, ibid, fq. 20.

Portës dhe kryengritësve shqiptarë, me të cilën Shqipëria u definua territorialisht dhe përfshiu "katër vilajetet", atëherë vendet fqinje këtë akt e quajtën si *casus belli* dhe rrezikim të interesave dhe të sigurisë së tyre nacionale, të bazuara kryekëput në politikën ekspansioniste ndaj trojeve etnike shqiptare[83]. Raporti i forcave në dëm të shqiptarëve si dhe sigurimi i interesave ekspansioniste të vendeve fqinje nga ana e Fuqive të Mëdha të kohës pati për pasojë krijimin me dhunë të identitetit të ri socio-politik dhe fizik të shqiptarëve dhe të trojeve etnike shqiptare, të cilat ranë nën sundimin e Serbisë, Greqisë dhe Malit të Zi, por jo edhe të Maqedonisë, siç pohon njëri prej koautorëve të librit që diskutohet këtu, dr. Esat Stavileci (fq. 14). Kjo për shkakun se kombi dhe shteti i sotëm maqedon, pra "ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" siç njihet sot, u formua vetëm pas Luftës së Dytë Botërore me iniciativën, insistimin dhe ndihmën direkte të Titos, diktatorit komunist të ish-Jugosllavisë, sërish për arsye të sigurisë dhe krijimit të raportit të ri të forcave në rajon. Mirëpo, për këtë nuk do të flasim këtu më shumë ngaqë i tejkalon caqet e këtij shkrimi. Shkarazi do t'i kthehemi kësaj çështjeje kur të flasim për konceptin komunist të barazimit të nocionit komb me nocionin republikë dhe, anasjelltas, të barazimit të nocionit "jokomb" me atë të autonomisë politiko-territoriale dhe statuseve të tjera juridiko-politike që nuk quhen "republikë federale".

3. Glorifikimi dhe fetishizimi i Kushtetutës së vitit 1974

Gjatë shtjellimeve të tyre, autorët i vënë një theks të posaçëm Kushtetutës së vitit 1974 të ish-Jugosllavisë, si bazë juridike e vlefshme për të drejtën e Kosovës dhe popullit të saj për vetëvendosje. Marrja me këtë kushtetutë nuk është veçse marrje me pasojë, për çka do të flasim më vonë. Tani menjëherë shënojmë se pozita socio-politike, legale dhe fizike e Kosovës gjatë tërë kohës së ekzistimit të ish-Jugosllavisë, pra deri më 1990-1991, përfshirë këtu edhe pozitën e përcaktuar në Kuvendin e Prizerenit (1945) ose sipas Kushtetutës së Vidovdanit (1921), gjatë ekzistimit të së cilës, sipas dr. Esat Stavilecit, Kosova paska pasur "status të njësisë së veçantë" (fq. 20), nuk ka qenë veçse pozitë e imponuar për shqiptarët. I njëjti autor, duke vazhduar më tej, konstaton se pozita e Kosovës ka qenë e veçantë para Luftës së Dytë Botërore "deri në momentin kur territori saj u nda mes tri banovinave: Banovinës së Vardarit,

[83] Cf. Edith P. Stckney, *Southern Albania or Vorio Epirus in European International Affairs: 1912-1913* (Stanford UP: California, 1926) fq. 19.

Moravës dhe Zetës" (po aty). Edhe në shqyrtimet e mëtejme të autorëve vërehet e njëjta logjike e rezonimit, duke ngatërruar haptazi argumentet historike të kontinuitetit të jetesës së shqiptarëve në trojet e tyre etnike me ato juridike, në të dyja rastet në funksion të arsyetimit të bazës legale të së drejtës për vetëvendosje të Kosovës dhe të popullit të saj shumicë, gjë e cila është një çështje krejtësisht tjetër.

Baza juridike e së drejtës për vetëvendosje eksterne, në parim nuk mund të kërkohet në të drejtën e brendshme, pra në Kushtetutën dhe ligjet e shtetit të dhënë, veçanërisht kur jemi në pyetje ne shqiptarët, për arsye se ato, në historinë tonë moderne, kanë qenë, pa asnjë përjashtim, të imponuara nga sunduesit e huaj. Përjashtim bëjnë vetëm vitet e paspërfundimit të Luftës së Ftohtë (Deklarata e 2 Korrikut 1990, Kushtetuta e Kaçanikut e 7 shtatorit 1990, referendumi dhe zgjedhjet e lira). Aktet e brendshme juridike (kushtetuta dhe ligjet) nuk kanë qenë bazë e së drejtës për vetëvendosje të asnjë popullni, edhe në rastet kur ato e kanë parashikuar një gjë të tillë shprehimisht, siç ka qenë rasti me nenin 72 të Kushtetutës së ish-BRSS-së të vitit 1977. Kjo është kështu edhe kur bëhet fjalë për shkëputjen si një nga format e realizimit të së drejtës për vetëvendosje (e drejta eksterne për vetëvendosje). Kështu është vepruar si më herët ashtu edhe me rastin e shpërbërjes së ish-federatave socialiste (BRSS-së, Çekosllovakisë, dhe Jugosllavisë)[84]. Shkëputja (secesioni) është fakt jetësor jashtë domenit legal (ligjor), ashtu siç është edhe vetë akti i krijimit të shtetit. Kjo rrethanë jetësore mund të këtë forma të ndryshme manifestimi: shpërbërjen totale të shtetit ekzistues ose zvogëlimin e sovranitetit të tij territorial[85].

Është perceptim i gabuar kur thuhet se Kushtetuta e vitit 1974 ka qenë kriter i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, siç e thonë dy nga koautorët (cf. dr.

---

[84] Cf. më shumë për këtë në Charles Tilly, "National Self-Determination as a Problem for All of Us", *Daedalus* vol. 122, no. 3 (Summer 1993); Max M. Kampelman, "Secession and Self-Determination: New States and Old Problems", *Current* no. 357 (November 1993); Isaias Afewerki, "Challenge from Within: The Theory and Practice of Self-Determination, *Harvard International Review* vol. XVII, no. 3 (1995); Hanum Hurst, "Self-Determination in the Post-Colonial Era", në Donald Clark & Robert Williamson (eds.), *Self-Determination: International Perspectives.*

[85] Cf. Henry Spruyt, "Decline Reconsidered: The Complex Nature of Modern Soverenigty", në *Harvard International Review* vol. XVII, no. 3 (1995); Alex Buchanan, "Self-Determination and the Right to Secede", në *Journal of International Affairs* vol. 45, no. 2 (1992); Alexis Heraclides, "Secession, Self-Determination and Non-Intervention: In Quest of a Normative Symbiosis", *Journal of International Affairs* vol. 45, no. 2 (1992); Christian Tomuchat, "Self-Determination in a Post-Colonial World", në Christian Tomuschat, *Modern Law of Self-Determination* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1993) fq. 1-20.

Esat Stavileci, fq. 29, dhe mr. Blerim Reka, fq. 82-85, etj.). Shkëputja (secesioni), pa marrë parasysh rezultatin final, është jashtë domenit legal të së drejtës së brendshme (kushtetutës dhe ligjit) dhe, në masë të caktuar, edhe të asaj ndërkombëtare. E drejta e brendshme eventualisht shërben si lehtësues i kërkesave retorike politike për vetëvendosje dhe i vetë procesit të vetëvendosjes së një grupi etnik me bazë territoriale. Fakti i shkëputjes si proces paraqet tërësinë e ngjarjeve që simbolizojnë forcë, qoftë fizike ose morale, i cili nuk nxitet nga e drejta (kushtetuta dhe ligji). Ajo, pra shkëputja (secesioni), mund të inkurajohet dhe të kanalizohet më vonë nga e drejta e brendshme, mirëpo formësimi i saj definitiv dhe ndalja (përfundimi) si proces nuk kanë punë me të drejtën e brendshme (Kushtetutën dhe ligjin). Çka do të bënin ish-kolonitë sikur e drejta e tyre për vetëvendosje të bazohej në të drejtën e brendshme (kushtetutat dhe ligjet) të ish-shteteve metropole, ose, çka do të bëhej sot me popujt e shtypur brenda shteteve të sotshme sovrane, të cilat nuk kanë rregullim socio-politik federativ? Sot nuk njihet e "drejta federale për vetëvendosje" dhe as ajo e bazuar në rendin e brendshëm. Ajo është pikërisht mohim i vetëvendosjes (eksterne) si koncept[86]. Për këtë do të flasim më vonë.

Konstatimi ynë si më sipër nuk bie ndesh me parimin *uti possidetis* në të drejtën ndërkombëtare, i cili hyn në funksion dhe aktivizohet vetëm pas fitimit të pavarësisë dhe i referohet caqeve (kufijve) territorialë të shtrirjes së sovranitetit të shtetit të ri. Një gjë e tillë është konfirmuar edhe në të gjitha vendimet dhe praktikën ndërkombëtare deri më sot, për çka do të flitet më pastaj.

Kushtetuta e vitit 1974 sigurisht që nuk ka njohur në asnjë dispozitë të saj të drejtën për vetëvendosje "deri në shkëputje" të asnjërit prej popujve të ish-Jugosllavisë, përfshirë këtu edhe shqiptarët, sikundër as të drejtën për vetëvendosje të entiteteve të tyre territoriale (republikave dhe krahinave). Përkundrazi, në këtë kushtetutë kanë ekzistuar dispozitat të cilat shprehimisht proklamonin se ish-Jugosllavia bazohej dhe paraqiste një lloj inkarnacioni, siç e thotë Antonio Cassese, të parimit të vetëvendosjes së popujve, ashtu që edhe realizimi i kësaj së drejte është quajtur si legal dhe legjitim vetëm jashtë atij shteti. Në vijim të kësaj, duhet kërkuar edhe shpjegimin pse një realizim i tillë i së drejtës për vetëvendosje jashtë ish-Jugosllavisë pati qenë i sanksionuar si një nga objektivat e politikës së saj të jashtme gjatë tërë kohës sa ka

[86] Cf. Otto Kimminich, "A 'Federal' Right of Self-Determination?", në Christiann Tomuschat, *Modern Law of Self-Determination*, fq. 84-87.

ekzistuar deri në shpërbërjen e saj më 1992[87]. Askund tjetër nuk mund të gjendet edhe vetëm një dispozitë që flet për vetëvendosje, aq më tepër në sensin e njohjes së saj në favor të ndonjërit prej entiteteve territoriale (republikave dhe krahinave) ose në favor të popujve të ish-Jugosllavisë. Ky nuk ka qenë rasti me ish-BRSS-në, siç e cekëm më sipër, mirëpo edhe kjo nuk ka pasur asnjë rol e rëndësi si pasojë e natyrës së ish-sistemit komunist. Fakti i mësipërm i pati shërbyer si bazë teorisë serbe, të bazuar në raportin momental të forcave në atë kohë (1989-1991), të pohojë se e drejta për vetëvendosje është "konsumuar" me vetë aktin e themelimit të ish-Jugosllavisë si shtet. Këtë serbët tentonin ta ngrisnin në ligj, përmes ish-Kuvendit të RSFJ, duke hartuar të a.q. Projekt-Ligjit për Vetëvendsoje më datën 20 janar 1992. Me këtë ligj, serbët kishin për qëllim që të kontrollimin zbatimin e së drejtës për vetëvendosje në tërë territorin e ish-Jugosllavisë, gjithnjë nën premisën se ajo e drejtë tanimë ishte "e konsumuar", por që akoma mund të realizohej atykëtu me një kontroll të caktuar federal. Duke qenë se shkëputja (secesioni) është fakt jetësor që nuk varet nga kushtetuta dhe ligji, projektligji si më sipër as që pati mundësi të vijë në rend dite për miratim, si pasojë e shpërbërjes totale të ish-Jugosllavisë.

Bazuar në doktrinën komuniste, sintagma "deri në shkëputje" u kuptua në të gjitha ish-vendet socialiste si diçka e rezervuar vetëm për republikat e tipit federal, kurse popujt tjerë pa një status të tillë organizimi u quajtën si popuj që nuk kanë të "drejtën deri në shkëputje". Në rastin e fundit, autonomia e a.q. politiko-territoriale (dhe format e ngjashme me të) u bë sinonim i statusit maksimal për popujt e tillë, të cilët u quajtën "kombësi" (*narodnost*). Në përcaktimin administrativ dhe arbitrar të statusit të republikave ose autonomive, përkatësisht të kombit ose të "kombësisë", nuk luante asnjë rol fakti se popujt e ndryshëm kishin përfunduar procesin e formimit të tyre si komb shumë kohë para se një status i tillë t'u imponohej. Në anën tjetër, popujt që nuk ishin formuar si komb akoma, u "futën" në procesin e formimit dhe u quajtën si të tillë brenda natës. Kjo praktikë u ndoq në të gjitha vendet ish-socialiste shumënacionale, kurse statuset e tilla qenë të imponuara

[87] Cf. më shumë në parimet I dhe VII të Kushtetutës së ish-RSFJ të vitit 1974; Antonio Cassese, "Self-Determination of Peoples and the Recent Break-Up of USSR and Yugoslavia", në Ronald St. John MacDonald (ed.), *Essays in Honour of Wang Tieya* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1994) fq. 131-144; Payam Akhavan, "Self-Determination and the Desintegration of Yugosllavia: What Lessons for the International Community?", në Donald Clark & Robert Williamson (eds.), *Self-Determination: International Perspectives*, fq. 240-242.

si pasojë e koncepcionit komunist mbi kombin, për çka do të flitet më shumë gjatë këtij shkrimi.

Në vijim të kësaj logjike, pas nxjerrjes së Kushtetutës së vitit 1974, dhe duke mos e kuptuar esencën e koncepcionit dhe të filozofisë komuniste, dukет se pjesëmarrësit shqiptarë nga Kosova në përpilimin e saj, si dhe vetë shkenca juridike në Kosovë, i patën vënë detyrë vetes që të glorifikojnë këtë akt legal, duke u bazuar në burimet "burimore" të historikut komunist të Kosovës gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Lëvizjet nacionaliste të kësaj kohe u heshtën tërësisht, kurse nga lidhja direkte e ish-Komitetit të Partisë Komuniste të Kosovës me atë omonim të ish-Jugosllavisë u nxorën konkluzione për Kosovën "si pjesë përbërëse e Republikës Socialiste të Serbisë dhe element konstitutiv i Federatës Jugosllave". Natyrisht, kjo tentohej mbi baza juridike dhe rrënja lypsej në dy nenet e para të ish-Kushtetutës së vitit 1974**.** Pas ngjarjeve historike të 11 marsit të vitit 1981, klasa politike e Kosovës, e ndihmuar fort edhe nga "shkenca juridike", e (pa)vetëdijshme për statusin e imponuar dhe diskriminues legal të Kosovës karshi entiteteve të tjera territoriale në ish-Jugosllavi, u vërsul në ofensivë të re të procesit tanimë të filluar të glorifikimit të kësaj kushtetute, tani nën parullën se "republikat dhe krahinat janë njësoj dhe vetëm emri nuk është i njëjtë". Sigurisht që baza reale e këtij perceptimi ka qenë e drejtë, dhe strukturat e pushtetit nëpër ish-republika dhe krahina kanë qenë gati të njëjta, por jo edhe identike. Sundimi i ish-Lidhjes Komuniste të Kosovës, përkatësisht i LKJ-së, dhe jo i Kushtetutës dhe ligjit, linin përshtypjen e rreme se fjala ishte për një status identik me të tjerët dhe jodiskriminues për ne. Kështu ka ndodhur edhe me vendet tjera dhe popujt nën regjimet ish-komuniste.

Ky proces kësisoj i glorifikimit, megjithatë, filloi të vihej në dyshim publikisht pas ngjarjeve të sipërcekura të vitit 1981: atëherë trupat e policisë serbe, me një rezistencë të vogël, e cila nga klasa politike e Kosovës së asaj kohe u quajt si konfirmim i pozitës së barabartë të Kosovës me entitetet tjera të ish-Jugosllavisë, arritën të futen në Kosovë për të shtypur me dhunë pakënaqësinë e popullit shumicë, pra të popullit shqiptar, ndaj emërtimit të Kosovës si "Krahinë Socialiste Autonome". Shqiptarët si popull shumicë, ndërkaq, nuk e ndienin veten se janë "kombësi" (lexo: pakicë kombëtare), pa marrë parasysh se statusi legal i Kosovës mbeti i njëjtë deri më 1990.

Iluzionet se me një glorifikim të tillë mund të vazhdohej pakufi u rrëzuan përfundimisht me fillimin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë: armatimi dhe forca tjetër fizike e atij shteti mbeti në duar të serbëve për t'i drejtuar të njëjtat kundër popujve të tjerë, gjë që edhe internacionalizoi krizën në ish-Jugos-

llavi. Ky internacionalizim pati për rrjedhojë ndërhyrjen e bashkësisë ndërkombëtare, e cila e quajti si të palejueshëm dhe të paligjshëm sipas së drejtës ndërkombëtare përdorimin e armatimit dhe forcës fizike të përbashkët kundër të tjerëve nga ana e Serbisë dhe Malit të Zi, të cilat kishin si qëllim fitimin e territoreve të cilat nuk ishin serbo-malazeze mbi bazën e asnjë kriteri. Kjo ndërhyrje gjithashtu pati për rrjedhojë edhe mosnjohjen e entiteteve serbe të krijuara si rezultat i pastrimit etnik, mënyrë kjo e palejueshme e krijimit të bazës territoriale të entiteteve që pretendojnë të jenë shtete sipas së drejtës ndërkombëtare. Futja e sanksioneve kundër Serbisë dhe Malit të Zi nga ana e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1992), si dhe mosnjohja ndërkombëtare e "Republika Srpska"-s në Dejton (1995) i shërbyen këtij qëllimi.

Shpërbërja e ish-Jugosllavisë shënoi një faze të re në të drejtën për vetëvendosje të Kosovës dhe popullit të saj shumicë dhe, rrjedhimisht, edhe në diskursin tonë juridiko-politik lidhur me këtë çështje. E gjendur në amulli si pasojë e mosnjohjes së shkaqeve për arsyetimet e deritanishme juridiko-politike të bashkësisë ndërkombëtare lidhur me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, një pjesë e juristëve në Kosovë filloi aktivisht procesin tjetër të arsyetimit të pozitës juridiko-politike të Kosovës sipas Kushtetutës së vitit 1974, mbi bazën e logjikës së njëjtë, proces që unë do ta quaja si fetishizim të asaj kushtetute deri në absurditet. Opinionet e dhëna publikisht, kryesisht politike por të vëna nën petkun legal, gjatë procesit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë e deri më sot, sigurisht që nuk kanë qenë pa ndikim në disa prej formulimeve të kërkesave politike për pavarësinë e Kosovës, gjë që mund të shihet nga mënyra dhe koha e formulimit të dokumenteve baze juridiko-politike të Republikës së Kosovës në prag të fillimit të procesit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Frika se fajësia për shpërbërjen e atij shteti do të zhvendosej tek shqiptarët duhet të këtë qenë një nga motivet kryesore të një diskursi dhe praktike të tillë.

Logjika sipas së cilës çdo gjë që ndalohej dhe pengohej nga regjimi komunist i ish-Jugosllavisë ka çuar deri të bashkëngjitja e këtij procesi të ri të fetishizimit edhe të një baze të re të se drejtës për vetëvendosje të Kosovës dhe popullit të saj shumicë, Konferencën e Bunjajt (1943-44), duke aluduar në paralelen e saj me AVNOJ-in, si bazë themelore e strukturës së pushtetit komunist të ish-Jugosllavisë pas Luftës së Dytë Botërore, si dhe pjellën e saj, Kuvendin e Prizerenit (1945). Duke mos parë asnjë dallim mes AVNOJ-it, si qeveri komuniste në formim e ish-Jugoslavisë, dhe faktit se procesi i lindjes së Kosovës si shtet ka koinciduar edhe me formimin e organeve tërësisht të reja në Republikën e Kosovës, njëri prej autorëve të librit, dr. Esat Stavileci, arrin në përfundimin se "sa i përket çështjes nëse ai [Kuvendi i Kaçanikut i

datës 7 shtator 1990 — vërejtja jonë, E.H.] ka qenë sesion sekret, i kujtojmë lexuesit se një akt i tillë nuk është i panjohur në historikun kushtetues dhe lidhur me këtë AVNOJ mund të merret si shembull" (fq. 139). AVNOJ-i, megjithatë, nuk ka krijuar ish-Jugosllavinë. Ai ka qenë pjesë e ristrukturimit të një shteti tashmë ekzistues, ish-Jugosllavisë, ashtu që njohja ndërkombëtare e tij si shtet as që është vënë në pyetje deri kur është shpërbërë (1991-1992), kurse Kuvendi i Kaçanikut ka vënë themelet definitive të lindjes së shtetit të ri të Kosovës, me rregullim unitar republikan, njohja ndërkombëtare e të cilit si shtet sovran dhe i pavarur akoma nuk është bërë. I pari (AVNOJ) i referohet lindjes së qeverisë, kurse i dyti shtetit (të Kosovës me rregullim unitar republikan). Këto janë dy çështje të ndryshme.

Gjithherë në vijim të logjikës si më sipër, tre autorët, e lidhin, në mënyra të ndryshme, Kuvendin e Prizerenit (1945) me bazën e së drejtës për vetëvendosje të Kosovës dhe popullit të saj shumicë. Kuvendi i Prizerenit (1945) merret si bazë e faktit se Kosova na qenka aneksuar nga Serbia Federale dhe tani, rrjedhimisht, u dashka t'i kthehet e drejta e marrë për vetëvendosje (dr. Esat Stavileci, fq. 261; mr. Blerim Reka, fq. 58-61, 931; dhe dr. Arsim Bajrami, fq. 117-118, etj.). Kuvendi i Prizerenit nuk ka qenë veçse një kurth politik i Serbisë për shprishjen e mëtejshme të identitetit socio-politik dhe fizik të Kosovës dhe të trojeve të tjera shqiptare nën ish-Jugosllavi, kësaj radhe me ndihmën e klasës politike shqiptare të proveniencës komuniste. Përveç kësaj, këto kanë qenë të organizuara si reagim ndaj kërkesave të krahut nacionalist të kohës për ruajtjen e tërësisë territoriale të trojeve etnike shqiptare dhe të subjektivitetit politik të kombit shqiptar (Lidhja e Dytë e Prizerenit, mesi i shtatorit 1943).

Paaftësia për t'i kuptuar rrjedhat dhe arsyetimet ndërkombëtare lidhur me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, si dhe vështirësia për t'iu përshtatur ndryshimeve pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, ka çuar autorët në kthimin e humbjeve tona politike në fitore, përkatësisht në shtjellimin e Kuvendit të Prizerenit (1945) si një nga bazat e së drejtës për vetëvendosje të Kosovës dhe popullit të saj. Qëllimi i vetëm është që në emër të shkencës juridike të gjendet kontinuiteti legal i Kuvendit të Prizerenit (1945) me Kushtetutën e vitit 1974 dhe parimin *uti possidetis*, i cili tërësisht është i paqartë për autorët, për çka do të behet fjalë në këtë shkrim.

Një filozofi e tillë e fetishizimit të Kushtetutës së vitit 1974, pasi "ngopi" mirë me "shkencë" tregun e Kosovës, filloi një "ekspansion" jashtë tij. Për çudi, kjo ka inkurajuar edhe ata qe nuk janë fare juristë për të arsyetuar të drejtën për vetëvendosje të Kosovës dhe popullit të saj mbi baza të njëjta. Kjo ka

çuar deri në falsifikim të dispozitës së nenit 2 të Kushtetutës së ish-Jugosllavisë të vitit 1974. I tillë është rasti me një vepër të autorit Alush Gashi[88]. Mund të ndodhë që autori në fjalë ka menduar se nuk ekziston versioni serbo-kroatisht i Kushtetutës së vitit 1974 të ish-Jugosllavisë, gjë që duket pak e besueshme. Ajo që është për t'u besuar i referohet faktit të fetishizimit të kësaj kushtetute dhe bindjes së krijuar se vetëm ato entitete që nuk kanë qenë në përbërje formale të ish-Republikës Socialiste të Serbisë kanë të drejtën për vetëvendosje. Pjesët e tjera të asaj kushtetute nuk janë shtrembëruar, gjë e cila vërteton motivin e sipërcekur, përndryshe fare të pabazuar dhe naiv.

Me këtë filozofi nuk dëshmohen veçse dy gjëra. *Së pari*, insistimi i tepërt nga ana jonë për të bazuar të drejtën për vetëvendosje të Kosovës dhe popullit të saj në ish-Kushtetutën e vitit 1974 ka për rrjedhojë pohimin indirekt sikur populli shqiptar i Kosovës ka pasur vullnet për jetesë në ish-Jugosllavi. Me fjalë të tjera, nga kjo del se objektivisht ka qenë vullnet i popullit të Kosovës, dhe interes i tij real, mbetja nën ish-Jugosllavi, përfshirë këtu të gjitha ridefinimet juiridko-politike të atij shteti, të cilat përndryshe nuk kanë asnjë efekt legal ndërkombëtar, para dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Një fakt i tillë, tek e fundit, shprehimisht pohohet edhe në libër. Kështu, ta zëmë, dr. Stavileci, thotë, *inter alia*, se "fakt tjetër i pamohueshëm, i cili nuk ekziston më, është se tani nuk ka interes të përbashkët të Kosovës dhe Serbisë mbi bazën e të cilit Kosova duhet të jetë brenda Serbisë, pasi që nuk ekziston më Jugosllavia shumëkombëshe si federatë" (fq. 26-27). Shënojmë se ai interes nuk ka ekzistuar kurrë dhe se mbetja e Kosovës dhe viseve të tjera nën ish-Jugosllavi ka qenë aksidentale, si edhe në rastin e gjenezës së Vilajetit të Kosovës dhe po për të njëjtat shkaqe dhe arsye. Këtë rrethanë, lidershipi kosovar po mundohet të mos e përsërisë kurrë më.

Së dyti, në vijim sa më sipër, një qasje e tillë si më sipër ndaj së drejtës së Kosovës dhe popullit të saj për vetëvendosje nuk ka shërbyer dhe as që shërben veçse si një pretekst i qarqeve ndërkombëtare të vendosjes për mbulimin e arsyeve dhe shkaqeve të vërteta të mosnjohjes ndërkombëtare (individuale dhe kolektive) të Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur. Ajo po shërben dhe ka shërbyer si një nxitje e bindjes së qarqeve diplomatike ndërkombëtare se ish-krahinat autonome të RSFJ nuk duhet pasur të drejtën për vetëvendosje, bindje që sot, mjerisht, ka fituar qytetarinë dhe po përdoret si bazë e ofertës së disa vendeve perëndimore për një "autonomi të zgjeruar" për Kosovën

[88] Alush Gashi, *The Denial of Human and National Rights of Albanian in Kosova* (Illyria: New York, 1991) fq. 94.

dhe popullin e saj. E vërteta është se baza reale e mosnjohjes ndërkombëtare (individuale dhe kolektive) të Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur, deri më sot, qëndron në mungesën e kontrollit efektiv mbi Kosovën nga ana e strukturave të pushtetit legjitim të Republikës së Kosovës si dhe në shkaqet gjeostrategjike. Kështu së paku e thonë ekspertët e huaj të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare[89].

Juridikisht shikuar, ndërkaq, ish-Kushtetuta e vitit 1974 nuk e ka njohur të drejtën për vetëvendosje as për ish-republikat, për çka u fol më herët. Procesi i pavarësimit të Kosovës, si shtet *in statu nascendi* (në lindje e sipër) koincidon me atë të njohjes ndërkombëtare të së drejtës për vetëvendosje të popullit të saj shumicë. Mirëpo, as njëri e as tjetri nuk e kanë bazën në Kushtetutën e vitit 1974, por në gjendjen faktike të krijuar në terren dhe zhdukjen nga faqja e dheut të ish-Jugosllavisë. Ky i fundit është fakt relevant juridikondërkombëtar dhe nënkupton atë se Serbia, për herë të dytë, ka humbur titullin legal të vlefshëm për qeverisjen e Kosovës. Subjekti juridik ndërkombëtar, i cili e ka pasur këtë titull, nuk ekziston më. Herën e parë, Serbia e ka humbur këtë titull juridik-ndërkombëtar jo në Kuvendin e Prizerenit (1945), ngaqë as Serbia nuk ka qenë shtet i njohur ndërkombëtarisht në atë kohë, sikundër që nuk është sot, por më 1918, kur është krijuar ish-Jugosllavia. Kuvendi i Prizerenit (1945) ose ai i vitit 1989 janë çështje për historianët e jo juristët.

Kontinuiteti i jetesës së shqiptarëve në trojet e tyre etnike, po e përsërisim edhe një herë, nuk mund të shpjegohet me argumente legale, veçanërisht jo duke u dhënë statuseve socio-politike të imponuara nga të huajt elementet e qenies shtet në dobi të Kosovës. Deri në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, Kosova dhe shqiptarët kanë pasur rol fare të vogël, ose asnjë rol, në rregullimin e jetës së tyre me kushtetutë dhe ligje, të cilat do të mund të quheshin si shprehje e vullnetit të tyre real. Vetëm pas shpërbërjes së saj, Kosova dhe shqiptarët si popull shumicë, pas afro dymijë vjetësh, për herë të parë, u shprehën lirisht për fatin e tyre.

---

[89] Cf. më shumë në Vaughan A. Lowe & Collin Wabrick, "Recognition of States", *International and Comparative Law Quarterly* vol. 41, part 2 (1992) fq. 480; cf. arsyet për njohjen e republikave të ish-Jugosllavisë tek punimi i autorëve si vijon: Martha Rady, "Self-Determination and the Dislotion of Yugosllavia", *Ethnic and Racial Studies* vol. 19, no. 2 (1996) fq. 382-384; Payam Akhavan, "Self-Determination and the Desintegration of Yugosllavia: What Lessons for the International Community?", fq. 227-28, 233-35, 240-42; dhe Malcolm Shaw, "State Succession Revisited", *Finish Year Book of International Law* vol. 5 (1994) fq. 37.

Në vijim, do të japim pikëpamjet tona lidhur me çështjet që janë të lidhura me ato si më sipër dhe atë: konceptin komunist si bazë e së drejtës për vetëvendosje dhe pasojat e tij; suksesionin (trashëgimin) e shteteve; parimin (rregullën) *uti possidetis*; kontinuitetin shtetëror-juridik të Serbisë me ish-Jugosllavinë; dhe, së fundi, bazën juridiko-ndërkombëtare të së drejtës për vetëvendosje të Kosovës dhe popullit të saj.

3. Koncepti komunist si bazë e së drejtës për vetëvendosje dhe pasojat e tij

Shekulli XX është dëshmitar i kalimit të ideologjisë komuniste, të bazuar në konceptin internacionalist të revolucionit botëror, në komunizëm nacional. E drejta e kombeve për vetëvendosje, e përdorur për qëllimet e "revolucionit botëror proletar" u mohua shprehimisht para ardhjes së bolshevikëve në pushtet në fillim të këtij shekulli. Ky ndryshim pati ndikim të drejtpërdrejtë në transformimin e konceptit të kombit në të gjitha vendet ish-socialiste (komuniste), duke krijuar në raport me botën përtej tij, pra në planin ndërkombëtar, idenë e "kombit kinez", "kombit jugosllav", "kombit sovjetik si tip i ri i entitetit njerëzor", kurse në shtetin shqiptar, si shtet njënacional, krijoi idenë e "njeriut të ri socialist". Mirëpo, ndikimi me obskur i këtij koncepti ishte në planin e brendshëm, pra, brenda vetë shteteve ish-socialiste (komuniste), për çka edhe ne do të vazhdojmë shqyrtimet tona. Si në rastin e parë, ashtu edhe në të dytin, çdo gjë fillon me Stalinin, teorinë dhe praktiken e tij.

Duke mos qenë rus, Stalini u zgjodh nga Lenini si personi më i përshtatshëm për të hulumtuar literaturën botërore mbi çështjen e kombit ashtu qe të krijohej një definicion i përshtatshëm për të, i cili do të shërbente më vonë si bazë partiake për politikën bolshevike ndaj kombeve dhe grupeve të tjera etnike në ish-BRSS. Kjo përgatitje filloi në prag të Revolucionit. Stalini, pasi kishte bërë përmbledhjen eklektike të definicioneve të kombit të dhëna nga Baueri dhe Kautski, formuloi definicionin e kombit të bazuar katërçipërisht mbi të a.q. kriteret "objektive" (gjuha, territori, marrëdhëniet ekonomike dhe konstruksioni psikik), ashtu që mungesa vetëm e njërit prej tyre bënte që entiteti i dhënë të mos kualifikohej për të qenë komb. Kurrë, sot e kësaj dite, nuk është dhënë përgjigjja në pyetjen se çka janë ato entitete që nuk i plotësojnë këto kritere kumullativisht (të gjitha së bashku dhe përnjëherë). Kjo ide u bë praktikë e të gjitha vendeve ish-socialiste (komuniste), pa përjashtim

dhe pa marrë parasysh modalitetet e vogla të futura më vonë nga ideologët e ndryshëm nacional të tipit, ta zëmë, të Edvard Kardelit.

"Vullneti" ose "ndjenja e përkatësisë" si elemente të a.q. "subjektive" të definimit të kombit, kurrën e kurrës nuk u morën parasysh në asnjë vend ish-socialist (komunist). Kjo për arsyen e thjeshtë se, në një sistem të tillë të vlerave, kombet ose grupet e tjera etnike konsideroheshin vetëm si objekte pasive të atij establishmenti politik, për t'u cilësuar si subjekt aktiv vetëm proletariati revolucionar dhe avangarda e tij — partia komuniste. Ishte kjo e fundit ajo që vendoste se cili grup etnik definohej (quhej) si komb e cili si pakicë ose "kombësi" (*narodnost*). Kriteret "objektive" ofruan mundësi të pakufizuara të vendosjes arbitrare lidhur me atë se kush ishte komb e kush jo, pa marrë parasysh se çka mendonte për veten e vet grupi i dhënë etnik. Duke përdorur kriteret "objektive" u bë e mundur që të kalkulohet, në mënyrë arbitrare dhe administrative, numri i kombeve në një vend. Është i njohur rasti i Leninit, i cili fillimisht pati mohuar ekzistimin e kombit hebre. Regjistrimi i popullsisë bëhej sipas regjistrave paraprakë, ku përcaktohej se kush janë kombe e kush nuk janë, ashtu që, ta zëmë, nëse dikush regjistrohej në ndonjë grup të paqenë sipas listës zyrtare të "kombeve" dhe "jokombeve", ai do të futej domosdo në njërën prej listave ekzistuese. Nuk është çudi, prandaj, qe në shumicën e këtyre vendeve figurojnë disa kombe si ekzistente gjatë një periudhe të caktuar, kurse më vonë është e kotë të kërkohet ekzistenca e tyre, ose anasjelltas. Dhe, anasjelltas, mbi bazën e këtij koncepti janë krijuar kombe të reja, të cilat nuk kanë ekzistuar, pa marrë parasysh faktin nëse grupi i dhënë ndihej si i tillë, pra si komb. Të rastit të parë janë, p.sh., rasti i ish-Republikës së Kurdistanit dhe i kombit kurd, ndërsa të rastit të dyte janë, p.sh., "ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" dhe i kombit maqedon. Statusi republikë u barazua me atë të kombit në mënyrën më arbitrare dhe administrativisht.

Një filozofi si kjo shërbeu si bazë edhe për krijimin e nocioneve të tjera juridiko-politike për të definuar statusin e "jokombeve". Një nga këto nocione është edhe ai i "autonomisë politiko-territoriale", i cili nuk ka qenë tjetër veçse mohim i pranimit të ekzistencës së kombeve tashmë ekzistuese nëpër këto shtete, duke i shpërndarë këta të fundit administrativisht dhe në mënyrë arbitrare nëpër "republikat kombe" për t'ua shprishur identitetin nacional tanimë të krijuar. Kurrë nuk është shpjeguar fakti, ta zëmë, se përse çerkezët në ish-BRSS qenë "kombësi" (*narodnost*), kurse azerët "komb", përkundër faktit se shumica prej dy grupeve etnike jetuan dhe akoma jetojnë jashtë republikave federale të ish-BRSS-së, tani shtete sovrane dhe të pavarura. Ose, një rast

tjetër, duhet pohuar se kalmukët ishin komb para vitit 1943, kur u "transformuan" në "kombësi" (*narodnost*), dhe që prapë u bënë "komb" më 29 korrik 1958, kur u restaurua republika e tyre. I njëjti fenomen ekziston edhe në Kinën e sotme, përkatësisht në marrëdhëniet mes hanëve si komb dhe kombeve të tjera[90].

Nuk do mend se mbi bazën e doktrinës së njëjtë, trojet etnike shqiptare në ish-Jugosllavi u ndanë me të vetmin qëllim mohimin e ekzistimit të kombit shqiptar në ish-Jugosllavi, nisur nga fakti se nocioni i republikës ishte sinonim i kombit, kurse ai i autonomisë quhej si i rezervuar për "kombësi" (*narodnost*) ose "jokombe". Prandaj, pozita dhe statusi juridiko-politik i Kosovës në ish-Jugosllavi pas Luftës së Dytë Botërore kanë qenë tërësisht të imponuara, përfshirë këtu të gjitha llojet e tyre që nga ai i Prizerenit (1945) e deri në atë të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974. Ky është edhe një argument më shumë se Kushtetuta e vitit 1974 nuk ka mundur aspak të jetë, dhe as që mund të jetë, bazë e së drejtës për vetëvendosje. Ajo ka qenë antipod i saj, shikuar historikisht. Të merresh me elaborimin e kësaj kushtetute si bazë e së drejtës për vetëvendosje do të thotë të merresh me pasojë, kurse të thuash se autonomia e Kosovës është "rrënuar në mënyrë kundërkushtetuese dhe kundërligjore dhe se ish-republikat e krahinat autonome kanë qenë të barabarta" (cf. dr. Esat Stavileci, fq. 24-25, 31,38; mr. Blerim Reka, fq. 73-80, 93-94, 104-102, etj. etj.), nuk është veçse marrje e sërishme me gjëra të kota, kësaj radhe me pasojën e pasojës. Statusi i Kosovës i vitit 1974 ka qenë status i imponuar sipas konceptit të sipërcekur komunist dhe mund të provohet lehtë para çdo kujt se ai ka pasur një natyre të tillë.

Në vijim të logjikës së mësipërme, njeri prej autorëve, dr. Arsim Bajrami, konkludon se "veprimet dhe aktet kundërkushtetuese të regjimit serb kanë rrënuar subjektivitetin politik të Kosovës" (fq. 111). Subjektiviteti politik i Kosovës, sipas konceptit të sipërcekur komunist, është rrënuar me vetë aktin e shkatërrimit të ish-Jugosllavisë, ashtu siç ka ndodhur edhe me ish-republikat tjera, tani shtete sovrane dhe të pavarura. Ajo që ka ndodhur më herët nuk i intereson së drejtës ndërkombëtare dhe nuk duhet të na interesojë as neve si juristë. Shpërbërja e ish-Jugosllavisë ka hapur rrugët e reja dhe bazë të re dhe reale të së drejtës për vetëvendosje të të gjithë popujve të ish-Jugosllavisë me bazë territoriale. Identiteti socio-politik dhe fizik i Kosovës si shtet në lindje e sipër (*in statu nascendi*) është fare i ri dhe nuk ka të bëjë me atë të

---

[90]. Cf. Michael Krykov, "Self-Detrmination from Marx to Mao", *Ethnic and Racial Studies* vol. 19, no. 2 (April 1996) fq. 352-377.

përcaktuar dhunshëm sipas Kushtetutës së vitit 1974, gjë që shtjellohet në mënyrë brilante nga i njëjti autor në pjesën e librit, e cila i referohet "Lindjes dhe krijimit të Republikës së Kosovës" (dr. Arsim Bajrami, fq. 112-126). Mirëpo, gabimi qëndron në atë se logjika e vlerësimit të "kundërkushtetutshmërisë dhe kundërligjshmërisë" së veprimeve dhe akteve serbe të vitit 1989 është bartur edhe pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, përkatësisht për aktet dhe veprimet serbe të ndërmarra në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë se Kosovës (dr. Arsim Bajrami, fq. 112). Gjithnjë në vazhdën e kësaj logjike të gabuar, tjetri koautor, dr. Esat Stavileci, duke arsyetuar politikën e diskriminimit serb ndaj shqiptarëve thekson elementin e "kundërkushtetutshmërisë së shkeljes së të drejtave të njeriut në Kosovë" (fq. 143-144 etj.). Në lëmin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së tyre është irrelevante (jo)kushtetutshmëria dhe (jo)ligjshmëria e akteve dhe veprimeve që çojnë deri te një cenim i tillë. Me rëndësi është që ato, mjerisht, shkelen dhe si të tilla vetëm duhet evidentuar, gjë që edhe është bërë në këtë libër në mënyrë mjaft të sistematizuar. Por, problemi është se autori në fjalë së bashku me një segment të caktuar të avokatëve nga Kosova duket se nuk njohin sa duhet mekanizmat dhe filozofinë juridiko-ndërkombëtare në lëmin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ashtu që edhe kanë përkrahur logjikën e vlerësimit të akteve dhe veprimeve të Serbisë si "ligje dhe akte diskriminuese", me referencë sistemin legal të Serbisë si pushtuese. Kjo është reflektuar negativisht edhe në raportet e ish-Raportuesit Special për të Drejtat e Njeriut në ish-Jugosllavi, z. Tadeusz Mazowiecki (Tadeush Mazovjecki, në këtë detyrë deri më 1995 kur dha dorëheqje për shkak të gjenocidit në Srebrenicë dhe mosreagimit të bashkësisë ndërkombëtare). Duket gjithashtu se personat e mësipërm nuk kanë qenë të vetëdijshëm se përmes kësaj logjike "juridike" është konfirmuar legjitimiteti i sistemit legal serb në Kosovë, deri në masën kur ai nuk është ose nuk do të jetë më antishqiptar (diskriminues). Në këtë dritë duhet shikuar edhe raportet e dy viteve të fundit, jo të favorshme dhe joreale në pjesën që ka të bëjë me Kosovën, të dhëna nga zonja Elizabeth Rehn (Elizabet Ren), si Raportuese Speciale për të Drejtat e Njeriut në ish-Jugosllavi. Duke elaboruar, ta zëmë, faktin se gazeta *Bujku* paguan 10 herë më shumë se gazeta *Jedinstvo* (mr. Blerim Reka, fq. 154) nuk arrihet tjetër pos që zyrtarizohet kërkesa drejtuar forumeve ndërkombëtare qe të bëhet presion mbi Serbinë për "pagesë të njëjtë të të gjitha gazetave që dalin nën juridiksionin serb". E së njëjtës proveniencë është edhe kërkesa e mëhershme e disa avokatëve tanë "për të ushtruar ankese" kundër "akteve dhe veprimeve serbe që cenojnë të drejtat e njeriut të shqiptarëve në Kosovë, si parakusht i kalimit në instancat ndërkombëtare",

sërish pa pasur parasysh faktin se me këtë legalizohet dhe legjitimohet para botës juridiksioni serb mbi Kosovën dhe qytetarët e saj.

Vetëvendosja e Kosovës dhe popullit të saj bazohet në faktin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe në parimin e vetëvendosjes, i cili përmblidhet në sintagmën ndërkombëtarisht të pranuar "shprehja e vullnetit të lirë të popullit", për çka do të flitet më shumë në vijim. Ajo nuk lidhet me konceptet legale të (kundër)kushtetutshmërisë dhe (kundër)ligjshmërisë. Si e tillë, ajo i referohet kategorisë së popujve me bazë territoriale, pra Kosovës dhe popullit të saj shumicë, të cilët gjenden nën okupim të huaj ushtarak si pasojë e mospasjes së titullit legal të vlefshëm nga ana e Serbisë dhe Malit të Zi (e a.q. RFJ) për qeverisje të Kosovës: ai, pra okupimi, është gjendje faktike, e përkohshme dhe nuk prodhon asnjë efekt legal. Kjo duhet dëshmuar para të tjerëve *de facto* dhe *de jure*, por jo me referencë në "të drejtën e brendshme" (kushtetutën dhe ligjet serbe). E drejta ndërkombëtare është e vetmja bazë për të dëshmuar ekzistencën e një gjendjeje të tillë dhe i vetmi inspirim për të dalë nga okupimi, siç do të shihet më vonë.

4. Suksesioni (trashëgimi), *uti possidetis*, kontinuiteti shtetëror-juridik i Serbisë me ish-Jugosllavinë dhe bazat në të cilat duhet të mbështetet sot e drejta e Kosovës për vetëvendosje

4.1. Suksesioni (trashëgimi) dhe uti possidetis

Suksedimi (trashëgimi) i shteteve në teorinë dhe praktikën e së drejtës ndërkombëtare definohet në mënyra të ndryshme. E përbashkët për të gjitha këto definime është teza sipas së cilës ai lind si pasoje e ndryshimeve në autoritetin sovran ose në titullarin (subjektin) e së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare ndaj një territori të caktuar[91]. Nga të gjithë subjektet e së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, vetëm shtetet kanë territor, ashtu qe në këtu flasim për suksedimin e shteteve dhe jo të subjekteve të tjera. Në anën tjetër, rregulla *uti possidetis*, qoftë në trajtën *de facto* ose *de jure*, nuk

[91] Cf. për teorinë: Daniel Patric O'Connell, *Succession in Municipal Law and International Law* vol. I (Cambridge UP: 1967) fq. 3; Sir Robert Jennings & Sir Arthur Watts, *Oppenheim's International Law*, 9th ed., vol. I (Longman: London, 1992) fq. 208; Ernst H. Feilchenfeld, *Public Debts and State Succession* (Macmillan: New York, 1931) fq. 2. Për zgjidhjet e traktateve ndërkombëtare, cf. neni 2 i Konventave të Vjenës, viti 1978 dhe viti 1983, lidhur me suksedimin (trashëgimin) e shteteve; pastaj, Mendimi Nr. 1 i Komisionit Badinter për ish-Jugosllavinë, etj. etj.

është veçse faqe tjetër e medaljes — suksedimit (trashëgimit) të shteteve në lëmin e kufijve ndërkombëtarë, qoftë kur flitet për kufijtë e përcaktuar me marrëveshje ndërkombëtare (të a.q. marrëveshje territoriale) ose për kufijtë administrativë. Kjo rregull zbatohet si për rastet kur shteti i mëparshëm e humb tërësisht subjektivitetin e vet ndërkombëtar, siç ka qenë rasti me ish-Jugosllavinë dhe Çekosllovakinë, ashtu edhe për rastet kur behet vetëm zvogëlimi i sovranitetit të tij territorial në favor të shteteve të tjera. I zbatuar për here të parë në procesin e dekolonizimit të Amerikës Jugore dhe Qendrore nga hegjemonia spanjolle në fillim të shekullit XIX, pastaj edhe në rastet tjera — si p.sh., në Azi (*Temple of Preah Vihear: Cambodia vs Thailand*, Merits, ICJ Rep.1962), Evropë (*Sovereignty over Certain Frontier Land: Belgium vs the Netherland*, ICJ Rep. 1959; Opinionet nr. 2 dhe 3 të Komisionit Badinter për ish-Jugosllavinë) dhe Lindje të Afërt (*Taba Case: Egypt vs Israel*, 80 ILR 1989) — parimi në fjalë ka për mesazh kryesor ruajtjen e kufijve (administrativë, kolonialë dhe të tjerë) pas fitimit të pavarësisë.

Zbatimi i këtij parimi në praktikë ka paraqitur vështirësi, veçanërisht lidhur me atë se cili variant i tij duhet zbatuar në praktikë: *uti possidetis juris* apo *uti possidetis de facto*. I pari ka të bëjë me pasjen e titullit legal, kurse i dyti me posedimin faktik të një territori, pa marrë parasysh titullin. Ky problem ka lindur për herë të parë në rastin gjyqësor mes Hondurasit dhe Guatemalës, më vonë edhe mes Brazilit dhe ish-kolonive të tjera spanjolle të Amerikës Latine. Praktika gjyqësore ka anuar kryesisht kah parimi *uti possidetis juris*, ngaqë në të kundërtën do të mohohej qëllimi i vetë këtij parimi, i cili konsiston në ruajtjen e stabilitetit dhe të *status quo*-s territoriale pas fitimit të pavarësisë. Përmbajtja e tij ka të bëjë kryesisht me faktin se fitimi i pavarësisë nuk mund të jetë bazë e mosnjohjes së kufijve ndërkombëtarë dhe administrativë të shtetit pararendës. Siç shihet, ky parim ka zbatim vetëm në një moment të caktuar kohor, atë të momentit të fitimit të pavarësisë, apo, siç është thënë në vendimin gjyqësor në rastin *Burkina-Fasoja kundër Republikës së Malit*, parimi në fjalë është "fotografim" i situatës territoriale në momentin e fitimit të pavarësisë. Fillimisht, ai ka shërbyer si bazë që territoret e pashkelura në Amerikën Latine të mos konsiderohen si *terra nullius* (toka të askujt) pas fitimit të pavarësisë se ish-kolonive, por t'iu takojnë atyre shteteve të reja në dokumentet topografike të të cilave figurojnë ato territore pas fitimit të pavarësisë. Kjo praktikë e fundit, pra ajo e bazuar mbi konceptin *terra nullius*, është bërë e pavlefshme si pasojë e parimit të vetëvendosjes. Gjithashtu, vlen të thuhet se sot një numër i madh i kushtetutave dhe dokumenteve ndërkombëtare të vendeve të Afrikës dhe Amerikës Latine e për-

mbajnë rregullën *uti possidetis*, por që ne nuk do të flasim në këtë shkrim sepse do të dilte jashtë caqeve të tij. Ajo çka është me rëndësi të veçantë për ne i referohet faktit se në të gjitha rastet e sipërpërmendura, kur është zbatuar parimi *uti possidetis*, fjala ka qenë për zonat përgjatë brezave kufitarë, të kontestuara nga palët (shtetet e reja) dhe nuk ka pasur të bëjë fare me titullin (të drejtën) juridik për ushtrimin e sovranitetit *per se*. Ky titull, ndërkaq, sot fitohet si pasojë e realizimit të dhunshëm të së drejtës për vetëvendosje të grupeve të dhëna (ta zëmë: rastet e Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Sllovenisë, Çeçenisë) ose përmes rrugës joviolente (siç ishte rasti me 12 republikat e ish-BRSS: Marrëveshja e Alma-Atas, datë 21 dhjetor 1991, ose rastet e Maqedonisë, Çekosllovakisë etj.). Këtu nuk futet rasti i ish-republikave baltike (Estonia, Letonia dhe Lituania), sepse aty nuk bëhet fjalë për krijimin e shteteve të reja ashtu siç kuptohen ato në të drejtën pozitive ndërkombëtare, por për restaurim të pavarësisë se humbur para Luftës së Dytë Botërore. Po ashtu, duhet thënë se deri më sot zonat që kanë qenë kontestuese dhe objekt zbatimi i këtij parimi kanë përfshirë sipërfaqet relativisht të vogla, ta zëmë rreth 500 kilometra katrorë (në gjykimin *Burkina-Fasoja kundër Republikës së Malit* të vitit 1986, ose rasti i kontestit rreth Prevllakës gjatë krizës në ish-Jugosllavi). Rrjedhimisht, ky është shkaku dhe logjika e zbatimit të këtij parimi vetëm pas fitimit të pavarësisë, e jo më herët, ashtu siç është edhe vetë aktivizimi i procesit të suksedimit (trashëgimit) pasojë e fitimit të pavarësisë së një territori të dhënë.

Autorët e librit flasin për parimin *uti possidetis*, suksesionin (trashëgimin) dhe okupimin në kuadrin e kontestit të njëjtë dhe në mënyrë tejet konfuze. Në vijim, po japim disa nga konkluzionet dhe shtjellimet e tyre: "Kufijtë (kon)federalë janë ndryshuar për herë të parë në Kosovë në mënyrë kundërkushtetuese, më 1989, kur është bërë aneksimi i Kosovës" (mr. Blerim Reka, fq. 78-80); pastaj, se dokumentet juridiko-politike të Kuvendit të Kosovës, të nxjerra pas datës 2 korrik 1990 e deri në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë (Kushtetuta e Kaçanikut, referendumi dhe zgjedhjet e lira) janë "bazë për pavlefshmërinë juridike dhe politike të aneksimit të Kosovës sipas Rezolutës së Prizerenit (1945) (mr. Blerim Reka, fq. 69); dhe, më tutje, se Mendimi i Badinterit Nr. 2 i datës 11 janar 1992 është i drejtë dhe duhet të vlejë edhe për shqiptarët pasi qe thotë se "grupeve konstitutive dhe bashkësive etnike u duhet njohur e drejta për identitet, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare" (mr. Blerim Reka, fq. 80); dhe, nga autori tjetër, "së dyti, meqë Kushtetuta e vitit 1974 e ish-Jugosllavisë ka qenë kriter baze për krijimin e saj, atëherë logjikisht dhe nga pikëpamja kushtetuese ajo duhet të jetë bazë e shpërbërjes

së ish-Jugosllavisë. Kosova ishte, prandaj edhe duhet njohur si njërin prej tetë subjekteve të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë me të drejtën për suksesion (trashëgim) dhe pavarësi" (dr. Esat Stavileci: fq. 29). Në vija të përgjithshme është ndjekur kjo logjikë rezonimi nga ana e autorëve, për të ardhur deri te konkludimi se "Në pajtim me parimin *uti possidetis*, Kosova kishte të drejtën për ndërkombëtarizimin e kufijve të saj, ngjashëm me rastin e republikave të tjera, në kushtet e shpërbërjes së federatës, pjesë përbërëse e së cilës ishte, në pajtim jo vetëm me Kushtetutën e ish-Jugosllavisë, por edhe mbi bazën e analogjisë komparative konform Vendimit të [Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, pra jo "*the Court of International Law*", siç thuhet në libër, sepse ai nuk ekziston si i tillë — vërejtja jonë, E.H.], të dhënë në rastin *Burkina-Fasoja/Republika e Malit*" (mr. Blerim Reka, fq. 83).

Të thuash se kufijtë e Kosovës duhet respektuar sepse ata janë ndryshuar në mënyrë kundërkushtetuese është jo vetëm qesharake, ngaqë asnjë shtet nuk shpërbëhet në mënyrë "kushtetuese", qoftë edhe kur kjo bëhet me marrëveshje (siç ishte rasti me ish-BRSS dhe Çekosllovakinë), por edhe legjitimim i kontinuitetit shtetëror-juridik të të a.q. RFJ (Serbi-Mali i Zi) me ish-Jugosllavinë, fakt ky të cilin askush në botë nuk është duke e pranuar. Kufijtë e Kosovës nuk janë ndryshuar, ata janë aty dhe në momentin e rrumbullakësimit të procesit të pavarësisë se Kosovës, ku njohja ndërkombëtare (individuale dhe kolektive) e saj do të jetë si dëshmi se një gjë e tille ka ndodhur, ata (pra, kufijtë e Kosovës) fitojnë statusin e kufijve ndërkombëtarë. Kështu ka ndodhur gjatë historisë moderne të krijimit të shteteve deri në rastet e fundit pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, BRSS-së dhe Çekosllovakisë. për diskontinuitetin shtetëror juridiko-ndërkombëtar të Serbisë me ish-Jugosllavinë, si vetmja baze juridiko-ndërkombëtare e Kosovës për vetëvendosje, do të flasim më vonë, kurse tani do të vazhdojmë me konstatimin e sipërcekur të autorit mr. Blerim Reka mbi njohjen e "identitetit" në favor tonin, ashtu siç është thënë në Mendimin nr. 2 të Komisionit Badinter. Autori, siç e thamë më sipër, duke u munduar të argumentojë se Kushtetuta e vitit 1974 është dashur të zbatohej edhe ndaj Kosovës dhe shqiptarëve si popull shumicë, citon Mendimin nr. 2 të datës 11 janar 1992 të Komisionit Badinter, në favor të njohjes së "identitetit" të njëjtë edhe për shqiptarët.

Ky rezonim, i bazuar në Komisionin Badinter, vetëm sa e përforcon edhe më tej tezën serbe mbi kontinuitetin shtetëror-juridik të të a.q. RFJ (Serbi-Maili i Zi) me ish-Jugosllavinë, për faktin e thjeshtë se ky mendim i Komisionit Badinter i referohet, fund e krye, minoriteteve. Për të qenë e keqja edhe më e madhe, ai nuk i referohet çfarëdo minoriteti, por pikërisht serbëve të

Bosnjë-Hercegovinës dhe të Kroacisë, pas fitimit të pavarësisë se këtyre të fundit. Pra është fjala për njohjen e kësi lloj "identiteti" për të cilin angazhohet Serbia dhe, mjerisht, edhe një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare kur është fjala për popullin shumicë në Kosovë.

Le të shihet në vijim konteksti në të cilin është dhënë mendimi i cekur i Komisionit Badinter. Ne të vërtetë, ai është dhënë si përgjigje ndaj pyetjes së parashtruar nga Serbia lidhur me atë nëse "populli serb i Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacisë, si një nga kombet konstitutive të Jugosllavisë, ka të drejtën për vetëvendosje" (Letër e ish-Ministrit të Jashtëm të Serbisë, date 4 tetor 1991, drejtuar Komisionit përmes Lordit Carrington, si Kryetar i Konferencës sa Hagës për Jugosllavinë). Në përgjigje të kësaj pyetjeje, Komisioni në mendimin e cekur si më sipër theksonte, *inter alia*, se "[e] drejta ndërkombëtare nuk i definon konsekuencat precize të së drejtës për vetëvendosje e as caqet e zbatimit të saj" (pika e parë e Mendimit). Në anën tjetër, vazhdonte më tej Komisioni, në po këtë pikë, e drejta për vetëvendosje në asnjë mënyrë nuk nënkupton modifikimin e kufijve ashtu siç kanë qenë ata në momentin e fitimit të pavarësisë, përveç me marrëveshje të përgjithshme. Pika në vijim, pika e dytë, i referohet "identitetit", njohjen e të cilit mr. Blerim Reka e kërkon të vlejë edhe për shqiptarët. Aty është thënë, *ad literam*, për sa vijon: "Në rastet kur ekzistojnë një ose më shumë grupe brenda shtetit, të cilat përbëjnë (paraqesin) një ose më shumë bashkësi etnike, fetare ose gjuhësore, atëherë ato kanë të drejtën e njohjes së identitetit të tyre në bazë të së drejtës ndërkombëtare".

Në mbyllje të këtij mendimi, Komisioni Badinter konkludon: "popullsia serbe e Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacisë ka të drejtën e shfrytëzimit të të gjitha të drejtave të cilat u njihen minoriteteve dhe grupeve etnike mbi bazën e së drejtës ndërkombëtare dhe Projekt-Konventës Ndërkombëtare mbi Jugosllavinë të datës 4 nëntor 1991" (me fjalën Projekt-Konvente mendohet dokumenti i përpiluar prej Lordit Carrington, mbi bazën e së cilës pati qenë bërë edhe plani famoz Z4 për serbët e Kroacisë, për çka në nuk do të diskutojmë më tej).

Komisioni Badinter nuk ka dhënë arsyetime për asnjë prej mendimeve të veta, ashtu që në shkrimet e eksperteve të huaj të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare janë dhënë shpjegime të ndryshme lidhur me njohjen ndërkombëtare (individuale dhe kolektive) të ish-republikave jugosllave. Për disa prej tyre është thënë se i kanë plotësuar të gjitha kushtet e qenies shtet, përkatësisht se kanë krijuar kontrollin efektiv mbi popullsitë dhe territoret e tyre (Sllovenia dhe Kroacia), kurse për tjerat si referencë është marrë fakti i

mosagresionit direkt serb (rasti i Maqedonisë) dhe jo mendimet e Badinterit *per se*. Në rastin e Bosnjë-Hercegovinës, por edhe të Sllovenisë dhe të Kroacisë, njohja ka shërbyer si mjet presioni mbi Serbinë dhe si dëshmi e së drejtës eksterne për vetëvendosje dhe e legjitimitetit të përdorimit të forcës kundër Serbisë me qëllim lehtësimin e zbatimit të parimit të kontrollit efektiv të territorit dhe popullsisë[92]. Sipas po kësaj logjike, tek autorët e huaj është thënë se kërkesa e Kosovës për njohje ndërkombëtare (individuale dhe kolektive), datë 23 dhjetor 1991, nuk është pranuar për shkak të mungesës së kontrollit efektiv të territorit nga ana e strukturave të pushtetit legjitim të Republikës së Kosovës dhe jo pse ajo nuk përmendet nga Komisioni Badinter. Mr. Blerim Reka nxjerr një konkluzion të çuditshëm lidhur me këtë çështje kur thotë se Kosova është sakrifikuar nga Evropa "sipas diktatit personal të presidentit francez Fransua Miteran" dhe për shkak të "ruajtjes së integritetit territorial të Serbisë" (mr. Blerim Reka, fq. 83). Kjo nuk është veçse zhvendosje e fajit tek tjerët. Pikë së pari, integriteti i Serbisë nuk mbrohet nga normat pozitive të së drejtës ndërkombëtare, meqenëse nuk flitet për një shtet të njohur ndërkombëtarisht. E njëjta vlen, *mutatis mutandis*, edhe kur është fjala për të a.q. RFJ (Serbi dhe Mali i Zi), veçanërisht jo nga dispozitat e Kartës së OKB-së, si pasojë e mënyrës së krijimit të kësaj kreature (përdorimi i armatimit dhe forcës fizike të përbashkët të ish-Jugosllavisë dhe pastrimit etnik të popujve tjerë me qellim të krijimit të bazës territoriale si kusht për njohjen e së drejtës për vetëvendosje, interne dhe eksterne, dhe pretendimit (insistimit) të saj në kontinuitet shtetëror-juridik me ish-Jugosllavinë (fiksioni i tyre se Kushtetuta e 27 prillit 1992 është vazhdimësi e asaj të vitit 1974, kurse ish-republikat tjera janë secesioniste). Për këtë do të flitet më vonë, kurse tani, së dyti, vlen të thuhet se konstatimi i mësipërm nuk mund të jetë politikë franceze. Kjo për faktin se Franca është autore e *Pacte sur la stabilité en Europe* [Pakti mbi stabilitetin në Evropë] të Unionit Evropian (gusht 1993), si projekt i përgatitur kohë më parë dhe i cili ka përmbajtur ide krejt unikate, duke mos përjashtuar ndryshimet e kufijve (administrativë dhe të tjerë) në Evropë. Për më tepër, ai i ka inkurajuar ato (ndryshime), ashtu që pas kësaj (pra, pas ndryshimeve) të arrihet njëherë e mirë dhe përfundimisht deri të një "Pakt Evropian", i cili do t'i "bënte të shenjtë" kufijtë e korrigjuar[93]. Së treti, serbët e Bosnje-Hercegovinës ishin pakicë sipas Badinterit dhe çdo kriteri tjetër relavant

[92] Cf. më shumë për këtë në Darko Petrović & Luiggi Condoreli, "L'ONU et la Crise Yugoslave", në *Annuaire Français de Droit International* vol. XXXVIII (Paris, 1992) fq. 32-60.
[93] Kamal S. Shehadi, "Ethnic Self-Determination and the Break-Up of States", në *Adelphi Papers* no. 283 (1993) fq. 75-85.

juridiko-ndërkombëtar, mirëpo Marrëveshja e Dejtonit (1995) i "njohu" si komb. Republika e tyre, "Republika Srpska", ndërkaq, nuk u pranua se është shtet në kuptimin e së drejtës ndërkombëtare, edhe pse kishin kontroll efektiv, për shkak të mënyrës së krijimit të bazës territoriale, siç u përshkrua me sipër. Mosnjohja e entiteteve të tilla sot quhet se ka karakter konstitutiv dhe këtu ka rol të veçantë e drejta ndërkombëtare. Kështu ka qenë rasti edhe me Biafran (Nigeri) dhe Republikën e Turqve të Qipros Veriore (Republika e Qipros), të cilat nuk janë shtete në kuptimin e së drejtës ndërkombëtare, por që mr. Blerim Reka i citon si pro argumentit komparativ "njohjen ndërkombëtare të Kosovës" (fq. 86). Kështu siç themi ne, trajtohen këto lloje të entiteteve sot për sot nga të gjithë autorët e huaj të së drejtës ndërkombëtare, pa asnjë përjashtim. Së fundi, *uti possidetis* nuk është sinonim i integritetit territorial: i pari ka të bëjë me caqet e shtrirjes territoriale të sovranitetit shtetëror në momentin e fitimit të pavarësisë, kurse i dyti me mbrojtjen ndërkombëtare të shteteve si tërësi pasi që ato ta kenë fituar pavarësinë dhe deri në zhdukjen e tyre. Pra, fjala është, në rastin e fundit, për mbrojtjen e shteteve ekzistuese, si shtete sovrane dhe të pavarura. Dhe ky dallim është substancial dhe tejet i madh[94].

Ngatërrimi i parimit *uti possidetis* me integritetin territorial, i suksedimit (trashëgimit) me pavarësinë, siç e bëjnë autorët e librit, nuk është veçse mosdallim i pasojës nga shkaku. Referimi në Kushtetutën e vitit 1974 si bazë për parimin *uti possidetis*, përfshirë këtu edhe rianeksimin e Kosovës më 1989, në një kohë kur pavarësia e Kosovës akoma nuk është ndërkombëtarisht e njohur dhe konfirmuar, pra fjala është për shtet në lindje e sipër (*in statu nascendi*), do të thotë pranim indirekt i tezës serbe për kontinuitetin shtetëror-juridik të kësaj kreature (e a.q. RFJ) me ish-Jugosllavinë, të cilin askush deri më sot nuk e ka njohur si të tillë (kontinuitet). Para se të kalojmë në këtë çështje, shënojmë se një tezë e tillë serbe ka qenë e vlefshme sipas së drejtës ndërkombëtare të kohës vetëm para Luftës së Dytë Botërore, kur *uti possidetis* dhe suksedimi në përgjithësi kanë luajtur rolin e legalizuesve dhe legjitimuesve të të gjitha të drejtave mbi territoret e fituara përmes okupimit ushtarak ose nënshtrimit të të tjerëve. Pra, e kemi fjalën për kohën kur parimi dhe e drejta e vetëvendosjes nuk kanë qenë ndërkombëtarisht të njohur[95].

---

[94] Cf. Rosalyn Higgins, "Postmodern Tribalism and the Right to Secession", në Catherine Brolmann (ed.), *Peoples and Minorities in International Law* (Springer Verlag: New York, 1993) fq. 30-35.

[95] Cf. A.S. Hershy, "The Succession of States", në *American Journal of International Law* vol. 5, no. 2 (1911); Tomas Joseph Lawrence, *Les principes de droit international* (Oxford UP:

4.2. Kontinuiteti

Që nga momenti i formimit të ish-Jugosllavisë si shtet dhe legalizimit të saj në Konferencën e Versajës pas Luftës së Dytë Botërore (1918) e deri në shpërbërjen e saj pas përfundimit të Luftës së Ftohtë (1992), çështja kryesore ka qenë dhe mbetet ajo e kontinuitetit juridiko-ndërkombëtar të Serbisë me ish-Jugosllavinë e para- dhe pas-Luftës së Dytë Botërore.

Argumentet mbi të cilat është bazuar justifikimi serb mbi kontinuitetin shtetëror-juridik, gjithherë sipas së drejtës ndërkombëtare, të Mbretërisë Serbe me ish-Jugosllavinë para Luftës së Dytë Botërore janë tjera nga ato që thuhen sot lidhur me kontinuitetin e të a.q. RFJ (Serbi dhe Mal i Zi) me ish-Jugosllavinë. Arsyeja, motivi dhe rezultati që synohet të arrihet, ndërkaq, janë të njëjtë: ruajtja e titullit juridik-ndërkombëtar për të mbajtur nën sovranitet dhe juridiksion të vetin Kosovën dhe viset tjera shqiptare të okupuara dhe aneksuara më 1912-13. Për këtë do të flasim më vonë. Tani duhet bërë disa sqarime lidhur me statusin juridik-ndërkombëtar të ish-Jugosllavisë (para dhe pas Luftës së Dytë Botërore deri në shpërbërjen e saj më 1992).

Sipas së drejtës ndërkombëtare, ish-Jugosllavia, pra si ajo mbretërore ashtu edhe ajo socialiste, ka qenë subjekt i njëjtë i së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, nisur nga rregulla ndërkombëtare se "shteti ruan, pas formimit të tij, subjektivitetin ndërkombëtar, përkundër ndryshimeve në udhëheqjen e tij, dinastinë, formën e sundimit, rangun dhe titullin, si dhe territorin"[96]. Kjo pikëpamje është mbizotëruese si në teorinë ashtu dhe në praktikën e së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Rrjedhimisht, me formimin e ish-Jugosllavisë, me rregullim mbretëror, pas Luftës së Parë Botërore, ka pushuar së ekzistuari si shtet jo vetëm Mbretëria Serbe, por edhe ajo e Malit të Zi[97]. Këtë mendim, megjithatë, nuk e kanë pasur serbët gjatë gjithë kohës së ish-Jugosllavisë e deri në shpërbërjen e saj më 1991-92, dhe jo vetëm atëherë.

1920) fq. 167-68, 591; Arrigo Cavaglieri, *Lezioni di diritto internazionale*, parte generale (G. Maio: Roma, 1926) fq. 201-216; Karl Strupp, *Elements du droit international public* I (Les ed. internationales: Paris, 1930) fq. 91-110; Paul Fauchille, *Traite de droit international public* tome 1, premier partie (Rousseau et Cie: Paris 1922) fq. 766; Karl Strupp, "Les reg1es générales du droit de la paix", *RCADI* tome 47, I (Paris, 1934) fq. 473-474; Frantz Despagnet, *Cours de droit international public* (Librairie de la Société du Recueil Gal. des Lois et des Arrêts: Paris 1910) fq. 117 -132, 574-575, 579-584; Hersch Lauterpacht, *Oppenheim's International Law* vol. II, 7th ed. (Longman: London, 1952) fq. 598-599; dhe shumë autorë tjerë.

[96] Hersch Lauterpacht, *Oppenheim's International Law*, fq. 148.

[97] Ibid. fq. 150.

Duke mohuar ekzistimin brenda kufijve të atij shteti jo vetëm të kombit shqiptar, por edhe të popujve të tjerë sllavë (teza mbi një popull me tre emra, tri religjione dhe dy alfabete), kryeministri serb Nikolla Pashiq do të pohonte se Kosova dhe viset tjera shqiptare qenë "integruar" (lexo: pushtuar dhe aneksuar) në Mbretërinë Serbe para vitit 1914, ashtu që nuk mund të jenë objekt diskutimi i Konferencës së Paqes në Paris (1920). Në fakt, Pashiqi me këtë mohonte pikëpamjen e Aleatëve të Luftës së Parë Botërore se Jugosllavia ishte shtet i ri. Beogradi preferonte më shumë që Mbretërinë SKS (më vonë Jugosllave) ta shihte si një zgjerim të natyrshëm të Mbretërisë Serbe, duke mos kërkuar asnjë mbështetje në të drejtën ndërkombëtare të kohës. Kjo teori mbi "vazhdimësinë", përkatësisht "kontinuitetin" mes Serbisë dhe Mbretërisë SKS do të frustrojë në vitet e ardhshme shtetin e ri të sllavëve të jugut, nisur nga fakti se me të nxitej problemi krucial, përkatësisht çështja nëse popujt e tjerë joserbë, themelues të atij shteti, duhej të ishin të barabartë me serbët apo duheshin trajtuar vetëm si "vëllezër të vegjël" (më 1917, Pashiqi u kishte thënë përfaqësuesve kroatë dhe sllovenë, si themelues të atij shteti, se mbreti do të ishte gjithnjë i religjionit ortodoks)[98]. U mor vesh, për popujt josllavë as që flitej në kuptim të të drejtave të tyre njerëzore, çfarëdo qofshin ato.

Si bazë legale, ndërkaq, e fiksionit serb se Londra (1913) dhe Versaja (1919) ishin në raport kontinuel e jopërjashtues pati shërbyer neni 12 i Marrëveshjes së Sen-Zhermenit mbi Mbrojtjen e Pakicave, datë 10 shtator 1919, mënyra e lidhjes së Marrëveshjes së Paqes në vitin 1918, si dhe fakti se delagacioni serb kishte marrë pjesë në punimet e Konferencës së Paqes në Versajë, datë 18 janar 1919. Ai "kontinuitet" në marrëdhëniet kontraktuese, mbi bazën e nenit 12 si më sipër, si dhe vetë pjesëmarrja e delegacionit serb në punimet e Konferencës, të cilat merreshin si argumente për "kontinuitetin" juridik-ndërkombëtar të Mbretërisë Serbe me ish-Jugosllavinë e para-Luftës së Dytë Botërore, nuk është nënkuptuar se ekziston automatikisht, siç është rregull ndërkombëtar me rastin e ndërrimit të zakonshëm të qeverive ose të ndryshimeve të vogla territoriale, veçse është arritur me marrëveshje dhe pëlqimin e palëve të reja kontraktuese të Marrëveshjes së Sen-Zhermenit. Në mënyrë të njëjtë, as në planin diplomatik delegacioni serb nuk qe trajtuar si i Mbretërisë Serbe. Pjesëmarrja është toleruar për arsyen se shteti i ri suksesor (trashëgimtar), Mbretëria SKS, nuk ka pasur akoma

[98] Cf. Mark Almond, *Europe's Backyard War: The War in The Balkans* (Heinemann: London 1994) fq. 117.

njohjen ndërkombëtare kolektive, gjë e bërë vetëm më datën 28 qershor 1919 (edhe pse Britania më 1 qershor 1919 dhe Franca më 6 qershor 1919 e kishin njohur si shtet të ri). Mohimi i vlefshmërisë së Marrëveshjes mbi Ekstradimin, të lidhur më 1901 mes ShBA-së dhe Mbretërisë Serbe, mbi bazën e së cilës qe kërkuar dorëzimi i Andria Artukoviqit nga ShBA-ja më 1958 (i akuzuar nga ish-Jugosllavia për krime lufte të kryera në ish-Jugosllavi gjatë Luftës së Dytë Botërore), ka qenë dëshmi e qartë e praktikës ndërkombëtare sipas së cilës suksedimi përfshin jo vetëm sferën e marrëdhënieve kontraktuese, por të gjitha të drejtat, detyrimet dhe marrëdhëniet ndërkombëtare dhe pa marrë parasysh bazën nga burojnë ato. Këtë pikëpamje shkencore lidhur me diskontinuitetin e Mbretërisë Serbe me ish-Jugosllavinë, të para- dhe pas-Luftës së Dytë Botërore, e ka mbrojtur edhe një autor serb, Stevan Gjorgjeviq, në disertacionin e tij të doktoraturës me titull *Mbi kontinuitetin e shteteve me vështrim të veçantë në kontinuitetin juridiko-ndërkombëtar të Mbretërisë Jugosllave dhe Republikës Federative të Jugosllavisë* (Beograd, 1967).

Të njëjtën logjikë Serbia e ka ndjekur edhe pas shpërbërjes definitive të ish-Jugosllavisë (1991-1992), gjë që shihet edhe nga shkrimet e autorëve me ndikim serbë të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, si dhe vetë praktika e veprimit të të a.q. RFJ (Serbi-Mali i Zi)[99]. Bashkësia ndërkombëtare, siç e thashë më herët, nuk e ka pranuar një gjë të tillë, kurse nga autorët e huaj është vetëm një, Yehuda Blum (Jehuda Blum), i cili pak a shumë ka ndjekur logjikën serbe të argumentimit në një shkrim të tij të botuar në *American Journal of International Law* [Ditari amerikan i së drejtës ndërkombëtare] (vol. 86, no. 4/93), me titull "UN Membership of 'New' Yugoslavia: Continuity or Break?" ["Anëtarësia në OKB e Jugosllavisë 'së re': vijimësi apo ndërprerje?"].

Cilat janë arsyet e sotshme mbi të cilat bazohet logjika serbe si më sipër? Së pari, të bindur se aktualisht nuk ka rregulla mbi suksedimin (trashëgimin) e anëtarësisë në organizata ndërkombëtare (krahaso: neni 4/1 i Konventës së Vjenës mbi Trashëgimin e Shteteve në Raport me Marrëveshjet Ndërkombëtare e datës 22 gusht 1978), e a.q. RFJ (Serbi-Mali i Zi) mosheqjen e flamurit dhe shenjave të ish-Jugosllavisë nga objektet fizike të OKB-së e ka kuptuar si sinjal në favor të legalizimit dhe legjitimimit të kontinuitetit shtetëror të saj

[99] Cf. Milenko Kreca, "A Few Remarks About the Continuity of FR Yugoslavia"; Ljubivoje Ačimović, "Continuity of International Legal Personality of Yugoslavia and Its Membership in the United Nations"; Konstandin Obradović, "Again on the Problem of Continuity — Is FR Yugoslavia 'Old' or 'New' State?". Të gjitha këto shkrime janë botuar në revistën beogradase *Medjunarodni Problemi* nr. 3 (IMPP, 1994) fq. 399-436.

me ish-Jugosllavinë, lidhur me anëtarësinë e mëtutjeshme në OKB. Mirëpo, siç thotë Ove Bring në polemikën e tij ndaj shkrimit të cekur të Y. Blumit, çështjet e mësipërme, pra "emri dhe flamuri i RFJ (Serbi dhe Mali i Zi) nuk janë të njëjtë me ato të një ish-anëtari të OKB-së, i cili nuk ekziston më, por, i një tjetri, i cili, tani për tani, është subjekt i padefinuar i së drejtës ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e të cilit tolerohen nëpër hapësirën fizike të objekteve të OKB-së"[100].

Së dyti, parimi sipas së cilit përcaktohet dallimi mes kontinuitetit (vazhdimësisë) shtetëror-juridik dhe suksesionit (trashëgimit) në të drejtën ndërkombëtare ka karakterin e politikës legale. Sipas këtij parimi, nëse vlerësohet se ekziston kontinuiteti (vazhdimësia) dhe identiteti i njëjti shtetëror, atëherë subjektiviteti legal dhe të drejtat e detyrimet mbesin të njëjta. Në anën tjetër, kur vlerësohet se ekziston suksedimi (trashëgimia) i shtetit të dhënë, atëherë shteti i ri duhet patjetër të kalojë nëpër procesin e përshtatjes legale kundruall shteteve të tjera. Problemi qëndron se, aktualisht, nuk ka asnjë normë (rregull) ndërkombëtare operative, e cila do të përcaktonte se kur bëhet fjalë për kontinuitet e kur për diskontinuitet. Ky fakt ka forcuar logjikën serbe se, në një mungesë të tillë, çështjet e (dis)kontinuitetit të saj me ish-Jugosllavinë do të vendosen në favor të saj në mënyrë arbitrare. Mirëpo, logjika serbe ka harruar se një vakum i tillë juridik plotësohet përmes praktikës së veprimit të shteteve dhe *opinio juris*, i cili krijohet në rastet e ndryshimeve në statusin territorial të shteteve ekzistuese. Kjo praktikë ka qenë konsistente lidhur me çështjen e kontinuitetit të ish-Jugosllavisë, gjë që ka krijuar një *opinio juris* konstant — mosnjohjen e kontinuitetit të kësaj kreature me ish-Jugosllavinë, duke u nisur që nga fillimi i krizës (deklaratat e BE-së, tani UE, lidhur me trendet e krizës në gusht të vitit 1991), formimi dhe mendimet e Komisionit Badinter dhe Konferencës për ish-Jugosllavinë e deri tek lindja e konceptit "muri i jashtëm i sanksioneve" (pas arritjes së Marrëveshjes së Dejtonit në nëntor të vitit 1995).

Së fundi, nisur nga vakumi i cekur legal, Serbia ka shpresuar se mund të imitojë Federatën Ruse, së cilës i është njohur kontinuiteti me ish-BRSS-në dhe atë kryesisht në sferën e marrëdhënieve kontraktuese. Fakte vendimtare në njohjen e këtij kontinuiteti kanë qenë territori i mbetur, popullsia, përfaqësueshmëria juridiko-politike (titulli legal) dhe fuqia e mbetur nukleare.

---

[100] Ove Bring, "Correspondents's Agora: UN Membership of the Former Yugosllavia — Letters to the Editor in Chief", në *American Journal of International Law* vol. 87, no. 2 (1993) fq. 45.

Këta faktorë nuk i ka poseduar e a.q. RFJ (Serbi-Mali i Zi), andaj edhe ka dështuar paralelja me Federatën Ruse. Mosnjohja e të a.q. RFJ (Serbi dhe Mali i Zi) si kontinuitet (vazhdimësi) i ish-Jugosllavisë është bërë për arsye se, në mes tjerash, kësaj i ka munguar përfaqësueshmëria (titulli legal) historiko-territorial. E formuar më 1918 dhe e ridefinuar më 1939, 1946, 1963 dhe 1974, ish-Jugosllavia me njohjen ndërkombëtare të Sllovenisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë dhe Maqedonisë ka pushuar së ekzistuari, ashtu që Beogradi nuk paraqet më qeverinë e cila ka përfaqësuar subjektin e mëparshëm ndërkombëtar, që përfshinte në vete grupe të ndryshme etnike, regjione dhe territore.

Nga ky shqyrtim si më sipër, shpresojmë se është e qartë se çdo tentim për të justifikuar dhe bazuar të drejtën e Kosovës dhe popullit të saj për vetëvendosje, si dhe çdo të drejtë tjetër të shqiptarëve, mbi bazën e Kushtetutës së ish-Jugosllavisë të vitit 1974 është i barasvlefshëm me synimet dhe logjikën e sipërcekur të te a.q. RFJ (Serbi-Mali i ZI).

4.3. Baza juridiko-ndërkombëtare e vetëvendosjes së Kosovës dhe popullit të saj

Që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore e deri më sot problemi kryesor, teorik dhe praktik, ka qenë dhe mbetet ai i titullarëve të së drejtës për vetëvendosje, si dhe mënyrës së realizimit të kësaj së drejte. Pa marrë parasysh interpretimet e ndryshme doktrinare, e qartë është se nga tërësia e normave (rregullave) juridiko-ndërkombëtare mbi vetëvendosjen, si parim dhe si e drejtë duke filluar që nga Karta e OKB-së (1945) e deri te Dokumenti dhe Programi i Veprimit (Vjenë, 1993) mund të nxirret përfundimi se kush janë titullarët e vetëvendosjes. Në disa raste, këto norma (rregulla) flasin për "*popujt kolonialë*", përkatësisht për popujt që jetojnë në territoret e sunduara nga shtete metropole. Në të tjerat raste, normat (rregullat) ndërkombëtare flasin për "*popujt nën dominim (okupim) të jashtëm ushtarak dhe okupim tjetër*", përkatësisht për popujt që jetojnë në territoret e nënshtruara ushtarakisht. Disa prej normave (rregullave) iu referohen "*grupeve etnike ose racore*" që jetojnë brenda shteteve ekzistuese. Të fundit janë normat (rregullat) ndërkombëtare që flasin për të drejtën në "*qeverisje demokratike të shtetit*" (në emër dhe për dobi) të tërë popullsisë, pa asnjë dallim. Lidhur me kategorinë e fundit të titullarëve të vetëvendosjes, të përcaktuar nga dispozitat e dy neneve të para të Konventave të OKB-së mbi të Drejtat e Njeriut të vitit 1966, duhet

thënë ca fjalë ngaqë lidhet me çështjen tonë, për të kaluar më vonë më konkretisht mbi kategorinë e cila ka të bëjë me Kosovën dhe popullsinë e saj.

Normat (rregullat) e së drejtës ndërkombëtare (zakonore dhe kontraktuese) nuk kanë çka të thonë, ose kanë fare pak, lidhur me mënyrat e mundshme të zbatimit të qeverisjes demokratike të shtetit. Po kështu, e drejta ndërkombëtare (zakonore dhe kontraktuese) nuk parashikon vijat udhëheqëse mbi mënyrat e mundshme të distribuimit të pushtetit mes njësive ose regjioneve të institucionalizuara brenda shteteve ekzistuese. Dhe, së fundi, e drejta ndërkombëtare (zakonore dhe kontraktuese) fare nuk cakton standarde të vlefshme lidhur me mënyrat e realizimit të së drejtës interne për vetëvendosje, siç janë bartja e pushtetit, autonomia, apo vetëqeverisja regjionale (lokale). Me fjalë të tjera, në rastin e fundit, "e drejta federale" për vetëvendosje nuk ekziston[101], pa marrë parasysh kritikat drejtuar Badinterit se "Komisioni, sidoqoftë, ka pasur mundësi që të parashikojë një metode unike për sa i përket mekanizmit të shpërbërjes së shteteve me rregullim federativ"[102]. Rolit të së drejtës së brendshme (kushtetuta dhe ligjet) do t'i kthehemi serish.

Kjo gjendje e së drejtës ndërkombëtare ka ekzistuar gjatë kohës së Luftës së Ftohtë dhe pas saj. Kështu është akoma edhe sot. Çështja është se Lufta e Ftohtë "ngriu" kufijtë e shteteve të Evropës Lindore dhe Qendrore, kurse përmes procesit të dekolonizimit kontrolloi krijimin e shteteve të reja. Konfliktet lidhur me vetëvendosjen dhe mënyrat e realizimit të saj nuk u zhdukën, ashtu që me përfundimin e saj lindi fenomeni tipik postkolonial: shpërbërja e shteteve sovrane dhe të pavarura si pasojë e jolegjitimitetit të sistemeve politike të brendshme, përkatësisht e papranueshmërisë së këtyre sistemeve represive dhe totalitare nga e tërë popullsia[103]. Reagimet e bashkësisë ndër-

---

[101] Cf. Otto Kimminich, "A 'Federal' Right of Self-Determination ?", fq. 84-87, 100; Gudmundur Alfredson, "Different Forms and Claims to the Right of Self-Determination", fq. 61-64; Patric Thornbery, "The Democratic or Internal Aspect of Self-Determination with some Remarks on Federalism", në Christian Tomuschat, *Modern Law of Self-Determination*, fq. 101-138.

[102] Cf. Martha Rady, "Self-Determination and the Disolution of Yugoslavia", në *Ethnic and Racial Studies* vol. 19, no. 2 (1996) fq. 387.

[103] Kamal S. Shehadi, ibid. fq. 21-22; Christian Tomuchat, ibid. fq. 1-20; Thomas Franck, "Legitimacy in the International System", në *American Journal of International Law* vol. 82, no. 4 (1988); Thomas Franck, "Intervention Against Illegitimate Regimes", në Lori Fisler Damrosch and David J. Scheffer (eds.) *Law and Force in the New International Order* (Westview Press: USA, 1991) fq. 159-177; Thomas Franck, "The Emerging Right to Democratic Governance", në *American Journal of International Law* vol. 86, no. 1 (1992); Igor I. Lukashuk, "The UN and Illegitimate Regimes: When to Intervene to Protect Human Rights", në Damrosch and Scheffer (eds.), vep. cit., fq. 143-159.

kombëtare, ndërkaq, ndaj këtij fenomeni dalluan mjaft nga ato të viteve 1945-1990, me përjashtim të rastit të pavarësimit të Bangladeshit nga Pakistani (1970-71), përkundër faktit se e drejta ndërkombëtare dhe organizatat kishin ndryshuar fare pak në pikëpamje strukturale.

"E drejta federale" për vetëvendosje, siç e thamë, nuk ekziston dhe as që ka ekzistuar ndonjëherë. Me fjalë tjera, e drejta e brendshme (kushtetuta dhe ligjet) nuk janë dhe as që kanë qenë baza e së drejtës për vetëvendosjen e popujve pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Ajo ka shërbyer dhe shërben vetëm si lehtësues në lokalizimin e popujve me bazë territoriale, pra jo se e drejta ndërkombëtare i ka njohur ose i njeh asaj (së drejtës së brendshme) vlerën e bazës juridike të së drejtës për vetëvendosje. Veprimi i forcave centrifugale dhe i retorikës politike të grupeve etnike me bazë territoriale, të mbështetura dhe inspiruara nga filozofia politike e vetëvendosjes, si baza e të gjitha standardeve dhe normave (rregullave) pozitive ndërkombëtare, janë aktivizuar kryekëput nga shkaku i paaftësisë së ish-regjimeve totalitare komuniste për transformime demokratike dhe paqësore. Shkëputja (secesioni) nga këto regjime totalitare dhe represive i grupeve etnike me bazë territoriale as që u parashikua dhe as që u ndalua nga e drejta ndërkombëtare e kohës. Kështu është edhe sot[104].

Veprimi i forcave centrifugale, në disa raste pati për pasojë shpërbërjen totale të shteteve ekzistuese (ish-Jugosllavia dhe Çekosllovakia), kurse në tjerat vetëm zvogëlimin e sovranitetit territorial. Dhuna dhe marrëveshja, ndërkaq, ishin dy ekstreme përmes së cilave u arrit realizimi i së drejtës për vetëvendosje. Në rastin e ish-BRSS-së dhe Çekosllovakisë realizimi i kësaj së drejtë u bë në mënyrë relativisht të qetë, kurse në rastin e ish-Jugosllavisë realizimi i kësaj së drejte shkaktoi tragjedi njerëzore që Evropa nuk e mbante që nga mbarimi i Luftës se Dytë Botërore. Si në rastin e parë, ashtu edhe në të dytin, parimi i vetëvendosjes ("shprehja e vullnetit të lire të popullit") shërbeu si mjet plotësues për identifikimin e titullarëve (subjekteve) të vetëvendosjes në ish-federatat socialiste[105]. Mbajtja e referendumeve për pavarësi nga ana e grupeve etnike me bazë territoriale i shërbeu këtij qëllimi, ndërsa në rastet kur baza territoriale u krijua përmes kryerjes së krimeve kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare, popujve të tillë iu mohua e drejta eksterne për vetëvendosje (p.sh., "Republika Srpska" dhe Nagorno-Karabah). E drejta

[104] Antonio Cassese (1994) fq. 118-20, 122-124; Rodolfo Stavenhagen, "Self-Determination: Right or Demon?" në Donald Clark & Robert Williamson (eds.), ibid. fq. 1-8.
[105] Antonio Cassese, *Self-Determination of Peoples: A Legal Reappraisal* (Cambridge UP: Cambridge, 1996) fq. 319-320.

ndërkombëtare dhe rregullat e saj, në rastet si më sipër, shërbyen si frenues duke imponuar në shtetet ekzistuese detyrimin e mosnjohjes së entiteteve të tilla, me pushtet efektiv, por që bazën territoriale e kishin krijuar përmes pastrimit etnik të popujve të tjerë. Jashtë këtyre rasteve përdorimi i dhunës u quajt si i ligjshëm dhe legjitim. Kështu është edhe sot.

Kosova dhe populli i saj, prandaj, kanë qenë dëshmitarë dhe pjesëmarrës i këtij procesi, janë inspiruar nga po ato ideale të lirisë si edhe popujt tjerë por assesi në statusin e tyre të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974. Si pasojë e veprimit të forcave centrifugale brenda ish-Jugosllavisë ka ndodhur shpërbërja e atij shteti. Kjo është fazë e re dhe inspirimi ynë duhet të jetë lirimi nga okupimi e jo arsyetimi i pozitës sonë sipas Kushtetutës së vitit 1974. Pas shpërbërjes së atij shteti, prania serbe aty, pa asnjë titull legal sipas së drejtës ndërkombëtare, është prani e një force të huaj, e cila ka qëllim pengimin e funksionimit të institucioneve legale dhe legjitime të sistemit në Kosovë, të dala nga vullneti origjiner i popullsisë shumicë e jo nga ndonjë ide fikse e njëfarë kontinuiteti me Kuvendin e Prizerenit (1945) apo Kushtetutën e vitit 1974 dhe ngjarjet që lidhen me të.

Kosova bie në kategorinë e mësipërme të territoreve dhe popujve nën okupim (dominim) të huaj ushtarak (dhe tjetër), ashtu siç përcaktohet me Deklaratën e OKB-së të vitit 1970 mbi Parimet e së drejtës Ndërkombëtare në Lidhje me Marrëdhëniet Miqësore dhe Bashkëpunimin mes Shteteve në Pajtim me Kartën e OKB-së (GA Rez. 2625 XXVI, 24 dhjetor 1970), për faktin se Serbisë i mungon titulli legal mbi Kosovën, sigurisht jo ai i përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974 ose Kuvendin e Prizerenit (1945). Serbia e ka humbur titullin juridik-ndërkombëtar mbi Kosovën dy herë: herën e parë kur është formuar ish-Jugosllavia (pas Luftës së Parë Botërore, së bashku me humbjen e qenies shtetërore të Malit të Zi) dhe, se fundi, kur është shpërbërë ish-Jugosllavia, si titullar i vetëm juridiko-ndërkombëtar i të gjithë popujve dhe territoreve nën ish-Jugosllavi. Që nga ky moment e tutje, titulli legal i takon Kosovës dhe popullit të saj mbi bazën e veprimit të parimit të vetëvendosjes, ashtu siç ka ndodhur me rastin *par exellence* të okupimit të territoreve arabe nga Izraeli pas luftës triditëshe arabo-izraelite më 1967. Në këtë rast, që ndryshe quhet edhe "okupim i zgjatur", Izraeli pati okupuar territoret palestineze, të cilat nuk ishin nën sovranitetin dhe juridiksionin as të Egjiptit dhe as të Jordanisë, por të Britanisë së Madhe si shtet administrator i Mandatit mbi Palestinën (fjala është për territoret e Bregut Perëndimor dhe Rripit të

Gazës)[106]. Në këtë rast, as vendet arabe, por as Izraeli pas vitit 1967, nuk kanë pretenduar se janë bartës (titullarë) të sovranitetit mbi këto territore: mbajtja e tyre qe justifikuar, nga dy palët, për arsye sigurie, kurse bashkësia ndërkombëtare kurrë nuk ka pranuar legalizimin dhe legjitimimin e titullit juridik sovran të vendeve të sipërcekura arabe, përkatësisht të Izraelit. Kështu edhe lindi koncepti legal i së drejtës për vetëvendosje të popujve nën okupim (dominim) të huaj (ushtarak dhe tjetër) në Deklaratën e cekur të OKB-së të vitit 1970, kurse lirimi nga okupimi (dominimi i huaj) u quajt si mënyra e vetme e realizimit të së drejtës për vetëvendosje të popujve dhe territoreve nën okupim (dominim) të huaj ushtarak (dhe tjetër)[107]. Dallimi i vetëm në rastin tonë është se Serbia nuk pranon se fjala është për okupim, për arsyet qe do t'i japim më pastaj. Sidoqoftë, kjo pozitë e jona legale dhe faktike duhet të jetë inspirimi i të gjithë neve dhe jo ndonjë tjetër dispozitë e përcaktuar gjatë ish-Jugosllavisë. U mor vesh, këtu nuk bëhet fjalë për aktet tona burimore, të nxjerra gjatë procesit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe pas përfundimit të tij (Deklarata e 2 Korrikut, Kushtetuta e 7 Shtatorit, referendumi për pavarësi dhe zgjedhjet e lira).

Edhe autorët e librit pajtohen se fjala është për okupim të Kosovës, ashtu siç kuptohet ai në të drejtën ndërkombëtare pozitive. Mirëpo, problemi qëndron në arsyetimet e tyre tërësisht të gabuara, të cilat edhe mund ta vejnë në dyshim një gjë të tillë. Kështu, autorët theksojnë që fakti se Kosova është aneksuar më 1945 dhe pastaj rianeksuar në mënyrë "kundërkushtetuese më 1989" janë të mjaftueshëm si bazë për revokimin e së drejtës për vetëvendosje apo rikthim në gjendjen e mëparshme (cf. dr. Esat Stavileci, fq. 28; mr. Blerim Reka, fq. 69; dr. Arsim Bajrami, fq. 103; etj.). Lituania, Letonia dhe Estonia citohen në favor të argumentit të sipërpërmendur, u mor vesh në emër të përvojës krahasuese (mr. Blerim Reka, fq. 63), pa qenë të vetëdijshëm se ato kanë qenë shtete sovrane dhe të pavarura, ndërkombëtarisht të njohura dhe anëtare të Lidhjes së Kombeve, pra me titull të plotë juridik-ndërkombëtar, në momentin e aneksimit të tyre në bazë të Paktit Molotov–Ribbentrop (1939). Shtetet Baltike nuk janë krijuar më 1990-91, ashtu siç është rasti me

---

[106] Cf. Eyal Benvenisti, *The International Law of Occupation* (Princeton UP: N.J., 1993) fq. 107-109; Hans-Peter Gasser, "The Geneva Conventions and the Autonomous Territories in the Middle East", *Security Dialogue* vol. 26, no. 2 (June 1995) fq. 173-181; R. Shehadeh, "The Geneva Conventions and the Autonomous Territories in the Middle East", *Security Dialogue* vol. 26, no. 2 (June 1995) fq. 181-185; Yram Dinstein, "Autonomy and Legal Status: A Rejoinder", *Security Dialogue* vol. 26, no. 2 (June 1995) fq. 185-191.

[107] Cf. Antonio Cassese (1996) fq. 44-46; Gudmundur Alfredson, ibid. fq. 61.

fillimin e procesit të krijimit të Republikës së Kosovës, si shtet në lindje e sipër (*in statu nascendi*). Fjala është për restaurim të pavarësisë shtetërore pas një kohe të një okupimi të zgjatur nga ish-BRSS, gjë që shihet edhe nga mënyra e formulimit të Deklaratës së Unionit Evropian (atëherë BE), datë 27 gusht 1991, lidhur me këtë rast: "Bashkësia Evropiane dhe shtetet anëtare mirëpritën restaurimin e sovranitetit dhe të pavarësisë se Shteteve Baltike, të cilat i humbën ato më 1940"[108].

Në rastin e Kosovës, ndërkaq, fjala është për imponime të statuseve legale në një kohë kur parimi i vetëvendosjes në të drejtën ndërkombëtare ka qenë i barasvlefshëm me konceptin e vetëvendosjes së shteteve ekzistuese (gjatë dhe menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore) apo, se ai ka vlejtur vetëm për kategoritë e cekura më herët të popujve dhe territoreve (pas vitit 1950 e deri në përfundim të Luftës së Ftohtë, e cila kishte "ngrirë" kufijtë e Evropës). Përveç kësaj, Serbia nuk ka qenë dhe nuk është shtet akoma, ashtu siç kuptohet ai në të drejtën pozitive ndërkombëtare. Ajo ka qenë hegjemon, ashtu si edhe Rusia. Ato kanë dhënë kontribut të veçantë për krijimin e ish-sistemeve represive dhe jo legjitime komuniste, të cilat janë zhdukur në një moment të dhënë historik — me mbarimin e Luftës së Ftohtë. Jam kurioz të di se çka do të thotë praktikisht teza e autorëve, si më sipër, për kthim në gjendje të mëparshme dhe revokim të vetëvendosjes, në dy rastet duke u bazuar në Kuvendin e Prizerenit (1945) dhe Kuvendin e vitit (1989)?!

Përveç rastit të mësipërm, rastet tjera të okupimit të zgjatur janë edhe ato të ish-RD të Gjermanisë, Kamboxhias, Saharasë Perëndimore (ky i fundit akoma i pazgjidhur), Afganistanit etj. etj.[109]. Këto quhen si "okupim i zgjatur ushtarak" për faktin se okupimi, si kontroll efektiv i pushtetit mbi një territor të caktuar për të cilin pushteti okupues nuk ka titull juridik-ndërkombëtar dhe e ushtron atë pa vullnetin e sovranit të atij territori, është i natyrës së përkohshme dhe faktike, ashtu që nuk prodhon asnjë pasojë legale në sensin e bartjes së territorit dhe popullsisë përmes forcës ose kërcënimit me forcë ushtarake[110].

Janë dy shkaqe pse Serbia nuk pranon, ashtu siç ka ndodhur edhe me shtetet e tjera okupuese në rastet e "okupimeve të zgjatura" (përveç Izraelit)

---

[108] Teksti i plotë në "United Kingdom Materials on International Law", *British Yearbook of International Law* 62 (1991) fq. 558; Shih edhe Malcolm Shaw, ibid. fq. 56-57; njëjtë edhe tek të gjithë autorët e tjerë, të cilët janë përdorur në këtë shkrim.

[109] Cf. Adam Roberts, "Prolonged Military Occupation: The Israeli-Occupied Territories Since 1967", *American Journal of International Law* vol. 84 (1990) fq. 44-103.

[110] Cf. Eyal Benvensiti, ibid. fq. 4-5.

se fjala është për okupim klasik të Kosovës dhe të popullit të saj, gjë që dëshmohet edhe për nga mënyra se si e sundon Kosovën dhe popullsinë e saj (sistemi i guvernatorëve, si tipik për regjimet okupuese). Shkaku i parë është ndërkombëtar dhe bazohet në dokumentet vijuese: qëndrimet e UE-së (dikur BE-ja) qysh në fillim të krizës në ish-Jugosllavi; Mendimi nr.10 i Komisionit Badinter i datës 10 korrik 1992; Rezoluta nr. 757 (1992) e Këshillit të Sigurimit të OKB-së; Rezoluta nr. 777 (1992) e Këshillit të Sigurimit të OKB-së; dhe Rezoluta nr.47/1 (1992) e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Mbi bazën e këtyre dokumenteve, Fondi Monetar Ndërkombëtar pati deklaruar më 15 dhjetor 1992 se "Jugosllavia ka pushuar se ekzistuari dhe, rrjedhimisht, edhe së qeni anëtare e FMN-së", kurse më 25 shkurt 1993, drejtorët ekzekutivë të Bankës Botërore përcaktuan se Jugosllavia ka pushuar se ekzistuari. Mesazhi i këtyre dokumenteve ka qenë dhe është, tani për tani, se ish-Jugosllavia ka pushuar së ekzistuari, por që e a.q. RFJ (Serbi dhe Mali i Zi) është shtet i ri dhe njohja ndërkombëtare kolektive e saj nuk është bërë deri më sot për arsye të politikës së rritjes territoriale me dhunë dhe pastrimit etnik të popujve të tjerë të ish-Jugosllavisë.

Gjithashtu, një njohje e tillë nuk është bërë edhe për arsye të mos zbatimit të normave ndërkombëtare qe kanë të bëjnë me garantimin e të drejtave të minoriteteve etnike, fetare dhe gjuhësore[111]. Ky *opinio juris* dhe kjo praktikë e veprimit të shteteve anëtare të bashkësisë ndërkombëtare ka qenë baza e sanksioneve të KS të OKB-së kundër të a.q. RFJ (Serbi dhe Mali i Zi) (1992-1995) dhe e "murit të jashtëm të sanksioneve" (kjo e fundit nën mbikëqyrjen e vetëm të një shteti, ShBA-së, pas arritjes së Marrëveshjes së Dejtonit në nëntor të vitit 1995). Njohja ndërkombëtare individuale, ndërkaq, e të a.q. RFJ (Serbi-Mali i Zi), e bërë pas arritjes së Marrëveshjes së Dejtonit (1995), në sensin e ngritjes së nivelit të marrëdhënieve diplomatike me regjimin në Beograd, nuk do të thotë se është pranuar vazhdimësia (kontinuiteti) i kësaj kreature me ish-Jugosllavinë. Krejt çka do të thotë, i referohet faktit se bashkësia ndërkombëtare ka pranuar legalizimin dhe legjitimimin, deri në një masë të caktuar, të politikës së dhunës dhe pastrimit etnik dhe okupimit të territoreve mbi të cilat Serbia dhe serbët nuk kanë dhe as që kanë pasur titull juridik të vlefshëm. Kjo është arsyeja pse Serbia nuk pranon gjendjen e okup-

[111] Cf. Vladimir D. Degan, "Correspondent's Agora: UN Membership of the Former Yugoslavia. Letters to the editor in Chief", *American Journal of International Law* vol. 87, no. 2 (April 1993); Rein Mullerson, "The Continuity and Succession of States by Reference to the Former USSR and Yugoslavia", *International and Comparative Law Quarterly* vol. 42, part 3 (July 1993).

imit në Kosovë: fakti se ajo nuk është pranuar si vazhdimësi (kontinuitet) i ish-Jugosllavisë nuk do të thotë se nuk mund të njihet kolektivisht si shtet i ri, duke marrë me vete me forcën e armës edhe Kosovën dhe popullin e saj shumicë. Në këtë llogarit Serbia.

Shkaku i dytë është i brendshëm dhe ka të bëjë me sjelljet e popullsisë shumicë në Kosovë. Në okupim dhe gjatë tërë kohës sa zgjat ai, popullsia duhet të sillet konform gjendjes së okupimit, përkatësisht të dëshmojë qartas dhe hapur pakënaqësinë e tij me gjendjen e tillë faktike në çdo sferë të jetës. Kjo është çështje e klasës politike në Kosovë dhe çdo elaborim i mëtutjeshëm i modaliteteve të sjelljes nën okupim i kalon caqet e këtij shkrimi. Mirëpo, këtu kanë rol edhe juristët në masën që nuk është dashur dhe as që duhet të kërkohet "kushtetutshmëri dhe ligjshmëri" para syve të botës kur është fjala për zbatimin e akteve dhe veprimeve serbe në Kosove, të cilat kanë për pasojë cenimin e të drejtave të njeriut të popullsisë shumicë (popullit shqiptar). Me rëndësi është, siç e thashë, se ato, mjerisht, po shkelen çdo ditë dhe si të tilla evidentohen me një zell të veçantë dhe disiplinë nga subjektet politik kompetent në Kosovë.

Çështja e "kundërkushtetutshmërisë dhe kundërligjshmërisë" së veprimeve dhe akteve serbe, jolegale dhe jolegjitime sipas së drejtës ndërkombëtare, zbatimi i të cilave ka për pasojë cenimin e të drejtave të njeriut *en masse* në Kosovë, nuk është veçse çështje sovraniteti shtetëror serb mbi Kosovën. Marrja me këtë çështje është baras me legalizimin dhe legjitimin e okupimit serb të Kosovës dhe sovranitetit të saj shtetëror. Prandaj, i quaj tërësisht të gabuara bazat e së drejtës për vetëvendosje të Kosovës dhe popullit të saj, ashtu siç janë dhënë në librin e autorëve të cekur, të cilat bazohen mbi "kundërkushtetutshmërinë dhe kundërligjshmërinë" e akteve dhe veprimeve serbe dhe "shkeljen sistematike të të drejtave të njeriut të shqiptarëve".

Legalizimi dhe legjitimimi eventual juridiko-ndërkombëtar i sovranitetit serb mbi Kosovën, për arsye të shkaqeve si më sipër, do ta kthente Kosovën dhe statusin e saj juridiko-politik në vitin 1918 e jo më 1989, kurse e drejta e popullit nën okupim ushtarak për çlirim nga ai okupim, ashtu siç kuptohet sot në të drejtën ndërkombëtare, do të reduktohej në të drejtën interne për vetëvendosje brenda sistemit juridiko-politik serb, përkatësisht "jugosllav". Kujdesi për të drejtat e njeriut është universal dhe përfshin edhe territoret nën okupim ose që janë në luftë e sipër. I tillë ka qenë rasti me Bosnjë-Hercegovinën dhe Kroacinë, apo, më herët, me territoret arabe nën pushtimin e Izraelit, rasti i Afganistanit, Kamboxhias, etj. etj. Mirëpo, në rastin e Kosovës ai kujdes është duke u abuzuar dhe keqkuptuar nga bashkësia ndërko-

mbëtare dhe vetë ne për arsyet që i dhamë, dhe si i tillë ka për qëllim futjen graduale të Kosovës nën sovranitetin shtetëror të të a.q. RFJ (Serbi-Mali i Zi), përkatësisht ka për qëllim krijimin e një titulli të ri juridiko-ndërkombëtar të sovranitetit shtetëror të kësaj kreature mbi Kosovën dhe popullin e saj. Këtë duhet penguar!? Këtij qëllimi duhet t'i shërbejë edhe shkenca juridike kosovare.

Përfundimi

1.

Mesazhi që synohet të bartet tek lexuesi përmes këtij libri ka të bëjë me argumentimin shkencor të së drejtës për vetëvendosje të Kosovës dhe popullit të saj. Autori i këtyre rreshtave nuk ka vërejtur se realisht ekziston një argumentim i tillë i kësaj çështje. Ajo që kemi vërejtur, ndërkaq, i referohet vetëm faktit të gatishmërisë dhe vullnetit të mirë të autorëve të librit për t'u përpjekur për të gjetur një arsyetim të pavarësisë se Kosovës, dhe asgjë tjetër. Si një përpjekje shkencore, ndërkaq, e quaj të dështuar tërësisht dhe, siç, thotë proverbi amerikan, gatishmëria dhe vullneti i mirë dinë të jenë nganjëherë edhe rrugë e sigurt për në ferr, sepse "djalli gjendet në imtësi".

Nga leximi i librit fitohet përshtypja se më tepër ka trajtime gjysmake historiko-politike se sa juridike dhe, kur është fjala për këto të fundit, autorët kanë përdorur nocione që nuk i korrespondojnë shkencës juridike, ose, edhe kur janë përdorur, arsyetimi i tyre është mjaft i zbehtë dhe jashtë kontekstit të cilin pretendojnë ta përfshijnë. Sigurisht që edhe fati i literaturës së huaj, të përdorur në libër, nuk ka qenë më i mirë. Në disa raste kemi vërejtur se kjo nuk përputhet me mendimet e autorëve të librit apo, në rastet tjera, ajo fare nuk e ka atë përmbajtje të cilën autorët e pohojnë. Mirëpo, këto çështje nuk i kemi shtjelluar në këtë shkrim. Ajo çka kemi shtjelluar ka të bëjë me atë që e cekëm më sipër, përkatësisht me përdorimin e koncepteve të gabuara. Në mesin e tyre është ai i Vilajetit të Kosovës si status *sui generis* konfederal, gjithherë sipas autorëve, pastaj, edhe i të gjitha statuseve juridiko-politike të Kosovës dhe shqiptarëve në trojet e tyre etnike deri më 1990. Vetë këto, si dhe konceptet me të cilat janë arsyetuar, janë tërësisht të gabuara. Të një natyre të tillë janë fjala vjen ai i parimit *uti possidetis*, suksedimi (trashëgimi), okupimi etj. Një përdorim i tillë i gabuar nuk është veçse pasojë e moskuptimit, nga ana e autorëve, të dallimit mes së drejtës për vetëvendosje dhe form-

ave të manifestimit të saj dhe konceptit të qenies shtet (ang. *statehood*) në të drejtën ndërkombëtare.

2.

Identiteti socio-politik dhe fizik i Kosovës, historikisht shikuar, është një identitet i imponuar nga të huajt. Një ka qenë i tillë që nga Vilajeti i Kosovës e deri në përfundimin e Luftës së Ftohtë. Sistemi i vilajeteve në Perandorinë Osmane nuk ka asgjë të përbashkët me konceptin (kon)federal. Ai është krijuar me të vetmin qëllim dhe pikërisht për ruajtjen dhe sigurimin e jetës së vetë perandorisë. Ai ka qenë antipod i konfederalizmit dhe është efekt refleksiv i raportit të forcave brenda dhe jashtë Perandorisë Osmane. Natyra e tij nuk mund të shpjegohet me koncepte legale, veçanërisht jo me barazimin e tij me entitete (kon)federale. Ai duhet futur në kontekstin e kohës dhe hapësirës ku ka lindur. Fakti se ai ka pasur ligje nuk tregon asgjë, sepse ligjet e tij kanë shprehur vullnetin absolut të Sulltanit. Parlamenti i parë i Perandorisë ka lindur vetëm në prag të Kongresit të Berlinit, me përfundimin e këtyre reformave, pjesë e pandarë e të cilit ka qenë edhe sistemi i vilajeteve. Sikur të argumentohej se vilajetet, pra edhe ai i Kosovës, kanë pasur status konfederal, kjo do të ishte e barabartë me argumentimin se civilizimet e para kanë filluar në Perëndim ose Jug, gjë që do të shkaktonte ridefinimin e tërë historisë se njerëzimit. Në lëmin e konfederalizmit, një gjë e tillë, po u argumentua shkencërisht, sigurisht që do të këtë për pasojë edhe ridefinimin e tërë ideve dhe praktikës së (kon)federalizmit në botë. Kontinuiteti i jetesës sonë në trojet etnike, ndërkaq, është çështje krejtësisht tjetër dhe, kam përshtypjen, nuk është argumentuar seriozisht në këtë libër. Përkundrazi, ai është komplikuar aq shumë sa një lexues i huaj i librit mund të nxjerrë konkluzione të gabuara për historinë moderne të kombit shqiptar.

3.

Kushtetuta e vitit 1974 e ish-Jugosllavisë ka imponuar për shqiptarët e Kosovës dhe të trojeve të tjera etnike pozicione socio-politike dhe fizike të njëjta sikur ato të rastit të vilajetit. Deri sa në rastin e parë qëllimi ka qenë pengimi i formimit si komb, në të dytin fjala bëhet për mohimin e ekzistencës së kombit shqiptar në trojet e tyre etnike. Një pozicion i tillë i Kosovës dhe i shqiptarëve ka qenë pjesë përbërëse e koncepcionit komunist mbi barazimin e republikës me komb dhe autonomisë me "jokomb". Ky status ka qenë pasojë e këtij koncepti, i bazuar në shkaqet e sigurisë dhe raportin e forcave të kohës së vet. Ai identitet socio-politik dhe fizik i Kosovës dhe i shqiptarëve

ka qenë i imponuar dhe nuk i është përgjigjur interesave reale të shqiptarëve. Të njëjtin fat e ndjekin edhe Kuvendi i Prizerenit (1945) dhe të gjitha kuvendet e proveniencës komuniste. Ato nuk mund dhe as që duhet të jenë bazë e së drejtës për vetëvendosje të Kosovës.

Kushtetuta e vitit 1974 ka kaluar nëpër dy faza: e para është ajo e glorifikimit të saj deri në momentin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, kurse e dyta ka filluar me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë dhe po vazhdon edhe sot. Fazën në vijim e sipër e kam quajtur si fetishizim të asaj kushtetute, për faktin se po i mvishen disa cilësi qe ajo nuk i ka pasur objektivisht kur është fjala për popujt e ish-Jugosllavisë dhe entitetet e tyre territoriale (republikat dhe krahinat autonome). Kjo më së paku na duhet neve. E drejta për vetëvendosje nuk ka buruar nga ajo kushtetutë për asnjërin prej popujve të ish-Jugosllavisë dhe entitetet e tyre territoriale — ish-republikat (tani shtete sovrane dhe të pavarura). Ajo ka qenë mohim i së drejtës për vetëvendosje, qofte si akt legal apo si kuadër normativ i një sistemi të caktuar socio-politik, të cilin ajo e ka sanksionuar. Vetëvendosja e ish-republikave është realizuar si pasojë e veprimit të parimit të efektivitetit të organeve të reja republikane dhe jo pse ajo është bazuar në këtë kushtetutë. Shkëputja fillestare e tyre dhe, më vonë, edhe vetë shpërbërja e ish-Jugosllavisë kanë qenë fakte jetësore jashtë domenit të Kushtetutës së vitit 1974 dhe së drejtës ndërkombëtare. Ato vetëm sa e kanë lehtësuar atë proces, por nuk e kanë nxitur e as inkurajuar. E drejta ndërkombëtare ka luajtur një rol frenues ndaj kërkesave serbe për zmadhim territorial në dëm të popujve të tjerë duke përdorur mjete të palejueshme (pastrimi etnik i territoreve dhe krimet kundër njerëzimit si mënyrë e ushtrimit të së drejtës për vetëvendosje). Parimi *uti possidetis* nuk i referohet përmbajtjes së parimit të vetëvendosjes e as të drejtave dhe detyrave të entiteteve territoriale të ish-Jugosllavisë.

Logjika se ne duhet të bazohemi në Kushtetutën e vitit 1974 ka krijuar përshtypjen tek të huajt se ka qenë interes yni real për të jetuar në atë shtet dhe si e tillë po u shërben qarqeve të huaja të vendosjes si pretekst se vetëm ish-republikat kanë të drejtën për vetëvendosje, gjë që nuk është e vërtetë. E vërteta është se kontrolli efektiv dhe arsyet gjeostrategjike kanë qenë dominantë për njohjen e pavarësisë dhe vetëvendosjes së ish-republikave jugosllave, pa marrë parasysh metodat me të cilat është arritur deri të kontrolli efektiv (me dhunë ose në mënyrë paqësore, me marrëveshje).

4.

Kushtetuta e vitit 1974, ashtu sikur edhe ato të cilat i kanë pararendur, nuk janë veçse akte legale të cilat kanë imponuar statuse diskriminuese socio-politike dhe fizike për shqiptarët nën ish-Jugosllavi. Ajo ka qenë e bazuar në konceptin komunist të ndarjes së popujve në kombe dhe "jokombe" dhe të barazimit të republikave dhe autonomive politiko-territoriale me koncept-et si më sipër. Kjo mënyrë administrative ka pasur për rrjedhojë që Kosovën dhe shqiptarët i ka reduktuar në një status hibrid dhe diskriminues (*narodnost*), me të vetmin qëllim mohimin e ekzistimit të kombit shqiptar në ish-Jugosllavi. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe koncepti komunist i autonomisë së a.q. politiko-territoriale. Ky koncept, historikisht shikuar, ka qenë substitut për mohimin e kombeve ekzistuese dhe ka qenë "zbuluar" nga arkitektët e komunizmit me të vetmin qëllim — mohimin e kombeve tashmë ekzistuese. Shqiptarët nën ish-Jugosllavi, përfshirë këtu edhe Kosovën, si pjesë të atij universi komunist, kanë ndjekur këtë fat të njëjtë, ashtu si edhe shumë kombe të tjera të robëruara nga ai sistem. Tani është koha e fundit që kjo praktikë e arsyetimit të së drejtës sonë për vetëvendosje të ndërpritet.

Duhet kuptuar njëherë e përgjithmonë se ajo kushtetutë nuk ka paraqitur bazën e së drejtës për vetëvendosje për asnjërin prej popujve të ish-Jugosllavisë me bazë territoriale. Natyra represive e atij sistemi dhe kontrolli efektiv i territoreve administrative nga popujt që kanë përbërë shumicën në to, kanë qenë baza e vetme e njohjes ndërkombëtare të së drejtës për vetëvendosje. Ne momentin që ai entitet është shpërbërë, pra ish-Jugosllavia, kanë pushuar të gjitha arsyet për t'u thirrur në shkeljen e të drejtave të njeriut si bazë për legjitimimin e së drejtës për vetëvendosje. Veçanërisht është brengosës fakti që, në këtë libër, autorët akoma i referohen konceptit të (kundër)kushtetutshmërisë dhe (kundër)ligjshmërisë së shkeljes së të drejtave të njeriut të shqiptarëve në sensin e krijimit të bazës për të drejtën e vetëvendosjes së Kosovës dhe popullit të saj. Natyra represive e regjimit totalitar të Beogradit është si bazë për të fituar simpatitë e bashkësisë ndërkombëtare lidhur me arsyeshmërinë e së drejtës sonë për vetëvendosje, por jo edhe si bazë e asaj së drejtë *per se*. Kjo për faktin se ai regjim e ka humbur titullin legal për të administruar Kosovën dhe të gjitha entitetet e tjera territoriale në atë moment që është shpërbërë ish-Jugosllavia. Që atëherë, ajo bazë ka kaluar në popullin e Kosovës dhe organet e zgjedhura prej tij, si zëdhënës të vullnetit të lirë të popullit shumicë në Kosovë. (Kundër)kushtetutshmëria dhe (kundër)ligjshmëria, ndërkaq, qoftë sa i përket akteve dhe veprimeve të ndërmarra nga Serbia para shpërbërjes së ish-Jugosllavisë ose pas saj, nuk kanë asnjë vlerë juridiko-ndërkom-

bëtare dhe janë pasojë e konceptit komunist, ashtu siç u sqarua me sipër. Sot në veçanti është gabim i madh thirrja dhe elaborimi i atyre koncepteve: ajo është rruga më e sigurt që në emër të shkencës juridike të futemi nën juridiksionin e ri të të a.q. RFJ (Serbi dhe Mali i Zi).

5.

Rregulli *uti possidetis*, si një nga segmentet e suksedimit të shteteve, gjen zbatim dhe aktivizohet vetëm pas fitimit të pavarësisë. Mënyra se si autorët e shtjellojnë këtë çështje nuk është veçse legalizim dhe legjitimim i kontinuitetit të regjimit të Beogradit mbi Kosovën. Me fjale të tjera, autorët, duke theksuar se Kosova ka qenë e barabartë me entitetet e tjera dhe duke kërkuar zbatimin e Kushtetutës së vitit 1974 edhe ndaj Kosovës si bazë e parimit *uti possidetis*, nuk bëjnë tjetër veçse legalizojnë dhe legjitimojnë vazhdimësinë e të a.q. RFJ (Serbi dhe Mali i zi) me ish-Jugosllavinë, përkatësisht kërkojnë zbatimin e parimit *uti possidetis* në formën e tij *uti possidetis de facto* (lat., të takon ajo çka e ke në posedim faktik, pa marrë parasysh se si e ke fituar). Autorët fare nuk e kanë të qartë përmbajtjen e këtij parimi, përkatësisht se ai zbatohet vetëm pas fitimit të pavarësisë dhe nuk ka të bëjë fare me përmbajtjen e akteve të brendshme legale në kuptim të të drejtave dhe detyrimeve, pra nëse ke qenë ose jo i barabartë me entitetet territoriale të ish-Jugosllavisë. Pas fitimit të pavarësisë, kjo rregull do të zbatohet edhe ndaj Kosovës, vetëm atëherë kur ndonjëri prej fqinjëve do t'i kontestojë kufijtë e Kosovës. Edhe atëherë, Kushtetuta e vitit 1974 zbatohet në sensin se ajo ka përcaktuar kufijtë e republikave dhe krahinave vetëm në parim, kurse të vlefshëm janë vetëm dokumentacioni topografik i ish-organeve të Kosovës në të cilat ekziston përshkrimi i gjendjes së kufijve, pra, cilat qytete, fshatra dhe lokalitete të tjera figurojnë aty si pjesë e Kosovës deri në momentin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë.

Siç mund të vërehet, logjika e autorëve se parimi në fjalë ka për bazë të drejtat dhe detyrimet e Kosovës krahasuar me entitetet tjera territoriale të ish-Jugosllavisë (republikat dhe krahinat), ashtu siç kanë qenë të përcaktuara në Kushtetutën e vitit 1974, nuk është veçse thirrje për kontinuitet me ish-Jugosllavinë dhe konfirmim i tezës serbe për një kontinuitet të tillë, ashtu siç e perceptojnë ata vetë se Kushtetuta e tyre e vitit 1992 është vazhdim i asaj të vitit 1974, kurse entitetet e tjera janë secesioniste. Faktin se Serbia nuk është kontinuitet sot e pranojnë të gjitha vendet e bashkësisë ndërkombëtare. Të njëjtin problem e ka ndeshur Serbia edhe para Luftës së Dytë Botërore, por që edhe atëherë nuk është konsideruar si kontinuitet i shtetit pararendës.

Serbia nuk ka qenë shtet as më 1918 e as sot, pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, prandaj nuk ka edhe logjikë profesionale që ne të merremi me statuset legale të imponuara gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, me fillim që nga Kuvendi i Prizerenit e deri më 1974. E njëjta vlen edhe për ato të imponuara në periudhën mes dy luftërave.

6.

Pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, Beogradi ka humbur titullin legal të përfaqësimit të të gjitha entiteteve të mëparshme territoriale. Rrjedhimisht, prezenca serbe në Kosovë është, ndërkombëtarisht shikuar, prezencë e një force të huaj ushtarake, e cila ka për qëllim pengimin e funksionimit normal të organeve të pushtetit të ri në Kosovë, si një entitet në lindje e sipër. Këto organe janë rezultat i zbatimit të parimit të vetëvendosjes (shprehja e vullnetit të lirë të popullit). (Kundër)kushtetutshmëria dhe (kundër)ligjshmëria e rrënimit të statusit të imponuar sociopolitik të Kosovës më 1974 nuk ka qenë dhe as që mund të jetë bazë e së drejtës sonë për vetëvendosje. Natyra represive e ish-regjimeve komuniste ka qenë baza mbi të cilën shpërbërja e tyre ka fituar legjitimitet ndërkombëtar. Sot, bazimi me të drejtat e njeriut dhe shkeljen e tyre nga regjimi represiv i Beogradit nuk është veçse legjitimim dhe legalizim i sovranitetit të kësaj kreature ndaj Kosovës dhe popullit të saj. Është tërësisht irrelevante nëse në kemi marrë pjesë në formimin e kësaj kreature më 1992, sikur që ka qenë rasti i njëjtë edhe kur është krijuar ish-Jugosllavia më 1918.

Shpërbërja e ish-Jugosllavisë përgjatë viteve 1990-1992 dhe humbja e titullit juridiko-ndërkombëtar mbi Kosovën ka bërë që Kosova të jetë, *de jure* dhe *de facto*, pjesë e territoreve dhe popujve nën okupim (dominim) të zgjatur ushtarak (dhe tjetër), ashtu siç përcaktohet një gjë e tillë me Deklaratën e OKB-së të vitit 1970. Fakti se bashkësia ndërkombëtare pranon se e a.q. RFJ (Serbi dhe Mali i Zi) është shtet i ri, por jo edhe kontinuitet i ish-Jugosllavisë, është një ndër arsyet kryesore pse Serbia nuk pranon se është okupuese në Kosovë. Mirëpo kjo nuk do të thotë se ne duhet ta pranojmë se ajo ka sovranitet mbi Kosovën dhe aq më pak që si bazë e jona për të drejtën e vetëvendosjes të shërbejë ish-Kushtetuta e vitit 1974, apo natyra represive e regjimit të Beogradit, apo çfarëdo baze tjetër. Natyra represive e regjimit të Beogradit dhe e ish-regjimeve represive komuniste ka pasur një status të tillë deri në momentin e shpërbërjes së tyre. Pas shpërbërjes, inspirimi dhe baza kryesore e arsyetimit të së drejtës sonë për vetëvendosje duhet të jetë Deklarata e OKB-së e vitit 1970 dhe filozofia politike dhe juridike mbi të cilën bazohen e

drejta dhe parimi i vetëvendosjes në të drejtën ndërkombëtare. E drejta e brendshme, pra Kushtetuta e vitit 1974, nuk ka asnjë rol për të luajtur, përveç atij të konfirmimit të kontinuitetit të të a.q. RFJ (Serbi dhe Mali i Zi) me ish-Jugosllavinë. U mor vesh edhe sjelljet tona duhen përshtatur me gjendjen *de facto* dhe *de jure* të okupimit, për çka modalitetet përcaktohen nga klasa politike e Kosovës. Juristët duhet gjithashtu që sjelljet e veta t'i harmonizojnë me këtë dhe jo të kërkojnë bazën legale të së drejtës për vetëvendosje atje ku nuk ekziston — në Kushtetutën e vitit 1974 dhe në natyrën represive të regjimit të Beogradit. Çka nëse regjimi i Beogradit nesër ose pasnesër nuk e ka një natyrë të tillë? Çfarë do të jetë fati i vënies në jetë të dokumenteve të pavarësisë së Kosovës, të nxjerra gjatë dhe pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, dhe të cilat janë të vetmet që realisht kanë shprehur vullnetin e popullsisë shumicë në Kosovë? A duhet ky të jetë inspirimi dhe baza jonë apo vlerësimi se sa janë aktet dhe veprimet e Serbisë (kundër)kushtetuese dhe (kundër)ligjore? Çka do të ndodhe nëse Serbia bëhet demokratike, pra jorepresive, dhe respekton kushtetutën dhe ligjin? Cila do të jetë baza e së drejtës sonë për vetëvendosje në një rast të tillë?!

III. Shprehje e pikëpamjeve individuale

(Në vend të përgjigjes: pse nuk dëshirojmë të polemizojmë me Enver Hasanin?)

Sikur mos të vlente parimi se heshtja nënkupton miratim (ndonëse nganjëherë ajo është injorim), nuk do të paraqiteshim as në këtë mënyrë. Kjo ngase, që në fillim jemi vënë në një pozitë të pabarabartë me reaguesin meqë lexuesit nuk kanë pasur mundësi të njihen me burimin origjinal, së pakut me fragmente të librit tonë. Parimisht nuk duam të polemizojmë me të ngase ai ka bërë zëvendësimin jokorrekt të tezave për ti mbështetur pikëpamjet e veta mbi "gabimet tona" të cilat kanë vetëm një bazë: në bindjet e tij, e jo në fakte relevante në të cilat ato ekzkluzivisht mund të bazohen për të nxjerrë gjykime të drejta.

Arsyet e veçanta pse nuk dëshirojmë të polemizojmë janë këto:

1.

Sepse, ai bën fjalë për "Gabimet e një shkence juridike" edhe pse shkrimet tona kanë karakter publicistik, me çka nuk mund të fsheh tendencën, por atë e bën më transparente. Enver Hasani do të mjaftonte të citonte vetëm një fjali nga parathënia e librit që të njohtonte opinionin për qëllimin pse u shkrua libri: "si përgjigje letrës — dokumentit të të vetëshpallurës 'RFJ' dërguar Komisionit të OKB për të drejtat e njeriut (E/CN.4/SUB.2/1996). (Shih "Preface" fq. 9 e librit tonë).

2.

Sepse, më shumë se në dy të tretat e shkrimit të tij, ai më tepër shfaq pikëpamjet e veta rreth të cilave nuk kemi as obligim moral e as profesional të marrim qëndrim ose të gjykojmë për to, meqë ato paraqesin, siç e thot vet ai: "qasje tjetërfare të këtij problemi ndër ne" (gjë të cilën askush nuk mund t'ia ndalojë) se sa që merret me argumentimin e "gabimeve tona".

3.

Sepse, ka bërë një shkrim relativisht të gjatë, mbase për të lënë përshtypjen për gjoja "mangësitë e mëdha" të librit tonë, pa bërë së paku një përpjekje të shkurtër për të bartur përmbajtjen dhe porositë themelore të tij, duke harruar se vlera e shkrimit nuk matet me gjatësinë por me përmbajtjen e tij, që flet se vëmendjen e opinionit është përpjekur ta tërheq me vëllim jo me cilësi, e cila ndryshe do të na detyronte të polemizojmë.

4.

Sepse, ka të bëjë me përzgjidhje të veten të pikëpamjeve tona (!) duke dëmtuar tërësinë e librit. Më tepër për hirë të lexuesve, se sa për t'u arsyetuar para reaguesit, do të veçojmë vet katër fjali nga libri në mënyrë që ata vetë objektivisht të gjykojnë për librin tonë:

> - [...] Pavarësia e Kosovës përbën një faktor të rëndësishëm për ruajtjen e paqes në rajon. Përballë një zhvillimi të proceseve të reja në Ballkan do të mund të shtrohej edhe çështja e statusit politik të Kosovës dhe e njohjes së tij në bazë të vullnetit politik të popullit shumicë të Kosovës në referendumin e mbajtur më 1991;
> - [...] Çështja e Kosovës nuk është dhe nuk mund të zgjidhet në rrafshin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut ndonëse ato shqiptarëve iu shkelen në mënyrën më brutale. Poqëse çështja e Kosovës do të vështrohej në atë rrafsh do të rrudhej në pikëpamje politiko-historike një nga çështjet më me interes për proceset e reja në Ballkan. Çështja e Kos-

> ovës paraqet para së gjithash çështje të vetëvendosjes së popullit shumicë të saj. Mëvehtësia e Kosovës dhe e drejta e vetëvendosjes së popullit shqiptar ka mbështetje në realitetin nacional dhe demografik të të ekzistimit të popullit dymilionësh shqiptar për të qenë sovran dhe i pavarur në bazë të deklarimit të vullnetit të lirë të tij në udhë institucionale dhe demokratike;
> - Nga pikëpamja konstitucionale është e padiskutueshme se shqiptarët paraqesin një etnikum të qartë me të cilin identifikohet popullata kompakte në territorin e vet, prandaj si historikisht ashtu edhe politiko-gjenetikisht është logjike që secili etnikum, pra edhe etnikumi shqiptar në Kosovë, të synojnë shtetësinë si realizim të vetin historik;
> - [...] Esenca e synimit për realizimin e sovranitetit dhe pavarësisë së Kosovës duhet parë dhe duhet kuptuar, por edhe duhet paraqitur kryesisht dhe në radhë të parë si përcaktim vetjak i Kosovës dhe i popullsisë shumicë të saj që të jetoj me ligjet e veta [...].

Prandaj pyesim se me cilën të drejtë morale Enver Hasani në pjesën përfundimtare pohon se: "autorët akoma i referohen konceptit të (kundër) kushtetutshmërisë dhe (kundër) ligjshmërisë së shkeljes së të drejtave të njeriut të shqiptarëve në sensin e krijimit të bazës për të drejtën e vetëvendosjes së Kosovës dhe popullit të saj"; dhe se: "juristët duhet gjithashtu që sjelljet e veta t'i harmonizojnë me këtë dhe jo të kërkojnë bazën legale të së drejtës për vetëvendosje atje ku nuk ekziston.. . në natyrën represive të regjimit të Beogradit"!!!

Në shkrimin e tij, Enver Hasani tezën e tij mbi kontinuitetin historiko-politik, pra edhe kushtetues të Kosovës, e ndërron dhe e paraqet si tezë tonën, siç shprehet ai, në bazë të "Kushtetutës së Kosovës të vitit 1974", kur baza baza juridiko-ndërkombëtare e vetëvendosjes së popullit shqiptar të Kosovës është elaboruar si kaptinë e veçantë e librit tonë (fq. 46-94). Kjo le të mbetë në ndërgjegjen e tij.

5.

Sepse, ai bën zëvendësimin jokorrekt të tezave për ti bazuar pikëpamjet e veta mbi "gabimet tona" që kanë vetëm një mbështetje në bindjet e tij, e jo në fakte relevente, në të cilat ato ekzkluzivisht mund të bazohen për të nxjerrë gjykime të drejta, siç është rasti me karakterin e Kushtetutës së vitit 1974, me të drejtën e vetëvendosjes, etj., për të krijuar opinione të gabueshme të lexuesit se: "autorët kanë përdorur nocione që nuk i korrespondojnë shkencës juridike, ose, edhe kur janë përdorur arsyetimi i tyre është mjaft i zbehtë dhe jashtë kontekstit të cilin pretendojnë ta përfshijnë", në mënyrë që të gjykojë

se: "nga leximi i librit fitohet përshtypja se më tepër ka trajtime gjysmake historiko-politike se sa juridike", duke harruar maksimën se "pas fjalëve të mëdha" nuk qëndrojnë automatikisht edhe "argumentimet e mëdha".

6.

Sepse, autori i pjesës së parë të librit (Dr. Esat Stavileci) ka pasur mendimin profesional të akademik Gazmend Zajmi qysh se në vitin 1974 kur përgadiste ciklin e shkrimeve me titull: "Shqiptarët në proceset e reja politike në Ballkan" dhe sygjerimin e tij se pikërisht me "Dimensionet politike të çështjes së Kosovës" në formën dhe përmbajtjen siç janë dhënë në këtë libër, ta hap ciklin e temave që tash po përgaditet si libër i veçantë. Besojmë se edhe vet Enver Hasani do të pajtohet se Gazmend Zajmi ishte njohës më i mirë i çështjes së Kosovës se ai.

7.

Sepse, përpiqet për të krijuar opinione të gabueshme për veprën tonë edhe pse tezat për të janë publikuar në shtypin dhe periodikun tonë, pa thënë asnjëherë askush prej politikologëve, juristëve e historianëve as të vetmen vërejtje për to, ndonëse edhe ne vet jemi të ndërgjegjshëm nuk kemi bër vepër të kryer e të përkyer, sepse të tillë nuk ka. Por, as që lejojmë që pa argumente bindëse të nëpërkëmbet ajo qoftë edhe nga Enver Hasani që pretendon të dëshmohet njëkohësisht edhe: si ekspert i sistemit politik, edhe i historisë, edhe i të drejtës ndërkombëtare, edhe i të drejtës kushtetuese.

8.

Sepse ai përpiqet të na imponoj se libri është dashur të shkruhet ose të përmbajë atë që ia thot mendja e tij, e jo atë që kemi shkruar ne dhe kjo për te paraqet "gabim", të cilin ne, natyrisht, nuk e pranojmë.

9.

Sepse, në këto kohë vërtet shqetësuese për popullin tonë, nuk dëshirojmë që me një polemikë të stërgjatur në gazetë t'ia mbysim shpresat në intiligjencinë, qoftë edhe me sakrificën tonë që të "përtypim" teza që nuk qëndrojnë si ato për margjinalizimin e kontinuitetit historik të mëvehtësisë së Kosovës; ato për karakterin e Kushtetutës së vitit 1974.

Ç'është e vërteta, është vet Enver Hasani, ai i cili jo shumë larg, por në vitin 1993 (tre vjet pas Deklaratës së Pavarësisë së vitit 1990) në një punim të tij elaboronte statusin "krahinor" të KSA të Kosovës, duke e barazuar atë me ish-republikat tjera socialiste të Jugosllavisë në fushën e marrëdhënieve ndër-

kombëtare (Shih: Enver Hasani, "The Participation of Kosova as a Federal Unit in the Framework of the International Activities of the SFRY According to the 1974 Constitution", 1993, fq. 4, 5, 6, dhe 7).

10.

Sepse, për tema të tilla, kritika e mirëfillët nuk mund të zhvillohet në gazetë, por në tryeza e tribuna ku me ballafaqimin e pikëpamjeve mund të arrihet deri te gjykimi objektiv. Prandaj edhe pse fillimisht përgaditëm përgjigjen tonë me shkrim prej mbi 40 faqesh (dy tabak e gjysëm autori) më shumë preferojmë ti kursejmë lexuesit nga një polemikë e cila mund të na ndajë e jo të na bashkojë, të na dobësoj e jo të na mobilizojë, të na përqajë e jo të na pajtojë, sikurse më shumë preferojmë të angazhohemi në projekte të reja, kështu që tre së bashku, duke mirëpritur edhe të tjerët. Reagimi i Enver Hasanit nuk na ka dekurajuar, sado që na ka befasuar, por përkundërazi na ka mobilizuar duke pasur parasyshë edhe pozicionet edhe qëllimet e fundit të tij.

Mendojmë se këto arsye janë të mjaftueshme që lexuesit e nderuar të na kuptojnë, por edhe të na justifikojnë përse nuk dëshirojmë të polemizojmë me atë i cili na rekomandon reduktimin e "individualitetit kompleks historik, gjeografik, struktural-demografik, dhe politik të Kosovës", duke margjinalizuar kontinuitetin historik të veçantësisë së Kosovës, gjë që përndryshe na "rekomandon" edhe historiografia serbe!

Prandaj mendojmë se ndoshta më mirë do të ishte sikur në gazetë të botoheshin qoftë edhe fragmentarisht pjesë të librit.

Vetëm në atë mënyrë gjykimet mund të bëheshin të drejta dhe objektive.

Ky sqarim i ynë i shkurtër pretendon të dëshmoj se aty ku janë faktet, fjalët bëhen të panevojshme.

Koha është ajo që do ta gjykoj vetë.

Dr. Esat Stavileci, Mr. Blerim Reka, Dr. Arsim Bajrami

IV. "Ungvibus et Rostris"

Përgjigje në reagimin "Shprehje e pikëpamjeve individuale: Pse nuk dëshirojmë të polemizojmë me Enver Hasanin", të autorëve dr. Esat Stavileci, mr. Blerim Reka dhe dr. Arsim Bajrami, botuar në *Rilindja* (28 gusht 1997), lidhur me kritikën time shkencore "Gabimet e një shkence juridike", botuar në *Rilindja* (1-16 korrik 1997).

Në gazetën *Rilindja* të datës 28 gusht 1997, u botua reagimi "Shprehje e pikëpamjeve individuale: pse nuk dëshirojmë të polemizojmë me Enver Hasanin?" i autorëve dr. Esat Stavileci, mr. Blerim Reka, dhe dr Arsim Bajrami. Ndonëse që në titull thuhet se nuk duan të polemizojnë me mua, ky reagim drejtpërsëdrejti lidhet me kritikën time shkencore me titull: "Gabimet e një shkence juridike", botuar në *Rilindja* nga 1 deri më 16 korrik të vitit 1997. Ky reagim, të cilin autorët turpërohen ta quajnë polemikë për arsye personale, meriton të shkoqitet më hollësisht, t'i sqarohen lexuesit synimet e autorëve dhe limitet e "shkencës së tyre juridike".

Së pari, ju aty keni cituar si timin punimin me titull "The Participation of Kosova as a Federal Unit in the Framework of the International Activities of the SFRY According to the 1974 Constitution" (1993). Fakti se ju këtë e citoni tregon qartë se më mbani për njëfarë "kushtetutëmbrojtësi" të Kushtetutës së vitit 1974, për çka unë kam shkruar kritikën kundër jush "Gabimet e një shkence juridike", pikërisht për t'u dalluar nga shkenca që ju predikoni. Ai punim, siç mund të vërehet, nuk mban vendin e botimit dhe kjo ka një shpjegim sa qesharak aq edhe ironik për ju. Ata që më njohin e dinë që unë kam përcjellë Konferencën Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë në Gjenevë gjatë viteve 1992-1993, në cilësinë e ekspertit ligjor të Qeverisë së Republikës së Kosovës në mërgim, ku edhe sot punoj. Sekretari i Konferencës në atë kohë, zt. Kutino, kishte dëgjuar nga një ekspert ligjor kroat se Kosova dhe Kroacia paskëshin pasur të drejtën e lidhjes dhe ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, kurse entitetet e tjera federale jo, pra as Serbia, gjithnjë bazuar në Kushtetutën e ish-RSFJ të vitit 1974. Në ndërkohë, "Grupi Special për Kosovën" në kuadër të Konferencës për ish-Jugosllavinë po përgatiste një projekt për Kosovën dhe zt. Kutino më pati lutur që t'i shuaja kureshtjen e tij intelektuale lidhur me çështjen në fjalë, pra nëse vetëm Kosova dhe Kroacia

paskëshin pasur të drejtën e lidhjes dhe ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare sipas Kushtetutës së ish-RSFJ të vitit 1974. Dhe, unë mora librin e autorit serb dr. Stevan Gjorgjeviq (Stevan Djordjević) me titull *Republike i pokrajine u medjunarodnim odnosima jugoslovenske federacije* [Republikat dhe krahinat në marrëdhëniet ndërkombëtare të federatës jugosllave] (Beograd, 1985), si bazë kryesore sepse ishte i vetmi autor jugosllav që kishte bërë monografi në këtë fushë. Kur i kam dorëzuar zt. Kutino shkrimin në fjalë, meqë ishte fjala për material propagandistik, ia pata dhënë titullin e institucionit ku punoj si dhe cilësinë time aty, sepse kështu shkojnë këto punë. Unë këtë shkrim nuk e kam botuar kurrë meqë ka mbështetje vetëm në një autor dhe nuk kam pasur të drejtën për një gjë të tillë, sepse do të ishte thjesht një plagjiat.

Nga fundi i vitit 1993, zt. Blerim Reka, së bashku me një grup të rinjsh nga Kosova patën ardhur në Gjenevë për një specializim njëmujor në diplomaci në Qendrën CASIN të Gjenevës. Në këtë kurs për diplomaci, të financuar në tërësi nga Qeveria e Kosovës në mërgim, kam pasur për detyrë të kujdesem për organizimin e konkursit për konkurrim të kandidatëve nga Kosova. Pas kësaj, kur kolegët nga Kosova kanë ardhur në Gjenevë, Qendra CASIN, përkatësisht drejtori i saj dhe miku im, dr. Jean Freymond (Zhan Frejmond), më ka ftuar që t'u mbaj kolegëve nga Kosova një ligjëratë me titull "Konferenca Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe struktura e saj". Në këso rrethana jam njohur me zt. Blerim Reka, i cili asokohe ka qenë në grupin e këtyre të rinjve që trajnoheshin në CASIN për diplomacinë e ardhshme të Kosovës. Në këtë orë mësimi, atij dhe tjerëve ua kisha shpërndarë disa materiale njohëse për Konferencën Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe Kosovën, ku në mesin e tyre, si material propagandistik qeveritar i Qeverisë së Kosovës, kishte qenë edhe punimi "im" si më sipër, i cili ishte i përkthyer në gjuhën angleze dhe që as më pak e as më shumë përbënte një përmbledhje të shkurtër të pjesëve për Kosovën dhe Kroacinë dhe kapacitetin e tyre ndërkombëtar kontraktues sipas Kushtetutës së vitit 1974, të cilën e kishte shkruar autori i njohur serb dr. Stevan Gjorgjeviq.

Në vijim si më sipër, për të qenë gazi dhe ironia më e madhe, zt. Blerim Reka këtë punim që e kisha bërë për qëllimet propagandistike të Qeverisë së Kosovës në mërgim, pas kthimit të tij në Kosovë, filloi ta botojë dhe riprodukojë si të vetin në të gjitha shkrimet që kam pasur rast t'i lexoj nëpër gazetat në gjuhën shqipe në Kosovë dhe gjetiu. Në botimet e tija, zt. Blerim Reka e lidh këtë aspekt të kapacitetit kontraktues ndërkombëtar të Kosovës si një argument të së drejtës për vetëvendosjes të saj. Edhe libri që është objekt i

kritikës sime në shkrimin "Gabimet e një shkence juridike" nuk ka qenë imun nga kjo veti e zt. Blerim Reka për ta përdorur shkrimin që ia pata dhënë në Gjenevë atij dhe studentëve tjerë si material të Qeverisë së Kosovës në mërgim për të cilën punoj. Kështu, ta zëmë, duke folur për bazat e së drejtës për vetëvendosje të Kosovës dhe "subjektivitetin juridiko-ndërkombëtar të Kosovës si njësi federale e ish-Federatës Jugosllave, zt. Blerim Reka ka kopjuar në tërësi *ad literam*, jo shkrimin tim, por të autorit serb Stevan Gjorgjeviq, nga i cili unë kam marrë dhe rishkruar duke i përfolur faqet që kanë pasur të bëjnë me Kosovën dhe Kroacinë si dhe zotësinë e tyre kontraktuese në planin ndërkombëtar (cf. dr. Esat Stavileci, mr. Blerim Reka, dhe dr. Arsim Bajrami, *Kosova: Political, International Law and Constitutional Agruments*, Prishtina, 1996, fq. 75-76). Zt. Blerim Reka duhet ta ketë bërë këtë duke qenë i bindur se ai shkrim është autorësi e imja, e pabotuar, ashtu që unë nuk do të kem mundësi të reagoj kundër tij me akuza për plagjiaturë. Siç vërehet, zt. Blerim Reka ka bërë plagjiat kundër dr. Stevan Gjorgjeviqit, jo ndaj meje, dhe, për të qenë e keqja më e madhe se kaq, ato pjesë që janë marrë dhe riprodukuar nga zt. Blerim Reka fare nuk i referohen së drejtës për vetëvendosje të Kosovës në asnjë aspekt të kësaj së drejte.

Të nderuar kolegë Stavileci, Reka e Bajrami, po e lexuat librin e dr. Stevan Gjorgjeviqit, do ta shihni se fjala është për paradokset e ish-sistemit legal komunist të ish-Jugosllavisë dhe fare nuk flet për vetëvendosjen, siç ka qenë rasti edhe me vetë burimin primar të atij sistemi — Kushtetutën e vitit 1974 (përveç rasteve që i kam dhënë në kritikën time "Gabimet e një shkence juridike"). Të gjitha këto fakte nuk do t'i nxirrja këtu, mirëpo ju ishit ata që kërkuat një gjë të tillë. Apo jo?

Do t'i mbetesha borxh lexuesit, megjithatë, por edhe vetë zt. B. Reka, sikur mos të shënoja këtu një pikëpamjet që kam pasur dhe që akoma kam për profilin shkencor të kolegut në fjalë. Kur u njoftuam së pari, kultura e tij juridike e shpirtërore m'u duk shumë inkurajuese në sensin që tek ai sikur kisha gjetur shkencëtarin e asaj gjenerate së cilës ai vetë i kishte kushtuar një vepër, librin *Vitet e Shpresës* (1991), shkencëtarin që supozohej se do të zëvendësonte rendin e shenjtë të "epokës së obskurantizmit", i krijuar ndër ne me vite të tëra dhe që akoma po vazhdon të jetojë në mesin tonë dhe rreth nesh. Sado që opusi shkencor i zt. B. Reka dallonte nga ai i dy kolegëve tjerë, fakti se ka kuptuar kritikën time fjalëpërfjalshëm vetëm si një "qasje tjetërfare" më bën të dyshoj nëse kolegu B. Reka mund të dalë lehtësisht nga rrethi vicioz i obskurantizmit legal të një segmenti të shkencës juridike në Kosovë.

Së dyti, ju thoni se këto janë pikëpamjet e mia individuale dhe se do të ishte mirë që libri juaj të botohej në gjuhën shqipe ashtu që lexuesi të bënte krahasimin në mes meje dhe jush. Ju e di se do ta bëni botimin vetëm në fragmente sepse ashtu në fragmente keni mundësi përzgjedhjeje të pjesëve me të cilat edhe unë edhe lexuesi mund të kemi mendim të njëjtë me ju. Prandaj, edhe keni reaguar në tekstin tim me fragmente, duke iu referuar kritikës sime të cilën e botoi *Koha Ditore* në Prishtinë, në një ose dy vazhdime, shkurt fare, botim i bërë pa autorizimin tim dhe që është tërësisht i zhveshur e i shfytyruar nga çdo element i kritikës së sinqertë shkencore.

Them se ju fare nuk keni nevojë ta botoni tekstin tuaj në fragmente por në tërësi ashti siç kam bërë unë. Jo pse lexuesi shqiptar dhe ai i huaj nuk është i informuar me opusin tuaj shkencor, por për të parë se libri juaj është përmbledhje e logjikës së njëjtë të cilën ju e keni filluar pas vitit 1990 dhe po e vazhdoni akoma. Ju keni të drejtë kur thoni se shkrimi im nuk ju ka dekurajuar, sikur që edhe unë kam të dejtë të them se punimi im nuk ka qenë i drejtuar vetëm kundër librit tuaj, por kundër gjithë opusit tuaj shkencor, gjë të cilën e kam thënë qartë në fillim të kritikës sime kur konstatoj se "tërësia përmban pjesën". Këtë mund ta dëshmoj fare lehtë, gjithmonë duke pasur parasysh çështjet kyçe në të cilat ju ngecni seriozisht.

Së treti, sa i përket pohimit tuaj se këto janë pikëpamje të mia individuale, më duhet të them se nuk është fare ashtu, dhe këtë ju e dini fare mirë. Nuk janë të tilla sepse burim i imi i literaturës janë kryesisht emrat më eminentë të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, historianë e juristë të njohur ndërkombëtarisht dhe të cilët i kanë dhënë vulën krizës në ish-Jugosllavi, duke qenë ekspertë nëpër forumet e ndryshme që janë marrë me atë shtet. Dhe ju shumë shpejt do të bindeni për këtë në kohën që po vjen pasi ndonjëri prej tyre sigurisht se do të ketë rol të caktuar në zgjidhjen e çështjes sonë. Atëherë, kolegë të nderuar, ju do të keni rastin të ballafaqoheni me ta për t'ua shprehur atyre pikëpamjet tuaja "shkencore" dhe t'u shpjegoni për "konfederatën e Vilajeteve me Kosovën si njësi federale *sui generis*", për AVNOJ-in (1943), Kuvendin e Prizerenit (1945), dhe, mos harroni, së fundi, t'u flisni diçka edhe për Kushtetutën e vitit 1974. Unë, ndërkaq, mbes me shpresë se me opinionin publik dhe shkencor kam "pastruar hesapet". Sigurisht se do të vazhdoj të kritikoj shkrimet tuaja, por vetëm pasi të kem mbaruar kritikën tjetër në vijim ndaj jush. Këtë radhë kritika ime do të fokusohet në literaturën tuaj të përdorur në librin tuaj si dhe mënyrën krejtësisht të gabuar të citimit të saj. Qasja juaj *ungvibus et rostris* [kthetra e sqep, pra me të gjitha mjet-

et] nuk i bën mirë shkencës juridike në Kosovë, përveç nëse ajo është bërë mjet për ndonjë qëllim tuajin politik afatshkurtër.

V. Një libër me rëndësi të veçantë

Hyrje

Në prillin e këtij viti doli nga shtypi libri për Kosovën i autorit të mirënjohur botëror, Noel Malcolm (Noel Malkolm)[112]. Më ka rastisur jo rrallë të dëgjoj, që nga koha e botimit të librit, se rëndësia e tij qëndron në faktin se është shkruar nga një autor i huaj. Dhe, kjo fare nuk është e saktë. Kjo paraqet një mendim krejt naiv. Rëndësia e librit në fjalë qëndron në përmbajtjen dhe momentin kohor të botimit të tij, jo në origjinën e vetë autorit.

Libri ka një vëllim prej 492 faqesh, përfshirë këtu indeksin e lëndës dhe të emrave, një literaturë (bibliografi) tejet të pasur, që kap hapësirën prej 100 faqesh. Sikur te libri për Bosnjën, autori ka bërë një hulumtim origjinal dhe të gjerë të çështjes së Kosovës, si dhe një sintezë të shkrimeve të tija lidhur me Kosovën dhe çështjen shqiptare përgjithësisht. Studimi i Malcolmit është bërë mbi bazën e burimeve shqiptare, serbe, franceze, gjermane, angleze dhe italiane, me referime të atykëtushme të materialeve në gjuhën hungareze. Kjo tregon tërë seriozitetin e librit dhe përmbajtjen shkencore të tij. Zaten, një libër a punim ose është shkencor ose nuk është fare i tillë, pa marrë parasysh origjinën e autorit. Kur kësaj i shtohet edhe momenti kohor i daljes në dritë të librit, atëherë del i saktë mendimi i përgjithshëm se libri në fjalë ka qenë dhe është kontributi më i madh që i është bërë çështjes së Kosovës dhe asaj shqiptare në përgjithësi këtyre tetë vjetëve të pasmbarimit të Luftës së Ftohtë dhe hapjes së çështjeve ballkanike, ku çështja shqiptare zë një vend kryesor. Nisur nga shembulli i ndjekur me Bosnjë-Hercegovinën dhe historinë e saj, këtu e katër vjet më parë, autori bëri edhe për këtë pjesë të Ballkanit një ndriçim dhe dekorim të historisë dhe miteve serbe, të jetës dhe të kulturës së tyre dhe të popujve me të cilët ata jetojnë aktualisht.

Këtë ese personale për librin e kemi konceptuar si një vlerësim subjektiv të disa prej pjesëve të tij, me bindje se për të do të shkruhet ndër ne dhe më

[112] Noel Malcolm, *Kosovo: A Short History* (New York UP: New York, 1998).

gjerë edhe për një kohë të gjatë. Në vijim të kësaj, edhe vëmendjen tonë e kemi koncentruar në disa çështje të përzgjedhura që kanë të bëjnë me nacionalizmin serb dhe natyrën e tij, përfshirë këtu rolin dhe rëndësinë e Kishës Ortodokse Serbe; me aspektet legale të çështjes së Kosovës; me Konferencën e Bunjajt (1943-1944); dhe, së fundi, çështjen e bashkësisë hebreje në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe fatin e tyre.

1. Veçoritë dalluese mes shqiptarëve dhe serbëve; vendi dhe roli i Kishës Ortodokse Serbe në ngritjen e nacionalizmit serb

Pas një analize të përbashkësisë mes serbëve dhe shqiptarëve, që del si rezultat i jetesës së gjatë nën të njëjtin sundues, por edhe të dallimeve që janë pasojë e rrethanave të tjera (rrënjët e ndryshme etnike, variacionet regjionale dhe lidhjet e dallueshme kulturore dhe fetare), autori jep elemente tejet të qarta dalluese mes serbëve dhe shqiptarëve dhe të nacionalizmave të tyre respektivë. Gjuha paraqitet si pika e parë dalluese (faqet 22-40, në faqen 30), duke kaluar menjëherë në rolin e Kishës Ortodokse Serbe, e pavarur që nga viti 1346, dhe rolin që ajo ka luajtur në krijimin e identitetit nacional serb përgjatë shekujve. Për perëndimorët dhe kulturat e tyre, vëren autori, është i pakuptueshëm roli dhe rëndësia e kësaj kishe ngaqë në të shumtën e rasteve ka qenë e tërhequr, ashtu si kishat tjera ortodokse në Ballkan, nga angazhimi social dhe politik, për t'u futur kështu në mbretërinë e kontemplacionit dhe të celebrimit liturgjik. Kjo ka pasur si pasojë ndrydhjen dhe eliminimin e shpirtit dhe të mendimit kritik në jetën socio-politike serbe (fq. 12-13). Ky nuk ka qenë rasti me perëndimorët dhe filozofinë e tyre, sepse atje është zhvilluar një proces i kundërt me këtë, qoftë në mesin e katolikëve ose të protestantëve. Me këtë rol parasysh, autori krejt i sigurt dhe me të drejtë sqaron enigmën "përse serbët gjatë disa momenteve të historisë së tyre kanë ndjekur qëllimet politike me një dëgjueshmëri e lojalitet të verbër dhe absolut" (fq. 13). Rrjedhimisht, njohja e kësaj filozofie paraqitet si imperativ i gjithë atyre që duan të merren seriozisht me shpjegimin e nacionalizmit serb në Ballkan.

Vendosja e Patrikanës Serbe në Pejë, si rezultat i një koincidence të rastësishme historike, i dha Kosovës një dimension tjetër emotiv për serbët, ndërkohë që të gjithë sundimtarët serbë, me fillim që nga Nemanja, Millutini, Dushani dhe Lazari, nuk i kishin pasur qendrat e tyre administrative në Kosovë (cf. kapitulli "Kosova para Princit Lazar: 850-1380", fq. 50), sado që pasuritë natyrore të Kosovës ishin ato që zgjuan interesimin e sundimtarëve

serbë për këtë vend (po aty). Vendosja e autoqefalisë serbe në Kosovë ishte një rastësi historike që lidhet me fatin e një sulmi të rrufeshëm rreth vitit 1290 të forcave tatare dhe kumane kundër Manastirit të Zhiqes, për t'i shtyrë serbët më thellë në drejtim të Kosovës (po aty).

Natyra e nacionalizmit serb, ashtu siç është parë gjatë këtyre dy shekujve dhe gjatë luftërave të fundit në ish-Jugosllavi, pa harruar këtu zhvillimet e fundit në Kosovë, i dedikohet strukturës sociale të vetë shoqërisë serbe. Në të vërtetë, atje nuk ka ekzistuar një aristokraci e lindur. Kjo ka qenë pasojë e pushtimit të gjatë otoman dhe i ka mundësuar Kishës dhe elitës serbe që të prodhojnë një nacionalizëm të tipit egalitar (popullist), sado që historianët romantikë serbë kanë provuar të dëshmojnë, përmes analogjisë me rusët, se organizimi rural i fshatit dhe familjes serbe kanë qenë shenjë e vitalitetit të tyre nacional. Prandaj, autori i librit me të drejtë ka vërejtur se të ashtuquajturat *zadruga* dhe format e ngjashme të vetorganizimit rural në Serbi kanë qenë shenjë e pasigurisë dhe e paqëndrueshmërisë se strukturave shtetërore serbe të kohës (fq. 11).

Për dallim prej serbëve, shqiptarëve u ka munguar një element i kohezivitetit në kohën e lindjes së nacionalizmit modern, i ngjashëm me atë të Kishës Ortodokse Serbe, dhe kjo është vërejtur nga autori i librit. Në këtë mënyrë, gjuha shqipe është spikatur nga autori si element koheziv te shqiptarët në kohën e lindjes së nacionalizmit modern. Ky problem diskutohet menjëherë pas atij të Kishës Ortodokse Serbe. Autori nuk sheh dallime të mëdha gjuhësore mes veriut dhe jugut të shqiptarisë, së pakut jo në atë masë që pohohet ndër ne nganjëherë. Por, autori gjithashtu ka vërejtur ekzistimin e një motivi të pjesshëm politik në procesin e unifikimit të gjuhës shqipe në vitet '70 të shekullit XX, fakt ky që të ne dramatizohet pa nevojë, duke i shtyrë gjërat kah dy skajshmëri përjashtuese: unifikimi ka qenë ekskluzivisht i motivuar politikisht më 1972 ose, e kundërta, se ai nuk ka pasur fare premisa të tilla?! Dallimet gjuhësore, fare të vogla, mes Skocisë dhe Anglisë së jugut i kanë shërbyer autorit si pikë referimi për ata që nuk e njohin sa duhet çështjen shqiptare.

2. Aspektet legale të çështjes së Kosovës

Duke mos qenë jurist, autori nuk është penguar që të marrë përsipër trajtimin edhe të aspekteve legale të çështjes së Kosovës dhe pasojat praktike të këtij segmenti, me kuptim pasjen ose mohimin e së drejtës për vetëvendosje

të popullsisë së saj shumicë. Sigurisht që trajtimi i aspekteve legale tek autori kalon esencialisht përmasat e trajtimeve që janë bërë këtyre viteve ndër ne lidhur me këtë problem. Ai është më largpamës për Kushtetutën e vitit 1974 dhe për historinë e aneksimit të Kosovës më 1912, pra jo më 1989 e as më 1878, si dëgjohet jo rrallë nga autorët shqiptarë, duke u bazuar në argumente eklektike e metafizikë absurde.

Pasi konstaton se Kosova ishte ndarë administrativisht ndërmjet dy Luftërave Botërore jo përgjatë vijave të mëparshme administrative dhe historike (fq. 283), por me referencë tre lumenjtë e ish-Jugosllavisë (Vardarin, Moravën dhe Zetën) dhe me të vetmin qëllim prishjen e identitetit të saj territorial e politik, autori në kapitullin XIV "Kaçakët dhe kolonistët: 1918-1914" (fq. 265-269) kujdeset për një trajtim të thukët të anës legale të problemit. Shqiptarët nuk ishin as minoritet në Jugosllavinë e viteve 1918-1941, sado që ka autorë të mjaftë shqiptarë që mundohen të argumentojnë të kundërtën për të dalë në anën legale të problemit të së drejtës për vetëvendosje të shqiptarëve nën ish-Jugosllavi. Autori vepron ndryshe, ndërkaq, duke e ndarë çështjen në argumentet legale të së drejtës kushtetuese dhe në ato të së drejtës ndërkombëtare publike. Për të parat, autori ka marrë në një mënyrë krejt origjinale, si pikë referimi, nenin e katërt të Kushtetutës së Mbretërisë Serbe të vitit 1903, ku thuhej shprehimisht se ndryshimi i kufijve të Serbisë mund të bëhej vetëm pas një pëlqimi të Asamblesë së Përgjithshme, gjë e cila kurrë nuk është bërë pas okupimit të Kosovës dhe të viseve të tjera gjatë Luftërave Ballkanike (1912-1913).

Argumentet e së drejtës ndërkombëtare kanë të bëjnë me marrëveshjet e lidhura pas dëbimit të otomanëve në Luftërat Ballkanike. Pastaj, thotë autori, Marrëveshja e Londrës e vitit 1913, e lidhur mes Aleateve Ballkanik dhe Shtetit Otoman, kurrë nuk është ratifikuar nga Serbia, kurse ajo e Bukureshtit, e po atij viti, nuk e kishte si palë Perandorinë Otomane, nga e cila ishin marrë forcërisht territoret në Ballkan, përfshirë këtu Kosovën dhe viset tjera shqiptare. Këto dy fakte i bëjnë këto dokumente si të pavlefshme dhe të paefekt juridik-ndërkombëtar. Marrëveshja e vetme mes Serbisë dhe Perandorisë Otomane, e marsit të vitit 1914 (Marrëveshja e Stambollit), po ashtu kurrë nuk u ratifikua si rezultat i Luftës së Parë Botërore qe filloi në tetorin e vitit 1914. Problemi i Kosovës nuk është zgjidhur legalisht as në mes dy Luftërave Botërore, ngaqë Marrëveshja e Sevresit (1920) edhe ashtu u deklarua nga të tjerët si e pavlefshme ndërkombëtarisht, kurse ajo e Ankarasë (1925), e lidhur mes Jugosllavisë dhe Turqisë, nuk përmbante dispozita mbi territoret e aneksuara nga Perandoria Otomane gjatë viteve 1912-1913. Sado që kjo e

fundit bënte fjalë për njohje reciproke të palëve kontraktuese, Jugosllavisë dhe Turqisë, megjithatë fjala është për Jugosllavinë dhe Turqinë, si subjekte të reja të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Rrjedhimisht, edhe shqiptarët ishin bërë shtetas të ish-Jugosllavisë dhe jo të Serbisë. Këtë fakt dhe të tjerat si më sipër, konstaton me të drejtë autori, e pati sanksionuar edhe Ligji mbi Shtetësinë i ish-Jugosllavisë i vitit 1928, në paragrafin e katërt të pjesës së 55-të (fq. 264-66). Me fjalë të tjera, autori në mënyrë të shkëlqyeshme ka bërë një prezantim të fakteve që dëshmojnë se shqiptarët e ish-Jugosllavisë kanë qenë shtetas të saj dhe jo të Serbisë dhe se nuk ka pasur kontinuitet juridiko-ndërkombëtar mes Mbretërisë Serbe dhe ish-Jugosllavisë, të krijuar më 1918.

3. Konferenca e Bunjajt (1943-44)

Konferencës së Bunjajt, pas mbarimit të Luftës së Ftohtë dhe rënies së komunizmit, i janë dhënë dy elemente shtesë, të cilat ajo objektivisht nuk i ka pasur dhe as që i ka sot e kësaj dite. Nisur nga logjika se çdo gjë e ndaluar në kohën e komunizmit është me vlerë për të sotmen dhe të ardhmen e shqiptarisë, Bunjaj në Kosovë ka filluar të trajtohet, pas vitit 1990, si e vetmja bazë e së drejtës së Kosovës për vetëvendosje, duke e lidhur këtë ngjarje edhe me rastin e Kuvendit të Prizerenit të vitit 1945, kur, siç thuhet, Kosovës i është marrë me dhunë e drejta për vetëvendosje dhe, rrjedhimisht, kjo e drejtë duhet t'i kthehet tani. Përveç kësaj, Bunjaj është parë edhe si versioni kosovar i të ashtuquajturit AVNOJ (*Këshilli Antifashist i Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë*), i cili gabimisht mendohet se ka krijuar Jugosllavinë. Kjo e fundit, siç theksuam, ka ekzistuar prej vitit 1918 deri më 1992 kurse ngjarjet e gjatë-Luftës së Dytë Botërore i referohen vetëm ndryshimit të sistemit të qeverisjes jugosllave dhe jo krijimit të shtetit të ri jugosllav, ashtu siç ka qenë rasti edhe me Shqipërinë e asaj kohe dhe vendet tjera ballkanike, të cilat u kthyen në vende komuniste pas vitit 1945.

Për ndriçimin e kësaj çështje, autori ka marrë parasysh konsideratat gjeostrategjike dhe për Bunjajn konstaton se ka qenë organizuar si kundërpeshë e Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe një hap taktik i komunistëve sllavë për t'i nxitur masat shqiptare për luftë në anën e partizanëve (fq. 307). Zaten, kjo edhe e bën të dyshimtë skajshmërisht edhe vetë vlerën e vullnetit të shprehur aty, kryesisht nga një shtresë e caktuar socio-politike e Kosovës së asaj kohe dhe atë në formën kushtetuese. Kjo formë kushtetuese ka konsistu-

ar në faktin se vetëm pas luftës Kosova dhe "shqiptarët do të kenë mundësinë e vet për të vendosur për fatin e tyre dhe të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje". Rolin e familjes Kryeziu, të kolonel Muharrem Bajraktarit dhe të nacionalistëve tjerë gjatë Luftës së Dytë Botërore, autori e jep në një kontekst krejt të ri, duke mohuar ndarjen shabllone 50-vjeçare në komunistë dhe partizanë, përkatësisht në bashkëpunëtorë të forcave të Boshtit. Sidoqoftë, nga autori në asnjë mënyrë nuk është dhënë të kuptohet se e drejta e Kosovës për vetëvendosje buron nga Konferenca e Bunjajt. Për Kuvendin e Prizerenit (1945), në këtë libër flitet si për një kuvend që nuk ka mundur të përfaqësojë assesi dhe në asnjë mënyrë vullnetin e popullsisë së Kosovës (fq. 317), prandaj, as që ka nevojë të rikthehet e drejta e Kosovës për vetëvendosje, siç pretendohet nga autorët shqiptarë, kryesisht nga Kosova.

4. Çështja e bashkësisë hebraike në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore

Pas pogromit spanjoll të vitit 1492, sikundër dihet, shumica e hebrenjve kishin kërkuar dhe gjetur strehim në territorin e Perandorisë Otomane, pra edhe në trojet etnike shqiptare, të cilat atëherë ishin pjesë e saj. Botërisht dihet toleranca fetare e kësaj perandorie dhe veçanërisht mungesa e ndjenjave të antisemitizmit në kohën e lindjes së nacionalizmit modern, gjë që nuk ishte rasti me shumicën e vendeve të Evropës së asaj kohe.

Hebrenjtë, ashtu si bashkësitë tjera etnike, kishin jetuar në harmoni me shqiptarët gjatë tërë shekujve të sundimit otoman, gjë që nuk kishte ndodhur kështu me tjerët. Në Serbi, ta zëmë, me përjashtim të një periudhe shumë të shkurtër të sundimit të Princit Millosh, tërë koha tjetër karakterizohet me një ndjenjë theksuar të antisemitizmit dhe, më vonë, ai qe prezent në Serbi akoma para se të vinin forcat gjermane në prag të Luftës së Dytë Botërore, për çka dëshmon incidenti i njohur i shkaktuar në Fakultetin Teknik të Beogradit në vjeshtën e vitit 1940. Kurse, Millan Nediqi, sundimtari serb gjatë Luftës së Dytë Botërore, që më 1943 pati theksuar i pari në Ballkan se Serbia ishte vendi i vetëm i lirë në Evropë nga të gjithë hebrenjtë. Antisemitizmin në shoqërinë serbe e ka argumentuar shkencërisht autori Philip P. Cohen (Filip P. Kohen), në një libër të tij me titull *Lufta sekrete e Serbisë: propaganda dhe mashtrimi i historisë*, botuar vitin e kaluar (1997). Përveç në Serbi, Kroacia ka qenë vendi tjetër ballkanik ku ndjenjat antisemite kanë qenë të theksuara gjatë kohës së sundimit të Ante Pavelliqit dhe shtetit të tij të "pavarur kroat".

Në dy rastet, siç shihet, antisemitizmi ka qenë politikë e orkestruar dhe e centralizuar shtetërore, me kampe të veçanta përqendrimi për zhdukjen fizike të "racave inferiore", gjë që nuk ka qenë rasti me shtetin shqiptar të kohës së Luftës së Dytë Botërore. Për këtë, dëshmia më e mirë është mirënjohja e Kongresit Hebraik Botëror dhënë shtetit shqiptar menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore.

Kosova e Luftës së Dytë Botërore, ndërkaq, ishte ndryshe nga ky aspekt dhe fatkeqësisht vetëm në prag të mbarimit të saj. Në të vërtetë, forcat gjermane në fillim të vitit 1944 kishin provuar të bënin një mobilizim të shqiptarëve për t'i ndihmuar ata në përpjekje për tërheqje nga Kosova dhe viset tjera shqiptare. Ky mobilizim kurrë nuk arriti shkallën e një force të armatosur serioze, më së shumti deri në 6,491 vetë, kurse forcat e mobilizuara shqiptare qenë tepër joaktive si pasojë e rrethanave të ndryshme. Megjithatë, një numër i tyre, në fillim të majit 1944, u vendos në rrethin e Gjakovës për të ruajtur disa miniera atje dhe për të bërë arrestimet e nevojshme që mund të kërkoheshin nga forcat gjermane. Nga mesi i atij muaji, pjesëtarët e mobilizuar shqiptarë, të njohur si divizioni vullnetar SS "Skanderbeg", kreu një nga aktet më të turpshme në historinë moderne të Kosovës, duke rrethuar dhe deportuar 281 hebrenj të Kosovës. Këtë fakt e ka konstatuar autori në faqen 310 të librit, jo vetëm mbi bazën e literaturës shqipe e serbo-kroate, por edhe të asaj gjermane kohës. Mirëpo, aty nuk vërehjet se autori e konsideron këtë si pjesë të një strategjie të orkestruar dhe të centralizuar shtetërore të shtetit shqiptar të Luftës së Dytë Botërore, siç ka qenë rasti, ta zëmë, me Serbinë dhe Kroacinë. Sidoqoftë, kjo duhet të jetë një nxitje për historiografinë kosovare për ndriçimin deri në fund të rrethanave të këtij akti makabër. Kjo edhe për faktin e thjeshtë se nga një sondim provizor që kam pasur me disa kosovarë të moshuar sikur del se një pjesë e shqiptarëve ka provuar strehimin dhe ndihmën e hebrenjve gjatë kësaj fushate antisemite të divizionit SS "Skanderbeg". Kur them se ky akt i shëmtuar ka qenë pjesë e një politike të orkestruar dhe të centralizuar shtetërore, nuk mendoj se duhet liruar aspak nga përgjegjësia gjenerata e Luftës së Dytë Botërore në Kosovë. Krejt çfarë dua të them është se antisemitizmi në Kosovë nuk ka qenë kurrë politikë shtetërore sepse i tillë ka qenë niveli i nacionalizmit shqiptar të kohës. Dhe, kjo mund të argumentohet shkencërisht në çdo kohë.

Përfundim

1.

Nacionalizmi serb dhe natyra e tij egalitare (populliste) janë shpjeguar nga autori i librit me mospasjen e një aristokracie të lindur në Serbi, si pasojë e rrethanave të krijuara nga sundimi otoman. Roli i Kishës Ortodokse Serbe në formësimin e nacionalizmit modern serb sigurisht që ka qenë dominant në lindjen e këtij lloji të nacionalizmit në shoqërinë serbe. Lidhja emotive serbe dhe e Kishës me Kosovën daton fare vonë dhe i referohet një koincidence historike aty rreth vitit 1290, sado që sundimtarët serbë e kishin pasur Kosovën si vend të burimeve të pasura natyrore, por jo edhe si qendër administrative, me fillim që nga Nemanja e deri te Princi Lazar.

Shqiptarëve u ka munguar një lidhje kohezive në kohën e lindjes së nacionalizmit modern në Ballkan dhe gjuha ishte i vetmi mjet koheziv ndër shqiptarët. Dallimet gjuhësore mes jugut dhe veriut të shqiptarisë nuk janë aq të mëdha, sipas autorit, së paku jo aq sa dramatizohen ndër ne nganjëherë.

2.

Lidhur me anën legale të çështjes së Kosovës, me kuptim të drejtën për vetëvendosje të popullit të saj shumicë, autori në një mënyrë *par excellence* ka dhënë argumentet kushtetuese dhe të së drejtës ndërkombëtare. Mbi bazën e tyre provohet lehtë se Kosova kurrë nuk ka qenë Serbi, por pjesë e një shteti të quajtur, tanimë, ish-Jugosllavi dhe qe krijuar më 1918. Mosekzistimi i kontinuitetit juridiko-ndërkombëtar mes ish-Jugosllavisë dhe Mbretërisë Serbe e bën të paqëndrueshme tezën serbe për të drejtën e tyre për të qeverisur me Kosovën dhe popullsinë e saj shumicë. Kjo theksohet qartë në libër dhe është një kontribut i çmueshëm në betejën e ardhshme që Kosova dhe intelektualët e saj do ta kenë në planin legal kundrejt bashkësisë ndërkombëtare dhe vetë serbëve.

3.

Gjatë historisë së tyre, shqiptarët nuk kanë ushqyer kurrë ndjenja antisemitizmi, veçanërisht jo në kuptim të bërjes së tij politike zyrtare, çfarë ka qenë rasti, ta zëmë, me Serbinë dhe Kroacinë. Në shtetin shqiptar të kohës së Luftës së Dytë Botërore sigurisht që nuk ka pasur asnjë legjislacion antisemit, gjë që nuk ka qenë rasti me vendet e tjera të Ballkanit. Prapëseprapë, në historinë moderne të Kosovës, në muajt e fundit të mbarimit të Luftës së Dytë

Botërore, është shënuar një rast makabër i arrestimit dhe depërtimit nga zona e Gjakovës të 281 hebrenjve kosovarë, fakt të cilin e ka konstatuar edhe autori i librit. Kjo del si një sfidë e re për historiografinë kosovare dhe më gjerë për ndriçimin e këtij incidenti dhe vënien e drejtësisë në vend. Kjo edhe për faktin e thjeshtë të provimit të shpirtit tolerant të shqiptarëve ndaj kulturave dhe civilizimeve të tjera.

Mesazhi i autorit të librit nuk lidhet vetëm me pjesën e parë të shqyrtimeve tona këtu, pra, me ato që kanë të bëjnë me nacionalizmin serb. Çfarë është, pra, mesazhi i librit që ne sot diskutojmë këtu dhe që mbetet aktual sot, veçanërisht sot?! Vetëm atëherë kur serbët e thjeshtë të mësojnë të mendojnë racionalisht dhe në mënyrë humane për Kosovën dhe kur të jenë më kritikë ndaj miteve të tyre nacionale, të gjithë popujt e Kosovës dhe Serbia do të përfitojnë, e serbët më së shumti, konstaton autori i librit në rreshtat e fundit të faqes 356. Edhe pse në disa recensione për librin në fjalë që kam lexuar këtyre ditëve pohohet se autori Noel Malcolm nuk propozon ndonjë zgjidhje për Kosovën, unë mendoj se pikërisht rreshtat e mësipërm janë propozimi më i qëlluar për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe asgjë më tepër.

Kapitulli IV

MBI MARRËDHËNIET ME GJYKATËN SUPREME DHE VENDIMET QË BËNË HISTORINË E GJYQËSISË KUSHTETUESE NË KOSOVËN E PAVARUR DHE SOVRANE

Sfondi historik: Në kuadër të këtij kapitulli jepen disa shkrime të cilat janë botuar viteve të fundit, pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese në fillim të vitit 2009 — më saktë, pas bërjes së saj funksionale më datën 26 qershor 2009. I pari ndër këto shkrime, krejt natyrshëm, është ai që flet për marrëdhëniet mes Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme.

Jo vetëm për laikët, por edhe për komunitetin juridik kosovar, gjyqësia kushtetuese ishte diçka krejt e re. Si e tillë nuk njihej dhe krijonte konfuzitet në opinionin publik, i cili nuk ishte mësuar që një gjykatë e lartë (Gjykata Kushtetuese) t'ia prishë vendimet një gjykate tjetër po ashtu të lartë (Gjykatës Supreme). E vetmja pikë referimi për gjyqësinë kushtetuese kosovare ishte ish-Jugosllavia dhe Kosova e asaj kohe, kur pati ekzistuar një version socialist i kësaj gjyqësie, por që nuk ushtrohej nga juristë, por kryesisht nga njerëz të ardhur nga jeta shoqërore e politike. Jo vetëm kaq! Gjyqësia kushtetuese ish-jugosllave, në të gjitha nivelet, nuk njihte fare ankesën individuale, e cila përbën sot në krejt Evropën mbi 90 për qind të procedurave dhe të ngarkesës së punës së gjykatave kushtetuese. Përveç këtij fakti, kishte edhe një faktor tjetër subjektiv që shërbente si burim i keqkuptimeve në opinion: pjesa dërmuese e juristëve kosovarë që kishin bërë një emër në komunitetin juridik kosovar aplikuan për pozitën e gjyqtarit në pranverën 2009 dhe shumica prej tyre dështuan. Kjo shumicë më pastaj do të aplikojë edhe në konkurset tjera për pozitën e gjyqtarit dhe asnjëherë nuk do ta arrijë. Në opinionin që krijohej rreth gjyqësisë kushtetuese kosovare, ky grupim i njerëzve me një zell të pashoq bënte analizën e punës së Gjykatës Kushtetuese, e në fakt krijonin opinione jo duke analizuar vendimet e saj, por profilin psikologjik e tjetër të kryetarit, autorit të këtyre rreshtave, e nganjëherë edhe të disa prej kolegëve që shërbyen me mua.

Për të evituar këto keqkuptime, të cilat në të shumtën e rasteve ishin jo të sinqerta dhe krejt qëllimkëqija, Gjykata Kushtetuese organizoi të ashtuquaj-

turat programe të vetëdijesimit të të gjithë akterëve kosovarë të cilët mund të hynin nën juridiksionin e Gjykatës si palë të autorizuara që mund të aplikonin pranë saj për ta vënë në lëvizje. Përveç kësaj, me Gjykatën Supreme, ku më së shumti kishim krijuar keqkuptime me vendimet tona, u morëm vesh që të ulemi së bashku në një konferencë të veçantë. Këtë konferencë, të cilën e financuan gjermanët, fondacioni GIZ, e organizuam si të përbashkët me Gjykatën Supreme edhe me Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë. Punimet dhe diskutimet nga kjo konferencë, e cila u mbajt në nëntor 2010 në Prishtinë, u përmblodhën në një libër. Botimi u bë pas dy vjetësh në Gjermani, dhe përfshiu punimin e autorit të këtyre rreshtave,[113] në ndërkohë që versioni shqip i punimit qe botuar një vit më herët në revistën *E drejta*[114].

Shkrimi i dytë me radhë është ai që ka të bëjë me ankesën kushtetuese. Ky mjet juridik kushtetues përbën një risi në Kosovë. Ky fakt ka qenë dhe ngelet shkaktari kryesor i keqkuptimeve në opinionin publik lidhur me vendin dhe rolin e Gjykatës Kushtetuese në sistemin juridik-kushtetues kosovar. Ankesa kushtetuese ka origjinën, historikisht shikuar, në Amerikën Latine në institucionin e njohur si *amparo*. Mirëpo, në formën që e njohim sot në Evropë, origjinën e saj e ka në Gjermani, ku edhe ka arritur kulmin e suksesit të saj. Pas Gjermanisë, Spanja dhe praktika e Gjykatës së saj Kushtetuese përbëjnë modelin tjetër të tregimit të suksesshëm të procedurave të nisura përmes ankesës kushtetuese, po ashtu të emërtuar si *amparo*. Procedurat e nisura përmes ankesës kushtetuese, në Kosovë dhe gjetiu, përbëjnë pjesën dërrmuese të procedurave që zhvillohen në gjykatat kushtetuese të cilat e njohin këtë mjet juridik kushtetues. Për të qenë më të saktë, mbi 90 për qind e punëve të gjykatave kushtetuese aktualisht kanë të bëjnë me procedurat e nisura sipas ankesës kushtetuese. Kosova nuk bën asnjë përjashtim. Ka qenë ankesa kushtetuese ajo që ka nisur procedurat në Gjykatën Kushtetuese që kanë çuar në rastet e caktuara në prishjen e vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe, për pasojë, në krijimin e keqkuptimit në mes këtyre dy institucioneve të vendit tonë. Ngjashëm ka ndodhur edhe me të gjitha vendet e ish-lindjes komuniste ku ekziston instituti i ankesës kushtetuese. Nëpër këto vende, gjy-

---

[113] Enver Hasani, "Constitutionalism in Kosovo and the Relationship between Constitutional Justice and the Supreme Court", në Enver Hasani, Peter Paczolay and Michael Reigner (eds.), *Constitutional Justice in Southeast Europe: Constitutional Courts in Kosovo, Serbia, Albania and Hungary between Ordinary Judiciaries and the European Court of Human Rights* (Nomos: Baden, 2012). Versioni shqip i këtij shkrimi është botuar në

[114] Enver Hasani, "Marrëdhënia ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme të Kosovës", *E drejta/Law* nr. 2 (2011).

katat kushtetuese janë cilësuar si gjykata të shkallës së katërt sepse ato kanë të drejtën e prishjes së vendimeve të instancave më të larta të gjyqësorit të rregullt. Kjo, u mor vesh, nuk është kështu dhe do të shihet nga shkrimi në vijim, i cili në versionin origjinal është botuar jashtë Kosovës, kurse në Kosovë në revistën *E drejta*. Si i tillë, punimi është bashkautorësi e imja dhe e dy kolegëve të nderuar nga Fakulteti Juridik, profesorëve Fisnik Korenica dhe Dren Doli respektivisht[115].

Shkrimi i tretë që ribotohet këtu ka të bëjë me një kumtesë të cilën e pata lexuar me rastin e njëzetvjetorit të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, me të cilën kemi pasur marrëdhënie të jashtëzakonshme profesionale e vëllazërore. Jo rastësisht më këtë rast pata zgjedhur edhe titullin e temës, që trajtonte momentet kyçe të gjyqësisë kushtetuese kosovare, momente të cilat i kishte përcaktuar dhe vulosur vetë Gjykata Kushtetuese. Më pastaj, kumtesat nga ky përvjetor u botuan si libër nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze[116].

Shkrimi i katërt dhe i fundit në këtë kapitull i dedikohet rolit dhe pozitës së shefit të shtetit nga perspektiva krahasuese, si dhe mbrojtjes së këtij institucioni kushtetues nga shkarkimi jokushtetues përmes amendamenteve kushtetuese. Pika nisëse e punimit është ushtrimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese e kontrollit preventiv abstrakt kushtetues të 11 amendamenteve të propozuara kushtetuese. Gjykata i shpalli jokushtetuese mbi 60 për qind të tyre, përfshirë dhe amendamentin X, i cili është objekt diskutimi parësor në këtë shkrim. Me këtë rast, Gjykata e ka bërë të qartë se ndërprerja e parakohshme e mandatit të shefit të shtetit përmes nxjerrjes së amendamenteve të reja kushtetuese është jokushtetues. Ky shkrim përfundimisht provon në mënyrë shkencore se nuk ekziston një gjykatë serioze e cila do të mund të merrte parasysh argumentet *ad hominem* në rastet që kanë të bëjnë me kontrollin abstrakt të ligjeve dhe të amendamenteve kushtetuese dhe sërish të quhej gjykatë profesionale.

---

[115] Enver Hasani, "Individual Complaint Mechanism as a Means to Protecting Fundamental Human Rights and Freedoms: The Case of the Constitutional Court of Kosovo", *European Yearbook on Human Rights* (Antwerp, 2012); Enver Hasani, Dren Doli dhe Fisnik Korenica, "Mekanizmi i ankesave si mjet për mbrojtjen e të drejtave themeloredhe lirive të njeriut: rasti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës", *E drejta/law* nr. 3-4 (2013).

[116] Enver Hasani, "Vendimet kryesore që bënë historinë kushtetuese në Kosovë", botuar në përmbledhjen e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë me titull *Ndarja dhe balancimi i pushteteve dhe roli i kontrollit kushtetues* (Hans Seidel Stiftung: Tiranë, 2012). Konferenca është mbajtur më datën 7 dhe 8 qershor 2012.

Versioni i plotë i këtij shkrimi është botuar për herë të parë në revistën *E drejta* të Fakultetit Juridik të Prishtinës[117], kurse më pastaj është botuar në Vjenë[118] një version i tij shkurtër dhe i përpunuar me qëllim që lexuesi i huaj ta analizojë dhe vlerësojë vetë qasjen vendore akademike ndaj doktrinës së a.q. amendamentet (jo)kushtetuese, rolit dhe pozitës së shefit të shtetit në sistemin kosovar, si dhe qasjen ndaj pamundësisë së largimit nga detyra të shefit të shtetit përmes nxjerrjes së amendamenteve kushtetuese të cilat ndryshojnë mandatin fillestar të këtij organi kushtetues kaq të rëndësishëm për stabilitetin institucional të tërë sistemit juridiko-kushtetues.

[117] Enver Hasani, "Kontrolli Abstrakt dhe Preventiv (paraprak) i Amendamenteve Kushtetuese dhe Mbrojtja nga Shkarkimi i Shefit të Shtetit: Rasti i Kosovës", *E drejta/Law* nr. 1/2013 (botim special).

[118] Enver Hasani, "Constitutional Protection of the Head of State: The Case of Kosovo", në *Vienna Journal on International Constitutional Law — ICL Journal* vol. 7, no. 2 (February 2013).

I. Marrëdhënia ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme të Kosovës

Hyrje

Objekt shqyrtimi në këtë studim është marrëdhënia ndërmjet Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Ky shqyrtim bazohet në rastet nga këto dy Gjykata, si dhe në kornizën kushtetuese dhe ligjore që e rregullojnë këtë marrëdhënie. Për ta arritur qëllimin kryesor të këtij studimi, ne i kushtojmë vëmendje të madhe historisë dhe praktikës së kushtetutshmërisë siç perceptohet dhe kuptohet tani në mbarë botën. Shpresojmë që me këtë mund të ndihmojmë në krijimin e një pozite të fortë për Kosovën ndër demokracitë e sapothemeluara kushtetuese të Evropës. Arsyeja kryesore për këtë qasje është fakti që Kushtetuta e Kosovës është e modeluar sipas traditës kontinentale kushtetuese dhe juridike të perëndimit, para së gjithash traditës së Gjermanisë së pasvitit 1945 bazuar në *Grundgesetz* — GG, e njohur si e drejta themelore, e shpallur më 23 maj 1949.

Në pajtim me këtë që u tha më lart, çështja e kushtetutshmërisë dhe tiparet e saj do të shqyrtohen gjerësisht në pjesën e parë të këtij studimi. Roli dhe vendi i pavarësisë gjyqësore dhe i vlerësimit të kushtetutshmërisë do të vlerësohen më pas.

Roli dhe natyra e kontrollit gjyqësor në Kosovë në lidhje me praktikën gjyqësore dhe kornizën ligjore që e rregullojnë punën dhe juridiksionin e Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës Kushtetuese do të shqyrtohen në pjesën e dytë të këtij studimi. Ky elaborim pasohet nga analiza mbi trendet e përgjithshme të marrëdhënies ndërmjet këtyre dy institucioneve, pa pasur asnjë iluzion që kjo analizë e shkurtër është shteruese. Në vend të kësaj, qëllimi ynë është shumë modest. Ne synojmë ta mbështesim një debat lidhur me natyrën e kësaj marrëdhënieje në vend se të arrijmë në konkluzione përfundimtare dhe të fuqishme për këtë çështje.

1. Kushtetutshmëria dhe vlerësimi i kushtetutshmërisë

Ideja e kontrollit gjyqësor është pjesë dhe pako e idesë dhe betejës për kushtetutshmëri, edhe pse e dyta është më e vjetër se e para. Ndonëse zanafilla e saj daton që nga mesjeta[119], zbatimi i parë i kontrollit gjyqësor duket të ketë ndodhur vetëm në vitin 1803 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në rastin e njohur *Marbury kundër Madison-it*. Ky ishte produkt i ardhjes së modernizmit dhe i besimit se "iluminizmi", "arsyeja" dhe besimi në progres nuk ishin domen ose rezervë vetëm e letërsisë dhe artit, por edhe e fushave të tjera të jetës dhe punës së njeriut, si gjyqësori. Shikuar nga kjo perspektivë, kontrolli gjyqësor është lloj elitë i institucionit, ndërsa kushtetutshmëria i takon klasës së mesme si instrument i luftës për t'iu kundërvënë sundimtarëve që nga mesjeta.[120]

Përveç këtij dallimi ndërmjet kushtetutshmërisë dhe kontrollit gjyqësor sa i përket paraqitjes së kësaj të fundit në këtë fazë historike, ekziston edhe një dallim tjetër ndërmjet këtyre dy fenomeneve që pasqyron tipare më të thella dhe më të plota. Ai dallim lidhet me natyrën dhe funksionin e kushtetutshmërisë dhe të kontrollit gjyqësor. Për nga natyra, kontrolli gjyqësor është institucion funksioni kryesor i të cilit është zbatimi gjyqësor i kushtetutës, ndërsa kushtetutshmëria është ideal përmbushja e të cilit kërkon gjykime normative lidhur me tri veçoritë e tij kryesore:

a. sundimi i ligjit;
b. kufizimet e pushtetit; dhe
c. të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.

a.

Gjatë historisë, sundimi i ligjit ka pasur kuptime të ndryshme në tradita të ndryshme juridike. Kjo shihet nga nocioni që po përdoret për ta paraqitur konceptin amerikan të sundimit të ligjit dhe për ta dalluar atë nga koncepti

---

[119] Për një analizë të plotë teorike dhe historinë e fenomenit të kushtetutshmërisë, shih më tepër në Nannerl O. Keohane, "Claude de Syessel and Sixteenth Century Constitutionalism in France", në J. Roland Pennock and John W. Chapman (eds.), *Constitutionalism* (New York UP: New York, 1979) fq. 47-83; Bruno Aguilera, "Law as Limit to Power: The Origins of the Rule of Law in the European Legal Tradition", në Susana Galera (ed.), *Judicial Review: A Comparative Analysis Inside the European Legal System* (Council of Europe Publishing: Strasbourg, 2010) fq. 15-35.

[120] Krahaso më tepër për këtë në Norman Dorsen, Michael Rosenfeld, Andras Sajo and Susanne Baer (eds.), *Comparative Constitutionalism: Cases and Materials* (West Group: Minneapolis, 2003) fq. 1-98, në 14.

gjerman *Rechtsstaat* dhe nga koncepti francez *État de droit*.[121] Megjithatë, koncepti që është duke u shqyrtuar, përkundër kuptimeve të veta të ndryshme në kultura të ndryshme juridike, ka ca përmbajtje minimale, përveç përmbajtjes maksimale dhe kërkesave të veta.[122] Në versionin e vet "të ngushtë", sundimi i ligjit kërkon sundim të drejtë dhe të hapur përmes normave të përgjithshme të mundshme që gëzojnë parashikueshmëri të madhe juridike të cilat kërkojnë që ato të publikohen që më parë në mënyrë që publiku të jetë në dijeni për ekzistimin e tyre, ndarjen e qartë ndërmjet pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe, së fundi, mbështetja e gjerë për propozimin që askush nuk është mbi ligjin. Megjithatë, kjo nuk mjafton për ekzistimin e një demokracie kushtetuese. Ajo ka kërkesa të tjera dhe kërkon më tepër se vetëm atë. Në versionin e vet "më të gjerë", sundimi i ligjit ka të bëjë me legjitimitetin e sundimit. Për të qenë legjitim, sundimi i ligjit duhet të përfshijë elemente të përgjegjësisë demokratike, paanësinë procedurale dhe mbështetjen substanciale për vlerat liberale (si vlerat e drejtësisë dhe pavarësinë e gjyqësorit, barazinë, lirinë, mbrojtjen e pakicave, etj.).[123]

Përveç dy kuptimeve të sipërpërmendura tradicionale të sundimit të ligjit, ekziston edhe kuptimi i tretë, i cili është krijuar nga studiuesit pas rënies së komunizmit: sundimi i ligjit në transicion. Si i tillë, ky koncept dallon nga kuptimet tradicionale të shqyrtuara më lart, sepse, siç e ka thënë themeluesja e këtij koncepti, Ruti Teitel, "në shoqëritë në transicion, ligji gjendet ndërmjet të kaluarës dhe të ardhmes, ndërmjet shikimit prapa dhe shikimit

---

[121] Krahaso Pietro Costa and Danilo Zolo (eds.), *The Rule of Law: History, Theory and Criticism* (Springer: Netherlands, 2010) fq. 153-319.

[122] Disa autorë i definojnë këto si kuptim "të ngushtë" dhe "të gjerë" të sundimit të ligjit. Krahaso Jane Stromseth, David Wippman and Rosa Brooks, *Can Might Make Rights? Building the Rule of Law After Military Interventions* (Cambridge UP: Cambridge, 2006) fq. 56-84, në 70-71.

[123] Krahaso më tepër për këtë në studimin shumë të detajuar dhe elokuent të Vicki C. Jackson, *Constitutional Engagement in a Transnational Era* (Oxford UP: Oxford, 2010) fq. 1-102, 254-285, posaçërisht në fq. 259-261, ku autori shqyrton rolin e bashkësisë ndërkombëtare në legjitimimin e kushtetutave vendëse lidhur me sundimin e ligjit në kuptimin e vet "më të gjerë" të shqyrtuar nga ne në këtë studim. Sa i përket gjyqësorit, ekziston një konsensus themelor ndër demokracitë perëndimore se në çdo rast gjyqësori duhet të jetë i paanshëm dhe i pavarur posaçërisht nga ndërhyrja e qeverisë. Krahaso më tepër për këtë edhe në Aalt Willem Heringa and Philip Kiiver, *Constitutions Compared: An Introduction to Comparative Constitutional Law*, 2d ed. (Intersentia: Antwerp, 2009) fq. 21-23, 145-170.

para, ndërmjet retrospektivës dhe perspektivës".[124] Kjo më tej do të thotë se ajo që shfaqet në këto shoqëri në transicion është koncepti i drejtësisë së kontekstualizuar dhe të pjesshme: ajo krijohet nga transicioni dhe është pjesë përbërëse e transicionit.[125]

Tipari më i pranuar dhe më i përgjithshëm i këtyre tri kuptimeve që janë duke u shqyrtuar është se çelësi për zbatimin e sundimit të ligjit është gjyqësori i pavarur. Pa gjyqësor të pavarur nuk mund të ketë diskutime për sundimin e ligjit në asnjërin prej kuptimeve të shqyrtuara më sipër.[126]

b.

Kufizimet e pushtetit, si karakteristikë e dytë e idealit të kushtetutshmërisë, fillojnë me të ashtuquajturën "qeveri e përzier". Ky ishte hapi i parë në kufizimin e pushtetit të mbretit në Anglinë e shekullit XVII. Kjo quhej "qeveri e përzier" sepse ishte përzierje e sundimit nga mbreti, feudalët dhe populli; kjo paraqiste një ndarje fizike të pushteteve, por, në të njëjtën kohë paraqiste edhe dobësim të konceptit anglez të sundimit parlamentar suprem dhe absolut.[127] Kjo formë e balancimit të pushteteve u shfaq si rezultat i reagimit *ab intra* të forcave shoqërore duke shpurë, si rrjedhojë, në një kufizim *de facto* të pushtetit në Angli në atë kohë. Si e tillë, kjo paraqet zanafillën e praktikës së ndarjes së pushteteve për t'u shfaqur më vonë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kufizimet e pushtetit në "qeverinë e përzier" burojnë nga balancimi i forcave brenda qeverisë po aq sa nga cilado dispozitë specifike kushtetuese.[128]

---

[124] Ruti Teitel, "Transitional Rule of Law", në Adam Czarnota, Martin Krygier and Wojciech Sadurski (eds.), *Rethinking the Rule of Law After Communism* (CEU Press: Budapest, 2005) fq. 279-294, në 279.

[125] Po aty, 280.

[126] Krahaso më tepër në Tom Bingham, *The Rule of Law* (Penguin Books: London, 2010) fq. 171-174.

[127] Krahaso më tepër për këtë në M.J.C. Ville, *Constitutionalism and the Separation of Powers* (Liberty Fund: Indianapolis, 1998) kapitulli I, fq. 1-23.

[128] Në të vërtetë, vlen të ceket se edhe sistemet më mizore dhe brutale, si ato të udhëhequra nga Stalini dhe Hitleri, apo sistemet e tjera despotike nga kohët antike, nuk mund të jenë absolute sepse vetë jeta dhe forcat shoqërore përreth saj krijojnë kufizime në çdo pushtet, pa marrë parasysh sa i vrazhdë mund të jetë. Ajo që po shqyrtohet këtu ka të bëjë me kufizimet e pushtetit të vendosura me vetëdije nga veprimi i njerëzve në marrëveshjet e tyre politike. Shprehja "qeveri e kufizuar" përdoret pikërisht në këtë kuptim, pra si cilado formë tjetër e qeverisë në të cilën pushteti sovran kufizohet me ligj, kushtetutë ose instrumente që paraqesin kontrollin dhe balancimin për ushtrimin e saj. Krahaso më tepër për këtë, studimin elokuent në tri vëllime nga S.E. Finer, *The History of Government* vol. I-III (Oxford UP: Ox-

Llojet e qeverisë së kufizuar janë po ashtu të shumta si mënyrat për kufizimin e pushtetit të ashpër: pushteti nganjëherë kufizohet përmes kushtetutës, nganjëherë përmes balancimit ndërmjet pushteteve të tjera. Qeveria e kufizuar, e bazuar në kushtetutë dhe në ndarje të pushteteve si mënyrë e kontrollimit dhe balancimit të pushtetit, gjithashtu, mund të quhet qeveri kushtetuese. Megjithatë, qeveria kushtetuese është më shumë se kaq. Ajo nuk varet vetëm nga balancimi i pushteteve duke u bazuar në kushtetutë: qeveria kushtetuese është formë e qeverisë së kufizuar në të cilën kushtetuta, bashkë me ligjin dhe zyrat e tjera të parapara nga ajo, i parashikojnë kufijtë për ushtrimin e pushtetit, dhe miratimin e çdo ushtrimi të pushtetit, ku asnjë zyrtar nuk mund ta shkelë kushtetutën pa pushuar së mbajturi pushtetin ligjor dhe pa u larguar nga zyra. Hobs, Lok, Monteskjë dhe shumë përkrahës të tyre zhvilluan teori të qeverisë kushtetuese, versionet e të cilës tani pranohen gjerësisht si paraqitje e vërtetë e lirisë politike dhe mënyrë e preferuar e ushtrimit të pushtetit politik. Ky pushtet qeveritar nuk shpreh vetëm vullnetin e atyre që e zotërojnë atë, por edhe të drejtat e qytetarëve që i qeverisin. Me fjalë të tjera, qeveria kushtetuese kërkon që përveç ndarjes së pushteteve dhe sundimit të ligjit, ushtrimi i pushtetit të bëhet përmes zyrës. Kryesore për të gjitha këto është aftësia e qytetarit për t'i kontestuar përmes rrugëve gjyqësore aktet *ultra vires* të organeve publike, bashkë me rregullat dhe garancitë procedurale që i bëjnë pushtetet legjitime të dallueshme.[129]

Pothuaj të gjitha shtetet bashkëkohore kanë kushtetuta që e rregullojnë ushtrimin e pushtetit. Megjithatë, duket që vetëm disa prej tyre janë kushtetuese. Fusha e të drejtave të njeriut është testi kryesor për të zbuluar nëse qeveria kushtetuese është duke u ushtruar mirëfilli ose nëse është vetëm farsë, mbulesë për ushtrim të paligjshëm të pushtetit politik.

c.

Sa i përket gjykimit normativ të tiparit të tretë të kushtetutshmërisë, siç u përmend më lart, pra e trajtimit ideal të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, vlen të përmendet se kjo paraqet thelbin e betejës së njeriut për kushtetutshmëri. Në fillim, ideja dhe ushtrimi i të drejtave të njeriut u zhvillua me sistemet nacionale të shteteve sovrane, duke filluar me të famshmen *Magna Carta* (1215), dokumentet revolucionare të ShBA-ve dhe Francës,

---

ford, 1999), posaçërisht vol. I, fq. 72-94, ku autori krijon një tipologji të kufizimit të pushtetit duke u bazuar në atë se si këto kufizime në pushtet janë bërë gjatë historisë së njerëzimit.

[129] Krahaso më tepër për këtë në Friedrich A. Hayek, *The Constitution of Liberty* (Univ. Chicago Press: Chicago, 1978).

Deklaratën elokuente të Pavarësisë së Amerikës (4 korrik 1776), dhe Deklaratën Franceze për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit (26 gusht 1789). Zhvillimet kushtetuese brenda shteteve lidhur me rolin dhe rëndësinë e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore ishin të dy llojeve: e para është qasja liberale, siç është pranuar nga Shtetet e Bashkuara, e cila vë theks në lirinë individuale përballë autoriteteve publike në mënyrë që autoritetet publike të kenë sa më pak ndikim në jetën e qytetarit, kurse e dyta është qasje e Evropës Perëndimore. Përveç mbështetjes dhe mbrojtjes vertikale të të drejtave dhe lirive të njeriut, ajo përqendrohet edhe në mbrojtjen dhe mbështetjen horizontale përballë individëve të tjerë si fqinjë dhe në marrëdhëniet e tyre që shfaqen si rezultat i jetesës së përbashkët.

Përveç këtyre karakteristikave brenda sistemeve nacionale, ekziston edhe një dallim tjetër në këtë drejtim, i cili buron nga zhvillimet politike ndërkombëtare që ekzistonin gjatë Luftës së Ftohtë e më vonë. Ato ishin dallime që ekzistonin në ish-botën komuniste dhe në pjesën tjetër të botës liberale perëndimore, që u sanksionuan në Aktin Final të Helsinkit në vitin 1975. Ky Akt është interesant pasi parashtronte një problem kryesor për filozofinë e të drejtave të njeriut: a janë të gjitha të drejtat me të vërtetë liri në kuptimin se janë kufizime mbi aktet e të tjerëve? Apo, a janë disa të drejta gjithashtu edhe detyra që kërkojnë sigurimin aktiv të asaj që nuk është në dispozicion pa përpjekje të njeriut? Lista e parë e të drejtave, e propozuar nga popujt e shteteve perëndimore, ndoqi mostrën e lirisë — pra, përbëhej nga një grup i kufizimeve lidhur me atë se çfarë mund të bëjë shteti për qytetarët (p.sh., t'i arrestojë në mënyrë arbitrare, t'i burgosë pa gjykim, t'i dënojë për shprehje të pikëpamjeve personale, etj.). Ish-vendet komuniste, të pasuara nga vendet e botës së tretë, insistonin që disa të drejta të tjera duhej të shtoheshin — posaçërisht e drejta e punës (si dhe të drejta të tjera shoqërore dhe ekonomike), e cila kërkon që shteti dhe agjencitë e tjera vazhdimisht të ofrojnë mundësi, e jo vetëm të lejojnë që gjërat të ndodhin në kuptimin e demokracive liberale të perëndimit, për të cilat kishin luftuar. Kjo retorikë ndërkombëtare ka vazhduar që nga miratimi i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (1948), të dy paktet për të Drejtat e Njeriut të vitit 1966, dhe u reflektua në të gjitha kushtetutat e të dy anëve të ndarjes lindje-perëndim. Në të vërtetë, beteja për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore gjatë Luftës së Ftohtë ishte vetëm një pasqyrim tjetër i frymës mbizotëruese të kushtetutshmërisë në ish-vendet komuniste dhe në ish-vendet e botës së tretë të kundërshtuar nga perëndimi liberal.

Edhe pse Lufta e Ftohtë mbaroi dhe komunizmi ra, koncepti liberal i zbatimit universal të të drejtave të njeriut ende ballafaqohet me dilemat dhe problemet që i ka hasur gjatë pjesës më të madhe të shekullit të kaluar. Kalimi i ish-vendeve komuniste në demokraci nuk kaloi pa probleme serioze dhe vakumi të cilin e la pas u plotësua me ideologji dhe praktika të tjera nacionaliste po ashtu të pafavorshme për të drejtat e njeriut dhe mbështetjen e tyre. Megjithatë, duhet të vihet në pah se pothuaj të gjitha ish-vendet komuniste e pranuan dhe plotësisht e përfshinë në kushtetutat e veta konceptin themelor të të drejtave dhe lirive të njeriut, duke përfshirë mekanizmat praktikë për zbatimin e tyre, të modeluar sipas standardeve liberale perëndimore. Kapituj të posaçëm të këtyre kushtetutave parashikonin dispozita themelore për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Megjithatë, ekziston një e drejtë e njeriut, e cila, kur u kuptua, duket se u pranua botërisht, dhe, kur u mbështet, duket ta ketë përshpejtuar kalimin nga tirania në qeveri kushtetuese — e drejta për proces të rregullt dhe pavarësia gjyqësore që ajo e kërkon.

2. Kontrolli gjyqësor në Kosovë

Gjykata Kushtetuese e Kosovës është institucioni i fundit i këtij lloji i themeluar në Evropë. Me këtë dua të them Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Kosova kishte Gjykatën e vet Kushtetuese gjatë kohës së komunizmit, prej vitit 1972 deri në vitin 1989, kur u suprimua nga Millosheviqi dhe regjimi i tij bashkë me suprimimin e autonomisë së Kosovës.[130] Në teori dhe nga pikëpamja historike, kjo do të thotë që drejtësia kushtetuese e Kosovës i takon gjeneratës së dytë të këtij lloji të drejtësisë së themeluar pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Siç e dimë, ky lloj i drejtësisë bën dallimin ndërmjet kontrollit gjyqësor dhe vlerësimit të kushtetutshmërisë.[131] Ky sistem i kontrollit gjithashtu njihet si modeli kelsenian sepse është i bazuar në një gjykatë kushtetuese të veçantë që e zbaton drejtësinë kushtetuese dhe dal-

[130] Miroslav Cerar, "Slovenia's Constitutional Court within the Separation of Power", në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010) fq. 213-245, në 213, fusnota 2.

[131] Krahaso më tepër për zhvillimet kushtetuese në ish-Jugosllavi prej vitit 1963 në Dr. Jovan Gjorgjeviq, *E Drejta Kushtetuese* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1972) fq. 75-114; dr. Dimitrije Kulić, *Ustavno sudstvo u svetu* (Gjyqësia kushtetutese në botë) (Naša Reč: Leskovac, 1972) fq. 157-190.

lohet nga sistemi i rëndomtë gjyqësor që zbatohet nga gjykatat e rregullta. Natyrisht, sistemi i themeluar nga juristi austriak Hans Kelsen ka pësuar ndryshime të mëdha, në formë dhe përmbajtje, që nga koha kur e kishte propozuar atë pas Luftës së Parë Botërore. Megjithatë, ajo që mbetet e njëjtë është fakti që drejtësia kushtetuese ushtrohet nga një gjykatë e veçantë, e cila nuk është pjesë e sistemit të rëndomtë. Ideja qendrore e drejtësisë kushtetuese kelseniane është se gjykatat kushtetuese veprojnë më tepër si institucion legjislativ sesa si gjykatë.[132] Ndërmjet viteve 1918-1939, vetëm Çekosllovakia (shkurt 1920) dhe Austria (tetor 1920) kishin institucione të tilla dhe puna e tyre ishte shumë e dobët.[133] Drejtësia kushtetuese filloi ta marrë rolin udhëheqës dhe të bëhej fenomen i përhapur ndër evropianët vetëm pas Luftës së Dytë Botërore: gjykatat kushtetuese si institucione të mirëfillta vendimmarrëse u themeluan në Gjermani, Itali dhe Austri. Më pas, ato u përhapën në Evropë, Amerikë Latine dhe gjetiu. Në rastet e Gjermanisë, Italisë dhe të Austrisë, qëllimi i tyre parësor nuk ishte vetëm t'u ndihmonin këtyre vendeve që të shkëputeshin nga e kaluara e tyre e hidhur, por edhe t'i rimodelonin ato bashkë me standardet liberale demokratike të demokracisë kushtetuese duke u bazuar në sundim të ligjit, demokraci dhe respektim të të drejtave të njeriut dhe të pakicave. Ky trend, që filloi pas Luftës së Dytë Botërore, u përhap shpejt pas vitit 1989, rënies së komunizmit dhe përfundimit të Luftës së Ftohtë.[134] Tani mund të thuhet lirisht që modeli kelsenian apo evropian i drejtësisë kushtetuese, pra një model i gjykatave të veçanta që merren me drejtësi kushtetuese, është modeli dominues në botë pavarësisht dallimeve të mëdha që ekzistojnë në sistemin politik të shteteve të ndryshme. Kosova nuk bën përjashtim në këtë drejtim.

---

[132] Hans Kelsen, "Judicial Review of Legislation: A Comparative Study of the Austrian and the American Constitution", *Journal of Politics* vol. 4, no. 2 (May 1942) fq. 183-200.

[133] Në Çekosllovaki, p.sh. gjatë ekzistimit të vet prej vitit 1920 deri më 1939, ajo shqyrtoi vetëm dy ligje. Krahaso Wojciech Sadurski, *Rights Before Courts in Post-Communist States of Central and Eastern Europe* (Springer: Netherlands, 2005) fq. 1-26.

[134] Krahaso më tepër për këtë në Taylor Cole, "Three Constitutional Courts: A Comparison", *The American Political Science Review* vol. 53, no. 4 (December 1959) fq. 963-984; Christopher F. Zurn, *Deliberative Democracy and Its Institutions of Judicial Review* (Cambridge UP: Cambridge, 2007) fq. 253-341; John Ferejohn and Pasquale Pasquino, "Constitutional Courts as Deliberative Institutions: Towards an Institutional Theory of Constitutional Justice", në Wojciech Sadurski, *Constitutional Justice, East and West*, fq. 21-36.

E themeluar në janar të vitit 2009, me Ligjin Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës[135], Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka juridiksion më të gjerë fushëveprimi se cilado gjykatë tjetër në rajonin e Ballkanit: e modeluar sipas Gjykatës Kushtetuese gjermane, ajo ka juridiksion mbi pothuaj çdo aspekt të veprimeve të autoriteteve publike. Ajo nuk parashikon vetëm *actio popularis*. Apo, thënë me shprehje të së drejtës kushtetuese, Gjykata Kushtetuese ka juridiksion, *inter alia*, mbi të gjitha llojet e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së legjislacionit dhe tekste të tjera juridike, *ex ante* dhe *ex posto*[136], kontrollin incidental/konkret të kushtetutshmërisë në bazë të veprimit të cilësdo gjykatë të rregullt në Kosovë[137], konfliktin e kompetencave mes autoriteteve qendrore[138], mbrojtjen në përgjithësi të të drejtave të komunave përballë autoriteteve qendrore[139], shkeljet e Kushtetutës nga Presidenti i shtetit[140], vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe referendumin e propozuar[141], vlefshmërinë e zgjedhjeve parlamentare[142], juridiksionin për ankesat individuale pasi individët t'i kenë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike që i kanë në dispozicion brenda sistemit juridik të Kosovës[143], etj.

Kontrolli konkret ose incidental i kushtetutshmërisë dhe vlerësimi i kushtetutshmërisë, i ndërmarrë nga Gjykata në bazë të një ankese individuale, janë dy pikëtakime ndërmjet Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese.[144]

---

[135] Ky Ligj u miratua nga Kuvendi i Kosovës më 16 dhjetor 2008, dhe u shpall me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës Nr. DL-070-2008, më 30 dhjetor 2008.

[136] Krahaso nenin 113, paragrafët 5 dhe 6, të Kushtetutës.

[137] Krahaso nenin 113, paragrafin 8, të Kushtetutës. Në disa vende, si p.sh. në Itali, Poloni dhe Bullgari, Gjykata mund të vihet në lëvizje vetëm nga instancat më të larta të gjykatave të rregullta.

[138] Krahaso nenin 113, paragrafin 3, pikën 1, të Kushtetutës.

[139] Krahaso nenin 113, paragrafin 4, të Kushtetutës.

[140] Krahaso nenin 113, paragrafin 6, të Kushtetutës.

[141] Krahaso nenin 113, paragrafin 3, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës.

[142] Krahaso nenin 113, paragrafin 3, pikën 5, të Kushtetutës.

[143] Krahaso nenin 113, paragrafin 7, të Kushtetutës.

[144] Deri më tani, vetëm një rast ka mbetur pezull në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, të cilin e ka iniciuar Gjykata Supreme, pra "Kërkesa e Gjykatës Supreme të Kosovës për Vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, nenet 35, 36, 37 dhe 38", i 17 janarit 2011. Kjo kërkesë ka të bëjë me kushtetutshmërinë e së drejtës për të parashtruar ankesë kundër vendimeve të Gjykatës Supreme, siç parashihet me nenet e sipërpërmendura të Ligjit Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme. Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti përfundimtar gjyqësor në Kosovë, megjithatë ky Ligj flet për ankesën kundër vendimeve të Gjykatës Supreme në pothuaj të njëjtën mënyrë si për

Në bazë të juridiksionit të vet lidhur me ankesat individuale, Gjykata Kushtetuese shqyrton shumë lloje të vendimeve të nxjerra nga autoritetet publike në Kosovë, duke përfshirë vendimet e Gjykatës Supreme. Marrëdhënia ndërmjet këtyre dy Gjykatave të Kosovës ka qenë deri më tani në suaza të kornizës ligjore e cila i rregullon juridiksionet e tyre përkatëse. Në Kosovë nuk ka pasur "luftë të gjykatave", siç ka pasur në Itali p.sh. në vitin 1965, që zgjati deri vonë[145], përkundër faktit që në kohën e shkrimit të këtij studimi Gjykata Kushtetuese e Kosovës kishte anuluar mbi njëqind aktgjykime të Gjykatës Supreme të Kosovës. Përveç kësaj, për shkak të punës profesionale dhe të përkushtuar të gjyqtarëve të këtyre dy Gjykatave, duket që korniza e qartë ligjore e Kosovës, në kuadër të së cilës këto dy Gjykata veprojnë, lë pak vend për keqkuptim ndërmjet këtyre dy institucioneve.

a. Roli dhe pozita e Gjykatës Supreme në sistemin juridik të Kosovës

Në sistemin juridik të Kosovës ekziston dallim i qartë dhe i prerë i punës ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme. Gjykata Supreme ka për detyrë ta zbatojë ligjin dhe Kushtetutën, dhe Gjykata Kushtetuese ka për

---

ankesat e rregullta që mund të parashtrohen kundër vendimeve të gjykatave të rregullta të instancave më të ulëta që ekzistojnë në sistemin juridik të Kosovës.

[145] Kjo shprehje u përdor për herë të parë në kontekst të marrëdhënies ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Kasacionit të Italisë për ta përshkruar këtë marrëdhënie, dhe më vonë për ta përshkruar të njëjtën marrëdhënie brenda sistemit juridik çek. Megjithatë, kjo marrëdhënie ka qenë tipar i përgjithshëm i punës së pothuaj të gjitha gjykatave kushtetuese dhe supreme të ish-shoqërive komuniste. Në këto shoqëri, gjykata supreme dhe gjykatat e tjera të larta nuk pranonin t'i respektonin të shumtën e rasteve vendimet e Gjykatave Kushtetuese apo ngurronin t'u përmbaheshin teksteve të kushtetutave të tyre, duke i zbatuar dhe interpretuar në vend të kësaj ligjet e rëndomta. Krahaso Giancarlo Rolla and Tania Grappi, "Between Politics and the Law: The Development of Constitutional Review in Italy", në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West*, fq. 143-149; Roberto Bin - et Giovanni Pirtruzzella, *Diritto Costituzionale* (G. Giappichelli Editore: Milano, 2010) fq. 424-479; Roberto Scarcglia, "L'organizzazione giudizaria", në Lucio Pegoraro, Antonio Reposo, Angelo Rinella, Roberto Scarciglia et Mauro Volpi (eds.), *Diritto Costituzionale e Publico* (G. Giappichelli Editore: Milano: 2005) fq. 369-379; Lucio Pegoraro, "Le garanzie costituzionali", në Lucio Pegoraro, Antonio Reposo, Angelo Rinella, Roberto Scarciglia et Mauro Volpi (eds.), ibid. fq. 416-484; Gustavo Zagrebelsky, *La giustizia costituzionale* (il Mulino: Milano, 1989) fq. 73-98, 481-524; Jiri Priban, "Judicial Power vs. Democratic Representation: The Culture of Constitutionalism and Human Rights in Czech Legal System", në Wojciech Sadurski, *Constitutional Justice, East and West*, fq. 373-394; Jean-Pierre Massias, *Droit constitutionnel des États d'Europe de l'Est* (Press Universitaire de France: Paris, 1999) fq. 14-140, 421-563; Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (Univ. Chicago Press: Chicago, 2000) fq. 236-238.

detyrë ta bëjë interpretimin përfundimtar të dispozitave të Kushtetutës. Kjo ndarje e punës reflektohet në Kushtetutë dhe në ligje të tjera që e rregullojnë punën e këtyre dy institucioneve. Në të vërtetë, forma e qeverisjes në Kosovë, siç parashihet me Kushtetutë, e bën të qartë që "Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre [...]".[146] Në paragrafin 5 të nenit 4 të Kushtetutës gjithashtu thuhet që "pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat". Në përputhje me standardin e përgjithshëm të modelit evropian, Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e gjyqësorit, por është plotësisht e pavarur prej tij dhe prej ndonjë forme tjetër të pushtetit. Detyrë e saj, si organ i pavarur i Kushtetutës, është që ta mbrojë kushtetutshmërinë dhe t'i bëjë interpretimet përfundimtare të Kushtetutës. Këto dispozita të përgjithshme operacionalizohen më tej në Kapitullin VII të Kushtetutës.[147]

Kushtetuta e Kosovës e specifikon rolin e Gjykatës Supreme në të njëjtën mënyrë siç bëjnë vendet e tjera të Evropës në kushtetutat e veta. "Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor"[148], ndërsa "organizimi, funksionimi dhe jurisdiksioni i Gjykatës Supreme dhe i gjykatave të tjera, rregullohen me ligj".[149]

Sa i përket anës juridike të punës së Gjykatës Supreme, ekzistojnë tri ligje që e rregullojnë atë. Ligji i parë, që ende zbatohet, është Ligji për Gjykatat e Rregullta i vitit 1990.[150] Ky ligj zbatohet që nga viti 1999 në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24 për Ligjin në fuqi në Kosovë, të 12 dhjetorit 1999 (e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/59, të 2 tetorit 2000), dhe mbetet në fuqi deri më tani.[151] Ligji i dytë për Gjykatat, i miratuar

---

[146] "Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit": Neni 4 i Kushtetutës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës u miratua më 9 prill 2008 dhe hyri në fuqi më 15 qershor 2008.

[147] Sistemi i Drejtësisë: nenet 102-107 të Kushtetutës.

[148] Neni 103, paragrafi 2, i Kushtetutës.

[149] Neni 103, paragrafi 1, i Kushtetutës.

[150] Ligji për Gjykatat e Rregullta, *Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës* nr. 14/1990 (17 prill 1990).

[151] Sipas këtyre dy akteve ligjore të UNMIK-ut, rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe ligji në fuqi në territorin e Kosovës më 22 mars 1989 do të jenë ligj i zbatueshëm në Kosovë pas 10 qershorit 1999 (mbarimi i luftës në Kosovë). Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret e UNMIK-ut dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to. Nëse një çështje ose një situatë nuk mbulohet nga ligjet në fuqi në territorin e Kosovës më 22 mars 1989, por mbulohet me ndonjë ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me "standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut", ligjet e tilla do të zbatohen.

nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 22 korrik 2010, do të hyjë në fuqi më 1 janar 2013.[152] Deri atëherë, juridiksioni i gjykatave të rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme të Kosovës, do të rregullohet bashkërisht nga dy aktet e mëparshme ligjore. Sipas tyre, Gjykata Supreme e Kosovës është kompetente dhe ka juridiksion, *grosso modo*, për çështje të ngjashme, si në vende të tjera, si p.sh.:

- të vendosë për rastet që i janë parashtruar përmes mjeteve të jashtëzakonshme juridike;
- të vendosë për ankesat kundër vendimeve të gjykatave më të ulëta;
- të vendosë për rastet që kanë të bëjnë me konflikt kompetencash ndërmjet gjykatave më të ulëta;
- ta bëjë kontrollin gjyqësor të akteve administrative; dhe
- ta miratojë dhe shpallë një pozitë të përbashkët dhe të përgjithshme që synon zbatimin e unifikuar dhe identik të ligjit në tërë territorin e Kosovës.[153]

b. Fushëveprimi dhe përmasa e kontrollit gjyqësor në Kosovë

Prej 285 kërkesave të parashtruara në Gjykatë deri në kohën e shkrimit të këtij studimi (qershor 2011), 170 kërkesa, ose 59,64 për qind e tyre, kanë të bëjnë me kontrollin gjyqësor të vendimeve të Gjykatës Supreme. Ndër to, 65 kërkesa i takojnë kategorisë së ashtuquajtur "Rastet e KEK-ut", që do të shqyrtohen më poshtë. Përkundër numrit të madh të vendimeve të Gjykatës Supreme, të shqyrtuara nga Gjykata Kushtetuese, nuk ka pasur tensione serioze në marrëdhënien ndërmjet këtyre dy gjykatave. Në anën tjetër, ky tension ka qenë i rëndomtë në marrëdhëniet ndërmjet gjykatave të larta dhe gjykatave kushtetuese në vendet e tjera të Evropës. Sipas mendimit tim, ekzistojnë dy arsye për situatën e tillë në Kosovë. Së pari, prej këtij numri të kërkesave, shumica prej tyre nuk kanë qenë të lejuara, d.m.th., Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur asnjë shkelje dhe ka qenë në përgjithësi në harmoni me gjetjet e Gjykatës Supreme, sa u përket fakteve dhe ligjit. Gjykata Kushtetuese vazhdimisht ka theksuar se nuk është gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës

---

[152] Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat e Republikës së Kosovës (22 korrik 2010). Në nenin 43 ("hyrja në fuqi") thuhet se ky Ligj do të hyjë në fuqi më 1 janar 2013 sa i përket juridiksionit dhe kompetencave të gjykatave të rregullta të Kosovës. Për dispozitat e tjera, hyrja e tij në fuqi fillon më 1 janar 2011.

[153] Neni 15 i Ligjit të Kosovës për Gjykatat, i vitit 1990, në lidhje me nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat e Republikës së Kosovës.

së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme. Gjykata Kushtetuese ka përsëritur se gjykatat e rregullta kanë për detyrë t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Pra, Gjykata nuk ka treguar asnjë tendencë për ta tejkaluar juridiksionin e vet, pra ajo ka qenë e kënaqur me vlerësimin e "fakteve gjyqësore" dhe së drejtës (materiale dhe procedurale), në të cilat ato fakte përfshihen nga gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme.

Arsyeja e dytë ka të bëjë me faktin se në rastet që kanë të bëjnë me kontrollin gjyqësor të vendimeve të Gjykatës Supreme, Gjykata Kushtetuese ka gjetur shkelje kushtetuese të të drejtave të parashtruesve vetëm në tri sosh. Në këto raste, Gjykata ka theksuar parimin e përgjithshëm të subsidiaritetit, të përmendur më lart, pra, parimin se Gjykata Kushtetuese ka juridiksion për të kërkuar nëse të drejtat e mbrojtura me Kushtetutën e Kosovës zbatohen në mënyrë të drejtë në procedurat e rregullta gjyqësore, duke përfshirë ato që zhvillohen në Gjykatën Supreme. Kjo do të thotë që Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion, dhe nuk duhet t'i zëvendësojë gjetjet e veta juridike ose faktike me ato të gjykatave të rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme.

Rastet në të cilat qasja e sipërpërmendur pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe që do të jetë objekt kryesor i diskutimit në vijim janë: "Rasti KEK I", "Rasti KEK II, III, IV" dhe "Rasti KEK V"[154], dhe Rasti i AKP-së".[155]

Në "Rastet e KEK-ut", Gjykata u mor me çështjen e shkeljes së supozuar të së drejtës së pronës (neni 46 i Kushtetutës së Kosovës dhe neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), dhe shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 i KEDNj-së).

Sa i përket së drejtës së pronës, Gjykata gjeti shkelje të nenit 46 të Kushtetutës [Mbrojtja e Pronës] dhe të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së të inter-

[154] Këtu kemi mbi 115 kërkesa të Gjykatës Kushtetuese, por që janë të bashkuara dhe më pas të vendosura përmes një pilot-aktgjykimi në tri grupe, pasi kanë të bëjnë me rrethana dhe situata të ngjashme faktike dhe juridike. Për këto arsye, ato paraqiten në regjistrat e Gjykatës si "KEK I, II dhe III". KEK është shkurtesë për "Korporata Energjetike e Kosovës", dhe Gjykata gjeti që KEK-u ua kishte shkelur punëtorëve të drejtën e pronës dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

[155] KI Nr. 25/10, e 31 marsit 2011: "Agjencia Kosovare e Privatizimit kundër Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës". AKP është shkurtesë për "Agjencia Kosovare e Privatizimit".

pretuar në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Kosovës.[156] Çështja në fjalë ishte ndërprerja e njëanshme e marrëveshjes për kompensim të përkohshëm të pagesës për shkëputje të kontratës së punës të lidhur ndërmjet KEK-ut (Korporatës Energjetike të Kosovës) dhe secilit parashtrues individual (ish-punëtorë të KEK-ut). Neni 1 i kësaj Marrëveshjeje parashihte që, në mbështetje të Nenit 18 të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor në Kosovë[157] dhe në bazë të konstatimit të komisionit invalidor, secili parashtrues kishte të drejtë për kompensim të përkohshëm për ndërprerje të marrëdhënies së punës deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës. Themelimi dhe funksionimi i Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës ishte thelbi i çështjes, sepse, siç vuri re Gjykata, ai ishte kusht zgjidhës sipas të cilit marrëveshjet ndërmjet KEK-ut dhe ish-punëtorëve të tij ishin nënshkruar: përmbushja ose mospërmbushja e tij ishte vlerësuar nga Gjykata sipas Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve.[158]

Gjatë vendosjes për këtë rast, Gjykata Supreme nuk e kishte marrë parasysh faktin e sipërpërmendur. Për shkak të kësaj, Gjykata Kushtetuese konsideroi që parashtruesit, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve me KEK-un, kishin pritje legjitime kontraktuale se do të kishin të drejtë për pagesë mujore deri në themelimin e Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës. Fondi ishte themeluar. Gjykata vuri re që pritja legjitime e tillë ishte, si e drejtë e pronës, e garantuar me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së. Natyra e saj ishte konkrete dhe jo vetëm shpresë e thjeshtë, dhe ishte e bazuar në një detyrim ose akt ligjor, pra në marrëveshjen individuale me KEK-un. Megjithatë, Gjykata erdhi në përfundim se ndërprerja e njëanshme e marrëveshjeve nga KEK-u, para përmbushjes së kushtit zgjidhës, i ka shkelur interesat materiale të parashtruesve, që ishin të njohura sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë, si dhe të mbrojtura me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së dhe nenin 46 të Kushtetutës.

Përveç shkeljes të së drejtës së pronës, siç u cek më lart, Gjykata gjeti, si të justifikuara, pretendimet e parashtruesve lidhur me shkeljen e së drejtës së tyre për gjykim të drejtë. Gjykata së pari e përshkroi gjerësisht jurisprudenc-

---

[156] Neni 53 i Kushtetutës: "Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

[157] *Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës* nr. 26/83, 26/86 dhe 11/88.

[158] *Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë* nr. 29/1978 dhe e ndryshuar në 39/1985, 45/1989, 57/1989.

ën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe e krahasoi atë me dispozitën e nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës.[159] Më pas, Gjykata vazhdoi duke thënë se Gjykata Supreme nuk e kishte marrë parasysh argumentin e parashtruesve, pra përmbushjen e kushtit zgjidhës të nenit 3 të Marrëveshjes, përkundër referencës së theksuar qartë në të para çdo instance tjetër gjyqësore. Në vend të kësaj, Gjykata Supreme e konsideroi këtë si fakt të pakontestueshëm, që do të thotë se pala kundërshtare (KEK) e përmbushi obligimin e vet ndaj parashtruesve duke ua paguar kompensimin e pagave sipas afatit të përcaktuar, pra deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës, me hyrje në fuqi që nga 1 janari 2004.[160] Sipas mendimit të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Supreme, duke neglizhuar vlerësimin e kësaj pike në tërësi, edhe pse ka qenë konkrete, e lidhur me çështjen dhe e rëndësishme, ka dështuar në obligimin e saj sipas nenit 6, paragrafit 1, të KEDNj-së dhe nenit 31 të Kushtetutës.

Në rastin tjetër, Rasti i AKP-së, çështja ishte ndryshe. Ndonëse ky rast kishte të bënte me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 6 të KEDNj-së, në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës, në *obiter dicta* të vet, Gjykata erdhi në përfundime koncize dhe interesante juridike që vlen të përmenden më në detaje.

Së pari, sa i përket gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata theksoi se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës i shkeli dispozitat e nenit 31, paragrafët 1 dhe 2, të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së duke kërkuar që UNMIK-u të jepte sqarim lidhur me interpretimin e ligjit në fuqi sepse vetë UNMIK-u ishte palë në këtë kontest që pritej të zgjidhej në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Gjithashtu, ky sqarim nuk iu komunikua parashtruesit, pra AKP-së, për ta lejuar atë që ta shprehte mendimin e vet lidhur me këtë, por, u përdor në vend të kësaj nga Dhoma e Posaçme në formulimin e Vendimit ASC-09-089, të shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese.

Në pajtim me këtë që u tha më lart, Gjykata Kushtetuese e Kosovës konsideroi që njëri prej aspekteve kryesore të gjykimit të drejtë është se pala duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë në mënyrë efektive në procedura gjyqësore. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ia mohoi këtë të drejtë AKP-së. Kjo Dhomë e trajtoi AKP-në si subjekt *de facto* por që nuk ka të drejtë veprimi pranë saj, siç parashihet me ligjin e Kosovës në fuqi. Duke mos e njohur

[159] "1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike." Neni 31 i Kushtetutës.
[160] Krahaso paragrafët 26 dhe 71 të Aktgjykimit.

ligjin që e rregullon pozitën juridike të AKP-së, Dhoma e Posaçme i shkeli dispozitat e Planit Ahtisaari[161], shih Aneksin IV (neni 1.1: Sistemi Gjyqësor). Neni 1.1 i Aneksit IV të këtij dokumenti qartazi përcakton që Gjykata Supreme siguron zbatimin e njëtrajtshëm të ligjit duke vendosur mbi ankesat e paraqitura para saj në pajtim me ligjin. Në të vërtetë, zbatimi i njëtrajtshëm i ligjit është njëri prej funksioneve kryesore të secilës gjykatë të lartë në demokracitë moderne kushtetuese.

Së dyti, Gjykata Kushtetuese e shtjelloi dhe shqyrtoi në mënyrë shumë elokuente dhe profesionale qasjen e ndërmarrë nga Dhoma e Posaçme. Siç u theksua, Dhoma nuk e njohu si të vlefshëm dhe të zbatueshëm Ligjin Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që do të thotë se AKP-së iu mohua e drejta e paraqitjes pranë Gjykatës Supreme. Në të vërtetë, Gjykata theksoi në paragrafin 53 të këtij Aktgjykimi se Dhoma e Posaçme thjesht e injoroi ekzistimin e Kosovës si shtet të pavarur dhe ligjet që burojnë nga Kuvendi i saj. Në lidhje me këtë, në paragrafin 54, Gjykata iu referua Opinionit Këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të 22 korrikut 2010, sipas të cilit miratimi i shpalljes së pavarësisë, më 17 shkurt 2008, nuk ka shkelur të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999)[162] apo Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje në Kosovë.[163]

---

[161] Plani Ahtisaari qëndron për "Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës" të 2 shkurtit 2007. Ky dokument u lejua nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ai ishte menduar për ta zëvendësuar Rezolutën 1244 të KSKB-së, të 10 qershorit 1999, me të cilën u themelua Misioni i OKB-së në Kosovë, i njohur si UNMIK. Vetëm shqiptarët e Kosovës e pranuan vlefshmërinë e Planit Ahtisaari, dhe në bazë të tij, shpallja e pavarësisë së Kosovës ndodhi më 17 shkurt 2008. Pala serbe e refuzoi atë. Ky dokument është emërtuar sipas ish-Presidentit të Finlandës, Martti Ahtisaari, i cili i udhëhoqi bisedimet paqësore që synonin përfundimin e statusit politik të Kosovës që ende ishte i pazgjidhur atë botë. Krahaso më tepër për këtë në Ray Murphy, *UN Peacekeeping in Lebanon, Somalia and Kosovo* (Cambridge UP: Cambridge, 2007); Mauro Mazza, *L'ordinamento costituzionale del Kosovo* (Jovene Editore: Napoli, 2008).

[162] Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e 10 qershorit 1999, u miratua as përfundimit të fushatës ajrore 78-ditëshe, të udhëhequr nga NATO-ja, kundër Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi) që synonte parandalimin e vrasjeve të mëtejme dhe spastrimin etnik të popullatës shumicë shqiptare të Kosovës. Rezoluta parashikoi një proces politik në të ardhmen e afërt për ta zgjidhur përfundimisht statusin politik të krahinës së atëhershme të Kosovës. Deri në mbarimin e procesit të tillë, në terren u themelua administrata e udhëhequr nga OKB-ja. Ajo ishte menduar të kishte karakter kalimtar dhe u quajt UNMIK.

[163] Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e shpallur si Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 9/2001, më 15 maj 2001.

Pikërisht për shkak të arsyeve të cekura më lart Gjykata Kushtetuese e shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin 09-089 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës të 4 shkurtit 2010, mbi bazën se ai i shkeli nenet 31 dhe 102 të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të KEDNj-së.

3. Trendet e përgjithshme të vlerësimit të kushtetutshmërisë në Kosovë

Këtu do t'i shtjelloj vetëm trendet e vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës sipas juridiksionit të përcaktuar në nenin 113.7 të Kushtetutës.[164] Kjo do të thotë se i kemi lënë anash aspektet e tjera të vlerësimit të kushtetutshmërisë siç parashihet në pjesët e tjera të nenit 113 lidhur me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Trendi i parë i përgjithshëm që mund ta shohim nga shqyrtimi i mësipërm është se shumica e kërkesave të parashtruara në GJKK janë shpallur të papranueshme. Ky trend i përgjithshëm shihet edhe në gjykatat e tjera kushtetuese të ish-vendeve komuniste. Në përgjithësi, mbi 80 për qind e rasteve të parashtruara në gjykatat kushtetuese në këto vende janë shpallur të papranueshme, kryesisht në baza procedurale.[165]

Së dyti, me rastin e shqyrtimit të vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykata Kushtetuese ka thënë qartë gjatë tërë kohës që nuk është gjykatë e apelit apo gjykatë e shkallës së katërt, që do të thotë se nuk ka juridiksion origjinal dhe se ajo i shqyrton vetëm aspektet që kanë të bëjnë me kredibilitetin dhe integritetin kushtetues të procedurave të zhvilluara në Gjykatën Supreme dhe në gjykatat e tjera të rregullta të Kosovës.

Së fundi, bazat e përdorura nga Gjykata Kushtetuese në procesin e shqyrtimit dhe shfuqizimit të vendimeve të Gjykatës Supreme kanë të bëjnë me

---

[164] "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj". Neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës.

[165] John Ferejohn et Pasquale Pasquino, "Constitutional Courts as Deliberative Institutions: Towards an Institutional Theory of Constitutional Justice", në Wojciech Sadurski, *Constitutional Justice, East and West*, fq. 21-36, 409-432; Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe*, fq. 236-238; Jean-Pierre Massias, *Droit constitutionnel des États d'Europe de l'Est*, 2e ed. (Presses Universitaire de France: Paris, 2008) fq. 14-140, 421-563. Përveç faqeve të cituara me këtë rast, autorët përshkruajnë në mënyrë shumë të detajuar dhe kompetente punën e shumicës së gjykatave të ish-shoqërive socialiste dhe arsyet për një numër kaq të madh të rasteve të papranueshme të shpallura nga gjykatat kushtetuese në këto vende.

dështimin e Gjykatës Supreme për ta mbrojtur kredibilitetin dhe integritetin e përgjithshëm të procedurave para saj që shpurën në shkeljen e së drejtës kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç parashihet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së.

Përfundime

Beteja për kushtetutshmëri është betejë për dinjitet të njeriut. Si e tillë, ajo ka qenë tipar i historisë së njeriut në betejën e tij për liri dhe pavarësi nga qeveria shtypëse. Si ideologji dhe sistem i besimeve, kushtetutshmëria është e mbushur me koncepte si qeveri e kufizuar, ndarje e pushteteve, të drejta të njeriut dhe sundim i ligjit. Gjatë revolucioneve ose në luftën ndërmjet ideologjive të perëndimit liberal dhe lindjes totalitare dhe komuniste, demokracia kushtetuese është formësuar dhe është bërë ajo që është sot. Koncepti kryesor në këtë rrugëtim drejt sundimit të demokracisë kushtetuese ka qenë dhe mbetet pavarësia e gjyqësorit, pa të cilën nuk mund të ekzistojë asnjë shoqëri e mirëfilltë që mbështetet në sundimin e ligjit.

Në ish-shtetet komuniste, gjykatat kushtetuese kanë qenë instrumente të ndryshimit pas rënies së komunizmit. Themelimi dhe puna e tyre dëshmoi të ishte shumë e dobishme për përkrahjen e sundimit të ligjit dhe kushtetutshmërisë. Megjithatë, themelimi i tyre dëshmoi të ishte burim i tensionit ndërmjet tyre dhe gjykatave të rregullta të instancave të larta. Në disa raste, korniza ligjore dhe kushtetuese qëndronte prapa këtij tensioni, por në shumicën e rasteve, kultura ligjore dhe historitë lokale ishin përgjegjëse për atë tension. Kosova dhe Gjykata Kushtetuese e saj, më e reja në Evropë, nuk janë përjashtim. Megjithatë, marrëdhënia me Gjykatën Supreme ka qenë më pak e tensionuar se gjetiu kur krahasohet me numrin e madh të aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të anuluara nga Gjykata Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese ka thënë në mënyrë të qartë në këto vendime se nuk e ka ndërmend të shërbejë si gjykatë e shkallës së katërt. Përveç kësaj, Gjykata ka theksuar në disa raste se ka ndërmend ta respektojë parimin e subsidiaritetit, pra, se ka ndërmend të mbrojë dhe shqyrtojë vetëm sa i përket integritetit të procedurave në Gjykatën Supreme. Kjo do të thotë që Gjykata Kushtetuese i respekton "faktet gjyqësore" siç janë të përfshira nga Gjykata Supreme dhe dispozitat ligjore (materiale dhe procedurale) të zbatuara për to. Gjykata Kushtetuese do t'i anulojë vendimet e Gjykatës Supreme vetëm kur ato i shkelin të drejtat kushtetuese dhe do të japë arsye të hollësishme për

këtë. Sa u përket efekteve juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, vlen të përmendet se ato janë të detyrueshme për të gjitha organet publike jo vetëm sa i përket pjesës operative të aktgjykimeve, por edhe në lidhje me rekomandimet juridike që përfshihen në arsyetim.

Mund të thuhet pa dyshim se, deri më tani, marrëdhënia ndërmjet Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese ka qenë në suaza të ligjit dhe Kushtetutës, një marrëdhënie normale dhe e drejtë e bazuar në profesionalizëm dhe pa tensione serioze ndërmjet këtyre dy institucioneve. Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk qe e detyruar të mbështetej në asnjë doktrinë shtesë, si ajo e "së drejtës së gjallë" në rastin e sistemit juridik italian, për ta shtyrë përpara doktrinën e vet në marrëdhënien e saj me Gjykatën Supreme të Kosovës. Kjo ishte për shkak të faktit që korniza ligjore e Kosovës është e qartë dhe parashikon përgjigje të mjaftueshme lidhur me mënyrën në të cilën marrëdhënia ndërmjet këtyre dy institucioneve duhet të zhvillohet. Ndërsa Gjykata Kushtetuese mbron kushtetutshmërinë në Kosovë, Gjykata Supreme kujdeset për ligjshmërinë e punës së gjykatave të rregullta në Kosovë. Vetëm kur Gjykata Supreme dështon në përmbushjen e kësaj detyre që shpie në shkelje të Kushtetutës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese hyn në skenë, dhe atëherë vetëm si institucion korrigjues shtesë i instancës së fundit ekskluzivisht në çështjet e së drejtës kushtetuese.

II. Mekanizmi i ankesave individuale si mjet për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe lirive të njeriut: rasti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës

Hyrje

Natyra dhe funksioni i gjykatave kushtetuese në botë i është nënshtruar transformimeve të vazhdueshme në shekujt e kaluar. Edhe pse fillimisht të themeluara sipas modelit kelsenian të kontrollit kushtetues, gjykatat kushtetuese — sidomos në Evropë — kanë kaluar në një proces të transformimit të vazhdueshëm[166]. Pra, ky proces i transformimit, ka kombinuar rolin e për-

[166] Për më shumë të dhëna mbi zhvillimin e modelit të centralizuar të vlerësimit kushtetues posaçërisht Gjykatën Kushtetuese të Austrisë në bazë të teorisë kelseniane, shih tek Theo

gjithshëm kelsenian të gjykatave kushtetuese me një rol më gjyqësor në mbrojtjen e të drejtave individuale. Nëse e trajtojmë gjerësisht, modeli kelsenian i gjykatës kushtetuese nuk është më modeli kryesor, pasi që gjykatat aktuale kushtetuese në Evropë marrin formën e një kombinimi të butë të modelit kelsenian me një model më amerikan të drejtësisë kushtetuese[167]. Veçoria kryesore që na mundëson të flasim për një kombinim të modelit kelsenian dhe atij amerikan në drejtësinë kushtetuese qëndron tek fakti që sot, gjykatat kushtetuese evropiane janë veshur me kompetencën e gjykimit të rasteve individuale të të drejtave të njeriut — në të kundërtën e trajtimit abstrakt — gjë që flet për përvetësimin e juridiksionit *in concreto* si shtresë e zakonshme e gati secilës gjykatë kushtetuese në Evropë.

Kur thuhet kjo, juridiksioni për trajtimin *in concreto* në shumë gjykata kushtetuese është karakteristikë që i bën gjykatat kushtetuese të përziejnë natyrën e tyre kuazi-gjyqësore me një rol më gjyqësor. U mor vesh, natyra dhe fushëveprimi i mekanizmit shqyrtues *in concreto* — si pjesë e juridiksionit të gjykatës kushtetuese — ndikon në marrëdhënien mes gjykatës kushtetuese dhe gjykatave të rregullta, duke ngritur kështu disa prej çështjeve kyçe të cilat ose vejnë në pikëpyetje ose mbështesin legjitimitetin e tyre. Në të njëjtën kohë, në përgjithësi theksohet se për aq sa gjykatat kushtetuese mbesin thjesht vendosëse abstrakte — pra duke vendosur mbi atë nëse legjislacioni është kushtetues — ato nuk mund të konsiderohen mekanizma gjyqësorë.

Megjithatë, me rritjen e kompetencave që gjykatat kushtetuese kanë marrë në trajtimin e gjykimit *in concreto* të shkeljeve të të drejtave individuale të njeriut, ato po transformohen në organe më gjyqësore, pasi që luajnë rolin e një organi të lartë qartësisht gjyqësor. Ky rol, siç do të thoshin të tjer-

---

Ohlinger, "The Genesis of the Austrian Model of Constitutional Review of Legislation", *Ratio Juris* vol. 16, nr. 2 (2003) fq. 206-222; L. Stanley Paulson, "Constitutional Review in the United States and Austria: Notes on the Beginnings", *Ratio Juris* vol. 16, nr. 2 (2003) fq. 223-239; dhe, së fundi, George Schmitz, "Constitutional Court of the Republic of Austria 1918-1920", *Ratio Juris* vol. 16, no. 2 (2003) fq. 240-265. Gjithashtu për më shumë mbi tiparet kyçe për modelin evropian (kelsenian) të vlerësimit kushtetues, shih tek Herman Schwartz, "Eastern Europe's Constitutional Courts", *Journal of Democracy* vol. 9, no. 4 (1998) fq. 100-114, dhe Victor F. Comella, "The European model of constitutional review of legislation: Toward decentralization?" *International Journal of Constitutional Law* vol. 2, nr. 3 (2004) fq. 461-491.

[167] Sipas Christie-it supozohet se modeli amerikan i vlerësimit kushtetues ua lejon gjykatave që kryesisht të ushtrojnë rol politik. Shih C. George Christie, "A model of Judicial Review of Legislation", *Southern California Law Review* vol. 48, no. 6 (1975) fq. 1306-1356.

ët, vërteton rritjen e pushtetit të gjykatave kushtetuese, jo thjesht kundrejt degëve ekzekutive e legjislative sipas traditës, por edhe kundrejt gjyqësorit[168].

Në vijim për sa më sipër, ky punim diskuton dhe qartëson juridiksionin *in concreto* të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, duke i kushtuar vëmendje të veçantë kuptimit, fushëveprimit dhe natyrës së tij. Fillimisht, punimi ofron një diskutim sfondi të juridiksionit *in concreto* në frymën e dispozitës kushtetuese që rregullon këtë çështje. Ky gjithashtu trajton palët e autorizuara për të shfrytëzuar këtë juridiksion, si dhe konceptet që Gjykata Kushtetuese ka ndërtuar në lidhje me këtë çështje. Më tutje, punimi veçanërisht vë në pikëpyetje shterimin e mjeteve juridike si standard pranueshmërie në juridiksionin *in concreto*, si dhe hedh dritë mbi aplikimin e tij në një kontekst më ndërkombëtar. Punimi gjithashtu vë theksin e tij tek kushtet tjera të pranueshmërisë, si dhe shpjegon rolin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me karakterin e saj ndihmës. Në vijim, punimi diskuton dhe analizon fushëveprimin dhe natyrën e juridiksionit të vlerësimit *in concreto* të Gjykatës Kushtetuese, duke i kushtuar vëmendje të veçantë efektit të vendimeve të saj *ratione personae*, *ratione temporis* dhe *ratione materiae*. Duke zhvilluar këtë konsideratë, punimi më tutje trajton funksionin e Gjykatës Kushtetuese në këndvështrimin e debatit gjykatë fakti kundrejt gjykatë subsidiare, krahas çështjes nëse Gjykata mund të veprojë *ultra petitum* në kuadrin e punës së saj sipas juridiksionit *in concreto*. Përfundimisht, punimi mbyllet duke theksuar që juridiksioni i vlerësimit *in concreto* i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës është mjaft i gjerë në kuptimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, dhe gati asnjë akt individual i një autoriteti publik nuk mund të jetë imun ndaj këtij juridiksioni.

1. Juridiksioni *in concreto* i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës: analizë e historikut

Përveç juridiksionit të saj të vlerësimit abstrakt — si funksion i saj kryesor — Gjykata Kushtetuese e Kosovës[169] është gjithashtu e autorizuar të kont-

[168] Shih një shënim prezantues mbi këtë çështje tek Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (Chicago UP: Chicago, 2002); Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010).

rollojë disa akte të caktuara individuale në kuptimin e përputhshmërisë së tyre me Kushtetutën[170][171]. Një juridiksion specifik i Gjykatës është që të kontrollojë aktet e autoriteteve publike që nxirren në raste individuale, për përputhjen e tyre me katalogun kushtetues të të drejtave të njeriut. Kjo mbetet ndoshta prej juridiksioneve më të rëndësishme *in concreto* të Gjykatës[172], si dhe e vetmja hapësirë e saj për të kontrolluar kushtetutshmërinë e të drejtave individuale të njeriut[173] që rrjedhin nga rastet individuale që parashtrohen normalisht në gjykata të rregullta[174]. Gjykata Kushtetuese, si rezultat i këtij juridiksioni të specializuar, "është vënë në një pozitë në të cilën duhet të jetë si një 'gjyqtar i gjyqtarëve', e jo gjyqtar i normave siç përcaktohet me formulën kelseniane"[175]. Në këtë kontekst, Kushtetuta, derisa përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese në nenin 113.7 thekson që "[i]ndividët janë të aut-

---

[169] Për një artikull të përgjithshëm shpjegues mbi Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, shih Fisnik Korenica, "Pointing the Rule-of-Law in a Transnational Polity: The Case of Kosovos Law on the Constitutional Court", *Contemporary Issues in Law* vol. 10, no. 3 (2010) fq. 183.

[170] Për një shënim të përgjithshëm për këtë çështje, shih Dren Doli and Fisnik Korenica, "Kosovar Constitutional Courts Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010) fq. 803, në fq. 809.

[171] Choper argumenton se i takon juridiksionit konkret që të kontrollojë shkeljet individuale të të drejtave të njeriut ajo që përbën vet arsyetimin e vlerësimit kushtetues. Shih shkrimin e Choper në Christopher Wolfe, *Judicial Review: From Constitutional Interpretation to Judge-Made Law* (Rowman & Littlefield: London, 1994) fq. 337.

[172] Me këtë rast duhet përmendur se kushtetuta gjithashtu i mvesh Gjykatës Kushtetuese një juridiksion incidental që thotë: "gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë". Kushtetuta e Kosovës, neni 113, para. 8.

[173] Ky juridiksion, sipas Steinberger, thekson rangun kushtetues të të drejtave të njeriut. Shih: Helmut Steinberger, *Models of Constitutional Jurisdiction* (European Commission For Democracy Through Law [Venice Commission]: Strasbourg, 1993) [CDL-STD (1993) 002].

[174] Shumë gjykata kushtuetuese në botë nuk kanë juridiksion për të kontrolluar shkeljet individuale të të drejtave të njeriut, sikurse është rasti i asaj të Francës. I kundërt është rasti i modelit amerikan të shqyrtimit juridik. Aucoin argumenton se e para është rezultat i konceptit të mbizotërimit të legjislacionit, kurse e dyta rezultat i mbisundimit të konceptit të sovranitetit të popullit. Shih më shumë në Louis M. Aucoin, "Judicial Review in France: Access of the Individual Under French and European Community Law in the Aftermath of France's Rejection of Bicentennial Reform", *Boston College International and Comparative Law Review* vol. 15, issue 2 (1992) fq. 443, në rrjet: http://lawdigitalcommons.bc.edu/iclr/vol15/iss2/7.

[175] Luis Lopez-Guerra, "The Role and Competences of the Constitutional Court", në Venice Commission, *The role of the constitutional court in the consolidation of the rule of law* [UniDem Seminar Bucharest, 8-10 June 1994, CDL-STD (1994) 010] (Council of Europe: Strasbourg, 1994).

orizuar të ngrenë shkeljet [në Gjykatën Kushtetuese] nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Ekzistojnë dy supozime kryesore të cilat përshkruajnë se kur e drejta individuale konsiderohet e cenuar, mbi bazën e të cilës individi i prekur mund të autorizohet në mënyrë legjitime që të parashtrojë ankesën individuale në Gjykatën Kushtetuese. Faktet tregojnë që një e drejtë individuale mund të konsiderohet e cenuar ose nga një akt i një organi publik që drejtpërdrejt kufizon/cenon të drejtën e garantuar me kushtetutë (shkelje e drejtpërdrejtë), ose nëse akti që prek të drejtën është i bazuar mbi një ligj apo akt nënligjor të cilin, për ndonjë arsye, Gjykata Kushtetuese e vlerëson si jokushtetues (shkelje derivative). Pra, mund të argumentohet që neni 113.7 ofron hapësirën e vetme prej të cilës qytetarët mund t'i qasen dhe të paraqiten para Gjykatës Kushtetuese: kjo konsiderohet qasje e drejtpërdrejtë e personave në Gjykatë, kundrejt qasjes së tërthortë që mund të arrihet përmes një vendimi preliminar që kërkohet nga një gjykatë e rregullt[176]. Në përgjithësi, mund të thuhet që është i vetmi ky juridiksion i specializuar që e bën Gjykatën Kushtetuese të veprojë si organ i pastër gjyqësor, pasi që i duhet të gjykojë *in concreto* një rast individual që është gjykuar tashmë nga gjykatat e rregullta[177].

---

[176] Sidoqoftë duhet përmendur se sistemi i qasjes indirekte të individëve përmes gjykatave të rregullta është shumë i zakonshëm në shtetet që kanë themeluar një model të centralizuar të vlerësimit kushtetues (duke përfshirë edhe Kosovën). Kjo procedurë, sipas Comella-së, sipas të gjitha gjasave bazohet në idenë se ky sistem ndanë kompetencat për të zbatuar legjislacionin në rastet konkrete për gjykatat e rregullta, përderisa kompetencat për të vlerësuar legjislacionin për gjykatat kushtetuese. Shih F. Victor Comella, "The European model of constitutional Review of legislation: Toward decentralization?", *International Journal of Constitutional Law* vol. 2, no. 3 (2004) fq. 461-491. Shih edhe "Study on Individual Access to Constitutional Justice", Study No. 538/2009, miratuar nga Venice Commission në Mbledhjen e 85-të Plenare (Venedik, 17-18 dhjetor 2010). Vlen të përmendet se autorizimi i gjykatave të rregullta për të parashtruar kërkesa kushtetuese nganjëherë është i kufizuar. Ky kufizim, për shembull, në rastin e Polonisë, i referohet kategorisë së gjykatave të rregullta të cilat janë të autorizuara t'i parashtrojnë pyetje ligjore Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, argumentohet se, në rastin e Polonisë, vetëm kategoritë në vijim të autoriteteve gjyqësore janë të autorizuara që t'i parashtrojnë drejtpërdrejt pyetje kushtetuese, Kryetari i Gjykatës Supreme, si ai i dhomës penale ashtu edhe asaj civile të Gjykatës Supreme, Kryetari i i Gjykatës së Lartë Administrative, dhe të gjitha gjykatat e apelit në sistemin e gjykatave të rregullta. Shih Mark F. Brzezinski, "The Emergence of Judicial Review in Eastern Europe: The Case of Poland", *American Journal of Comparative Law* vol. 41, no. 2 (1993) fq. 153-200, në fq. 189.

[177] Për më tepër, Brzezinski dhe Garlicki e pranojnë se qasja e individëve në gjykatën kushtetuese përmes mekanizmave të kërkesave individuale është thelbësore në realizimin e të drejt-

Në vijim pason analiza e këtij juridiksioni të specializuar, me qëllim të gjetjes së përgjigjes ndaj pyetjeve hulumtuese të këtij punimi.

Fillimisht shtrohet pyetja se cili është kuptimi i termit "individë" brenda formulimit të nenit 113.7, pasi që përkufizimi i këtij termi do të mund të jetë qartësim për ato subjekte që në fakt mund të shfrytëzojnë këtë juridiksion të vlerësimit *in concreto* të Gjykatës Kushtetuese. Në pamje të parë, mund të thuhet që termi "individë" në dispozitën e nenit 113.7 i referohet vetëm personave fizikë: kështu është qasja edhe e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Derisa i referohet termit "individë" të nenit 113.7, Ligji përdor përemrin vetor "ai/ajo", si dhe mbiemrin vetor "i tij/saj"[178]. Në këtë kontekst, mund të detyrohemi të mendojmë që personat juridikë nuk i nënshtrohen kësaj dhe nuk mund të paraqiten para Gjykatës Kushtetuese si parashtrues individualë, pasi që Ligji ua njeh këtë të drejtë vetëm personave fizikë. Krejt e sigurt është, megjithatë, që neni 113.7 ekziston aty për të plotësuar nevojat e mbrojtjes së katalogut kushtetues të të drejtave të njeriut, siç është shumë e qartë që katalogu kushtetues i të drejtave të njeriut është bërë për të mbrojtur jo vetëm të drejtat e personave fizikë, por edhe të atyre juridikë. Padyshim që Kushtetuta e përcakton shumë saktë: "Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme"[179]. Ky formulim sikur e lë në dukje të parë të mjegullt përgjigjen nëse mbrojtja e akorduar nga Gjykata Kushtetuese për katalogun kushtetues së të drejtave të njeriut ofron mburojë edhe për personat juridikë, pasi që është mjaft e dukshme që së paku çdo e drejtë kushtetuese e lidhur me pronën mund të gëzohet edhe nga personat juridikë, gjë të cilën Kushtetuta e konfirmon në nenin e saj 21.4. Në përballje me këtë situatë, të komplikuar nga përshkrimi i dobët i hartuesve të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese është treguar më racionale dhe më e përgjegjshme ndaj misionit të saj të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese, pra që ato të gëzohen qoftë nga personat fizikë apo nga personat juridikë. Kështu, Gjykata Kushtetuese, në

---

ave njerëzore të garantuara me kushtetutë, prandaj, kjo e drejtë në asnjë mënyrë nuk duhet të kufizohet vetëm për institucionet publike. Për më shumë shih Mark Brzezinski and Leszek Garlicki (1995) "Judicial Review in Post-Communist Poland: The Emergence of a Rechtsstaat", *Stanford Journal of International Law* vol. 31, no. 1 (1995) fq. 13-60, dhe Wojciech Sadurski, *Rights Before Courts: A Study of Constitutional Courts in Postcommunist States of Central and Eastern Europe* (Springer: The Netherlands, 2008), kapitujt 5, 6, dhe 7.

[178] Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, neni 47, paragrafët 1 dhe 2.

[179] Kushtetuta e Kosovës, neni 21, paragrafi 4.

rastin e Universitetit AAB kundër Qeverisë së Kosovës[180], kishte vendosur që termi "individë" në nenin 113.7 duhet të kuptohet si përfshirje edhe e personave juridikë. Pra, rasti i Universitetit AAB në Gjykatën Kushtetuese korrigjon kufizimin që gabimisht është vënë nga ligjvënësi në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, pasi që do të ishte joracionale dhe në kundërshtim me thelbin e nenit 133.7 që të theksohej se vetëm personat fizikë mbrohen me mekanizmin e ankesave kushtetuese. Kjo sigurisht që do të ishte kërcënim ndaj së drejtës për qasje të barabartë në gjykata, sepse të drejtat kushtetuese që gëzohen nga personat juridikë do të mbeteshin jashtë fushëveprimit të mekanizmit të vlerësimit kushtetues *in concreto*.

Akoma mbeten pyetjet nëse fushëveprimi i nenit 113.7 përfshin vetëm personat privatë — kundrejt atyre publikë — juridikë, ose edhe personat privatë edhe ata publikë juridikë. Kjo është qartësuar nga Gjykata Kushtetuese në rastin AKP kundër Gjykatës Supreme[181], ku ajo kishte vendosur që të gjithë atyre organeve publike që kanë subjektivitet juridik i njihet e drejta për të shfrytëzuar juridiksionin e nenit 113.7, dhe në këtë mënyrë njihen si persona juridikë në kuptimin e nenit të fundit. Kjo ilustron që Gjykata ka zgjeruar përdorimin e konceptit "person juridik", si dhe që i mjafton një organi publik të ketë subjektivitet juridik për t'u konsideruar person juridik. Në përgjithësi, mund të thuhet që standardi i vendosur në rastin AKP kundër Gjykatës Supreme vendos një lloj barazie armësh mes personave privatë dhe publikë në kuptimin e gëzimit të të drejtave të tyre, por mbetet të zgjidhet në rastet tjera nëse, për shembull, "qeveria" si e tillë do të mund të konsiderohej si person juridik, e vijimisht të lejohej që të parashtronte kërkesa në Gjykatën Kushtetuese si person juridik. Kjo sigurisht që do të zgjeronte shumë spektrin e çështjeve që do të ngriteshin në Gjykatën Kushtetuese, si dhe do t'i lejonte Qeverisë dhe organeve publike që të ankoheshin në Gjykatë Kushtetuese pasi të shterojnë procesin e rregullt gjyqësor.

Edhe personat fizikë edhe juridikë pra janë të autorizuar të parashtrojnë ankesa në Gjykatën Kushtetuese, për të vlerësuar kushtetutshmërinë e akteve publike në kuptimin e katalogut kushtetues të të drejtave të njeriut. Kjo e bën Gjykatën Kushtetuese shtresë të katërt të kontrollit gjyqësor, edhe pse mbetet të shqyrtohet nëse në fakt kjo është gjykatë e shkallës së katërt. Për të pasur qasje në Gjykatën Kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113.7, personat me-

[180] Universiteti AAB sh.p.k. kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti 41/09, Vendimi mbi papranueshmërinë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

[181] Agjencia Kosovare e Privatizimit kundër Gjykatës Supreme, Rasti KI 25/10, Aktgjykimi, Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

gjithatë duhet të kenë shteruar së pari të gjitha mjetet juridike efektive[182]. Në pjesën në vijim merremi me çështjen e shterimit të mjeteve juridike efektive, në pikëvështrimin e kushteve për të pasur qasje në Gjykatën Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7.

2. Shterimi i mjeteve juridike efektive dhe standardet e tjera të ndërlidhura me lejueshmërinë në vështrim të juridiksionit *in concreto* të Gjykatës Kushtetuese

Siç përcaktohet me nenin 113.7, personat mund të parashtrojnë kërkesa në Gjykatën Kushtetuese vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit[183]. Vazhdimisht, Gjykata Kushtetuese, si në rastin Denić kundër Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa[184], e racionalizon këtë parim kushtetues me argumentin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut[185] që së pari duhet mundësuar që institucionet e rregullta të shtetit (e veçanërisht gjykatat) të korrigjojnë shkeljen, para se rasti të arrijë në gjykatën e tij më të lartë. Megjithatë, është me rëndësi të trajtohet se cilët nivele gjyqësore duhet të kalojë rasti para se të ketë mundësi të parashtrohet në Gjykatën Kushtetuese sipas nenit 113.7.

Ligji i Kosovës për Gjykatat vendos gjykatat themelore si mekanizma gjyqësorë të instancës së parë në Kosovë, për çështjet civile, penale, ekonomike, administrative[186] dhe çështje tjera të përgjithshme[187]. Rastet e vendosura një

---

[182] Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, neni 47, paragrafi 2.

[183] Ngjashëm, në rastin e Gjermanisë dhe Spanjës, individët mund të parashtrojnë kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, vetëm pasi ata të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike. Përderisa në rastin e Austrisë, kërkesat individuale kushtetuese mund të parashtrohen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese. Në Gjermani, kërkesat e drejtpërdrejta individuale janë të pranueshme vetëm kur, dhe për sa kohë që disa plotësohen disa kushte të veçanta. Shprehimisht, kërkohet që pala aktualisht dhe drejtpërdrejt të ndikohet nga ligji dhe duhet të jetë e paarsyeshme që individi në fjalë fillimisht të kërkojë ndihmë duke ndjekur adresimin e zakonshëm përmes ligjit. Shih Wolfgang Zeidler, "The Federal Constitutional Court of the Federal Republic of Germany: Decisions on the Constitutionality of Legal Norms", *Notre Dame Law Review* vol. 62 (1987) fq. 504-525, në fq. 506.

[184] Denić kundër Këshillit Zgjedhor për Ankesa, rasti KI 22/11, Vendim për Papranueshmërinë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

[185] Gjykata Kushtetuese përdor këto dy Aktvendime të rëndësishme të GjEDNj si shembull për këtë: Selmouni kundër Francës Nr. 25803/94, vendimi i datës 28 korrik 1999, GjEDNj; dhe Azinas kundër Qipros, Nr. 56679/00, vendimi i datës 28 prill 2004, GjEDNj.

[186] Sidoqoftë, vlerësimi juridik i akteve administrative është centralizuar nën autoritetin e Gjykatës Themelore të Prishtinës.

herë në gjykatë themelore më pastaj mund të apelohen në një gjykatë të centralizuar të shkallës së dytë, Gjykata e Apelit të Kosovës[188]. Pasi të kalojë edhe Gjykatën e Apelit, vendimi bëhet i prerë dhe nuk mund të ankimohet me mjete të rregullta juridike[189]. Nuk është e mjaftueshme që rasti thjesht të parashtrohet në Gjykatën Kushtetuese, nëse të gjitha mjetet efektive juridike nuk janë shteruar. Kjo sigurisht vë theksin tek fakti që personat duhet të shterojnë jo vetëm mjetet e zakonshme juridike në dispozicion, por edhe ato që kanë status të jashtëzakonshëm. Si i tillë, Ligji për Gjykatat mundëson që personat të shfrytëzojnë mjete të jashtëzakonshme juridike për të apeluar vendimet e Gjykatës së Apelit tek Gjykata Supreme e Kosovës[190]. Vetëm pasi rasti të ketë kaluar edhe mekanizmin shqyrtues të Gjykatës Supreme, atëherë mund të parashtrohet në Gjykatën Kushtetuese, brenda juridiksionit të caktuar me nenin 113.7. Rrjedhimisht, në praktikë, sistemi gjyqësor i Kosovës mundëson që rasti të trajtohet në tri instanca gjyqësore, me anë të mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike, para se të konsiderojë që mjetet juridike efektive janë shteruar[191], duke fituar kështu statusin e rastit që mund të parashtrohet në Gjykatën Kushtetuese. Kjo do të thotë që një rast i caktuar së pari duhet të kalojë dy gjykata me mjete të rregullta juridike, si dhe një gjykatë me mjete të jashtëzakonshme juridike, para se të ketë mundësi të merret parasysh nga mekanizmi i vlerësimit kushtetues.

Në një aspekt më të gjerë, shterimi i mjeteve efektive juridike gjithsesi që duhet konsideruar me një masë elasticiteti. Si pikë referuese, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), në rastin Lehtinen kundër Finlandës dhe Cardot kundër Francës[192] ka vendosur që rregulli në fjalë duhet aplikuar me fleksibilitet, pra jo me aq shumë formalitet. Për më tepër, GjEDNj-ja ka

---

[187] Shih Ligji për Gjykatat e Kosovës, neni 17, paragrafi 1.

[188] Ligji për Gjykatat e Kosovës, neni 17, paragrafi 1.

[189] Këtu vlen një përjashtim i vetëm: rastet në lidhje me privatizimin dhe/ose ndërmarrjet shtetërore apo në pronësi publike gjykohen nga një dhomë e posaçme — si gjykatë e shkallës së parë — në kuadër të Gjykatës Supreme të Kosovës. Ekzistojnë edhe disa përjashtime tjera të vogla.

[190] Ligji për Gjykatat e Kosovës, neni 22, paragrafi 1.1.

[191] Në literaturë mund të haset pikëpamja se mjetet juridike të jashtëzakonshme nuk konsiderohen si mjete juridike efektive. Sidoqoftë, kjo mbetet e dyshimtë edhe në praktikën e GjEDNj, përderisa Gjykata Kushtetuese e Kosovës zakonisht i konsideron mjetet juridike të jashtëzakonshme si mjetet juridike efektive në pikëpamje të juridiksionit konkret të nenit 113.7.

[192] Keneth Lehitnen kundër Finlandës. Kërkesa nr. 39076/97. Vendimi në lidhje me Pranueshmërinë, Dhoma e GjEDNj (në referim të Cardot kundër Francës Aktgjykimi i datës 19 mars 1991, Seria A nr.200, 18, paragrafi 34).

vendosur në rastin Van Oostervvijck kundër Belgjikës që rregulli i shterimit nuk është as absolut e as automatik, si dhe duhet gjykuar në dritën e rrethanave të secilit rast individual[193]. Përveç kësaj, GjEDNj-ja ka përcaktuar tek rasti Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë që duhet "të merret parasysh realisht jo vetëm ekzistenca e mjeteve formale juridike në sistemin ligjor të Palës Kontraktuese, por edhe konteksti i përgjithshëm juridik dhe politik në të cilin ato funksionojnë, por edhe rrethanat personale të parashtruesve"[194]. Kjo thekson nevojën që mjeti juridik të jetë edhe në dispozicion por edhe efektiv, dy kushte të cilat gjykata subsidiare duhet t'i ketë parasysh kur vlerëson nëse kushti i shterimit është plotësuar nga parashtruesi; për shembull, në rastin D.H. et al. Kundër Republikës Çeke, GjEDNj-ja ka vendosur që duhet vlerësuar nëse parashtruesi ka shfrytëzuar mjetet juridike "që mund të priten nga ai apo ajo në masë të arsyeshme"[195]. Megjithatë, në përgjithësi, mënyra në të cilën GjEDNj-ja vështron çështjen e shterimit të mjeteve juridike nuk është e natyrës së njëjtë me atë të një gjykate shtetërore kushtetuese, por parimet e njëjta zbatohen. Si të tilla, marrë parasysh vështrimit që GjEDNj-ja e ngre çështjen e shterimit të mjeteve jo vetëm që është e dobishme, por në një masë edhe çështje përgjegjësie[196]. Nga kjo del se Gjykata Kushtetuese mund të interpretojë në mënyrë fleksibile rregullin e shterimit nga neni 113.7, si dhe të mundësojë që rasti të gjykohet nga ajo edhe nëse nuk ka plotësuar krejt kushtet në tërësinë e tyre për t'u konsideruar si mjete efektivisht të shteruara. Gjykata Kushtetuese, për shembull, mund të pranojë kërkesën si të lejueshme *nëse nuk është e mundur të shterohen të gjitha mjetet tjera juridike, për shembull në rastin e masave sekrete të vëzhgimit policor, për të cilat personi i prekur nuk është informuar, si dhe kështu nuk mund të parashtrojë ankesë kundër tyre, si dhe në rastet kur është e paarsyeshme të pritet nga ankuesi të shterojë të gjitha mjetet tjera juridike*[197]. Kjo është kështu në veçanti në rastin kur kërke-

[193] Van Osterwijck kundër Belgjikës. Akgjykimi i datës 6 nëntor 1980, Seria A nr.40, paragrafi 35, 18.

[194] Keneth Lehitnen kundër Finlandës. Kërkesa nr. 39076/97. Vendimi në lidhje me Pranueshmërinë, Dhoma e GjEDNj (në referim të Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë, Aktgjykimi i datës 16 shtator 1996; Raportime mbi aktgjykimet dhe vendimet 1996-IV, fq. 1210-1211, paragrafët 65-68).

[195] D.H. Dhe të tjerët kundër Republikës Çeke. Kërkesa nr.57325/00. Aktgjykimi, Dhoma e Lartë, GjEDNj, 13 nëntor 2007, paragrafi 116 (në referim të Ilhan kundër Turqisë [DHL], nr.22277/93, paragrafi 59, GjEDNj 2000-VII).

[196] Të konsiderohet neni 53 i Kushtetutës së Kosovës si bazë e këtij obligimi.

[197] Elke Luise Barnstedt, "Differences Between Constitutional Complaints That Challenge Court Rulings And Those That Challenge Statutes. European Commission For Democracy

sa që parashtruesi të shterojë të gjitha mjetet juridike, "do të çonte në rrezikimin e parashtruesit që t'i ekspozohet procedurës penale"[198], ose kërcënimeve të tjera.

Kjo qasje fleksibile ndaj çështjes së shterimit — ngjashëm me atë të rastit Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë, që është përdorur nga GjEDNj-ja — është përdorur një herë nga Gjykata Kushtetuese në rastin Krasniqi kundër RTK dhe të tjerëve[199]. Gjykata Kushtetuese pati lejuar parashtruesin t'i nënshtrohet juridiksionit *in concreto* sipas nenit 113.7, edhe pse ai nuk kishte shteruar mjetet efektive juridike. Gjykata pati vendosur që në rrethanat kur pretendimi i një pale konteston një normë ligjore abstrakte, e cila nuk mund të shfuqizohet nga një gjykatë e rregullt pasi gjykatat e rregullta nuk shfuqizojnë ligjet, ka arsye objektive për të ndërhyrë në mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të parashtruesit për dobi të interesit publik, duke përjashtuar domosdoshmërinë e shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Kjo qasje, që është përdorur në rastin Krasniqi kundër RTK dhe të tjerët, i mundëson Gjykatës Kushtetuese t'i ndjekë me vendosmëri parimet e fleksibilitetit dhe racionalitetit në lidhje me shterimin e mjeteve juridike brenda kuptimit të nenit 113.7. Duhet theksuar këtu që rasti Krasniqi kundër RTK-së nuk ka pasur prirje të transformojë juridiksionin *in concreto* sipas nenit 113.7 në një drejtë *actio popularis* të individëve pasi që ka pranuar pretendimin e palës vetëm pasi ka konfirmuar që të drejtat individuale dhe interesat personale janë cenuar nga një normë abstrakte e cila nuk do të mund të korrigjohej efektivisht në një gjykatë të rregullt[200].

Përveç kësaj, Gjykata është marrë gjithashtu në rastin Bislimi kundër Ministrisë së Brendshme dhe të tjerët[201] me çështjen e mungesës së mjeteve efektive juridike. Parashtruesi në rastin Bislimi kundër Ministrisë së Brendshme

---

Through Law", në *Konferenca e Katërt e Sekretarëve të Përgjithshëm të Gjykatave Kushtetuese dhe Gjykatave të Juridiksionit Ekuivalent* (Ankara, Turqi: 1-2 tetor 2009), organizuar nga Komisioni i Venedikut, CDL-JU (2009) 055, fq. 2.

[198] Po aty.

[199] Tomë Krasniqi kundër RTK dhe të tjerët, Rasti KI 11/09. Vendimi mbi Masën e Përkohshme. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

[200] Disa mund të pohojnë se kjo praktikë çon deri tek *quasi action popularis*, me ç'rast individi mund të vërtetojë se norma abstrakte në një mënyrë ose tjetrën ndërhyn në interesin e tij/saj personal. Shih "Study on Individual Access to Constitutional Justice", Studimi No. 538/2009, miratuar nga Komisioni i Venedikut në sesionin e tij të 85 Plenar (Venedik, 17-18 dhjetor 2010).

[201] Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brandshme dhe të tjerët, Rasti KI 06/10. Akgjykim. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

dhe të tjerëve kishte argumentuar që e drejta e tij e lëvizjes ishte shkelur nga një "konkludim" i pashkruar i Ministrisë së Brendshme, si dhe që joformaliteti i atij akti e bënte të pamundur apelimin nga ai të atij akti në ndonjë gjykatë të rregullt. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese kishte vendosur që për aq sa parashtruesve nuk iu ofrohet një mjet efektiv juridik, ajo do të pranojë kërkesat e tyre si të lejueshme sipas nenit 113.7, si dhe të vlerësojë pretendimet e tyre lidhur me cenimin e të drejtave të njeriut.

Një çështje tjetër themelore në lidhje me rregullin e shterimit është nëse shterimi do të supozohet nëse ka më shumë se një mjet efektiv juridik në dispozicion, si dhe nëse parashtruesi ka shfrytëzuar vetëm njërin prej tyre. GjEDNj-ja ka konfirmuar, në rastin Jeličić kundër Bosnjë-Hercegovinës[202] që mjafton që parashtruesi të ketë shfrytëzuar njërin nga mjetet efektive juridike në dispozicion, nëse ka më shumë se një mjet juridik në dispozicion njëkohësisht. Për më tepër, GjEDNj-ja ka vendosur, në rastin Kozacioğlu kundër Turqisë që "parashtruesi duhet të ketë shfrytëzuar normalisht […] mjetet juridike që kanë gjasë të jenë efektive dhe të mjaftueshme, si dhe që kur një mjet nuk është shfrytëzuar, shfrytëzimi i një mjeti tjetër që në esencë ka të njëjtin synim nuk është i domosdoshëm"[203]. Përveç kësaj, ia vlen të bëhet pyetja nëse një parashtrues do të mund të parashtronte rastin në Gjykatën Kushtetuese, brenda juridiksionit të nenit 113.7, pasi të ketë shteruar mjetet vendore juridike, nëse rasti nuk ka qenë qartësisht identik kur është ngritur në gjykatat e rregullta. Prapë, GjEDNj-ja na paraqitet e dobishme në këtë kuptim, pasi që ka vendosur, në rastin Castells kundër Spanjës[204], se mjafton që rasti të jetë ngritur në thelb para një gjykate të rregullt, ashtu që rasti të mund të hyjë në derën e një gjykate subsidiare. Kjo ilustron që mjafton që parashtruesi të dorëzojë rastin në Gjykatën Kushtetuese, edhe nëse i njëjti pretendim, por së paku me substancë të njëjtë, nuk është vlerësuar nga gjykatat e rregullta. Për më tepër, mjetet diskrecionale juridike — si kërkesa që gjykata të rishikojë vendimin e saj — nuk kanë nevojë të shfrytëzohen, siç është vendosur nga GjEDNj-ja në rastin Prystavska kundër Ukrainës[205].

---

[202] Ruža Jeličić kundër Bosnjë-Hercegovinës. Kërkesa nr.41183/02. Vendimi mbi Pranueshmërinë. Dhoma, 15 nëntor 2005, GjEDNj.

[203] Kozacioğlu kundër Turqisë. Kërkesa nr.2334/03. Akgjykim. Dhoma e Lartë, 19 shkurt 2009, paragrafi 40 (në referim të Riad dhe Idiab kundër Belgjikës, nr.29787/03 dhe 29810/03, paragrafi 84, GjEDNj 2008).

[204] Castells kundër Spanjës. Kërkesa nr.11798/85. Akgjykim. Dhoma, GjEDNj, 23 prill 1992.

[205] Danyila Semenivna Prystavska kundër Ukrainës. Kërkesa nr.21287/02, Vendimi mbi Pranueshmërinë, Dhoma, GjEDNj, 17 dhjetor 2002.

Një pyetje tjetër ka të bëjë me palën tek e cila lihet barra e dëshmisë në lidhje me shterimin e mjeteve juridike. Ligji për Gjykatën Kushtetuese përcakton që Gjykata Kushtetuese trajton kërkesën që dorëzohet nga një person sipas nenit 113.7 "nëse përcakton që të gjitha kushtet ligjore janë përmbushur"[206] nga personi në fjalë. Pra, argumentohet që Ligji nuk emëron saktësisht palën që duhet të dëshmojë shterimin e mjeteve juridike, por i lë Gjykatës Kushtetuese të përcaktojë sipas detyrës zyrtare nëse pretendimi i palës për shterimin e mjeteve juridike është i saktë apo jo.

Ligji thekson që parashtruesi do të mund të parashtronte një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, nën autoritetin e nenin 113.7, brenda katër muajsh nga dita kur parashtruesi ka marrë njohuri mbi vendimin përfundimtar të gjykatës së rregullt, që i mundëson atij personi të dorëzojë rastin në Gjykatën Kushtetuese. Në të gjitha rastet tjera, periudha katër-mujore fillon në ditën kur akti apo vendimi i kontestuar është publikuar zyrtarisht[207]. Periudha katër-mujore shërben sigurinë juridike të parashtruesve, si dhe iu mundëson atyre të kenë kohë racionalisht të mjaftueshme për të ngritur rastin në gjykatën subsidiare, si dhe parandalon vonesat e panevojshme në procedura. Kjo sigurisht është në përputhje me standardet e Strasburgut për afatet kohore, siç është përcaktuar nga GjEDNj-ja në rastin P.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar[208].

Në parim, mund të thuhet që vetëm parashtruesit që mund të dëshmojnë që janë viktima të shkeljes së një të drejte të njeriut sipas Kushtetutës do të mund të parashtronin kërkesën nga neni 113.7. Është me rëndësi që parashtruesi të vërtetojë vazhdimisht në Gjykatën Kushtetuese se ka qenë viktimë e shkeljes që është ngritur para Gjykatës, siç është vendosur nga GjEDNj-ja në rastin Scordino kundër Italisë[209]. Megjithatë, siç theksohet nga GjEDNj-ja në rastin Lizarraga et al. kundër Spanjës[210], Gjykata duhet të aplikojë kon-

---

[206] Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, neni 46.

[207] Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, neni 49. Ligji gjithashtu njeh procedurën për rikthimin në gjendjen paraprake, dhe Gjykata mund të pranojë se një palë mund të parashtrojë një kërkesë pas periudhës katër muajshe nëse ajo palë mund të dëshmojë se një problem serioz e ka penguar atë nga parashtrimi i kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese në afatin e duhur (shih Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, neni 50).

[208] P.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar. Kërkesa nr.6638/03. Vendimi për Pranueshmërinë. Dhoma, GjEDNj, 24 gusht 2004.

[209] Scordino kundër Italisë (nr. 1). Kërkesa nr. 36813/97. Aktgjykim. Dhoma e Lartë, GjEDNj, 29 mars 2006 (paragrafi 179).

[210] Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët kundër Spanjës. Kërkesa nr. 62543/00. Aktgjykim. Dhoma, 27 prill 2004 (paragrafi 38).

ceptin e "viktimës" në mënyrë liberale dhe në përputhje me perceptimin e zakonshëm të viktimës në shoqëri. Përveç kësaj, në parim, kërkohet që shkelja e pretenduar të ketë prekur drejtpërdrejt viktimën, atë që ka parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, përndryshe parashtruesi nuk do të mund të kishte ratione personae në Gjykatë, ashtu siç edhe është vendosur nga GjEDNj-ja në rastin Amuur kundër Francës[211], sado që GjEDNj ka kërkuar në rastin Karner kundër Austrisë[212] që ky rregull të mos interpretohet në mënyrë mekanike dhe dogmatike. Kështu, ka disa raste në të cilat GjEDNj sugjeron konsiderimin e "viktimave" potenciale si palë të kualifikuara për të parashtruar një kërkesë për proces subsidiar të vlerësimit të të drejtave të njeriut, si në rastin Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar[213]. Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, ndjenja apo supozimi që e drejta e dikujt është shkelur i jep shkas të qenët viktimë e një shkeljeje të të drejtave të njeriut, siç është thënë në rastin Vijayanathan e Pusparajah kundër Francës[214]. Përveç kësaj, vlen të theksohet që në raste të veçanta, Gjykata Kushtetuese mund të pranojë një kërkesë brenda juridiksionit të nenit 113.7 nga një viktimë indirekte, siç është bashkëshortja e viktimës (shih rastin e GjEDNj-së McCann et al. Kundër Mbretërisë së Bashkuar[215]), ose nipi i viktimës (shih rastin e GjEDNj-së Yaşa kundër Turqisë[216]). Gjykata Kushtetuese do të mund të pranonte të gjykonte pretendimin e një viktime indirekte si dhe të njihte statusin e saj si veprim në emër të viktimës direkte, por vetëm nëse ka një lidhje personale mes viktimës së drejtpërdrejtë dhe parashtruesit, me kusht që viktima direkte të mos ketë mundësi të parashtrimit në Gjykatë.

Në fund, është me rëndësi të shihet nëse Gjykata do të mund të vendoste ndonjë kriter material, kundrejt atyre procedural, për rastet që i parashtrohen për të kaluar filtrin e lejueshmërisë[217]. Edhe pse parashtruesi do të mund

---

[211] Amuur kundër Francës, 17/1995/523/609. Aktgjykim. Dhoma, GjEDNj, 25 qershor 1996 (paragrafi 36).

[212] Karner kundër Austrisë. Kërkesa nr.40016/98. Aktgjykim. Dhoma, GjEDNj, 24 korrik 2003 (paragrafi 25).

[213] Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar. Kërkesa nr.14038/88. Aktgjykim. Sesioni Plenar, 7 korrik 1989.

[214] Vijayanathan dhe Pusparajah kundër Francës. Kërkesa nr.17550/90, 17825/91. Aktgjykim. Dhoma, GjEDNj, 27 gusht 1992 (paragrafi 46).

[215] McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar. Kërkesa nr.18984/91. Aktgjykim. Dhoma, GjEDNj, 27 shtator 1995.

[216] Yaşa kundër Turqisë. Kërkesa 63/1997/847/1054. Aktgjykim. Dhoma, GjEDNj, 2 shtator 1998 (paragrafi 66).

[217] Për një listë të përgjithshme të kritereve në këtë çështje, parë nga këndvështrimi i drejtësisë kushtetuese Evropiane, shih Arne Mavčič, "The Applicant before the Constitutional

të përmbushte të gjitha kushtet e lejueshmërisë procedurale, shumica prej të cilave janë trajtuar më lart, Rregullorja e Punës lejon që Gjykata Kushtetuese të refuzojë një rast në bazë të lejueshmërisë, "kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme, ose që nuk përfaqësojnë një rast ose një kontest"[218]. Pra, mund të argumentohet që Gjykata do të mund të hedhë poshtë një rast si i palejueshëm *ratione materiae* nëse mendon që "rasti për çfarëdo arsye nuk paraqet një çështje që duhet të trajtohet nga Gjykata Kushtetuese". Në këtë drejtim, i lihet Gjykatës në liri të veprimit të plotë të vlerësojë nëse një kërkesë e tillë është mjaftueshëm një çështje për t'u gjykuar sipas juridiksionit *in concreto*[219]. Kjo shkon në të mirë të argumentit që Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt, pasi që nuk është e obliguar të gjykojë secilën kërkesë që thjesht plotëson kriteret procedurale të lejueshmërisë.

3. Fushëveprimi dhe natyra e vlerësimit *in concreto*

Disa prej karakteristikave kryesore të juridiksionit *in concreto* të Gjykatës Kushtetuese kanë të bëjnë me fushëveprimin dhe natyrën e vlerësimit si të tillë. Vlerësimi *in concreto* është vlerësim *ex post*, që do të thotë vlerësim i shkeljes së pretenduar vetëm pasi parashtruesi të dorëzojë fakte që ajo ka ndodhur, si dhe që është ndikuar drejtpërdrejt nga ajo. Kështu, pyetja e parë ka të bëjë me fushëveprimin e vlerësimit *in concreto*. Siç përcaktohet me nenin 113.7, Gjykata është e autorizuar të gjykojë një rast të parashtruar nga një person në lidhje me përputhshmërinë e një akti të një autoriteti publik[220] me

---

Court with a Special Reference to the Individual Application: Access to the Court — The Applicant in the Constitutional Jurisdiction", Riga, Letoni: 6 nëntor 2009, Komisioni i Venedikut, CDL-JU (2009) 039.

[218] Rregullorja e Punës e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Rregulli 32, paragrafi 4.

[219] Instrumenti i filtrimit shfrytëzohet nga shumë gjykata kushtetuese në botë, si Gjykata Kushtetuese Gjemane, dhe gjykatat e arsyetojnë përdorimin e tij me pikëpamjen se gjykata kushtetuese duhet të refuzojë ato raste të cilat mund të duken se kanë një shkallë të lartë të dështimit dhe të lejojnë që vetëm ato që kanë mundësi të lartë të suksesit të kalojnë këtë filtrim. Shih Arne Mavčič, "The Applicant before the Constitutional Court with a Special Reference to the Individual Application: Access to the Court — The Applicant in the Constitutional Jurisdiction", Riga, Letoni, 6 nëntor 2009, Komisioni i Venedikut, CDL-JU (2009) 039.

[220] Ligji për Gjykatën Kushtetuese në Serbi, Ligji Kushtetues për Gjykatën Kushtetuese të Kroacisë dhe Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Sllovenisë lejojnë që parashtruesit individual të sfidojnë jo vetëm aktet e autoriteteve publike, por edhe aktet e autoritetve të mveshura me autoritet publik në lidhje me përputhjen e tyre me të drejtat e njeriut. Mbetet për t'u parë nëse Gjykata Kushtetuese e Kosovës do të zgjerojë aktet të cilat do t'i vlerësojë sipas juri-

katalogun e të drejtave të njeriut të përcaktuar me Kushtetutë[221]. Kjo flet për faktin që arsyeshmëria e juridiksionit *in concreto* të Gjykatës Kushtetuese është aty vetëm për të mbrojtur të drejtat e njeriut, e jo për të zgjidhur kontestet apo konfliktet mes autoriteteve dhe/ose personave. Kjo, në anën tjetër, legjitimon funksionin e Gjykatës, pasi e bën gjykatë të specializuar të shkallës së fundit për të drejtat e njeriut.

Kjo ngre dy pyetje: së pari, a ka një listë shteruese të të drejtave të njeriut të përcaktuar me Kushtetutë? Së dyti, a ka kufizim të vlerësimit nga Gjykata të aktit të kontestuar?

Sa i përket pyetjes së parë, Kushtetuta ofron tri burime të garancive të të drejtave të njeriut: së pari, një listë të drejtash e lirish që janë të shkruara e të përcaktuara me tekstin e vetë Kushtetutës; së dyti, një listë të tetë instrumenteve ndërkombëtare për të drejta të njeriut që janë pjesë e Kushtetutës përmes nenit 22[222]; dhe, së treti, gjithë praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, e cila, sipas nenit 53 të Kushtetutës, është pikë referuese obligative për interpretimin e garancive të të drejtave të njeriut të përcaktuar me të[223]. Me këto tri

---

diksionit nga neni 113.7. Krahas kësaj, Steinberger pohon se, në lidhje me pyetjen se cilat akte mund të sfidohen përpara gjykatës kushtetuese, zgjidhjet ndryshojnë nga vendi në vend, me fillim që nga përfshirja e të gjitha akteve të autoriteteve publike në vend deri te kufizimi vetëm në akte të veçanta (norma të kategorive të ndryshme, vendime të gjykatave, akteve administrative). Mund të jetë fare me vend që të zgjerohet juridiksioni i kërkesave kushtetuese ndaj të gjitha akteve të autoriteteve publike, si aktet administrative, vendimet dhe urdhërat e gjyqësorit e madje edhe aktet legjislative përfshirë statutet, normat nënligjore dhe dekretet e institucioneve te pavarura. Shih Helmut Steinberger, *Models of Constitutional Jurisdiction* (European Commission For Democracy Through Law [Venice Commission]: Strasbourg, 1993) [CDL-STD (1993) 002].

[221] Lopez-Guerra argumenton se "në kërkesat kushtetuese në Spanjë dhe Gjermani, nuk është kushtetueshmëria e një ligji të aplikuar nga një gjyqtar apo nga administrata që merret në shqyrtim, por nëse janë shkelur të drejtat themelore të një individi të vetëm apo një grupi nga një aplikim i tillë. Prandaj, është akti ai që gjykohte dhe jo norma." Kjo ndihmon mjaft shumë në ndarjen e funksionit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për sa i përket juridiksionit të saj sipas nenit 113.7. Shih Luis Lopez-Guerra, "The Role and Competences of the Constitutional Court", në Venice Commission, *The role of the constitutional court in the consolidation of the rule of law* [UniDem Seminar Bucharest, 8-10 June 1994, CDL-STD (1994) 010] (Council of Europe: Strasbourg, 1994).

Shih edhe: Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, neni 47, paragrafi 1.

[222] Këto janë, në përputhje me rrethanat, drejpërdrejt efektive dhe të aplikueshme, dhe kanë një rang kushtetues për nga fuqia e tyre, ndonëse Kosova nuk është palë në këto tetë traktate ndërkombëtare dhe nuk mban asnjë përgjegjësi ndërkombëtare për zbatimin e tyre. Shih Kushtetutën e Kosovës, nenin 22, paragrafët 1-8.

[223] Fisnik Korenica dhe Dren Doli, "Calling Kosovo's Constitution: A Legal Review", *Denning Law Journal* vol. 22, no. 1 (2010) fq. 51; Në lidhje me rolin që GjEDNj ka kryer kundrejt

burime të drejtash të njeriut, do të mund të argumentohej që lista e të drejtave të njeriut e përcaktuar me Kushtetutë ka natyrë joshteruese, si dhe bazohet në burime vendore dhe ndërkombëtare.

Pyetja e dytë ka rëndësi më praktike, pasi pyet nëse Gjykata duhet, në bazë të vlerësimit të saj *in concreto*, të merret vetëm me anën procedurale të akteve nga autoritetet publike, ose do të mund të angazhohej edhe me pjesën substanciale të atyre akteve. Argumenti ynë në këtë drejtim është mjaft i thjeshtë: pasi neni 113.7 autorizon Gjykatën Kushtetuese të vendosë mbi përputhshmërinë e akteve të autoriteteve publike me secilën të drejtë të njeriut të përcaktuar me Kushtetutë, nuk kufizon të drejtat mbi të cilat Gjykata është e obliguar të vendosë. Pra, Kushtetuta ofron edhe të drejta që kanë natyrë procedurale (si e drejta për t'u dëgjuar, ose e drejta për gjykim të drejtë), si dhe të drejtat që kanë natyrë substanciale (si e drejta për pronë ose e drejta për arsim). Kjo tregon që juridiksioni *in concreto* i Gjykatës nuk është vetëm të kontrollojë pjesën procedurale të aktit të kontestuar publik, por edhe pjesët përmbajtjesore të tyre. Kështu, Gjykata thirret të kontrollojë pajtueshmërinë e akteve publike me Kushtetutën, edhe në kuptimin e procedurës, por edhe në meritat e tyre.

Të mundohemi të demonstrojmë këtë me dy raste. Tek rasti AKP kundër Gjykatës Supreme[224], Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar vendimin e Gjykatës Supreme, duke gjetur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, pa konsideruar meritat e rastit. Gjykata Kushtetuese kishte kërkuar që Gjykata Supreme të rigjykojë rastin, në përputhje me garancitë procedurale të përcaktuara me të drejtën për gjykim të drejtë[225]. Në të kundërtën e kësaj,

---

gjykatave kushtetuese kombëtare për sa i përket të drejtave të njeriut, Sadurski argumenton se këto të fundit kanë shërbyer si mjete të fuqishme të harmonizimit "të shqyrtimeve kushtetuese, dhe se [...] gjykatësit e gjykatave kushtetuese janë në dijeni se fjala e tyre mund të mos jetë e fundit në lidhje me kushtetueshmërinë e një ligji kombëtar". Shih Wojciech Sadurski, "Constitutional Review in Europe and in the United States: Influences, Paradoxes, and Convergence", *Legal Studies Research Paper* (Sydney Law School) no. 11/15 (2011) fq. 8.

[224] Agjencia Kosovare e Pronës kundër Gjykatës Supreme. Rasti KI 25/10. Akgjykim. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

[225] A mundet gjykata kushtetuese, na bazë të logjikimit të njëjtë, t'i ofrojë individëve të drejtën për të parashtruar ankesa kundër akteve të personave privatë? Kjo është një praktikë e Gjykatës Kushtetuese të Spanjës. Prandaj argumentohet se Gjykata Kushtetuese e Spanjës në mënyrë të tërthortë ka lejuar ankimimin/shqyrtimin e akteve të personave privatë. Gjykata argumenton se vendimi i një gjykate civile mund të jetë shkak i shkeljes së të drejtave të individuale, duke u bazuar se gjykata me rastin e marrjes së një vendimi në një çështje gjyqësore private, mund të mos ofrojë mbrojtje efikase të të drejtave kushtetuese individuale ku-

në rastin Ibrahimi me të tjerët kundër Gjykatës Supreme[226], Gjykata Kushtetuese jo vetëm që kishte gjetur që Gjykata Supreme kishte shkelur të drejtën për gjykim të drejtë, por kishte vendosur edhe që Gjykata Supreme kishte dështuar në garantimin e së drejtës për pronë për parashtruesit. Pra, Gjykata Kushtetuese kishte shfuqizuar vendimin e Gjykatës Supreme, si dhe i kishte kërkuar kësaj të fundit që të rihapte rastin duke respektuar të drejtën e parashtruesve në pronë, si dhe të drejtën e tyre për gjykim të drejtë. Rasti Ibrahimi me të tjerë kundër Gjykatës Supreme tregon që Gjykata Kushtetuese urdhëron që gjykata e rregullt të veprojë në një mënyrë të caktuar në lidhje me meritumin e vendimit, si dhe procedurën e gjykimit të saj. Kjo flet për faktin që Gjykata Kushtetuese angazhohet në ritrajtimin e meritumit nga gjykata më e ulët, për aq sa ka të bëjë me të drejtën kushtetuese, si dhe e konsideron të pamjaftueshme të merret vetëm me pjesën procedurale të vendimit.

Vlen të bëhet pyetja nëse juridiksioni *in concreto* i Gjykatës Kushtetuese do të mund të përdorej për të kontrolluar vetëm veprimet apo edhe mosveprimet e organeve publike në kuptimin e përputhshmërisë së tyre me të drejtat kushtetuese. Edhe pse nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë që e qartëson këtë, Gjykata Kushtetuese e ka bërë të qartë në rastin Bislimi kundër Ministrisë së Brendshme dhe të tjerët[227] që është brenda juridiksionit të saj *in concreto* që të vendosë mbi mosveprimet e autoriteteve publike në kuptimin e përputhshmërisë së tyre me katalogun e të drejtave të njeriut. Kjo qasje është ruajtur fuqimisht, edhe pse në një natyrë më abstrakte, në rastin TYLSL kundër Gjykatës Supreme[228], ku Gjykata Kushtetuese ka kërkuar që parlamenti të miratojë një ligj, mosmiratimi i të cilit është konsideruar të ketë shkelur të drejtat e parashtruesve. Për pasojë, me juridiksionin e saj *in concreto*, Gjykata Kushtetuese mund të vlerësojë edhe aktet edhe mosveprimet e autoriteteve publike në kuptimin e të drejtave të njeriut.

Në lidhje me fushëveprimin e shqyrtimit, dalin tri pyetje të përgjithshme: së pari, efektet e tyre *ratione personae*; së dyti, efektet e tyre *ratione temporis*; si dhe së treti, efektet *ratione materiae.*

---

ndrejt aktit të një personi privat. Shih Helmut Steinberger, *Models of Constitutional Jurisdiction* (Venice Commission: Strasbourg, 1993) [CDL-STD (1993) 002], pika IV, paragrafi 3.

[226] Imer Ibrahimi dhe të tjerët kundër Gjykatës Supreme. Rasti KI 40/90. Aktgjykim. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

[227] Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brandshme dhe të tjerët. Rasti KI 06/10. Akgjykim. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

[228] Trashëgimtarët e Ymer Loxhës dhe Sehit Loxhës kundër Gjykatës Supreme. Rasti KI 14/09. Vendim mbi Pranueshmërinë. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Është shumë e qartë që kur Gjykata Kushtetuese vendos në mënyrë abstrakte mbi një çështje, vendimi i saj ka efekt *erga omnes*. Në anën tjetër, kur Gjykata Kushtetuese vendos mbi një rast individual, që i referohet një pretendimi individual, vendimi i Gjykatës duhet të jetë mbi një çështje individuale dhe, rrjedhimisht, efekti është vetëm *inter partes*. Spektri i këtij efekti është në përputhje me kërkesën e Ligjit që parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë[229]. Megjithatë, është e mundur që Gjykata të vendosë jo vetëm mbi një pretendim individual të parashtruesit, por edhe njëkohësisht të vendosë *in abstracto* për një çështje të caktuar që ka relevancë të drejtpërdrejtë me shkeljen që pretendohet të jetë shkaktuar në rastin individual që gjykohet. Rasti Krasniqi kundër RTK-së dhe të tjerëve[230] është ilustrim i praktikës ku Gjykatës i kërkohet të vendosë mbi një pretendim individual, por, për të korrigjuar shkeljen, Gjykata duhet të vendosë *ultra petitum* mbi ligjin që supozohet të ketë shkaktuar shkeljen. Në këtë kontekst, vendimi i Gjykatës ka efekt *inter partes* për sa i përket rikthimit të së drejtës së parashtruesit, kurse pjesa e vendimit që ka natyrë abstrakte ka efekt *erga omnes*. Kjo thekson faktin që edhe pse juridiksioni *in concreto* iniciohet nga një palë individuale që ka pretendim *in concreto*, Gjykata përveç vendimit për atë pretendim *in concreto* mund të vendosë paralelisht edhe *in abstracto* për të mundësuar që aktet abstrakte që shkaktojnë shkeljen individuale të shfuqizohen: kjo e bën vetë vendimin të ketë efekt *inter partes* në lidhje me pretendimin individual, si dhe efektin *erga omnes* në kuptimin e normave abstrakte të identifikuara dhe vendosura nga Gjykata.

Derisa shumë kritikohet rrethana që parashtresat për kontrollimin e kushtetutshmërisë së akteve abstrakte mund të bëhet vetëm nga aktorët institucionalë, e kundërt kjo me *actio popularis*, gjë që nënkupton pozicionim kundër iniciativave popullore[231], efekti *erga omnes* i aktgjykimeve të Gjykatës mund të ofrojë zgjidhjen me kusht që pala të cilësohet si legjitime për të ngritur çështjen në bazë të një interesi individual sipas nenit 113.7, siç edhe është vendosur në rastin Krasniqi kundër RTK-së dhe të tjerëve. Kjo thekson fak-

[229] Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, neni 48.

[230] Tomë Krasniqi kundër RTK dhe të tjerët. Rasti KI 11/09. Vendimi mbi Masën e Përkohshme. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

[231] Për një shënim të përgjithshëm për këtë çështje, shih Dren Doli dhe Fisnik Korenica, "Kosovar Constitutional Court's Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010) fq. 803, 809.

tin që edhe iniciativat individuale, krahas atyre institucionale, do të mund të vinin aktin abstrakt në filtrin e rishikimit kushtetues, edhe pse në mënyrë të tërthortë, si dhe përmes një pretendimi individual për shkelje të të drejtave të njeriut.

Një çështje tjetër e rëndësishme në lidhje me fushëveprimin e efektit *ratione personae* sa i përket juridiksionit *in concreto* të Gjykatës Kushtetuese është nëse arsyet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese janë obliguese. Në përgjithësi, Gjykata Kushtetuese qartëson — në pjesën e arsyetimit — kërkesën e parashtruesit individual duke shpjeguar standardet dhe rregullat e përgjithshme (abstrakte) që aplikon, siç mund të shihet për shembull në rastin Ibrahimi e të tjerët kundër Gjykatës Supreme[232], Kastrati kundër Gjykatës Supreme[233], NTSh Meteorit kundër Gjykatës Supreme[234], e të tjera. Por, në rastin TYLSL kundër Gjykatës Supreme[235], vendim ky për lejueshmërinë, Gjykata i kishte kërkuar Kuvendit, në arsyetimin e saj, që të respektojë disa obligime të caktuara kushtetuese. Kështu, arsyetimi i aktgjykimit ka vënë një obligim pozitiv për Kuvendin. Sa i përket efekteve *ratione temporis* të vlerësimit, mund të thuhet që i mbetet Gjykatës Kushtetuese të vendosë nëse vendimi i saj duhet të jetë efektiv *ex tunc* ose *ex nunc*. Një shembull i tillë është rasti IUVVIMK kundër AKP-së[236], ku Gjykata i kishte dhënë efekt *ex tunc* aktgjykimit të saj, duke i gjetur aktet e ndërmarra nga AKP-ja si nule. Në të kundërtën, në shumë vendime të tjera, Gjykata i jep efekt *ex nunc* vendimeve të saj. Pra, mund të thuhet që çështja e efektit *ratione temporis* të vendimeve kushtetuese është çështje e natyrës së shkeljes të së drejtës: Gjykata mund të konsiderojë që shkelja mund të korrigjohet vetëm me efekt *ex tunc* të aktgjykimit, si dhe e kundërta, duke lënë mundësinë të argumentohet që lloji i efektit që Gjykata i jep vendimeve të saj varet nga mënyra në të cilën ajo korrigjon shkeljet e të drejtave të individit.

Në vijim për sa më sipër, është tejet e rëndësishme të vihen në pyetje efektet *ratione materiae* të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me

---

[232] Ibrahimi dhe të tjerët kundër Gjykatës Supreme. Rasti KI 40/90. Aktgjykim. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

[233] Kastrati kundër Gjykatës Supreme. Rasti KI 68/09. Aktgjykim. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

[234] NTSH Meteorit kundër Gjykatës Supreme. Rasti 55/09. Aktgjykim. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

[235] Trashëgimtarët e Ymer Loxhës dhe Sehit Loxhës kundër Gjykatës Supreme. Rasti KI 14/09. Aktvendim. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

[236] Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Fabrikës së Çelikut IMK në Ferizaj kundër AKP. Rasti 08/09. Aktgjykim. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

juridiksionin *in concreto*. Kjo e vë në pikëpyetje edhe masën në të cilën Gjykata Kushtetuese mundet dhe duhet të angazhohet në aspektin material (të brendshëm) derisa gjykon një rast individual. Në këtë pikë të diskutimit, sigurisht që mund të argumentohet se Gjykata Kushtetuese nuk ka të drejtë të kryejë një funksion që i atribuohet një gjykate të rregullt, ashtu që vlerësimi i saj duhet të kufizohet në vlerësimin e aktit të kontestuar në lidhje me shkeljen e të drejtave kushtetuese, e jo në lidhje me "ligjshmërinë në përgjithësi"[237]. Në thelb, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë fakti, ashtu që nuk vendos mbi çështje që në juridiksion i përkasin gjykatave të rregullta. Ajo në parim vendos vetëm nëse rasti është në përputhje, në kuptimin procedural dhe substancial, me katalogun e të drejtave të njeriut. Nëse gjen që gjykata e rregullt apo një institucion tjetër shtetëror ka nxjerrë një akt jokushtetues, ajo shpall zhvlerëson (bën të pavlefshëm) aktet e tyre dhe kërkon nga institucionet përkatëse që të rishikojnë rastin, si dhe ta vendosin në përputhje me aktgjykimin e saj. Një shembull i tillë është Ibrahimi e të tjerë kundër Gjykatës Supreme[238], ku Gjykata kishte urdhëruar një gjykatë të rregullt të rihapte rastin dhe të vendoste meritat e rastit në përputhje me udhëzimet e vendimit të saj. Pra, në parim, Gjykata Kushtetuese nuk lëshohet në vlerësimin e provave apo vlerësimin e fakteve, pasi kjo është detyrë e zakonshme e gjykatave të rregullta[239]. Megjithatë, Ligji për Gjykatën Kushtetuese mundëson që Gjykata Kushtetuese të lëshohet në administrimin e provave dhe fakteve[240], duke i mundësuar të vlerësojë secilën provë që gjykata e rregullt ka pasur në trajtim[241]. Në dritën e kësaj të drejte që i përket Gjykatës Kushtetuese, do të mund

---

[237] Helmut Steinberger, *Models of Constitutional Jurisdiction* (Venice Commission: Strasbourg, 1993) [CDL-STD (1993) 002] pika IV, paragrafi 11.

[238] Imer Ibrahimi dhe të tjerët kundër Gjykatës Supreme. Rasti KI 40/90. Aktgjykim. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

[239] Elementet e fakteve nuk mungojnë kurrë tërësisht në çfarëdo lloj gjykimi: një normë ligjore gjithmonë i referohet fakteve, atyre të përcaktuara apo që do të krijohen më pastaj. Për këtë arsye, kurrë nuk mund të thuhet se gjykatat kushtetuese apo gjykatësit janë vetëm gjykatës të normave, dhe jo të njerëzve. Shih Eivind Smith, "Courts of people, not of norms? Law and fact in constitutional review as performed by courts of general or administrative jurisdiction", konferenca ndërkombëtare *Law and Fact in Constitutional Jurisprudence*, 30 qershor–1 korrik 2005, Vilnius, Lituani (Komisioni i Venedikut: Strasbourg, 2005) CDL-JU(2005)022, fq. 4.

[240] Ligji për Gjykatën Kushtetuese, neni 25.

[241] Është tejet e rëndësishme të përmendet liria e veprimit që i lejon Rregullorja e Punës Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lidhje me provat. Ndonëse funksioni i përgjithshëm i Gjykatës nuk ka të bëjë asgjë me një gjykatë të fakteve — një gjykatë që vërteton rrethanat faktike në lidhje me rastin që është duke u gjykuar — Rregullorja e Punës lejon që Gjykata Kushtet-

të thuhej që edhe ajo do të mund të luante rolin e gjykatës së faktit, me funksion të kufizuar, pasi nuk mund ta vendosë vetë rastin pasi që çështja i përket juridiksionit të një gjykate të rregullt. Ajo mund të vendosë vetëm për aspektet substanciale dhe procedurale që janë të garantuara me Kushtetutë, si dhe të cilat gjykata e rregullt duhet t'i marrë parasysh kur rihap rastin. Gjykata Kushtetuese pra nuk vërteton dëmet, nuk ofron kompensim, e as nuk atribuon përgjegjësi penale ndaj personave apo organizatave. Kjo shtyn më tutje argumentin që thotë se Gjykata Kushtetuese, sipas juridiksionit nga neni 113.7 i Kushtetutës, nuk është gjykatë e shkallës së katërt — edhe pse është nivel i katërt subsidiar i kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së akteve të autoriteteve publike — dhe se sipas kësaj, nuk luan rolin bazë të gjykatës së rregullt: Gjykata Kushtetuese vendos vetëm mbi çështjet kushtetuese, duke lënë çështjen e interpretimit të ligjeve gjykatave të rregullta[242]. Përveç kësaj, është me rëndësi të përmendet që Gjykata Kushtetuese mund të thotë në vendimin e saj se iu njeh gjykatave të rregullta një hapësirë të caktuar gjykimi e vendosje[243], duke refuzuar të merret me disa çështje *rationae materiae* me arsyetim se disa çështje më së miri trajtohen dhe gjykohen nga një gjykatë më e ulët rregullt.

Përveç këtyre, është me rëndësi të diskutohet natyra e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të nxjerra brenda juridiksionit të nenit 113.7. Kushtetuta e bën të qartë se "vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës"[244]. Kjo bazohet mbi qëndrimin që gjykatat e rregullta nuk kanë gjasë të refuzojnë që të marrin parasysh ose të udhëzohen nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Kësisoj, kjo dispozitë kushtetuese siguron që gjykatat e rregullta nuk mund të thonë që nuk duan të pranojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese që gjykon një rast individual me argumentin se kjo e fundit ka vepruar *ultra vires*. Në këtë drejtim, masa e përfshirjes së Gjykatës Kushtetuese në gjykimin e një rasti që ka kaluar nëpër gjykatë të rregullt është çështje e diskrecionit të vetë Gjykatës Kushtetuese, gjë që sugjeron se kjo e fundit do të mund

---

uese të luaj rolin e një gjykate faktike me të drejta të plota nëse ajo dëshiron që të përfshihet në shqyrtimin e rrethanave faktike të një rasti të veçantë. Shih Rregulloren e Punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Rregullat 45-53.

[242] Shih edhe Lech Garlicki (2007), "Constitutional Courts Versus Supreme Courts", *International Journal of Constitutional Law* vol. 5, nr. 1 (2007) fq. 68.

[243] Praktika e ndjekur nga GjEDNj në lidhje me njohjen e një hapsirë të gjerë të vlerësimit të lirë në favor të Gjykatës së Drejtësisë së BE-së mund të jetë një pikë referimi e mirë për këtë diskutim.

[244] Kushtetuta e Kosovës, neni 116, paragrafi 1.

të vendoste vetë dhe e vetme mbi një çështje, si çështje kushtetuese, edhe pse mund t'i përkasë fillimisht hapësirës juridiksionale të një gjykate të rregullt.

Mbetet me rëndësi të përmendet që juridiksioni *in concreto* i Gjykatës Kushtetuese mundëson paraqitjen e fenomenit të konstitucionalizimit të degëve të tjera të së drejtës. "Konstitucionalizimi i degëve të veçanta të së drejtës do të thotë që përmbajtja normative e secilës nga këto degë përcaktohet jo vetëm me ligjet e kodet e veçanta, por me dispozitat përkatëse kushtetuese dhe praktikën gjyqësore kushtetuese ekzistuese"[245]. Kjo ilustron funksionin në rritje të praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese që lind nga juridiksioni i saj për të kontrolluar mbrojtjen individuale të të drejtave të njeriut, si dhe ndikimin e saj në zgjerim e sipër mbi degët e tjera të së drejtës, të cilat normalisht zbatohen (vihen në jetë) nga ana e gjykatave të rregullta.

Përfundimisht, pasi Kosova nuk është palë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e kështu personat nga Kosova nuk mund të paraqiten *ratione personae* dhe *ratione loci* para Gjykatës së Strasburgut, është shumë e rëndësishme që një tribunal specifik të marrë përsipër rolin e trajtimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut në nivel shtetëror. Është e kuptueshme që pasi që Kushtetuta e Kosovës obligon gjykatat dhe të gjitha autoritetet e tjera publike të Kosovës që të ndjekin praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, si dhe i jep kompetencë specifike Gjykatës Kushtetuese për të shërbyer si tribunal subsidiar për të kontrolluar përputhshmërinë e akteve publike me ligjet e të drejtave të njeriut, Gjykata Kushtetuese mbetet mekanizëm zëvendësues për të zëvendësuar rolin që normalisht GjEDNj luan në një shtet anëtar të Këshillit të Evropës. Kjo mbështet argumentin që funksioni i Gjykatës Kushtetuese, në juridiksionin e saj *in concreto*, është themelor në lidhje me kontrollin subsidiar dhe mbrojtjen e të drejtave individuale.

Përfundim

Ky punim ka trajtuar juridiksionin *in concreto* të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lidhje me mbrojtjen e të drejtave individuale të njeriut, duke trajtuar veçanërisht kuptimin, fushëveprimin dhe natyrën e tij. Përveç kësaj, punimi zbulon funksionin special që juridiksioni *in concreto* i jep Gjykatës

[245] Lech Garlicki (2007), "Constitutional Courts Versus Supreme Courts", *International Journal of Constitutional Law* vol. 5, no. 1 (2007) fq. 68; shih edhe András Sajo, *Limiting Government: An Introduction to Constitutionalism* (Central European UP: Budapest, 1999) fq. 243.

në dritën e mbrojtjes së përgjithshme të të drejtave të njeriut në sistemin e përgjithshëm. Gjerësisht, punimi është shërbyer me një tërësi të gjerë të praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe GjEDNj-së, krahas dispozitave ligjore specifike që rregullojnë këtë çështje, për të përforcuar argumentet që janë dhënë, derisa theksohet që juridiksioni *in concreto* mbetet mjaft kompleks në disa raste. Në pjesën e vet fillestare, punimi ka trajtuar disa çështje të përgjithshme në lidhje me juridiksionin *in concreto* të Gjykatës Kushtetuese dhe ka qartësuar se cilat palë kanë status të parashtrojnë ankesa individuale pranë saj.

Në pjesën e dytë, punimi është marrë me standardet e lejueshmërisë së rasteve. Më me rëndësi, punimi analizon çështjen e shterimit të mjeteve juridike, para se parashtruesi të ketë mundësinë të kërkojë që Gjykata Kushtetuese të ofrojë kontrollimin e saj subsidiar mbi aktet e autoriteteve publike në kuptim të përputhshmërisë së tyre me të drejtat kushtetuese të njeriut. Punimi e bën të qartë që edhe praktika e Gjykatës Kushtetuese edhe jurisprudenca e GjEDNj-së kanë qenë në favor të faktit që rregulli i shterimit të mjeteve juridike nuk mund të interpretohet as mekanikisht, e as shumë formalisht. Përveç këtyre, punimi gjithashtu ka shqyrtuar disa standarde tjera të lejueshmërisë në lidhje me legjitimitetin e parashtruesve për parashtrimin e kërkesave sipas nenit 113.7, si dhe gjithashtu ka ofruar argumentin që Gjykata Kushtetuese do të mund të konsideronte të palejueshme *ratione materiae* një parashtresë që në vështrimin e Gjykatës nuk paraqet kundërthënie, ose nuk përbën rast (nuk është një çështje kontestuese). Rrjedhimisht, punimi ka trajtuar fushëveprimin dhe natyrën e rishikimit *in concreto* të ofruar nga Gjykata Kushtetuese, duke vënë në pikëpyetje në mënyrë specifike kufijtë dhe kuptimin që ky juridiksion i specializuar i jep asaj. Gjykata Kushtetuese është e kufizuar tek kontrollimi i përputhshmërisë së akteve dhe mosveprimeve të autoriteteve publike në kuptimin e përputhshmërisë së tyre me të drejtat kushtetuese, duke përfshirë edhe çështjet substanciale dhe procedurale. Ky rol specifik e bën Gjykatën nivel të katërt të kontrollit gjyqësor në kuptimin e mbrojtjes së të drejtave individuale të njeriut, por jo gjykatë të shkallës së katërt, e as gjykatë fakti. Në këtë drejtim, punimi gjithashtu diskuton natyrën e efekteve të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të nxjerra brenda juridiksionit të saj *in concreto*, e përgjithësisht përfundon që nuk ka ndonjë perspektivë, së paku ligjërisht, që gjykatat e rregullta të kontestojnë apo sfidojnë aplikimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Përfundimisht, punimi konkludon që e drejta kushtetuese në Kosovë ofron një juridiksion mjaft të pasur *in concreto* të Gjykatës Kushtetuese, duke e

bërë këtë të fundit autoritet të fundit institucional për trajtimin e mbrojtjes së të drejtave kushtetuese. Në anën tjetër, kjo përforcon argumentin që gjykatat kushtetuese në Evropë po transformohen në organe tejet të fuqishme gjyqësore, me synim të ofrimit të mbrojtjes gjyqësore subsidiare për të drejtat individuale të njeriut.

III. Vendimet kryesore që e bënë historinë kushtetuese në Kosovë

Hyrja

Siç do të shohim, asnjë nga këto raste nuk kanë të bëjnë me kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë (qoftë preventiv apo represiv). Vetëm një rast i trajtuar ka të bëjë me vlerësimin e kushtetutshmërisë së statutit të Komunës së Prizrenit, një qytet në jug të Kosovës në kufi me Shqipërinë, edhe pse rasti ishte ngritur si çështje e barazisë së qytetarëve të Kosovës në nivel komunal. Në këtë rast Gjykata nuk u mor me çështjen e kushtetutshmërisë së vetë statutit. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë se Gjykata nuk ka trajtuar çështje të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës abstrakte. Raste të tilla janë, mes tjerash, këto: *Rasti Qeska*[246], *Rasti i Imunitetit të zyrtarëve të lartë të Kosovës*[247], *Rasti i pagave të deputetëve të Kuvendit*[248], *Rasti Pacolli*[249], *Rasti i shpro-*

[246] Aktgjykimi në rastin nr. KO 80/10. Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Tij, dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e Kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska. Më 7 tetor 2010 (që kishte të bëjë me dorëheqjen e Kryetarit i cili më vonë e ndërroi mendjen si dhe efektin juridik në zgjedhjet lokale të kësaj dorëheqjeje pasi që ishte bërë publike).

[247] Aktgjykimi në rastin nr. KO 98/11. Parashtrues: Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Më 20 shtator 2011 (që kishte të bënte me fushëveprimin e imunitetit të zyrtarëve të lartë të Kosovës).

[248] Aktgjykimi në rastin nr. KO 119/10. Parashtrues: Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë të nenit 14, paragrafit 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Nr. 03/L-111 i 4 qershorit 2010. Më 8 dhjetor 2011 (që kishte të bënte me të ashtuquajturin pension suplementar i deputetëve)

[249] Sqarimi i aktgjykimit në rastin nr. KO 29/11. Parashtrues: Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.

nësimeve[250], the *Rasti i Marrëveshjeve Ndërkombëtare*[251], *Rasti i Hoçës së Madhe* dhe *Prizrenit*[252] etj. Këto aspekte të punës së Gjykatës do të trajtohen në të ardhmen në një punim tjetër shkencor. Këtu do të diskutojmë disa vendime që kanë shënuar kthesë në vendosjen e jurisprudencës së Gjykatës për të ardhmen.

Në rastin e parë, Rasti i Radiotelevizionit të Kosovës (RTK), do të elaborojmë formën dhe vetë përmbajtjen e vendimit të parë të Gjykatës që ka pasur ndikim në formësimin e sjelljes së menaxhmentit të RTK në raport me metodologjinë e financimit të RTK-së si subjekt publik i transmetimit. Siç do të shohim, vendimi i Gjykatës nuk ishte aktgjykim por aktvendim me të cilën vendosej masa e përkohshme të cilën e kishte kërkuar një individ, masë me të cilën u ndalua inkasimi i mëtejmë i 3,5 eurove nga RTK-ja për të financuar aktivitetet e saj.

I një rëndësie më të madhe se rasti i RTK-së ishte e ashtuquajtura Logoja e Prizrenit. Ky rast kishte të bënte me ankesën e ngritur në Gjykatë nga ana e Zëvendëskryesuesit të Komunës së Prizrenit, ku pretendonte se emblema e qytetit nuk reflektonte ndjenjat dhe identitetin të gjithë qytetarëve që jetojnë në këtë qytet të lashtë të Kosovës. Pas trajtimit të këtij rasti të rëndësishëm pason tregimi për dy (ish-)presidentët e Kosovës, të cilët u rrëzuan nga vendimet e Gjykatës brenda një periudhë kohore prej gjashtë muajsh.

04-V-04, në lidhje me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës të 22 shkurtit 2011. Sqarimi i kërkuar i Vendimit të shumicës të datës 30 mars 2011. Më 1 prill 2011 (që kishte të bënte me sqarimin që kishin kërkuar disa aktorë përkitazi me fushëveprimin e aktgjykimit në rastin 29/11 të 30 marsit 2011)

[250] Aktgjykimi në rastin Nr. KO 4/11. Parashtrues: Gjykata Supreme e Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr. 03/L-139. Më 1 mars 2012 (që kishte të bënte me kontroll incidental të normës të iniciuar nga Gjykata Supreme në çështjen që ishte në procedurë e sipër për shpronësimet e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës si pasojë e ndërtimit të autorrugës që lidh Shqipërinë me Kosovën dhe Serbinë)

[251] Aktvendimi për papranueshmëri në rastin Nr. KO 05/12. Parashtruesit e kërkesës: Visar Ymeri dhe dymbëdhjetë deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-279 të 20 janarit 2012, më 19 mars 2012.

[252] Aktgjykimi në rastet KO 45/12 dhe KO 46/12. Parashtrues: Liburn Aliu dhe 11 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësimin të kushtetutshmërisë të Ligjit për fashtin Hoçë e Madhe dhe Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Më 25 qershor 2012 (që kishte të bënte me kushtetutshmërinë e dy ligjeve të dizajnuara për të mbrojtur diversitetin kulturor dhe të tjerë në dy qytete të Kosovës që kanë numër të madh të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera joshumicë).

Përzgjedhja e rastit të fundit, rastit AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit), është bërë duke pasur parasysh natyrën specifike të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve evropianë që shërbejnë në mision në Kosovë, të njohur si misioni EULEX. Siç dihet , në bazë të një plani ndërkombëtar, Plani i Ahtisaari , i cili do të diskutohet më vonë, në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008 punon një numër i caktuar i gjyqtarëve dhe prokurorëve si pjesë e sistemit të drejtësisë në Kosovë. Këta gjyqtarë e prokurorë supozohej se ishin të detyruar ligjërisht që të zbatonin ligjet pozitive të Kosovës në mënyrë të njëjtë sikur kolegwt e tyre vendor. Kjo nuk po nodhte kështu pasi disa nga këta gjyqtarë dhe prokurorë në kuadër të Gjykatës Supreme të Kosovës po zbatonin ligjet e vendit në mënyrë arbitrare në bazë të zgjedhjes së tyre të lirë.

1. Vështrim i përgjithshëm i punës së Gjykatës dhe juridiksionit të saj

Gjykata Kushtetuese e Kosovës është gjykata e fundit e këtij lloji e themeluar në Evropë. Kjo megjithatë nuk do të thotë se Kosova nuk ka pasur gjykata kushtetuese në të kaluarën. Gjykata Kushtetuese ishte themeluar nga regjimi komunist më 1972 dhe ajo ka ekzistuar deri në suprimimin e saj nga regjimi i Sllobodan Millosheviqit në vitin 1989[253]. Nga kjo perspektivë historike, gjyqësia kushtetuese në Kosovë bën pjesë në gjeneratën e dytë të themeluar në Evropë në kulminacionin e Luftës së Ftohtë.

Gjykata e tanishme Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës u themelua në fillim të vitit 2009 me Ligjin nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës[254]. Që nga shkurti i vitit 2009 deri në kohën e këtij shkrimi (korrik 2012), Gjykata ka pranuar më shumë se katërqind e pesëdhjetë (450) kërkesa. Prej tyre, më shumë treqind e

[253] Cf. Mirosal Cerar, "Slovenia's Constitutional Court Within the Separation of Power", në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010) fq. 213-245, në 213 fusnota 2; cf. Gjithashtu zhvillimet kushtetuese në ish-Jugosllavi gjatë kësaj periudhe në Jovan Gjorgjeviq, *E Drejta Kushtetuese* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1972) fq. 75-114; Dr. Dimitrije Kulić, *Ustavno sudstvo u svetu* (Gjyqësia Kushtetuese në Botë) (Naša Reč: Leskovac, 1972) fq. 157-190.

[254] Ky Ligj u miratua nga Kuvendi i Kosovës më 16 dhjetor 2008. Është shpallur me Dekretin Nr. DL-070-2008 të 30 dhjetorit 2008.

pesëdhjetë (350) kërkesa janë zgjidhur ndërsa rreth 100 sosh janë në proces të vendosjes nga Gjykata. Në përgjithësi, pothuajse nëntëdhjetë (90) për qind e kërkesave janë shpallur si të papranueshme: Gjykata ka nxjerrë aktgjykime në vetëm dhjetë (10) për qind të rasteve. Një gjendje e tillë është e ngjashme me vende të tjera që kanë procedura të ankesës së plotë kushtetuese. Kjo është kështu për faktin se shumica dërmuese e kërkesave, rreth nëntëdhjetë (90) për qind kanë të bëjnë me ankesa individuale nga ana e qytetarëve dhe personave tjerë juridikë.[255] Institucionet e Kosovës janë palë përgjegjëse në pothuajse 14 për qind të rasteve, ndërsa pjesa tjetër janë kërkesa individuale nga qytetarët dhe personat juridikë. Në mesin e këtyre të fundit, ankuesit shqiptarë përbëjnë më se 80 për qind derisa serbët, turqit dhe qytetarët e tjerë të Kosovës përbëjnë pjesën tjetër të përqindjes. Kjo e bën Gjykatën të jetë institucioni më i besueshëm në vend.

Sa i përket juridiksionit, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka juridiksionin më të gjerë në mesin e gjykatave simotra në Ballkan. Ajo është e modeluar sipas sistemit gjerman që do të thotë që me një fjalë ka juridiksion mbi të gjitha veprimet e të gjitha autoriteteve publike në vend, përfshirë gjyqësorin. E vetmja procedurë që nuk është paraparë në Kushtetutë është ajo e iniciuar me *actio popularis*. Në kuptim të së drejtës kushtetuese, Gjykata ka juridiksion, *inter alia*, mbi të gjitha llojet e kontrollit abstrakt të normave ligjore dhe kushtetuese, *ex ante*[256] dhe *ex post*[257]; juridiksion mbi kontrollin incidental të normës që mund të iniciohet nga çdo gjykatë në Kosovë në çdo kohë me kusht që pranë tyre të jetë në procedurë e sipër një rast apo çështje e diskutu-

---

[255] Për këtë gjendje të gjërave, cf. Më shumë në hulumtimin e detajuar të ndërmarrë nga një studiues i ri Jean-Marc Lacourcière, *Report on the Jurisprudence of the Constitutional Court of Kosovo on Human and Minority Rights* (Kosovo Law Center: Prishtinë, 2011).

[256] Neni 113, paragrafi 9 i Kushtetutës (Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara):

"9. Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës".

[257] Neni 113, paragrafët 2 dhe 5 të Kushtetutës (Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara):

"2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;

(2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën."

"5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur".

eshme[258]; juridiksion mbi konflikt kompetencash që lind në mes pushtetit qendror dhe autoriteteve të tjera publike në Kosovë[259]; mbrojtjen në përgjithësi të të drejtave të autoriteteve lokale *vis-à-vis* autoriteteve qendrore[260]; juridiksion mbi shkeljet e pretenduara të Kushtetutës nga ana e Presidentit të Republikës[261]; vlerësimin e kushtetutshmërisë të vendimit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, referendumet e propozuara, propozim-amendamentet kundrejt marrëveshjeve të obligueshme ndërkombëtare të ratifikuara në mënyrën e duhur si dhe kushtetutshmërinë e zgjedhjeve për Kuvend[262]; juridiksion mbi ankesat individuale pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike brenda rendit kushtetues dhe juridik të Kosovës[263]; dhe, në fund, juridiksion shtesë që mund të caktohet me ligj[264].

---

[258] Neni 113, paragrafi 8 i Kushtetutës (Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara):

"8. Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë".

[259] Neni 113, paragrafi 3(1) i Kushtetutës (Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara):

"3. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:

konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës".

[260] Neni 113, paragrafi 4 i Kushtetutës (Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara):

"4. Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt".

[261] Neni 113, paragrafi 6 i Kushtetutës (Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara):

"6. Tridhjetë (30) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, janë të autorizuar të ngrenë çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës".

[262] Neni 113, paragrafi 3 (pika 2 deri 5) i Kushtetutës (Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara):

"3. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:

(1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

(2) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;

(3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;

(4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;

(5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit".

[263] Neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës (Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara):

2. Rasti i RTK-së

Rasti i Radiotelevizionit RTK është pikërisht vendimi i parë që e ka nxjerrë Gjykata më 16 tetor 2009. Ky vendim kishte të bënte me masë të përkohshme e jo me meritat e rastit. Në fakt kurrë nuk u vendos për meritat e rastit pasi që rasti u rregullua vetvetiu me kalimin e kohës. Ky vendim megjithatë ka pasur ndikim në vendimin për meritat e rastit.

Kërkesa e njohur si KI 11/09 (Tomë Krasniqi kundër RTK-së dhe të tjerëve) është e bazuar në një ankesë individuale të parashtruar në Gjykatë nga z. Tomë Krasniqi, një qytetar pensionist i Kosovës më 2 shtator 2009, "me të cilën kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme në lidhje me kërkesën KI 11/09, që ka të bëjë pagesën e 3,5 eurove në muaj në emër të kërkesës të shërbimit të parapagimit".[265] Kjo shumë prej 3,5 eurosh inkasohej nga ai dhe të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike në Kosovë prej vitit 2003 deri më 16 tetor 2009, që është data e vendosjes së masës së përkohshme nga ana e Gjykatës.

Gjykata në këtë rast vërejti faktin se Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), e cila bënte inkasimin e tre euro e gjysmë (3,5) në emër të RTK-së, kishte pasur humbje materiale dhe dëme si pasojë e këtij inkasimi. Këtë shumë prej 3,5 eurosh e paguanin konsumatorët e energjisë elektrike së bashku me faturat e rrymës.[266] Gjykata, megjithatë, e bëri të qartë se kërkesa për masë të përkohshme nga z. Tomë Krasniqi nuk ishte një *actio popularis*, siç mund të duket në shikim të parë, duke argumentuar se miratimi i kërkesës për masë të përkohshme praktikisht do të thoshte se do të ndalohej pagesa e mëtutjeshme e 3,5 eurove deri sa të merrej vendimi përfundimtar për meritat e rastit. Ky veprim i Gjykatës u mbështet në mbrojtjen e interesit publik të qytetarëve të Kosovës.[267] Me një vendim të tillë, Gjykata efektivisht pezulloi zbatimin e mëtutjeshëm të nenit 20.1 të Ligjit nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës të 20 janarit 2006, duke rekomanduar Kuvendit të Kosovës që "deri

---

"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

[264] Neni 113, paragrafi 10 i Kushtetutës (Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara):

"10. Juridiksioni shtesë mund të rregullohet me ligj".

[265] Cf. Paragrafi 5 i Vendimit: Masa e përkohshme/MP/Rasti KI 11/09, Tomë Krasniqi kundër RTK-së dhetë tjerëve.

[266] Cf. Paragrafi 11 i Vendimit.

[267] Paragrafët 13 dhe 17 të Vendimit.

në dhjetor 2009 të rishikojë natyrën e nenit 20.1 të Ligjit për RTK-në".[268] Kuvendi pas këtij rekomandimi i rishikoi këto dispozita gjatë vitit 2010 ashtu që deri në fund të atij viti çështja u bë pa objekt shqyrtimi kështu që Gjykata në baza meritore e hoqi rastin nga lista dhe e mbylli rastin.[269]

3. Rasti i Logos së Prizrenit

Ky rast[270], i njohur për opinioni edhe si "Rasti i Logos së Prizrenit", paraqet një kërkesë tjetër me të cilën Gjykata u mor në ditët e saj të para. Me siguri është një ndër aktgjykimet më elokuente dhe më të qarta që ka kontribuar jashtëzakonisht shumë në vënien e themeleve të sundimit të ligjit në Kosovë. Çështje në rrezik në këtë rast ishte pozita e komunitetit joshumicë në qytetin e vjetër të Prizrenit.[271] Më 22 prill 2009, Ćemailj Kurtiši, Zëvendëskryesuesi i Komunës së Prizrenit, parashtroi kërkesë në Gjykatë duke pretenduar se neni 7 i Statutit të Komunës së Prizrenit ishte në kundërshtim me nenet 3.1[272]; 6.1[273]; dhe 59.1[274] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në

[268] Cf. Pjesa operative pika II e Vendimit.

[269] Dy të ashtuquajtura mendime mospajtuese u paraqitën nga dy gjyqtarë, me gjasë diçka e paprecedent në historinë e gjyqësisë kushtetuese, pra "atakimi" i një vendimi për masë të përkohshme. Siç dihet mirëfilli, është vendimi përfundimtar për meritat (gjë që kurrë nuk ka ekzistuar në këtë rast) ndaj të cilit mund të paraqitet mospajtimi dhe mendimet konkurruese. Ajo çfarë bënë këta dy gjyqtarë duke paraqitur mendim mospajtues ndaj një urdhri për lejimin e masës së përkohshme në esencë përfaqëson mendimin e tyre për meritat e rastit. Në procedura normale të çdo gjykate, një veprim i tillë i këtyre dy gjyqtarëve do të paraqiste bazë absolute për përjashtimin e tyre nga këshillimet e mëtejmë për rastin. Pasi që për meritat e rastit kurrë nuk u mor vendim u bë një zgjidhje për ruajtjen e nderit të tyre kështu që Gjykatës nuk i është dashur të gjendet në pozitë të tillë që të detyronte të dy gjyqtarët të largoheshin gjatë fazës së këshillimeve. Cf. Rasti KI 11/09, Tomë Krasniqi kundër RTK-së dhe KEK-ut. Mendimi mospajtues në lidhje me masën e përkohshme. Gjyqtari Almiro Rodrigues; dhe rasti KI 11/09, Tomë Krasniqi kundër RTK-së dhe KEK-ut. Mendimi mospajtues në lidhje me masën e përkohshme. Gjyqtarja Gjyljeta Mushkolaj. fq. 16-36.

[270] Aktgjykimi në rastin nr. KO 01/09. Ćemailj Kurtiši kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit, i 18 marsit 2010.

[271] Prizreni është qytet në jug të Kosovës ku filluan aktivitetet politike dhe ushtarake të shqiptarëve kundër sundimit otoman që kulminuan në një lëvizje shumë të konsoliduar të rezistencës kombëtare. Këtë fakt e njeh edhe Gjykata në paragrafin 43 ku, *inter alia,* thuhet se "[k]jo Gjykatë është e vetëdijshme që shqiptaret identifikohen me '1878'-shin e shkruar në emblemën e Komunës së Prizrenit, ashtu siç thuhet me nenin 7 të Statutit të Komunës. Viti 1878 ka qenë viti i themelimit të Lidhjes së Prizrenit. Udhëheqësit shqiptarë u mblodhën në Prizren, më 10 qershor të atij viti, duke kërkuar të arrijnë shtetin e pavarur shqiptar."

[272] Neni 3.1 (Barazia para Ligjit): "Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me

bazë të nenit 55.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-040, i 20 shkurtit 2008, në rast se Komuna vendos të mos rishqyrtojë aktet dhe vendimet që shkelin të drejtat e komuniteteve të garantuara me Kushtetutë e që i janë referuar asaj nga ana e Zëvendëskryesuesit, ai ose ajo mund ta parashtrojë çështjen drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese.[275] Kjo e drejtë e Zëvendëskryesuesit është e sanksionuar në nenin 62 paragrafët 3 dhe 4 të Kushtetutës, ashtu që nenet 54.1, 54.2 dhe 55.4 të Ligjit të lartpërmendur për Vetëqeverisjen Lokale janë identike me të. Për më tepër, neni 113.10 i Kushtetutës thotë se "Jurisdiksioni shtesë mund të rregullohet me ligj."

Përveç argumenteve materiale duke theksuar se emblema e komunës duhet të simbolizojë dhe përçojë porosinë e bashkëjetesës së komuniteteve dhe pjesëtarëve të komuniteteve dhe ekzistimin e ambienteve multietnike, multikulturale, multireligjioze dhe shumëgjuhësore[276], z. Ćemailj Kurtiši po ashtu ngriti argumente tjera të natyrës procedurale duke këmbëngulur se emblema nuk ishte miratuar me shumicën e dy të tretave (2/3) të Kuvendit siç kërkohet me nenin 7.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.[277] Kuvendi Komunal i mohoi këto pretendime[278].

Pas një ekzaminimi dhe vlerësimi të gjatë, shumë të hollësishëm dhe të kujdesshëm të fakteve të rastit si dhe argumenteve të të dy palëve[279], Gjykata gjeti se Kuvendi Komunal kur mori vendim për të miratuar nenin 7 të Statutit, kishte imponuar një emblemë që nuk mund të konsiderohej simbol i për-

---

respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore".

[273] Neni 6.1 (Simbolet): "Flamuri, stema dhe himni janë simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës të cilat pasqyrojnë karakterin shumetnik të saj.".

[274] Neni 59.1 (Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre): "Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet: 1. të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre".

[275] (Zëvendëskryesuesi për komunitete) Neni 54.1 i Ligjit: "Në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve joshumicë, posti i zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve"; Neni 54.2 i Ligjit: "Postin e zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete e mban kandidati përfaqësues i popullatës jo-shumicë, që ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në kuvendin e komunës".

[276] Paragrafi 12 i aktgjykimit.

[277] Paragrafi 13 i aktgjykimit.

[278] Për argumentet e Kuvendit Komunal, cf. paragrafët 20-25 të akgjykimit.

[279] Cf. Paragrafët 26-54.

bashkët i të gjithë njerëzve që jetojnë në Prizren, dhe kishte mbipërfaqësuar identitetin e komunitetit etnik shqiptar në raport me identitetin e komuniteteve të tjera në Prizren[280]. Duke vepruar kështu Kuvendi Komunal kishte shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës, më konkretisht nenet 3, 7.1, 58 dhe 59.[281] Sipas Gjykatës, kjo do të thotë se Kuvendi Komunal nuk kishte konsideratë apo nuk kishte konsideratën e duhur për të drejtat dhe liritë themelore që ua jep Kushtetuta komuniteteve joshumicë për të ruajtur, mbajtur dhe promovuar identitetet e tyre. Për këtë arsye, Gjykata në pikën IV të pjesës operative urdhëroi "Komunën e Prizrenit që, brenda një periudhe prej tre muajsh nga dorëzimi i këtij Aktgjykimi, të ndryshojë Statutin dhe emblemën e saj në mënyrë që ta sjellë atë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe të mos përjashtojë komunitetet joshumicë". Kjo në fakt edhe ndodhi më vonë: Komuna e Prizrenit e ndryshoi nenin 7 të Statutit të saj ashtu që emblema e tanishme e qytetit është plotësisht në pajtim me Kushtetutën.[282]

Në pjesën e fusnotave të këtij aktgjykimi vlen të përmendet mendimi konkurrues i gjyqtarit Almiro Rodrigues, jo pse ai shton ndonjë vlerë të vërtetë pikëpamjeve të shumicës siç janë shprehur në aktgjykim, por për shkak të natyrës tejet kontradiktore. Duke qenë vetë gjyqtar raportues, Almiro Rodrigues paralajmëroi se do të jepte mendim konkurrues në ditën kur Gjykata po merrte vendim. Në fakt, posa e paraqiti atë, ai doli të ishte një diskutim i fokusuar kryesisht në pjesën operative të aktgjykimit dhe pikërisht në faktet dhe meritat e vetë rastit.[283]

4. Tregimi për dy presidentët

Mes shtatorit 2010 dhe marsit 2011, Gjykata Kushtetuese vendosi për fatin e dy presidentëve të Kosovës. Këto dy Aktgjykime, njëri më 28 shtator

[280] Cf. Paragrafi 55 i aktgjykimit

[281] Cf. Pjesa operative, pika III e aktgjykimit.

[282] Më 18 qershor 2010, Kryetari i Prizrenit, dr. Ramadan Muja, i dërgoi një letër Gjykatës në të cilën kërkoi zgjatjen e afatit prej 3 muajsh të caktuar në aktgjykimin KI No. 01/09 edhe për gjashtëdhjetë (60) ditë tjera. Me Urdhrin e saj të 21 qershorit 2010, Gjykata vendosi të lejonte këtë zgjatje të afatit. Komuna e Prizrenit përfundimisht veproi në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës më 24 mars 2011 kur miratoi Vendimin Nr. 01/011-3581 për Ndryshimin e Statutit të Komunës së Prizrenit.

[283] Cf. Mendimi konkurrues i gjyqtarit Almiro Rodrigues për aktgjykimin në rastin nr. 01/09, konkretisht në lidhje paragrafin 14.

2010[284] dhe tjetri më 30 mars 2011[285], dëshmuan të jenë vendimet që patën ndikimin më të madh në jetën institucionale të Kosovës. Që nga marsi 2011 ka pasur një debat të vazhdueshëm dhe veprime të ndërmarra në skenën politike me qëllim të ndryshimit të dispozitave të Kushtetutës, përkitazi me zgjedhjen dhe kompetencat e Presidentit të Kosovës.

Në rastin e parë, rasti KI 47/10, parashtruesit e kërkesës, 32 deputetë të Kuvendit të Kosovës, më 25 qershor 2010 i parashtruan kërkesën Gjykatës, me pretendimin se Presidenti Fatmir Sejdiu ishte duke kryer shkelje serioze të nenit 88.2 të Kushtetutës, me mbajtjen e postit së Presidentit Kosovës dhe, sipas tyre, të postit të Kryetarit të partisë Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), atëkohë njëra nga dy partnerët e koalicionit qeverisës. Çështja kryesore, thelbi i aktgjykimit që duhej të nxirrte Gjykata, ishte se a kishte dallim ligjor mes "ushtrimit" dhe "ngrirjes" së funksionit publik, meqë Presidenti Fatmir Sejdiu pohonte se ai nuk ishte duke ushtruar funksionin e tij si udhëheqës i partisë së tij, LDK, që nga 28 dhjetori 2006, data kur ai kishte njoftuar partinë për vendimin tij për të "ngrirë ushtrimin nga ai të funksionit të Kryesuesit të Lidhjes Demokratike të Kosovës".[286] Parashtruesit e kërkesës, megjithatë, pretendonin se neni 88 i Kushtetutës nuk flet për "ngrirje", që do të thotë, se fakti i mbajtjes së posteve nga Presidenti i atëhershëm i Kosovës Fatmir Sejdiu paraqiste shkelje serioze të Kushtetutës, siç parashihet me nenin 88.2 në lidhje me nenin 83 të Kushtetutës.[287]

Pas parashtrimit të kërkesës, nënshkruar nga 31 deputetë, tre prej tyre u tërhoqën[288]. Sipas mendimit të përfaqësuesve ligjor të Presidentit, kjo tërheqje bënte kërkesën të papranueshme *ipso facto* sepse, siç thanë ata, do të duhej të ishin së paku 30 deputetë të cilët, brenda tridhjetë (30) ditësh, do të mund të kontestonin kushtetutshmërinë e veprimeve të Presidentit të Republikës.[289]

---

[284] Rasti KI 47/10. Naim Rrustemi dhe 31 Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së Tij Fatmir Sejdiut, President i Republikës së Kosovës. Aktgjykimi i 28 shtatorit 2010.

[285] Rasti KO 29/11. Sabri Hamiti dhe Deputetët e tjerë: Vlerësimi Kushtetues i Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-04, Përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës të 22 shkurtit 2011. Aktgjykimi i 30 marsit 2011.

[286] Cf. Paragrafi 21 i Aktgjykimit.

[287] Cf. Paragrafët 11-16 e Aktgjykimit. neni 88. 2 i Kushtetutës thotë se "… Pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike", përderisa neni 83 sanksionin statusin e Presidentit ashtu që ai/ajo "është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës".

[288] Cf. Paragrafi 7 i Aktgjykimit.

[289] Cf. Paragrafët 17-29 e Aktgjykimit. "Tridhjetë (30) ose më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës janë të autorizuar të referojnë pyetjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka

Gjykata, më 22 shtator 2010, shqyrtoi me dyer të mbyllura kërkesën, dhe vendosi për pranueshmërinë dhe meritat e saj. Sa i përket pranueshmërisë, Gjykata deklaroi se çështja "i është referuar në mënyrë të ligjshme nga palë e autorizuar", pavarësisht tërheqjes së tre deputetëve nga rasti.[290] Kjo do të thotë se Gjykata mori qëndrim se momenti i referimit të çështjes asaj është momenti që përcakton faktin nëse një parashtrues është palë e autorizuar a jo. Për më tepër, Gjykata vërejti se edhe pas tërheqjes së palës ajo prapë mund të veprojë lidhur me kërkesën. Sa i përket afatit prej 30 ditësh nga shkelja siç parashihet me Kushtetutë, [291] Gjykata konsideroi se shkelja e pretenduar paraqet një situatë të vazhdueshme meqë (ish-)Presidenti i Kosovës Fatmir Sejdiu mbante këto dy zyra, atë të Presidentit të Partisë dhe Republikës së Kosovës, madje edhe në kohën kur ishte paraqitur kërkesa, dhe atë nga 28 dhjetori 2006 deri më 25 qershor 2010.

Për meritat e rastit, Gjykata gjeti se kishte shkelje të nenit 88.2 të Kushtetutës[292] me rastin e mbajtjes së dy funksioneve të cekura, duke arsyetuar se nuk është e mundur të "ngrihet" një funksion partiak siç pretendohej nga Presidenti i atëhershëm Fatmir Sejdiu. Për më tepër, Gjykata vendosi se meqë Presidenti dhe partia e tij, Lidhja Demokratike e Kosovës, "përfitojnë nga asociimi me njëri-tjetrin",[293] kjo praktikisht do të thotë se ai ushtroi funksionin e tij si udhëheqës partie përderisa njëkohësisht ishte President i Republikës së Kosovës. Ky fakt i vetëm përbën shkelje serioze të Kushtetutës së Kosovës, tha Gjykata, gjegjësisht neni 88.2, duke mbajtur Zyrën e Presidentit të Republikës dhe njëkohësisht duke mbajtur edhe Zyrën e Kryesuesit/Presidentit të Lidhjes Demokratike të Kosovës[294].

Dy mendime mospajtuese u paraqitën në këtë rast, respektivisht nga gjyqtarët Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues.[295] Pikat kyçe të mos-

---

kryer shkelje serioze të Kushtetutës" (neni 113.6 i Kushtetutës); "Kërkesa duhet parashtruar Kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve që nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike" (Neni 45 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 16 dhjetorit 2008).

[290] Cf. Paragrafët 30-47 të Aktgjykimit.

[291] Neni. 113.6 i Kushtetutës (Juridiksioni dhe palët e autorizuara): "Tridhjetë (30) ose më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës janë të autorizuar të referojnë pyetjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës".

[292] Neni 88.2 i Kushtetutës (Papajtueshmëria): "Pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike".

[293] Cf. paragrafi 68 i aktgjykimit.

[294] Cf. Pjesa operative pika II e aktgjykimit.

[295] Mendim i përbashkët mospajtues i gjyqtarit Almiro Rodrigues dhe gjyqtares Snezhana Botusharova: Rasti Nr. KI 47/10 Naim Rrustemi dhe 31 Deputetë të tjerë të Kuvendit të Re-

pajtimeve trajtuan me sa vijon: çështjen e palës së autorizuar, afatet kohore për parashtrimin e kërkesës në raste të tilla, mbështetja e kërkesës dhe, përfundimisht çështja e përdorimit të *travaux préparatoires* (punëve përgatitore) kur vendoset për këtë çështje.

Sa i përket "palës së autorizuar", mospajtuesit argumentuan se meqë tre (3) nga tridhjetenjë (31) deputetët tërhoqën pajtimin e tyre me kërkesën e 25 qershorit 2010, rasti u bë i papranueshëm meqë "është e nevojshme që të njëjtit parashtrues të kërkesës të mbeten deri në fund të procedurës".[296] Për më tepër, mospajtuesit argumentuan se jo vetëm personat, por edhe "*petitumi dhe arsyet për petitum*" duhet të ngelin, siç e thonë ata, "stabil" që nga njoftimi i palëve kundërshtare për rastin derisa të merret vendimi përfundimtar për rastin.[297] Me këtë qëndrim, dy gjyqtarët mospajtues krejtësisht injoruan, apo harruan, dispozitën e rregullit 32 të Rregullores së Punës së Gjykatës duke i dhënë diskrecion Gjykatës të vendos për kërkesën.[298] Në fakt, mospajtuesit nuk u lodhën asnjëherë të përfshiheshin në diskutime të këtilla që trajtojnë raste të veçanta që mund të ngriten gjatë punës së Gjykatës.

Sa i përket afatit kohor prej tridhjetë (30) ditësh për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë në rastet e shkeljeve serioze të Kushtetutës nga Presidenti i Republikës, mospajtuesit me të drejtë vërejtën se "qëllimi i këtij rregulli është që njëkohësisht të ndalojë autoritetet, dhe persona të tjerë të interesuar, që të mos mbahen në gjendje pasigurie për një kohë të gjatë". Ata janë plotësisht gabim, megjithatë, kur ata kontestuan mendimin e shumicës e cila pranoi se Presidenti i atëhershëm i Kosovës Fatmir Sejdiu ishte duke shkelur Kushtetutën që nga momenti kur u bë udhëheqës i shtetit pa braktisur postin e tij si udhëheqës i Lidhjes Demokratike të Kosovës, por, në vend të kësaj, zgjodhi të "ngrijë" atë. Mospajtuesit argumentuan se afati prej tridhjetë (30)

---

publikës së Kosovës kundër Shkelqësisë së Tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës, më 12 tetor 2010.

[296] Cf. Paragrafi 10 i Mendimit të Përbashkët Mospajtues

[297] Cf. Paragrafi 10 i Mendimit të Përbashkët Mospajtues

[298] Rregulli 32 i Rregullore e Punës së Gjykatës (Tërheqja e kërkesës):

"(1) Pala e cila ka parashtruar kërkesën mund ta tërheq atë në çfarëdo kohe para fillimit të seancës dëgjimore për atë kërkesë.

(2) Pavarësisht tërheqjes në pajtim me paragrafin (1), Gjykata mund të zgjedh të vendos në lidhje me atë kërkesë. Në rast të tillë, Gjykata vendos pa seancë dëgjimore, duke u bazuar vetëm në kërkesë dhe përgjigje, në rast se përgjigja është parashtruar, dhe çfarëdo dokumentesh të bashkëngjitura asaj

(3) Sekretariati njofton të gjitha palët me shkrim për tërheqjen e palës dhe përcaktimin e Gjykatës për të vendosur në bazë të kërkesës pavarësisht tërheqjes së saj".

ditësh ka kaluar kohë më parë dhe se tridhjetedy (32) deputetët nuk kishin të drejtë të parashtronin kërkesës ngase nuk kishte "shkelje të vazhdueshme" të Kushtetutës siç deklaroi shumica, sepse "Ky koncept ka të bëjë me situata që janë të vazhdueshme për shkak të mungesës së një mjeti efektiv të brendshëm, i cili mund t'i japë fund atyre ose sepse mjetet ekzistuese nuk janë më efektive".[299] Gjyqtarët mospajtues nuk thonë asgjë lidhur me atë se cilat mjete vendore ishin të disponueshme dhe për kë, si dhe nëse mjetet, nëse ka, kanë qenë të efektshme. Mjete të tilla nuk ekzistojnë në rendin kushtetues të Kosovës sa i përket Presidentit të Republikës. Në fakt, asnjë procedurë e mirëfilltë për denoncim (të Presidentit) nuk ekziston në Kosovë, e cila do të mund të ngrihej pavarësisht kundër Presidentit, kjo është, pa vendim paraprak të nxjerrë nga Gjykata Kushtetuese. Përveç kësaj, mospajtuesit gabojnë lidhur me këtë edhe për një arsye tjetër: shkeljet serioze të Kushtetutës nga ana e Presidentit mund të paraqesin vetëm një akt, por vetë shkelja asnjëherë nuk mund të rregullohet vetvetiu (ndreqet vetë) brenda një periudhe kohore prej tridhjetë (30) ditësh. E njëjta vlen edhe për periudhën kohore prej gjashtë (6) muajsh për të cilën mund të kontestohet një ligj (ose dispozitë e tij) nga një palë e autorizuar para Gjykatës Kushtetuese[300]. Të dy këto dispozita të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese duhet injoruar në praktikë dhe duhet konsideruar si të tepërta apo sajuara sepse nëse siç sugjerojnë dy mospajtuesit ajo do të thoshte se pas tridhjetë (30) ditësh (në rast të shkeljeve serioze të Kushtetutës nga Presidenti) ose gjashtëdhjetë (60) ditësh (në rast të kontestimit të dispozitave ligjore) veprimet e kreut të shtetit dhe dispozitat ligjore jokushtetuese do të konsiderohen si të përmirësuara me kalimin e kohës. Konsideroj se kjo është në kundërshtim me maksimën e vjetër juridike Romake: *quod ab initio vitiosum lapsu temporis convalescere nequit* (çka është joligjore nuk mund të rregullohet vetvetiu me kalimin e kohës).

Çështja e ngritur në mospajtim ka të bëjë me mbështetjen me prova të kërkesës. Janë dy gjëra që ndahen aty. E para, mospajtuesit argumentojnë se kërkesa ishte qartazi e pabazuar, për shkak të mungesës së dëshmive bindëse në mbështetje të shkeljes së pretenduar. Kjo do të thotë se, sipas mospajtues-

---

[299] Cf. Paragrafi 21 i Mendimit të përbashkët Mospajtues.

[300] Neni 30 (Afatet) i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese:

"Kërkesa e paraqitur në pajtim me nenin 29 të këtij Ligji duhet parashtruar brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e aktit të kontestuar".

Neni 45 (Afatet) i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese:

"Kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve që nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike".

ve, parashtruesit e kërkesës do të duhej të dëshmonin se shkeljet serioze të Kushtetutës ishin kryer nga Presidenti në mënyra të ndryshme. Megjithatë, vetë mospajtuesit nuk thonë asgjë për llojin e provave që do të duheshin paraqitur nga parashtruesit e kërkesës. E gjitha që thonë ata në paragrafët 31 dhe 32 mospajtimit të tyre është një elaborim *in abstracto* i praktikës gjyqësore të Strasburgut, pa ndonjë kontekst konkret në lidhje me rastin në diskutim. E njëjta vlen edhe për të dytën, çështjen e ngritur për meritat e rastit, kjo është, shkelja e parimeve gjyqësore dhe barazia e armëve të Presidentit të Republikës, sepse, siç thonë ata, nuk kishte fare procedura verbale dhe se argumentet e palës kundërshtare, Presidentit të Republikës, do të duhej t'u ishin komunikuar edhe parashtruesve të kërkesës për komente, ose, edhe mund të ishin diskutuar në seancë publike. Në mbështetje të mendimeve të veta, mospajtuesit cituan nenin 55 të Ligjit Gjerman për Gjykatën Kushtetuese Federale, duke trajtuar procedurën e denoncimit të Presidentit[301] Federal. Kjo është siç u vërejt, një pikëpamje plotësisht e gabuar, ngase në rendin kushtetues të Kosovës nuk ekziston procedura e denoncimit të Presidentit si e vetme dhe e ndarë nga vendimi paraprak i Gjykatës Kushtetuese që do të konfirmonte shkeljet serioze të Kushtetutës nga Presidenti i Republikës. Për më tepër, si rregull, procedura në Gjykatën Kushtetuese janë me shkrim, përderisa dëgjimet verbale janë në përjashtim në rastet kur Gjykata vlerëson se kjo do t'i kontribuonte aspektit ligjor dhe faktik të trajtimit të një kërkese në Gjykatë. Kjo është një rregull i përgjithshëm në të gjithë Gjykata Kushtetuese të Evropës, dhe gjetkë.[302]

Për më tepër, sa i përket gabimit lidhur me argumentimin e denoncimit, argumenti i mospajtuesve se komunikimet dhe njoftimet e Presidentit si palë kundërshtare do të duhej dërguar parashtruesve të kërkesës po ashtu është e një natyre të dyshimtë. Kjo për shkakun se po të veprohej ashtu kjo do ta bënte edhe më të vështirë pozitën e Presidentit dhe, me siguri se, me të vërtetë do të shkelte parimin e drejtësisë dhe barazisë së armëve, krejtësisht ndryshe nga ajo që argumentojnë mospajtuesit në mënyrë jo dhe aq bindëse. Barra e dëshmimit të mëtutjeshëm do të kishte rënë mbi palën kundërshtare,

---

[301] Cf. Paragrafët 31-34 të Mendimit Mospajtues.

[302] Wojciech Sadurski, "Constitutional Justice, East and West: An Introduction", në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective*, fq. 1-18; John Ferejohn and Pasquale Pasquino, "Constitutional Courts as Deliberative Institutions: Towards an Institutional Theory of Constitutional Justice", në Sadurski (ed.), po aty, fq. 21-36.

shkelës i pretenduar i Kushtetutës. Që të dyja si dëgjimi verbal si dhe komunikimi i vazhdueshëm i përgjigjeve të Presidentit do të dukeshin, sipas të gjitha gjasave, si një maskaradë dhe tregim i forcës nga ana e Gjykatës.

Njëjta si më lart, vlen edhe për argumentet e mospajtuesve lidhur me mospërdorimin e *travaux préparatoires* nga ana e Gjykatës, përderisa vendosej për meritat e rastit. Mospajtuesit kanë të drejtë kur thonë se ato "mund të përdoren për të ndihmuar në zgjedhjen e paqartësive në tekst, për të konfirmuar domethënien atribuuar nga përdorimi i rregullave të tjera ose për t'i ikur një absurditeti".[303] Duhet cekur se, megjithatë, Gjykata gjatë punës procedurale për këtë kërkesë ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës si edhe ka hulumtuar vetë për *travaux préparatoires* të rastit, por nuk gjeti. Çfarë do të ishte rezultati, dikush mund të shtrojë pyetjen, sikur të ishin të disponueshme për Gjykatën *travaux préparatoires* nga neni 88 i Kushtetutës? Përsëri duhet theksuar se, megjithatë, si në çështjet e lartpërmendura të këtij rasti, do të kishte pasur ndikim negativ në pozitën e Presidentit para Gjykatës.

Dy kundërshti janë të duhurat këtu. E para, pala kundërshtare, Presidenti, nuk ka kërkuar kurrë nga Gjykata që t'i përdorte *travaux préparatoires* nga neni 88 i Kushtetutës.[304] Kjo do të thotë se çfarëdo hapi zyrtar nga Gjykata për qëllim të vlerësimit të validitetit të *travaux préparatoires* nga neni 88 i Kushtetutës do të ishte një veprim *ultra vires* i Gjykatës. E dyta, disa ditë pas vendimit të Gjykatës, pala kundërshtare, Presidenti i Republikës Fatmir Sejdiu, dha dorëheqje nga zyra e kreut të shtetit. Vetëm pas dorëheqjes, ai filloi të argumentonte se ishte një marrëveshje "e pashkruar" mes tij dhe disa faktorëve ndërkombëtarë që i lejonte atij imponimin e futjes së dispozitës së tanishme të nenit 84 të Kushtetutës në mënyrë që t'i mundësonte atij ushtrimin e dy pozitave dhe, njëkohësisht, t'i jepte të drejtën për të "ngrirë" pozitën e tij si udhëheqës i partisë, kështu që, të vazhdonte me ushtrimin e funksionit si President i Republikës ës Kosovës[305]. Për më tepër, duke supozuar se edhe

[303] Cf. Paragrafi 42 i Mendimit të Përbashkët Mospajtues.

[304] Cf. Paragrafët 17-29 (Përgjigja e Presidentit) të Mendimit të Përbashkët Mospajtues.

[305] Presidenti i Kosovës Fatmir Sejdiu dha dorëheqje më 27 shtator 2010. Që atëherë ai ka argumentuar publikisht për ekzistimin e një marrëveshje politike në mes tij dhe faktorëve tjerë (vendas dhe ndërkombëtarë) në mbështetje të "ngrirjes" së pozitës së tij si kryetar i partisë. Ai ka argumentuar se, përveç kësaj, kjo marrëveshje e pretenduar ka shërbyer si kopje rezervë për *travaux préparatoires*, kjo do të thotë se ajo ka shërbyer si shtyllë për draftimin dhe formën aktuale të nenit 84 të Kushtetutës. Cf. Enver Robelli, "Doli prej zarfit, tash nuk del prej zyres!", në të përditshmen *Koha Ditore* nga Prishtina (e martë, 10 korrik 2012) fq. 10. Në këtë artikull, autori përmend bindjen e fortë të ish-Presidentit për ekzistimin e marrëveshjes së lartcekur "gojore" në mes tij dhe faktorëve tjerë ndërkombëtarë.

po të kishte një marrëveshje të tillë mes Presidentit të atëhershëm të Kosovës Fatmir Sejdiu dhe disa faktorëve ndërkombëtarë, kjo nuk do të ndryshonte asgjë sepse Gjykata nuk mund të marrë parasysh ndonjë argument ekstra kushtetues: Kushtetuta, dhe asgjë tjetër, shërben si pikë referimi për Gjykatën kur vendoset për rastet para saj, në mënyrën e paraparë ligjore.

Në rastin e dytë, Rasti Nr. 29/11, i 30 marsit 2011, në kuptimin strikt të fjalës, Gjykata nuk ka vlerësuar veprimet (ose sjelljen) e Presidentit të Kosovës Behgjet Pacolli. Më shumë kishte të bënte me veprimet ose sjelljen e Kuvendit të Kosovës dhe anëtarëve të tij gjatë procedurës së zgjedhjes së Presidentit të Republikës, më 22 shkurt 2011.[306] Një ditë më parë, Kryetari i Kuvendit të Kosovës ftoi deputetët për një seancë të jashtëzakonshme për ditën e nesërme. Agjenda për këtë seancë të jashtëzakonshme kishte të bënte me zgjedhjen e Presidentit të ri, pas dorëheqjes së Presidentit paraprak, z. Fatmir Sejdiu. I vetmi kandidat i propozuar për këtë zyrë ishte z. Behgjet Pacolli. Gjatë votimit i cili ndodhi më 22 shkurt 2011, tri partitë opozitare, LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës), AAK (Aleanca për ardhmërinë e Kosovës) dhe VV ("Vetëvendosje") nuk morën pjesë, kështu që, numri i atyre që morën pjesë në proces ishte gjashtëdhjeteshtatë (67) nga njëqind e njëzet (120) deputetët dhe me një kandidat të vetëm, Kuvendi i Kosovës pas rundit të tretë zgjodhi z. Behgjet Pacolli si President të Republikës. Brenda tetë ditësh, pra më 1 mars 2011, Sabri Hamiti dhe 33 deputetë të tjerë parashtruan kërkesë në Gjykatë duke kontestuar kushtetutshmërinë e procedurës për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës siç u bë në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit mbajtur më 22 shkurt 2011, duke pretenduar shkeljen e nenit 86 ("Zgjedhja e Presidentit") të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës në

[306] Sipas nenit 86 të Kushtetutës së Kosovës, Presidenti i Republikës zgjedhet nga Kuvendi. Kjo procedurë do të ndërrojë në një të ardhme të afërt me zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit të Kosovës. Ky ndryshim që mund të ndodhë në të ardhmen është rezultat i vendimit të Gjykatës mu në këtë rast duke shpallur jokushtetues vendimin e Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit Behgjet Pacolli për President të Kosovës. Duhet vërejtur se zgjedhja indirekte e presidentëve në vendet ish-komuniste është një përjashtim. Ndryshimi (ose miratimi) i mënyrës së zgjedhjes së kreut të shtetit në këto vende ka qenë pjesë e përpjekjeve për të kontrolluar (ose si rezultat i rritjes së) tendencën e diktaturës përbrenda tyre dhe njëkohësisht të mundësojë këtë institucion të luajë rolin e garantuesit të stabilitetit institucional dhe ndarjes së pushteteve, që do të thotë se t'i mundësojë kreut të ushtrojë "pushtetin neutral" të tij në mënyrë që të promovojë dhe zhvillojë identitetin e ri të kushtetutshmërisë në vendet ish-komuniste të Europës Juglindore. Cf. më shumë për këtë shih përmbledhjet e eseve: Anton Bebler and Jim Seroka (eds.), *Contemporary Political Systems: Classifications and Typologies* (Lynne Reinner: Boulder, 1990); Arend Lijphart (ed.), *Parliamentary versus Presidential Government* (Oxford UP: Oxford, 1992).

veçanti pohuan se neni 86, paragrafët 4, 5 dhe 6 të Kushtetutës ishin shkelur, në pikëpamjen e mungesës së kuorumit të nevojshëm gjatë votimit, mungesën e kandidatit kundërshtar dhe ndërprerjen e votimit gjatë procedurës zgjedhore.[307] Gjykata, pasi që shpalli kërkesën të pranueshme në baza[308] formale, u lëshua në analizimin e meritave në veçanti. Me metodën e krahasimit, Gjykata me të drejtë gjeti se kishte shkelje të nenit 86, jo për shkak të kuorumit, i cili ishte një çështje tjetër, por për shkak të faktit se në dy rundet e para është e nevojshme që dy të tretat e deputetëve të marrin pjesë dhe se duhej të kishte më shumë se një kandidat. Duke shkuar me vetëm një kandidat në të tri fazat e procesit dhe me vetëm gjashtëdhjeteshtatë (67) deputetë të pranishëm dhe duke votuar, Kuvendi shkeli jo vetëm nenin 86 të Kushtetutës por edhe frymën dhe natyrën e dispozitave që rregullojnë pozitën dhe rolin e Presidentit si përfaqësues i unitetit (kushtetues) të njerëzve (popullit). Gjykata në njëfarë mënyre pranoi se shumica e dy të tretave (2/3) ka për qëllim kompensimin e legjitimitetit që zgjedhja e drejtpërdrejtë krijon për Presidentin e zgjedhur. Kjo do të thotë se në një shumicë aq të kualifikuar dhe me të paktën dy kandidatë, fituesi potencialisht do të reflektonte vullnetin e shumicës së qytetarëve të Kosovës. Ky, megjithatë, nuk ishte mendimi i dy gjyqtarëve mospajtues në këtë rast, duke gjetur vendimin e shumicës si të gabuar[309]. Argumentet e tyre, megjithatë, duket të thonë të kundërtën. Mendimi i mospajtuesve është plotësisht joprofesional dhe i bazuar në argumente ekstrajuridike dhe ekstrakushtetuese. Brenga e tyre kryesore që ata e kthejnë në argument ka të bëjë me pasojat e vendimit të Gjykatës. Ata besonin se vendimi i shumicës "imponon shpërbërjen e Kuvendit dhe zgjedhjet e reja të përgjithshme". Kjo do të thotë se dy gjyqtarët mospajtues besonin se vendimi i Gjykatës, duke deklaruar se Kuvendi ka shkelur Kushtetutën më 22 shkurt 2011 me zgjedhjen e z. Behgjet Pacolli si President të Republikës, është njëjtë sikur të thuhet se Kuvendi ka dështuar të zgjedhë një President, pas raundit të tretë të votimit, dhe automatikisht, duhet të ketë zgjedhje të përgjithshme pas 45 ditësh[310]. Ky është një gabim themelor dhe mungesë e të kuptuarit të

[307] Cf. Paragrafët 23-38 të Aktgjykimit.
[308] Cf. Paragrafët 57-61.
[309] Rasti Nr. KO 29/11. Sabri Hamiti dhe Deputetët e tjerë të Kuvendit të Kosovës. Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-04 Përkitazi me Zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, të 22 shkurt 2011. Mendimi mospajtues i gjyqtarëve Robert Carolan dhe Almiro Rodrigues, të 30 marsit 2011.
[310] Neni 82 i Kushtetutës (Shpërndarja e Kuvendit):
"1. Kuvendi shpërndahet në këto raste:

rolit dhe pozitës së Gjykatës si interpretues përfundimtar i Kushtetutës. Vendimi i shumicës nuk ka thënë, dhe nuk ka mundur të thotë, se Kuvendi ka dështuar të zgjedhë Kryetarin e Republikës. Se çfarë tha, megjithatë, është se Kuvendi i Kosovës zgjodhi Presidentin e ri më 22 shkurt 2011 në mënyrë jokushtetuese, do të thotë se për ato tridhjetetetë apo më shumë ditë, Kosova ka pasur një President veprimet e të cilit ishin jo të vlefshme: asnjë vakum institucional nuk ekzistonte mes 22 shkurtit–30 marsit 2011 (e fundit është data kur Gjykata nxori vendimin e vet). Kjo më tej nënkupton se Kryetari i Kuvendit u bë ushtrues detyre i kreut të shtetit që nga momenti kur Gjykata nxori vendimin e saj më 30 mars 2011, që do të thotë se situata ishte e njëjtë me atë të krijuar me dorëheqjen e Kryetarit të Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiut. Në kuptim më konkret të kushtetues kjo do të thotë se vendimi i shumicë nuk ka pasur efekt retroaktiv.

Kjo pikëpamje e shumicës duket të ketë qenë e vështirë për t'u kuptuar jo vetëm nga gjyqtarët mospajtues por edhe nga qeveria e Kosovës, nga vetë z. Behgjet Pacolli dhe nga Kuvendi. Që të gjithë ata kërkuan sqarime shtesë të vendimit të sipërpërmendur të Gjykatës, duke çuar në një shqiptim të dytë nga Gjykata, përmes një Sqarimi të Aktgjykimit. Gjykata nxori Sqarimin e Aktgjykimit më 1 prill 2011, duke adresuar shqetësimet dhe paqartësitë e shprehura nga qeveria, nga vetë Presidenti Behgjet Pacolli dhe Kryetari i Kuvendit. Sqarimi shkoi përgjatë gjithë vijave siç u përmend më lart dhe mbylli përgjithmonë tregimin e dy presidentëve duke hapur rrugën për zgjedhjen e presidentit të ri (të tanishëm) të Kosovës, znj. Atifete Jahjaga më 7 prill 2011. Megjithatë, pozita e saj, u kontestua përsëri në Gjykatën Kushtetuese por me bazë tjetër, që është, në bazë të kontrollit parandalues të amendamenteve kushtetuese të Kushtetutës së Kosovës[311]. Në përgjigje të kësaj sfide, Gjykata gjeti antikushtetuese çdo lëvizje, përmes amendamentit ose në ndonjë

(1) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria;

(2) nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës;

(3) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës

2. Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë."

[311] Neni 113 i Kushtetutës (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara):

"9. Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës".

mënyrë tjetër, që synon në ndërprerjen e parakohshme të mandateve kushtetuese, duke përfshirë edhe atë të Presidentes së tanishme, znj. Atifete Jahjaga. Përfundimi i mandatit kushtetuese mund dhe duhet të ndodhë vetëm nëpërmjet mënyrave të paracaktuara kushtetuese[312]. Ky qëllim i politikës kosovare për të përdorur Gjykatën Kushtetuese për qëllimet e tyre ditore politike u mposht dhe u sigurua vazhdimi i mandatit të Presidentit të tanishëm të Republikës. Ishte triumf i konstitucionalizmit kundrejt rrymave politike që u përpoqën të mposhtnin një organ kyç kushtetues, kreun e shtetit, përmes përdorimit të një teknike juridike për ndryshim kushtetues, p.sh., amendamentimi kushtetues.

5. Rasti AKP

Rasti i njohur si "AKP" (Agjencia Kosovare e Privatizimit) ka të bëjë me shqyrtimin kushtetues të Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC -09-089, të 4 shkurtit 2010[313].

Parashtruesi pretendonte, në veçanti se vendimi i lartpërmendur i Dhomës së Posaçme, që ishte objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë në Gjykatë, ka shkelur nenin 3.2 (Barazia para Ligjit); 31.2 dhe 3 (e Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm); 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave); 102.1 dhe 4 (Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor); 112.2 (Parimet e Përgjithshme); 116.3 (Efekti Juridik i Vendimeve); 143 (Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës); 145.2 (Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Legjislacionit të Aplikueshëm) të Kushtetutës si dhe neni 13 (E drejta për mjete efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNj).

Esenca e çështjes së kësaj kërkesës përmblidhet në të dy qëndrimet e nxjerra nga Dhoma e Posaçme, përkatësisht, se AKP ishte një agjenci de fakto që vepronte sipas një ligji de fakto duke pasur cilësinë e një rregulloreje të brendshme, e jo të një ligji të vërtetë për AKP[314]. Ky qëndrim i përgjithshëm i Dhomës së Posaçme, që vazhdoi që nga themelimi i saj pas luftës së Kosovës

---

[312] Cf. Aktgjykimi në Kërkesat K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12. Amendamentet e propozuara kushtetuese të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012. Më 20 korrik 2012. Cf. Paragrafët 244-286 të Aktgjykimit.

[313] Aktgjykimi në rastin Nr. KI 25/10. Parashtruesi i kërkesës: Agjencia Kosovar e Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC 09-89, të 4 shkurtit 2010.

[314] Ligji Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 21 majit 2008.

(10 qershor 1999), preku esencën e *pouvoir constitutif* të Kosovës ashtu siç u shpreh më 17 shkurt 2008 (deklarata e pavarësisë e Kosovës — përfaqësuesit e zgjedhur) gjithashtu edhe ushtrimi i autoritetit publik nga autoriteteve themeluara në mënyrë të rregullt/duhur të Kosovës pas asaj date (*pouvoir constitué*). Ky qëndrim i përgjithshëm ka nevojë për një qartësim të mëtejmë për lexuesit si në vijim: çka është Dhoma e Posaçme? Cili është autoriteti i saj? Çka është "AKP" dhe Ligji sipas të cilit vepron brenda rregullit kushtetues të Kosovës?

Procesi i privatizimit në Kosovë që filloi menjëherë pas instalimit të administratës ndërkombëtare të qershorit të 1999-ës, nën mbikëqyrjen e Kombeve të Bashkuara, të njohur si UNMIK (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë), ka pasur specifikat e veta. Në fakt, çdo proces i privatizimit pas kolapsit të komunizmit më 1989 ka qenë specifik dhe ishte në varësi të karakteristikave të secilit shtet[315]. Në këtë drejtim, Kosova nuk bën përjashtim. Specifikat e Kosovës përbëhen, ndër të tjera, nga ajo që i tërë procesi i privatizimit ka qenë i udhëhequr nga UNMIK-u përderisa organet dhe autoritetet vendore shërbenin si autoritete jovendimmarrëse. Në thelb prezenca e tyre aty ishte vetëm sa për sy e faqe[316]. Baza juridike për këtë lloj privatizimi që zuri vend pas qershorit 1999 në Kosovë ishte Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit e 13 qershorit 2002. Sipas kësaj Rregulloreje, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) shërbente si institucion përgjegjës për të udhëhequr tërë procesin e privatizimit në Kosovë pas 10 qershorit 1999, përderisa Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës ishte organi për të gjykuar dhe vendosur për çështjet në lidhje me privatizimin.[317]

Pas deklaratës së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës fuqizoi një Ligj për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Ligji nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 21 majit 2008 duke u bazuar në *pouvoir constitué* e saj si një shtet sovran dhe i pavarur. Si-

---

[315] Cf. më shumë në lidhje me këtë në një studim elokuent nga Csongor Kuti, *Post-Communist Restitution and the Rule of Law* (Central European UP: Budapest, 2009).

[316] Cf. më shumë në lidhje me këtë në një artikull në shqip, me një rezyme në anglisht, të shkruar nga Haxhi Gashi, "Konflikti lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore: Ndryshimi i ligjit për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, i Ligjit për AKP-në dhe ligjet relevante" ("The Conflict of Laws Concerning the Socially Owned Enterprises"), *E drejta/Law* no. 2 (2011) fq. 47-63.

[317] Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, me ndryshime. Datë: 13 qershor 2002.

pas këtij ligji, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, siç u ndryshua, do të pushojë së prodhuari efekt juridik në datën që ka hyrë në fuqi. Kuvendi i Kosovës më parë ka fuqizuar Ligjin nr. 03/L-053 për Juridiksionin, Përzgjedhjen e rastit dhe Caktimin e rastit, të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë më 13 mars 2008, që ishte dizajnuar që të rregullojë integrimin dhe juridiksionin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, duke përfshirë edhe ata që punojnë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Ky ligj, megjithatë, duket të ketë qenë burim i keqkuptimeve për shkak të interpretimeve të dhëna për të nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës. Dhoma e Posaçme, në vend se të shfrytëzonte këtë ligj si bazë për të lidhur diferencat mes gjyqtarëve dhe prokurorëve kosovarë dhe kolegëve të tyre të EULEX-it, i mohoi statusin juridik AKP-së për çështjet e privatizimit dhe vazhdoi ta trajtojë AKP-në si të vetmin përfaqësues të Dhomës derisa trajtonte Ligjin nr. 03/L-067 si një rregullore të brendshme që duhej të respektohej dhe zbatohej nga një agjenci *de facto* të njohur si AKP.

Ky qëndrim i Dhomës së Posaçme, i shprehur në Vendimin e saj të kontestuar ASC-09-089 të 4 shkurtit 2010, ishte objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese. Në Aktgjykimin e saj nr. KI25/10 të 31 marsit 2011, Gjykata Konstatoi se Vendimi ASC-09-089, siç u përmend më lart ishte në kundërshtim me shumë norma dhe vlera të Kushtetutës së Kosovës. Megjithatë, në diskutimin tonë, pjesa kryesore e Aktgjykimit nuk është analiza e Gjykatës për shkeljen e dispozitave të veçanta, të Kushtetutës dhe për vlerat e saj thelbësore[318], por ishte pjesa e përfshirë në analizën e Gjykatës në lidhje me *pouvoir constituif*. Kjo analizë është e përfshirë në paragrafin 54 të Aktgjykimit të Gjykatës. Gjykata ia bëri të qartë Dhomës së Posaçme, në mënyrë shumë profesionale, se kompetencat përbërëse të Republikës së Kosovës siç janë shprehur në vendimin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, nuk bazohen në normat e një rendi të mëparshëm juridik, siç do ta formulonte Carl Schmitt (Karl Shmit)[319]. Këto kompetenca konstitutive tejkalojnë dhe u japin fund kompetencave të të gjitha normave dhe autoriteteve të tjera. Ato janë ushtruar fillimisht nga kosovarët më 17 shkurt 2008, dhe si të tilla nuk vijnë nga një rend i mëparshëm juridik të krijuar nga UNMIK-u (i bazuar në Këshillin e Sigurimit të OKB-së nr. 1244 të 10 qershorit 1999). Për këtë arsye, ushtrimi i tyre më 17 shkurt 2008, nuk ka shkelur

[318] Cf. Cf. Paragrafët 45-53 dhe 55-62 të aktgjykimit.

[319] Cf. më shumë në lidhje me këtë në Carl Schmitt, *Political Theology: Four Chapters on the Concept of Sovereignty* (Univ. Chicago Press: Chicago, 2005) fq. 16-35; Slobodan Samardžić (ed.), *Norma i odluka: Karl Šmit i njegovi kritičari* (Filip Visnjić: Beograd, 2001) fq. 85-124.

ndonjë normë të veçantë apo të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese është tërësisht në harmoni me arsyetimin dhe frymën e Opinionit Këshillëdhënës për Kosovën të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të 22 korrikut 2010[320]. Me këtë Aktgjykim, Gjykata Kushtetuese në mënyrë të qartë i ka treguar Dhomës së Posaçme se është pjesë dhe pako e pandashme e rendit kushtetues dhe juridik të Kosovës, me qëndrim të veçantë, që do të thotë se nuk kishte të drejtë të marrë e të zgjedhë sipas dëshirës ligjet që kishte për t'i zbatuar ose kualifikuar si *de facto* entitete të organizmave të caktuara juridike të Kosovës. Dhoma e Posaçme duhet të shërbejë si një pjesë integrale e Gjykatës Supreme të Kosovës funksioni kryesor i së cilës është të sigurojë zbatim të njëtrajtshëm të ligjit në tërë territorin e Kosovës. Në esencë/thelb ky është pikërisht roli dhe detyra e çdo gjykate supreme ose e një ekuivalenti të ngjashëm që ka gradën më të lartë të gjyqësisë në një vend të caktuar në çdo sistem juridik në Tokë.

Përfundim

Në këtë shkrim, u morëm me vendimin kyç të Gjykatës, i cili, sipas pikepamjes sonë, hapi rrugën për një të ardhme stabile të praktikës ligjore të Gjykatës dhe vendosi bazat për t'u bërë gardian i vërtetë i Kushtetutës. Megjithatë, kjo nuk nënkupton se vendimet e tjera të Gjykatës nuk kanë pasur një efekt kaq të rëndësishëm (ose të ngjashëm me të). Është vetëm koha dhe hapësira që na detyruan të përzgjedhim këto raste dhe t'i diskutojmë në thelb/thellësi, duke shpresuar se do të shërbejnë si një pikënisje për hulumtime dhe komente në të ardhmen në komunitetin e dijetarëve të interesuar për Kosovën dhe për Gjykatën e saj Kushtetuese.

Rasti i RTK-së, rasti i parë që ka trajtuar Gjykata pasi që është fuqizuar, në shtator të vitit 2009, kishte të bënte me një masë të përkohshme dhe dy mendime mospajtuese të ngritura kundër këtij vendimi të Gjykatës për të shqiptuar masën e përkohshme. Veçantia e saj qëndron jo vetëm në faktin e çuditshëm të mospajtimit të parashtruar për vendimin jomeritor, po gjithashtu edhe përse i dërgoi një mesazh të qartë Kuvendit të Kosovës për defektet e Ligjit të saj për RTK-në si dhe për mënyrën se si zbatohej në atë kohë. Mospajtimi i ngritur për një vendim për masë të përkohshme që zbul-

[320] "Pajtueshmëria me të Drejtën Ndërkombëtare e Shpalljes së Njëanshme të Pavarësisë në lidhje me Kosovën". Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Mendim Këshillëdhënës. Datë: 22 korrik 2010. Cf. konkretisht paragrafët 52-56, 74-84, 96-109, 114-121.

onte një qëndrim për meritat e rastit, siç u diskutua këtu, është gjithashtu i rëndësishëm sepse zbulon vështirësitë e ditëve të para të themelimit të Gjykatës dhe mungesën e njohurive dhe ekspertizës brenda Gjykatës ne ditët e saj të para.

Rasti i Logos së Prizrenit, shumë i ndjeshëm politikisht, është i rëndësishëm për faktin se Gjykata u ngrit në mbrojtje të vlerave thelbësore kushtetuese të barazisë, diversitetit, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Mbrojti komunitetet joshumicë nëpërmjet një qëndrimi të fortë/të paluajtshëm sa i përket rolit të identitetit t tyre të larmishëm brenda shoqërisë së Kosovës dhe vlerave të saj kushtetuese. Gjykata njohu rëndësinë historike të qytetit të Prizrenit për jetën e kombit shqiptar në Ballkan si tërësi, akoma më shumë barazoi atë me vlerat themelore të Kushtetutës së Kosovës dhe orientimin e saj të thellë drejt një shoqërie të bazuar në sundimin e ligjit dhe demokracisë.

Në rastet e dy presidentëve të Republikës, Gjykata bëri të qartë se askush nuk është mbi ligjin. Pas këtyre dy vendimeve, konstitucionalizimi i diskursit politik mori një qëndrim të paluhatshëm. Para se të merren këto vendime ka pasur shumë pak, nëse ka pasur ndonjë, politikanë të cilët do të vinin re ekzistencën e një dokumenti të quajtur Kushtetuta e Kosovës, e cila kërkonte besnikërinë e tyre dhe zbatimin e plotë. Mospajtimi i parashtruar në këtë rast është më afër pikës që krahasohet më rastin e parë të diskutuar këtu (rasti i RTK-së).

Megjithatë, argumentet e mospajtuesve në këtë rast janë të një natyre më pak kushtetuese. Në fakt ata janë të shtyrë nga frika legjitime e mospajtuesve për stabilitetin e vendit pas vendimit të Gjykatës për të deklaruar jokushtetues vendimin e Kuvendit për zgjedhjen e z. Behgjet Pacolli president të ri të vendit. Çfarë mospajtuesit nuk kanë kuptuar ishte fakti se Gjykata në vendimin e saj nuk la asnjë dyshim për sa i përket vakumit institucional, domethënë ajo bëri të qartë se Presidenti i zgjedhur ishte jokushtetues, mirëpo pa fuqi retroaktive. Z. Behgjet Pacolli ka qenë një president legjitim i vendit për rreth 38 ditë dhe të gjitha veprimet e tij kishte qenë të vlefshme me kushtetutë, derisa vendimi i gjykatës u mor duke thënë se vendimi i Kuvendit nuk ishte në përputhje me Kushtetutën.

Rasti i fundit, rasti i AKP-së, është në mesin e atyre rasteve që nuk ka kapur syrin dhe vëmendjen e publikut, por ajo është e një rëndësie të madhe për sundimin e ligjit dhe sigurinë juridike të qytetarëve dhe subjekteve të tjera juridike. Siç është vërejtur, çështja kishte të bënte me një ankesë që pretendonte shkeljen e të drejtave të veçanta kushtetuese. Mirëpo, arsyetimi i Gjykatës në këtë rast shkoi shumë më larg, duke prekur segmente më vitale

të sundimit të ligjit: parashikueshmërinë dhe sigurinë juridike që ishte shkaktuar nga një zbatim jo i njëtrajtshëm të ligjeve nga autoriteti më i lartë gjyqësor, p.sh. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës. Në një mënyrë shumë profesionale, Gjykata zbatoi Opinionin Këshillëdhënës për Kosovën të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i cili në mënyrë të qartë bëri dallimin midis fuqive konstitutive (*pouvoir consitutif*) dhe fuqive të konstituuara (*pouvoir constitué*).

IV. Kontrolli kushtetues dhe preventiv (paraprak) i amendamenteve kushtetuese dhe mbrojtja nga shkarkimi i shefit të shtetit: rasti i Kosovës

Hyrje

Polemika e zhvilluar ndërmjet dy luftërave botërore, në vitet e '30-ta të shekullit të kaluar, ndërmjet dy filozofëve më me ndikim të drejtësisë dhe të politikës, Carl Schmitt dhe Hans Kelsen, pa asnjë dyshim se prek themelet teorike e praktike të institucionit kushtetues që quhet shefi i shtetit, të formës dhe përmbajtjes së tij. Kjo vlen si për presidentin e republikës, ashtu dhe për monarkun. Debati në fjalë është aktual dhe i rëndësishëm edhe sot e gjithë ditën, po aq sa ka qenë aktual dhe i rëndësishëm në kohën kur u zhvillua. Rëndësia e tij në Kosovë vjen e shtohet aktualisht, në një kohë kur synohet me çdo kusht krijimi i një debati politik kontestues ndaj vendimit të fundit të Gjykatës Kushtetuese[321].

[321] Aktgjykimi në rastet KO29/12 dhe KO48/12, i datës 20 korrik 2012 (Nr. ref. AGJ 284/12). Ky aktgjykim, nga kontestuesit e tij, u quajt pa të drejtë "vendimi i Kushtetueses mbi Presidenten e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga". Duhet të theksojmë, megjithatë, se Aktgjykimi ka të bëjë me kontrollin abstrakt dhe preventiv (paraprak) të propozim-amendamenteve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të cilat, në pajtim me nenin 144.1 të Kushtetutës, e në lidhje me nenin 113.9 të saj, u propozuan nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit 120-anëtarësh të Republikës së Kosovës. Kryetari i Kuvendit, sipas dispozitave të sipërcekura kushtetuese, është i vetmi që ka tagër (autorizim) kushtetues për t'i dërguar në Gjykatë Kushtetuese amendamentet e propozuara nga subjektet kushtetuese të nenit 144.1 të Kushtetutës, me qëllim të kontrollit preventiv (paraprak) të kushtetutshmërisë së tyre. Një grup tjetër, Komisioni për ndryshime kushtetuese, ka synuar tërë kohën t'i prijë kontestimit të fuqisë juridike-kushtetuese të këtij aktgjykimi. Ai kontestim, më 25 shtator 2012, shkoi aq larg sa

Shmitianët e kelsenianët e kontekstit kosovar nuk ravijëzohen, e aq më pak nuk modelohen, për dallim nga autorët origjinalë të polemikës në fjalë, sipas kritereve ideologjike, partiako-politike, apo sipas ndonjë doktrine të veçantë kushtetuese. Varfëria ideologjiko-politike dhe teoriko-kushtetuese e debatit kosovar për "çështjen e Presidentes Jahjaga" nuk është e vetme: një situatë e tillë, pak a shumë, sundon diskursin publik kosovar edhe kur flitet për çështjet e tjera. Diskursi, që konteston aktgjykimin në fjalë të Gjykatës Kushtetuese, bazohet në tërësi në kritere joprofesionale dhe pa fije respekti për rregullat themelore profesionale, të cilat vlejnë kur kontestohet një vendim i një organi jopolitik dhe të pavarur, siç është Gjykata Kushtetuese. Në esencë, siç do të shihet, më shumë bëhet fjalë për një diskurs mohues, që konteston - *en generale* punën e Gjykatës dhe që për synim primar ka prodhimin e një debati *pro et contra* vendimit në fjalë në nivelin gjithëkosovar. Megjithatë, ky synim nuk është arritur as për së afërmi, për shkak të fuqisë së dobët të argumenteve mbi të cilat mbështetet. Si protagonist kryesor të vetin, ky diskurs, ka, në njërën anë, zyrtarët e lartë të partisë kryesore opozitare në Kosovë,

---

deshi të vërë në pikëpyetje vetë dispozitat kushtetuese të neneve 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës, të cilat e mandatojnë Gjykatën Kushtetuese për të ushtruar kontroll abstrakt dhe preventiv (paraprak) të kushtetutshmërisë së çdo amendamenti kushtetues të propozuar juridikisht në mënyrë të rregullt: Komisioni deklaroi se, amendamentet e shpallura si jokushtetuese nga Gjykata, mund të votohen në Kuvend, përkundër asaj që Gjykata mbi 60 (gjashtëdhjetë) për qind të tyre i ka shpallur si jokushtetuese. (Cf. Besnik Krasniqi, "Bajrami: Amendamenti 10 do të hidhet për votim në Kuvend", gazeta e përditshme *Koha Ditore* (e mërkurë, 26 shtator 2012) fq. 2.)

Kontrolli preventiv (paraprak) i kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese bëhet para se ato të votohen në Kuvend. Gjykata vlerëson *in abstracto* nëse amendamentet që propozohen zvogëlojnë të drejtat dhe liritë nga Kapitulli II i Kushtetutës. Kuvendi i Kosovës nuk guxon të votojë amendamentet, të cilat janë shpallur si jokushtetuese nga Gjykata. Kjo shprehimisht parashihet në nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës së Kosovës. Për praktikat komparative të kontrollit kushtetues abstrakt dhe preventiv (paraprak) të amendamenteve kushtetuese do të flitet më shumë në vijim të shkrimit.

Sikundër do të vërehet në vijim, qëllimi primar i hartuesve të këtyre amendamenteve ka qenë që "ta konstitucionalizojnë" (t'i japin fuqi dhe legjitimitet kushtetues) një marrëveshje politike, të lidhur në prill të vitit 2011, ndërmjet aktorëve kyçë të politikës kosovare, marrëveshje e cila në veçanti sanksiononte shkarkimin e shefit të shtetit të Kosovës, presidentes aktuale, znj. Atifete Jahjaga, nëpërmjet amendamentit kushtetues. Përveç kësaj, amendamentet në fjalë, në pjesën dërrmuese, synonin konstitucionalizimin e konjukturave të interesit momental politik, të cilat lidhen me rolin dhe me pozitën e sistemit të drejtësisë si dhe me pozitën e natyrën e kompetencave të ushtruesit të detyrës së Presidentit të Kosovës. E tërë kjo përpjekje është bërë, duke i pasur parasysh sjelljet e ish-ushtruesit të detyrës së Presidentit, gjatë kohës që i parapriu zgjedhjes së znj. Atifete Jahjaga për president të Kosovës (shtator 2010–prill 2011).

LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës), dhe, në anën tjetër, anëtarët kyç të Komisionit për ndryshime kushtetuese, i cili kryesisht dominohet nga përfaqësues të partisë në pushtet, PDK (Partia Demokratike e Kosovës).[322]

Siç dihet nga historia e teorisë kushtetuese, debati Schmitt–Kelsen është bërë për atë se kush është, apo kush duhet të jetë, garant i kushtetutës. Gjatë atij debati fillestar, është hedhur dritë edhe për rolin dhe për rëndësinë e shefit të shtetit (kryesisht) në demokracitë parlamentare me rregullim (kryesisht) republikan. Një pjesë e madhe e atij debati kishte të bënte me shefin e shtetit, si përfaqësues i unitetit të popullit, dhe me mospajtimin konceptual përkitazi me atë nëse ky unitet është sociologjiko-politik apo ka natyrë ekskluzivisht juridiko-kushtetuese. Të parën pikëpamje e ndërtoi dhe e mbështeti deri në fund Carl Schmitt, kurse të dytën Hans Kelsen. Nuk ka asnjë dyshim se drita e hedhur nga këta dy autorë ka shërbyer si një udhërrëfyes për teorinë dhe për praktikën shtetërore bashkëkohore që merret me pozitën dhe me rolin e shefit të shtetit në demokracitë parlamentare kushtetuese. Në diskutimet e tyre për rolin dhe për pozitën kushtetuese të shefit të shtetit, ata kanë trajtuar, në esencë, çështje që paraqesin vetë themelet e demokracisë kushtetuese dhe përbërësit kryesorë të saj, siç janë: ndarja e pushteteve dhe sundimi i ligjit, respekti për drejtat e njeriut dhe të minoriteteve dhe demokracia[323]. Këto aspekte të debatit në fjalë, po ashtu, përvijohen gjatë shtjellimeve tona në këtë temë.

---

[322] Ky komision vetvetiu nuk është kushtetues, meqë palë e autorizuar për të propozuar ndryshime dhe amendamentime janë vetëm Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit (neni 144.1 i Kushtetutës). Vetëm këto subjekte, askush tjetër, mund të propozojnë ndryshime dhe amendamentime të Kushtetutës.

Synimi i këtij komisioni për t'u paraqitur palë në procedurë pranë Gjykatës, ka shkaktuar telashe të natyrës procedurale dhe konfuzion. Në dispozitën e nenit 113.9 të Kushtetutës, ndër të tjera, thuhet: "Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë [në Gjykatën Kushtetuese — vërejtja jonë] amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës". Pra, si palë para Gjykatës, mund të jetë vetëm kryetari i Kuvendit, *per constitutionem,* kurse, si propozues i ndryshimeve dhe i amendamentimeve, sipas nenit 144.1 mund të jenë vetëm Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit. Siç u tha, ky komision është formuar *ad hoc,* nëpërmjet një marrëveshjeje politike të liderëve të tri forcave kryesore politike: PDK (Partia Demokratike e Kosovës), LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës) dhe AKR (Aleanca Kosova e Re). Kryetari i këtij komisioni është nga partia në pushtet, PDK, kurse partitë e tjera marrin pjesë sipas fuqisë politike që kanë.

[323] Për një trajtim të thellë të pikave kyç të debatit kushtetues C. Schmitt–H. Kelsen, cf. Michael Stolleis, *A History of Public Law in Germany: 1914-1945* (Oxford UP: Oxford, 2004),

Koncepti i shefit të shtetit, si përfaqësues i unitetit sociologjiko-politik, te Carl Schmitt, është mjaft i strukturuar dhe përfundon në personin e Fyhrerit, i cili gjendet në krye të piramidës shtetërore si mishërim i unitetit të tillë. Te Hans Kelsen, po ashtu, koncepti është mjaft i strukturuar, por, në një mënyrë e në një kahe tjetër, krejt të kundërt, me atë të C. Schmittit. Shefi i shtetit, te H. Kelsen, del si mishërim i unitetit juridiko-kushtetues të popullit, kurse, në krye të piramidës shtetërore, gjendet norma bazë (*Grundnorm*), të cilën shefi i shtetit duhet ta vërë në jetë krahas me institucionet e tjera kushtetuese. Derisa teoria e parë është në esencë diktatoriale, e dyta paraqet të kundërtën e saj.

Me kalimin e kohës, teoria e dytë u bë vetë thelbi i asaj që tashmë njihet si teoria dhe praktika për demokracinë kushtetuese. Thënë më saktë, teoria e dytë, për dallim nga e para, e cila vuri themelet e arsyetimit irracional të diktaturës naziste, shërbeu si substrat i teorisë dhe i praktikës së konstitucionalizmit modern që mori hov pas Luftës së Dytë Botërore.

Siç u tha, në rastin e Kosovës, në esencë, kemi të bëjmë me pamundësinë e ushqimit dhe të vënies në lëvizje të një debati publik serioz dhe të argumentuar me terma shkencorë e intelektualë. Në vend të kësaj, pas vendimit në fjalë të Gjykatës, u nis një diskurs kontestues, në shikim të parë sporadik, ku protagonistë kryesorë u shfaqën zyrtarët e lartë të LDK-së, si parti më e madhe opozitare, dhe anëtarët e Komisionit kushtetues. Në anën tjetër, në mënyrë të sforcuar dhe me çdo kusht, u synua që Gjykata Kushtetuese të paraqitet si pjesë e këtij diskursi. Gjykata, u mor vesh, nuk mund të pranojë një "ftesë" të tillë, edhe për faktin se, në Aktgjykimin e saj me mbi dyzet faqe, ka shkrirë tërë arsenalin profesional teoriko-kushtetues dhe praktik, me qëllim të mbrojtjes së vlerave e të parimeve të konstitucionalizmit perëndimor, të cilat janë të mishëruara në çdo dispozitë të Kushtetutës së Kosovës.

Çështja, që diskutohet në këtë shkrim, u nis në vijim të kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të kushtetutshmërisë së 11 (njëmbëdhjetë) amendamenteve të propozuara nga një grup deputetësh të Kuvendit të Kosovës. Gjykata e ushtron *per constitutionem* këtë juridiksion, çdoherë kur ka propozime për ndryshim apo për amendamentim të Kushtetutës, sipas nenit 144 të Kushtetutës. Ky proces amendamentimi ka qenë pjesë e një marrëveshjeje të mëhershme politike të forcave kryesore politike. Nevoja për amendamentim, ndërkaq, u pa atëherë kur, brenda një kohe të shkurtër (shtator 2010–prill

---

në veçanti kapitulli 3 ("Revolution, Weimar Constitution, and Versailles") dhe kapitulli 5 ("Quarrel Over Methods and the Crisis of the State").

2011), Gjykata "rrëzoi" dy presidentët e Kosovës, në vijim të mbrojtjes së parimeve, të vlerave dhe të normave kushtetuese që kanë të bëjnë më rolin, me pozitën dhe me natyrën e institucionit të Presidentit të Republikës. Kjo do të thotë se, pa u kuptuar sfondi i ngjarjeve dhe i rrethanave që lidhen me dy aktgjykimet për dy ish-presidentët e Kosovës, nuk mund të kuptohet esenca e vendimit që diskutohet këtu dhe që ka të bëjë me kontrollin abstrakt dhe preventiv (paraprak) të 11 (njëmbëdhjetë) propozim-amendamenteve kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Një pjesë e këtyre amendamenteve të propozuara kishte të bënte me mënyrën dhe me kohën e zgjedhjes së presidentit të ardhshëm të Kosovës. Pikërisht kjo pjesë, përkatësisht propozimi i amendamentit 10 (dhjetë), i cili kishte të bënte me shpalljen e zgjedhjeve të para presidenciale kosovare, u dramatizua në publik, duke i lënë nën hije aspektet e tjera tepër të rëndësishme të Aktgjykimit. U krijua një diskurs, në shikim të parë krejt spontan, por në thelb krejt i planifikuar dhe malicioz, i cili mbështetet hapur në legjitimitetin e teorisë dhe të praktikës kushtetuese për unitetin sociologjiko-politik të popullit dhe për dominimin e shumicës ndaj të tjerëve. Si i tillë, ky diskurs kontestues, përshkon të gjitha aspektet e demokracisë kushtetuese dhe nuk kufizohet vetëm në rëndësinë, në rolin dhe në pozitën e shefit të shtetit të Kosovës.

Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, që shpall jokushtetuese mbi 60 (gjashtëdhjetë) për qind të 11 (njëmbëdhjetë) amendamenteve të propozuara, është objekt shqyrtimi në pjesën e parë të këtij shkrimi. Kjo pjesë pasohet nga e dyta, e cila ka titullin në gjuhën frënge, sepse ashtu është përdorur për herë të parë nga Benjamin Constant (Benzhamen Konstan) dhe nga autorët e tjerë të shekullit XIX. Ky koncept, pra *il regne et ne gouverne pas* ("shefi i shtetit mbretëron, por nuk qeveris"), ka dashur të sqarojë se të ashtuquajturat *pouvoir neutre et indermediaires* ("autorizimet neutrale dhe të ndërmjetme") të shefit të shtetit në demokracitë kushtetuese parlamentare, shikuar historikisht, nuk ekzistojnë, për të krijuar një pushtet tjetër krahas atij ekzekutiv, legjislativ e gjyqësor. Ato autorizime, përkundrazi, shërbejnë për t'i mundësuar një të treti, i cili quhet shef i shtetit, që të balancojë pushtetet e tjera, duke garantuar funksionimin e qetë e normal të institucioneve kushtetuese.[324] Këto autorizime përcaktojnë përmbajtjen e sintagmës në gjuhën frënge

[324] Ky rol i shefit të shtetit ekziston dhe sanksionohet në të gjitha vendet evropiane, me përjashtim të Francës, e cila ka sistem gjysmëpresidencial, ku shefi i shtetit ka pjesëmarrje të madhe në ekzekutivin e vendit. Kosova nuk bënë përjashtim në këtë drejtim. Dispozitat e neneve 4 (para. 3) dhe 83 e bëjnë të qartë një gjë të tillë:

il regne et ne gouverne pas. Ato, në thelb, pasqyrojnë vetë esencën e pozitës, të rolit dhe të rëndësisë që ka shefi i shtetit në një sistem të qeverisjes që quhet demokraci kushtetuese.

Pjesa e tretë vjen natyrshëm dhe prek thelbin e diskursit aktual që konteston Aktgjykimin e Gjykatës për 11 propozim-amendamentet kushtetuese. Në trajtimin tonë këtu, njëjtë siç ka bërë Gjykata, nuk merremi dhe nuk flasim *ad hominem* për shefin aktual të shtetit të Kosovës. Trajtimi mëton që deri në fund të jetë akademik e profesional dhe ka për qëllim primar mbrojtjen e institucionit të shefit të shtetit, në kontekstin e sotëm kosovar dhe në dritën e debatit gjithnjë aktual dhe shkencor Schmitt–Kelsen. Kjo mbrojtje, këtu, vlen për të gjitha situatat e për të gjitha kohët, në të cilat mund të gjendet një shef shteti, i rrezikuar nga shkarkimi ekstrakushtetues nëpërmjet amendamentimit të tekstit ekzistues të kushtetutës.

Misioni i përbashkët i drejtësisë dhe i teorisë kushtetuese konsiston në mbrojtjen e parimeve dhe të vlerave të ideologjisë së konstitucionalizmit modern perëndimor. Çdo argumentim *ad hominem* i një institucioni kushtetues është i huaj për konstitucionalizmin modern dhe për teorinë kushtetuese, siç do të shihet në shtjellimin tonë në pjesën e katërt dhe të fundit të këtij punimi.

Përfundimet tona ndjekin frymën e shtjellimet përgjatë këtij teksti dhe rrjedhshëm reflektojnë përfundimet e secilës prej katër pjesëve të shkrimit.

1. Historiku i një vendimi, forma dhe përmbajtja e tij

Vendimi i sipërcekur, që është objekt analize këtu, ka formën e aktgjykimit. Atij i ka paraprirë një proces politik, i cili u zhvillua pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, të datës 30 mars 2011, me të cilin qe shpallur jokushtetuese zgjedhja e Behgjet Pacollit President i Kosovës nga Kuvendi i Republikës.[325] Gjykata nuk i dha fuqi retroaktive vendimit për "rastin Pacolli", duke i

---

Neni 4, paragrafi 3 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]: "Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë".

Neni 83 [Statusi i Presidentit]: "Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës".

[325] Rasti KO29/11. Sabri Hamiti dhe deputetët e tjerë: Vlerësimi kushtetues i vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, i 22 shkurtit 2011, përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës; Aktgjykimi i 30 marsit 2011.

njohur kështu si të vlefshme të gjitha veprimet dhe punët e kryera nga z. Pacolli si ish-President i Kosovës. Më këtë qasje, Gjykata konfirmoi teorinë e praktikën dominante kushtetuese bashkëkohore, e cila ia njeh shefit të shtetit të drejtën e identifikimit juridiko-kushtetues me shtetin, si brenda ashtu dhe jashtë tij. Nuk ka rëndësi fare kush e ushtron atë funksion *ad hominem*: një shtet serioz nuk guxon për asnjë moment të ndërpresë jetën e vet institucionale, jetë kjo që mishërohet dhe që personifikohet, *inter alia*, nga personaliteti i shefit të shtetit.[326] Kjo do të thotë se shefi i shtetit i mbijeton ndryshimet sociologjiko-politike, të cilat ndodhin në shtet, sepse paraqet mishërim të vetë thelbit të kontinuitetit shtetëroro-juridik.

Teoria e mbijetimit të ndryshimeve nga shefi i shtetit është njohur dhe është zhvilluar nga Benjamin Constant, në shtjellimet e tij dhe të autorëve të tjerë të shekullit XIX, në kontekstin e monarkive kushtetuese të kohës. Ato shtjellime kishin të bënin me sqarimin e rolit dhe të rëndësisë së monarkut, si shef shteti në monarkitë evropiane gjatë kohës së Napoleonit dhe pas kohës së Napoleonit.[327] Këtë aspekt, të reflektimit të shefit të shtetit në kontinuitetin shtetëror e juridik, e ka sanksionuar dhe e ka shtjelluar Gjykata në Aktgjykimin për rastin e ish-Presidentit Behgjet Pacolli, duke e njohur si të vlefshëm dhe me fuqi e me kompetencë kushtetuese çdo akt dhe çdo veprim të ndërmarrë nga ai. Me të njëjtin aktgjykim, Gjykata e riktheu kryetarin e

---

[326] Te Hans Kelsen, ky personifikim lidhet me kategorinë e atribuimit (mveshjes). Sipas tij, çdo akt që mund t'i atribuohet (mvishet) shefit të shtetit është akt i shtetit. E njëjta gjë vlen edhe për aktet e bartësve të tjerë të autorizimeve publike kushtetuese. Kjo teori është shtjellim i nisur nga juristi i njohur gjerman Georg Jellinek, gjë të cilën e pohon edhe vetë Hans Kelsen. Georg Jellinek ka folur i pari për kontinuitetin juridik të shtetit, i cili realizohet nëpërmjet veprimit të organeve të tij. Para kohës së Napoleonit, përkatësisht në kohën nga Paqja e Vestfalisë (1648) deri te Revolucioni Francez i vitit 1789, debatet për subjektivitetin shtetëror kanë qenë të fokusuara në subjektivitetin juridiko-ndërkombëtar të shtetit. Vetëm pas Revolucionit Francez e tutje, u hap debati për subjektivitetin juridiko-kushtetues të shtetit dhe për pasojat e tij për rendin e brendshëm kushtetues. Cf. Clemens Jabloner, "Hans Kelsen: Introduction", në Arthur J. Jacobson and Bernhard Schlink (eds.), *Weimar: A Jurisprudence of Crisis* (Univ. of California Press: Berkeley, 2000) fq. 67-76; Hans Kelsen, "Legal Formalism and the Pure Theory of Law", në Arthur J. Jacobson and Bernhard Schlink (eds.), vepra cit., fq. 77-84; Hans Kelsen, *General Theory of Law and State* (The Lawbook Exchange: Clark, New Jersey, 2009) fq. 181-207; Janne Elisabeth Nijman, *The Concept of International Legal Personality: An Inquiry Into the History and Theory of International Law* (T.M.C. Asser: The Hague, 2004), në veçanti kapitulli 2 ("Historical Introduction: Leibniz and the Emergence of the Concept of ILP") dhe kapitulli 3 ("Demystifying the ILP: Brierly, Kelsen and Scelle").

[327] Cf. Biancamaria Fontana (ed.), *Benjamin Constant: Political Writings* (Cambridge UP: Cambridge, 2010) fq. 171-328.

Kuvendit në vendin e tij të ushtruesit të detyrës së shefit të shtetit kosovar, duke mos lënë kështu, për asnjë moment, asnjë vakum juridiko-kushtetues në funksionimin e institucionit të Presidentit të Kosovës.[328] Pas aktgjykimit në fjalë për "rastin Pacolli", u hapën rrugët drejt zgjedhjes së shefit të ri të shtetit, gjithnjë duke pasur parasysh respektimin deri në fund të dispozitave kushtetuese për zgjedhjen e të parit të institucionit në fjalë.

Konstatimi i Gjykatës, me të cilin shpall jokushtetues vendimin e Kuvendit për zgjedhjen e B. Pacollit President të Kosovës, ka pasur tri lloj pasojash kushtetuese: e para, ai ka qenë President, kurse veprimet e aktet e tij të kryera përgjatë më shumë se një muaji i atribuohen (i mvishen) atij dhe vetëm atij; e dyta, zgjedhja e tij ka qenë jokushtetuese dhe, për pasojë, me rastin e zgjedhjes së shefit tjetër të shtetit kosovar duhet respektuar Kushtetuta deri në fund; dhe, e treta, me rikthimin e kryetarit të Kuvendit në pozitën e ushtruesit të detyrës së shefit të shtetit kosovar është bërë e qartë se Kosova nuk ka jetuar për asnjë moment pa kreun e vet të shtetit.

Pak ditë pas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, që mohonte kushtetutshmërinë e vendimit të Kuvendit për zgjedhjen e Behgjet Pacollit President të Kosovës, forcat kryesore politike në vend arritën një marrëveshje politike, e cila kishte për qëllim primar tejkalimin e krizës së krijuar politike. Kjo marrëveshje u arrit më 6 prill 2011 dhe u nënshkrua nga kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, në emër të PDK-së; nga prof. Isa Mustafa, në emër të LDK-së, partisë më të madhe opozitare; dhe nga ish-Presidenti i Kosovës, z. Behgjet Pacolli, në emër të AKR-së, si parti e koalicionit qeverisës. Me këtë marrëveshje, palët nënshkruese, në emër të përkushtimit të tyre për t'i vënë interesat e vendit mbi interesin e tyre, u dakorduan për sa vijon:

- që të nominojnë zonjën Atifete Jahjaga si kandidate të përbashkët për Presidente të Republikës së Kosovës;
- që të fillohet me amendamentimet e Kushtetutës dhe të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ashtu që ato të reflektojnë konceptin e ri të zgjedhjeve të drejtpërdrejta për president republike, me të gjitha ndryshimet në pozitën dhe në rolin e Presidentit të Republikës, që mund të burojnë nga ndryshimi i mënyrës së zgjedhjes së shefit të shtetit;

[328] Behgjet Pacolli është zgjedhur president i Kosovës më 22 shkurt 2001 dhe ka ushtruar këtë funksion deri më 30 mars 2011, kur Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se ka pasur shkelje të Kushtetutës me rastin e zgjedhjes së tij dhe, për pasojë, ka anuluar me efekt joprapaveprues vendimin e Kuvendit, nr. 04-V-04, të 22 shkurtit 2011, përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

- që zgjedhjet e para për President të Republikës të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën hyjnë në fuqi ndryshimet e nevojshme kushtetuese e ligjore; dhe, së fundi,
- që zgjedhjet e përgjithshme, sipas Ligjit të reformuar për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe me amendamentet përkatëse, të mbahen jo më vonë se 18 muaj nga hyrja në fuqi e këtyre amendamenteve ligjore e kushtetuese.

Ditën e nesërme, më 7 prill 2011, Kuvendi i Kosovës nxori një rezolutë me të cilën mbështeti marrëveshjen e arritur.[329] Kjo rezolutë e Kuvendit mbështeste në tërësi marrëveshjen politike. Për më tepër, këtë e bënte duke e parafrazuar tekstin e saj në tërësi. Duhet thënë, megjithatë, se ka një dallim substancial ndërmjet tyre. Ai ndryshim konsiston në faktin se, në paragrafin e fundit, Rezoluta thotë se mbështetjen e marrëveshjes politike e bën duke u bazuar në tërësi në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ky ka qenë sfondi i ngjarjeve dhe vetë konteksti politik kur Kuvendi votoi zonjën Atifete Jahjaga presidente të Kosovës, më 7 prill 2011. Ajo u zgjodh në raundin e parë.[330] Jo shumë pas kësaj, Kuvendi formoi dy komisione, të cilat ishin paraparë me marrëveshjen politike, dhe atë: Komisionin për ndryshime kushtetuese dhe Komisionin për ndryshimet përkatëse të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.[331] Kryetari i Kuvendit, dr. Jakup Krasniqi, të njëjtën ditë, ka tërhequr vërejtjen për jokushtetutshmërinë e komisioneve, duke vënë në pah se ato kishin ekskluzivisht natyrë politike. Dr. Jakup Krasniqi shkoi një hap më tutje, kur tha se, me formimin e tyre, në fakt, po shkelej Kushtetuta e Kosovës. Ky reagim i tij, megjithatë, nuk u miratua nga deputetët kosovarë, të cilët votuan themelimin e dy komisioneve të përmendura.[332]

---

[329] Rezoluta Nr. 04-R-02, e datës 7 prill 2011, e Kuvendit të Kosovës, me të cilën mbështetet arritja e marrëveshjes politike të 6 prillit 2011. Rezoluta u miratua me 75 vota për, me 2 abstenime dhe me 1 votë kundër.

[330] Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-11, i datës 7 prill 2011, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

[331] Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-12, i datës 22 prill 2011, për formimin e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-13, i datës 22 prill 2011, për formimin e Komisionit për amendamentimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

[332] Jakup Krasniqi, "Për mandatin e presidentes të flasin Thaçi, Mustafa e Pacolli", intervistë, gazeta e përditshme *Epoka e re* (e hënë, 9 korrik 2012) fq. 4-5.

Komisioni për reformën zgjedhore nuk arriti ndonjë rezultat konkret deri në kohën e shkrimit të këtij punimi (nëntor 2012): ai ndërpreu punën si pasojë e mospajtimeve politike ndërmjet pozitës dhe opozitës.[333] Komisioni tjetër, komisioni për amendamentimet kushtetuese, arriti të dorëzojë, në mars të këtij viti, një draft të vetin te Kryetari i Kuvendit të Kosovës. Siç u cek më herët, sipas nenit 113.9 të Kushtetutës, Kryetari i Kuvendit ka detyrim kushtetues që çdo amendamentim të Kushtetutës t'ia referojë Gjykatës për kontroll kushtetues abstrakt dhe preventiv (paraprak). U mor vesh, Kryetari i Kuvendit, si palë e autorizuar pranë Gjykatës, i referon amendamentimet vetëm nëse ato janë bërë sipas nenit 144.1 të Kushtetutës. Në rastin konkret, kjo nënkupton se ato propozim-amendamente do të duhej të kishin nënshkrimet e më së paku 30 deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Kontrolli që ushtron Gjykata është kontroll kushtetues abstrakt dhe preventiv (paraprak). Ai konsiston në vlerësimin nëse ndonjë amendament i propozuar zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës. Dispozita e nenit 113.9 të Kushtetutës paraqet versionin kosovar të asaj që, në teorinë dhe në praktikën kushtetuese komparative, identifikohet me emra të ndryshëm, siç janë: "klauzola e përjetësisë" (*eternity clause*), "dispozitat kushtetuese që nuk mund të ndryshohen" (*unamendable constitutional provisions*), "amendamentet kushtetuese jokushtetuese" (*unconstitutional constitutional amendments*), "dispozitat e rrënjosura në mënyrë absolute" (*absolutely entrenched provisions*) etj. Këto çështje do të diskutohen sërish më vonë, në pjesën e fundit të këtij punimi. Këtu mjafton të thuhet se, si të tilla, këto dispozita e parime kushtetuese gjenden në mjaft kushtetuta të botës, kurse origjinën e kanë në teorinë e në praktikën gjermane. Vetë koncepti i tyre ka dalë nga mendja e Carl Schmittit, në një analizë të tij për legalitetin dhe për legjitimitetin e Kushtetutës së Vajmarit. Teoria e praktika gjermane, pas Luftës së Dytë Botërore, sërish me sugjerimin e tij, pranoi futjen e këtij koncepti në Ligjin Themelor të Gjermanisë (1949).[334]

---

[333] Komisioni për reformën zgjedhore, siç u njoh në publik, u kryesua nga dr. Haki Demolli i LDK-së. Puna e tij u ndërpre në fund të gushtit 2012, "sepse nuk ekzistoi vullneti në anën e nënshkruesve të marrëveshjes politike për implementimin e saj dhe të Rezolutës së Kuvendit me të cilën u përkrah marrëveshja politike për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme presidenciale, siç parashihej me dy këto dokumente". Deklaratë e dr. Haki Demollit, kryetar i Komisionit, dhënë autorit të këtyre rreshtave, më 24 nëntor 2012.

[334] Këtu bëhet fjalë për nenin 79.3 të Ligjit Themelor të Republikës Federale të Gjermanisë. Kjo dispozitë e Ligjit Themelor te Republikës Federale të Gjermanisë parasheh si vijon: "(Amendamentimi i Ligjit Themelor): (1) Ky Ligj Themelor mund të amendamentohet vetëm me një ligj i cili në mënyrë shprehimore amendamenton ose plotëson tekstin e tij. Në

Po të mos ekzistonte kjo dispozitë e nenit 113.9 në Kushtetutën e Kosovës, e cila mundëson kontrollin abstrakt dhe preventiv (paraprak) të çdo amendamenti kushtetues para se të shkojë për miratim në Kuvend, diçka që nuk njihet në shumë vende të botës,[335] sigurisht që nuk do të ekzistonte as diskursi aktual kosovar që synon të mohojë vlerën dhe fuqinë juridiko-kushtetuese të vendimit të sipërcekur të Gjykatës Kushtetuese. Ky vendim, siç u tha, gabimisht cilësohet si "vendimi i Kushtetueses mbi Presidenten", apo "vendimi që i dha presidentes Atifete Jahjaga mandatin e plotë pesëvjeçar".[336] Në pjesën e fundit të shkrimit, do t'i bëjmë një analizë të plotë këtij diskursi të mbyllur dhe joprofesional deri në fund, kundrejt gjendjes aktuale të teorisë dhe të praktikës kushtetuese në vendet e përparuara të botës perëndimore. Tani mjafton të tregojmë, në vija të trasha, se cila është forma dhe përmbajtja e tij.

Vendimi në fjalë është vendim meritor dhe, për pasojë, ka formën e aktgjykimit. Si i tillë, ai paraqet përgjigjen meritore të Gjykatës, në kuadër të juridiksionit të bazuar në nenin 113.9 dhe në nenin 114.3 të Kushtetutës. Ky ju-

---

rastet e traktatit ndërkombëtar mbi paqen, përgatitjen e paqes, përfundimin gradual të një regjimi okupues, apo kur skicohet promovimi i mbrojtjes së Republikës Federale të Gjermanisë, do të jetë e mjaftueshme nëse thuhet se dispozitat e këtij Ligji Themelor nuk përjashtojnë lidhjen dhe hyrjen në fuqi të një traktati të tillë ndërkombëtar dhe nëse ky sqarim futet në tekstin e ligjit të ri që amendamenton këtë Ligj Themelor; (2) Çdo ligj i tillë miratohet me dy të tretat e anëtarëve të Bundestagut dhe dy të tretat e votave të Bundesratit; (3) Nuk lejohen amendamentet e Ligjit Themelor që prekin ndarjen e Federatës në lande, pjesëmarrjen e landeve në procesin legjislativ, si dhe ato që kanë të bëjnë me parimet e cekura në nenet 1 dhe 20".

Përveç Gjermanisë, dispozita të tilla ka gjithandej në Evropë (Norvegjia, Italia, Franca, Turqia), në Afrikë (Afrika e Jugut, Maroku), në Azi (India), në Amerikë Latine (Kili), etj.

[335] Kontrolli preventiv, si në rastin e Kosovës, është i rrallë dhe ekziston vetëm në disa vende, siç janë Azerbajxhani, Kirgizia, Moldavia, Turqia dhe Ukraina. Cf. analizën komparative të Komisionit të Venedikut: *Report on Constitutional Amendment, Adopted by The Venice Commission at Its Plenary Session* (Venice, 11-12 December 2009). Në rrjet: venice.coe.int, me shenjën CDL-AD (2010) 001, Study No. 469/2008, Strasbourg, 19 January 2010. Për aspektet teorike të kontrollit preventiv të amendamenteve kushtetuese, cf. Kemal Gözler, *Judicial Review of Constitutional Amendments: A Comparative Study* (Ekin Press: Bursa, 2008); Gary Jeffrey Jacobsohn, "An unconstitutional constitution? A comparative perspective", *International Journal of Constitutional Law* vol. 4, no. 3 (July 2006).

[336] "Zgjedhjet e parakohshme presidenciale varen nga Jahjaga", gazeta e përditshme *Koha ditore* (e shtunë, 7 korrik 2012) fq. 1 dhe 3; "Jahjaga: Mirupafshim në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016", gazeta e përditshme *Bota sot* (e shtunë, 7 korrik 2012) fq. 1 dhe 4-5; "Foli Kushtetuesja: Presidentja ka mandat pesëvjeçar", gazeta e përditshme *Epoka e re* (e shtunë, 7 korrik 2012) fq. 1 dhe 4-5; "Presidente e plotë", e përditshmja *Gazeta Express* (e shtunë, 7 korrik 2012) fq. 1 dhe 4-5; "Jahjaga edhe katër vjet presidente", gazeta e përditshme *Zëri* (e shtunë, 7 korrik 2012) fq. 1-2.

ridiksion, në rastin konkret që shtjellohet këtu dhe që ka qenë objekt i Aktgjykimit, ka të bëjë me kontrollin kushtetues abstrakt dhe preventiv (paraprak) të 11 (njëmbëdhjetë) propozim-amendamenteve në Kushtetutën e Kosovës. Ato mbajnë autorësinë e një të katërtës (1/4) së deputetëve të Kuvendit, por në të njëjtën kohë reflektojnë synimin e sforcuar për autorësi të njëjtë të Komisionit për ndryshime kushtetuese.[337] Sipas nenit 144.1 të Kushtetutës, siç u cek më herët, për propozim të amendamentimit kushtetues kërkohet së paku një e katërta (1/4) e numrit të deputetëve, së paku 30 sish. Komisioni kushtetues nuk paraqet palë të autorizuar kushtetuese për propozimin e amendamenteve në Kushtetutën e Kosovës.[338]

Aktgjykimi ka mbi dyzet faqe, me 276 paragrafë, pa llogaritur këtu pjesën e tij operative (dispozitivin). Ky i fundit ka pesë paragrafë përmbajtjesorë. Përkundër këtij vëllimi, në diskursin publik të sforcuar njëanshëm nga LDK-ja, si parti opozitare, dhe nga një pjesë e anëtarëve të Komisionit kushtetues, është goditur dhe është përfolur vetëm dispozita e paragrafit 255 të tij.[339] Gjykata vuri në pah, në këtë paragraf, se pritjet e qytetarëve të Kosovës nuk janë ato që buronin nga marrëveshja politike me të cilën, *inter alia*, kërkoheshin zgjedhjet e parakohshme, por ato që buronin nga vendimi i Kuvendit për zgjedhjen e Presidentes Jahjaga (për pesë vjetët e ardhshëm). Gjykata i dha përparësi absolute pritjeve të qytetarëve që burojnë nga një vendim i një trupi kushtetues, Kuvendi i Kosovës, i cili zgjodhi znj. Atifete Jahjaga Presidente të Kosovës.[340] Pritjet e tilla të qytetarëve të Kosovës janë transcendente dhe

---

[337] Neni 144.3 i Kushtetutës [Amendamentimi]: "Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për ta vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës".

[338] Neni 144.1 i Kushtetutës [Amendamentimi]: "Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit, sipas Rregullores së punës së Kuvendit, mund të propozojnë ndryshime dhe amendamentime të kësaj Kushtetute".

[339] Paragrafi 255: "Në rastin e Presidentes aktuale të Republikës, kjo do të thotë që i gjithë populli i Kosovës pret që ajo të jetë Presidentja e tyre gjatë pesë (5) vjetëve të ardhme. Kështu që, shkurtimi i mandatit të saj, siç propozohet me amendamentin dhjetë (10), e privon popullin e Kosovës nga përfaqësuesi i tyre legjitim dhe garantuesi në një kohë më të hershme se që besonin dhe shpresonin".

[340] Më 2 tetor 2012, në emisionin *Rubikon* të KTV-së, shefi i LDK-së, z. Isa Mustafa, deklaroi se "të gjithë e kemi ditur kur kemi lidhur marrëveshjen politike se dispozitat e saj janë antikushtetuese, sepse mandati i Presidentit të Kosovës është pesë (5) vjet". Z. Mustafa tha se nuk sheh asgjë të keqe në Aktgjykimin e Gjykatës në këtë drejtim. Ajo që kontestoi z. Mustafa, në këtë paraqitje publike, kishte të bënte me faktin se "Gjykata duhet ta dijë se krejt Kosova e ka pasur të qartë se me marrëveshje politike ne jemi dakorduar që znj. Jahjaga të ketë

mbijetojnë konjukturat momentale politike, të cilat i ka pasur parasysh marrëveshja politike. Pritjet, të cilat i njeh Aktgjykimi, lidhen me rolin dhe me pozitën e Presidentit të Kosovës si përfaqësues legjitim i vendit, brenda e jashtë, dhe si garantues i funksionimit demokratik të institucioneve kushtetuese të Kosovës. Kjo është fryma e letra e Kushtetutës. Kontestimi i fuqisë së Aktgjykimit, në këtë pjesë, u bë në mënyrë krejt të thjeshtëzuar, me fjalë e me argumente që aspak nuk kanë të bëjnë me teorinë dhe me praktikën kushtetuese të vendeve perëndimore, të atyre vendeve që Kosova dhe kushtetuta e saj i synojnë pa asnjë dyshim.

Paragrafët 247-271 të Aktgjykimit, që kanë të bëjnë me Presidentin e Republikës, sikundër dhe pjesët e tjera, kanë një arsyetim të gjatë e profesional. Aty shtjellohet roli, pozita dhe rëndësia e shefit të shtetit, si garantues dhe si personifikim i unitetit juridiko-kushtetues dhe shtetëror i tërë shoqërisë kosovare (e kuptuar si shtet sovran dhe i pavarur). Esenca e diskursit kontestues, krejtësisht politik, mëtonte t'i tregonte publikut kosovar se, ndër të tjera, "presidentja Atifete Jahjaga nuk përfaqëson popullin e Kosovës dhe, për pasojë, Gjykata nuk ka mundur ta dijë se kush është përfaqësues politik i popullit të Kosovës".[341] Përveç ndaj këtij paragrafi, në asnjë moment nuk ka pasur kritikë ndaj pjesëve të tjera të Aktgjykimit. Gjykata nuk ka thënë, në

---

mandat të përkohshëm dhe jo mandat pesëvjeçar", emisioni *Rubikon*, me Adriatik Kelmendin, në programin televiziv të KTV-së (Kohavizion), 2 tetor 2012 (ora 20:00).

[341] Debati në fillim u nis me fjalët e thjeshta e pa asnjë përmbajtje, se "vendimi i Gjykatës nuk është profesional". Ky lloj "diskutimi" ka vazhduar me një intensitet mjaft të madh që nga dita e nxjerrjes së vendimit dhe akoma aty-këtu synon të mbahet "gjallë" nga Komisioni kushtetues. Në publik, dhe në qarqet akademike, nuk ka pasur asnjë debat në përkrahje të një qasjeje të tillë të thjeshtëzuar ndaj vendimit në fjalë. Ndonjë përkrahje aty-këtu ka qenë nga laikët dhe nga publicistika kosovare, pa asnjë vlerë shkencore. Cf. "Kryetari i Komisionit kushtetues, Arsim Bajrami, konteston vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me amendamentet për zgjedhjen e presidentit", gazeta e përditshme *Koha ditore* (e shtunë, 7 korrik 2012) fq. 1 dhe 3; "Kuvendi me Rezolutë antikushtetuese", *Koha ditore* (e diel, 8 korrik 2012) fq. 1 dhe 3; Riza Smaka, "Vendimi ka qenë korrekt", gazeta e përditshme *Epoka e re* (e hënë, 9 korrik 2012) fq. 7; "LDK ndihet e tradhtuar nga Thaçi, AKR shpreson në vullnetin e presidentes", *Koha ditore* (e martë, 10 korrik 2012) fq. 2; "Kushtetuesja: I gjithë populli shpreson ta ketë Jahjagën 5 vjet në krye", *Koha ditore* (e shtunë, 21 korrik 2012) fq. 3; Halil Matoshi, "Popullizmi kushtetues dhe Zarifja", *Koha ditore* (e mërkurë, 25 korrik 2012) fq. 10; Sokol Bylykbashi, "Kushtetuesja politike", gazeta e përditshme *Tribuna shqiptare* (e mërkurë, 19 gusht 2012) fq. 13; "Gjykata Kushtetuese dhe Komisioni për ndryshime kushtetuese përplasen për amendamentet që i referohen presidentit", *Koha ditore* (e mërkurë, 29 gusht 2012) fq. 1 dhe 3; "E godasin Gjykatën", e përditshmja *Gazeta Express* (e mërkurë, 29 gusht 2012) fq. 6; "Kuvendi në hall me amendamentet jokushtetuese", *Koha ditore* (e shtunë, 11 gusht 2012) fq. 1 dhe 3.

asnjë paragraf, e aq më pak në paragrafin 255, se Presidentja Jahjaga përfaqëson unitetin politik të popullit. Ky nuk është ndonjë zbulim, meqë dihet botërisht se zonja Presidente Atifete Jahjaga asnjëherë nuk ka përfaqësuar ndonjë forcë politike. Edhe po të ishte se ajo përfaqëson një forcë të caktuar politike, nuk është punë e Gjykatës të merret me aspektet e përfaqësimit të unitetit sociologjik dhe politik të popullit nga shefi i shtetit. Kjo do të përbënte një absurd *par exellence* për sistemin presidencial të tipit të ShBA-së, ku shefi i shtetit ka forcë ekzekutive dhe përfaqëson maksimalisht mesataren e qytetarëve amerikanë, e lëre më për demokracinë kushtetuese parlamentare të tipit të Kosovës.

Debati Schmitt–Kelsen koncentrohet pikërisht në atë se kush përfaqëson unitetin e popullit, qoftë atë sociologjiko-politik apo juridiko-kushtetues. Ky debat ka qenë i rëndësishëm në kohën ku është prodhuar, po aq sa është sot, në Kosovë dhe kudo që mund të bëhet. Derisa Carl Schmitt ka parë në shefin e shtetit personifikimin e unitetit sociologjiko-politik të popullit, Hans Kelsen dhe autorët e tjerë të proveniencës, e cila cilësohet si demokraci kushtetuese, nuk kanë pasur asnjë dyshim se nuk mund të ketë institucion të vetëm që të personifikojë një unitet të tillë sociologjiko-politik. Kjo vlen si për praktikat e diktaturave më të ashpra të tipit stalinist apo hitlerian, ashtu dhe për demokracitë më të përparuara me sistem kushtetues presidencial të tipit të ShBA-së.

Shtrohet pyetja tani: pse lindi ky diskurs kontestues ndaj vendimit në fjalë të Gjykatës, i mbyllur në dy-tre vetë, kaq politik e kaq brutal dhe pa fije argumenti profesional?

Sikundër që mund të jetë vërejtur nga shtjellimet e mësipërme, gjeneza e këtij diskursi të vetëmbyllur buron nga dinamikat e brendshme politike në Kosovë, të cilat u krijuan dhe u zhvilluan pas arritjes së marrëveshjes politike të datës 6 prill 2011, si dhe nga vetë kushtet e parapara aty. Mbi bazën e atyre kushteve, nuk ka asnjë dyshim, u përpiluan 11 amendamentet e propozuara në Kushtetutën e Kosovës. Këto amendamente kanë qenë objekt i vlerësimit abstrakt dhe preventiv (paraprak) nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Se amendamentet e propozuara mishëronin frymën dhe germën e marrëveshjes politike vërehet jo vetëm nga mënyra e formulimit të amendamentit, me të cilin synohej shkurtimi i mandatit pesëvjeçar të shefit aktual të shtetit kosovar,[342]

[342] Ka pasur dy versione të amendamenteve të propozuara: versioni A dhe versioni B. Këtë cilësim të këtyre propozimeve e ka bërë vetë Gjykata, për qëllimet e lehtësimit të punës së saj. Për qëllimet e dhënies së drejtësisë kushtetuese, ndërkaq, këto dy propozime fare nuk kanë rëndësi. Kjo, nga shkaku se Aneksi A flet për "brenda gjashtë muajsh", kurse versioni B

por edhe nga formulimi i amendamentit tjetër, që synonte kufizime drastike dhe irracionale të kompetencave të ushtruesit të detyrës së Presidentit, në rastet kur kjo pozitë do të ushtrohej nga kryetari i Kuvendit. Edhe këto amendamente, Gjykata i vlerësoi me të drejtë si jokushtetuese, sepse zvogëlonin të drejtat dhe liritë e parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.[343]

Në nenin 90.5 (2,3,6) të Kushtetutës, u propozua amendamenti 7 (shtatë), i cili thoshte se ushtruesi i detyrës së Presidentit duhet të jetë i kufizuar në ushtrimin e të gjitha kompetencave dhe të funksioneve të Presidentit, në veçanti ato që kanë të bëjnë me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, me emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, si dhe me kompetencën për dhënien e faljeve individuale. Arsye e këtyre kufizimeve të çuditshme, të cilat fare nuk mund të futen në kornizën e teorisë edhe të praktikës së konstitucionalizmit perëndimor, duhet kërkuar, siç e thamë më lart, në dinamikat politike që i kanë pararendur arritjes së marrëveshjes politike. Hartuesit e këtij amendamenti i kanë pasur parasysh faktorët *ad hominem*, përkatësisht vlerësimin të cilin aktorët kryesorë politikë ia kanë bërë punës dhe sjelljes së ushtruesit (dy herë me radhë) të detyrës së presidentit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqit. Ky vlerësim i referohet kohës prej shtatorit të vitit 2010 e deri në prill të vitit 2011, kur z. Krasniqi pati ushtruar detyrën e Presidentit të Kosovës. Në këtë kohë, ai pati refuzuar emërimin e një numri të caktuar të gjyqtarëve e të prokurorëve, pati dhënë një numër të madh të faljeve individuale, pati ndarë medalje, mirënjohje e çmime, të cilat qenë kritikuar pub-

---

për "pas gjashtë muajsh", kohë kur amendamenti që shkurtonte mandatin e Presidentes aktuale duhej të hynte në fuqi dhe, për pasojë, të organizoheshin zgjedhjet e reja. Versioni i parë përsërit *ad literam* urdhrin politik të marrëveshjes së sipërcekur politike. Kjo marrëveshje parashikonte mbajtjen e zgjedhjeve "jo më vonë se gjashtë muaj nga dita e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të nevojshme kushtetuese dhe ligjore". Versioni B, po ashtu, përçonte një urdhër politik të qartë, i cili ishte kristalizuar ndërkohë nga liderët politikë kosovarë, nënshkrues të marrëveshjes së sipërcekur politike. Tash, me këtë version, sikur tregohej një lloj "mëshire" për mandatin kushtetues (pesëvjeçar) të presidentes kosovare, sepse parashihte zgjedhjet e drejtpërdrejta pas "gjashtë muajsh" nga dita e hyrjes në fuqi të amendamenteve kushtetuese.

Esenca e Aktgjykimit qëndron në atë se ai pastroi dilemat e atyre që besonin se mund të përdornin Gjykatën Kushtetuese të Kosovës për "konstitucionalizimin" e një marrëveshjeje politike të krijuar në mënyrë jashtëkushtetuese. Gjykata tha, për të qenë më i qartë, se Presidentja aktuale nuk mund të shkarkohet nëpërmjet amendamenteve kushtetuese në asnjë kohë para se të mbushen 4 (katër) vjet e 365 (treqindegjashtëdhjetepesë) ditë. Nuk ka rëndësi nëse fjala është "brenda" apo "pas gjashtë muajsh".

[343] Paragrafi operativ III [pikat 3 deri 5] të Aktgjykimit.

likisht mjaft ashpër nga segmente të caktuara të shoqërisë kosovare.[344] E, megjithatë, vlen të thuhet se këto kritika kanë qenë kryekëput politike, sepse nuk ka pasur një procedurë apo një vlerësim ligjor të kryer me kompetencë, ku do të kontestohej ligjshmëria apo kushtetutshmëria e punës dhe e sjelljes së ish-ushtruesit të detyrës së Presidentit të Kosovës për këtë periudhë. Gjykata Kushtetuese nuk ka guxuar t'i marrë për bazë argumentet *ad hominem* në procedurën e kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të normës kushtetuese të përmbajtur në propozim-amendamentin 7 (shtatë). Në fakt, Gjykata nuk guxon ta bëjë një gjë të tillë në asnjë procedurë që zhvillohet para saj.

Cilësia themelore e kontrollit abstrakt të normës juridiko-kushtetuese konsiston në atë se aty bëhet vlerësimi i efektit të përgjithshëm dhe hipotetik të normës kundrejt çdo situate apo rrethane në të cilën dikush mund të ndodhet në të ardhmen. Gjykata, pra, për dallim nga politika, abstrahon se kush ka qenë, kush është, apo kush mund të jetë ushtrues i detyrës së Presidentit të Republikës, dje, sot dhe në të ardhmen. Ai sërish mund të jetë dr. Jakup Krasniqi. Kjo nuk ndryshon asgjë. Në rastet e kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të normës kushtetuese, kjo bie më shumë në sy. Ky kontroll, siç u theksua, bëhet në raport me Kapitullin II të Kushtetutës, përkatësisht ka për qëllim vlerësimin nëse amendamenti i propozuar zvogëlon të drejtat dhe liritë nga Kapitulli II i Kushtetutës. Edhe Kapitulli II i Kushtetutës, i cili shërben si pikë themelore e referimit me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara, vlerësohet në mënyrë abstrakte. Kjo do të thotë se Gjykata ka vlerësuar *in abstracto* që çdo kufizim i sotshëm i kompetencave të ushtruesit të detyrës së Presidentit, siç është synuar nga hartuesit e propozim-amendamentit në fjalë, cenon çdo herë dhe ndaj çdokujt të drejtat dhe liritë nga Kapitulli II i Kushtetutës, dhe atë, për sa vijon:

- në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme, potencialisht paralizon shtetin dhe krijon krizë kushtetuese, pra krijohet një ambient ku vihen në rrezik të drejtat dhe liritë e njeriut;[345]
- kur bëhet fjalë për emërimet e për shkarkimet e gjyqtarëve, një kufizim i tillë pengon administrimin e drejtësisë dhe, për pasojë, pakëson të

[344] Cf. Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Lajmet e fundit: Reagim i Kabinetit të Kryetarit të Kuvendit", sajti i Kuvendit të Kosovës (e hënë, 20 shkurt 2012): http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,128,4462 (shikuar më 24 nëntor 2012); "Eliminuan nga lista Driton Muharremin", gazeta e përditshme *Kosova sot* (e premte, 27 janar 2012). Këtu, në këtë shkrim, analizohet raporti kritik i Misionit të OSBE-së në Kosovë, i cili flet për parregullsitë në emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Kosovës nga u.d. i Presidentit, dr. Jakup Krasniqi).

[345] Cf. Paragrafët 158-161 të Aktgjykimit.

drejtat e liritë e njeriut nga Kapitulli II i Kushtetutës në sensin që qytetarët dhe subjektet e tjera të së drejtës nuk kanë mundësi t'i realizojnë me rrugë gjyqësore të drejtat dhe liritë e tyre;[346]

- për sa i takon faljeve individuale, pengimi i ushtruesit të detyrës së Presidentit për të bërë shpalljen e faljeve individuale të atyre që janë të privuar nga liria paraqet cenim absolut të të drejtave dhe të lirive njerëzore, sepse qytetarët që kanë të drejtë për një falje të tillë privohen nga ushtrimi dhe nga gëzimi i fryteve të faljes deri sa vendi të zgjedhë presidentin e ri.

Sikundër vërehet nga kjo paraqitje e përciptë, Gjykata nuk ka marrë parasysh asgjë tjetër, përveç analizimit *in abstracto* të normës kushtetuese të propozuar me amendament kundrejt Kapitullit II të Kushtetutës. Në këtë lloj të kontrollit kushtetues shpërfillen në tërësi ngjarjet dhe personat që ndërlidhen *in concreto* me ushtruesin e detyrës së Presidentit. Kush ka qenë, kush është dhe kush mund të jetë ushtrues detyre i Presidentit, si dhe kush mund të përfitojë, apo të dëmtohet, nga veprimet apo nga aktet e ushtruesit të detyrës së Presidentit, nuk çon peshë fare dhe nuk merret parasysh me rastin e ushtrimit të këtij lloji të juridiksionit kushtetues nga Gjykata. Po ashtu, fuqishëm duhet të vihet në dukje fakti se, me rastin e kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të normës kushtetuese, Gjykata nuk guxon të marrë parasysh *travaux préparatoires* (punimet përgatitore), të cilat kanë çuar në hartimin e propozim-amendamenteve, të cilat janë objekt i kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) kushtetues. Si punime përgatitore, në rastin që diskutojmë këtu, kanë qenë bisedimet politike, kryesisht diskrete, ndërmjet liderëve politikë dhe të cilat kanë rezultuar me arritjen e marrëveshjes politike të datës 6 prill 2011. Nuk ka asnjë dyshim se, nga analiza e tekstit të amendamenteve të propozuara dhe nga krahasimi i tyre me tekstin e marrëveshjes, del që hartuesit e amendamenteve kanë synuar "të konstitucionalizojnë", përkatësisht të kontrabandojnë, një vullnet momental politik të nënshkruesve të marrëveshjes dhe ta shkrijnë atë vullnet në tekstin e ri të Kushtetutës së Kosovës. Kjo formë e ushtrimit të pushtetit konstitutiv, pra e vullnetit të popullit si sovran, nuk ka mundur të pranohet nga Gjykata, sepse është tërësisht në kundërshtim me parimet bazë të konstitucionalizmit modern. Në kuadrin e këtyre parimeve bazë, karta për të drejtat dhe për liritë kushtetuese të subjekteve të së drejtës, Kapitulli II i Kushtetutës, paraqet një shtyllë tejet të rëndësishme, e cila mbështet dhe legjitimon ushtrimin e këtij vullneti kon-

[346] Cf. Paragrafët 162-167 të Aktgjykimit.

stitutiv të popullit, i kuptuar si sovran.[347] Do të ishte lëshim serioz dhe skandal profesional i llojit të vet, sikur Gjykata t'i kishte marrë parasysh *travaux préparatoires,* të cilat kanë rezultuar me arritjen e marrëveshjes politike, pra sikur të kishte "konstitucionalizuar" dispozitat e saj *post festum*. Kjo është kështu, në veçanti, nëse kihet parasysh se, në Kosovë, për dallim nga shumë vende të tjera, nuk ka dallim ndërmjet Kuvendit, si organ ligjvënës, dhe Kuvendit, si organ kushtetutëbërës[348]. Me një fjalë, amendamentimi kryhet nga i njëjti kuvend, me dy të tretat e anëtarëve të tij. Në një situatë të tillë, kushtetutëbërësit origjinalë kosovarë kanë vendosur t'i japin Kapitullit II rolin e pikës së referimit për ta matur shkallën dhe formën e konstitucionalizmit kosovar në rastet kur dikush synon të bëjë ndryshimin e tekstit origjinal të Kushtetutës. Në kushtet e globalizimit aktual, me të drejtë është vërejtur në doktrinë se, e drejta ndërkombëtare, në veçanti pjesa e saj që ka të bëjë me të drejtat e njeriut, luan një rol të veçantë në vlerësimin kushtetues të amendamenteve

[347] Në disa kushtetuta, ushtrimi i pushtetit konstitutiv ka një formë e procedurë krejt të strukturuar dhe është i ndarë nga procedura e amendamentimit të zakonshëm. Në disa raste kërkohet konvokimi i një asambleje të veçantë kushtetuese për këtë qëllim (Bullgaria), në disa të tjera kërkohet që të bëhet propozim-amendamentimi dhe të shpërndahet organi përfaqësues e të krijohet një tjetër, i cili pas leximit tjetër vendos për miratimin ose jo të tyre (vendet skandinave), duke i lënë hapësirë të mjaftueshme debatit publik për amendamentet e propozuara. Përveç këtyre, në praktikë, ka raste kur parashikohen intervale të gjata kohore ndërmjet propozimit të amendamenteve dhe miratimit të tyre në organin përfaqësues (Estonia, Lituania, Mali i Zi etj.). Cf. Report on Constitutional Amendment, Adopted by the Venice Commission at Its Plenary Session (Venice, 11-12 December 2009); për aspektet teorike të të gjitha modaliteteve të amendamentimit kushtetues, Cf. Carlo Fusaro, "Changing Constitutions", në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds.), *How Constitutions Change: A Comparative Study* (Hart: Oxford, 2011) fq. 3-6; Dawn Oliver and Carlo Fusaro, "Changing Constitutions: Comparative Analysis", në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds.), vepra cit., fq. 381-403; Carlo Fusaro and Dawn Oliver, "Towards a Theory of Constitutional Change", në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds.), vepra cit., fq. 404-433.

[348] Izraeli është një tjetër vend ku nuk bëhet dallimi mes asamblesë konstitutive dhe asaj legjislative. Megjithatë, ekziston një dallim mes Kosovës dhe Izraelit në sensin që në Izrael Kneset-i (parlamenti izraelit) e ka të njohur nga tjerët rolin e kujdestarit të vullnetit origjinal të popullit hebre, në veçanti kur është fjala për ruajtjen e demokracisë hebreje. Edhe atje, sidoqoftë, Kneset-i ka fuqi të kufizuar për sa i përket ushtrimit të pushtetit konstitutiv në emër të krejt hebrenjve dhe ndryshimit të vetë natyrës së demokracisë hebreje. Cf. më shumë për këtë tek Ahron Barak, "Unconstitutional Constitutional Amendments", në *Israel Law Review* vol. 44, no. 3 (2012); Sharon Weintal, "The Challenge of Reconciling Constitutional Eternity Clauses with Popular Sovereignty: Toward Three-Track Democracy in Israel as a Universal Holisitic Constitutional System and Theory", në *Israel Law Review* vol. 44, no. 3 (2012).

kushtetuese.[349] Kjo është kështu, në veçanti në Evropë, pjesë e së cilës është Kosova, e cila, në nenin 53 të Kushtetutës së saj, pra brenda Kapitullit II, i jep fuqi dhe vend të veçantë Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.[350]

Amendamentet kushtetuese, derisa nuk janë votuar, i nënshtrohen kontrollit kushtetues për të parë nëse bien ndesh me tekstin origjinal të Kushtetutës. Në momentin e miratimit të tyre, ato bëhen pjesë e barabartë me pjesët origjinale (fillestare) të tekstit kushtetues. Për këtë arsye, në teorinë dhe në praktikën kushtetuese parashihen kufizime te theksuara procedurale dhe materiale (substanciale) në ushtrimin e fuqisë (pushtetit) konstitutive (krijuese) të popullit, i kuptuar si sovran. Amendamentimi paraqet një ndër këto fuqi (pushtete) krijuese. Kjo çështje sërish trajtohet në fund të këtij shkrimi. Këtu mjafton të thuhet se Gjykata, me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamentit 10 (dhjetë), deri në fund ka pasur parasysh kriteret profesionale të drejtësisë kushtetuese dhe të konstitucionalizmit modern perëndimor. E njëjta vlen edhe për propozim-amendamentin 7 (shtatë). Kjo do të thotë se Gjykata, në asnjë rast, nuk ka çarë kokën për kriteret dhe për kushtet e parapara në tekstin e marrëveshjes politike. Në paragrafët 247-271 të Aktgjykimit, në mënyrë shumë abstrakte flitet për çdo situatë apo për çdo gjendje në të cilën mund të gjendet secili person në cilësinë e Presidentit të Kosovës, sot dhe në të ardhmen, përkatësisht se ai/ajo mund të mënjanohet nga detyra vetëm nëpërmjet mënyrës së paraparë kushtetuese. Gjykata ka treguar, njësoj sikur Gjykata Supreme e Indisë, se "e drejta për amendamentim nuk nënkupton të drejtën për rrënim".[351] Ky është standardi matës i çdo demokracie kushtetuese. Çdo rrugë tjetër, si kjo që synohej nëpërmjet amendamentit 10 (dhjetë) (neni i ri i propozuar ka qenë neni 162.1), cenon vetë esencën, rolin dhe pozitën e shefit të shtetit në një republikë demokratike parlamentare, pra

---

[349] Cf. Lech Garlicki and Zofia A. Garlicki, "External Review of Constitutional Amendments? International Law as a Norm of Reference", në *Israel Law Review* vol. 44, no. 3 (2012).

[350] Neni 53 ("Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut"): "Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara më këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

[351] *Minerva Mills Ltd. v. Union of India* (A.I.R. 1980, S.C. 1789) fq. 1798. Për komentet e këtij pozicioni, Cf. Gary Jeffrey Jacobsohn, "An unconstitutional constitution. A comparative perspective?" *International Journal of Constitutional Law* vol. 4, no. 3 (July 2006) fq. 472-476; Lech Garlicki and Zofia A. Gralicka, "Review of Constitutionality of Constitutional Amendments (An Imperfect Response to Imperfections)", në *Journal of Constitutional Law / Revue de droit constitutionnel* vol. I, issue 1 (Istanbul, 2012) fq. 216-219; Dr. J.N. Pandey, *The Constitutional Law of India*, 47th ed. (CLA: Allahabad, India, 2010) fq. 366-367, 420-421, 770-772.

të një institucioni që personifikon unitetin juridiko-kushtetues të popullit dhe garantuesin e funksionimit demokratik të institucioneve kushtetuese shtetërore.[352] E shikuar nga këndvështrimi i Kapitullit II, sërish *in abstracto*, pra pa marrë parasysh se kush është dhe pse është sot shef i shtetit kosovar, kjo mënyrë e synuar për mënjanimin e kreut të shtetit cenon të drejtat zgjedhore (aktive e pasive),[353] ndarjen e pushteteve,[354] të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave,[355] barazinë para ligjit,[356] e kështu me radhë. Gjykata, në asnjë rast, nuk ka marrë parasysh kriteret jokushtetuese, njësoj siç është vepruar edhe me rastin e ish-presidentit kosovar, z. Fatmir Sejdiu.[357]

2. *Il regne et ne gouverne pas*

Drejtësia kushtetuese, në kuptimin e gjerë të fjalës, nuk kryhet vetëm nëpërmjet mekanizmit të gjykatës kushtetuese, por edhe me ndihmën e punës së përditshme të institucioneve të tjera kushtetuese. Në kuptimin e ngushtë, ndërkaq, ajo identifikohet me punën e me veprimtarinë profesionale të gjykatës kushtetuese, e cila ka monopolin e mbrojtjes dhe të interpretimit të kushtetutës.[358] Se cili segment i drejtësisë kushtetuese do të dalë në syprinë varet

---

[352] Paragrafi 259 i Aktgjykimit: "Pasi të zgjidhet, Presidenti mban mandatin deri në pesë vjet. Presidentja aktuale mban mandatin në mënyrë legjitime dhe është, në bazë të zgjedhjes së saj Presidente, garantuese e funksionimit demokratik të institucioneve në shtet. Mandati i Presidentit të Kosovës është përzierje e legjitimitetit të zgjedhjes së tij/saj, kohëzgjatjes së mandatit (pesë vjet) dhe kompetencave që i jepen Presidentit me Kushtetutë, jo vetëm kompetencat e dhëna sipas nenit 84 (Kompetencat e Presidentit)".

[353] Paragrafët 260-261.

[354] Paragrafët 267-268.

[355] Paragrafët 262-264.

[356] Paragrafi 265.

[357] Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, pati dhënë dorëheqje më 27 shtator 2010. Që atëherë, ai ka folur publikisht për ekzistimin e një marrëveshjeje politike ndërmjet tij dhe faktorëve ndërkombëtarë në mbështetje të "ngrirjes" së pozitës së tij si kryetar i partisë. Ai ka pohuar se, përveç kësaj, kjo marrëveshje e pohuar ka shërbyer si bazë për *travaux préparatoires,* pra si shtyllë për draftimin dhe formën aktuale të nenit 84 të Kushtetutës. Cf. Enver Robelli, "Doli prej zarfit, tash nuk del prej zyrës!", gazeta e përditshme *Koha ditore* (e martë, 10 korrik 2012) fq. 10. Në këtë artikull, autori përmend bindjen e fortë të ish-presidentit Fatmir Sejdiu për ekzistimin e marrëveshjes së lartcekur "gojore" ndërmjet tij dhe faktorëve kryesorë ndërkombëtarë.

[358] Në teori nganjëherë bëhet dallim ndërmjet mbrojtjes dhe interpretimit të kushtetutës. Cf. Luis Lopez-Guerra, "The Role and Competences of the Constitutional Court", në Venice Commission, *The role of the constitutional court in the consolidation of the rule of law* [Uni-

nga një sërë faktorësh, siç janë kultura kushtetuese e politike, por edhe nga rrethanat e tjera objektive socio-ekonomike e politike. Ajo që njihet si konstitucionalizëm, ideologji kjo moderne e kushtetutës, në esencë i referohet konceptit të gjerë të drejtësisë kushtetuese dhe është cilësi themelore e demokracive kushtetuese me traditë të gjatë e stabile.[359] Edhe vendet e tjera, kryesisht vendet në transicion, ku hyn Kosova dhe vendet e tjera ish-komuniste, synojnë këtë identifikim të drejtësisë kushtetuese në kuptim të gjerë, me tërë gamën e gjerë të infrastrukturës institucionale e formalo-juridike, e cila mbështet punën e gjykatës kushtetuese si institucion i specializuar për dhënien e drejtësisë kushtetuese në kuptim të ngushtë.

Një identifikim i tillë gjithëpërfshirës nuk ka qenë gjithherë i mundur: vendet ish-komuniste, përfshirë Kosovën, është dashur të mbështeten për një kohë të gjatë ekskluzivisht në gardianin dhe interpretuesin e vetëm të kushtetutës — në Gjykatën Kushtetuese. Infrastruktura tjetër dhe strukturat e tjera kushtetuese e shtetërore kosovare, njëjtë si në ish-botën komuniste, mbeten mjaft të dobëta për t'u mbështetur kryesisht vetëm në to.[360]

Dem Seminar Bucharest, 8-10 June 1994, CDL-STD (1994) 010] (Council of Europe: Strasbourg, 1994) fq. 20-23.

Edhe Kushtetuta e Kosovës e bën dallimin ndërmjet mbrojtjes dhe interpretimit të kushtetutës. Për mbrojtjen flitet në kontekstin e formës së regjimit kosovar, kurse për interpretimin në kuadër të dispozitave për Gjykatën Kushtetuese dhe për juridiksionin primar të saj. Kështu, në nenin 4.6 (Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit) thuhet: "Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës", kurse në nenin 112.1 (Gjykata Kushtetuese — Parimet e Përgjithshme): "Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën".

[359] Cf. Carlo Fusaro and Dawn Oliver, "Changing Constitutions", në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds.), *How Constitutions Changes: A Comparative Study*, fq. 3-5; Dawn Oliver and Carlo Fusaro, "Changing Constitutions: Comparative Analysis", po aty, fq. 381-403; "Towards a Theory of Constitutional Change", po aty, fq. 405-433.

[360] Për një analizë të shkëlqyer të përvojave të të gjitha vendeve ish-komuniste, si dhe për rolin dhe për pozitën e gjykatave kushtetuese gjatë transicionit, përfshirë këtu krahasimin e tyre me vendet e përparuara perëndimore, shih më shumë në: Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (Univ. Chicago Press: Chicago, 2000) fq. 1-21 dhe 226-248; Levent Gonenc, *Prospects for Constitutionalism in Post-Communist Countries* (Kluwer Law International: The Hague, 2002), në veçanti kapitulli 1 ("Conceztptual Framework") dhe kapitulli 3 ("Constitution-Making") fq. 3-25 dhe 103-208; Jean-Pierre Massias, *Droit constitutionnel des États d'Europe de l'Est*, 2e ed. (Presses Universitaire de France: Paris, 2008) fq. 13-63.

Ka pasur autorë, megjithatë, të cilët kanë qenë kundër kësaj mbështetje ekskluzivisht vetëm në gjykatën kushtetuese. Sipas tyre, një mbështetje e tillë ekskluzivisht në gjykatën kushtetuese i paralizon organet tjera, i delegjitimon dhe i defaktorizon të njëjtat dhe e rëndon

Drejtësia kushtetuese kosovare, e kuptuar kësisoj, jo vetëm që e ndikon punën aktuale të Kushtetutës, si një kuadër për qeverisje dhe si një kartë e të drejtave e lirive njerëzore, por edhe e inspiron atë. Nga ky prizëm vërehet qartë ndërveprimi ndërmjet drejtësisë kushtetuese dhe kontekstit institucional, kulturor e politik në të cilin vihet në jetë drejtësia kushtetuese. Drejtësia kushtetuese kosovare, njëjtë si ajo e vendeve ish-komuniste gjatë transicionit, pa dyshim se është konceptuar si një garantuese e demokracisë kushtetuese, e vlerave, e parimeve dhe e normave të saj. Njohja dhe pranimi i epërsisë së qartë të demokracisë kushtetuese, karshi formave të tjera, paraqet një *condictio sine qua non* të drejtësisë kushtetuese. Kjo demokraci legjitimohet dhe arsyetohet vetëm nëpërmjet termave e koncepteve të asaj që njihet si ideologji e konstitucionalizmit modern perëndimor (antimazhoranca, balanca dhe ndarja e pushteteve, të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit dhe të ngjashme). Vetëm në këtë kuadër të gjerë konceptual mund të kuptohet dhe të shpjegohet drejtësia kushtetuese, si një prej teknikave specifike për dhënie të drejtësisë. Misioni i saj primar konsiston në ngritjen e sundimit të ligjit në një shkallë më të lartë, si dhe në përsosjen dhe në zhvillimin permanent të pikëpamjeve e të praktikave të shekullit XIX për sundimin e ligjit dhe pajtimin e tyre me konstitucionalizmin modern perëndimor. Në këtë drejtim, Kosova nuk dallon aspak nga vendet ish-komuniste: Kushtetuta e Kosovës, dispozitat dhe fryma e saj, në tërësi modelohet sipas mësimeve e përvojave të vendeve më të përparuara të botës perëndimore.

Në kohën pas rrënimit të monarkive absolute, të shkaktuara nga Revolucioni Francez i vitit 1789, e deri më sot, konstitucionalizmi dhe drejtësia kushtetuese, si komponentë e tij, kanë konsistuar në menaxhimin nëpërmjet rrugëve institucionale e formalo-kushtetuese të formave të ushtrimit të vullnetit të pakontrolluar të popullit, si sovran i ri në skenën politike evropiane të kohës. Dihet mirëfilli se i tërë shekulli XIX ka qenë në shenjë të kontrollit institucional dhe kushtetues të monarkive evropiane dhe synimit për të garantuar stabilitetin e tyre institucional e politik. Teoria për të ashtuquajturat kushtetuta të ngurta i ka shërbyer këtyre qëllimeve e synimeve për stabilitet

---

dukshëm punën e funksionimit të tërë sistemit kushtetues. Cf. Wojciech Sadurski, "Post-communist Constitutional Courts in Search of Political Legitimacy", në *Working Paper of the Law Department of the European University Institute* (Series/Report No. 11/2001, EUI Law); Wojciech Sadurski, "Constitutional Review After Communism: Legitimacy and Reasons", në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010).

institucional e politik. Për t'i shërbyer qëllimeve e synimeve të tilla, ajo u formulua sa pari nga *Lord Bryce*.[361] Si praktikë, megjithatë, ajo është më e hershme dhe daton që nga shekulli XVIII. Koncepti për kushtetutat rigjide nuk është vetëm një çështje *ex catedra* e diskurseve demagogjike dhe shterpe. Ky koncept nuk është vetëm punë procedure në sensin e ekzistimit të disa pengesave, të cilat pamundësojnë ndryshimin e lehtë dhe të shpejtë të tekstit kushtetues. Disiplina e njohur si amendamentimi kushtetues, sado e një rëndësie tepër të madhe, megjithatë, nuk mund ta zbulojë tërë thelbin e ndodhive dhe mënyrën e formimit të sistemit politik fillestar sipas kushtetutës në fuqi, e cila cilësohet si rigjide. Për të kuptuar thelbin e këtyre ndodhive dhe thelbin e mënyrës së formimit të sistemit politik origjinal (fillestar) në të kaluarën, asnjëherë nuk duhet harruar vlerat substanciale (materiale), pra jo vlerat procedurale, të cilat garantojnë rigjiditetin e kushtetutës së caktuar. Kjo vlen për Kosovën, po aq sa vlen edhe për pjesën dërrmuese të demokracive kushtetuese bashkëkohore. Këto vlera substanciale gjenden nëpër dispozitat materiale kushtetuese dhe njihen, siç u pa më herët, me lloj-lloj emrash e shprehjesh. Këto vlera nuk është e thënë të gjenden shprehimisht nëpër tekstin kushtetues ekzistues. Ka raste kur ato janë krijuar nga praktika e gjatë e ushtrimit të drejtësisë kushtetuese.[362] Në hulumtimet shkencore të këtij lëmi, ka rezultuar se vetë epërsia e kushtetutës, kundrejt çdo norme tjetër, nënkupton ekzistimin e kontrollit gjyqësor, sikundër që vetë të qenët rigjid të një kushtetute fuqizon tej mase kontrollin kushtetues. Pra, ka një korrelacion pozitiv ndërmjet ekzistimit të një teksti të shkruar kushtetues dhe rigjiditetit të saj të theksuar dhe të një kontrolli të fuqishëm gjyqësor të kushtetutshmërisë.[363]

Në tekstet kushtetuese, apo të krijuara nga praktika e gjyqeve kushtetuese, esenca e vlerave substanciale si më sipër konsiston në atë se vetëm nëpërmjet analizës dhe studimit të tyre mund të kuptohet përfundimisht historiku dhe zhvillimi i sistemit politik origjinar (fillestar), i ndërtuar sipas procedurave të kushtetutës rigjide. Këto dispozita kushtetuese materiale, të cilat

---

[361] James Bryce, *Studies in History and Jurisprudence* (Clarendon Press: Oxford, 1901), në veçanti "Essay III: Flexible and Rigid Constitutions", fq. 145-254.

[362] Të tilla janë rastet e Indisë, të Gjermanisë, të Kanadasë, etj. Cf. dr. sc. Jasna Omejec, "Kontrola ustavnosti ustavnih normi (ustavnih amandmana i ustavnih zakona)" ("Kontrolli i kushtetushmërisë së normave kushtetuese (amendamentet kushtetuese dhe ligjet kushtetuese)"), *Godišnjak Akademije pravnih znanosti Hrvatske* vol. 1, no. 1 (Prosinac, 2010) fq. 1-28.

[363] Arend Lijphart, *Patterns of Democracy: Government forms and Performance in Thirty-Six Countries* (Yale UP: New Haven, 1999) fq. 217-230.

ngërthejnë këto vlera dhe parime të (pa)ndryshueshme, paraqesin një lloj "kodi gjenetik" të secilës kushtetutë.[364] Kosova, në këtë drejtim, nuk bën përjashtim: Kapitulli II i Kushtetutës për të drejtat dhe liritë e njeriut është "kodi gjenetik" i saj, vija e kuqe, ndryshimi eventual i të cilit do ta shkatërronte formën dhe përmbajtjen e sistemit aktual politik kosovar, të formësuar këtyre viteve mbi bazën e tekstit (rigjid) origjinal (fillestar) kushtetues, të datës 15 qershor 2008.[365] Kjo do të thotë se amendamentimi i Kushtetutës së Kosovës has në vështirësi, të cilat nuk lidhen vetëm me procedurën e vështirë për

[364] Kjo shprehje për herë të parë është përdorur nga Carlo Fusaro dhe Dawn Oliver në "Towards a Theory of Constitutional Change", vepra cit., fq. 428.

[365] Kosova ka shpallur Deklaratën e Pavarësisë më 17 shkurt 2008. Më pas, Kuvendi i Kosovës, bazuar në këtë deklaratë, më 9 prill 2008 ka miratuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më 15 qershor të të njëjtit vit. Këto akte janë ndërmarrë nga përfaqësuesit e popullit të Kosovës, jo nga strukturat e pushtetit të krijuara në Kosovë pas qershorit të vitit 1999, mbi bazën e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të datës 10 qershor 1999.

Nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND), kjo shpallje është vlerësuar si akt i ushtrimit të pushtetit konstitutiv (*pouvoir constiuant*), jo atij legjislativ (*pouvoir constitué*), i cili ka funksionuar në Kosovë mbi bazën e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të datës 10 qershor 1999. Cf. Paragrafët 102-109, 118 dhe 121 të Vendimit Konsultativ të GjND-së, të datës 22 korrik 2010, International Court of Justice (ICJ), Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in respect of Kosovo, Advisory Opinion, 22 July 2010.

Për komentet e këtij vendimi, në literaturë, Cf. James Summers (ed.), *Kosovo: A Precedent? The Declaration of Independence, the Advisory Opinion and Implications for Statehood, Self-Determination and Minority Rights* (Martinus Nijhoff: The Hague, 2011); Michael Bothe, "Kosovo — So What? The Holding of the International Court of Justice Is Not the Last Word on Kosovo's Independence", në *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010); Robert Howse & Ruti Teitel, "Delphic Dictum: How Has the ICJ Contributed to the Global Rule of Law by its Ruling on Kosovo?", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010); Björn Arp, "The ICJ Advisory Opinion on the Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo and the International Protection of Minorities", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010); Robert Muharremi, "A Note on the ICJ Advisory Opinion on Kosovo", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010); Thomas Burri, "The Kosovo Opinion and Secession: The Sounds of Silence and Missing Links", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010); James E. Moliterno, "What the ICJ's Decision Means for Kosovars", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010); Elena Cirkovic, "An Analysis of the ICJ Advisory Opinion on Kosovo's Unilateral Declaration of Independence", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010); Hanna Jamar & Mary Katherine Vigness, "Applying Kosovo: Looking to Russia, China, Spain and Beyond After the International Court of Justice Opinion on Unilateral Declarations of Independence", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010); Toma Galli, "Kratka analiza Savjetodavnog mišljenja Međunarodnog suda o proglaenju neovisnosti Kosova s međunarodnim pravom", *Zbornik Pravnog Fakulteta u Zagrebu* vol. 61, no. 6 (prosinac 2011).

amendamentimin e saj[366], por, mbi të gjitha dhe kryesisht, me vështirësitë që i referohen parimeve dhe vlerave substanciale kushtetuese të Kapitullit II të Kushtetutës dhe të dispozitave të tjera materiale.[367]

T'i kthehemi sërish çështjes së origjinës së praktikës së implementimit të kushtetutave rigjide, si dhe vetë arsyeve për një praktikë të tillë, rolit dhe rëndësisë së drejtësisë kushtetuese në kuptim të gjerë, si dhe lindjes së drejtësisë kushtetuese në kuptim të ngushtë.

Siç e thamë më parë, praktika e kushtetutës rigjide u nis në fund të shekullit XVIII. Pas revolucioneve të mëdha të fundit të atij shekulli, në dy anët e Atlantikut, lindi një pikëpamje e re për konstitucionalizmin. Demokracia radikale ose absolute, si një prodhim i dogmës revolucionare të revolucioneve amerikane (1776) dhe franceze (1789), u zëvendësua nga demokracia kushtetuese: koncepti i një kushtetute rigjide, e cila mund të ndryshohej me një vështirësi të jashtëzakonshme, u fut në përdorim nga njerëzit e mençur të kohës. Ndërkohë që miratimi i dy teksteve kushtetuese në dy anët e Atlantikut u bë nëpërmjet shumicës së thjeshtë në konventën kushtetuese (ShBA), përkatësisht në Asamblenë Kushtetuese (Franca), ndryshimit të tyre në të ardhmen iu vunë pengesa të paimagjinueshme deri atëherë. Kjo rezultoi në atë që literatura me të drejtë e quajti "paradoksi i konstitucionalizmit", në sensin që shumica e thjeshtë e një brezi ia lidh duart shumicës absolute të së ardhmes.[368] Për herë të parë u bë zgjedhja ndërmjet demokracisë radikale dhe asaj

---

[366] Neni 144, paragrafi 2 [Amendamentimi]: "Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës".

[367] Në Aktgjykimin për Presidenten, siç po quhet në praktikë, Gjykata ka bërë me dije shumë qartë se Kapitulli II i Kushtetutës nuk mund të shikohet në mënyrë të izoluar nga Kapitulli III në vijim, i cili mbron të drejtat dhe liritë e bashkësive joshumicë në Kosovë. Për më tepër, Gjykata ka vënë në dukje se nuk janë vetëm këta dy kapituj që merren parasysh nga ajo me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese, por edhe parimet e vlerat e tjera të sanksionuara me Kushtetutë. Cf. paragrafët 61-68 të Aktgjykimit.

Kjo qasje e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës është në vijë të njëjtë me teorinë dhe me praktikën e Gjykatës Gjermane, e cila e sheh Ligjin Themelor të RF të Gjermanisë si një tërësi organike, një unitet strukturor të vlerave dhe të parimeve kushtetuese. Për komentet, Cf. Donald P. Kommers, "German Constitutionalism: A Prolegomenon", *Emory Law Journal* vol. 40, issue 1 (1991); Donald P. Kommers, *The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany*, 2nd ed. (Duke UP: Durham, 1997) fq. 3-60.

[368] Për analizë të gjatë e të detajuar të këtij paradoksi dhe për praktikat moderne në përgjigje të këtij paradoksi, cf. Martin Loughlin and Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism: Constituent Power and Constitutional Form* (Oxford UP: Oxford, 2007).

kushtetuese. Nga kjo kohë e tutje, asnjë kushtetutë nuk mund t'i shmangej këtij opsioni. Vlerat kushtetuese, të cilat një brez i sanksionoi me një shumicë të thjeshtë, bëhen transcendente në kuptim të mbijetimit të brezave. Ky mbijetim bëhet nëpërmjet futjes nga "brezi i shumicës së thjeshtë" të dispozitave për "shumicën e kualifikuar në mënyrë specifike", me të vetmin qëllim: pengimin e ndryshimeve kushtetuese që cenojnë (prekin) vlera sublime transcendente të krijuara nga "brezi i parë i shumicës së thjeshtë".[369] Në thelb, kjo qasje ka mbetur cilësia dalluese e demokracisë kushtetuese, e demokracisë joradikale dhe jopopulliste, në të cilën procedurat përkatëse sanksionojnë një përmbajtje liberale që respekton dinjitetin, të drejtat dhe liritë e secilit, pa marrë parasysh numrin dhe karakteristikat e tjera të subjektit të së drejtës.[370] Demokracia kushtetuese mbron shoqërinë nga ajo që John Stuart Mill (Xhon Stjuart Mill) e ka cilësuar si "tirania e shumicës", përkatësisht nga rreziqet e "sundimit demokratik" (Ronald Dworkin).[371]

Demokracia radikale/populliste, ndërkaq, është ajo formë e sistemit politik ku sovraniteti qëndron në popull, i cili supozohet se flet dhe vepron nëpërmjet një asambleje të gjithëpushtetshme. Ekzekutivi dhe organet e tjera politike sillen si satelitë të këtij trupi përfaqësues. Ky trup ka monopol për tërë aktivitetin vendimmarrës. Këto praktika radikale, siç na mëson historia, kanë degjeneruar në forma kaotike të *gouvernement d'assemblée* (rasti i Francës,

---

Kjo temë ka nxitur kureshtjen edhe të filozofëve dhe të studiuesve nga lëmenjtë e tjerë. Për elaborimet dhe për arsyetimet teorike-filozofike të këtij paradoksi, cf. debatet ndërmjet filozofëve dhe studiuesve në Norman Dorsen, Michel Rosenfled, Andras Sajo dhe Susanne Baer (eds.), *Comparative Constitutionalism: Cases and Materials* (West Group: USA, 2003) fq. 66-98.

[369] Cf. Andras Sajo, *Limiting Government: An Introduction to Constitutionalism* (CEU Press: Budapest, 1999) fq. 17-24 dhe 136-40. Për kritikë të ashpër të këtij koncepti të konstitucionalizmit modern nga C. Schmitt, cf. Carl Schmitt, *Legality and Legitimacy* (Duke UP: Durham, 2004) fq. 39-58. Në këtë shtjellim të gjatë, C. Schmitt e quan kapitullin e dytë të Kushtetutës së Vajmarit, e cila sanksiononte të drejtat e njeriut dhe ndryshimin e tyre me shumicë të kualifikuar, si "një kushtetutë të dytë brenda kushtetutës ekzistuese vajmariane".

Ai, në fakt, kapitullin vajmarian që përmbante dispozitat materiale për të drejtat e njeriut, e cilësonte si një antikushtetutë, sepse shumica e kualifikuar e dy të tretave kërkohej për ndryshimin e tyre. Sipas tij, kjo shumicë e kualifikuar kësisoj, në esencë paraqiste mohim të parimit themelor të demokracisë, e kuptuar sipas tij si sundim i shumicës.

[370] Për demokracisë liberale, të kuptuar si procedurë që ngërthen dhe garanton vlerat substanciale njerëzore, Cf. F.A. Hayek, *The Constitution of Liberty: The Definitive Edition* (Univ. Chicago Press: Chicago, 1960, 2011).

[371] Jeffrie G. Murphy, "Rationality and Constraints on Democratic Rule", në J. Ronald Pennock and John W. Chapman (eds.), *Justification: Nomos XXVIII* (New York UP: New York, 1986) fq. 141-143.

pas vitit 1789),[372] apo në hegjemoninë e një force politike, e cila ka sunduar prapa perdeve të skenës parlamentare. Rasti i dytë ishte karakteristikë e vendeve diktatoriale dhe jodemokratike, ku është ruajtur forma "parlamentare" e qeverisjes sa për sy e faqe. Çdo gjë ka filluar me Leninin dhe me doktrinën e tij për "parlamentin, si një trup punues"[373]. Më vonë, degjenerimet e tilla kanë qenë gati rutinë në shumicën e vendeve nga e ashtuquajtura Bota e Tretë (Amerika Latine, Azia Juglindore dhe Lindja e Mesme) gjatë kohës së Luftës së Ftohtë.[374]

Drejtësia kushtetuese, në kuptim të ngushtë, pra jo si pjesë e projektit madhor dhe kompleks të demokracisë kushtetuese dhe veprimit të përditshëm të institucioneve të saj, nuk arriti të dalë në sipërfaqe në Evropë deri me krijimin e republikave demokratike. Ndërkohë që, në ShBA, më 1803, Gjykata Supreme sanksionoi rolin parësor të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së akteve e të veprimeve të organeve të tjera të pushtetit, në Evropë, monarkia kushtetuese nuk linte hapësirë për drejtësi kushtetuese në kuptim të ngushtë: vetë sovrani kishte pushtet ekskluziv dhe kompetencë kushtetuese për moslejimin e kalimit të një akti legjislativ. Ideja e një gjykate kushtetuese nuk eci përpara, derisa monarkia kushtetuese nuk u zëvendësua me repu-

---

[372] M. Perry, M. Chase, J.R. Jacob, M.C. Jacob and Th.H. von Laue (eds.), *Western Civilisation: Ideas, Politics, and Society*, 10th ed. (Wadsworth Cengage Learning: Boston, 2013, 2009) kapitulli 19 ("The French Revolution: the Affirmation of Liberty and Equality"); Louis Favoreu, *Droit constitutional*, 12e ed. (Dalloz: Paris, 2009) fq. 8-12; Lucien Jaume, "Constituent Power in France", në Martin Loughlin and Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism: Constituent Power and Constitutional Form*, fq. 67-85; R.C. van Caenegem, *An Historical Introduction to Western Constitutional Law* (Cambridge UP: Cambridge, 1995) fq. 174-193.

[373] V.I. Lenin, *The State and Revolution* (Penguin Books: London, 1992) fq. 42. Për komente dhe shtjellime teorike të evoluimit të idesë dhe praktikës së parlamentarizmit, cf. Andras Sajo, *Limiting Goverment: An Introduction to Constitutionalism*, fq. 103-171.

[374] Për Amerikën Latine dhe parlamentet e tyre sa për sy dhe faqe ose liliput, si dhe për kultivimin e sistemeve hiperpresidenciale, cf. më shumë në Paul W. Darke, *Between Tyrany and Anarchy: A History of Democracy in Latin America, 1800-2006* (Stanford UP: Sanford, 2009) fq. 34-39. Për një analizë të shkëlqyer komparative të Evropës ish-komuniste dhe të Amerikës Latine, si dhe të rëndësisë së madhe që ka sistemi presidencial në Amerikën Latine, krahasuar me Evropën ish-komuniste, cf. Valierie Bunce, "Comparing East and South", në Larry Diamon and Marc F. Plattner (eds.), *Democracy After Communism* (John Hopkins UP: Baltimore, 2002) fq. 18-32. Ky autor, në faqet 28-29 të këtij shkrimi, mendon se debati aktual, që ekziston përkitazi me atë se cili sistem i qeverisjes duhet të ketë përparësi në Evropën postkomuniste, duhet të zgjidhet në favor të sistemit presidencial, sepse, sipas t-ij, ai sistem ofron më shumë efektivitet dhe mundësi praktike për zgjidhjen e problemeve të ish-vendeve komuniste.

blikën. Idesë në fjalë i parapriu një elaborim teorik, i cili theksonte nevojën e ekzistimit të një institucioni të tretë që do të kujdesej për vënien në jetë të parimeve themelore të demokracisë kushtetuese, përkatësisht të drejtësisë kushtetuese në kuptim të gjerë të fjalës. Këtu e kemi fjalën, në rend të parë, për debatin shtjellues teorik Schmitt–Kelsen. Siç mund të vërehet, ai debat, por edhe i tërë konteksti i drejtësisë kushtetuese në dy kuptimet e saj, të gjerë dhe të ngushtë, ka të bëjë, në pikat kyç, me themelet e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, që kontestohet sot. Jemi deri në fund të bindur se relevanca e këtij shkrimi nuk mund të kufizohet në rastin konkret kosovar. Relevanca në fjalë shtrihet më gjerë, ashtu siç ka qenë vetë debati Schmitt–Kelsen, i cili ka shërbyer si udhërrëfyes permanent i formës dhe i përmbajtjes së këtij shkrimi. Ka dhe një arsye tjetër që rreshtat e këtij shkrimi i bën relevant jashtë Kosovës: dilema për rolin dhe pozitën e Presidentit të Republikës së Kosovës është aktualizuar në kuadër të kontrollit abstrakt (jokonkret) dhe preventiv të normës kushtetuese.[375] U mor vesh, Hans Kelsen asnjëherë nuk e ka pasur parasysh "rolin e ligjvënësit negativ" të gjykatës kushtetuese në raport me amendamentet kushtetuese. Ky segment, pra i kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese, ka lindur pas Luftës së Dytë Botërore dhe lidhet, siç do të diskutohet më vonë, me teorinë dhe me praktikën gjermane, të bazuar në interpretimet e nenit 79.3 të Ligjit Themelor të Republikës Federale të Gjermanisë.

Preokupim themelor i Hans Kelsenit ka qenë qartësimi i iluzioneve nga e kaluara, të cilat thoshin se shefi i shtetit mund të jetë gardian i kushtetutës. Kelsen u angazhua, përkundrazi, për një garanci gjyqësore dhe më efektive të dispozitave, të parimeve dhe të vetë frymës së kushtetutës. Kjo nuk nënkupton, në asnjë mënyrë, se ai nuk ka qenë për një drejtësi kushtetuese në kuptim të gjerë. Krahas veprimit të përditshëm të institucioneve dhe të organeve të tjera kushtetuese, H. Kelsen i ka dhënë rëndësi edhe formës institucionale të garantimit dhe të mbrojtjes së rendit demokratik kushtetues. Kundërshtari kryesor i kësaj qasjeje, Carl Schmitt, besonte se gardiani i kushtetutës duhej kërkuar në vetë dispozitat e Kushtetutës së Vajmarit, që flisnin për presidentin e republikës, për zgjedhjen e tij nga populli dhe për kompetencat ligjvënëse nga neni 48 i Kushtetutës, përkatësisht në riinterpetimin e tyre pozitivist dhe pragmatik. Carl Schmitt kishte ardhur deri te ky pozicion nëpërmjet një

[375] Ky kontroll abstrakt (jokonkret) dhe preventiv i normës kushtetuese, njihet në publik si "procesi i amendamentimit të Kushtetutës", i cili ka filluar, siç u tha më herët, si pasojë e vënies në jetë të marrëveshjes politike të 6 prillit 2011.

interpretimi tepër kritik pozitivist të këtyre dispozitave, të cilat, sipas tij, sanksiononin dhe ushqenin një sistem parlamentar jofunksional. Teorinë e tij për gardianin e kushtetutës, pas ardhjes së Hitlerit në pushtet, Schmitt e bazon në interpretime të formës konkrete kushtetuese, pra jashtë dispozitave të Kushtetutës së Vajmarit.[376] Kjo, nga shkaku se, sipas tij, teoria në fjalë përgjithësisht nuk mund të zbulohej nga analizimi i normave juridiko-kushtetuese, por vetëm duke u bazuar në vendimin dhe në formën konkrete të një momenti.[377]

Duke kritikuar joefikasitetin e parlamentarizmit gjerman të kohës, Carl Schmitt gjeti në shefin e shtetit të vetmin institucion që mund të garantonte unitetin sociologjiko-politik të popullit gjerman. Meqenëse i vetmi ishte presidenti që zgjidhej nga populli, si i tillë, mendonte Schmitt, vetëm ai personifikonte vullnetin unik dhe homogjen të tërë popullit gjerman. Këtë nuk mund ta bënte, sipas tij, parlamenti plural, i ndarë dhe i copëzuar nga interesat partiako-politike të aktorëve të ndryshëm të shoqërisë vajmariane. Ai e shihte Kushtetutën e Vajmarit dhe formimin e Gjermanisë vajmariane si rezultat të një vendimi politik, të vetëm dhe unik, të shprehur nga i tërë kombi (populli) gjerman. Vullneti i tillë nuk mund të kishte natyrë plurale, përkatësisht nuk mund të realizohej nëpërmjet institucionit të parlamentit, të ndarë dhe të copëzuar nga interesat partiako-politike dhe nga interesat e tjera të aktorëve politikë. Me një parlament të tillë, sipas tij, nuk mbetej askush tjetër përveç presidentit të Rajhut që mund të përfaqësonte vendimin unik dhe të vetëm të tërë kombit (popullit) gjerman. Të shohim tani teknologjinë shmitiane sipas së cilës shefi i shtetit bëhet gardian i vetëm i Kushtetutës vajmariane.

---

[376] C. Schmitt, me një entuziazëm të pashoq, flet kundër ndarjes së pushteteve, sigurisë juridike, parashikueshmërisë së zbatimit të ligjit, si dhe prodhimeve të tjera të liberalizmit pozitivist, siç i quan ai vetë. Në vend të tyre, C. Schmitt angazhohet për udhëheqësin (Fyhrerin), si mishërim i tri gjërave në të njëjtën kohë: i shtetit, i kombit dhe i lëvizjes. Shteti, sipas këtij mishërimi, nuk është asgjë tjetër veçse një instrument në duart e udhëheqësit (Fyhrerit). Cf. Karl Šmit, *Tri vrste pravnonaučnog mišljenja* (Biblioteka Parerga: Beograd, 2003) fq. 34-42, 46-54; titulli në origjinal: Carl Schmitt, *Über die drei Arten des rechtswissenschaftlichen Denkens* (Hanseatische Verlagsanstalt: Hamburg, 1934).

C. Schmitt, me të drejtë është vërejtur në literaturë, tërë diskursin dhe angazhimin e tij e ka drejtuar kundër "rreziqeve të abstraksionit liberalist, formalizmit legal, *potestats indirecta* dhe shumë shprishjeve të tjera të koncepteve të shkaktuara nga liberalizmi (siç janë, ta zëmë, koncepti i depolitizimit, i largimit të interpretimeve teleologjike dhe historike nga politika, etj.)". Cf. William Hooker, *Carl Schmitt's International Thought: Order and Orientation* (Cambridge UP: Cambridge, 2009) fq. 126.

[377] Cf. Karl Šmit, *Tri vrste pravnonaučnog mišljenja*, fq. 16-17.

Pika nisëse e tij, në këtë qasje për shefin e shtetit si gardian i vetëm i kushtetutës, bazohet në teorinë e Benjamin Constantit për të ashtuquajturin *pouvoir neutre et intermédiaire*. Në shkrimin e tij, "Gardiani i Kushtetutës" (1929), Carl Schmitt kritikon ashpër teorinë e kohës që modelohej sipas sistemit amerikan, ku gjykatat e larta ishin mekanizmat primarë për mbrojtjen e kushtetutës. Në fakt, gjysma e parë e këtij shkrimi kritik, të gjatë mbi 50 faqe, i dedikohet kritikës së sistemit gjyqësor si mekanizëm për garantimin e kushtetutës.[378] Në pjesën tjetër, Schmitt shpjegon se gardian i kushtetutës mund të jetë vetëm ai organ apo ai institucion që është i furnizuar me kompetenca të veçanta, të cilat ia bëjnë të mundur që të jetë neutral, pra jashtë sistemit të vendosur vajmarian të tri pushteteve të ndara. Këtë pushtet të tretë dhe neutral, ai e sheh te shefi i shtetit, duke u bazuar në teorinë e shekullit XIX të Benjamin Constantit dhe në mësimet e tij për *pouvoir neutre et intermédiaire*. Këto autorizime të veçanta dhe neutrale i japin shefit të shtetit mundësinë e ndërmjetësimit në konfliktet e brendshme kushtetuese. Këtu flitet për autorizimet dhe për mundësitë që kanë të bëjnë me pozitën e privilegjuar të shefit të shtetit dhe me pacenueshmërinë e saj, me shpalljen e ligjeve, me të drejtën e faljes, me të drejtën e emërimit të ministrave dhe të zyrtarëve të tjerë shtetërorë, si dhe me shpërndarjen e dhomave të zgjedhura të parlamentit. Në *pouvoir neutre et intermédiaire* futej edhe rrethana se shefi i shtetit shihej si përfaqësues i kontinuitetit permanent të unitetit shtetëror dhe si garantues i vetëm i funksionimit unik të shtetit. Kjo rrethanë e dytë dilte, në fakt, si pasojë e autorizimeve dhe e privilegjeve presidenciale, të cilat e bënin të mundur kontinuitetin juridiko-shtetëror dhe funksionimin e pandërprerë të institucioneve të sistemit. Këto dualizma, sipas Schmittit, mundësonin që shefi i shtetit të udhëheqë (*regne*) dhe jo të qeverisë (*gouverne*). Kjo e dyta i takonte vetëm qeverisë. Këtu konsiston sintagma që thotë se *il regne et ne gouverne pas*.[379]

---

[378] Karl Šmit, "Čuvar Ustava", në Slobodan Samardžić (ed.), *Norma i odluka: Karl Šmit i njegovi kritičari* (Filip Visnjić: Beograd, 2001) fq. 211-253, në fq. 211-238; titulli i origjinalit: Carl Schmitt, "Der huter der verfasung", A*rchiv des offentlichen rechts*, Neue Folge 16 Band J.C.B. Mohr (Paul Siebeck: Tubingen, 1929).

Kritikën e tij për sistemin gjyqësor dhe pamundësinë totale të këtij sistemi për të qenë gardian i kushtetutës, C. Schmitt e kishte shtjelluar shumë më herët në librin e tij monumental, me titull *Teoria kushtetuese*. Cf. Carl Schmitt, *Constitutional Theory* (Duke UP: Durham, 2008) fq. 147-164; titulli i origjinalit: Carl Schmit, *Varfassungslehre* (Duncker und Humblot: Munich, 1928).

[379] Karl Šmit, "Čuvar Ustava", fq. 241-253.

Në shkrimin e tij polemizues, me titull "Kush duhet të jetë gardian i kushtetutës?" (1931), botuar si reagim ndaj shkrimit të mësipërm, Hans Kelsen sqaron se koncepti i Benjamin Constantit për *pouvoir neutre et intermédiaire* i referohet monarkisë dhe asnjëherë republikës parlamentare të tipit vajmarian. Sipas Benjamin Constantit, sqaron Kelsen, monarku ishte pjesë e ekzekutivit. Në fakt, vazhdon ai më tej, kur Benjamin Constant ka konstatuar se:

> monarku është bartës i një pushteti neutral, atëherë ai këtë thënie e ka mbështetur në faktin se ekzekutivi ndahet në dy pushtete të ndryshme: njëri pushteti aktiv, kurse tjetri pushteti pasiv. Vetëm ky i dyti i takon monarkut, sepse vetëm ky është pushtet neutral dhe assesi ana e tij aktive.[380]

Sipas Hans Kelsenit, ky nuk ka qenë dhe nuk mund të ishte rasti me shefin e shtetit në Gjermaninë e Vajmarit, sepse ai ka qenë pjesë aktive e ekzekutivit, si pasojë e kompetencave të mëdha që ka pasur sipas nenit 48 të Kushtetutës.[381] Këto kompetenca, në mënyrë të kulluar, i jepnin atij mundësinë dhe të drejtën për të qeverisur (*gouverner*), pra jo për të udhëhequr (*regener*) në sensin e elaboruar nga Benjamin Constant. Kështu, thotë Kelsen, një krahasim i tillë nga Schmitti është i pavend: sikur shefi i shtetit të caktohej për gardian të kushtetutës, atëherë ai do të shndërrohej në një diktator absolut, marrë parasysh kompetencat e njohura nga neni 48 i Kushtetutës (në veçanti kompetencat për ligjvënie në vend të Rajhstagut).[382] Hans Kelsen e quajti manipulim, keqkuptim dhe interpretim për qëllime ditore politike, që mëton të quhet shkencë juridike, interpretimin e dispozitës së nenit 48 të Kushtetutës së Vajmari të bërë nga Carl Schmitt.[383]

---

[380] Hans Kelsen, "Ko treba da bude čuvar Ustava", në Slobodan Samardžić (ed.), *Norma i odluka*, fq. 256-297, në fq. 265; titulli në original: Hans Kelsen, *Wer soll der huter der verfassung sein?* (Dr. Walther Rothschild: Berlin-Grunewald, 1931).

[381] Vlen të theksohet këtu se, në literaturë, me të drejtë është vërejtur që, në esencë, identiteti i C. Schmittit si konstitucionalist bazohet në avokimin e tij parezervë në favor të përdorimit të pushteteve (autorizimeve) nga neni 48 i Kushtetutës së Vajmarit nga Fyhreri. Këtë evokim, C. Schmitt e pati filluar qysh me veprën e tij monumentale, *Teoria kushtetuese* (*Verfassungslehre*) (1928). Cf. William Hooker, *Carl Schmitt's International Thought: Order and Orientation*, fq. 129.

[382] Hans Kelsen, "Ko treba da bude čuvar Ustava", fq. 262.

[383] Ibid. fq. 297. Krahasimi i shefit të shtetit të një republike parlamentare moderne me doktrinën e shekullit XIX të Benjamin Constantit është e pavend. Në shekullin XIX, kjo doktrinë ka pasur për qëllim kufizimin e forcës ekzekutive të monarkut dhe ndarjen e asaj force me përfaqësuesit e popullit (me parlamentin), pra jo me qëllim të ruajtjes së kushtetutës. Doktrina për monarkinë, e cila përmblidhet në shprehjen *il regne et ne gouverne pas*, ka pasur për qëllim kontrollin kushtetues të monarkut, pasivizimin dhe neutralizimin e anës aktive të

Vetëm kalimi i kohës e zgjodhi këtë mosmarrëveshje teorike me pasoja të mëdha praktike për drejtësinë dhe për gjyqësinë kushtetuese. Kjo, megjithatë, ndodhi vetëm pas një katastrofe të madhe njerëzore që solli Lufta e Dytë Botërore. Gjërat shkuan ashtu siç kishte parashikuar Hans Kelsen. Shefi i shtetit, në shumicën e vendeve të botës së sotme, luan një rol të çmuar në mbrojtjen e kushtetutës nëpërmjet ushtrimit të autorizimeve të anës pasive të pushtetit. Kjo nuk ndodh në të gjitha demokracitë kushtetuese, por vetëm në rastet kur ekziston një sistem parlamentar kushtetues. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se monopoli i ruajtjes së kushtetutës mbetet te shefi i shtetit, përkatësisht te drejtësia kushtetuese në kuptimin e gjerë të fjalës. Ai monopol i takon një institucioni tjetër, të ndarë nga pushtetet e tjera, i cili zakonisht nuk është pjesë e sistemit gjyqësor. Fjala është për gjykatën kushtetuese.

Assesi nuk do të thotë se, në terrenin politik, debati Schmitt–Kelsen për natyrën dhe për funksionin e pjesës pasive të pushtetit ka humbur nga vlera e vet fillestare. Kjo vërehet në faktin se teza e Schmittit për shefin e shtetit si pushtet neutral dhe ndërmjetësues (*pouvoir neutre et intermédiaire*) nuk është aktualisht krejt e pavlerë dhe pa një rëndësi praktike.[384] Në të njëjtën kohë, kjo në asnjë mënyrë nuk nënkupton se Carl Schmitt ka pasur të drejtë sa i përket substancës (përmbajtjes) së konceptit për shefin e shtetit si *pouvoir neutre et intermédiaire*. Trajtimi i substancës (përmbajtjes) së kësaj doktrine është objekt diskutimi i pjesës në vijim të këtij punimi. Kjo substancë (përmbajtje) e bën të qartë gjendjen dhe pozitën kushtetuese të shefit të shtetit sot, në Evropë dhe më gjerë, në sistemet e demokracive parlamentare kushtetuese.

3. Uniteti juridiko-kushtetues i popullit dhe dallimi i tij nga uniteti sociologjiko-politik

Cila, pra, është substanca (përmbajtja) e teorisë për *pouvoir neutre et intermédiaire*, e cila e bën atë të dallueshme nga origjina e vet shmitiane? Mbi të

---

pushtetit të vjetër ekzekutiv të monarkut absolut të kohës së para Revolucionit Francez të vitit 1789.

[384] Në Evropë, me përjashtim të Francës, bëhet një ndarje e qartë ndërmjet shefit të shtetit dhe shefit të ekzekutivit. Këto dy role luhen nga dy individë të ndryshëm. Në Evropë, me përjashtim të Francës, shefi i shtetit është ose monark ose president i zgjedhur dhe ka në mënyrë ekskluzive vetëm funksione përfaqësuese në sensin që *il regne et ne gouverne pas*. Cf. Jurg Steiner and Markus M.L. Crepaz, *European Democracies* (Pearson Education: USA, 2007) fq. 105-110.

gjitha, cila është relevanca praktike e kësaj teorie? Të kuptuarit e kësaj çështje mund të jetë komplet vetëm nëse kihen parasysh dy gjëra: *e para* ka të bëjë me esencën e debatit për gjyqësinë kushtetuese vajmariane, kurse *e dyta* i referohet natyrës së pushtetit krijues apo konstitutiv (*pouvoir constituant*) në rendin kushtetues vajmarian.

Në teoritë kushtetuese angleze e franceze, për vite të tëra, u krijuan koncepte e parime për të arsyetuar dhe për të shtjelluar konceptet bazë të së drejtës kushtetuese.[385] Për dallim nga këto, në Gjermaninë paravajmariane nuk ka pasur ndonjë debat teorik të veçantë dhe të stërholluar të tipit anglez apo francez: pushteti krijues, konstitutiv, gjendej në duart e princërve gjermanë, të cilët atë pushtet e ushtronin mbi bazën e një marrëveshjeje paraprake. Krahas kajzerit (mbretit) gjerman, mbretit të princërve, ekzistonte edhe Rajhstagu, parlamenti gjerman, i cili u krijua si përgjigje ndaj lëvizjeve populliste të fundit të shekullit XIX. Rajhstagu, megjithatë, nuk qeveriste sepse kishte një rol të kufizuar, kurse vetë qeveria nuk kishte asnjë përgjegjësi para këtij organi përfaqësues. Rajhstagu shërbente vetëm për të bërë presion publik mbi qeverinë, asgjë më shumë. Kjo zgjidhje kushtetuese paravajmariane, e cila në rendin kushtetues të kohës modelonte ndryshe pushtetin krijues (konstitutiv) monarkik nga pushteti krijues (konstitutiv) demokratik (popullor), dallonte shumë nga modeli anglez dhe francez. Kjo nuk do të thotë se ka munguar interesimi teorik gjerman për problemin e marrëdhënies ndërmjet formës kushtetuese dhe legjitimitetit politik.[386] Ky interesim, megjithatë, mori trajtim adekuat teorik e politik vetëm pas vitit 1919. Forma kushtetuese, e sanksionuar me Kushtetutën e Vajmarit, ka qenë ajo e një parlamentarizmi kushtetues, i cili, në të njëjtën kohë, nuk ka përjashtuar format e tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të vullnetit politik, si dhe formimin e organit kryesor shtetëror, presidentit të Rajhut, nëpërmjet zgjedhjeve të drejtpërdrejta. Koncepti vajmarian i demokracisë kushtetuese është bazuar në kultivimin e

---

[385] Për të drejtën angleze, cf. Scott Gordon, *Controlling the State: Constitutionalism from Ancient Athens to Today* (Harvard UP: Harvard, 1999), në veçanti kapitulli 7 ("The Development of Constitutional Government and Countervaillance Theory in Seventeenth: Century England") dhe kapitulli 9 ("Modern Britain"). Për të drejtën franceze, cf. Lucien Jaume, "Constituent Power in France", vepra cit., fq. 67-85; R.C. van Caenegem, *An Historical Introduction to Western Constitutional Law*, fq. 174-193.

[386] Cf. më shumë për këtë kapitullin e parë "Prologue: The Shattering of Methods in Late Wilhelmine Germany", botuar në Arthur J. Jacobson and Benrhard Schlink (eds.), *Weimar: A Jurisprudence of Crisis* (Univ. of California Press: Berkley, 2000) fq. 41-65; Michael Stolleis, *Public Law in Germany, 1800-1914* (Berghahn: New York, 2001), në veçanti kapitulli 8 ("General German Constitutional Law: The Doctrine of the Imperial State").

drejtësisë kushtetuese në kuptimin e gjerë, pra në ndarjen e pushteteve (ku gjyqësia e rregullt, me në krye Gjykatën e Rajhut, ka gëzuar një pozitë të privilegjuar) dhe në njohjen e një korpusi të të drejtave e të lirive njerëzore (Kapitulli II i Kushtetutës së Kosovës). Sipas çdo standardi, Kushtetuta e Vajmarit ka qenë një kushtetutë mjaft liberale. Debati teorik për formën kushtetuese vajmariane, ndërkaq, ka qenë pragmatik dhe është koncentruar kryesisht në rrënimin e saj. Kjo është kështu sepse një pjesë e madhe e doktrinës dhe e popullit gjerman e ka parë Kushtetutën e Vajmarit si "një rrobë false të shtetit të ri gjerman".[387] I kësaj provenience rrënuese të rendit kushtetues vajmarian, ka qenë edhe tërë diskursi shmitian.[388]

Në shikim të parë, debati Schmitt–Kelsen duket sikur ka të bëjë vetëm me rolin dhe me rëndësinë e krijimit të një gjyqi kushtetues sipas modelit çekosllovak-austriak të vitit 1920. Ai debat, megjithatë, prek vetë themelet e rendit kushtetues vajmarian dhe paraqet përpjekjen më sistematike për rrënimin e rendit (C. Schmitt), respektivisht për mbrojtjen e këtij rendi (H. Kelsen).

Duke dhënë kundërargumente se përse nuk duhet dhe nuk mund të këtë gjykatë kushtetuese, C. Schmitt theksonte se nuk mund të ketë gjykim të normave juridike, meqë gjykimi i referohet subsumcionit të një gjendjeje faktike që ka ndodhur në të kaluarën ndaj një norme të përgjithshme. Sipas tij, në gjyqësinë kushtetuese flitet për gjykimin e dy normave të përgjithshme, e kjo do të thotë që, nëse themelohet kjo gjykatë, atëherë duhet të ndodhë prishja e dallimit ndërmjet krijimit të normës, e cila ndodh në parlament, dhe zbatimit të saj, e cila kryhet nga gjykatat. Kjo është kështu sepse, sipas tij, në gjyqësinë kushtetuese bëhet "gjykimi" i një norme kundrejt një tjetre e kjo domethënë politikë dhe humbje e dallimit ndërmjet pushtetit legjislativ dhe atij gjyqësor meqenëse, në fund, gjykata (kushtetuese) mban të drejtën e anulimit të normës jokushtetuese.[389] Ky ishte argument i parë kundër gjyqësisë kushtetuese. Në fakt, duke luftuar krijimin e një gjykate të veçantë kushtetuese, C. Schmitt luftonte drejtësinë kushtetuese në kuptim të gjerë, sepse mbronte deri në fund parimin e unitetit të pushtetit me udhëheqësin (Fyhrerin) në krye të tij. Për të nuk paraqiste asnjë shqetësim nëse humbej dallimi ndërmjet krijimit dhe zbatimit të normës, si pasojë e krijimit eventual të një gjykate të veçantë kushtetuese, por sepse udhëheqësi (Fyhreri) si shef shteti më nuk do të

---

[387] Cf. Martin Loughlin and Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism: Constituent Power and Constitutional Form*, fq. 91.

[388] Cf. David Dyzenhaus, *Legality and Legitimacy: Carl Schmitt, Hans Kelsen and Herman Heller in Weimar* (Oxford UP: Oxford, 1997) fq. 51-58, 70-84.

[389] Cf. Karl Šmit, "Čuvar Ustava", fq. 211-239.

mund t'i ushtronte këto dy pushtete vetëm (krijimin dhe zbatimin e normës juridike).[390]

Argumenti i dytë, në vijim për sa më sipër, i referohet jo objektit të një gjykimi kushtetues, që ishte një normë ligjore, por vetë konceptit të gjykimit në fjalë. Sipas Carl Schmittit, ajo që quhej gjykim kushtetues në Gjermaninë vajmariane, ka pasur të bëjë vetëm me ato gjykime për kompetenca që mund të lindnin ndërmjet landeve (njësive federale), komunave dhe njësive të tjera brenda sistemit federal gjerman të kohës. Pra, vetëm gjykimet në nivel jofederal mund të cilësoheshin si gjykime kushtetuese. Për të qenë një gjykim kushtetues në nivelin e Rajhut gjerman, sipas tij, duhet të ndryshojë natyra e kushtetutës dhe e vetë shtetit të ri gjerman. Sipas C. Schmittit, ky lloj gjyqi kushtetues mund të ekzistojë vetëm nëse kushtetuta kuptohej si një kontratë, jo si një vendim unik i krejt popullit homogjen gjerman. Kur kushtetuta është kontratë, atëherë, mendonte ai, mund të formohet një gjykatë federale kushtetuese për të zgjidhur kontestet kushtetuese ndërmjet subjekteve përbërëse. Por, në rastin e Vajmarit, kjo nuk është kështu: Kushtetuta e Vajmarit, sipas Carl Schmittit, është vendim unik i krejt popullit homogjen gjerman. Populli gjerman, sipas tij, është një tërësi homogjene organike. Për këtë arsye, ideja e Hans Kelsenit për një gjykatë kushtetuese duhet të kuptohet si një përpjekje për të ndryshuar natyrën e shtetit gjerman, ku ai më nuk do të quhej si një demokraci e bazuar në kushtetutën e popullit gjerman unik dhe homogjen, por në një kontratë me një parlament të përçarë. Ky i fundit nuk përfaqësonte, sipas C. Schmittit, asgjë tjetër pos tërësinë e shumësisë së inter-

---

[390] Gjëja më e mirë që kishin sjellë nacional-socialistët, sipas Carl Schmittit, ishte vënia në jetë e parimit të udhëheqësit (Fyhrerit) dhe, bashkë me të, i koncepteve të tjera, siç ishin lojaliteti, ndjenja e verbër për ndjekje të udhëheqësit (Fyhrerit), si dhe disiplina e nderi. Këto koncepte mund të kuptohen vetëm nga rendi dhe nga shpirti konkret gjerman dhe jo nga ndonjë abstraksion normativ i bazuar në demokracinë kushtetuese liberale. Në këtë rend konkret, ekziston relacioni shtet-lëvizje-popull (gjerman). Në këtë relacion krijohet uniteti sociologjiko-politik i rendit, rend të cilit ligjvënësi nacional-socialist i jep formë dhe jetë konkrete gjermane. Fyhreri rri në krye të këtij rendi konkret gjerman. Me këtë, ky ligjvënës, po ashtu, i jep fund mendimit dhe praktikës pozitiviste të shtetit liberal vajmarian të bazuar në ndarjen e pushteteve. Cf. Karl Šmit, *Tri vrste pravnonaučnog mišljenja*, fq. 51-54.

Gjatë viteve 1933-1936, Carl Schmitt është marrë kryesisht me çështje dhe me probleme në lëmin kushtetues. Pas kësaj periudhe, ai intensifikoi krijimtarinë e tij në lëmin ndërkombëtar. Për kritikat e thella dhe sistematike të arsyetimit të diktaturës nacional-socialiste në periudhën e viteve 1933-1936, cf. David Dyzenhaus, "The Politics of the Question of Constituent Power", në Martin Loughlin and Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism: Constituent Power and Constitutional Form*, fq. 132-133; William Hooker, *Carl Schmitt's International Thought: Order and Orientation*, fq. 126-132.

esave johomogjene të shtresave të ndryshme gjermane. Në fakt, C. Schmitt, problemin kryesor e shihte te parlamenti gjerman dhe, si i tillë, paraqiste objektin kryesor të goditjes së tij.[391]

Argumenti i fundit kundër gjyqësisë kushtetuese bazohet, në vijim për sa më sipër, në mohimin e demokracisë kushtetuese parlamentare. Ky mohim bazohej në bindjen se Kushtetuta e Vajmarit paraqiste një vendim unik dhe të vetëm të krejt popullit unik dhe homogjen gjerman. Bartës i këtij vullneti, të kuptuar kështu, nuk mund të jetë parlamenti i përçarë, por organi tjetër, ai që zgjidhet nga populli me votën e drejtpërdrejtë të tij. Këtu bëhet fjalë për presidentin, jo për parlamentin gjerman. Kjo qasje paraqet zbatim të një logjike metafizike: një vendim unik i një populli unik e homogjen mund të zbatohet vetëm nga një organ i tillë — unik dhe homogjen. Uniteti dhe homogjeniteti i kombit (popullit) gjerman prezumohej. Vetëm marrja e vendimit nga ky komb (popull) duhej të ndodhte. Pikërisht presidenti, në vijim të këtij koncepti të C. Schmittit, mund ta reflektonte dhe ta ruante kushtetutën si një vendim sublim i kombit (popullit) unik dhe homogjen gjerman, assesi një gjykatë e veçantë kushtetuese. Pse presidenti? Sepse, sipas C. Schmittit, vetëm ai përfaqësonte dhe personifikonte vullnetin e krejt kombit (popullit) unik homogjen gjerman. Sipas Kushtetutës së Vajmarit, mendonte Schmitt, vetëm presidenti posedonte ato pushtete neutrale që i jepnin mundësinë për zgjidhjen e konflikteve kushtetuese dhe politike në nivel të Rajhut: vetëm presidenti është neutral, i tretë, i paanshëm dhe me pushtete kushtetuese neutrale, të cilat mundësojnë zgjidhjen e çdo konflikti shtetëror, politik dhe kushtetues brenda Rajhut.[392] "Integrimi funksional", i cili ndodh nëpërmjet zgjedhjeve, votimeve, koalicioneve zgjedhore etj., siç predikohej prej Rudolf Smendit dhe liberalëve të tjerë të kohës,[393] nuk i përshtatej këtij koncepti shmitian. Presidenti nuk përfaqësonte këtë integrim funksional, por vetëm kombin (popullin) organik e homogjen të integruar politikisht në një shtet të ri gjerman. Ky integrim politik po ndodh sepse, mendonte C. Schmitt, gjer-

[391] Për një analizë të shkëlqyer të pozicionit të Carl Schmittit kundrejt pozicionit të Hans Kelsenit, si dhe për sulmet e tij kundër parlamentarizmit gjerman, cf. David Dyzenhaus, *Legality and Legitimacy: Carl Schmitt, Hans Kelsen and Herman Heller in Weimar*, në veçanti kapitulli 1 ("Legality and Legitimacy: Reflections from Weimar") kapitulli 2 ("Friend and Enemy: Schmitt and the Politics of Law") dhe kapitulli 5 ("Lessons from Weimar: The Legitimacy of Legality").

[392] Karl Šmit, "Čuvar Ustava", fq. 239-252.

[393] Cf. Stefan Korioth, "Rudolf Smend", në Arthur J. Jacobson and Benrhard Schlink (eds.), *Weimar: A Jurisprudence of Crisis*, fq. 207-212; Rudolf Smend, "Constitution and Constitutional Law", në Arthur J. Jacobson and Benrhard Schlink (eds.), ibid. fq. 213-248.

manët po lëviznin drejt krijimit të shtetit total, ku do të humbiste çdo dallim ndërmjet shtetit dhe pjesës tjetër të shoqërisë që ekzistonte jashtë shtetit. Kjo nënkuptonte se shteti po bëhej total në kuptimin e gllabërimit të shoqërisë tjetër gjermane në të gjitha sferat: politike, ekonomike, sociale e kulturore. Në këto rrethana e në këto kushte, vetëm presidenti mund të ishte mbrojtës i kushtetutës, sepse vetëm ai përfaqësonte unitetin organik të kombit (popullit) gjerman.[394] Sipas këtij interpretimi shmitian, del se kombi (populli) gjerman gjithnjë prezumohet të jetë homogjen në pikëpamje sociologjiko-politike.

Duke e mbrojtur fuqishëm idenë e krijimit të një gjykate kushtetuese të veçantë dhe të ndarë nga tri pushtetet e tjera, Hans Kelsen ka dhënë argumente që i kanë qëndruar kohës. Në rend të parë, ai është mbështetur në formën parlamentare të sistemit kushtetues vajmarian. Këtë formë, assesi popullin gjerman si tërësi, ai e ka parë si personifikim të vullnetit origjinal të pushtetit konstitutiv (*pouvoir constituant*). Ky vullnet origjinal, krijues, i pushtetit konstitutiv, realizohet nëpërmjet institucioneve dhe organeve përkatëse kushtetuese si pushtete derivative (*pouvoirs constitué*), të krijuara nga pushteti konstitutiv. Në një demokraci kushtetuese, pushtetet janë të ndara dhe vetë presidenti vajmarian konsiderohej pjesë përbërëse e atyre pushteteve, meqë kishte jo vetëm pushtete pasive, të cilat C. Schmitt i cilësonte si pushtete neutrale, por edhe aktive, të cilat e bënin të pamundur që ai të shërbente si gardian i kushtetutës. Në esencë, thotë H. Kelsen, Kushtetuta e Vajmarit e ndan pushtetin ndërmjet dy faktorëve: parlamentit dhe qeverisë. Kjo e fundit ngërthente në vete edhe shefin e shtetit dhe ministrat e qeverisë, të cilët kundërfirmosnin aktet e tij.[395]

H. Kelsen fuqishëm ka kundërshtuar teorinë e C. Schmittit që theksonte se kombi (populli) gjerman është homogjen dhe se Kushtetuta e Vajmarit, në preambulën e saj, i referohej pikërisht këtij homogjeniteti. Ky homogjenitet, sipas C. Schmittit, rrezikonte të prishej nga pluralizmi i Rajhstagut, në të cilin ravijëzoheshin në pafundësi dhe pa kthim dallimet thelbësore ndërmjet shtetit dhe shoqërisë gjermane. Për të penguar prishjen (copëtimin) e këtij homogjeniteti, shoqëria gjermane po lëvizte drejt një integrimi tjetër jofunksional, integrim që bazohej në shtetin total. Instrumenti kryesor dhe leva lëvizëse drejt shtetit total ishte presidenti i Rajhut: ai dhe askush tjetër kishte detyrimin dhe mundësinë kushtetuese të personifikimit të vullnetit unik dhe homogjen të kombit (popullit) gjerman të integruar në tërësi në aspektin so-

[394] Karl Šmit, "Čuvar Ustava", fq. 244-253.
[395] Cf. Hans Kelsen, "Ko treba da bude čuvar Ustava?", fq. 282.

cio-politik. H. Kelsen, me një mjeshtëri të rrallë, vërejti se C. Schmitt po luftonte unitetin juridiko-kushtetues të popullit gjerman nëpërmjet ndërtimeve teorike, të nxjerra nga një interpretim momental pozitivist i Kushtetutës së Vajmarit. Në këtë ndërtim joreal, Schmitt po i jepte presidentit të Rajhut rolin e përfaqësuesit dhe personifikuesit të vetëm të vullnetit momental, unik dhe homogjen të tërë kombit (popullit) gjerman. Kushtetuta e Vajmarit ishte një vendim momental i këtij kombi (populli) gjerman, i kuptuar në këtë mënyrë. Ky fakt, që është vërejtur nga H. Kelsen, ka mjaftuar që C. Schmitt ta paraqiste presidentin e Rajhut si gardianin e vetëm të kushtetutës: zgjedhja e tij e drejtpërdrejtë garantonte se ai, dhe vetëm ai, mund t'i kundërvihej parlamentit, si simbol i ndarjes së shtetit nga shoqëria dhe, në të njëjtën kohë, të shërbente si garantues i "shtetit total", ku do të humbiste përgjithmonë dallimi ndërmjet shtetit dhe shoqërisë. Këtij koncepti, thuajse kuazibiologjik, H. Kelsen i kundërvihej me teorinë gjithnjë aktuale e moderne, e cila thotë se nuk ka unitet të popullit në kuptimin sociologjik dhe as fshirje të dallimit ndërmjet shtetit dhe shoqërisë: ai unitet në secilën kushtetutë është vetëm juridiko-kushtetues dhe, si i tillë, mbijeton dallimet socio-politike dhe dallimet e tjera në shtet dhe në shoqëri, duke paqësuar dallimet e tilla vetëm me rrugë institucionale dhe me organe të sistemit, të krijuara me kushtetutë e me ligje. Teorinë e Carl Schmittit për gjykatën kushtetuese si një fiksion, Hans Kelsen e rrëzon pikërisht me këtë që u tha këtu, pra me atë se uniteti i popullit në kuptimin sociologjiko-politik është fiksion metafizik që nuk mund të provohet në asnjë mënyrë dhe me asnjë mjet. Ajo që shefi i shtetit përfaqëson unitetin shtetëror, thotë Kelsen, nuk nënkupton asnjëherë dhe në asnjë mënyrë se bëhet fjalë për unitet material, sociologjik, por për një unitet juridiko-kushtetues të shtetit. Ky unitet, thotë më tutje Kelsen, nuk nënkupton se shefi i shtetit përfaqëson solidaritetin e interesave efektive në një kohë konkrete, por të kundërtën e tyre: kuptimi i saktë dhe i vërtetë i teorisë për *pouvoir neutre et intermédiaire* të shefit të shtetit është se ai duhet t'i fshehë (mbulojë) dhe të neutralizojë kundërthëniet radikale të interesave socio-politike, klasore dhe të interesave të tjera që përfaqësojnë partitë politike dhe aktorët e tjerë. Me një fjalë, shefi i shtetit nuk mund të jetë përfaqësues i interesave radikalisht të kundërta të aktorëve socio-politikë, socio-ekonomikë dhe socio-kulturorë në shoqëri dhe në shtet.[396]

Sikundër vërehet, C. Schmitt e bën çdo arsyetim nga një prizëm i demokracisë radikale, e kuptuar si sundim i shumicës, pra jo në kuptimin modern

[396] Ibid., fq. 285-289.

të demokracisë kushtetuese që bazohet në ndarjen dhe në balancimin e pushteteve, në sundimin e ligjit dhe në respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Kjo qasje e dytë, me gjyqësinë kushtetuese si garant dhe si mbrojtës i parimeve, i vlerave e i normave të konstitucionalizmit bashkëkohor, ekziston vetëm te H. Kelsen dhe përbën një pjesë mjaft të madhe të polemikës së tij me C. Schmittin dhe me autorët e tjerë të proveniencës konservative vajmariane.[397] Për këtë arsye, ka rëndësi të shohim te këta dy autorë raportin ndërmjet demokracisë radikale, e kuptuar si sundim i shumicës, me demokracinë kushtetuese dhe përbërësit e saj. Kjo, në esencë, nuk është asgjë tjetër veçse një anë tjetër e debatit të tyre për pushtetin krijues, origjinal, konstitutiv (*pouvoir constituant*) dhe pushtetit derivativ, joorigjinal, të konstituuar (*pouvoir constitué*) dhe për rolin e presidentit, si personifikues dhe si përfaqësues i unitetit juridiko-kushtetues të popullit, i cili, si i tillë, është i ndarë sipas shtresëzimeve të ndryshme socio-politike, ekonomike, kulturore e të tjera.

Esenca e diskursit të C. Schmittit, jo vetëm në polemikën me H. Kelsenin, qëndron në përpjekjen e tij të qëllimshme e sistematike për të mbajtur gjallë epërsinë e demokracisë radikale, e kuptuar si sundim i shumicës, me Fyhrerin në krye të saj.[398] Demokracia kushtetuese, siç u vërejt më herët në këtë

---

[397] Cf. përveç kapitujve nga fusnota 72 e më lart, edhe kapitullin 3 ("The Pure Theory in Practice: Kelsen's Science of Law") nga libri David Dyzenhaus, *Legality and Legitimacy: Carl Schmitt, Hans Kelsen and Herman Heller in Weimar*. Nuk ka asnjë dyshim se vepra kryesore e Hans Kelsenit, që sublimon tërë esencën e diskursit të tij për gjyqësinë kushtetuese, është *General Theory of Law and State* (Lawbook Exchange Ltd.: Clark, New Jersey, 2007, 2009). Kjo, në fakt, është riformulim i përmbledhur i librit të tij, *Pure Theory of Law* (Lawbook Exchange Ltd.: Clark, New Jersey, 2002, 2009). Botimet e para të këtyre dy librave kanë parë dritën para se të zhvillohej polemika me Carl Schmittin, në gjuhë dhe me tituj pak më të ndryshëm.

[398] Përveç shkrimeve të përmendura deri më tash në këtë punim, vlen të theksohen edhe këto shkrime të Carl Schmittit, në të cilat ai, në mënyrë sistematike, angazhohet për demokraci radikale dhe kundër demokracisë kushtetuese: Carl Schmitt, *Political Theology: Four Chapters on the Concept of Sovereignty* (Univ. of Chicago Press: Chicago, 1985) ; Carl Schmitt, *Political Romanticism* (MIT Press: Massachusetts, 1986); Carl Schmitt, *The Crisis of Parliamentary Democracy* (MIT Press: Massachussets, 1988); Carl Schmitt, *Roman Catholicism and Political Form* (Greenwood Press: Westport, 1996); Carl Schmitt, *The Concept of the Political* (Univ. Chicago Press: Chicago, 1996, 2007); Carl Schmitt, *Theory of the Partisan* (Telos Press: New York, 2007); Carl Schmitt, *The Leviathan in the State Theory of Thomas Hobbes* (Univ. Chicago Press: Chicago, 2008); Carl Schmitt, *Political Theology II: The Myth of the Closure of Any Political Theology* (Polity Press: USA, 2008). Shumica e këtyre veprave janë botuar në kohën e Gjermanisë vajmariane, në gjuhën gjermane. Për kritikat e diskursit shmitian të kësaj kohe, cf. David Dyzenhaus (ed.), *Law as Politics* (Duke UP: Durham,

shkrim, paraqet sinonim të drejtësisë kushtetuese në kuptimin e gjerë të fjalës. Për të ruajtur këtë vijë arsyetimi, pra të epërsisë së demokracisë radikale, e kuptuar si sundim i shumicës, kundrejt demokracisë kushtetuese në kuptim të gjerë të fjalës, Carl Schmitt ka një shtjellim me një arsyetim të veçantë të kufizimeve të pushtetit shtetëror, kufizime që ai i gjen në dispozitat e Kushtetutës së Vajmarit për të drejtat e njeriut dhe për balancimin e pushteteve. Të parat, ai i sheh si kufizime, të cilat në thelb burojnë nga vendimi konkret konstitutiv i kombit (popullit) unik homogjen gjerman, i cili ka thënë se individët duhet t'i gëzojnë këto të drejta në një mënyrë të caktuar, kurse të dytat kufizime i sheh si të bazuara mbi ekzistimin e supozuar të një pushteti unik dhe të pandarë, nga i cili më pastaj burojnë kompetencat në dobi të degëve të caktuara të pushtetit.

Këto dy lloje të dispozitave, C. Schmitt i quan ide të shtetit liberal, të cilat synojnë neutralizimin e çdo veprimi politik. Ky neutralizim buron në shtetin liberal, nga një interpretim i Kushtetutës së Vajmarit, i cili është qëllimisht normativ, jopolitik dhe josociologjik. Kjo nënkupton se çdo pjesë e pushtetit shtetëror rregullohet me norma juridiko-kushtetuese dhe ligjore, ashtu që nuk mund të ketë vend për aksion politik të tipit të demokracisë radikale. Thënë shkurt, jashtë normave juridiko-kushtetuese e ligjore, nuk ka veprim politik të subjektit, i kuptuar si popull shumicë, i cili ushtron pushtetin krijues (origjinal, konstitutiv).[399] Kjo do të thotë se C. Schmitt, për dallim nga H. Kelsen, i sheh këto dy çështje (të drejtat e njeriut dhe ndarjen e balancimin e pushteteve) si neutralizim të demokracisë radikale, sepse e zëvendësojnë aksionin politik të subjektit popull, i kuptuar si shumicë, me aksionin politik në emër të subjektit të tillë.

Në teorinë dhe në praktikën kushtetuese të tipit kelsenian, megjithatë, pranohet se populli, si subjekt, vetë kurrë nuk është i pranishëm në veprimin politik konstitutiv (krijues, origjinal).[400] Një akt i tillë mund të identifikohet si akt i subjektit, i kuptuar si popull, vetëm duke qenë e mundur që akti në fjalë t'i atribuohet (mvishet) subjektit popull-shumicë, akt që realizohet

---

1998); Alberto Predieri, *Carl Schmitt, un NAZISTA senza CORAGGIO* vol. I & II (La Nuova Italia Editrice: Firenze, 1998-1999).

[399] Cf. Carl Schmitt, *Constitutional Theory*, fq. 200 e tutje; Hans Kelsen, "On the Essence and Value of Democracy", në Arthur J. Jacobson and Bernhard Schlink (eds.), *Weimar: A Jurisdprudence of Crisis*, fq. 154-155, 291-292.

[400] Cf. analizën elokuente krahasuese të kësaj çështjeje, në Hans Lindahl, "Constituent Power and Reflexive Identity: Towards an Ontology of Collective Statehood", në Martin Loughlin and Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism: Constituent Power and Constitutional Form*, fq. 9-24.

nëpërmjet organeve apo përfaqësuesve të këtij subjekti. Në terma kushtetues, ky veprim që i atribuohet (mvishet) subjektit popull-shumicë, por që ndërmerret nga organet apo nga individët që përfaqësojnë pushtetin konstitutiv (krijues, origjinal), paraqet kushtin minimal për mbrojtjen e individit (segmenti i mbrojtjes së të drejtave të njeriut) dhe ushtrimin e pushtetit në kuptimin modern kushtetues (segmenti i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve). Shikuar nga ky kuptim, demokracia kushtetuese nuk e neutralizon veprimin politik të subjektit popull-shumicë. Ajo, e kuptuar si tërësi e dispozitave dhe e praktikave për të drejtat e njeriut dhe për ndarjen e balancimin e pushteteve, nuk bën asgjë tjetër veçse garanton kushtet institucionale për veprim politik në emër të subjektit (i kuptuar si popull, që nuk është as shumicë e as pakicë, por thjesht subjekt-popull). Kushdo që flet në emër të popullit duhet ta ketë parasysh se demokracia kushtetuese jep dhe garanton formën institucionale të identitetit kolektiv dhe individual, mbi të cilin mbështetet një shoqëri moderne demokratike. Thënë ndryshe, demokracia radikale, e kuptuar si sundim i shumicës, "kullohet" nëpërmjet filtrave që përbëjnë demokracinë kushtetuese, si dhe veprimeve të cilat qartë mund t'i atribuohen (mvishen) subjektit i kuptuar si popull (që nuk është as shumicë e as pakicë, por thjesht subjekt-popull). Ky atribuim (mveshje) del si pasojë e veprimeve të organizuara të individëve që përfaqësojnë subjektin e tillë. Dispozitat kushtetuese për ndarjen dhe për balancimin e pushteteve dhe ato për të drejtat e njeriut paraqesin "filtrat" kryesorë që zbusin parimin e demokracisë radikale, e kuptuar si sundim i shumicës, dhe janë vetë baza mbi të cilën mbështetet uniteti juridiko-kushtetues i popullit, i kuptuar si subjekt.

Dispozita të tilla përmbajnë të gjitha kushtetutat evropiane dhe ato të vendeve të tjera të modeluara sipas modelit të konstitucionalizmit perëndimor. Kosova nuk përbën përjashtim nga kjo: nenet 4.3 dhe 83 të Kushtetutës flasin për këtë lloj të unitetit juridiko-kushtetues, të cilin e përfaqëson presidenti i Kosovës, kurse çdo veprim i autorizuar nga dispozitat kushtetuese të nenit 84 të Kushtetutës nuk përbëjnë veçse veprime të cilat mund t'i atribuohen (mvishen) presidentit të Kosovës.[401] Presidenti, thotë Kushtetuta në nenin 83, "është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës

[401] Në nenin 84 të Kushtetutës së Kosovës janë paraparë 30 lloj kompetencash, të cilat i takojnë Presidentit të Republikës. Dy të parat, jo rastësisht, sërish përsërisin tekstin e dispozitave të neneve 4.3 dhe 83 të Kushtetutës. Pra, që në fillim të përcaktimit të kompetencave të Presidentit të Republikës, në dy paragrafët e parë ritheksohet se ai/ajo është përfaqësues i Republikës së Kosovës, brenda dhe jashtë, si dhe garantues i funksionimit kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë.

së Kosovës". Dispozitat kushtetuese nga neni 84 janë dispozita autorizuese në sensin që çdo veprim i ndërmarrë në vijim të zbatimit të tyre cilësohet si atributiv, pra mund t'i mvishet presidentit. Kjo cilësi buron nga neni 84 i Kushtetutës, i cili i operacionalizon dhe u jep kuptim dispozitave të neneve 4.3 dhe 83 të Kushtetutës, me të cilat definohet rëndësia dhe roli primar i kreut të shtetit kosovar. Por, dispozitat në fjalë nuk mund të shikohen të izoluara, sepse ato autorizojnë veprime që mund t'i atribuohen (mvishen) presidentit vetëm atëherë kur ushtrohen brenda kuadrit kushtetues dhe në frymën e parimeve e të normave të tjera për ndarjen e për balancimin e pushteteve, për sundimin e ligjit dhe të demokracisë, si dhe të respektit për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve. Këto parime e norma gjenden të sanksionuara në Kapitullin I (Dispozitat Themelore), në Kapitullin II (Të Drejtat dhe Liritë Themelore) dhe në Kapitullin III (Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre) të Kushtetutës. Çdo ushtrim i pushtetit dhe çdo veprim politik që kryhet, mund t'i mvishet (atribuohet) popullit të Kosovës vetëm atëherë kur ushtrohet në respektim të këtyre kapitujve të Kushtetutës. Kjo vlen edhe për presidentin e Kosovës, i cili përfaqëson dhe mishëron unitetin juridiko-kushtetues të popullit të Kosovës si tërësi, me kusht që autorizimet nga neni 84 i Kushtetutës kryhen brenda kuadrit kushtetues të këtyre tre kapitujve.

4. Kushtetutat mbrojnë shefin e shtetit, jo individin *ad hominem*

Ideja e kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese tingëllon paradoksale në sensin që, në këto raste, bëhet kontrolli kushtetues i një propozim-norme kushtetuese, duke e krahasuar me një normë tjetër kushtetuese, e cila gjendet në tekstin fillestar (origjinal) kushtetues. Kjo, vetvetiu, hap dilema kuptimore, sepse vetë ideja e drejtësisë kushtetuese, në kuptim të ngushtë të fjalës, e konceptuar nga H. Kelsen, konsiston në kontrollin kushtetues të normës ligjore, si normë më e ulët se norma kushtetuese, për të parë nëse norma e tillë ligjore është në pajtim (harmoni) me normën kushtetuese, si normë më e lartë për nga fuqia juridike në hierarkinë e përgjithshme të normave. Megjithatë, ky lloj kontrolli kushtetues jo vetëm që ekziston por, në disa vende (si p.sh., në ShBA), është më i vjetër sesa vetë kontrolli kushtetues i ligjeve.[402]

[402] Vendimi i parë i Gjykatës Supreme përkitazi me kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese është marrë më 1798, në rastin *Hollingsworth v. Virginia*, pesë vjet para rastit *Marbury v. Madison* (1803), me të cilin u themelua praktika e kontrollit kushtetues të ligje-

Arsyeja kryesore dhe e vetme për ekzistimin e këtij lloji të kontrollit kushtetues qëndron në faktin se, në mjaft raste, kushtetutat përmbajnë parime e dispozita që konsiderohen si të paamendamentueshme. Kjo do të thotë se, parimet e dispozitat e tilla, në asnjë rast nuk mund të jenë objekt amendamentimi. Këto parime e dispozita, të cilat nuk mund të jenë objekt amendamentimi në asnjë rast apo rrethanë, u cilësuan me emra të ndryshëm nga teoria kushtetuese. Kjo u tha në pjesën e parë të këtij shkrimi. Këtu mjafton të thuhet se termi i përdorur për herë të parë, me qëllim të tregimit të parimeve dhe të dispozitave kushtetuese që nuk mund të amendamentohen, ka qenë "dispozitat e rrënjosura" (*entrenched provisions*) dhe është futur në përdorim nga vetë C. Schmitt para Luftës së Dytë Botërore.[403] Në Evropë, pas Luftës së Dytë Botërore, koncepti për "dispozitat e rrënjosura" (*entrenched provisions*) u rikrijua nga doktrina gjermane.[404] Tashmë u theksua më herët se, në një mënyrë krejt paradoksale, ka qenë Carl Schmitt prapa idesë së tekstit nga dispozita 79.3 e Ligjit Themelor të Republikës Federale të Gjermanisë, nen ky në të cilin u mbështet teoria dhe praktika gjermane për parimet dhe për dispozitat e paamendamentueshme kushtetuese. Nganjëherë kjo cilësohet si teoria dhe praktika për "amendamentet jokushtetuese në kushtetutë" (*unconstitutional constitutional amandements*).[405]

---

ve. Cituar në Kemal Gözler, *Judicial Review of Constitutional Amendments: A Comparative Study* (Ekin Press: Bursa, 2008) fq. 29.

[403] Ai përdori këtë term, siç u tha më herët në këtë shkrim, në një analizë të tij për Kapitullin II të Kushtetutës së Vajmarit, ku sanksionoheshin të drejtat dhe liritë e gjermanëve. Këto "dispozita të rrënjosura", sipas tij, paraqisnin kushtetutën e dytë të Gjermanisë (krahas Kushtetutës së Vajmarit). Pse? Sepse, mendonte ai, ky kapitull kufizonte ushtrimin e pushtetit shtetëror të presidentit të Rajhut dhe të qeverisë së tij, meqenëse krijonte detyrime shtesë dhe të veçanta për këto organe, e në favor të gjermanëve. Cf. Karl Šmit, "Legalnost i Legitimnost", fq. 323-336. Për më shumë komente nga autorët tjerë, cf. Ulrich K. Preuss, "The Implications of 'Eternity Clauses': The German Experience", në *Israel Law Review* vol. 44, no. 3 (2012).

[404] Rasti i parë në praktikë ka ndodhur më 23 tetor 1952 dhe njihet me emrin *SouthWest*. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë ka theksuar se ekzistojnë disa parime e vendime të cilave i nënshtrohen dispozitat e tjera kushtetuese dhe të cilat nuk mund dhe nuk guxojnë të cenohen në asnjë rast. Cf. Kemal Gözler, *Judicial Review of Constitutional Amendments: A Comparative Study*, fq. 55-56, 84-86; Donals P. Kommers, "German Constitutionalism: A Prolegomenon", fq. 858-859, fusnota 60.

[405] Kushtetuta e ShBA-së, në nenin V, flet për ndalimin e çfarëdo amendamenti që cenon të drejtën e votës së barabartë të shteteve anëtare, kurse Kushtetuta e Norvegjisë, e vitit 1814, në nenin 112 të saj, flet për ndalimin e çfarëdo amendamentimi që bie ndesh me parimet dhe me shpirtin e tekstit origjinal kushtetues. Cf. më shumë për këtë në: Kemal Gözler, *Judicial Review of Constitutional Amendments: A Comparative Perspective*, fq. 10-12, 28-34, 78-

Kjo teori, dhe praktika e bazuar mbi të, duhet të dallohen nga pengesat procedurale kushtetuese, të cilat vështirësojnë dukshëm, nganjëherë edhe e bëjnë të pamundshëm, amendamentimin e kushtetutës. Në këso raste, pa pasur një konsensus substancial brenda shoqërisë, nuk mund të ndodhë amendamentimi kushtetues. Këto pengesa, për herë të parë, janë sanksionuar në nenin V të Kushtetutës Amerikane të vitit 1787 dhe, më pastaj, janë bartur nëpër kushtetutat e vendeve të tjera, por janë rimodeluar në mënyra të ndryshme. Këto dispozita procedurale paraqesin kuptimin e "kushtetutës rigjide", e cila u diskutua më herët. Në rastin e teorisë dhe të praktikës për parimet dhe për dispozitat e paamendamentueshme, megjithatë, bëhet fjalë për parime dhe për dispozita që gjenden në pjesët materiale të kushtetutës. Si të tilla, ato vetvetiu nuk mund të jenë objekt amendamentimi. Dispozitat procedurale, që paraqesin kuptimin e "kushtetutës rigjide", përkundrazi, mund të ndryshohen nëse ndjekin procedurën e paracaktuar kushtetuese. Ky dallim, siç shihet, është mjaft i madh, sepse, derisa të parat nuk mund të ndryshohen fare, në rastin e dispozitave procedurale kushtetuese, ndryshimi nuk përjashtohet nëse ndiqet një procedurë e paracaktuar kushtetuese.

Në vijim për sa më sipër, së dyti, këto parime e dispozita të paamendamentueshme janë vetë identiteti kushtetues i një vendi, vetë "ADN"-ja e tij, pa të cilat vetë kushtetuta nuk ka asnjë kuptim. Parimet dhe dispozitat, të cilat nuk mund të ndryshohen asnjëherë dhe në asnjë rrethanë, zakonisht i referohen formës republikane të qeverisjes, raportit ndërmjet qendrës dhe periferisë shtetërore, laicitetit të shtetit, demokracisë kushtetuese, sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut etj. I tillë është rasti, ta zëmë, i Gjermanisë, i Francës, i Turqisë, i Norvegjinë, i Portugalisë, i Rumanisë, i Ukrainës, i Azerbajxhanit, i Afrikës së Jugut dhe i mjaft shteteve të tjera. Këtu e kemi fjalën për vendet që kultivojnë demokraci kushtetuese të modeluar sipas konstitucionalizmit perëndimor, sepse ka vende të tjera, ta zëmë Maroku, në të cilin, si dispozita të paamendamentueshme, janë ato që kanë të bëjnë me ruajtjen e rolit primar të islamit në shoqëritë e këtyre vendeve.[406]

80; Lechh Garlicki and Zofia A. Garlicka, "Review of Constitutionality of Constitutional Amendments (An Imperfect Response to Imperfections)", *Journal of Constitutional Law/Review De Droit Constitutionnel* vol. 1, issue 1 (2012) fq. 205, fusnota 46.

[406] Jo vetëm Maroku, por edhe shumë vende islamike, kanë të njëjtin modelim të dispozitave kushtetuese të pandryshueshme dhe i referohen kryesisht rolit primar të fesë islame në shoqëritë e tyre. Cf. Amina El Messaoudi, "Il Modelo di Giustizia Costituzionale in Marocco", në Luca Mezzeti, *Sistemi e Modeli di Giustizia Costituzionale*, Tomo II (CEDAM: Padova, 2011).

Së treti, vetë ekzistimi i këtyre parimeve e i dispozitave të paamendamentueshme kushtetuese, gëzon mbrojtje gjyqësore në sensin që çdo amendament kushtetues i cili bie ndesh me to shpallet antikushtetues nga gjykata respektive. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se kontrolli kushtetues i amendamenteve ekziston vetëm në ato vende ku kushtetutat përmbajnë parime dhe dispozita të paamendamentueshme dhe anasjelltas. Ka raste kur teksti origjinal ekzistues kushtetues përmban parime dhe dispozita kushtetuese që nuk mund të amendamentohen, por që në praktikë kurrë nuk ka ndodhur kontrolli i amendamenteve kushtetuese. I tillë është rasti, ta zëmë, me Kushtetutën e Norvegjisë, të vitit 1814. Njëjtë me këtë, ka raste kur fare nuk ekzistojnë parime dhe dispozita kushtetuese, të cilat nuk mund të amendamentohen, por që, në praktikë, gjykatat respektive kanë zhvilluar një praktikë gjyqësore për lakmi dhe tepër të pasur. I tillë është rasti, ta zëmë, i Indisë.

Së fundi, rasti i kontrollit kushtetues të amendamenteve është kontroll abstrakt i normës juridiko-kushtetuese, pra nuk i referohet zbatimit të saj në një rast konkret, por ndaj të gjitha rasteve të kohës që vjen. Në pjesën dërrmuese të shteteve, kontrolli abstrakt i normës juridiko-kushtetuese kryhet vetëm *a posteriori*, pra pasi të ketë hyrë në fuqi norma juridiko-kushtetuese e përmbajtur në amendament. Përjashtimet janë të rralla, siç u theksua më herët, kur kontrolli kushtetues i amendamenteve kryhet para se ato të hyjnë në fuqi. Në këtë përjashtim, në Evropë, bën pjesë edhe Kosova, kurse jashtë Evropës Kili, Afrika e Jugut, Azerbajxhani etj.

Në vijim të zbatimit të dispozitës kushtetuese të neneve 113.9 dhe 144.1 të Kushtetutës së Kosovës, të cilat parashohin si të detyrueshëm dërgimin për kontroll kushtetues të çdo amendamenti kushtetues, ka lindur edhe "çështja e Presidentes Jahjaga". Kontestimi i legjitimitetit të saj nuk është juridiko-kushtetues, por është politik, dhe bazohet në bindjen se "ajo nuk përfaqëson vullnetin politik të popullit të Kosovës", kurse Gjykata Kushtetuese, sipas kontestuesve, ka gabuar kur ka thënë se "populli i Kosovës pret që presidentja të jetë përfaqësuese e tyre për pesë vjetët e ardhshëm".

Ky shkrim trajton vetëm anën jopolitike të "çështjes së Presidentes Jahjaga", pra atë që ka të bëjë me sqarimin komparativ të kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të amendamenteve, të cilin Gjykata e kryen në bazë të neneve 113. 9 dhe 114.1 të Kushtetutës së Kosovës. Politikës ditore dhe aktorëve të saj i lihet liri e plotë e gjykimit në kontestimet reciproke politike *ad hominem*. Këto kontestime, në asnjë mënyrë, nuk mund ta zbehin esencën e teorisë dhe të praktikës për "amendamentet jokushtetuese në kushtetutë" dhe për zbatimin e saj "në rastin konkret të presidentes Jahjaga".

Në rastin e Kosovës, kjo teori dhe praktikë, mbështet vetëm te një fjali, e cila thotë se çdo amendament në Kushtetutën e Kosovës duhet të shkojë në Gjykatën Kushtetuese për kontroll gjyqësor, për të parë nëse amendamenti i propozuar zvogëlon të drejtat nga Kapitulli II i Kushtetutës. Kjo do të thotë se, në praktikë, Kapitulli II i Kushtetutës është "ADN"-ja e Kushtetutës së Kosovës, vetë identiteti i saj si shtet sovran e i pavarur. Çdo kontroll gjyqësor i amendamenteve si më sipër, bëhet *in abstracto,* duke i marrë parasysh vetëm kriteret e gjykimit profesional abstrakt, të cilat vlejnë çdoherë, për këdo dhe në çdo rast apo rrethanë në të ardhmen. Kjo do të thotë se Gjykata Kushtetuese fare nuk ka mundur të marrë parasysh se çfarë ka qenë forma dhe përmbajtja e marrëveshjes politike, e as kush dhe si është bërë president i Kosovës në vijim të zbatimit të marrëveshjes. Këto aspekte kanë qenë dhe janë objekt diskutimi i politikës kosovare, jo i Gjykatës Kushtetuese.

Të shohim, pra, në pak më shumë detaje, çfarë ka thënë Gjykata Kushtetuese e Kosovës me rastin e kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të amendamenteve kushtetuese, të propozuara nga grupi i 30 deputetëve të Kuvendit të Kosovës, gjatë muajve mars dhe maj të vitit 2012.

Gjykata, në asnjë rast, nuk është marrë me anën politike të "çështjes Jahjaga". Fjala ka qenë dhe është për kontroll kushtetues abstrakt dhe preventiv (paraprak) të amendamenteve kushtetuese, 11 (njëmbëdhjetë) sish, të propozuara në vitin e katërt të jetës së Kushtetutës së Kosovës. Ky Aktgjykim është i dyti i llojit të vet në praktikën e Gjykatës.[407] Është abstrakt dhe fare nuk lidhet me emër, me situatë konkrete apo me rrethana të rastit konkret dhe të pranishëm. Një qasje e tillë e Gjykatës del nga vetë dispozitat kushtetuese për kontrollin preventiv (paraprak) të propozim-amendamenteve kushtetuese. Këto dispozita mandatojnë Gjykatën që të ushtrojë këtë lloj kontrolli, duke pasur parasysh çdoherë vetëm Kapitullin II të Kushtetutës, u mor vesh, pa u kufizuar në mënyrë dogmatike vetëm në atë kapitull. Një kufizim i tillë është tërësisht i pamundur për shkak të, siç u tha më herët, asaj që në teorinë dhe në praktikën gjermane njihet si lidhje organizative dhe strukturore e dispozitave kushtetuese, të marra në tërësinë e tyre. Kjo është krejt normale, nëse kihet parasysh teoria për "ADN"-në e secilës kushtetutë, pra teoria për dispozitat dhe për parimet e pandryshueshme që e përshkojnë çdo "qelizë" të tekstit kushtetues dhe vetë shpirtit (frymës) së tij.

---

[407] Rasti i parë i kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) i amendamenteve kushtetuese ka qenë pak para këtij që diskutohet këtu: më 15 maj 2012, Gjykata vendosi për kushtetutshmërinë e amendamenteve të propozuara kushtetuese me të cilat konstitucionalizohej fundi i mbikëqyrjes së pavarësisë, ashtu siç e kishte thënë Plani Ahtisari në dispozitat e tij.

Në vijim të ushtrimit të këtij juridiksioni, Gjykata u ndesh, *inter alia*, edhe me vlerësimin e amendamentit 10 (dhjetë), i cili propozonte që shefi aktual i shtetit kosovar të linte detyrën dhe të shkonte në shtëpi, domethënë të shkarkohej nga detyra nëpërmjet një amendamenti kushtetues të kësaj legjislature kosovare. Verdikti profesional i Gjykatës, i cili buron nga silogjizmi (subsumcioni) gjyqësor i propozim-amendamentit 10 kundrejt tekstit në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, tha se asnjë president, në asnjë rast dhe në asnjë rrethanë, nuk mund të mënjanohet nga detyra përveçse duke i ndjekur procedurat kushtetuese të parapara në nenin 91 të Kushtetutës së Kosovës.[408] Amendamenti në fjalë, siç u tha më herët, zvogëlonte të drejtat njerëzore nga Kapitulli II i Kushtetutës, jo të drejtat konkrete të presidentes aktuale të Kosovës. Thënë shkurt, propozim-amendamenti 10 në Kushtetutën e Kosovës cenonte (prekte) seriozisht "ADN"-në e Kushtetutës, pra jo të drejtat konkrete të shefit *ad hominem* të shtetit kosovar, domethënë të drejtat e Presidentes Atifete Jahjaga. "Çështja e Presidentes Jahjaga" ka ekzistuar shumë më herët para se 11 (njëmbëdhjetë) propozim-amendamentet të silleshin në Gjykatë për vlerësim. Më konkretisht, ajo çështje ka filluar të ekzistojë që nga data e lidhjes së marrëveshjes politike, më 6 prill 2011. Gjykata nuk ka mundur të merret me implementimin *ad hominem* të dispozitave të asaj marrëveshjeje. Gjykatat kushtetuese mbrojnë vetëm parimet dhe dispozitat e konstitucionalizmit bashkëkohor. Në rastin tonë, ato parime dhe dispozita, nëpërmjet Kapitullit II, përshkojnë tërë Kushtetutën e Kosovës, letrën dhe frymën e saj.

Kur Gjykata shikon nëse propozim-amendamentet cenojnë parimet dhe dispozitat e Kapitullit II të Kushtetutës, ajo e bën këtë duke pasur parasysh përmbajtjen e normës kushtetuese që propozohet, krahasuar me normën dhe me parimet kushtetuese ekzistuese që janë në fuqi. Në rastin konkret, propozim-amendamenti nr. 10 synonte ndryshimin esencial të mandatit të shefit aktual të shtetit kosovar. Kjo nuk mund të ndodhte, vendosi Gjykata, për dy arsye. E para kishte të bënte me vetë natyrën e shefit të shtetit: në nenet 4.3 dhe 83 të Kushtetutës së Kosovës ai përfaqëson unitetin juridiko-kushtetues të popullit kosovar, si brenda ashtu dhe jashtë, dhe garanton funksionimin normal të institucioneve të sistemit. Kjo natyrë e shefit të shtetit nuk guxon të ndryshohet apo të ndërpritet për asnjë moment. Çdo largim i parakohshëm i shefit aktual të shtetit, jashtë procedurave dhe jashtë kushteve të para-

[408] Neni 91.1 ("Shkarkimi i Presidentit"): "Presidenti i Republikës së Kosovës mund të shkarkohet nga Kuvendi nëse ai/ajo është dënuar për kryerjen e krimit të rëndë ose nëse ajo/ai nuk është i/e aftë për të ushtruar përgjegjësitë e këtij posti për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës".

para në nenin 91 të Kushtetutës, paraqet cenim të parimeve dhe të dispozitave për unitetin juridiko-kushtetues dhe të atyre që kanë të bëjnë me përfaqësimin e popullit të Kosovës, brenda dhe jashtë saj, si dhe me garantimin e funksionimit stabil të institucioneve të shtetit kosovar.

E dyta, në vijim sa më sipër, synimi për shkarkim nëpërmjet amendamentit, përveç që pengon qytetarët e Kosovës nga të qenët unikë në pikëpamje juridiko-kushtetuese të përfaqësimit të tyre (brenda dhe jashtë vendit), të garantimit të stabilitetit institucional shtetëror, ai, në të njëjtën kohë, cenon parimet dhe dispozitat konkrete të Kapitullit II të Kushtetutës. Ky cenim nuk ka të bëjë me të drejtat dhe me liritë njerëzore *ad hominem*. Synimi për cenim të parimeve dhe të dispozitave, sa më sipër, ka të bëjë me çdo president të Kosovës, sot dhe përgjithmonë. Sikundër mund të vërehet fare lehtë, Gjykata nuk ka mbrojtur *ad hominem* pozitën e presidentes aktuale, znj. Atifete Jahjaga, por formën dhe përmbajtjen e institucionit të kreut të shtetit kosovar, të paraparë me nenet 4.3 dhe 83 të Kushtetutës, kundrejt synimit antikushtetues të propozim-amendamentit kushtetues nr. 10. Ky propozim-amendament synonte që, në mënyrë krejt joprofesionale, të bënte agresion ndaj Kapitullit II të Kushtetutës në fuqi të Kosovës, i cili kapitull shërben si pikë themelore referimi me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së çdo propozim-amendamenti kushtetues.

U mor vesh, kjo nuk do të thotë se nuk ekziston një mënyrë kushtetuese për ta ndryshuar mandatin e kreut të shtetit. Në aspektin komparativ, ka pasur raste kur kjo ka ndodhur, pra kur është ndryshuar mandati i shefit të shtetit, ashtu sikundër që ka kushtetuta që e sanksionojnë një gjë të tillë. Rasti i parë ka ndodhur në Francë, në vitin 2000. Atë vit, francezët ndryshuan me amendament kushtetues mandatin e presidentit të atëhershëm francez nga shtatë në pesë vjet. Por, ky amendament hyri në fuqi dhe u zbatua vetëm për sa i përkiste presidentit tjetër që vinte, jo atij aktual. Kjo do të thotë se nuk u lejua apriori që amendamenti i ri, që ndryshoi mandatin e presidentit aktual francez, të kishte efekt retroaktiv si në rastin kosovar.[409] Nga kushtetutat që parashohin një gjë të tillë, vlen të theksohet Kushtetuta e Koresë së Jugut, e cila përcakton procedurat që duhet ndjekur në rastet kur ndryshohet mandati i kreut të shtetit, duke e bërë të qartë se ato ndryshime

[409] Oliver Duhamel, "France's New Five-Year Presidential Term", *Brookings* (1 March 2001), në rrjet: https://www.brookings.edu/research/articles/2001/03/france-duhamel (herën e fundit shikuar në nëntor 2012).

mund të vlejnë vetëm për shefin e ardhëm të shtetit.[410] Është e qartë, pra, se gjyqësia kushtetuese, në asnjë rast, nuk mbron *ad hominem* askënd, por vetëm parimet dhe dispozitat kushtetuese që paraqesin esencën e konstitucionalizmit bashkëkohor.

Përfundim

Ky shkrim ka sqaruar në mënyrë shkencore, nga këndi komparativ kushtetues, rolin dhe pozitën e shefit të shtetit dhe mbrojtjen e tij nga shkarkimi jokushtetues nëpërmjet procesit të amendamentimit të kushtetutës në fuqi.

Në të drejtën kushtetuese komparative, shefit të shtetit i njihen dy role: roli përfaqësues dhe roli garantues. Roli përfaqësues mishërohet në shefin e shtetit si institucion personifikues i unitetit juridiko-kushtetues të popullit dhe i kontinuitetit juridiko-shtetëror. Si garantues, ndërkaq, kreu i shtetit paraqitet garant i funksionimit normal (të rregullt) të institucioneve dhe i stabilitetit të tyre. U mor vesh, këtu gjithnjë bëhet fjalë për një demokraci kushtetuese të tipit parlamentar.

Amendamentimi kushtetues paraqet një proces që ndodh në çdo shoqëri. Shpeshtësia (incidenca) e amendamentimit kushtetues varet nga shumë faktorë, prej gjatësisë së tekstit aktual kushtetues e deri te faktorët e tjerë që ndodhen jashtë tekstit në fjalë. Çështja e shpeshtësisë (incidencës) së ndryshimit të tekstit aktual kushtetues, megjithatë, nuk ka qenë objekt shqyrtimi i këtij shkrimi.[411] Ajo që u shqyrtua këtu ka të bëjë vetëm me një aspekt të procesit të amendamentimit kushtetues. Ai proces, që u shtjellua këtu, njihet si kontroll gjyqësor abstrakt dhe preventiv (paraprak) i propozim-amendamenteve kushtetuese. I njohur nga një numër mjaft i vogël i vendeve, përfshirë

---

[410] Kushtetuta e Koresë së Jugut, e 17 korrikut 1948, në nenin 128, iniciativa për ndryshim të saj, përcakton: "(2) Amendamentet në Kushtetutë për zgjatje të kohës së mandatit të Presidentit apo për lejimin e rizgjedhjes së tij nuk mund të hyjnë në fuqi për Presidentin në detyrë në kohën e parashtrimit të tyre". Komisioni i Venedikut këtë dispozitë e konsideron si një standard të mirë dhe si masë matëse për vlerësim të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese që prekin mandatet e organeve kryesore të shtetit. Cf. *Report on Constitutional Amendment, adopted by the Venice Commission at Its Plenary Session* (Venice, 11-12 December 2009), paragrafi 145.

[411] Për një analizë komparative shkencore të shkaqeve që çojnë në amendamentime të shpeshta kushtetuese cf. Sanford Levinson (ed.), *Responding to Imperfection: The Theory and Practice of Constitutional Amendment* (Princeton UP: Princeton, 1995).

këtu Kosovën, ky kontroll nënkupton se vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit kushtetues bëhet para hyrjes së tij në fuqi.

Shumica e vendeve njohin vetëm kontrollin represiv të amendamenteve kushtetuese, pra, pasi ato të kenë hyrë në fuqi. E përbashkëta e kontrollit preventiv (paraprak) dhe atij represiv (pas hyrjes në fuqi) konsiston në atë se, në të dy rastet, vlerësimi bëhet duke kontrolluar nëse amendamentet kushtetuese cenojnë (prekin) parimet dhe dispozitat ekzistuese kushtetuese, të cilat nuk mund të amendamentohen. Në rastin e Kosovës, këto parime e dispozita, gjenden kryesisht në Kapitullin II të Kushtetutës, por edhe në parimet e në dispozitat e tjera të saj.

Në vijim të kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të 11 amendamenteve të propozuara, Gjykata shpalli jokushtetues mbi 60 për qind të tyre. Pjesë e tyre ishte edhe amendamenti 10, i cili kryesisht ishte objekt i këtij shkrimi. Më këtë rast, Gjykata ka bërë të ditur se është jokushtetuese ndërprerja, nëpërmjet amendamentit kushtetues, e mandatit kushtetues pesëvjeçar të shefit të shtetit kosovar, sot dhe përgjithmonë. Nuk ka rëndësi nëse ndërprerja bëhet nëpërmjet sanksionimit të zgjedhjeve të parakohshme "brenda gjashtë muajsh" apo "pas gjashtë muajsh". Për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës dhe për drejtësinë kushtetuese bashkëkohore, ndërprerja e mandatit të shefit të shtetit mund të ndodhë vetëm duke respektuar parimet dhe dispozitat kushtetuese në fuqi. Çdo rrugë tjetër, si kjo e synuar me propozim-amendamentin 10, cenon Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës, vetë natyrën dhe pozitën e shefit të shtetit kosovar, si përfaqësues i unitetit juridiko-kushtetues, brenda dhe jashtë, dhe si garantues i funksionimit normal (të rregullt) të institucioneve shtetërore. Kjo është kështu për çdo shef shteti në demokracitë kushtetuese të tipit parlamentar.

Teoria dhe praktika për shefin e shtetit, si përfaqësues i unitetit juridiko-kushtetues të popullit dhe si garantues i funksionimit normal (të rregullt) të institucioneve të sistemit, ka filluar në Francë pas Revolucionit të vitit 1789, fillimisht e elaboruar nga Benjamin Constant. Në fakt, kjo teori u elaborua në një kontekst më të gjerë, në atë që ka të bëjë me natyrën dhe me pozitën e pushtetit konstitutiv të popullit, si sovran i ri që po dilte në skenë pas Revolucionit të vitit 1789. Tërë përpjekja e Benjamin Constantit ka konsistuar në "juridifikimin" e këtij vullneti të pakontrolluar të popullit, si sovran i ri i sapodalë në skenë. Në kuadër të kësaj përpjekjeje, u krijua sintagma për monarkun si institucion, i cili *regne et ne gouverne pas*. Kështu ka besuar një pjesë fare e vogël e ithtarëve të teorisë politike dhe kushtetuese, përfshirë Carl Schmittin. Kjo, u mor vesh, nuk ka qenë e saktë, siç ka vërejtur me të drejtë

Hans Kelsen në përgjigjen e tij Carl Schmittit. Pse? Sepse, siç thotë Kelsen, monarku ka qenë pjesë përbërëse e ekzekutivit (qeverisë). Përgjatë tërë shekullit XIX, e deri në Kushtetutën e Vajmarit, teoria dhe praktika provuan të kufizonin sa më shumë autorizimet ekzekutive të monarkëve të kohës. Kushtetuta e Vajmarit ishte përpjekja e fundit që synonte krijimin e një shefi të shtetit që *regne et ne gouverne pas*, mirëpo, pa ndonjë sukses të madh, për shkak të autorizimeve që dilnin nga dispozita e nenit 48 të saj. Ky nen nuk mundësonte që presidenti i Rajhut të ishte gardian i kushtetutës, sepse vetë ai paraqiste pushtetin ekzekutiv që rrinte mbi Rajhstagun dhe mbi të gjitha pushtetet e tjera. Shefi vajmarian i shtetit nuk mund të garantonte funksionimin normal (të rregullt) të institucioneve, sepse qëndronte mbi të gjithë. Autorizimet e ligjvënies dhe ato ekzekutive, nga neni 48 dhe nga nenet e tjera të Kushtetutës së Vajmarit, bënë që shefi i shtetit të mos përfaqësonte unitetin juridiko-kushtetues të popullit gjerman, por vetëm interesat momentale të pushtetit ekzekutivo-legjislativ, të cilat i posedonte sipas këtij neni. Me një fjalë, shefi vajmarian i shtetit nuk ka përfaqësuar as unitetin sociologjik dhe politik, siç besonte Carl Schmitt, lëre më atë juridiko-kushtetues, siç e mohonte në vazhdimësi Hans Kelsen. Kjo e fundit ka ndodhur dhe është sanksionuar vetëm me kushtetutat e demokracive kushtetuese të Evropës pas Luftës së Dytë Botërore.

Mbase, duket disi e çuditshme që, në këtë shkrim, sqarojmë se gjykatat nuk mbrojnë pozicionet apo të drejtat e liritë njerëzore *ad hominem*. Ky sqarim këtu, në fakt, bëhet si përgjigje ndaj diskursit të njëanshëm kosovar që mëtoi të kontestojë fuqinë juridike të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në pjesën që i referohet shefit kosovar të shtetit. Vetë kontrolli preventiv (paraprak) i amendamenteve kushtetuese është deri në fund abstrakt. Ai i referohet çdo personi dhe çdo situate në të ardhmen, kushdo qoftë ai dhe çfarëdo qofshin ato. Një gjykatë serioze dhe profesionale nuk guxon asnjëherë, në rastin e gjykimeve abstrakte të normës, të marrë parasysh argumentet *ad hominem.* Në gjykimet abstrakte të kushtetutshmërisë së normës, qoftë ajo normë ligjore apo kushtetuese, kjo qasje vjen më shumë në shprehje, se sa ajo me rastin e gjykimeve konkrete dhe kundërthënëse.

Kapitulli V

CILËSITË THEMELORE TË SISTEMIT KUSHTETUES KOSOVAR, STATUSI I TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE IDENTITETI KUSHTETUES I KOSOVËS SOT

Sfondi historik: Në këtë kapitull japim vetëm dy shkrime. I pari flet për cilësitë themelore të sistemit kushtetues kosovar, botuar në *E drejta/Law*, dhe përfshin edhe një historik të zhvillimit të drejtësisë kushtetuese në Kosovë deri në kohën e botimit. Shkrimi mban titullin "Veçoritë themelore të sistemit kushtetues në Kosovë", dhe pritet të dalë edhe në Lisbonë, Portugali, në një libër dyvëllimor që duhet të botohet për nder të ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Portugalisë, mikut tim, Rui Moura Ramos (Ruj Mora Ramush). Kur më 20 mars 2015, kryetari aktual i Gjykatës Kushtetuese të Portugalisë, Joaquim de Sousa Ribeiro (Zhuakim de Soza Ribajru), poashtu mik imi, më ftoi të merrja pjesë në botim, pa asnjë hezitim vendosa ta pranoja ftesën. Të vetmen dilemë që e kisha lidhej me temën që do ta trajtoja. Do të ndihesha keq nëse nuk do zgjidhja ndonjë temë që i përshtatet profilit intelektual dhe moral, si dhe udhëheqjes së pashoq, të ish-kryetarit Rui Moura Ramos, me të cilin kishim bashkëpunuar aq gjatë, që nga ditët e para të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, kryetar i parë i së cilës u zgjodha më 26 qershor 2009.

Pas shumë konsultimeve me kolegët nga bota akademike në Kosovë dhe jashtë saj, vendosa ta shkruaja këtë punim, të cilin e botova në një version fillestar në revistën *E drejta* të Prishtinës, për të parë reagimet e opinionit më të gjerë në Kosovë[412]. Esenca e punimit, sipas vlerësimit tim, do të konsistonte në trajtimin e veçorive kryesore të sistemit kushtetues kosovar, të cilat e strehojnë identitetin e ri kushtetues të Kosovës, që dallon qartë dhe dukshëm nga çdo identitet kushtetues i Kosovës nga e kaluara. Atëherë kam besuar dhe akoma vazhdoj të besoj se kjo temë prek gjithashtu ndjenjat e komunitetit akademik portugez, meqë edhe atje ka pasur një diktaturë të egër, e cila në

[412] Enver Hasani, "Veçoritë Themelore të së Drejtës Kushtetuese Kosovare", *E drejta/Law* nr. 1-4 (2014). Kjo revistë për çështje shoqërore dhe juridike, të cilën e boton Fakulteti Juridik i Prishtinës, për shkaqe financiare dhe të tjera, zakonisht del me një vonesë të konsiderueshme, ashtu që lexuesi duhet ta kuptojë se fjala është për rrethanat pas marsit 2015.

mesin e viteve 1970 u zëvendësua nga një demokraci kushtetuese. Ajo demokraci deri sot ka arritur rezultatet të jashtëzakonshme në ridefinimin e identitetit kushtetues të Portugalisë dhe në bërjen e saj një model për vendet e dala nga diktatura, çfarëdoqoftë lloji i saj.

Punimi i dytë ka të bëjë me të drejtat e njeriut në Kosovë, dhe natyrshëm përbën vazhdimësi në diskutimin tim për identitetin kushtetues kosovar. Të drejtat e njeriut nga dy kapitujt e Kushtetutës së Kosovës — kapitullit II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] — natyrshëm veçohen si dispozita ku ankorohet pjesa më e madhe dhe më e dallueshme e identitetit të ri kushtetues kosovar. Punimi është botuar në Gjermani si pjesë e një publikimi nëntëvëllimësh mbi të drejtat dhe liritë e njeriut në Evropë. Botimi ka pasur për drejtues ish-kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, Hans-Jürgen Papier (Hans-Jyrgen Papier), një ndër juristët më të mirë në çështjet kushtetuese që kam njohur gjatë punës sime si kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (2009-2015)[413]. Me kolegun Papier, kam pasur kënaqësinë të takohem në cilësinë e kryetarit të Gjykatës, dhe shpeshherë në ndërkohë kemi këmbyer mendime të dobishme për Kosovën lidhur me vendimmarrjen në çështjet kryesore që i kanë dhënë vulën identitetit të gjyqësisë kushtetuese në Kosovë. Kjo për faktin e thjeshtë se Gjermania paraqet shembullin më të cituar të praktikës në lëmin e gjyqësisë kushtetuese në dy anët e Atlantikut. Edhe pas mbarimit të mandatit të tij më 2010, asnjëherë nuk ka hezituar që të përgjigjet në kuriozitetet nga lëmi kushtetues që ngrisnim ne nga Kosova si një institucion i ri dhe pa përvojë. Një version shumë i ndryshuar i këtij shkrimi është botuar edhe në Itali, në një ndër revistat më me nam në lëmin e të drejtave të njeriut[414].

Nënkapitulli i tretë flet për identitetin kushtetues kosovar, shikuar në aspektin komparativ. Pse? Ka shumë arsye pse kemi vendosur që ta trajtojmë këtë temë kaq të virgjër në diskursin profesional kosovar. Në rend të parë, idenë për këtë shkrim e fituam krejt rastësisht në pranverë të vitit 2016, kur dekani i Fakultetit Juridik, prof. Haxhi Gashi, i kërkoi autorit të fliste në kuadër të tryezës shkencore për ndër të përvjetorit të tetë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E dyta, dhe kjo lidhet me origjinën e idesë, çështja e

---

[413] Enver Hasani, "Grundrechte im Kosovo", botuar në Detlen Marten und Hans-Jürgen Papier (eds.), *Handbuch der Grundrechte in Deutschland und Europa: Band IX: Grundrechte in Osmittel und Osteuropa* (C.F. Muller: Heidelberg, 2016).

[414] Enver Hasani, "Two Chapters on Human Rights and Fundamental Freedoms in the Constitution of Kosovo", botuar në *Mediterranean Journal of Human Rights* vol. 19, issue 3 (2014).

identitetit kushtetues kosovar po skeletohet si një problem serioz i Kosovës. Kjo sepse pas çdo vendimi me rëndësi të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka një rol kyç në formësimin e identitetit kushtetues kosovar, po pëlcasin analiza e debate nga segmente të caktuara të (pa)dijes juridike kosovare, që kryesisht po fokusohen në argumente metafizike ose në sulme personale kundër atyre që janë në Gjykatë si gjyqtarë. Fakti që të gjithë ata që sot merren me analizën e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese kanë qenë, pa asnjë përjashtim, kandidatë për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, dhe janë refuzuar, paraqet një rrethanë rënduese sepse gjykimi i tyre në vazhdim nuk po arrin të jetë neutral: asnjëherë këta analistë nuk po arrijnë të merren me studimin e rasteve të vendosura nga Gjykata Kushtetuese në mënyrë profesionale. Së fundi, identiteti kushtetues kosovar është një identitet fare i ri dhe shumë pak përkon me strukturën materiale të shoqërisë kosovare. Kosova nuk është e vetme në këtë drejtim: në pjesën dërrmuese të rasteve shtetet e reja kanë prodhuar tekste kushtetuese që nuk kanë në përputhje me strukturën e tyre materiale të shteteve.

Në kuptim të përgjithshëm, *grosso modo*, ka dy përvoja sa i përket identitetit kushtetues: një, përvoja është amerikane, ku teksti kushtetues i paraprin identitetit kushtetues dhe e krijon atë; dhe, nën dy, përvoja evropiane ku teksti kushtetues vetëm shërbën si mbulesë për kornizimin e identitetit kushtetues që ekziston i shkapërderdhur nëpër strukturat materiale të shteteve të tilla. Këtu, që të jemi të qartë, flasim për ndarjet që gjenden brenda sistemeve kushtetuese të vendeve të cilat modelohen sipas shembullit të demokracive kushtetuese perëndimore.

Më 14 dhe 15 tetor 2016, në Regensburg të Gjermanisë, u mbajt Kongresi i XVIII Ndërkombëtar mbi të Drejtën Evropiane dhe Kushtetuese Komparative, me temën "Drejtësia Kushtetuese dhe Politika". Këtë punim e prezantova në këtë kongres. Këtë e bëra si një test fillestar për të parë nëse, në një ambient ndërkombëtar ku flasin njerëz të zgjedhur të profesionit, do të pritej si duhet. Kjo më duhet për të shikuar nëse ia vlen që të vazhdoj më tutje të merrem me një temë të tillë vërtetë ekzotike për kushtetet tona. Prezantimi i qëndroi testit për shkak se debati për identitetin kushtetues dhe raportin e tij me identitetet tjera etnike, nacionale, fetare, regjionale etj., me sa duket gjendet në kulmin e vetë. I vetmi dallim është se në Evropë pikë referimi për të bërë dallimin në mes të identitetit kushtetues dhe identiteve tjera është Traktati i Lisbonës dhe përpjekja e parreshtur e evropianëve për të krijuar një identitet supranacional kushtetues të bazuar në vlerat e përbashkëta kushtetuese të shoqërive të kontinentit të vjetër. Sa do të jetë kjo reale mbetet të

shihet në të ardhmen. Besojmë se punimi ynë, të cilin e prezantuam në Regensburg dhe të cilin e risjellim këtu, do të jetë një kontribut modest në këtë debat evropian.

I. Veçoritë themelore të sistemit kushtetues në Kosovë

Hyrje

E drejta kushtetuese kosovare ka disa veçori të përgjithshme dhe disa të posaçme. Në grupin e veçorive të llojit të parë bie veçoria e saj si një e drejtë kushtetuese ish-komuniste në transicion. U mor vesh, ky transicion në Kosovë ka filluar me një vonesë prej më shumë se dy dekadash. E megjithatë, e drejta kushtetuese kosovare përbën pjesë të së drejtës në transicion në po atë mënyrë siç ka qenë rasti me të drejtat kushtetuese të krejt vendeve ish-komuniste në Evropë. Veçoria e dytë e përgjithshme ka të bëjë me modelin e së drejtës kushtetuese të cilin e ka ndjekur Kosova pas shpalljes së pavarësisë, më 17 shkurt 2008. Ai model ka qenë dhe mbetet model i demokracive kushtetuese perëndimore. Nga këto dy veçori burojnë veçoritë e tjera të veçanta, të cilat pak a shumë lidhen me kontekstin kosovar dhe burojnë nga fakti se Kosova ka pasur një trajektore tjetër të zhvillimit social, politik, ekonomik, kulturor dhe tjetër, gjë e cila e bën Kosovën mjaft ndryshe nga vendet e tjera ish-komuniste të Evropës. Kjo rrethanë shpjegon edhe faktin pse në Kushtetutën e Kosovës ekzistojnë dispozita të dukshme, të cilat më herët, në historinë kushtetuese kosovare, ishin krejt të panjohura dhe, herë-herë, shkaktuan e po shkaktojnë keqkuptime serioze në qarqet publicistike, akademike dhe politike. Kjo ishte arsyeja pse vendosëm që, në këtë punim, t'i diskutojmë veçoritë më karakteristike të së drejtës kushtetuese kosovare.

Në mesin e sqarimeve që duhen bërë që në fillim, në seksionin e parë, është ai që lidhet me vlerësimit e kushtetutshmërisë së ligjeve të Kuvendit të Kosovës që ratifikojnë marrëveshje ndërkombëtare, duke përdorur arsyetimin e Gjykatës, të dhënë me rastin e kontrollit kushtetues të një marrëveshje për normalizim të marrëdhënieve, e lidhur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.[415]

[415] Aktgjykim në Rastin Nr. KO95/13. Parashtrues: Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-199 për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e

Më këtë rast, Gjykata u prononcua rreth vendit dhe rëndësisë së marrëveshjeve ndërkombëtare dhe së drejtës ndërkombëtare, në përgjithësi, në sistemin kushtetues kosovar. Jo më pak i nevojshëm për t'u sqaruar ngel edhe keqkuptimi i kartës kosovare për të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve, vendi dhe rëndësia e saj në sistemin kushtetues kosovar. Ka diçka në këtë kartë që është e përgjithshme dhe që nuk dallon shumë nga vendet e tjera ish-komuniste në Evropë, por ka edhe diçka që është krejt specifike dhe që lidhet me rolin dhe me rëndësinë që kanë në Kosovë komunitetet dhe pjesëtarët e tyre. Një status të tillë të ngjashëm kushtetues e gjejmë vetëm në Republikën e Maqedonisë, jo edhe në Bosnjë-Hercegovinë, sepse, në këtë vend, Marrëveshja e Dejtonit[416] sanksionon vetëvendosjen e brendshme të entiteteve territoriale dhe jo vetëvendosjen e bazuar në të drejtat e njeriut dhe të pjesëtarëve të komuniteteve që jetojnë në shtetin e Bosnjë-Hercegovinës.[417] Këtë çështje e trajtojmë në seksionin e dytë të këtij punimi.

Asnjë kuptim nuk do të kishte ky punim, sikur të mungonte seksioni i tretë, i cili trajton llojin dhe juridiksionin aktual të Gjykatës Kushtetuese dhe vetë modelin e drejtësisë kushtetuese kosovare. Vetëm të kuptuarit analitik të këtij juridiksioni jep pasqyrën e qartë të keqkuptimeve ekzistuese në diskursin publik kosovar rreth problemeve kryesore të së drejtës kushtetuese kosovare. Keqkuptimi kundrejt rolit dhe rëndësisë së Gjykatës Kushtetuese në Kosovë vihet në spikamë thuajse pas çdo vendimi "të madh" të këtij institucioni. Ky keqkuptim, me sa duket, buron nga fakti i mosnjohjes elementare të caqeve si dhe të vetë natyrës së juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, gjë e

---

marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje (Nr. ref.: AGJ469/13. 9 shtator 2013).

[416] Kushtetuta e Bosnjë-Hercegovinës, e cila emërtohet si "Kushtetuta" apo "Kushtetuta e shtetit" për qëllimet e dallimit të saj nga kushtetutat e entiteteve, është një nga dymbëdhjetë anekset e Marrëveshjes së Përgjithshme për Paqen në Bosnjë-Hercegovinë të vitit 1995 ("Marrëveshja e Dejtonit"). Kjo marrëveshje u parafua në Dejton, më 21 nëntor 1995, kurse u nënshkrua në Paris, më 14 dhjetor 1995. Marrëveshja e Dejtonit paraqet kurorëzim të negociatave prej 44 muajsh, të kryera nën mbikëqyrjen e Konferencës Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe të Grupit të Kontaktit.

[417] Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), në një aktgjykim të saj të vitit 2009, ka gjetur se pozicioni i bazuar në Marrëveshjen e Dejtonit është diskriminues dhe cenon nenin 14 ("Ndalimi i diskriminimit") të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), lidhur me nenin 3 ("E drejta për zgjedhje të lira") të Protokollit Nr. 1 të KEDNjsë. Cf. më shumë në: *Rasti Sejdić dhe Finci v. Bosnjë-Hercegovina* (Kërkesat nrs. 27996/06 dhe 34836/06), Dhoma e Plotë, *Aktgjykimi*, 22 dhjetor 2009, Strasburg, Aktgjykimi 1.

cila lidhet me cilësinë dhe me llojin e studimeve të drejtësisë në të kaluarën e Kosovës.[418]

Sipas Kushtetutës së vitit 1974, Kosova ka pasur një gjykatë kushtetuese. Gjykata qe themeluar së pari më 1972, kurse u suprimua nga diktatori serb Sllobodan Millosheviq, së bashku me autonominë e Kosovës, si pjesë e fushatës së tij represive kundër Kosovës dhe popullit të saj shumicë (1986-2000).[419] Ajo gjykatë, megjithatë, ishte krejt e ndryshme nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës: funksioni i saj primar ishte ruajtja dhe kultivimi i vlerave të sistemit diktatorial komunist në Kosovë, si pjesë e sistemit komunist në ish-Jugosllavi. Sistemi bazohej në unitetin e pushtetit të proletariatit, pushtet që, sipas Kushtetutës së vitit 1974 (jugosllave dhe kosovare), ushtrohej në emër të proletariatit nga ana e Partisë Komuniste në pushtet, e cilësuar si një avangardë krejt e vetme. Përveç kësaj, ajo gjykatë ka pasur në juridiksion të vetin edhe mbrojtjen e ligjshmërisë; nuk ka njohur fare ankesat individuale; ka pasur mundësi të vihet vetë në lëvizje *sua sponte*; dhe, së fundi, ka pasur detyrë të mbikëqyrë lëvizjet dhe zhvillimet në sferën e kushtetutshmërisë e të ligjshmërisë dhe t'i raportojë ato nëpër kuvendet federative, republikane dhe krahinore. Ka pasur dhe kompetenca të tjera që nuk janë aspak në natyrën e gjyqësisë kushtetuese të modeluar sipas sistemit të konstitucionalizmit perëndimor.[420] Dija dhe përvoja kushtetuese e prodhuar nga kjo Gjykatë në asnjë

---

[418] Keqkuptime nga autorët e huaj, të ngjashme me ato të segmenteve të caktuara të juristëve kosovarë, i kemi hasur vetëm në një shkrim. Sado që autori i këtij shkrimi synon një status prej studiuesi analitik të punës së Gjykatës Kushtetuese në Kosovë, një qëllim i tillë gjendet larg arritjes. Kjo, jo për faktin se autori i shkrimit është ekonomist me profesion, pa asnjë bagazh serioz akademik, por, mbi të gjitha, për arsye se analiza në fjalë përmban mungesë të njohurive themelore për formën dhe për përmbajtjen e juridiksionit kushtetues kosovar (natyra e modelit kushtetues kosovar). Cf. Andrea Lorenzo Capussela, "A Critique of Kosovo's Internationalized Constitutional Court", *European Diversity and Autonomy Papers* (EDAP: 02/2014), në rrjet: http://www.eurac.edu/edap.

[419] Për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, deri në rrënimin e saj nga diktatori serb Sllobodan Milosheviq, cf. më shumë në Mirosal Cerar, "Slovenia's Constitutional Court Within the Separation of Power", botuar në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010) fq. 213-245, në fq. 213, fusnota 2; për zhvillimet kushtetuese në ish-Jugosllavi gjatë periudhës komuniste, cf. më shumë në Jovan Gjorgjeviq, *E Drejta Kushtetuese* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1972) fq. 75-114; Dr. Dimitrije Kulić, *Ustavno sudstvo u svetu* (Gjyqësia kushtetuese në botë) (Naša Reč: Leskovac, 1972) fq. 157-190.

[420] Për natyrën e pushtetit dhe për rolin e të drejtës në sistemin komunist të vendeve të ish-bllokut socialist, cf. më shumë në Paolo Carrozza, "Il diritto socialista", botuar në P. Carrozza, A. Di Giovine & G.F. Ferrari (eds.), *Diritto costituzionale comparato* (GLF Editori Later-

mënyrë nuk ka mundur të shërbejë si pikë referimi për gjykimin e vendimmarrjes dhe të punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, gjë e cila, për fat të keq, ndodh shpeshherë në diskursin publik kosovar kur komentohen e kur analizohen "vendimet e mëdha".

Faktori ndërkombëtar ka fituar një peshë të madhe në modelimet e proceseve të kushtetutëbërjes pas rënies së komunizmit. Ky fenomen ka mundur të ndodhë vetëm pas krijimit të rrethanave të reja me mbarimin e Luftës së Ftohtë[421], sado që përpjekjet ndërkombëtare për të ndikuar në sistemet e brendshme kushtetuese të vendeve të Botës së Tretë kanë ekzistuar shumë më herët dhe njihen si përpjekjet e vendeve të "konsensusit të Uashingtonit".[422] Rasti i Kosovës, megjithatë, është krejt i veçantë në këtë aspekt, sepse kjo ndërhyrje ishte jo vetëm formale, por edhe thellësisht substanciale. Për dallim nga vendet e tjera ish-komuniste në Evropë, në Kosovë, faktori ndërkombëtar ishte thuajse autori i parë i tekstit aktual të Kushtetutës. Në vendet e tjera ish-komuniste në Evropë, ndërhyrja e faktorit të jashtëm, kryesisht nëpërmjet Komisionit të Venedikut dhe inkurajimit të tyre për rrugën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ishte në formë të ndihmës teknike nëpërmjet ekspertizës, duke i lënë hapësirë të madhe ekspertizës vendëse, me qëllim të futjes në kushtetutat e reja të këtyre vendeve të zgjidhjeve të ofruara kësisoj nga ekspertët evropianë dhe nga ekspertët e tjerë ndërkombëtarë.[423]

---

za: Roma-Bari, 2009) fq. 583-615; Karl J. Fridrih, *Konstitucionalna demokratija* (CID: Podgorica, 2005) fq. 47-50.

[421] Me mbarimin e Luftës së Ftohtë u bë e qartë se konstitucionalizmi modern bazohet në tregun e lirë, në pluralitetin e pronave dhe të ideve, në respektin për të drejtat njerëzore dhe liritë fundamentale, në sundimin e ligjit dhe në postulate të tjera të ngjashme me këto. Cf. më shumë për këtë në Laura Montanari, "Le nuove democrazie dell'Europa centro-orientale", botuar në P. Carrozza, A. Di Giovine & G.F. Ferrari (eds.), *Diritto costituzionale comparato*, fq. 514-553.

[422] Cf. më shumë në John Williamson, "What Washington Means by Policy Reform", botuar në John Williamson (ed.), *Latin American Readjustment: How Much Has Happened* (Institute for International Economics: Washington, 1989); Joseph Stiglitz, *Globalization and its Discontents* (W.W. Norton: New York, 2003).

[423] Për rastet e Shqipërisë, të Polonisë, të Hungarisë, si dhe për ngjashmëritë dhe për dallimet me vendet e tjera ish-komuniste, si dhe për ndikimin në këto vende të përvojës spanjolle, cf. më shumë në Scott N. Carlson, "The Drafting Process for the 1998 Albanian Constitution"; Andrew Arato and Zoltan Miklosi, "Constitution Making and Transitional Politics in Hungary"; Lech Garlicki and Zofia A. Garlicka, "Constitution Making, Peace Building, and National Reconciliation: The Experience of Poland"; Andrea Bonime-Blanc, "Constitution Making and Democratization: The Spanish Paradigm"; dhe Laurel E. Miller, "Designing Constitution-Making Processes: Lessons from the Past, Questions for the Future". Të gjitha këto shkrime janë botuar në Laurel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition:*

Kjo do të jetë objekt diskutimi në seksionin e fundit të këtij shkrimi, për të kaluar më pastaj në gjetjet e punimit si tërësi.

1. Vendi dhe rëndësia e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe e së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi

Çështja e vendit dhe e rëndësisë në sistemin kushtetues kosovar të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të së drejtës ndërkombëtare në të gjitha format e manifestimit të saj është shtruar në terma praktikë për herë të parë në një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës i cili ka të bëjë me *Marrëveshjen e Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë*, e parafuar në Bruksel, më datën 19 prill 2013.[424] Me këtë rast, Gjykata kryesisht është prononcuar për vendin dhe për rëndësinë në sistemin kushtetues kosovar të marrëveshjeve ndërkombëtare. Ishte e pashmangshme për Gjykatën, megjithatë, që të mos flasë në *obiter dicta* edhe për statusin e së drejtës ndërkombëtare në të gjitha format e manifestimit të saj, ashtu siç është formuluar në nenin 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Ka disa nene të Kushtetutës së Kosovës të cilat paraqesin pikë referimi me rastin e çdo diskutimi për vendin dhe për rëndësinë e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi në sistemin kushtetues kosovar. Ato nene janë, për sa vijon: neni 16, paragrafi 3;[425] neni 17,[426] neni 18,[427] neni 19,[428] neni 20,[429] neni 22,[430] dhe neni 53.[431] Si të tilla, këto nene

---

Case Studies in Constitution Making (United States Institute of Peace Press: Washington D.C., 2010). Cf. po ashtu edhe Christos L. Rozakis, "The European Judge as Comparatist", botuar në Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law: A New Source or Inspiration?* (Routledge: London, 2006) fq. 338-339.

[424] Cf. Aktgjykimi i cituar në fusnotën nr. 1 *supra*.

[425] Neni 16 ["Epërsia e Kushtetutës"]: "1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë; 2. Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta; 3. Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare; 4. Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës i nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës".

[426] Neni 17 ["Marrëveshjet Ndërkombëtare"]: "1. Republika e Kosovës lidh marrëveshje ndërkombëtare dhe anëtarësohet në organizata ndërkombëtare; 2. Republika e Kosovës merr pjesë në bashkëpunim ndërkombëtar për promovimin dhe mbrojtjen e paqes, sigurisë dhe të drejtave të njeriut".

[427] Neni 18 ["Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare"]: "1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje: (1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake; (2) të

kanë nevojë për një elaborim të veçantë, gjithnjë duke marrë parasysh rrugën e ndjekur nga Gjykata Kushtetuese në aktgjykimin që ka të bëjë me marrëveshjen e sipërcekur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në këtë kontekst, të një rëndësie të veçantë janë paragrafët 49-101 të Aktgjykimit.[432] Në këta paragrafë është trajtuar vetëm aspekti i statusit në sistemin kushtetues kosovar të marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura në mënyrë të duhur nga ana e auto-

---

drejtat dhe liritë themelore; (3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare; (4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës; 2. Marrëveshjet ndërkombëtare me përjashtim të atyre në pikën 1, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës; 3. Presidenti i Republikës së Kosovës ose Kryeministri njoftojnë Kuvendin sa herë që të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare; 4. Amendamentimi ose tërheqja nga marrëveshjet ndërkombëtare do të kenë të njëjtën procedurë të vendimmarrjes sikur ajo e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare; 5. Parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare rregullohen me ligj".

[428] Neni 19 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"]: "1. Marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji; 2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës."

[429] Neni 20 ["Bartja e Sovranitetit"]: "1. Republika e Kosovës, në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, për çështje të caktuara mund të kalojë kompetenca shtetërore organizatave ndërkombëtare; 2. Nëse një marrëveshje anëtarësimi e ratifikuar nga Republika e Kosovës për pjesëmarrje në një organizatë ndërkombëtare në mënyrë eksplicite kërkon zbatim të drejtpërdrejtë të normave të kësaj organizate, ligji me të cilin ratifikohet marrëveshja e anëtarësisë miratohet me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe ato norma kanë epërsi
ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës".

[430] Neni 22 ["Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare"]: "Të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese".

[431] Neni 53 ["Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut"]: "Të drejtat njeriut dhe liritë themelore, të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

[432] Cf. Aktgjykimi i cituar në fusnotën nr. 1 *supra*.

riteteve kompetente shtetërore, pra jo edhe statusi në sistemin kushtetues të Kosovës i së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi. Si të tillë, këta paragrafë hedhin mjaft dritë edhe mbi statusin e së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi, nëse merren parasysh dy fakte: së pari, sikundër dihet, marrëveshjet ndërkombëtare paraqesin burimin primar dhe më të qartë të të drejtave dhe të detyrimeve të subjekteve të së drejtës ndërkombëtare dhe instrumentin kryesor të komunikimit ndërmjet tyre;[433] dhe, së dyti, çdo vendim i Gjykatës Kushtetuese është i detyrueshëm për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës, përfshirë këtu edhe gjyqësorin,[434] gjë që nënkupton se dispozitat e Kushtetutës që flasin për statusin e së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi, tani e tutje duhet të interpretohen në frymën e aktgjykimit në fjalë.

T'i kthehemi tani çështjeve kyçe të këtij seksioni, e që në terma doktrinarë përbën në thelb tematikën e asaj që njihet si teoria dualiste dhe teoria moniste, nëpërmjet të cilave shpjegohet marrëdhënia ndërmjet së drejtës ndërkombëtare dhe asaj të brendshme. Këtë qasje doktrinare e ka ndjekur edhe Gjykata, gjë që vërehet qartë qysh në paragrafin hyrës 48 të Aktgjykimit (para fillimit të analizës komparative).[435] U mor vesh, këtu bëhet fjalë vetëm për marrëdhënien e së drejtës së brendshme me atë ndërkombëtare kontraktuale, pra jo me të gjitha llojet e së drejtës ndërkombëtare. Se kjo është kështu, shihet qartë nga paragrafi 52 i Aktgjykimit, ku Gjykata citon nenin 19 të Kushtetutës si dëshmi të faktit se marrëveshjet e ratifikuara në mënyrë të duhur bëhen pjesë e sistemit të brendshëm të Kosovës dhe mund të ekzekutohen nëse janë të vetekzekutueshme, përkatësisht nëse ekzekutimi i tyre nuk kërkon nxjerrjen e një ligji tjetër implementues. Natyra e marrëveshjeve,

---

[433] Sado që ky konstatim paraqet një dije konvencionale, një diçka rreth së cilës ka konsensus në doktrinën e së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Gjykata e ka konstatuar si të tillë në paragrafin 94 të Aktgjykimit, duke theksuar, *inter alia*, se "Gjykata vëren se marrëveshjet ndërkombëtare shërbejnë për plotësimin e një nevoje themelore të shteteve për të rregulluar, me pëlqim, çështjet e shqetësimit të përbashkët, dhe kësisoj të sjellin stabilitet në marrëdhëniet e tyre reciproke. Pra, marrëveshjet ndërkombëtare janë instrument për të siguruar stabilitet në marrëdhëniet e tyre reciproke. Si të tilla, marrëveshjet ndërkombëtare janë instrument për të siguruar stabilitet, besueshmëri, dhe rend në marrëdhëniet ndërkombëtare, dhe, rrjedhimisht, gjithmonë kanë qenë burim kryesor i marrëdhënieve juridike ndërmjet shteteve".

[434] Neni 116.1 ["Efekti Juridik i Vendimeve"] i Kushtetutës.

[435] Analizën komparative, Gjykata e ka bërë në paragrafët 49-69 të Aktgjykimit në Rastin KO95/13. Aty diskutohen zgjidhjet e ofruara lidhur me marrëdhënien ndërmjet së drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare të përmbajtur në marrëveshjet e lidhura ndërkombëtare nëpër sistemet juridiko-kushtetuese të Bosnjë-Hercegovinës, të Britanisë së Madhe, të Bullgarisë, të Holandës, të Kroacisë, të Maqedonisë, të Sllovenisë dhe, së fundi, të Shqipërisë.

pra nëse ato janë të vetekzekutueshme apo jo, ka qenë dhe mbetet çelës për përcaktimin e natyrës juridike të ligjeve që lidhen me statusin e një marrëveshjeje ndërkombëtare.

Në vijim, për sa më sipër, ekzistojnë dy lloje të ligjeve që nxirren në lidhje me statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin e brendshëm juridik. Në llojin e parë bëjnë pjesë ato ligje të cilat vetëm ratifikojnë një marrëveshje ndërkombëtare dhe nuk kanë asnjë vlerë normative. Llojet e tjera të ligjeve janë ato që nxirren me qëllim të operacionalizimit të dispozitave konkrete të marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura në mënyrë të duhur dhe, si të tilla, kanë vlerë normative dhe i nënshtrohen kontrollit të kushtetutshmërisë së tyre. Në rastin e dytë, me fjalë të tjera, dispozitat konkrete të marrëveshjes operacionalizohen me qëllim të vënies së tyre në jetë nga ana e gjykatave, të autoriteteve të tjera publike dhe të personave privat.

Dallimet ndërmjet ligjeve me forcë normative dhe atyre që nuk kanë këtë forcë, e që nxirren në vijim të internalizimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin e brendshëm juridik, ekzistojnë vetëm në sistemin kontinental, të cilit i takon edhe Kosova. Në sistemin britanik, të cilit i takojnë thuajse të gjitha ish-kolonitë britanike, ligji për ratifikim ka vlerë normative, pa marrë parasysh nëse është apo jo vetekzekutues ligji që internalizon marrëveshjen e caktuar ndërkombëtare. Në fakt, në kuptim të ngushtë, në këto vende nuk ka ligj për ratifikim në sensin që ekziston në Kosovë dhe në vendet e tjera që modelohen sipas sistemit kontinental. Në sistemin britanik dhe në ish-kolonitë britanike, lidhja e një marrëveshjeje ndërkombëtare është prerogativë mbretërore, e cila ushtrohet nëpërmjet ministrit të jashtëm dhe, si e tillë, obligon shtetin britanik në marrëdhëniet e tij me shtetet dhe me subjektet e tjera të së drejtës dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare. Për t'u bërë pjesë e sistemit të brendshëm juridik në Britani dhe në ish-kolonitë e saj, nevojitet nxjerrja e një ligji të veçantë me të njëjtin emër dhe me të njëjtën përmbajtje. Po nuk u bë kjo, marrëveshja mbetet në ajër dhe nuk mund të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykatat, nga autoritetet e tjera publike dhe nga individët. Edhe ligji që internalizon një marrëveshje ndërkombëtare në sistemin e brendshëm britanik dhe në sistemet e ish-kolonive britanike, mund të ndryshohet dhe të plotësohet sipas procedurës së njëjtë që vlen për ndryshimin dhe për plotësimin e ligjeve të zakonshme. Sistemi kontinental është

krejt ndryshe dhe këtë e ka reflektuar Gjykata në aktgjykimin që diskutohet këtu, duke elaboruar edhe modelin britanik.[436]

Sistemi kontinental ka një qasje më të ndryshme. Ligji për ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare nuk ka forcë normative dhe paraqet vetëm një teknikë standarde juridike nëpërmjet së cilës internalizohet, pra bëhet pjesë e sistemit të brendshëm juridik, marrëveshja ndërkombëtare e lidhur në mënyrën e duhur. Sado që në këto vende, përfshirë dhe Kosovën, ka ligje që përcaktojnë mënyrën e lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare, pikë referimi nuk janë ligjet e tilla, por Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve, e vitit 1980 (KVDT).[437] Në fakt, në nenin 46 të Konventës, shprehimisht theksohet se zgjidhjet e brendshme kushtetuese e ligjore nuk mund të shërbejnë si bazë juridike për moszbatim të detyrimeve të marra nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura në mënyrë të duhur. Sipas Konventës, *inter alia*, mënyrë e duhur është edhe ratifikimi.[438]

Ratifikimi kushtetues është krejt i ndryshëm nga ratifikimi që bëhet sipas Konventës dhe së drejtës ndërkombëtare zakonore. Këtë dallim e ka theksuar edhe Gjykata në paragrafët 77-84 të Aktgjykimit, duke theksuar se Kryeministri, shefi i shtetit dhe ministri i jashtëm nuk kanë nevojë të kenë autorizim shprehimor për marrjen e detyrimeve ndërkombëtare sepse, *ex lege*, e drejta ndërkombëtare ua njeh këtyre autoriteteve të drejtën e lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare pa autorizim paraprak. Çështja e autorizimit paraprak të këtyre tri organeve është çështje e brendshme kushtetuese, e cila nuk mund të përdoret nga shteti si arsyetim për mohim të detyrimeve të marra ndërkombëtare nga ana e tyre. Për organet e tjera kushtetuese, sipas Gjykatës

---

[436] Për dallimin ndërmjet sistemit britanik dhe atij kontinental, cf. paragrafin 50 të Aktgjykimit. Për shtjellimet doktrinare, Cf. Thomas Buergenthal, "Modern Constitutions and Human Rights Treaties", në *Columbia Journal of Transnational Law* vol. 36, no. 1 (1997) fq. 211, fq. 213-216; cf. Po ashtu Franck C. Newman and David Wiessbrodt, *International Human Rights: Law, Policy, and Process* (Anderson: Cincinati, 1996) fq. 23; David Weissbrodt and Connie de la Vega, *International Human Rights: An Introduction* (Univ. of Pennsylvania Press: Philadelphia, 2007) fq. 4-6; Anthony Aust, *Modern Treaty Law and Practice* (Cambridge UP: Cambridge, 2000) Kapitulli 10 ("Treaties and Domestic Law") fq. 143-161.

[437] *Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve e vitit 1969 (e hyrë në fuqi me 27 janar 1980)*. Botimet Zyrtare të Kombeve të Bashkuara. *Treaty Series*, vol. 1155.

[438] Sipas nenit 11 të KVDT ekzistojnë këto mënyra për manifestimin e vullnetit për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare: 1. nënshkrimi; 2. këmbimi i instrumenteve që nënkuptojnë marrëveshje; 3. ratifikimi; 4. pranimi; 5. miratimi ose aderimi; dhe 6. çdo mënyrë tjetër sipas pajtimit të palëve.

dhe duke u mbështetur në KVDT, nevojitet autorizimi me shkrim shprehimor për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare.[439]

Përkundër faktit që "tre të mëdhenjve", pra shefit të shtetit, shefit të Qeverisë dhe ministrit të jashtëm, nuk u kërkohet autorizimi me shkrim për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, Gjykata ka shtjelluar edhe rrethanën se shefit të ekzekutivit kosovar i ishte dhënë pëlqimi shprehimor nga Kuvendi i Kosovës me qëllim të negocimit dhe të lidhjes së marrëveshjes në fjalë për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Këtë e ka sqaruar Gjykata në paragrafët 14 dhe 80 të Aktgjykimit, duke cituar Rezolutën e Kuvendit Nr. 04-R-08 mbi Normalizimin e Marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, të 18 tetorit 2012. Me këtë rezolutë, shefi i Qeverisë së Kosovës pati marrë dritën e gjelbër për negocim me Serbinë. Në paragrafin 15 të Aktgjykimit përmendet vendimi tjetër, ai me numër 04-R-10, i 22 prillit 2013, me të cilin shefi i Qeverisë autorizohej që të parafonte një marrëveshje për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë. Shefi i Qeverisë e ka parafuar Marrëveshjen, më 19 prill 2013, në Bruksel, dhe me këtë, sipas nenit 11 të KVDT, ka marrë detyrim ndërkombëtar për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare për normalizim e marrëdhënieve me Serbinë dhe ekzekutimin *bona fide* të çdo detyrimi që del nga kjo marrëveshje. Ekzekutimi me mirëbesim, *bona fide*, i detyrimeve ndërkombëtare paraqet një ndër detyrimet kryesore që dalin nga neni 26 ["Pacta Sunt Servanda"] i KVDT dhe nga vetë e drejta zakonore ndërkombëtare. Edhe sikur shefi i Qeverisë së Kosovës të ishte thirrur në pengesa kushtetuese për vënien në jetë të detyrimeve të marra me këtë marrëveshje, ato nuk do të kishin pasur efekt. Për këtë arsye, Gjykata me të drejtë ka vërejtur se parafimi i Marrëveshjes është bërë në kuadër të autorizimeve ndërkombëtare që ka shefi i Ekzekutivit, ndërkohë që autorizimet kushtetuese, të dhëna nga Kuvendi i Kosovës për negocim dhe lidhje të marrëveshjes ndërkombëtare me Serbinë, kanë paraqitur dhe paraqesin rrethanë shtesë, e cila pengon çdo kontroll kushtetues të marrëveshjes në fjalë. Kjo, megjithatë, nuk është e tëra, sepse arsyeja e vërtetë e mospasjes së një mundësie kushtetuese për kontroll kushtetues të

[439] Paragrafi 77 i Aktgjykimit: "Për sa i përket çështjes se cili autoritet shtetëror ka të drejtën e lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare, Gjykata i referohet nenit 2 (c) të Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve të vitit 1969, e cila definon kuptimin "autorizim" si "një dokument që buron nga autoriteti kompetent shtetëror me të cilin caktohet personi apo personat që do të përfaqësojnë shtetin gjatë negociatave, miratimit apo vërtetimit të tekstit të një traktati, gjatë shprehjes së vullnetit të shtetit për të qenë i detyruar nga një traktat, apo gjatë kryerjes së ndonjë veprimi lidhur me një traktat".

marrëveshjeve ndërkombëtare rrjedh nga fakti se Kosova, sikur vendet e tjera të sistemit kontinental, nuk ka një dispozitë kushtetuese që lejon Gjykatën Kushtetuese për të bërë një kontroll të tillë të marrëveshjeve që janë lidhur në mënyrë të duhur dhe pasi të jenë ratifikuar në Kuvend. Kjo nënkupton se ratifikimi kushtetues i bërë më 27 qershor 2013 në Kuvendin e Kosovës, me vendimin nr. 04-V-638, vetëm vërteton se Kosova, nëpërmjet parafimit nga Kryeministri të marrëveshjes në fjalë, ka hyrë në detyrime ndërkombëtare të cilat duhet t'i ekzekutojë me mirëbesim, *bona fide*. Kjo, më tutje, nënkupton se Ligji Nr. 04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë nuk ka asnjë vlerë normative. U mor vesh, pjesët e Marrëveshjes, që kanë natyrë vetekzekutuese, mund të zbatohen drejtpërsëdrejti. Deri më sot nuk është vërejtur se Marrëveshja ka një natyrë të tillë vetekzekutuese, gjë që shihet nga fakti se deri më tani janë nxjerrë dy ligje në vijim të zbatimit të saj: Ligji mbi Amnistinë, Nr. 04/L-209, i 11 korrikut 2013, dhe Ligji Nr. 04/L-201 mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit Nr. 04/L-165 mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, i 25 korrikut 2013, të cilat po ashtu kanë qenë objekt kontrolli kushtetues në Gjykatën Kushtetuese.[440] Sikur Gjykata të kishte pranuar të ushtronte kontroll represiv, pra pas hyrjes në fuqi në sistemin juridik të Kosovës të kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare, atëherë ajo do ta merrte rolin e një gjykate ndërkombëtare që kontrollon cilësinë juridike të një dokumenti ndërkombëtar. Gjykata këtë nuk e ka bërë kur ka theksuar, nisur nga aspekti komparativ, se Kushtetuta e Kosovës nuk lejon fare kontrollin kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare, as represiv e as preventiv.[441] Po të pranonte një gjë të tillë, siç

[440] Cf. Aktgjykimi i 3 shtatorit 2013 në Rastin KO108/13. Parashtrues: Albulena Haxhiu dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kontrolli kushtetues i Ligjit Nr. 04/L-209 mbi Amnistinë, i 11 korrikut 2013; dhe Aktvendim për Papranueshmëri, i 2 shtatorit 2013, në Rastin KO118/13. Parashtrues: Albana Fetoshi dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kontrolli kushtetues i Ligjit Nr. 04/L-201 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-165 mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

[441] Nga analiza komparative e Gjykatës, e kryer në paragrafët 48-69 të Aktgjykimit, shihet qartë se disa vende njohin kontrollin preventiv të kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare, d.m.th. kontrollin para se ato të ratifikohen nga organi përkatës kushtetues. Kontrollin represiv, d.m.th. kontrollin pas ratifikimit kushtetues, nuk e njeh asnjë nga vendet e sistemit kontinental. Rasti i Gjermanisë përmendet në literaturë si një rast që lejon kontrollin represiv të normave ndërkombëtare. Në rastin gjerman bëhet fjalë për kontrollin kushtetues të cilin e bën Gjykata Federale e Gjermanisë kundrejt akteve *ultra vires* të Bashkimit Evropian si dhe për kontrollin kushtetues që ka për qëllim mbrojtjen e *identitetit kushtetues* të Gjermanisë. Cf. Daniel Thym, "From Ultra-Vires-Control to Constitutional-Identity-

ka vërejtur Gjykata me plot të drejtë, atëherë do të prishej komunikimi juridik normal ndërmjet shteteve dhe do të shkaktohej një pasiguri e madhe në komunikimin ndërkombetar në përgjithësi, pasi që asnjë shtet më nuk do të ishte i sigurt se çfarë janë obligimet dhe të drejtat e tij kundrejt të tjerëve. Kjo rrethanë e shpjegon dispozitën sipas së cilës marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga organet e autorizuara në sistemin kosovar, por edhe në shumicën e sistemeve kontinentale, kanë forcë më të madhe se ligjet e zakonshme, ndërkohë që, sipas fuqisë juridike, gjenden nën normat kushtetuese: ndryshimi apo tërheqja nga marrëveshjet ndërkombëtare nuk mund të bëhet veçse sipas procedurave të njëjta sipas të cilave janë krijuar marrëveshjet e tilla.[442]

Ajo çka është e papërcaktuar në Kosovë lidhur me fuqinë juridiko-kushtetuese të së drejtës ndërkombëtare, përveç asaj pjese që buron nga marrëveshjet ndërkombëtare, ka të bëjë me zgjidhjet e ofruara në dispozitat e nenit 16.3 ["Epërsia e Kushtetutës"] lidhur me nenin 19 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] të Kushtetutës. Deri sa Kushtetuta është e qartë kundrejt marrëveshjeve ndërkombëtare, nuk ekziston një prononcim i tillë për pjesët e tjera të së drejtës ndërkombëtare. Sa i përket së drejtës zakonore ndërkombetare si dhe normave *jus cogens*, në veçanti ato që lidhen me të drejtën

---

Review: The Lisbon Judgement and German Constitutional Court", në José María Beneyto / Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the Recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond* (Nomos: Baden-Baden, 2011) fq. 45-62; Mattias Wendel, "Lisbon Before the Courts: Comparative Perspectives", në José María Beneyto / Ingolf Pernice (eds.), vepra. cit., fq. 65-106. Përveç Gjermanisë, Spanja dhe disa vende perëndimore kanë synuar të bëjnë kontrollin kushtetues substancial të dispozitave kushtetuese e legjislative të Bashkimit Evropian. Rrugë të njëjtë kanë ndjekur edhe vendet ishkomuniste të Evropës, edhe pse me më pak ndikim se Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë (GjFK). Cf. për më shumë Alexander H.E. Morawa, "Kafka, Kelsen and Supremacy: How European Courts Interact with a View to Fostering Constitutionalism", në Kyriaki Topidi and Alezander H.E. Morawa (eds.), *Constitutional Evolution in Central and Eastern Europe* (Ashgate: Burlington, 2011) fq. 166-171; Antonio López Pina, "The Spanish Constitutional Court, The European Law and the Constitutional Tradition Common to the Member States (art. 6.3 of the TEU): Lisbon and Beyond", në Beneyto/Pernice (eds.), vepra cit., fq. 137-165; Roberto Miccu, "Toward a (Real) Cooperative Constitutionalism? New Perspectives on the Italian Constitutional Court", në Beneyto/Pernice (eds.), vepra cit., fq. 109-130; Jiří Zemánek, "The Two Lisbon Judgements of the Czech Constitutional Court", në Beneyto/Pernice (eds.), vepra cit., fq. 45-63; Emilia Drumeva, "Evolutive Attitude of the Bulgarian Constitutional Court in EU Law Space", në Beneyto/Pernice (eds.), vepra cit., fq. 131-136; Alexander H.E. Morawa, "Kafka, Kelsen and Supremacy", vepra cit., fq. 167-171.

[442] Cf. neni 18.4 ["Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare"] lidhur me nenin Neni 19.2 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] të Kushtetutës.

penale ndërkombëtare, gjykojmë se të njëjtat duhet të kenë epërsi ndaj Kushtetutës së Kosovës. Kjo edhe për faktin se në Kosovë, si pjesë e ish-Jugosllavisë, ka pasur dispozita të tërthorta, qoftë në tekstin kushtetues[443] apo në Planin Ahtisaari,[444] nëpërmjet të cilave janë marrë detyrime për zbatim të normave ndërkombëtare të natyrës zakonore me forcë *jus cogens*, sado që këtu edhe nuk mund të flitet *stricto sensu* për marrje të detyrimit për zbatim, sepse këto norma duhet të zbatohen domosdo. Disa vende, siç është rasti me Holandën, ia njohin epërsinë ndaj Kushtetutës çdo norme që buron nga marrëveshjet ndërkombëtare, ndërkohë që, siç u tha më herët, zgjidhjet standarde në sistemin kontinental, përfshirë Kosovën, janë që këtyre normave t'u njihet statusi i epërsisë ndaj ligjeve të zakonshme të vendit, por jo edhe ndaj Kushtetutës.[445]

---

[443] Neni 16.3 ["Epërsia e Kushtetutës"]: "Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare".

[444] Cf. Neni 2.3.a ["Mandati i Kompetencave të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar"] në Aneksin IX ["Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar"] i Planit Ahtisaari.

[445] Në Evropë, megjithatë, ka vende, siç është rasti me Holandën, të cilat i japin një përparësi absolute të drejtës ndërkombëtare kundrejt të drejtës së brendshme, duke mos lejuar në të njëjtën kohë që gjykatat vendëse të bëjnë kontroll kushtetues të asnjë pjese të së drejtës ndërkombëtare. Disa vende të tjera, siç është rasti me Gjermaninë, parashikojnë kontrollin kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare nëse të njëjtat cenojnë parimin *ultra vires* apo, siç thuhet në doktrinën gjermane, nëse marrëveshjet ndërkombëtare cenojnë "identitetin kushtetues". Megjithatë, shumica e vendeve të tjera në Evropë dhe përtej ndjekin praktikën sipas së cilës i jepet përparësi marrëveshjeve ndërkombëtare kundrejt legjislacionit vendës. Cf. më shumë për rastet e Holandës, të Gjermanisë dhe të vendeve të tjera në: Louis Prakke and Constantijn Kortmann (eds.), *Constitutional Law of 15 EU Member States* (Kluwer: Deventer, 2004); Sir Basil Markesinisins and Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law: A New Source of Inspiration?* (Routledge: London, 2006), në veçanti kapitulli 2 ("A quick glance at seven jurisdictions"); Andrew Harding and Peter Leyland (eds.), *Constitutional Courts: A Comparative Study* (Wildy, Simmonds & Hill: London, 2009); Vicki C. Jackson, *Constitutional Engagement in a Transnational Era* (Oxford UP: Oxford, 2009), në veçanti kapitulli 9 ("Constitutions as Mediating Institutions, Transnational Constitutional Values, and Engagement in Twenty-First Century Constitutional Interpretation"); Dinah Shelton (ed.), *International Law and Domestic Legal Systems: Incorporation, Transformation, and Persuasion* (Oxford UP: Oxford, 2011); Anne Peters and Ulrich K. Preuss, "International relations and international law", botuar në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Routledge Handbook of Constitutional Law* (Routledge: London, 2013) fq. 33-43, në fq. 37-39.

2. Karta kosovare mbi të drejtat e njeriut: vendi dhe rëndësia e saj

Kushtetuta e Kosovës ngërthen të gjitha dimensionet e njohura mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të cilat kanë të bëjnë qoftë me efektin apo me vetë natyrën e tyre. Siç dihet, shikuar historikisht, të drejtat e njeriut synojnë kufizimin e pushtetit politik. Ky efekt, i cilësuar si vertikal, përbën dimensionin parësor që flet për vetë lindjen e konceptit të të drejtave të njeriut që nga mesjeta e deri në nxjerrjen e teksteve moderne kushtetuese. Me një fjalë, kufizimi vertikal i pushtetit politik ka qenë dhe mbetet kryefjala e konceptit mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Shumë më vonë, doktrina juridike gjermane krijoi termin tjetër për të treguar se të drejtat e njeriut kanë edhe një efekt pandan atij vertikal, i njohur si efekti horizontal (*Drittwirkung*).[446]

Si në kushtetutat e tjera të demokracive perëndimore, edhe në rastin e Kosovës, gjenden dispozitat kushtetuese që flasin për dy këto aspekte të efektit të të drejtave të njeriut. Këtu e kemi fjalën për dispozitat kushtetuese të cilat, *grosso modo*, gjenden në nenet 21-62 të Kapitullit II ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore"] dhe të Kapitullit III ["Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre"] të Kushtetutës. Ndërkohë që efekti vertikal nuk është kontestues, efekti horizontal i të drejtave kushtetuese në Kosovë nuk bie nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, meqenëse e njëjta mund të vendosë vetëm mbi kushtetutshmërinë e akteve individuale të autoriteteve publike kosovare. Me fjalë të tjera, ky juridiksion shërben vetëm për të treguar mënyrën se si autoritetet publike duhet të garantojnë efektin horizontal në nivel të dytë (dytësor). Si i tillë, juridiksioni në fjalë më shumë prodhon, siç do të thuhej në gjuhën e Bashkimit Evropian, një efekt të tërthortë horizontal, sesa një efekt të drejtpërdrejtë.

Ka pasur dhe një dimension tjetër që e ka prodhuar doktrina juridike dhe që lidhet me përcaktimin e natyrës së të drejtave të njeriut, dimension që po ashtu reflektohet në dispozitat e Kushtetutës së Kosovës. Doktrina juridike ka kohë që argumenton se të drejtat e njeriut janë të drejta natyrore, të cilat njerëzit i gëzojnë për faktin e thjeshtë se janë qenie njerëzore dhe, për pasojë, gëzimi i tyre në praktikë nuk varet nga ajo nëse përmenden në tekstin kushtetues. Si të tilla, ato thjesht ekzistojnë si një rend objektiv i vlerave që mbijetojnë tekstin kushtetues. Shumica e të drejtave civile dhe politike, të emërtuara si të drejta klasike, kanë një status të tillë. Të drejtat e tjera, që nuk kanë

---

[446] Cf. më shumë për këtë në Eric Engle, "Third Party Effect of Fundamental Rights (*Drittwirkung*)", *Hanse Law Review* vol. 5, no. 2 (2009) fq. 165-173.

një status të tillë, cilësohen si të drejta pozitiviste, të cilat gëzohen nga individët për faktin se, si të tilla, i përcakton teksti kushtetues. Dy këto aspekte, natyror dhe pozitivist, reflektohen gjerësisht nëpër tekstet kushtetuese moderne të vendeve të ndryshme. Kosova nuk bën përjashtim në këtë aspekt, sepse Kushtetuta, në Kapitullin II, përmban dispozita që kryesisht reflektojnë natyrën natyrore të të drejtave të njeriut, ndërkohë që Kapitulli III ngërthen të kundërtën e saj, pra natyrën pozitiviste të të drejtave të njeriut. Natyra pozitiviste vërehet në këtë kapitull, nisur nga fakti se reflekton kontestin kosovar në tërësi, dhe vështirë se mund të gjendet gjetiu në Evropë nëpër tekstet kushtetuese (përjashtim bën Maqedonia, siç e thamë më sipër).

Për dimensionin natyror flet dispozita e nenit 21.1 ["Parimet e Përgjithshme"] të Kapitullit II të Kushtetutës, i cili thotë, si vijon: "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës". Dimensioni tjetër, ai pozitivist, pra dimensioni kontekstual që buron nga zhvillimi kushtetues i shtetit modern dhe i demokracisë kushtetuese në përgjithësi, në rastin e Kosovës pasqyrohet në dispozitat e Kapitulli III. Ky kapitull është efekt refleksiv i kontekstit specifik kosovar lidhur me mbrojtjen dhe me përparimin e të drejtave dhe lirive njerëzore të grupeve të caktuara, të cilësuara si komunitete, të cilat janë pjesë përbërëse e popullsisë së Kosovës. Këto të drejta dhe liri njerëzore janë specifike për faktin se janë rezultat i drejtpërdrejtë i zhvillimit historik dhe i kontekstit socio-politik të Kosovës. Në të njëjtën kohë, ato janë të drejta e liri njerëzore pozitive për aq sa garantohen me Kushtetutë. Këto dy aspekte, pra aspekti specifik e kontekstual dhe ai pozitivist i këtyre të drejtave e lirive njerëzore, pasqyrohet në parimin e parë të nenit 57 ["Parimet e Përgjithshme"] të Kapitullit III të Kushtetutës. Në këtë nen përcaktohet, *inter alia*, se këto të drejta i gëzojnë "banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (komunitetet) krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute". Parimi në vijim, parimi i dytë, i nenit të njëjtë, garanton autonominë e plotë të individit për të zgjedhur lirisht nëse dëshiron të trajtohet ose të mos trajtohet si pjesëtar i komunitetit, duke siguruar që nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që ndërlidhen me këtë zgjedhje nuk mund të rezultojë asnjë diskriminim. Qëllimi i këtij sanksionimi kushtetues tregohet më tutje në parimin e tretë me radhë të nenit 57, i cili konsiston në atë që t'u mundësohet pjesëtarëve të komuniteteve që lirisht të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë identitetin dhe atributet e tyre si komunitet. Në

parimin e fundit të këtij neni reflektohet dimensioni horizontal pozitivist, meqenëse përcaktohet që komunitetet në ushtrimin e këtyre të drejtave kanë edhe detyrim e përgjegjësi për të vepruar në pajtim me ligjin e Republikës së Kosovës, duke mos i cenuar të drejtat e të tjerëve.

Të gjitha këto dimensione të të drejtave të njeriut, vertikal-horizontal dhe natyror-pozitivist, janë prodhim i pastër i dizajnit kushtetues kosovar, i cili është përpiluar me ndihmën e madhe të bashkësisë ndërkombëtare dhe me përqafim krejt të vullnetshëm të kosovarëve. Ky dizajn reflekton vlerat kryesore, parimet, normat dhe cilësitë e konstitucionalizmit modern, ashtu si ekziston aktualisht në botën perëndimore, dhe jo strukturën materiale të shoqërisë së Kosovës.[447] Se kjo është kështu vërehet që nga fakti se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në Kushtetutë paraqiten si cilësi definuese të shtetit të ri të Kosovës në të cilin sovraniteti dhe pavarësia si dhe ushtrimi i pushtetit në të nuk mund të kryhen pa respektim të plotë të të drejtave dhe lirive themelore[448]. Kjo rrethanë, e shikuar në dritën e dispozitave të tjera të Kushtetutës, të cilat flasin për ndarjen e pushtetit, për pluralizmin politik dhe të pronës, për tregun e lirë liberal, paraqesin vetë esencën e sistemit kushtetues kosovar.

Ndihma ndërkombëtare në dizajnimin kushtetues nuk është specifikë vetëm e Kosovës sepse, shikuar historikisht, në të shumtën e rasteve, shoqëritë, që kanë kaluar nëpër faza të represionit, të dhunës, të luftërave dhe të konflikteve të llojeve të ndryshme, kanë treguar më shumë prirje për pranim të së drejtës ndërkombëtare. Këtë, zakonisht, e kanë bërë duke i inkorporuar instrumentet ndërkombëtare, apo duke i marrë ato si pikë referimi, nëpër tekstet e tyre kushtetuese të miratuara pas luftës apo pas konflikteve të tjera violente[449]. Historia violente dhe tragjike e këtyre shoqërive, megjithatë, nuk

---

[447] Anne Peters and Ulrich K. Preuss, "International Relations and International Law", fq. 33-34.

[448] Cf. Neni 2 ["Sovraniteti"] në lidhje më nenin 3.2 ["Barazia Para Ligjit"] të Kushtetutës.

[449] Në rastin e Afrikës së Jugut, ta zëmë, nënseksionet 39(1)(b) dhe (c) të Kushtetutës së vitit 1996 (e cila akoma është në fuqi) përcakton që gjykatat vendore "mund të marrin në konsideratë të drejtën e huaj", mirëpo ato "duhet të marrin parasysh të drejtën ndërkombëtare", kur interpretojnë Kartën mbi të Drejtat e Njeriut. Cf., më shumë për këtë dhe për zgjidhjet e ngjashme, në: Dinah Shelton, "International Law and Domestic Legal Systems: Introduction", në Dinah Shelton (ed.), *International Law and Domestic Legal Systems*, fq. 2; Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law: A New Source or Inspiration?* (Routledge: London, 2006) fq. 6 (fusnota 14), fq. 85-108; Laurie W.H. Ackermann, "Constitutional Comparativism in South Africa. A Response to Sir Basil Markesinis and Dr. Jorg Fedke", botuar në Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law: A New Source or Inspiration?*, fq. 263-286.

është përcaktuese e identitetit kushtetues të tyre. Kosova nuk bën përjashtim në këtë aspekt. Ajo që përcakton identitetin kushtetues të një shoqërie nuk ka të bëjë me "muret e qytetit" (Aristoteli),[450] por me mënyrën e organizimit të pushtetit dhe me vendin dhe me pozitën e njeriut në shoqëri.[451] Në literaturë, identiteti kushtetues cilësohet si identitet real, për dallim nga identiteti fizik. Në rastin e Kosovës, janë dispozitat e Kapitullit II dhe të Kapitullit III të Kushtetutës, të marra së bashku, të cilat strehojnë identitetin (real) kushtetues të Kosovës, vetë "ADN"-në e saj. Ky identitet është krejt i ndryshëm nga identiteti kushtetues i Kosovës para 10 qershorit 1999. Nëse merret parasysh struktura materiale e shoqërisë kosovare aktualisht, identiteti kushtetues (real) i Kosovës është krejt i kundërt edhe me identitetin fizik kosovar. Kjo për faktin se dizajni kushtetues kosovar fokusohet në këta dy kapituj, me dinjitetin e njeriut si bazën themelore të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore. Këtë cilësi të dinjitetit të njeriut, si një vlerë e shtuar me rëndësi praktike të cilën duhet pasur parasysh çdoherë, e ka afirmuar edhe Gjykata Kushtetuese.[452] Në fakt, ky lloj pozicioni ekziston për më shumë se gjysmë shekulli në praktikën e Gjykatës Kushtetuese gjermane, i njohur si *objektive Wertordnung* ("rend objektiv i vlerave").[453] Ky rend objektiv i vlerave, në sistemin kushtetues kosovar, imponon një detyrim të pashkruar për Gjykatën që çdo interpretim të Kushtetutës ta bëjë në një mënyrë unifikuese dhe të integruar.[454] Në këtë aspekt, Kushtetuta e Kosovës nuk ka pasur asnjë dyshim se

---

[450] Ernest Barker (ed.), *The Politics of Aristotle* (Oxford UP: New York, 1962) fq. 97-98.

[451] Për një shtjellim origjinal dhe të gjerë të identitetit kushtetues, të përbërësve të tij, si dhe të vetë historikut të këtij fenomeni, cf. më shumë Gary Jeffrey Jacobsohn, *Constitutional Identity* (Harvard UP: Cambridge, Mass., 2010).

[452] Cf. në veçanti paragrafët 26 dhe 30 të *Aktgjykimit të 18 marsit 2010 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në Rastin KO01/09, Ćemailj Kurtiši dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit,* të cilët, duke cituar Planin Ahtisari si bazë legale për Kushtetutën e Kosovës, vërtetojnë *inter alia* se dy dokumentet kanë për qëllim mbrojtjen e dinjitetit, të barazisë, si dhe natyrën multietnike dhe diverse të shoqërisë kosovare.

[453] Për një analizë elokuente të këtyre segmenteve, që kanë të bëjnë me renditjen e vlerave në sistemin kushtetues gjerman, cf. më shumë në: Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law: A New Source or Inspiration*?, fq. 16-17, 71-82. Në fakt, ky rend objektiv i vlerave mbron vlerat që nuk mund të ndryshohen në asnjë rrethanë nëpërmjet amendamenteve kushtetuese, sepse një gjë e tillë do të paraqiste ndryshim në identitetin kushtetues të shoqërisë së dhënë.

[454] Si i tillë, ky koncept që sheh tekstin kushtetues si një dhe të integruar, buron nga përvoja gjermane. Cf. më shumë në: Donald P. Kommers, "German Constitutionalism: A Prolegomenon", në *Emory Law Journal* vol. 40, issue 1 (Summer, 1991); Donald P. Kommers, *The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany*, 2nd ed. (Duke UP: Durham, 1997) fq. 3-60.

shoqëria e saj duhet të ndërpresë çdo traditë me të kaluarën, përkatësisht se Kosova nuk ka pasur pse të sfidohet nga identiteti i saj i kaluar.[455]

Nëpërmjet mekanizmit të saj institucional, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka prodhuar një jurisprudencë që është për lakmi dhe që i kalon gjykatat e tjera të vendeve ish-komuniste. Aktivizmi gjyqësor dhe puna efektive e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nuk do të kishte kuptim sikur të mos ekzistonte juridiksioni i nenit 113.7 të Kushtetutës, që rregullon të drejtën për ankesë individuale të individëve (dhe të personave juridikë) në rastet kur çmojnë se me akt individual të ndonjë autoriteti publik në Kosovë u janë cenuar drejtat apo liritë e garantuar me Kushtetutë. Ky nen, në fakt, i jep kuptim Kartës së Kosovës për të Drejtat e Njeriut, të mishëruar në Kapitullin II dhe në Kapitullin III të Kushtetutës, për faktin e thjeshtë se ankesa, sipas 113.7, është e "tipit të plotë", duke i dhënë kështu një kuptim krejt konkret kapitujve në fjalë.[456] Se kjo është kështu, shihet nga fakti se Gjykata Kushtetuese, falë kësaj dispozite, duhet të merret në pjesën më të madhe me rastet e ankesave individuale: mbi 90 për qind e rasteve të parashtruara në Gjykatë, të nisura nga personat fizikë dhe juridikë në Kosovë, kanë të bëjnë me ankesa për cenim të të drejtave nga Kapitulli II dhe nga Kapitulli III i Kushtetutës.[457] Interpretimi

---

[455] Për rastet e tundimeve gjatë kushtetutëbërjes për zgjedhjen ndërmjet të së kaluarës së mirë dhe të së ardhmes së pasigurt, cf. më shumë në shkrimin e Alexander H.E. Morawa, "Kafka, Kelsen and Supremacy: How European Courts Could Interact with a View to Fostering Constitutionalism", në Kyriaki Topidi and Alexander H.E. Morawa (eds.), *Constitutional Evolution in Central and Eastern Europe*, fq. 159-205.

[456] Ky emër buron nga jurisprudenca gjermane dhe ka të bëjë me faktin sipas të cilit Gjykata mund të vendosë si aspektet faktike ashtu dhe ato juridike të rastit konkret. Në këto sisteme, të cilëve u takon edhe Kosova, gjykatat kushtetuese konsiderohen si vend ku gjenden mjete efektive juridike para se të shkohet në GjEDNj. Kjo është kështu sepse gjykatat kushtetuese në këto sisteme kanë të drejtën e prishjes së vendimeve përfundimtare të gjykatave të rregullta dhe të vendimeve të institucioneve të tjera publike dhe t'i rikthejnë prapa te vendimmarrësi për shqyrtim të sërishëm në dritën e lëshimeve të gjetura nga gjykata kushtetuese përkatëse. Cf. më shumë për këtë në: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), *Study on Individual Access to Constitutional Justice* (Council of Europe: Strasbourg, 2009), Study No. 538/2009 Adopted by the Venice Commission at its 85th Plenary Session (Venice, 17-18 December 2010).

[457] Ky aspekt i punës së gjykatave kushtetuese në lëmin e të drejtave të njeriut është cilësuar si "procesi i juridifikimit të diskursit mbi të drejtat e njeriut". Cf. më shumë për këtë në: Tom Campbell, K.D. Ewing and Adams Tomkins, "Introduction", botuar në Tom Campbell, K.D. Ewing and Adams Tomkins, *The Legal Protection of Human Rights: Skeptical Essays* (Oxford UP: Oxford, 2011) fq. 1-10; Janet L. Hiebert, "Governing Like Judges?", botuar në Campbell, Ewing and Tomkins, vep. cit., fq. 40-65. Punimet e tjera të këtij vëllimi shprehin qëndrim të njëjtë, përkatësisht se mbrojtja e të drejtave të njeriut kërkon më shumë diskutim mbi aspektet e tyre politike, sociale e kulturore sesa diskutim mbi konstruksionin juridik, të

që Gjykata i bën Kushtetutës bazohet jo në strukturën materiale të shoqërisë kosovare por në nenin 53 ["Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut"] të Kushtetutës, i cili përcakton se "të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Kjo, më tutje, nënkupton se parimet, vlerat, normat dhe premisat e përmbajtura në kapitujt II dhe III të Kushtetutës, janë efekt refleksiv i karakteristikave themelore të konstitucionalizmit modern perëndimor. Kur Gjykata interpreton dispozitat e këtyre dy kapitujve, këtë e bën krejt në mënyrë të pavarur nga ndërgjegjja morale e aktorëve lokalë kosovarë dhe nga vetë struktura materiale e shoqërisë kosovare, duke u bazuar vetëm në urdhrin nga neni 53 i Kushtetutës.[458] Se kjo është kështu shihet jo vetëm nga struktura e këtij neni dhe e nenit 113.7 të Kushtetutës, por edhe nga dispozitat e tjera kushtetuese, të cilat flasin për juridiksionin e Gjykatës. Modeli i drejtësisë kushtetuese kosovare, i përcaktuar me dispozitat kushtetuese mbi juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, i jep kësaj të fundit një rol dhe një pozitë të fortë në sistemin kushtetues kosovar. Këto janë çështje të cilat diskutohen në rreshtat në vijim.

3. Natyra e Gjykatës Kushtetuese dhe lloji i juridiksionit të saj

Vendi dhe rëndësia e Gjykatës Kushtetuese në Kosovë përcaktohet nga dy faktorë. I pari ka të bëjë me atë se ajo nuk paraqet pjesë të sistemit gjyqësor e as pjesë të sistemit të drejtësisë kosovare, por një *pouvoir constitué*, e ndarë nga pjesët e tjera të pushtetit.[459] Këtë e ka bërë të qartë katërçipërisht neni 4 i Kapitullit I ["Dispozitat Themelore"] të Kushtetutës, i cili flet për formën e

---

cilin ata e quajnë "juridifikim", për ta dalluar nga "politizimi" që ndodh në kuadër të trupave politike dhe reprezentative që kanë një natyrë deliberative (siç janë parlamentet, këshillat, shoqëria civile, dhe ngjashëm me këto).

[458] Cf. më shumë për këtë aspekt në Thomas Risse and Kathryn Sikknik, "The Socialization of International Human Rights Norms Into Domestic Practices: Introduction", në Thomas Risse, Kathryn Sikkink and Stephen C. Ropp (eds.), *The Power of Human Rights: International Norms and Domestic Change* (Cambridge UP: Cambridge, 1999) fq. 17.

[459] Në disa kushtetuta dhe në disa vende, gjyqësia kushtetuese llogaritet si pjesë e gjyqësorit. Cf. më shumë për këtë në: European Commission for Democracy Through Law ["Venice Commission"], *Models of constitutional jurisdiction* (Council of Europe Press: Strasbourg, 1994); European Commission for Democracy Through Law ["Venice Commission"], *The role of the constitutional court in the consolidation of the rule of Law* (Council of Europe Press: Strasbourg, 1994); dhe Lech Garlicki, "Constitutional Courts versus Supreme Courts", *International Journal of Constitutional Law* vol. 5, no. 1 (January 2007).

qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit. Në paragrafin 6 të këtij neni, pasi flitet për formën e qeverisjes në Kosovë dhe për mënyrën e ndarjes së pushtetit,[460] menjëherë konstatohet se Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë, e cila bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Këtë interpretim Gjykata e bën nëpërmjet ushtrimit të juridiksionit të saj të paraparë në nenin 113 të Kushtetutës ["Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara"], si dhe të juridiksionit shtesë që mund të përcaktohet më ndonjë ligj të veçantë.[461] Për juridiksionin e Gjykatës do të flasim në vijim të këtij punimi, kurse tani mjafton të ceket se kjo që u tha më sipër paraqet një formulim klasik të vendit dhe të rëndësisë së një gjykate kushtetuese, ashtu siç është koncipuar nga Hans Kelsen.

Vërtetësia e kësaj që u tha më sipër shihet jo vetëm në shtjellimet doktrinare të vetë Hans Kelsenit, por edhe në përmbajtjen e polemikës së tij me mohuesit e idesë së gjyqësisë kushtetuese, e bërë ndërmjet dy luftërave botërore.[462] Ka autorë që shkojnë më larg se kaq, duke e lidhur idenë e gjyqësisë

---

[460] Neni 4 ["Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit"]: "1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë; 2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ; 3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë; 4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar; 5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat; 6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës; 7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës".

[461] I tillë është rasti, ta zëmë, me juridiksionin shtesë që parashihet për Gjykatën me nenin 106.1 ["Rezultatet Zgjedhore"] të Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, të 5 qershorit 2008; dhe me nenin 64.2.3 të Ligjit Nr. 03/L-04 për vetëqeverisjen lokale, të 20 shkurtit 2008.

[462] Për polemikën ndërmjet Carl Schmittit dhe Hans Kelsenit cf. Karl Šmit, "Čuvar Ustava", botuar në Slobodan Samardžić (ed.), *Norma i Odluka. Karl Šmit i Njegovi Kritičari* ("Filip Višnjić": Beograd, 2001) fq. 211-253. Titulli i origjinalit Carl Schmitt, "Der Hüter der Verfasung", *Archiv des offentlichen Rechts*, Neue Folge 16 Band J.C.B. Mohr (Paul Siebeck), Tubingen 1929; Hans Kelsen, "Ko treba da bude čuvar Ustava", botuar në Slobodan Samardžić (ed.), *Norma i odluka*, fq. 256-297. Titulli në original: Hans Kelsen, *Wer soll der Hüter der Verfassung sein?* (Dr. Walther Rothschild, Berlin-GruNewald, 1931).

Kritikën e tij për sistemin gjyqësor dhe për pamundësinë totale të këtij sistemi për të qenë gardian i kushtetutës, C. Schmitt e kishte shtjelluar shumë më herët në librin e tij monumental me titull "Teoria Kushtetuese". Cf. Carl Schmitt, *Constitutional Theory* (Duke UP:

kushtetuese me shtjellimet doktrinare të Benjamin Constantit (Benzhamen Konstan), ideatorit të dallimit ndërmjet *pouvoir constitutant* dhe *povoir constitué*. Shtjellimet e tilla doktrinare të B. Constantit janë bazuar në rolin e fortë të gjykatave franceze gjatë *ancien régime* dhe në kompromet imin e tyre gjatë asaj periudhe, rrethanë e cila pas Revolucionit (1879) pati për pasojë detyrimin e gjyqtarëve që të jenë zbatues të verbër të ligjit pa pasur asnjë të drejtë në interpretim të tij.[463] Thënë shkurt, pas rënies së *ancien régime*, gjyqtarët u trajtuan si *la bouche de la loi* dhe asgjë më shumë. Vullneti i shumicës u shpall si diçka krejt absolute. Kjo rrethanë shkaktoi lindjen e ideve për dallimet ndërmjet pushtetit krijues (*pouvoir constitutant*) dhe atij të krijuar (*povoir constitué*), si dhe për nevojën e pasjes së një trupi brenda parlamentit, që do ta vlerësonte cilësinë e ligjeve të nxjerra nga shumica, për t'i hequr gjyqësisë së rregullt monopolin dhe mundësinë e interpretimit të ligjit. Aferësisht e njëjta arsye historike ka ekzistuar në vendet ish-komuniste, përfshirë Kosovën, për ndarjen e gjyqësisë kushtetuese nga gjyqësia e rregullt, si dhe për fuqizimin e gjyqësisë kushtetuese me anë të njohjes së një juridiksioni mjaft të gjerë në favor të gjykatave kushtetuese. Këto të fundit u panë si mekanizma të veçantë për mbrojtjen dhe për promovimin e demokracive kushtetuese në të gjitha segmentet e saj.[464]

Durham, 2008) fq. 147-164. Titulli i origjinalit: Carl Schmit, *Varfassungslehre* (Duncker und Humblot: Munich, 1928).

Edhe Hans Kelsen, mjaft herët, në vitet 1911 deri më 1934, kishte botuar libra në të cilat kishte shtjelluar deri në detaje nevojën e pasjes së një gjykate të ndarë kushtetuese nga gjyqësori i rregullt, për arsyet që kryesisht lidheshin me kompromet imin e gjyqtarëve gjatë kohës së perandorive gjermane e austriake respektivisht. Fjalën e kemi për *General Theory of Law and State* (The Lawbook Exchange Ltd.: Clark, 2007, 2009), e cila paraqet në thelb versionin e përpunuar të librit të tij *Pure Theory of Law* (The Lawbook Exchange Ltd.: Clark, 2002, 2009). Dy këto vepra, siç u tha, janë botuar shumë para debatit të nisur me Carl Schmittin, në dekadat e para të shekullit XX.

Për një trajtim të thellë të pikave kyçe të polemikës kushtetuese ndërmjet Carl Schmittit dhe Hans Kelsenit, cf. më shumë në Michael Stolleis, *A History of Public Law in Germany: 1914-1945* (Oxford UP: Oxford, 2004), në veçanti kapitullin 3 ("Revolution, Weimar Constitution, and Versailles") dhe kapitullin 5 ("Quarrel Over Methods and the Crisis of the State").

[463] Cf. Biancamaria Fontana (ed.), *Benjamin Constant: Political Writings* (Cambridge UP: Cambridge, 2010) fq. 171-328.

[464] Kyriaki Topidi and Alexander H.E. Morawa, "Prologue: Constitutional Transition in Central and Eastern Europe", në Kyriaki Topidi and Alexander H.E. Morawa (eds.), *Constitutional Evolution in Central and Eastern Europe* (Ashgate: Burlington, 2011) fq. 4-5; Kyriaki Topidi, "Fundamental Rights in the EU's Post-Enlargement Landscape: An Exercise in Constitutional Translation", në Topidi and Morawa (eds.), vepra cit., fq. 70-72; Daniel Smilov,

Kjo na sjell deri te faktori i dytë, i cili, në vijim për sa më sipër, ka të bëjë me faktin e juridiksionit jashtëzakonisht të gjerë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Ky juridiksion përcaktohet me nenin 113 të Kushtetutës dhe, si i tillë, paraqet juridiksionin më të gjerë të mundshëm, krahasuar jo vetëm me vendet ish-komuniste në Evropë por edhe me demokracitë kushtetuese perëndimore me një traditë të gjatë.

Gjykata e tanishme, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, është themeluar në fillim të vitit 2009, me *Ligjin Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës*.[465] Që nga shkurti i vitit 2009 e deri në kohën e këtij shkrimi (tetor 2014), Gjykata ka pranuar 892 kërkesa. Prej tyre, janë zgjidhur 839 kërkesa, ndërsa të tjerat janë në proces të vendosjes. Në përgjithësi, pothuajse 90 për qind e kërkesave janë shpallur të papranueshme. Gjykata ka nxjerrë aktgjykime vetëm në 10 për qind të rasteve. Një gjendje e tillë është e ngjashme me vendet e tjera që kanë procedura të ankesës së plotë kushtetuese. Kjo është kështu për faktin se shumica dërrmuese e kërkesave, rreth 90 për qind e tyre, kanë të bëjnë me ankesa individuale nga qytetarët dhe nga personat e tjerë juridikë.[466] Kjo sikur bie ndesh me konceptin themelor të Hans Kelsenit mbi rolin dhe pozitën e gjyqësisë kushtetuese. Por, siç e ka thënë një autor, ne, sado që jemi shumë mirënjohës ndaj Kelsenit, nuk jemi robër të tij.[467] Kjo për faktin se kontrolli abstrakt i normave juridike akoma mbetet kryefjala e të gjitha kushtetutave nacionale kur bëhet fjalë për definimin e gjyqësisë kushtetuese, për rolin dhe për funksionin e saj primar, sado që ankesat individuale përbëjnë ngarkesën dërrmuese të punës së gjykatave kushtetuese. Kjo, për faktin se, siç dihet, me lindjen e kartës së drejtave të njeriut si kategori kushtetuese, që filloi me Kushtetutën e Vajmarit, gra-

---

"The Rule of Law and the Rise of Populism: A Case Study of Post-Accession Bulgaria", në Topidi and Morawa (eds.), vepra cit., fq. 270-271.

[465] Ky ligj u miratua nga Kuvendi i Kosovës më 16 dhjetor 2008. Është shpallur me Dekretin Nr. DL-070-2008, të 30 dhjetorit 2008.

[466] Për këtë gjendje të gjërave në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, cf. më shumë në hulumtimin e detajuar të ndërmarrë nga një studiues i ri, Jean-Marc Lacourcière, *Report on the Jurisprudence of the Constitutional Court of Kosovo on Human and Minority Rights* (Kosovo Law Center: Prishtinë, 2011). Për gjendjen në vendet e tjera ish-komuniste, cf. Wojciech Sadurski, "Constitutional Justice, East and West: An Introduction", në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective*, fq. 1-18; John Ferejohn and Pasquale Pasquino, "Constitutional Courts as Deliberative Institutions: Towards an Institutional Theory of Constitutional Justice", në Sadurski (ed.), vepra cit., fq. 21-36.

[467] Allan R. Brewer-Carias, *Constitutional Courts as Positive Legislators: A Comparative Law Study* (Cambridge UP: Cambridge, 2011) fq. 31, fusnota 74.

dualisht u bë e domosdoshme të krijohet edhe një mekanizëm institucional për vënien në jetë të këtyre kartave mbi të drejtat e njeriut. Kjo gjë u pa si e domosdoshme në veçanti pas Luftës së Dytë Botërore, kur kushtetutat nacionale në mënyrë graduale po fusnin në dispozitat e tyre normat mbi të drejtat e njeriut si dhe mekanizmat përkatës institucional për vënien e tyre në jetë (së bashku me instrumentet juridike — siç është ankesa kushtetuese — të cilat qytetarët mund t'i përdorin për realizimin e të drejtave e lirive të tyre).

Sikur u tha më sipër, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka juridiksionin më të gjerë ndër gjykatat simotra në Ballkan. Ajo është e modeluar sipas sistemit gjerman, që do të thotë me një fjalë se ka juridiksion mbi të gjitha veprimet e të gjitha autoriteteve publike në vend, përfshirë gjyqësorin. E vetmja procedurë që nuk është paraparë në Kushtetutë është ajo e iniciuar me *actio popularis*. Në kuptim të së drejtës kushtetuese, Gjykata ka juridiksion, *inter alia*, mbi të gjitha llojet e kontrollit abstrakt të normave ligjore dhe kushtetuese, *ex ante*[468] dhe *ex post*;[469] ka juridiksion mbi kontrollin incidental të normës që mund të iniciohet nga çdo gjykatë në Kosovë, në çdo kohë, me kusht që në to të jetë në procedurë e sipër një rast apo një çështje e diskutueshme;[470] ka juridiksion mbi konfliktin për kompetenca, që lind ndërmjet pushtetit qendror dhe autoriteteve të tjera publike në Kosovë;[471] ka juridiksion në mbrojtjen në

---

[468] Neni 113, paragrafi 9, i Kushtetutës ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"]: "Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës."

[469] Neni 113, paragrafët 2 dhe 5, i Kushtetutës ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"]:

"2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim: (1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën; (2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën. [...]

"5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur."

[470] Neni 113, paragrafi 8, i Kushtetutës ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"]: "Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë".

[471] Neni 113, paragrafi 3 (1), i Kushtetutës ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"]: "Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë

përgjithësi të të drejtave të autoriteteve lokale *vis-à-vis* autoriteteve qendrore;[472] ka juridiksion mbi shkeljet e pretenduara të Kushtetutës nga ana e Presidentit të Republikës;[473] ka juridiksion mbi vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, mbi referendumet e propozuara, mbi propozim-amendamentet kundrejt marrëveshjeve të obligueshme ndërkombëtare të ratifikuara në mënyrën e duhur si dhe mbi kushtetutshmërinë e zgjedhjeve për Kuvend;[474] ka juridiksion mbi ankesat individuale pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike brenda rendit kushtetues dhe juridik të Kosovës;[475] dhe, në fund, ka juridiksion shtesë që mund të caktohet me ligj.[476]

Vendi dhe pozita e Gjykatës Kushtetuese në sistemin kushtetues kosovar përcaktohet nga juridiksioni i saj i gjerë. Ky juridiksion i ka mundësuar asaj një rol mjaft aktiv në formësimin e shoqërisë kosovare përgjatë vijave të konstitucionalizmit modern perëndimor, duke qenë kështu një aktor kyç në përgatitjen e integrimit të Kosovës në strukturat euroatlantike. Kjo shihet nga vetë mënyra e arsyetimit të vendimmarrjes së Gjykatës, që bazohet në tërësi në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kur bëhet fjalë për vënien

çështjet në vijim: 1. konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës".

[472] Neni 113, paragrafi 4, i Kushtetutës ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"]: "Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt".

[473] Neni 113, paragrafi 6, i Kushtetutës (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara): "Tridhjetë (30) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, janë të autorizuar të ngrenë çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës".

[474] Neni 113, paragrafi 3 (pika 2 deri 5), i Kushtetutës (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara): "Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim: (1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës; (2) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën; (3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën; (4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur; (5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit".

[475] Neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara): "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

[476] Neni 113, paragrafi 10, i Kushtetutës (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara): "Juridiksioni shtesë mund të rregullohet me ligj".

në jetë të standardeve më të larta evropiane mbi të drejtat e njeriut, si dhe për përdorimin e metodës komparative kur bëhet fjalë për vendimmarrjen tjetër jashtë sferës së të drejtave të njeriut. Kësi roli aktiv kanë pasur edhe gjykatat kushtetuese të vendeve ish-komuniste në Evropë, të cilat, me vendimmarrjen e tyre, kanë hapur rrugë e perspektiva të reja për integrimin në Evropë të këtyre vendeve që kishin kaluar nëpër regjime të ashpra totalitare.[477]

4. Faktori ndërkombëtar: roli i tij në procesin e kushtetutëbërjes dhe në kuadër të sistemit kushtetues

Sado që autorët kosovarë synojnë ta fshehin rolin vendimtar të faktorit ndërkombëtar në procesin e krijimit të Kushtetutës së Kosovës, herë-herë duke e cilësuar veten si përpilues të saj, e vërteta është se ky faktor, nëpërmjet ekspertëve të vet, i ka dhënë asaj formën dhe përmbajtjen aktuale. Kjo tanimë nuk mohohet nga autorët e huaj, të cilët, me kompetencë dhe në bazë të burimeve krejt të besueshme nga pikëpamja komparative, kanë arritur te përfundimi i mësipërm, të cilin pa asnjë dyshim e përkrah edhe autori i këtyre rreshtave.[478] Kosova nuk është e vetme në këtë drejtim. Roli dhe

---

[477] Kasia Lach and Wojciech Sadurski, "Constitutional Courts of Central and Eastern Europe: Between Adolescence and Maturity", në Andrew Harding and Peter Leyland (eds.), *Constitutional Courts: A Comparative Study* (Wildy, Simmonds & Hill: London, 2009) fq. 52-80.

[478] Cf. më shumë në Anne Peters and Ulrich K Preuss, "International relations and international law", botuar në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Routledge Handbook of Constitutional Law* (Routledge: London, 2013) fq. 33-34.

Se kjo është kështu shihet edhe nga fakti se, në punën e saj, Gjykata Kushtetuese e Kosovës disa herë është ndeshur me pamundësinë e sigurimit të qoftë edhe të një rreshti të *travaux préparatoires* me rastin e interpretimit autentik të Kushtetutës. Gjykata, në fakt, disa herë ka tentuar të gjejë një kopje të *travaux préparatoires*, por më kot. Në Kuvendin e Kosovës, dhe askund tjetër, nuk gjenden tekstet e tilla. Një mik ndërkombëtar, i cili ka qenë i involvuar në draftimin e Kushtetutës së Kosovës, i ka thënë autorit të këtyre rreshtave se arsyeja për mungesën e këtyre teksteve është se të huajt kanë dashur të fshehin çdo gjurmë të ndihmës së sinqertë dhe krejt profesionale që ia kanë dhënë Kosovës gjatë fazës së kushtetutëbërjes.

Kjo gjendje me *travaux préparatoires*, megjithatë, nuk ka ngelur pa pasoja. Me rastin e marrjes së dy aktgjykimeve, respektivisht më 1 korrik 2014 dhe më 26 gusht 2014, të cilat kishin të bënin me formimin e organeve pas zgjedhjeve nacionale të 8 qershorit 2014, u krijua një situatë e pakëndshme për Gjykatën: një pjesë e kuazijuristëve e kuazintelektualëve filloi një fushatë të paparë kundër Gjykatës. Akuzat thoshin se Gjykata e dinte se ku ishin *travaux préparatoires,* por se ajo me qëllim nuk dëshironte t'i kishte në posedim. Ky diskurs akuzues ndaj Gjykatës, obskur dhe krejt qëllimkeq, nuk kishte parasysh faktin themelor se *travaux préparatoires* mund të shërbenin si mjet ndihmës në rastin e interpretimit të tekstit

rëndësia e organizatave ndërkombëtare, si dhe e aktorëve të tjerë ndërkombëtarë, në procesin e kushtetutëbërjes dallon nga vendi në vend dhe kushtëzohet nga kontekste të caktuara socio-politike.[479] Për nga dinamika e kushtetutëbërjes dhe për nga pesha e ndërhyrjes ndërkombëtare, Bosnjë-Hercegovina, Iraku, Afganistani dhe Kosova paraqesin shembuj tipikë ku organizatat ndërkombëtare dhe aktorët e tjerë i kanë dhënë vulën procesit të kushtetutëbërjes dhe vetë produktit të dalë nga ai proces.[480] I tillë ka qenë rasti me Gjermaninë dhe me Japoninë, pas Luftës së Dytë Botërore.[481]

E dalë nga një proces kushtetutëbërës si më sipër, Kushtetuta e Kosovës paraqet një prerje radikale me të kaluarën, për arsyen e thjeshtë se nuk reflekton strukturën materiale të shoqërisë kosovare, por reflekton vlerat dhe

---

kushtetues kosovar vetëm nëse ato gjendeshin të arkivuara në Kuvendin e Kosovës, dhe askund tjetër. Në të njëjtën kohë që akuzohej e goditej Gjykata lidhur me çështjen e *travaux préparatoires*, këta kuazijuristë e kuaziintelektualë dilnin me tezën se kishte njerëz në Kosovë që i kishin në posedim dhe, për më tepër, Gjykata kishte mbajtur anën e partisë fituese në zgjedhjet nacionale të 8 qershorit 2014 sepse, në partinë fituese, ishin ekspertët juridikë që ia kishin përshtatur kësaj partie dispozitat kushtetuese të vitit 2008, që kishin të bënin me formimin e Kuvendit dhe të Qeverisë së Kosovës (sic!). *O tempora o mores*!

Po të ndiqte Gjykata këtë logjikë, atëherë, pas çdo vendimi të saj me peshë, do të dilnin lloj-lloj "ekspertësh" dhe "hartuesish" të Kushtetutës së Kosovës, të vitit 2008, dhe do të tregonin se cili ka qenë qëllimi i kushtetutëbërësve të tekstit kushtetues kosovar, u mor vesh gjithnjë duke ia përshtatur *travaux préparatoires* e tyre një gjendjeje momentale politike. Kjo nuk shkon kështu! Këtë e ka bërë të ditur hapur autori i këtyre rreshtave në një ligjëratë të mbajtur më 29 shtator 2014 në Akademinë Diplomatike të Vjenës, të titulluar: "Roli i Gjykatës Kushtetuese në zhvillimin e sundimit të ligjit në Kosovë" (në rrjet: https://youtu.be/nNXRPrgg4pI).

[479] Cf., më shumë për këtë, në Andrew Harding, Peter Leyland, and Tania Groppi, "Constitutional Courts: Forms, Functions and Practice in Comparative Perspective", në Andrew Harding and Peter Leyland (eds.), *Constitutional Courts: A Comparative Study*, fq. 1-26.

[480] Cf., më shumë për pikëpamje të ngjashme, në këto punime: Louis Aucoin, "Introduction", në Laurel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition. Case Studies in Constitution Making* (United States Institute of Peace Press: Washington, D.C., 2010); James C. O'Brien, "The Dayton Constituion of Bosnia and Herzegovina", në Miller (ed.), vepra cit.; J. Alexander Thier, "Big Tent, Small Tent: The making of a Constitution in Afganistan", në Miller (ed.), vepra cit.; Jonathan Morrow, "Deconstitution Mesopotamia: Cutting a Deal on the Regionalisation of Iraq", në Miller (ed.), vepra cit.; dhe Laurel E. Miller, "Designing Constitution-Making Processes: Lessons from the Past, Questions for the Future", në Miller (ed.), vepra cit.; Markus Bokenforde and Daniel Sabsay, "Supranational organizations and their impact on national constitutions", në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Routledge Handbook of Constitutional Law*; Anne Peters and Ulrich K. Preuss, "International relations and international law", në Tushnet et al., vepra cit.

[481] Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law: A New Source or Inspiration?*, fq. 71-82.

arritjet e kulturave materiale të prodhuara nga konstitucionalizmi perëndimor. Nisur nga kjo, ajo është cilësuar si një "kushtetutë me standard të lartë evropian".[482] Ka autorë, megjithatë, të cilët thonë se ndërprerja radikale me të kaluarën prodhon jostabilitet dhe nuk paraqet një gjë të mirë për ardhmërinë dhe prosperitetin e një vendi.[483] Mbase, kjo qëndron dhe, në parim, duhet të kuptohet kësisoj. Por, në të njëjtën kohë, duhet të vërehet se çdo parim ka përjashtimet e veta, të cilat diktohen nga faktorë të tjerë kontekstual. Konteksti zakonisht e ruan parimin në aspektet e tij themelore, por shkon përtej tij, duke ndërtuar një rrugë me një vizion që i referohet një gjendjeje joekzistuese, me qëllim që të hapet një perspektivë tjetër përtej ekzistueses. Kjo do të thotë se rastet, si Kosova, të cilat bëjnë prerje radikale me të kaluarën, synojnë të ndërtojnë një realitet tjetër nga ai ekzistues, pra ndryshe nga realiteti material aktual. Për të arritur këtë, ligjet dhe kushtetutat në këto vende, përfshirë Kosovën, kanë një funksion të dyfishtë, tjetër nga ai që kanë ligjet dhe kushtetutat e vendeve të demokracive kushtetuese stabile. Përveç funksionit primar të normimit të raporteve në të ardhmen, ligji dhe kushtetuta e transicionit, përfshirë Kosovën, kanë edhe një funksion tjetër — atë të ndryshimit të gjendjes prezente, duke mos u mbështetur në strukturën materiale aktuale, por duke shërbyer si instrument i ndryshimit.[484] Pra, vetë ligji e kushtetuta në këto vende, paraqiten si instrumente të ndryshimit, sepse i prijnë një ndryshimi të caktuar që dëshirohet të arrihet nëpërmjet ligjeve dhe një kushtetute të caktuar në mënyrë specifike. Për arritjen e këtij synimi, që ka për qëllim tejkalimin e strukturës materiale vendëse, është vendimtare ndihma dhe ndër-

---

[482] Dren Doli and Fisnik Korenica, "The Consociational System of Democracy in Kosovo: Questioning Ethnic Minorities Special Status in Kosovo's Constitutional Regime", *International Journal of Public Administration* vol. 36, issue 9 (2013) fq. 601-613, në fusnotën nr. 7.

[483] W. Phillips Shively, *Power and Choice: Introduction to Political Science*, 8th ed. (McGraw Hill: New York, 2003) fq. 206-207.

[484] Ekzistojnë situata kur, përkundër prerjeve radikale me të kaluarën, nëpërmjet ristrukturimit kushtetues dhe ligjor radikal, megjithatë janë ruajtur disa institucione dhe praktika të vjetra nga e kaluara tragjike, sepse është vlerësuar se mund të luajnë një rol pozitiv në transicion. I tillë ka qenë rasti me Gjermaninë, pas Luftës së Dytë Botërore, dhe me Afrikën e Jugut, pas mbarimit të Luftës së Ftohtë. Cf. më shumë për këtë në Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law: A New Source or Inspiration?*, fq. 89 (fusnota 125); Laurie W.H. Ackermann, "Constitutional Comparativism in South Africa: A Response to Sir Basil Markesinis and Dr. Jorg Fedke", botuar në Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law: A New Source or Inspiration?*, fq. 265-268; Brun-Otto Bryde, "The Constitutional Judge and the International Constitutionalist Dialogue", botuar në Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law. A New Source or Inspiration?*, fq. 296-297.

hyrja e aktorëve të jashtëm ndërkombëtarë. Kjo praktikë është e hershme dhe nuk fillon me rënien e komunizmit.[485]

Përveç asaj si u tha më sipër, roli dhe rëndësia e faktorit ndërkombëtar në sistemin kushtetues kosovar ka qenë edhe formalisht i sanksionuar në tri vitet e para të pavarësisë së Kosovës. Deri me mbarimin e pavarësisë së mbikëqyrur, në shtator të vitit 2012, Kushtetuta e Kosovës ka pasur një sistem të gjerë dhe të detajuar të dispozitave që patën normuar vendin, kompetencat dhe prerogativat e përgjithshme të institucioneve ndërkombëtare të pranishme në Kosovë në atë kohë. Këto institucione, në fakt, kanë qenë të pranishme në cilësinë e tyre si institucione kushtetuese kosovare të tipit ndërkombëtar. Cili, pra, ka qenë statusi kushtetues i këtyre organeve kushtetuese kosovare të tipit ndërkombëtar? Përveç anës institucionale, ndikimi ndërkombëtar në Kosovë ka qenë i dukshëm edhe sa i përket infrastrukturës legale, e cila qe krijuar në Kosovë pas 10 qershorit 1999. Këto dy aspekte, aspekti i pranisë institucionale ndërkombëtare dhe i infrastrukturës ndërkombëtare legale, ishin të normuara me kapitujt e fundit të Kushtetutës së Kosovës: Kapitulli XIII ["Dispozitat Përfundimtare"] dhe Kapitulli XIV ["Dispozitat Kalimtare"]. Kapitulli XIII kishte të bënte me aspektet legale, kurse Kapitulli XIV mbulonte aspektet institucionale të pranisë ndërkombëtare në Kosovë. Të dy këta kapituj janë fshirë me amendamentet I-XXII në Kushtetutën e Kosovës, që kishin të bënin me përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës.[486] Sado të shfuqizuara, dispozitat e nenit 143 paraqesin një sistem vlerash, të cilat, në pjesën dërrmuese, janë të integruara thellësisht, të shtratëzuara, në Kushtetutën e Kosovës. Si të tilla, ato paraqesin pjesë të pandarë të letrës dhe të shpirtit të Kushtetutës së Kosovës.

---

[485] Praktika e miratimit të teksteve kushtetuese, që nuk reflektojnë strukturën materiale të një shoqërie, ka filluar me Kushtetutën e Vajmarit të vitit 1919, e cila ka pasur një kapitull të tërë, Kapitullin II, që ka përcaktuar të drejtat e njeriut në një mënyrë jashtëzakonisht progresive dhe liberale për kohën e vet. Ky kapitull, i cilësuar si "kushtetuta e dytë gjermane" nga autorët e proveniencës konservative të kohës, nuk ka qenë i vetmi që nuk ka reflektuar strukturën materiale të Gjermanisë së asaj kohe. Kushtetuta e Vajmarit, duke qenë rezultat i një kompromisi krejt fragjil të politikave socialiste e kristiane të kohës, me zgjidhjet e ofruara, si ato në Kapitullin II (të cilat nuk patën asnjë garantues institucional për vënien e tyre në jetë), ashtu dhe ato lidhur me organizimin e pushtetit, me kalimin e kohës vetëm sa krijuan frustrim social, politik , ekonomik dhe kulturor. Për këtë arsye, dispozitat e saj mbi të drejtat e njeriut dhe ato mbi ndarjen e pushtetit, asnjëherë nuk arritën të bëhen mjet i kontrollit të pushtetit politik, duke e kthyer në fund këtë pushtet kundër vetvetes. Karl J. Fridrih, *Konstitutionalna demokratija*, fq. 149.

[486] Vendimi i Kuvendit të Kosovës Nr. 04-V-436, 7 shtator 2012. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 25/2012.

Neni 143, tashmë i shfuqizuar, flet për vendin, për rolin dhe për statusin juridik-kushtetues të tekstit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i njohur si Plani Ahtisari (26 mars 2007). Me të përcaktohej detyrimi i të gjitha autoriteteve publike në republikë që të veprojnë në pajtim me detyrimet e marra sipas Propozimit Gjithëpërfshirës. Përveç kësaj, në këtë nen, normoheshin edhe tri gjëra të tjera të rëndësishme. E para, detyrimet nga Propozimi i referoheshin vetëm autoriteteve publike, gjë që nënkuptonte se sfera horizontale e marrëdhënieve ndërmjet subjekteve të së drejtës (sfera private) përjashtohej nga normimi. E dyta, në vijim të kësaj, autoritetet publike kosovare detyroheshin të nxirrnin ligje dhe akte të tjera të përgjithshme, të njohura si "ligjet e Pakos Ahtisari",[487] me qëllim të vënies në jetë të këtyre detyrimeve ndërkombëtare. Ndërkohë që Propozimi Gjithëpërfshirës nuk mund të ishte objekt *of judicial review* në Gjykatën Kushtetuese, ligjet e nxjerra me qëllim të vënies në jetë të dispozitave të tij, "ligjet e Pakos Ahtisari", nuk gëzonin një status të tillë. Gjykata Kushtetuese ka juridiksion ndaj këtyre ligjeve, si ndaj çdo ligji tjetër të nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës.[488] Së fundi, ky nen përcaktonte përparësinë absolute të dispozitave të Propozimit Gjithëpërfshirës ndaj Kushtetutës, ndaj ligjeve dhe ndaj akteve të tjera të Kosovës.

Neni 145, po ashtu i fshirë, ka folur për dy çështje. E para ka pasur të bëjë me vazhdimësinë e marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura në emër të Kosovës nga autoritetet ndërkombëtare, kurse e dyta i referohej vazhdimësisë së zbatimit të normave juridike të nxjerra apo të fuqizuara nga autoritetet ndërkombëtare deri në ditën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kjo qasje kushtetuese është e njohur gjerësisht në teori dhe në praktikë dhe ka për synim themelor moslejimin e vakuumit kushtetues-juridik në marrëdhëniet shoqërore dhe në krijimin e sigurisë juridike për subjektet e së drejtës.[489] Si i tillë, qëllimi i këtij neni duhet të dallohet nga nenet e tjera të

---

[487] Në aneksin XII të Propozimit Gjithëpërfshirës parashihet agjenda legjislative e Kosovës. Nga kjo agjendë, Kosova ka kryer të gjitha detyrimet, me përjashtim të Ligjit për Restituimin e Pronës, i cili nuk është nxjerrë akoma, edhe pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur në shtator të vitit 2012.

[488] Deri më tash, ka pasur procedura të këtij paragrafi me rastin e dy ligjeve, ai për Hoçën e Madhe dhe për Prizrenin. Cf. Aktgjykim në rastet KO 45/12 dhe KO 46/12. Kërkesa e Liburn Aliut dhe e 11 deputeteve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për fshatin Hoça e Madhe dhe te Ligjit për Qendrën Historike te Prizrenit, Nr. ref.: AGJ 255/12, Prishtinë, 25 qershor 2012.

[489] Aspekti i sigurisë juridike është shtjelluar gjerësisht nga Gjykata në rastin e njohur si "Agjencia Kosovare e Privatizimit", apo "rasti i AKP"-së. Cf. Aktgjykimi në Rastin Nr. KI

pjesës kryesore të Kushtetutës që flasin për raportin ndërmjet së drejtës kushtetuese dhe asaj ndërkombëtare në Kosovë, për rolin dhe për rëndësinë e marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin kushtetues-juridik kosovar, të cilat janë diskutuar më herët në këtë punim.[490]

Kapitulli XIV, siç u cek më herët, ka mbuluar aspektet institucionale të pranisë ndërkombëtare në Kosovë. Si i tillë, ka rregulluar anën substanciale dhe anën formale të funksionimit të institucioneve kushtetuese gjatë periudhës së transicionit, kompetencat, mënyrën e punës, si dhe zëvendësimin gradual të tyre nga stafi vendës. Amendamentet I deri XXII, të 7 shtatorit 2012, të cilat kishin të bënin me përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur, të 7 shtatorit 2012,[491] kanë shfuqizuar nenet 146-154 dhe nenet 157-160 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Neni 155 ["Shtetësia"] është bartur në Kapitullin I, "Dispozitat Themelore", pa treguar fare ku dhe pas cilit nen të Kushtetutës duhet të ngelë ky nen (sic!). Ngjashëm më këtë, neni 156 ["Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur"] është transportuar në Kapitullin II të Kushtetutës, pa treguar fare ku dhe pas cilit nen duhet të ngelë (sic!). Neni i vjetër 161 ["Transicioni i Institucioneve"] tani është riemëruar si "Dispozitat Kalimtare" dhe përcakton për si vijon:

> Individët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, mandati i të cilëve nuk ka përfunduar para deklarimit të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur, do të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre në institucionet ku janë deri në fund të mandatit të specifikuar. Kosova do t'ua japë këtyre individëve të njëjtat privilegje dhe imunitete që i gëzojnë diplomatët dhe familjet e tyre sipas Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike.

Neni 146 kishte dy paragrafë, të cilët regullonin rolin dhe pozitën e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar (PCN), i njohur anglisht si ICO, brenda

---

25/10. Parashtrues i kërkesës: Agjencia Kosovare e Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC 09-89, të 4 shkurtit 2010.

[490] Se detyrimet ndërkombëtare të Kosovës, në fuqi në ditën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës, duhet respektuar është thënë në një vendim të Gjykatës Kushtetuese me të cilin qe sqaruar se marrëveshjet për ekstradim, të lidhura në emër të Kosovës nga autoritetet ndërkombëtare, do të kenë vlefshmëri deri në lidhjen e marrëveshjeve të tjera nga kjo fushë. Cf. *Vendim mbi Kërkesën për Masë të Përkohshme në Rastin KI 22/09. Dode Gecaj kundër Vendimit PKL-KZZ 76/08 të Gjykatës Supreme të Kosovës* (Ref. Nr. MP 03/09). Prishtinë, 15 dhjetor 2009.

[491] Vendimi i Kuvendit, Nr. 04-V-436, i 7 shtatorit 2012. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 25/2012.

sistemit kushtetues kosovar gjatë viteve 2008-2012 (sa ka zgjatur pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës). Roli dhe pozita e PCN-së ka pasur të bëjë kryesisht me sundimin e ligjit, me qeverisjen e mirë, si dhe me të drejtat e komuniteteve dhe të anëtarëve të tyre. Në këto lëmi, PCN-ja ka pasur pushtet ekzekutiv, të cilin megjithatë asnjëherë nuk e ka ushtruar. Nenet 148-154 dhe 157-160 rregullonin përbërjen ndërkombëtare të organeve të tjera kushtetuese, siç janë: Gjykata Kushtetuese, Auditori i Përgjithshëm, Këshilli Gjyqësor e Prokurorial, Autoriteti Qendror Bankar etj., si dhe aspektet e tjera të mbrojtjes kushtetuese të komuniteteve joshumicë, siç janë vendet e rezervuara dhe të garantuara, si dhe nxjerrja e ligjeve me interes vital për këto komunitete. Në fund, ky kapitull rregullonte vazhdimin e pranisë ndërkombëtare ushtarake në Kosovë për një kohë të pacaktuar,[492] si dhe transformimin në ushtri të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) në të ardhmen. Ndryshimi i statusit të tanishëm të pranisë ushtarake në Kosovë mund të bëhet vetëm në bazë të marrëveshjeve bilaterale, të lidhura ndërmjet Kosovës dhe vendeve apo organizatave të ndryshme ushtarake, në bazë të partneritetit dhe të barazisë reciproke. Marrëveshjet e tilla njihen si SOFA (*Status of Forces Agreement*) dhe zakonisht parashohin privilegje e imunitete, të cilat, për nga natyra, kanë ekzistuar në Kosovë sipas Rezolutës 1244 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.[493] Deri më tani, Kosova ka lidhur marrëveshje të tillë vetëm me ShBA-në.[494]

Përfundim

Ky punim ka trajtuar cilësitë themelore të sistemit kushtetues kosovar. Ky trajtim ka qenë komparativ në të gjitha segmentet e tij. Kjo për faktin se Kosova, si vendi i fundit ish-komunist në Evropë, që fitoi pavarësinë më 17

[492] Operimi i mëtejmë i pranisë së huaj ushtarake në Kosovë bazohet në vendimin e njëanshëm të Kosovës, të shprehur në pikën 5 të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, të 17 shkurtit 2008, me të cilën kërkohet dhe mirëpritet prania e tillë ushtarake në Kosovë deri në aftësimin e Kosovës për kryerjen e detyrave të tilla ushtarake, si dhe deri në anëtarësimin e Kosovës në Paktin e Atlantikut të Veriut (NATO).

[493] Cf. më shumë për SOFA, për historikun, për kuptimin, për formën dhe për përmbajtjen e tyre në studimin gjithëpërfshirës Dieter Fleck (ed.), *The Handbook of The Law of Visiting Forces* (Oxford UP: Oxford, 2001), në veçanti fq. 3-47.

[494] Marrëveshja për Statusin e Forcave ndërmjet ShBA-së dhe Kosovës është nënshkruar më 18 shkurt 2012, në Prishtinë. Cf. "Signing of Status of Forces Agreement between the United States of America and the Republic of Kosovo", Ambasada e ShBA-së në Prishtinë, Kosovë (18 shkurt 2012).

shkurt 2008, u orientua për të njëjtin dizajn kushtetues që vendet ish-komuniste zgjodhën dekada më herët, pas rënies së komunizmit. Nga ky komparacion u pa se cilësitë themelore të sistemit kushtetues kosovar nuk dallojnë shumë nga vendet e tjera ish-komuniste të Evropës. Kjo rrethanë u vërejt në këtë trajtim në pesë segmente: së pari, sa i përket vendit të marrëveshjeve ndërkombëtare; së dyti, sa i përket kartës kosovare mbi të drejtat e njeriut; së treti, sa i përket vendit dhe rëndësisë së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; dhe, së fundi, sa i përket rolit të faktorit ndërkombëtar në procesin e kushtetutëbërjes në Kosovë.

Ajo çka konstatohet në këtë shkrim, *grosso modo*, është se identiteti kushtetues i Kosovës është krejt i ndryshëm nga identiteti i saj para qershorit të vitit 1999. Kjo nënkupton se Kosova, më shumë se çdo vend tjetër ish-komunist, ka larguar vetveten nga historia tragjike e dekadave para qershorit të vitit 1999, jo pa arsye. Ky identitet i ri kushtetues i Kosovës vërehet në çdo germë të Kushtetutës së saj, teksti i së cilës vë në spikamë (në kapitujt II dhe III) të drejtat dhe liritë fundamentale të njeriut dhe të minoriteteve, sundimin e ligjit dhe ndarjen e pushtetit, si vlera mbi të cilat qëndron rendi i ri kushtetues. Kjo vënie në spikamë në mënyrë të qartë e të drejtave e lirive themelore njerëzore dhe të minoriteteve, me sundimin e ligjit dhe me ndarjen e pushteteve si vlera kyç kushtetuese, nuk do të kishte asnjë kuptim sikur të mos ishin dispozitat e tjera kushtetuese që i njohin një rol po aq qendror marrëveshjeve ndërkombëtare, qofshin ato nga e drejta e përgjithshme ndërkombëtare apo nga e drejta evropiane. Në këtë aspekt, njësoj si në vendet e tjera ish-komuniste, Gjykatës Kushtetuese i jepet një rol qendror në mbrojtjen dhe në promovimin e së drejtës ndërkombëtare, të përgjithshme e të veçantë.[495] Kjo qasje kushtetuese, në dizajnin kushtetues kosovar, është pasojë imediate e rolit të jashtëzakonshëm që ka pasur faktori ndërkombëtar në dy anët e Atlantikut në kushtetutëbërjen e Kosovës, si dhe në historinë më të re të Kosovës.

[495] Zdenek Kuhn, "Making a European Transnational Constitution: Some Central European Perspectives", në Ingolf Pernice and Jiří Zemánek (eds.), *A Constitution for Europe: The IGC, The Ratification Process and Beyond* (Nomos: Baden-Baden, 2005) fq. 132-133.

II. Të drejtat fundamentale në Kosovë

Kosova është një vend ish-komunist në transicion. Transicioni në Kosovë, megjithatë, ka filluar 20 vite më vonë se gjetiu si pasojë e historisë tragjike të vendit në dekadat e fundit të shkaktuar nga politikat violente dhe represive të diktatorit serb Sllobodan Millosheviq. Si në vendet e tjera, edhe në Kosovë, Kushtetuta dhe ligjet që bazohen në të përfaqësojnë një instrument të ndryshimit, anise edhe vetë të dyja janë në të njëjtën kohë prodhim i këtij ndryshimi në transicion[496]. Ndryshimi i dëshiruar në shoqërinë e Kosovës synon themelimin e një identiteti të ri të Kosovës, identitetit kosovar, i cili nuk do të reflektojë strukturën e saj materiale. Shikuar nga kjo perspektivë, një identitet i tillë kosovar përfaqëson një ndarje radikale me të kaluarën, sepse Kushtetuta e Kosovës e 15 prillit 2008 nuk pasqyron parimet, normat, vlerat dhe zakonet e nivelit lokal kosovar[497]. Kushtetuta e Kosovës reflekton parimet, normat, vlerat dhe zakonet e konstitucionalizmit perëndimor. Kjo shihet qartë nga dispozitat e Kushtetutës që flasin për të drejtat e njeriut, kapitujt II ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore"] dhe III ["Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre"], si dhe me dispozitat e tjera që normojnë juridiksionin, vendin dhe rolin e Gjykatës Kushtetuese[498]. Gjykata, siç do të shih-

---

[496] Ruti Teitel "Transitional Rule of Law", në Adam Czamota, Martin Krygeier and Wojciech Sadurski (eds.), *Rethinking the Rule of Law After Communism* (CEU Press: Budapest, 2005) fq. 279.

[497] Për një mendim i cili thotë se identiteti kushtetues ndjek traditat nacionale dhe strukturën materiale të shoqërisë së dhënë, shih më shumë në Georg P. Fletcher, "Constitutional Identity", në Michel Rosenfeld (ed.), *Constitutionalism, Identity, Difference, and Legitimacy* (Duke UP: Durham, 1994) fq. 223-232. Për një mendim krejt të kundërt, i cili thotë se kushtetuta, ligjet dhe gjykatat janë ato që qëndrojnë prapa konstitucionalizmit modern, jo rregulli mbi sundimin e shumicës, shih më shumë në: Ruti G. Teitel, "Reactionary Constitutional Identity", në Rosenfeld (ed.), vepra cit., fq. 233-243; Catherine Dupre and Jiunn-rong Yeh, "Constitutions and legitimacy over time", në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Routledge Handbook of Constitutional Law* (Routledge: London, 2013) fq. 45-54.

[498] Më fjalë tjera, është kushtetuta dhe interpretimi i saj që përcaktojnë identitetin e një shoqërie, jo struktura materiale e shoqërisë. Kjo qasje fillon me Aristotelin. Cf. Ernest Baker (ed. dhe përkth.), *The Politics of Aristotle* (Oxford UP: Oxford, 1962) fq. 98-99; Michel Rosenfeld, "Modern Constitutionalism as Interplay Between Identity and Diversity", në Michel Rosenfeld (ed.), *Constitutionalism, Identity, Difference, and Legitimacy*, fq. 3-35; Garry Jeffrey Jacobsohn, *Constitutional Identity* (Harvard UP: Cambridge, Mass., 2010) fq. 8-10;

et nga faqet në vijim, ka shërbyer që nga themelimi i saj në fillim të vitit 2009 si një mekanizëm kyç për vënien në jetë të të drejtave dhe lirive fundamentale të mishëruara në kapitullin II dhe III të Kushtetutës. Interpretimi i këtyre dy kapitujve nga ana e Gjykatës Kushtetuese ka formësuar në mënyrë substanciale identitetin kushtetues të Kosovës, sepse ai interpretim është kryer jo duke u bazuar në strukturën materiale të shoqërisë kosovare por në unitetin strukturor të tekstit të Kushtetutës, gjithnjë duke marrë parasysh parimet, vlerat dhe zakonet e shoqërive perëndimore.

1. Zhvillimi i të drejtave të njeriut

Nën Mbretërinë e Jugosllavisë (1918-1941), Kosova nuk ka pasur identitet të veçantë kushtetues, por as identitet tjetër politik apo territorial. Ajo nuk ka qenë e njohur si territor i veçantë, dhe as popullsia e saj nuk ka pasur asnjë subjektivitet apo njohje nga ana e atij shteti. Për këtë arsye, diskutimi që pason këtu poshtë në këtë seksion ka të bëjë vetëm me zhvillimet pas Luftës së Dytë Botërore. Edhe këtu, zhvillimet kushtetuese sa i përket Kosovës lidhen vetëm me vitin 1974 e tutje. Koha prej viteve 1945-1974 ka qenë një periudhë gjatë së cilës Kosova nuk ka gëzuar ndonjë status të theksuar juridik-kushtetues sepse qe trajtuar vetëm si pjesë dhe problem ekskluziv i Republikës së Serbisë federale, e cila edhe vetë ka qenë pjesë e ish-RSFJ-së. Identiteti kushtetues i Kosovës në kuadër të ish-RSFJ ka marrë formë vetëm pas vitit 1974, kur u miratua Kushtetuta e ish-KSA të Kosovës[499]. Vetëm me këtë kushtetutë Kosova pati mundësi që të ketë një status të veçantë juridiko-kushtetues gati të ngjashëm më atë të ish-republikave jugosllave. Që nga viti 1974, Kosova dhe Vojvodina (kjo e fundit tani përbën pjesë autonome në Serbinë e veriut) filluan të gëzonin statusin e autonomisë politiko-territoriale ashtu siç e kishte predikuar Stalini në teori dhe në praktikë.[500]

Michel Rosenfeld, "Constitutional Identity", në Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford UP: Oxford, 2012) fq. 756-776.

[499] Disa studiues në Kosovë mendojnë në mënyrë të gabuar se Kosova ka pasur një identitet politik dhe kushtetues para vitit 1974, përkatësisht gjatë kohës së Perandorisë Otomane dhe Mbretërisë së Jugosllavisë (sic!). Cf. më shumë lidhur me pikëpamjet kritike të kësaj pozite absurde të këtyre studiuesve në Noel Malcolm, *Kosovo: A Short History* (New York UP: New York, 1998), "Introduction" dhe fq. 314-333.

[500] Për një pasqyrë të mrekullueshme të "historisë kushtetuese" të Kosovës para vitit 1974, Cf. Prof. dr. Kurtesh Salihu, *Lindja, Zhvillimi, Pozita dhe Aspektet e Autonomitetit te Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste* (Enti i Teksteve dhe i Mjeteve

Për qëllim të lehtësimit, seksioni në vijim ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë përfshinë ngjarjet që janë zhvilluar para datës 10 qershor 1999, kurse pjesa e dytë diskuton periudhën dhe ngjarjet deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt.

1.1. Gjatë kohës së komunizmit

Kosova, si pjesë e ish-Jugosllavisë komuniste, në kuptim të "konstitucionalizmit" ka pasur cilësitë e njëjta sikur vetë shteti të cilit i ka takuar. Komunizmi jugosllav, përkundër pretendimit të tij se ka qenë i ndryshëm nga tjerët, në esencë ka pasur cilësitë që kanë qenë të përbashkëta për të gjitha vendet e universit komunist. Në rend të parë, të drejtat dhe liritë fundamentale të njeriut u janë nënshtruar interesave të klasës punëtore dhe fshatarësisë të udhëhequra nga Partia Komuniste[501]. Së dyti, ka qenë ligjshmëria socialiste dhe uniteti i pushtetit që ushtrohej nga Partia Komuniste në emër dhe për klasën punëtore dhe fshatarësinë që kanë dominuar ndaj çdo gjëje tjetër. Kjo nënkuptonte se asnjë individ nuk mund të gëzonte të drejta dhe liri njerëzore në dëm të këtyre vlerave të kësaj ligjshmërie socialiste dhe të këtij uniteti socialist të pushtetit, i njohur ndryshe edhe si "diktatura e proletariatit" [502]. Së fundi, Gjykata Kushtetuese e Kosovës (dhe ajo e Vojvodinës), njëjtë si gjykatat kushtetuese të njësive federale jugosllave dhe Gjykata Kushtetuese e ish-

---

Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1984) fq. 7-63; Historia e konceptit të autonomisë territoriale ashtu siç është shtruar nga Stalini është dhënë tek Michael Krykov, "Self-Determination From Marx to Mao", *Ethnic and Racial Studies* vol. 19, no. 2 (April 1996) fq. 352-377.

[501] Cf. Nenet 375-396 të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë së vitit 1974 si dhe nenet korresponduese të kushtetutave të republikave ish-jugosllave dhe të dy krahinave autonome (të Kosovës dhe të Vojvodinës) të vitit 1974. Për tekstin e plotë të këtyre kushtetutave, shih në: *Ustav SFRJ: Ustavi socialistickih republika i pokrajina* (Slobodna Dalmacija: Beograd, 1974); Për komentet në doktrinën jugosllave, shih në Prof. Jovan Gjorgjeviq, *E Drejta Kushtetuese* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtine, 1972) fq. 279-332; 342-355; 770-801; Prof. Jovan Gjorgjeviq, *Sistemi Politik: Kontribut shkencës mbi njeriun dhe vetëqeverisjen* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1978) fq. 606-625, 947-1006, 1110-1144.

[502] Cilësia kryesore e "konstitutcionalizmit socialist", pjesë e të cilit ka qenë edhe Kosova, ka qenë akomodimi i tensionit bazik mes doktrinës komuniste mbi supremacinë e organit përfaqësues, Kuvendit, me doktrinën mbi unitetin e tërë pushtetit, në të cilin partia komuniste shërbente si vangardë e klasës punëtore dhe e fshatarësisë në emër të të cilëve ai pushtet unik ushtrohej. Cf. më shumë në Paolo Carrozza, "Il diritto socialista", në P. Carrozza, A. Di Giovine & G.F. Ferrari (eds.), *Diritto costituzionale comparato* (GLF Editori Laterza: Roma-Bari, 2009) fq. 583-615; Karl J. Fridrih, *Konstitucionalna demokratija* (CID: Podgorica, 2005) fq. 47-50.

RSFJ, i kanë shërbyer ruajtjes së këtyre vlerave, pa pasur asnjë mekanizëm që do të mbronte të drejtat dhe liritë individuale. Të gjitha këto gjykata kushtetuese ishin kelseniane vetëm në formë, në ndërkohë që përmbajtja e tyre qe disenjuar ashtu që të shërbenin si një instrument për ruajtjen e vlerave themelore të komunizmit, i cili bazohej në epërsinë e të drejtave kolektive të zhvillimit socialist ndaj të drejtave e lirive fundamentale të individit.

1.2. Pas vitit 1990

Gjykata Kushtetuese e ish-KSAK ka ekzistuar deri në vitin 1989, kur në mars të atij viti diktatori serb Sllobodan Millosheviq e rrënoi si të tillë, së bashku me autonominë që Kosova kishte gëzuar sipas Kushtetutës së vitit 1974[503]. Millosheviqi e vuri Kosovën në tërësi nën thundrën e sistemit juridik-kushtetues serb, duke rrënuar të gjitha shenjat e identitetit kushtetues që Kosova kishte gëzuar me vite sipas Kushtetutës së vitit 1974[504]. Kjo politikë prodhoi rezistencë masive në mesin e popullsisë shumicë në Kosovë, e cila deri në fillim të vitit 1998 pati qenë krejtësisht paqësore nën udhëheqjen e liderit dr. Ibrahim Rugova, presidentit të parë të Kosovës. Gjatë kësaj kohe, kosovarët organizuan jetën paralele në sferën politike, sociale, arsimore, shëndetësore dhe ekonomike. Ky organizim paralel kishte për qëllim refuzimin e tërësishëm të integrimit të Kosovës me regjimin e instaluar serb në vend. Kosovarët *de facto* u përjashtuan nga çdo aspekt i jetës publike në Kos-

---

[503] Miroslav Cerar, "Slovenia's Constitutional Court Within the Separation of Powers", në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010) fq. 213, fusnota 2.

[504] Sipas Kushtetutës së Serbisë të vitit 1990, autonomia e Kosovës të cilën e gëzonte sipas Kushtetutës së RSFJ të vitit 1974 u suprimua dhe nuk ekzistonte më. Nenet 108-112 të Kushtetutës së Serbisë të vitit 1990 përcaktonin elementet bazë të "autonomisë së re" për Kosovën. Në nenin 6, Kosova u riemërtua si një krahinë autonome krahas Vojvodinës, duke pasur një lloj autonomie territoriale.

Kushtetuta e vitit 1992 e Republikës Federative të Jugosllavisë (Serbi dhe Mali i Zi), e njohur si Kushtetuta e Zhabljakut (sipas emërit të vendit në Mal të Zi ku është draftuar) ka sanksionunar këtë pozitë të Kosovës dhe Vojvodinës, duke respektuar në tërësi dispozitat e Kushtetutës së Serbisë të vitit 1990. Në kapitullin II, kjo Kushtetutë ka pasur dispozitat mbi të drejtat e njeriut, kapitull që titullohej: "Liritë, të Drejtat dhe Detyrat e Individit dhe Qytetarit" (nenet 19-68). Edhe pse në paragrafin 4 të nenit 124, Kushtetuta fliste për ankesën individuale në rastet e cënimeve me aktet individuale të autoriteteve publike të të drejtave dhe lirive të individit të garantuara me Kushtetutë, ushtrimi praktik i ankesës individuale në territorin e Kosovës nuk kishte asnjë gjasë dhe mundësi. Kosova dhe populli i saj ishin futur në një geto kolektive në duart e regjimit represiv të diktatorit serb Sllobodan Millosheviq.

ovë duke u bërë kështu një lloj hapësire e huaj publike e cila në të njëjtën kohë koekzistonte më hapësirën publike të imponuar me dhunë nga regjimi serb i diktatorit Sllobodan Millosheviq, por që përkrahej në masë të madhe nga popullsia lokale serbe në Kosovë. Kjo situatë zgjati deri në fillim të vitit 1998, kur një kryengritje e armatosur kundër regjimit serb filloi nën udhëheqjen e të sapoformuarës UÇK (Ushtria Çlirimtare e Kosovës). Paraqitja e UÇK-së në skenën publike kosovare ka qenë rezultat imediat i ngritjes dramatike dhe të shpejtë të dhunës dhe represionit serb në Kosovë si dhe i dështimit të rrugës paqësore të presidentit dr. Ibrahim Rugova. Konflikti i hapur mes UÇK-së dhe forcave serbe të instaluara në Kosovë detyroi bashkësinë ndërkombëtare të vihej në lëvizje dhe të thërriste një konferencë ndërkombëtare të paqes, e cila u mbajt në Rambuje të Francës, me qëllim të zgjidhjes së mospajtimeve serioze të cilat rrezikonin paqen dhe sigurinë në rajon dhe më gjerë. Kjo konferencë, e cila mbaroi më 23 shkurt të vitit i1999, prodhoi një dokument jashtëzakonisht të detajuar pas javëve të negocimit intensiv mes palëve në konflikt. Ky dokument, megjithatë, nuk u jetësua asnjëherë, sepse atë e refuzoi diktatori serb Sllobodan Millosheviq, i cili vazhdoi me politikat e veprimit violent dhe represiv kundër popullsisë shumicë në Kosovë. Meqë shqiptarët nënshkruan dokumentin e Konferencës, kurse diktatori Millosheviq vazhdoi represionin dhe dhunën në Kosovë, një gjë e tillë mjaftonte që të hapeshin dyert për sulme ushtarake të NATO-s kundër caqeve policore dhe ushtarake të RFJ-së me qëllim të ndërprerjes së mizorive që regjimi në Beograd po bënte kundër popullsisë shqiptare, dhunës e terrorit që kishte marrë përmasa gjenocidale.[505] Fushata ajrore e NATO-s mbaroi pas 78 ditëve të sulmeve intensive kundër caqeve në tërë territorin e RFJ-së, dhe u pasua me futjen e trupave të NATO-s në Kosovë dhe themelimin e një administrate ndërkombëtare të përkohshme nën lidershipin e OKB-së, e njohur si UNMIK, bazuar në Rezolutën 1244 të KS të OKB-së të datës 10 qershor 1999.[506]

[505] Për rezistëncën paqësore të popullit shumicë në Kosovë ngaviti 1989 deri në fillim të vitit 1998, për luftën e viteve 1997-1998 dhe për Marrëveshjet e Rambujesë të shkurtit 1999, shih më shumë në Marc Weller "Rambouillet Conference on Kosovo", në *International Affairs* vol. 75, issue 2 (April 1999) fq. 211-251.

[506] KS i OKB-së, Security Council Resolution 1244 (1999) [on the deployment of international civil and security presences in Kosovo], 10 June 1999, S/RES/1244 (1999), në rrjet: http://www.refworld.org/docid/3b00f27216.html (qasur herën e fundit më 27 gusht 2013).

2. Ndikimi i dokumenteve të huaja me karakter kushtetues

Shumë kohë para se të përpilohej Marrëveshja për Paqe e Rambujesë, Komisioni i Venedikut pati marrë përsipër kryerjen e një vlerësimi intern, krejt konfidencial, lidhur me pozitën kushtetuese të Kosovës dhe popullsisë së saj shumicë duke e pasur si pikë referimi Kushtetutën e Serbisë të vitit 1990 (dhe Kushtetutën e RFJ të vitit 1992). Pika e referimit për vlerësim ka pasur vlerë vetëm për aq sa ka qenë e domosdoshme për raportim për qëllimet e vlerësimit në fjalë[507]. Raporti ka pasur për qëllim që të shërbejë si një guidë për draftimin e marrëveshjes së paqes mes shqiptarëve si popullsi shumicë në Kosovë dhe qeverisë së Beogradit si forcë represive, në kohën që po vinte.

Në këtë raport, Komisioni i Venecias nuk la asnjë mëdyshje lidhur me pozitën e vështirë të popullsisë shumicë në Kosovë, statusin e saj inferior në pikëpamje kushtetuese si dhe për sa i përket gjendjes së të drejtave të njeriut dhe diskriminimit të kësaj popullsie në nivelin e administrimit lokal. Komisioni ka propozuar që të zbatohen standardet e duhura ndërkombëtare sa i përket të drejtave dhe lirive fundamentale, ashtu siç ato janë të mishëruara në kushtetutat e vendeve në Perëndim. Kjo në veçanti u bë e qartë kur u diskutua çështja e vetëqeverisjes lokale dhe rolin e saj si kuadër që shërben për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive fundamentale të individit.

Marrëveshja e Rambujesë, siç do të shihet në vijim, ka përmbajtur dispozita kushtetuese që ishin të modeluara sipas vijave kryesore të skicuara në raportin e vlerësimit të Komisionit të Venedikut. Kjo është e qartë në veçanti kur flitet për dispozitat që rregullojnë organizimin e pushtetit dhe marrëdhëniet e pushtetit brenda Kosovës[508], por edhe kur janë në pyetje dispozitat lidhur me vendin dhe rolin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve në Kosovë[509]. Se kjo është kështu shihet qartë nga fakti i thjeshtë se raporti i vlerësi-

---

[507] European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Draft outline of main elements for an agreement on Kosovo: Confidential* (Council of Europe: Strasbourg, 31/08/98).

[508] Cf. Seksioni III "Autorizimet Respektive të Federatës dhe të Kosovës" [paragrafët 7 -12] dhe seksioni V "Pjesmarrja e Kosovës në Organet dhe Institucionet e Republikës Federative të Jugosllavisë" [paragrafët 21-32].

[509] Seksioni IV i titulluar si "Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut dhe të Minoriteteve brenda Kosovës" përmbanin paragrafët 13-20, me të cilët parashihej zbatimi në Kosovë i standardeve mjaft të larta mbi të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve. E një rëndësie të veçantë është dispozita e paragrafit 13 që parashikonte zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave materiale të KEDNj-së dhe të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Nacionale të vitit 1993, si dhe të nenit 7 të Kartës Evropiane për Gjuhët e Minoriteteve dhe të Regjioneve. Përveç kësaj,

mit u bë në gusht të vitit 1998, shumë kohë para se Marrëveshja e Rambujesë të arrihej, ashtu që dispozitat e kësaj të fundit parashikuan saktësisht standarde të njëjta për vetëqeverisjen lokale, për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, njëjtë si ato standarde të parashikuara në raportin e vlerësimit.

3. Ndikimi i instrumenteve ndërkombëtare

Marrëveshja e Rambujesë, përkundër faktit që ka pasur një natyrë të përkohshme, përfaqëson një dokument shumë të elaboruar qëllim parësor i së cilës ishte ndalimi i dhunës dhe luftës në Kosovë dhe krijimi i kushteve për themelimin e një autonomie substanciale. Si i tillë, ky dokument ka pasur karakter të dyfishtë: prospektiv dhe retrospektiv. Ngjashëm me Marrëveshjen e Dejtonit për Bosnjë-Hercegovinën (nëntor 1995), Marrëveshja e Rambujesë ka ngërthyer një rrjet mjaft të detajuar të dispozitave me të cilat mëtohej rregullimi i të gjitha aspekteve të jetës në Kosovë pasi të mbaronte lufta, por edhe dispozita që synonin nxitjen e ndryshimeve të menjëhershme në terren (ndalimi i dhunës dhe i luftës së armatosur mes palëve).

Në të njëjtën kohë, për dallim nga Marrëveshja e Dejtonit, në kuptim të të drejtave e lirive fundamentale, Marrëveshja e Rambujesë nuk ka qenë aq e gjerë. Nenet VI ("Të Drejtat dhe Liritë Fundamentale") dhe VII ("Bashkësitë Nacionale") të Kapitullit I ("Kushtetuta") të Marrëveshjes së Rambujesë nuk kanë parashikuar një listë të dokumenteve ndërkombëtare që do të zbatoheshin në Kosovë pas mbarimit të luftës dhe konfliktit të armatosur. I vetmi përjashtim në këtë aspekt ka qenë Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Fundamentale dhe protokollet e saj, të cilat, sipas nenit VI(2), parashikohej që të zbatoheshin drejtpërsëdrejti në Kosovë. Përveç këtij instrumenti ndërkombëtar, Marrëveshja e Rambujesë në nenin VI(1) ka përdorur këtë formulim sa i përket të drejtave e lirive fundamentale të individit: "të gjitha autoritetet publike në Kosovë do të përkujdesen për vënien në jetë të të drejtave e lirive njerëzore të cilat ndërkombëtarisht janë të pranuara". Të drejtat dhe liritë e stipuluara në këtë mënyrë parashihej që të kishin epërsi ndaj çdo ligji tjetër që mund të ishte i vlefshëm në territorin e Kosovës.

Të drejtat e bashkësive nacionale, në anën tjetër, në Marrëveshjen e Rambujesë qenë koncipuar si të drejta e liri shtesë me qëllim që atyre t'u mundësonte ruajtjen dhe kultivimin e identiteteve të tyre nacionale, kulturore, fetare,

---

në të njëjtën dispozitë parashihej mundësia që palët të "përcaktonin vetë se cilat pjesë tjera të Kartës do të bëheshin pjesë e Marrëveshjes".

dhe gjuhësore në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe Aktin Final të Helsinkit (neni VII(1)).[510] Kjo qasje e largimit radikal nga e kaluara nuk ka pasur për qëllim ruajtjen e traditave dhe zakoneve të kaluara, si dhe aspektet e tjera të strukturës materiale të shoqërisë kosovare, të cilat kishin qenë pjesë përbërëse e historisë tragjike të Kosovës. Kjo qasje, përkundrazi, ka qenë një veprim i vetëdijshëm dhe me ndërgjegje i kryer me qëllim të largimit nga trashëgimia e hidhur e Kosovës, njëjtë siç kishte bërë Afrika e Jugut kur kishte refuzuar regjimin e apartheidit dhe përqafimin në të njëjtën kohë të vlerave, parimeve, normave dhe zakoneve bazë të shoqërive perëndimore[511].

2.1. Epërsia e zbatimit të së drejtës ndërkombëtare mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Çështja e prioritetit të ligjit ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut në Kosovë ka qenë për herë të parë e trajtuar në dokumentin e njohur si "Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje në Kosovë", një derivat i autoritetit të KS të OKB-së sipas Rezolutës 1244. Siç u pa më sipër, Marrëveshja e Rambujesë kishte njohur se standardet e njohura ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut do të kenë epërsi ndaj çdo ligji vendor në Kosovë. Marrëveshja, megjithatë, nuk ka specifikuar tekstet ndërkombëtare të cilat do të kenë epërsi ndaj legjislacionit vendor në lëmin e të drejtave dhe lirive fundamentale të individit. Me fjalë të tjera, me Marrëveshjen e Rambujesë, çështja e burimeve të së

---

[510] Për tekstin e plotë të Marrëveshjes së Rambujesë për Paqe, shih *Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo* (1999). Në rrjet: https://en.wikisource.org/wiki/Kosovo_Rambouillet_Agreement_1999.

[511] Për dallimin mes kushtetutave tranformative dhe jotranformative, shih më shumë në: Cass R. Sunsstein, *Designing Democracy: What Constitutions Do* (Oxford UP: Oxford, 2001) fq. 67-68; Juan E. Mendez, "Constitutionalism and Transitional Justice", në Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law,* fq. 1282-1285. Duhet të theksohet, megjithatë, se Cass R. Sunstein konsideron si ruajtëse të gjitha kushtetutat e ish-vendeve komuniste të Evropës sepse, sic e thotë ai vetë, "ato provojnë të ndërtohen mbi botëkuptimet që paradatojnë komunizmin". Ibid. fq. 68. Kjo, natyrisht, është gabim sepse dallimi mes dy llojeve të bazohet në atë nëse kushtetutat synojnë të ruajnë traditat e mëparshme individuale, pra jo traditat e kulturave e civilizimeve të tjera. Sikur të ishte kështu, atëherë çdo kushtetutë e vendeve të botës së tretë dhe kushtetutat e vendeve të tjera të modeluara sipas standardeve perëndimore mbi demokracinë kushtetuese pas rënies së sistemeve të tyre totalitare do të konsideroheshin si kushtetuta që ruajnë (konservojnë) të kaluarën. Këto vende si, p.sh., Spanja, Portugalia, Greqia etj., apo tjerat si Kili, Nikaragua, Honduras, Angola, Mozambiku etj., do të cilësoheshin si kushtetuta ruajtëse (konservuese) të traditave të kaluara, përkundër faktit se tërë përpjekjet e tyre kanë qenë që të shkëputen nga e kaluara e tyre totalitare.

drejtës në lëmin e të drejtave dhe lirive fundamentale të individit pati ngelur e paqartë. Ky nuk ka qenë rasti me Kornizën Kushtetuese, e cila vuri në lëvizje standardet mbi të drejtat e liritë fundamentale, të cilat pak a shumë kanë ngelur të pandryshuar në tekstin e Kushtetutës së Kosovës të datës 15 qershor 2008.

Korniza Kushtetuese është miratuar nga një Kuvend i Liderëve Politikë të Kosovës më 2002[512]. Miratimi i saj ka qenë një hap i rëndësishëm në shërbim të paqes dhe stabilitetit në Kosovë. Si e tillë, Korniza Kushtetuese hapi rrugën për mbajtjen e zgjedhjeve të para të lira dhe të ndershme në nëntor të vitit 2001, nga lindën institucionet e reja vetëqeverisjes në Kosovë, të njohura si Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë ("IPVQ"). Zgjedhjet e nëntorit 2001, nga të cilat lindën institucionet e reja të vetëqeverisjes në Kosovë, përbënin një hap institucional që i atribuohet kapitullit VII të Kartës së OKB-së. Përkundër faktit se ato nuk kanë pasur një autonomi të plotë siç e kanë institucionet e një vendi sovran dhe të pavarur, ato sërish ngelen institucionet e para demokratike në historinë e shtetndërtimit në Kosovë.

Në kuptim të të drejtave dhe lirive të individit, si dhe të komuniteteve kosovare, Korniza Kushtetuese në kapitujt 3 dhe 4 parashikonte dispozita identike me ato të kapitujve II ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore"] dhe III ["Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre"] të Kushtetutës së Kosovës në fuqi. Korniza ka shërbyer si një pikë referimi për hartuesit e Kushtetutës së Kosovës.

Për herë të parë, me Kornizën Kushtetuese parashikohet zbatimi në territorin e Kosovës, i drejtpërdrejtë[513] dhe tërthortë, i marrëveshjeve ndërkomb-

---

[512] Korniza Kushtetuese ka hyrë në fuqi më 15 maj 2001, si Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2001/9, dhe është shpallur nga ana e PSSP të OKB-së. Si e tillë, ka pasur cilësinë e një legjislacioni të autorizuar dhe të nxjerrë nga ana e UNMIK-ut konform Rezolutës 1244 të KS të OKB-së dhe Rregullores Nr. 01 të datës 15 korrik 1999. Ky dokument, i nxjerrë me synimin për të krijuar bazën e rendit kushtetues kosovar, ka pasur rangun dhe vlerën e njëjtë si rregulloret dhe aktet tjera të UNMIK-ut të nxjerra pas qershorit 1999 deri më shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008. Për tekstin e plotë të Kornizës Kushtetuese, shih në rrjet: http://www.unmikonline.org/regulations/2001/reg09-01.htm.

[513] Zbatimi i drejtpërdrejtë i normave ndërkombëtare është ngushtë i lidhur me kuptimin e vetekzekutimit të normës së dhënë, pa marrë parasysh burimin e saj. Kjo është logike sepse një rregull zbatohet vetëm nëse ka përmbajtje normative. Kjo do të thotë se një normë ndërkombëtare, e cila gjendet në një marrëveshje ndërkombëtare, zbatohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë vetëm nëse ka natyrë të vetekzekutueshme. Mbi zbatimin e drejtpërdrejtë të normave ndërkombëtare në aspektin komparative, shih më shumë në Anne Peters and Ulrich K Preuss, "International relations and international law", në Mark Tushnet, Thomas

ëtare mbi të drejtat e njeriut.[514] Kjo ngjashmëri me Kushtetutën e Kosovës në fuqi daton që nga Marrëveshja e Rambujesë.[515] Kjo nënkupton, me fjalë tjera, se Marrëveshja e Rambujesë dhe Korniza Kushtetuese kanë përmbajtur dispozita substanciale regjionale e ndërkombëtare mbi të drejtat e liritë fundamentale të individit, të cilat kanë shërbyer si e drejtë kushtetuese e Kosovës për të ndihmuar transicionin në drejtim të një demokracie të mirëfilltë kushtetuese. Përmes këtyre dy dokumenteve, instrumentet regjionale dhe ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut u bënë e drejtë e Kosovës në transicion dhe mjete për ndryshim të shoqërisë kosovare përgjatë vijave të konstitucionalizmit perëndimor. Një gjë e tillë reflektohet në çdo dispozitë të këtyre dy dokumenteve të Kosovës para shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008, si kur flitet për organizimin e pushtetit ashtu edhe për vendin dhe rolin e të drejtave e lirive fundamentale të individit dhe të minoriteteve.

Sa i përket zbatimit të dispozitave të kapitujve të cituar më sipër të Kornizës Kushtetuese, neni 3.2 theksonte se:

> Institucionet e Pavarura të Vetëqeverisjes respektojnë dhe sigurojnë zbatimin e të drejtave e lirive të individit të njohura ndërkombëtarisht, përfshirë ato që parashihen në: (a) Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut; (b) Konventën Evropiane për të Drejtat e Liritë e Njeriut dhe protokollet e saj; (c) Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe protokollet e saj; (d) Konventën Evropiane për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial; (e) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave; (f) Konventa për të Drejtat e Fëmijëve; (g) Karta Evropiane për Gjuhët Regjionale dhe të Minoriteteve; dhe (h) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Nacionale.

Korniza Kushtetuese njohu që "dispozitat mbi të drejtat dhe liritë e parapara në këto instrumente zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë si

---

Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Routledge Handbook of Constitutional Law* (Routledge: London, 2013) fq. 33-43.

[514] Zbatimi i tërthortë është i lidhur ngushtë me interpretimin e tekstit të dhënë kushtetues, gjë që nënkupton se një normë ndërkombëtare zbatohet në mënyrë të tërthortë jo për shkak se paraqet një detyrim juridik për institucionet vendore por për shkak të faktit se një interpretim i normave vendore (kushtetuese dhe ligjore) bëhet duke marrë parasysh normat dhe standardet e të drejtës ndërkombëtare. Mbi zbatimin e tërthortë të normave ndërkombëtare nga aspekti komparativ shih më shumë në Anne Peters and Ulrich K Preuss, "International Relations and International Law", fq. 33-43.

[515] Për një analizë të hollë të kësaj materieje, shih tek Marc Weller, *Shtetesia e kontestuar: Administrimi ndërkombetar i luftës së Kosovës për pavarësi* (Koha: Prishtinë, 2009) fq. 391-420.

pjesë e kësaj Kornize Kushtetuese"[516]. Zbatimi i drejtpërdrejtë, megjithatë, nuk ka arritur të krijojë në mënyrë automatike efektin homonim të këtyre instrumenteve, anise një lexim logjik mund të çojë te argumenti sipas së cilit instrumentet e tilla mund të kenë efektin e tillë të drejtpërdrejtë dhe të shërbejnë si bazë për të mbështetur burimin e së drejtës dhe lirisë konkrete njerëzore.

Sipas Kornizës Kushtetuese, normat ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë fundamentale të njeriut konsideroheshin si të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë për aq sa ato kishin natyrën e normave të vetekzekutueshme. Interpretimi i tyre sipas standardeve të njohura ndërkombëtarisht mbi të drejtat e liritë fundamentale (zbatimi i tërthortë) ishte detyrim që dilte jo vetëm nga neni 3.2 i Kornizës Kushtetuese por edhe nga rregullativa tjetër e nxjerrë nga UNMIK-u gjatë fazës së hershme të administrimit me Kosovën[517] Normat ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë fundamentale kanë qenë pjesë përbërëse e rendit juridik kosovar që nga nxjerrja e rregulloreve të ndryshme të UNMIK-ut, të cilat kishin për qëllimin administrimin e Kosovës. Si zbatimi i drejtpërdrejtë ashtu dhe ai i tërthortë nuk ka qenë kontestues, sepse ky zbatim ka qenë një detyrim kushtetues i të gjitha autoriteteve publike kosovare. Në praktikë, megjithatë, situata ishte ndryshe sepse shumë pak, nëse ndonjëri, prej institucioneve të Kosovës e mori seriozisht një detyrim të tillë. Kjo shpërputhje mes normave të nxjerra nga UNMIK-u dhe situatës në terren u pa hapur vetëm me ngjarjet tragjike të marsit 2004.

3.2. Nuk ka dualizëm në lëmin e të drejtave dhe lirive fundamentale

Për sa i përket sferës së të drejtave dhe lirive fundamentale, në Kushtetutën e Kosovës ekzistojnë dy gjëra që posaçërisht duhet të veçohen me këtë rast. Së pari, në frymën e Marrëveshjes së Rambujesë dhe raportit konfidencial vlerësues të Komisionit të Venedikut, që u cek më sipër, Kushtetuta në fuqi e Kosovës iu njeh statusin e normave kushtetuese instrumenteve kyçe

---

[516] Neni 3.3 ["Të Drejtat e Njeriut"] i Kornizës.

[517] Po aq e rëndësishme është edhe rregullorja e UNMIK-ut që ka të bëjë me të drejtat dhe liritë fundamentale të individit, Rregullorja Nr. 24/1999 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë e datës 12 dhjetor 1999. Në seksionin 1.3 lidhur me "Ligjin e Zbatueshëm", Rregullorja përdorte të njëjtin formulim si neni 3.2 i Kornizës Kushtetuese duke listuar gati të njëjtat instrumente ndërkombëtare si burim të ligjit mbi të drejtat e njeriut në Kosovë. I vetmi përjashtim është se kjo Rregullore listonte nën germën "d", përveç instrumenteve nga neni 3.2 i Kornizës Kushtetuese edhe Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të 16 dhjetorit 1966.

regjionale e universale në lëmin e të drejtave dhe lirive të individit. Në nenin e vet 22 ["Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare"], Kushtetuta liston një nga një instrumentet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, regjionale dhe universale, të cilat gëzojnë statusin kushtetues në mënyrë të njëjtë si çdo normë tjetër e Kushtetutës së Kosovës[518]. Në rast të konfliktit me legjislacionin tjetër të zakonshëm, këto instrumente dhe marrëveshje regjionale dhe universale kanë epërsi. Në këtë drejtim nuk ka ndonjë kontest sa i përket asaj nëse këto instrumente dhe marrëveshje gëzojnë status kushtetues, jo vetëm në aspektin material por edhe në aspektin formal (procedural). Natyrisht, i mbetet në barrë Gjykatës Kushtetuese që të definojë këtë marrëdhënie nga perspektiva e natyrës së penetrimit të së drejtës ndërkombëtare në rendin nacional kosovar.

Për rastin e instrumenteve dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare në lëmin e të drejtave dhe lirive të individit në të cilat Kosova mund të bëhet palë në të ardhmen, vlejnë rregullat e përgjithshme të Kushtetutës që kanë të bëjnë me lidhjen dhe ratifikimin e marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare. Këto rregulla gjenden në nenin 18 ["Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare"] të Kushtetutës. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë e individit bëhet me dy të tretat e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Kur të ratifikohen njëherë, ato marrëveshje bëhen pjesë e rendit të brendshëm juridik-kushtetues të Kosovës dhe kanë fuqinë mbi legjislacionin e zakonshëm të Kuvendit. Kjo nënkupton se ligji mbi ratifikimin nuk ka fuqi autonome normative të ndarë nga marrëveshja të cilën e fut në sistemin vendor përmes procesit të ratifikimit legjislativ. Nëse marrëveshja është e vetekz-

---

[518] Neni 22 ["Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare"] i Kushtetutës:

"Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

(3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;

(4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;

(5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;

(6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;

(7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;

(8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese".

ekutueshme, atëherë zbatohet drejtpërdrejt. Dhe, e kundërta, nëse një marrëveshje nuk ka natyrë të tillë të vetekzekutueshme, atëherë për zbatimin e saj nevojitet nxjerrja e legjislacionit implementues në mënyrë që marrëveshja e tillë të gjejë zbatim në gjykatë dhe nga autoritetet e tjera publike. Në asnjë rast, megjithatë, në Kosovë nuk mund të ndodhë ndryshimi përmes legjislacionit të zakonshëm i një marrëveshjeje ndërkombëtare e cila është ratifikuar me legjislacion prej dy të tretave të Kuvendit të Kosovës. Një marrëveshje e tillë mund të ndryshohet vetëm me ndjekjen e procedurës së njëjtë të ndryshimit të traktateve, e cila parashikohet me Konventën e Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve të vitit 1980 (KVDT).[519] Jo vetëm kaq, kjo rregull përbën një normë *jus cogens* për qëllimet e vënies në jetë të detyrimeve të shteteve të marra përmes ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare. Nga kjo del se Kosova bën pjesë në sistemin monist të shteteve për sa i përket marrëdhënies mes së drejtës ndërkombëtare dhe së drejtës së brendshme, në veçanti kur flitet për të drejtat dhe liritë e individit. Një gjë e tillë është theksuar pa asnjë ekuivok nga Gjykata Kushtetuese në aktgjykimin e saj lidhur me kontrollin kushtetues të Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, e iniciuar më datën 19 prill 2013 në Bruksel. Me këtë rast, Gjykata ka theksuar se nuk mund ta bëjë kontrollin kushtetues të një marrëveshjeje ndërkombëtare pas ratifikimit të saj nga ana e Kuvendit të Kosovës,[520] duke bazuar arsyetimin e saj në parimin e mosshmangies nga rregulla e KVDT që ndalon thirrjen në normat e brendshme kushtetuese me qëllim të zhvlerësimit të detyrimeve ndërkombëtare të shtetit.

Një çështje mjaft e rëndësishme, e cila duhet të ceket në vijim të diskutimit si më sipër, ka të bëjë me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës lidhur me përputhshmërinë e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas Kushtetutës dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur[521]. Ky është një argument shtesë që tregon se Kosova nuk pranon të bëjë kontroll represiv

[519] Cf. neni 18.4 ["Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare"] lidhur me nenin 19 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] i Kushtetutës.
[520] Cf. Aktgjykimi i datës 9 shtator 2013 në rastin KO 95/13. Parashtrues: Visar Ymeri dhe 11 Deputetë Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Rishikimi Kushtetues i Ligjit Nr. 04/L-199, mbi Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë të Parimeve që kanë të bëjnë me Normalizimin e Marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.
[521] Cf. neni 113. 2 (4) ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës.

të kushtetutshmërisë së traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, gjë që është në vijë me standardet e krijuara nga Komisoni i Venecias në këtë lëmi.

3.3. Lex Mitior *në lëmin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut*

Çështja e zbatimit të parimit *lex mitior* në lëminë e të drejtave dhe lirive fundamentale ka të bëjë me hierarkinë e burimeve të së drejtës kushtetuese në këtë lëmi. Kushtetuta e Kosovës, në këtë aspekt, nuk përmban rregulla specifike që njohin epërsinë e parimit *lex mitior* për sa i përket Kushtetutës. Me fjalë tjera, në rastin e Kosovës çështja e zbatimit të parimit *lex mitior* nuk shtrohet fare. Arsyeja për një gjendje të tillë gjendet në faktin se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në frymën e traditës së sipërcekur që ka filluar me Marrëveshjen e Rambujesë, ua njeh rangun kushtetues disa marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, të cilat zbatohen drejtpërsëdrejti në Kosovë. Në rast të konfliktit, thuhet në paragrafin e parë të nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, këto marrëveshje e instrumente ndërkombëtare kanë epërsi ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera juridike të autoriteteve dhe institucioneve publike kosovare. Ky pozicionim kushtetues i Kushtetutës së Kosovës nënkupton se nuk mund të ekzistojnë situatat në të cilat ofrohet një zgjidhje më e favorshme nga ligjet e vendit apo institucionet publike se ajo që ofrohet nga teksti i Kushtetutës në të cilën gjendet si normë kushtetuese lista e gjerë e marrëveshjeve e instrumenteve ndërkombëtare të cilat ngërthejnë standardet më të larta ndërkombëtare mbi mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive fundamentale të individit. Kjo është arsyeja pse në rastin e Kosovës epërsia e Kushtetutës në lëmin e të drejtave dhe lirive fundamentale të individit ndaj ligjeve dhe akteve të tjera juridike ka kuptimin e epërsisë efektive të standardeve më të larta ndërkombëtare mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive fundamentale të individit, ashtu siç janë të mishëruara në marrëveshjet dhe instrumentet regjionale dhe ndërkombëtare në këtë fushë. Një situatë e tillë ka ekzistuar, siç u tha më herët, edhe në Kornizën Kushtetuese, e cila në nenin 3.2 ka përmbajtur thuajse listën e njëjtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve regjionale dhe ndërkombëtare mbi të drejtat e liritë fundamentale të individit. Për më tepër, në praktikë gjendja prezantohet në një dritë pak më të ndritur.

Në praktikën e saj, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka shkuar më larg se tagri i pranuar nga neni 22.1 i Kushtetutës: në interpretimin e së drejtës për ambient të shëndoshë që buron nga neni 52.2 ["Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor"] të Kushtetutës, Gjykata gjerësisht është mbështetur në "të drejtën e

butë" që buron nga aktiviteti i OKB-së dhe Këshilli i Evropës, siç janë Deklarata e Rios e vitit 1992 mbi Mjedisin Jetësor dhe Zhvillimin; Konventa e vitit 1998 mbi Qasjen në Informata, Pjesëmarrjen Publike në Vendimmarrje dhe Qasjen në Drejtësi në Fushën e Ambientit Jetësor; dhe, së fundi, Rekomandimi 1614 i vitit 2003 i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës mbi Mjedisin Jetësor dhe të Drejtat e Njeriut[522]. Të drejtat e mjedisit të njohura si "e drejtë e butë" e OKB-së dhe Këshillit të Evropës janë shumë më të elaboruara se ato që njihen dhe pranohen nga Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut dhe kanë natyrë të vërtetë globale. Me këtë qasje, Gjykata ka vënë standarde rrënjësisht më të ndryshme në kontekstin e Kosovës në lëminë e mjedisit jetësor dhe përgjegjësisë së të gjithë akterëve për mbrojtjen e tij[523].

Përveç dispozitave të nenit 22 që iu njeh statusin kushtetues një numri të caktuar të marrëveshjeve e instrumenteve ndërkombëtare në lëmin e të drejtave dhe lirive fundamentale të individit, ekzistojnë disa dispozita tjera të cilat rregullojnë statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe instrumenteve të tjera si dhe statusin e së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi. Marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara në mënyrë kushtetuese bëhen pjesë e sistemit juridik dhe zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nëse janë të vetekzekutueshme, pasi të jenë publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës[524]. Në rastet kur nuk janë të vetekzekutueshme, atëherë duhet të nxirret një ligj i ri përmes së cilit ato bëhen pjesë e rendit kushtetues të Kosovës. Siç u cek më herët, ligji që ratifikon një instrument ndërkombëtar nuk ka fuqi normative: ai shërben vetëm si mjet për futjen në sistemin e brendshëm kushtetues të instrumentit të tillë ndërkombëtar. Kjo nënkupton se çdo amendament ose tërheqje nga instrumenti ndërkombëtar duhet të ndjekë rrugën e njëjtë të vendimmarrjes ashtu siç është ndjekur me rastin e ratifikimit. Marrëveshjet e tilla ndërkombëtare dhe instrumentet e tjera krahas normave të detyrueshme të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Kosovës[525].

---

[522] Cf. Aktgjykimi i 22 dhjetorit 2010 në rastin KI 56/09. Parashtrues: Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë vs. Kuvendit Komunal i Prizrenit.
[523] Cf. Paragrafët 61-64 të Aktgjykimit.
[524] Cf. Neni 18 ["Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare"] dhe neni 19 ["Zbatimi i së drejtës Ndërkombëtare"] i Kushtetutës.
[525] Cf. Neni 18 ["Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare"] lidhur me nenin 19 ["Zbatimi i së drejtës Ndërkombëtare"] të Kushtetutës.

4. Nocioni dhe funksionet e të drejtave fundamentale

Disejni kushtetues kosovar, i skicuar nën mbikëqyrjen dhe ndihmën e madhe të bashkësisë ndërkombëtare reflekton vlerat bazike, normat, parimet dhe zakonet konstitucionalizmit modern ashtu siç kuptohet dhe zbatohet në botën perëndimore.[526] Në këtë kuptim, Kushtetuta e Kosovës nuk dallon për nga burimi i saj prej kushtetutave të vendeve perëndimore dhe të atyre të modeluara sipas kritereve dhe standardeve perëndimore. Dallimet që ekzistojnë janë kryesisht si rezultat i teknikave të krijuara me qëllim të zbatimit të burimeve bazike të së drejtës kushtetuese në lëmin e të drejtave dhe lirive fundamentale të individit të rregulluara nën Kapitullin II ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore"] me nenin 21 ["Parimet e Përgjithshme"] dhe nenin 22 ["Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare"], lidhur me nenin 18 ["Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare"] dhe nenin 19 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] të Kushtetutës. Dispozitat e këtyre neneve sigurojnë që të drejtat dhe liritë fundamentale të individit janë cilësia kryesore definuese e Shtetit të Kosovës në të cilin as sovraniteti e as pavarësia[527], por edhe as ushtrimi i pushtetit, nuk mund të realizohen pa respektim të plotë të të drejtave dhe lirive fundamentale të individit[528]. Kjo është sa i përket aspektit vertikal ose klasik të funksionit të të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut.

Kushtetuta e Kosovës përmban dispozita edhe për funksionin horizontal të të drejtave dhe lirive fundamentale: paragrafi i tretë i nenit të saj 21 thekson detyrimin e përgjithshëm që vlen për çdokënd dhe i cili konsiston në atë se secili individ duhet të respektojë të drejtat dhe liritë fundamentale të individëve të tjerë. Efekti horizontal i efektit të të drejtave dhe lirive kushtetuese, megjithatë, nuk hyn në kuadër të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, meqë kjo e fundit mund të vendosë vetëm mbi kushtetutshmërinë e akteve individuale të autoriteteve publike. Juridiksioni aktual i Gjykatës Kushtetuese që ka të bëjë me ankesat individuale shërben vetëm për të krijuar kontekstin në të cilin autoritetet publike kanë për detyrë të garantojnë rrugën dhe mënyrat

---

[526] Anne Peters and Ulrich K. Preuss, "International relations and international Law", fq. 33-34.

[527] Cf. Neni 2 ["Sovraniteti"] i Kushtetutës.

[528] Neni 3 paragrafi 2["Barazia para Ligjit"] i Kushtetutës: "Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkombetarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre".

për respektimin e të drejtave të njeriut në nivelin horizontal. Si i tillë, ky juridiksion i Gjykatës, thënë sipas gjuhës së Bashkimit Evropian, siguron efektin e tërthortë horizontal të të drejtave dhe lirive fundamentale të individit. Së bashku me dispozitat e tjera që kanë të bëjnë me ndarjen e pushteteve, pluralizmin politik, dhe llojet e ndryshme të pronës në një ekonomi të lirë të tregut, dispozitat e neneve 21 dhe 22 të Kushtetutës së Kosovës paraqesin esencën e së drejtës kushtetuese kosovare sepse tregojnë që e drejta kushtetuese e Kosovës nuk reflekton strukturën materiale të shoqërisë së Kosovës por praktikat më të mira të demokracive moderne kushtetuese.

Në lëmin e të drejtave dhe lirive fundamentale, Kushtetuta e Kosovës, pa fije dyshimi, mishëron konceptin natyror të të drejtave, i cili nënkupton se sanksionon idenë themelore sipas së cilës të drejtat dhe liritë fundamentale të individit u takojnë njerëzve *qua humans* pavarësisht dispozitave kushtetuese. Kjo qasje reflektohet në tërësi në dispozitën e paragrafit të parë të nenit 21 që konstaton se "të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës".

4.1. Koncepti i të drejtave fundamentale dhe interpretimi i tyre

Kushtetuta e Kosovës iu njeh të drejtave dhe lirive fundamentale të individit një status ekstra kushtetues. Si të tilla, ato definojnë të gjitha aspektet e jetës në Kosovë, si në sferën publike ashtu dhe në atë private. Formulimi i dispozitës së nenit 21 në Kapitullin II të Kushtetutës, e cila flet për parimet e përgjithshme, përbën shprehjen më sublime të këtij koncepti. Kjo nuk është kështu kur është fjala për të drejtat dhe liritë nga Kapitulli III ["Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre"], të cilat duhet të shërbejnë si plotësim i të drejtave dhe lirive fundamentale nga Kapitulli II.

Neni 57 i Kapitullit III flet për parimet e përgjithshme të cilat, megjithatë, nuk kanë vlerë universale siç kanë ato nga neni 21 i Kapitullit II të Kushtetutës. Të drejtat dhe liritë nga Kapitulli II janë të konceptuara si të drejta dhe liri natyrore që iu takojnë të gjithë atyre që bien nën juridiksionin e Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës, kurse ato nga Kapitulli III, mund të thuhet, janë të konceptuara si të drejta dhe liri pozitive të cilat i përshtaten kontekstit kosovar dhe nuk kanë vlerë universale.

Parimi i parë i përgjithshëm i nenit 21 përfaqëson një deklaratë fakti, gjë e cila nënkupton se nuk bën asgjë pos që deklaron se të drejtat dhe liritë fundamentale në Kosovë janë të drejta dhe liri natyrore, ekstra-kushtetuese, dhe

i paraprijnë çdo pushteti politik. Si të tilla ato i takojnë vetë natyrës njerëzore, janë të patjetërsueshme, të pandashme, të pacenueshme dhe bazë e çdo rendi juridik e pushteti politik në Kosovë, dhe assesi anasjelltas. Parimi i dytë i përgjithshëm sanksionon një detyrim për Republikën e Kosovës që t'i mbrojë të drejtat dhe liritë fundamentale të konceptuara kësisoj. Përveç këtij aspekti klasik, përkatësisht vertikal të mbrojtjes të të drejtave dhe lirive fundamentale, parimi në vijim, parimi i tretë, i nenit 21 nuk lë asnjë dyshim për sa i përket aspektit horizontal të mbrojtjes në fjalë, gjë që ka një vlerë të njëjtë me anën klasike të mbrojtjes. Për këtë qëllim, ky parim deklaron se "çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve". Parimi i fundit me radhë parashikon mbrojtjen dhe gëzimin e të drejtave dhe lirive fundamentale nga ana e personave juridikë, siç thuhet, "për aq sa janë të zbatueshme" për ta.

Parimet e përgjithshme të Kapitullit III, siç përshkruhet në nenin 57 të Kushtetutës, janë të ndryshme sepse formulimi i tyre është në terma pozitivist. Parimi i parë e bën të qartë se të drejtat e këtij kapitulli janë të drejta specifike të cilat i gëzojnë, krahas të drejtave e lirive fundamentale nga Kapitulli II i Kushtetutës, qytetarët që i takojnë grupit të njëjtë nacional, etnik, gjuhësor apo fetar të cilët tradicionalisht kanë qenë prezentë në territorin e Republikës së Kosovës ("komunitetet"). Parimi i përgjithshëm në vijim u njeh autonomi të plotë për të zgjedhur atyre të cilët eventualisht dëshirojnë t'i takojnë komunitetit të caktuar kosovar dhe asnjë pasojë diskriminuese nuk mund të burojë nga një zgjedhje e tillë. Kjo është bërë me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të identitetit dhe karakteristikave të komuniteteve të Kosovës, siç sqarohet më tutje në parimin e tretë të përgjithshëm të nenit 57 të Kushtetutës. Në gëzimin e këtyre të drejtave dhe lirive, komunitetet kosovare kanë detyrime të dyfishta, si ndaj shtetit të Kosovës ashtu edhe ndaj atyre me të cilët jetojnë në përbashkësi. Kjo bëhet e qartë në parimin e fundit të përgjithshëm të këtij neni, i cili thotë se "ushtrimi i këtyre të drejtave do të bartë me vete detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me ligjin e Republikës së Kosovës, dhe nuk i cenon të drejtat e të tjerëve".

4.2. Të drejtat dhe detyrimet fundamentale

Nga një analizë e kapitujve të Kushtetutës të cilët përbëjnë kartën kosovare të të drejtave dhe lirive të individit mund të vërehen disa lloje të të drejtave dhe lirive të garantuara por edhe disa detyrime fundamentale. Të drejtat dhe liritë kanë disa kritere çelës për klasifikim të cilat kanë të bëjnë me natyrën

dhe llojin e bartësve të tyre. Në kuptim të natyrës, ato ndahen në të drejtat dhe liri civile dhe politike, në njërën anë, dhe në të drejta sociale, ekonomike dhe kulturore, në anën tjetër. Duke ndjekur këtë klasifikim vihet deri te kategoria e të drejtave dhe lirive të gjeneratës së tretë.

Të drejtat civile, apo të drejtat e gjeneratës së parë, përfaqësojnë në rend të parë kufizimet substanciale të pushtetit shtetëror *vis-à-vis* individëve dhe autonomisë së tyre të lindur dhe dinjitetit njerëzor. Si të tilla, këto të drejta imponojnë një detyrim ndaj shtetit për t'u përmbajtur nga ndërhyrja në vlerat në të cilat mbështeten këto të drejta civile, siç janë vlerat, ta zëmë, si dinjiteti[529], jeta njerëzore[530], mendimi i lirë[531], privatësia[532], etj. etj. Siç do të shohim më vonë, ndërhyrja nga ana e shtetit mund të bëhet vetëm për aq sa është e domosdoshme në një shoqëri demokratike.

Të drejtat politike, apo të drejtat e pjesëmarrjes, nënkuptojnë të drejtat e individëve për të marrë pjesë në formimin, ushtrimin, kontrollin dhe ndryshimin e pushtetit shtetëror. Këto të drejta janë vendimtare për legjitimitetin e pushtetit politik. Në mesin e këtyre të drejtave më të rëndësishmet janë e drejta e votës[533], e drejta për të marrë pjesë në pushtet dhe në qasje të barabartë në postet publike[534], e drejta për të kritikuar qeverinë dhe mbajtësit e zyrave publike[535], etj. etj.

Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, të drejtat e gjeneratës së tretë ose të drejtat e mirëqenies, janë njohur shumë më vonë si pasojë e domosdoshme e natyrës njerëzore me qëllim të krijimit të kushteve minimale për drejtësi sociale dhe solidaritet. Si të tilla, këto të drejta synojnë krijimin e një ambienti të gjerë për realizim efektiv dhe substancial të të drejtave civile dhe politike. Me qëllim që kjo të ndodhë, ato i vejnë shtetit një barrë për ndërmarrjen e hapave të domosdoshëm për të siguruar të drejtën për punë[536], së

---

[529] Cf. Neni 23 ["Dinjiteti i Njeriut"] i Kushtetutës.
[530] Cf. Neni 25 ["E Drejta për Jetën"] i Kushtetutës.
[531] Cf. Neni 38 ["Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë"] lidhur me nenin 40 ["Liria e Shprehjes"] i Kushtetutës.
[532] Cf. Neni 36 ["E Drejta Privatësisë"] i Kushtetutës.
[533] Neni 45. 1 ["Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes"] i Kushtetutës.
[534] Neni 45. 3 ["Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes"] i Kushtetutës.
[535] Neni 40. 1 ["Liria e Shprehjes"] i Kushtetutës.
[536] Neni 49 ["E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit"] i Kushtetutës. Cf. Po ashtu Aktgjykimi i datës 15 prill 2013 në rastin KO 131/12. Parashtrues: Dr. Shaip Muja dhe 11 Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Shqyrtimi i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit mbi Shëndetësinë, Nr. 04/L-125, miratuar nga ana e Kuvendit më datën 13 dhjetor 2012. Në këtë rast Gjykata, pasi theksimit në paragrafin 155 të Aktgjykimit se e drejta për punë nuk është një e drejtë që mbrohet nga KEDNj, ka gjetur se ka cenim të së

bashku me të drejtat e tjera shtojcë për kompensim të barabartë për punën e kryer dhe si dhe për kompensim për situatat e papunësisë, të drejtën për edukim[537], sigurim social dhe kujdes shëndetësor[538], etj. etj.

Së fundi, të drejtat e njeriut janë klasifikuar në Kushtetutën e Kosovës duke marrë për bazë bartësit e tyre. Si të tillë, bartësit mund të jenë individual dhe kolektiv. Në esencë, të drejtat njerëzore janë të drejta individuale. Realizimi i tyre, megjithatë, në disa raste është i mundur vetëm në bashkësi me të tjerët. Përveç kësaj, individët nuk mund të gëzojnë të drejtat e tyre individuale nëse komuniteti të cilit ata i takojnë është i kërcënuar apo i diskriminuar. Për këtë arsye, të drejtat e tilla janë cilësuar në mënyra të ndryshme, si të drejta kolektive, ose të drejtat e popullit, të drejtat komunitare, të drejtat e komuniteteve etnike, fetare, nacionale, raciale, gjuhësore dhe të drejtat e tjera grupore etj. Në Kushtetutën e Kosovës, këto të drejta janë pjesë e Kapitullit III dhe definohen si të drejta të atyre të cilët janë:

> banorë që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet) [dhe të cilët] gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute.[539]

Për sa i përket detyrimeve fundamentale në përgjithësi, Kushtetuta e Kosovës parashikon tri lloje sosh. Grupin e parë e përbëjnë detyrimet të cilat e detyrojnë Republikën e Kosovës që të ofrojë një ambient të sigurt dhe të qetë për gëzimin e këtyre të drejtave dhe lirive fundamentale, si dhe të ndërmerr hapa konkret për gëzimin e tyre. Kjo quhet ndryshe edhe "detyrimi për të vepruar" në anën e shtetit, i parashikuar në shumicën e kushtetutave të shoqërive që kanë dalë nga sundimi autoritar. Në këtë kuptim, shteti merr rolin e garantuesit që do të ketë një ndërprerje me të kaluarën për aq sa i takon mbrojtjes dhe gëzimit të të drejtave dhe lirive të caktuara. Lloji i dytë i detyrimit fundamental ka të bëjë me detyrimin vertikal të shtetit për mosveprim, përkatësisht për mosndërhyrje ndaj shfrytëzimit të disa të drejtave dhe lirive të caktuara të individëve. Në maje të këtij detyrimi horizontal, përkatësisht të

---

drejtës për punë nga Kuvendi i Kosovës meqë nuk është kryer një balancim i drejtë mes interesit publik dhe lirisë së individëve për të zgjedhur lirshëm profesionin e tyre (paragrafi 155 në lidhje me paragrafët 174-175).

[537] Neni 47 ["E Drejta për Arsimin"] i Kushtetutës.

[538] Neni 51 ["Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale"] i Kushtetutës.

[539] Neni 57.1 ["Parimet e Përgjithshme"] i Kapitullit III ["Të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre"].

këtij detyrimi të individëve *qua* individë qëndron detyrimi për të respektuar të drejtat e tjerëve dhe për të mos i cenuar ato. Si një detyrim i ndarë i natyrës fundamentale është ai që i referohet komuniteteve kosovare, të cilat kanë detyrim të respektojnë jo vetëm ligjet e Kosovës por edhe të drejtat e tjerëve. Kjo nënkupton se gjatë gëzimit të të drejtave të tyre specifike, komunitetet nuk mund të cenojnë të drejtat e tjerëve. Detyrimet e këtyre të fundit, pra detyrimet e komuniteteve kosovare janë krejt kontekstuale dhe kanë për qëllim që të transformojnë shoqërinë kosovare ashtu që të drejtat dhe liritë fundamentale nga Kapitulli II të kenë më shumë kuptim substancial dhe real, duke marrë parasysh të kaluarën violente të shoqërisë kosovare. Në këtë kuptim, dispozitat e Kapitullit III në tërësi nuk reflektojnë strukturën materiale të shoqërisë kosovare dhe shkojnë përtej kësaj strukture me qëllim që ta tejkalojë dhe rimodelojë atë përgjatë vijave të traditave dhe praktikës së konstitucionalizmit modern perëndimor në kohën që po vjen.

5. Marrëdhënia juridike në lëmin e të drejtave fundamentale

Marrëdhënia juridike në lëmin e të drejtave të njeriut i referohet dhënies së përgjigjeve në këto pyetje: 1. kush janë bartësit e të drejtave dhe lirive fundamentale njerëzore; dhe 2. kujt i adresohen të drejtat dhe liritë fundamentale njerëzore; dhe, së fundi, 3. cili është ndikimi i të drejtave dhe lirive fundamentale në një shoqëri (caqet e tyre, kufizimi dhe llojet e kufizimit të të drejtave dhe lirive njerëzore).

5.1. Bartësit e të drejtave fundamentale

5.1.1. Personat fizikë (natyrorë)

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin e saj 21 qartë flet për zbatimin e të drejtave dhe lirive njerëzore ndaj personave fizikë. Sa i përket personave juridikë, zbatimi i të drejtave e lirive fundamentale bëhet për aq sa është e mundur një gjë e tillë (për aq sa lejon natyra e personave juridikë)[540].

[540] Cf. Neni 21.1 dhe 4 ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore: Parimet e Përgjithshme"] i Kushtetutës. Gjykata disa herë ka vendosur lidhur me të drejtat e personave juridikë. Rasti i parë që ka shërbyer më pastaj si pikë referimi në këtë aspekt ka qenë Aktvendimi mbi Papranueshmëri në rastin KI 41/09. Parashtrues: Universiteti AAB-Riinvest kundër Qeverisë së Kosovës, datë 27 janar 2010. Në këtë rast, Gjykata ka theksuar se të drejtat dhe liritë funda-

5.1.2. Shtetasit

Në parim, pjesëmarrësit e parë në gëzimin e të drejtave dhe lirive fundamentale janë shtetasit e Kosovës, përfshirë edhe ata që jetojnë jashtë vendit. Në nenin e saj 14 ["Shtetësia"] të Kushtetutës është thënë se "fitimi dhe humbja e së drejtës së shtetësisë së Republikës së Kosovës rregullohet me ligj"[541]. Neni në vijim, neni 15 ["Shtetasit jashtë Vendit"] i Kushtetutës, normon detyrimin e Republikës për të mbrojtur interesat e shtetasve kosovarë që jetojnë jashtë vendit ashtu siç parashihet me ligj.

5.1.3. Të huajt

Në dy kapitujt e Kushtetutës që normojnë kartën kosovare të të drejtave të njeriut, të cilat u diskutuan më parë, nuk ekziston asnjë dispozitë që do të kufizonte shfrytëzimin e të drejtave dhe lirive fundamentale mbi bazën e shtetësisë. Kjo qasje e Kushtetutës mund të deduktohet nga neni 21.1 i Kushtetutës, i cili në mënyrë të qartë thekson se "të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës". Rendi juridik-kushtetues kosovar në parim mbështet mbi të drejtat dhe liritë fundamentale njerëzore. Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka afirmuar dhe konfirmuar këtë fakt juridik-kushtetues në vendimet e saj duke mos lënë asnjë dyshim se edhe të huajt hyjnë në këtë kategori të shfrytëzuesve të të drejtave dhe lirive njerëzore[542]. Neni 21.1 i Kushtetutës nuk bën asgjë pos që i jep një kuptim shtesë nenit 1 ["Përkufizimi i Shtetit"] të Kushtetutës, nen i cili, në të njëjtën kohë, në paragrafin e tij të dytë konstaton si vijon: "Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respekti-

---

mentale zbatohen në mënyrë të njëjtë edhe ndaj personave juridikë për aq sa lejon natyra e tyre si persona juridikë.

[541] Ligji Nr. 03/L-034 mbi Shtetësinë e Kosovës i 20 shkurtit 2008.

[542] Cf. në veçanti rastet si vijon: Aktvendimi për Papranueshmëri i 21 marsit 2011 në rastin Nr. KI 02/10. Parashtrues: Roland Bartetzko. Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, AP-KZ 181/2002, të 12 nëntorit 2002.

Aktvendimi për Papranueshmëri i 14 dhjetorit 2011 në rastin Nr. KI 121/10. Parashtrues: Sitaram Chaulagai, Krishna Bandur Chamlagai, Chandra Kala Chauhan dhe Hom Bahadur Battarai. Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë GJL. nos. 1258/2010, 1259/2010, 1260/2010, 1261/2010, të 22 nëntorit 2010.

Aktvendimi për Papranueshmërinë i datës 20 mars 2012 në rastin KI 147/11. Parashtrues: Maria Strugari. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, GJL. nr. 1288/2011, të 28 tetorit 2011.

min e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj".

5.1.4. Personat juridikë/grupi i personave pa zotësi juridike

Në nenin 21.4 të Kushtetutës, që i referohet parimeve të përgjithshme të Kapitullit II ["të Drejtat dhe Liritë Themelore"], Kushtetuta thotë se "të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme". Në këtë frymë, Gjykata Kushtetuese në rastin *AAB-Riinvest*, ka shtjelluar rolin dhe vendin e të drejtave dhe lirive fundamentale në kuadër të sistemit juridik-kushtetues të Kosovës dhe zotësinë juridike të personave juridikë. Vetëm në këtë kontekst mund të diskutohet për gëzimin e barabartë të lirive dhe të drejtave fundamentale nga ana e personave të tjerë përveç atyre fizikë.

Për sa i takon grupimeve të personave të tjerë, përveç atyre që kanë zotësi juridike, në rastin e njohur si *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit*[543], Gjykata e ka bërë të qartë se ata kanë një akt të një autoriteti publik, akt që prek të drejtat e liritë e tyre fundamentale. Kjo domethënë se është akti i autoritetit publik ai që përcakton shfrytëzuesit e të drejtave dhe lirive fundamentale dhe shërben si pikë referimi, pra jo numri i personave apo zotësia juridike e tyre veç e veç.

5.2. Kujt i adresohen të drejtat dhe liritë njerëzore?

Marrëdhënia juridike në lëmin e të drejtave dhe lirive njerëzore është e dyfishtë. Nganjëherë ajo përbën një marrëdhënie ekstrakushtetuese dhe paraqet një raport natyral mes individëve kundrejt tërë botës që i rrethon. Në rastet e tjera, marrëdhënia përbën një të drejtë subjektive e cila parashikohet nga vetë teksti kushtetues. Si e tillë, e drejta subjektive ka bartësit e të drejtave dhe lirive fundamentale si dhe bartësit e autorizimeve (tagrave) konkrete që dalin nga këto të drejta dhe liri fundamentale. Autorizimet (tagrat), në të njëjtën kohë, mund të përkthehen edhe si detyrime për të tjerët që të respektojnë dhe promovojnë të drejtat dhe liritë e tilla të njohura me tekstin kushtetues. Të marra si tërësi, këto aspekte të të drejtave dhe lirive njerëzore përbëjnë një rend objektiv kushtetues që garantohet dhe vihet në jetë nga pushteti publik përmes mekanizmave dhe instrumenteve të ndryshme kushtetue-

[543] Cf. fusnota 108, supra.

se. Me fjalë të tjera, këto të drejtave subjektive kanë një adresë e cila krijon një detyrim për autoritetet publike që t'i vëjnë në jetë sepse si të tilla ato të drejta përbëjnë një rend objektiv kushtetues.

5.2.1. Pushteti publik

Në parim, shteti kosovar paraqitet si garantuesi kryesor i zbatimit të të drejtave dhe lirive fundamentale të parapara me kapitujt II dhe III të Kushtetutës. Kështu, në nenin 21.2 të Kushtetutës është thënë se "Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë". Kjo dispozitë e përgjithshme është elaboruar më tutje në nenin 58 ["Përgjegjësitë e Shtetit"] që rregullon në shtatë paragrafë të gjitha aspektet e detyrimeve shtetërore për të siguruar zbatimin real të të drejtave dhe lirive fundamentale të komuniteteve kosovare. Në vendimin e vet famoz lidhur me emblemën e Komunës së Prizerenit, qytet në jug të Kosovës, Gjykata e ka bërë të qartë se barazia e të gjithë anëtarëve të komuniteteve kosovare, i kulturës dhe identitetit të tyre paraqet një *sine qua non* të ekzistencës së shtetit të ri të Kosovës, i cili modelohet sipas vlerave të konstitucionalizmit perëndimor[544].

Roli dhe pozita e Shtetit të Kosovës në vënien në jetë të të drejtave dhe lirive nga kapitujt II dhe II janë të qarta sepse bëhet fjalë për detyrime specifike të Republikës së Kosovës për të vepruar përmes organeve legjislative, administrative dhe gjyqësore me qëllim që t'i japë kuptim konkret të drejtave e lirive të garantuara me tekstin kushtetues.

5.2.2. Të tjerët

Adresa të tjera të të drejtave e lirive fundamentale gjenden në sferën e marrëdhënieve jovertikale të veprimit (efektit) të tyre. Në doktrinën gjermane kjo njihet si "efekti horizontal" (*Drittwirkung*) i të drejtave të njeriut[545]. Në Kushtetutën e Kosovës, kjo doktrinë mishërohet në nenin 21.3 të saj, i cili thekson se "çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve". Në praktikën e vet Gjykata nuk ka hasur në një rast të vendimmarrjes në këtë lëmë sepse neni 113.7 i Kushtetutës parashikon që

[544] Aktgjykimi i datës 18 mars 2010 në rastin KO 01/09. Ćemailj Kurtiši kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit.

[545] Cf. më shumë në Eric Engle, "Third Party Effect of Fundamental Rights (*Drittwirkung*)", në *Hanse Law Review* vol. 5, no. 2 (2009) fq. 165-173.

"individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj". Më fjalë të tjera, Gjykata shqyrton vetëm veprimet individuale të autoriteteve publike kosovare, jo veprimet individuale të individëve *qua* individë. Efektet juridike të vendimeve të Gjykatës, megjithatë, në disa raste mund të kenë (dhe kanë) efekt ndaj palëve të treta.

5.3. Ndikimi i të drejtave fundamentale

5.3.1. Caqet e mbrojtjes së të drejtave fundamentale

5.3.1.1. Mbrojtja për sa i përket ligjvënësit

Neni 112 i Kushtetutës definon rolin dhe pozitën e Gjykatës Kushtetuese[546]. Neni në fjalë ndahet në dy pjesë. Autoriteti i Gjykatës për të shërbyer si autoriteti përfundimtar për interpretim të Kushtetutës është pjesa e parë e këtij neni, kurse pjesa e dytë e tij flet për rolin e Gjykatës si kontrollues i pajtueshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera të autoriteteve publike me Kushtetutën. Ky nen i Kushtetutës qartë pozicionon Gjykatën si një institucion klasik kelsenian. Kuptimi "ligj" i përdorur në këtë nen duhet të kuptohet si diçka që përfshinë si legjislacionin primar ashtu edhe atë sekondar si dhe aktet e tjera të trupave që nxjerrin "ligje", si p.sh. kuvendet komunale. Kjo është bërë e qartë në dispozitat e Kushtetutës që rregullojnë juridiksionin e Gjykatës.

Në nenin 113 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] të Kushtetutës, ekzistojnë disa paragrafë që rregullojnë kontrollin kushtetues dhe format e tij, si preventive ashtu edhe represive, të akteve legjislative (primare dhe sekondare). Paragrafi 2(1) i nenit 113 referohet kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve, dekreteve të Presidentit dhe të Kryeministrit, si dhe të rregullave të Qeverisë. Paragrafi 2 në vijim i nenit të njëjtë parashikon kontrollin kushtetues të statuteve komunale.

Në mesin e dispozitave specifike të Kushtetutës janë që sanksionojnë kontrollin preventiv të amendamenteve kushtetuese. Ky lloj i kontrollit është i rrallë. Vetëm pak vende e njohin në kushtetutat e tyre[547]. Kushtetuta e Kos-

[546] Cf. Neni 112 i Kapitullit VIII ["Gjykata Kushtetuese: Parimet e Përgjithshme"] i Kushtetutës.

[547] Kontrolli preventiv i kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara kushtetuese bëhet para votimit të tyre në Kuvend. Gjykata vlerëson *in abstracto* nëse amendamentet e propozuara zvogëlojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Ku-

ovës njeh dy lloje të kontrollit preventiv të amendamenteve kushtetuese. Së pari, Kushtetuta autorizon Gjykatën që të bëjë kontrollin e pajtueshmërisë së amendamenteve kushtetuese me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi në bazë të Kushtetutës përfshirë këtu kontrollin kushtetues të procedurës së ndjekur për ratifikimin e tyre[548]. Së dyti, Gjykata ka autorizim për të bërë kontrollin kushtetues të çdo amendamenti kushtetues për të parë nëse amendamenti i tillë zvogëlon të drejtat dhe detyrat e garantuar në Kapitullin II të Kushtetutës[549]. Në praktikën e Gjykatës, ky nen është interpretuar ashtu që ka nënkuptuar se jo vetëm Kapitulli II por edhe Kapitulli III, si dhe shpirti e germa e Kushtetutës, duhet të merren për bazë me rastin e kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese[550].

---

vendi nuk mund të votojë asnjë amendament që shpallet jokushtetues nga ana e Gjykatës. Kjo shprehimisht parashihet me nenet 113(9) dhe 144(3) të Kushtetutës së Kosovës.

Kontrolli preventiv si më sipër është i rrallë nëpër botë. Ekziston vetëm në disa vende, siç është Azerbajxhani, Kirgizia, Moldavia, Turqia, dhe Ukraina. Për një analizë komparative të kësaj çështje, shih më shumë në "Report on Constitutional Amendment", miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen e tij plenare (Venedik, 11-12 dhjetor 2009). Në rrjet: venice.coe.int, nën shenjën CDL-AD (2010) 001, Study No. 469/2008, Strasbourg, 19 January 2010. Për aspektet teorike të kontrollit preventiv të amendamenteve kushtetuese, shih më shumë në Kemal Gözler, *Judicial Review of Constitutional Amendments: A Comparative Study* (Ekin: Bursa, 2008) ; Gary Jeffrey Jacobsohn, "An unconstitutional constitution? A comparative perspective", në *International Journal of Constitutional Law* vol. 4, no. 3 (July 2006); Ahron Barak, "Unconstitutional Constitutional Amendments", në *Israel Law Review* vol. 44, no. 3 (2012); Sharon Weintal, "The Challenge of Reconciling Constitutional Eternity Clauses With Popular Sovereignty: Toward Three-Track Democracy in Israel as a Universal Holistic Constitutional System and Theory", në *Israel Law Review* vol. 44, no. 3 (2012); Lech Garlicki and Zofia A. Gralicka, "Review of Constitutionality of Constitutional Amendments (An Imperfect Response to Imperfections)", në *Jorurnal of Constitutional Law / Revue de droit constitutionnel* vol. I, issue 1 (Istanbul, 2012); Dr. sc. Jasna Omejec, "Kontrola ustavnosti ustavnih normi (ustavnih amandmana i ustavnih zakona)", *Godišnjak Akademije pravnih znanosti Hrvatske* vol. 1, no. 1 (Prosinac: Zagreb, 2010); Yaniv Roznai, "The Theory and Practice of 'Supra-Constitutional' Limits on Constitutional Amendments", *International and Comparative Law Quarterly* vol. 62, issue 03 (July 2013).

[548] Cf. Neni 113.3 (4) ["Juidiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës.

[549] Cf. Neni 113.9 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës.

[550] Deri më sot Gjykata ka vendosur për rastet e kontrollit preventiv të amendamenteve kushtetuese të kategorisë së dytë me të cilat interpretohet neni 113.9 i Kushtetutës në kuptim të një uniteti strukturor dhe organik. Cf. Aktgjykimi i 20 korrikut 2012 në rastin KO 29/12 dhe 48/12. Parashtrues: Presidenti i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Amendamentet e Propozuara Kushtetuese të paraqitura nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012; dhe Aktgjykimi i 31 tetorit 2012 në rastin KO 61/12. Parashtrues: President i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Konfirmimi i Amendamenteve të Propozua-

5.3.1.2. Mbrojtja sa i përket akteve të administratës

Deri me miratimin e Ligjit mbi Gjykatat, kontrolli kushtetues i akteve të administratës publike ka qenë nën juridiksionin e departamentit të veçantë administrativ në kuadër të Gjykatës Supreme të Kosovës. Kjo, në fakt, ka qenë një traditë e trashëguar nga koha e komunizmit[551]. Kjo situatë ndryshoi me miratimin e ligjit në fjalë mbi gjykatat pas pavarësimit të Kosovës. Ligji mbi Gjykatat i Kosovës sovrane dhe të pavarur në nenet 11.3 dhe 12.1.2 parashikon se për çështjet administrative do të formohet një Departament për Çështjet Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës, i cili do të përfshijë tërë territorin e vendit. Sipas neneve 18.1 dhe 22.1.1 të Ligjit, shkalla e dytë dhe e tretë në çështjet administrative mund të ndiqen nga palët që kanë interes juridik pranë Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme të Republikës[552].

5.3.1.3. Mbrojtja sa i përket akteve të juridiksioneve të tjera

Në sistemin kushtetues kosovar ekziston mundësia e kontrollit kushtetues të çdo akti të autoriteteve publike. Kjo parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, i cili nen flet për ankesën kushtetues të tipit të plotë, apo *Echte*, siç njihet nga gjermanët ku edhe e ka origjinën. Me këtë ankesë kushtetuese mund të ngiten të gjitha aspektet faktike dhe juridiko-kushtetuese të rastit me kusht që ato aspekte kanë të bëjnë me cenimin e të drejtave dhe lirive fundamentale të garantuara me Kushtetutë[553]. Ky mjet mund të përdor-

---

ra Kushtetuese të paraqitura nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më datën 22 qershor 2012 me letrën nr. 04-DO-1095.

Kjo qasje e Gjykatës është në vijë me teorinë dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, e cila e sheh Ligjin Themelor të Republikës Federale të Gjermanisë si një tërësi strukturore dhe organike të parimeve dhe vlerave ashtu që si i tillë duhet të shikohet në tërësinë e tij. Për komentet, shih më shumë në Donald P. Kommers, "German Constitutionalism: A Prolegomenon", në *Emory Law Journal* vol. 40, issue 1 (Summer, 1991); Donald P. Kommers, *The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany*, 2nd ed. (Duke UP: Durham, 1997) fq. 3-60.

[551] Ligji mbi Gjykatat e rregullta i Kosovës i vitit 1978 (*Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës* nr. 21/1978). Ky ligj është zbatuar në Kosovë deri më zëvendësimin e tij me Ligjin Nr. 03/L-199 mbi Gjykatat e Republikës së Kosovës të datës 22 korrik 2010.

Deri vonë, si aktet materiale ashtu edhe ato procedurale mbi administrimin e drejtësisë administrative kanë qenë të kohës së kaluar. Cf. Ligji Nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative të datës 22 korrik 2005 dhe Ligji mbi Konfliktet Administrative (*Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë* nr. 4/1977).

[552] Ligji Nr. 03/L-199 mbi Gjykatat i datës 22 korrik 2010.

[553] Cf. më shumë lidhur me këtë një studim të gjerë të kryer nga Komisioni i Venedikut, në Venice Commission: European Commission for Democracy Through Law, *Study on Indi-*

et në Gjykatën Kushtetuese me kusht që pala e cila ka interes juridik-kushtetues i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike efektive të cilat i njeh sistemi kosovar juridik-kushtetues. Kjo nënkupton se Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si një gjykatë e shkallës së katërt, pra duhet të presë deri të kryhen të gjitha procedurat juridike që janë në vijim pranë gjykatave të rregullta. Gjykata, duke vepruar sipas juridiksionit nga neni 113.7 i Kushtetutës, duhet të zbatojë praktikën gjyqësore të GjEDNj-së. Ky detyrim buron nga neni 53 i Kushtetutës. Në literaturë kjo është interpretuar si dispozitë që kompenson mungesën e anëtarësimit të Kosovës në Këshill të Evropës dhe, për pasojë, edhe në KEDNj.[554].

5.3.1.4. Mbrojtja sa i përket veprimet të personave privat

Në Kosovë nuk ka pasur një debat serioz lidhur me çështjen e efekteve horizontale të të drejtave dhe lirive fundamentale të individit. Pika e vetme e referimit për diskutim lidhur me këtë temë janë gjyqësori i rregullt dhe praktika e tij. Gjykatat e rregullta në Kosovë, sidoqoftë, asnjëherë nuk citojnë praktikën gjyqësore të GjEDNj-së apo praktikën gjyqësore të vendeve të tjera përkundër faktit që sipas nenit 53 të Kushtetutës edhe ato duhet ta bëjnë një gjë të tillë[555]. Referenca e vetme lidhur me efektin horizontal të të drejtave dhe lirive fundamentale të individit gjendet në nenin 21.3 të Kushtetutës, i cili flet për parimet e përgjithshme të Kapitullit II të Kushtetutës[556].

---

vidual Access to Constitutional Justice. Study No. 538/2009 (Strasbourg, 27 January 2011). Adopted by the Venice Commission at its 85th Plenary Session: Venice, 17-18 December 2010.

Kjo qasje është përkrahur edhe nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Cf. paragrafi 22 i Aktvendimit për Papranueshmëri i datës 21 mars 2011 në rastin Nr. KI 02/10. Parashtrues: Roland Bartetzko. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, AP-KZ 181/2002 i datës 12 nëntor 2010.

[554] Markus Bokenforde and Daniel Sabsay, "Supranational organizations and their impact on national constitutions", në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Routledge Handbook of Constitutional Law*. fq. 472-475, në veçanti fusnota 14 dhe teksti që shkon me të. Për tekstin e plotë të nenit 53 të Kushtetutës, shih fusnotën në vijim.

[555] Neni 53 ["Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut"] i Kushtetutës: "Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

[556] Neni 21.3 i Kapitullit II ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore"] i Kushtetutës: "3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve"

6. Kufizimet e të drejtave fundamentale

6.1. Autoriteti në ngarkesë të kufizimeve të të drejtave fundamentale

Kushtetuta e Republikës së Kosovë ia kushton një nen të veçantë, nenin 55, çështjes së kufizimit të të drejtave dhe lirive fundamentale të individit. Ky nen ka gjithsej pesë paragrafë.

Autoriteti në ngarkesë për të vënë në jetë një kufizim të tillë i takon legjislativit. Kjo në thelb nënkupton se autoritetet e tjera janë në ngarkesë të kufizimit në fjalë, por vetëm në bazë të një ligji ekzistues. Më tutje, kjo do të thotë se legjislacioni i deleguar nuk mund të shërbejë si bazë për kufizimin e të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut, gjë e cila është konfirmuar dhe nga Gjykata në rastin e njohur si "rasti i pasaportave"[557]. Në këtë rast, Gjykata theksoi se testi që zbatohet lidhur me çfarëdo kufizimi të lirisë së lëvizjes, konform nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNj-së, përkatësisht kufizimi i lirisë për të lëvizur nga vendi duhet të jetë ndërmarrë në pajtim me ligjin, të ndjekë një qëllim legjitim, dhe, së fundi, duhet të jetë i domosdoshëm në një shoqëri[558]. Në këtë rast, Gjykata gjeti se kufizimi i lirisë së lëvizjes nuk ishte i bazuar në ligj por në një memorandum mirëkuptimi të lidhur mes Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 18 gusht 2008. Ky memorandum i jepte mundësi Ministrisë së Brendshme për t'iu shmangur implementimit të Ligjit mbi Dokumentet e Udhëtimit, Ligji Nr. 2008/03-L037 i datës 15 qershor 2008, i cili në nenin e tij 27 theksonte se çdo refuzim i dhënies së pasaportës duhet të bëhet "mbi bazën e një vendimi gjyqësor", përkatësisht vetëm "nëse gjykata kërkon ndalimin e lëshimit të pasaportës". Me fjalë tjera, Ministria e Brendshme refuzoi dhënien e pasaportës aplikuesit jo duke u bazuar në ligje relevante penale apo në Ligjin për Dokumentet e Udhëtimit por në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit, dispozitat e të cilit venin kufizime në lirinë e lëvizjes pa një vendim individual të autoriteteve kompetente (gjykatave themelore). Memorandumi, përkundrazi, parashikonte një listë të gjerë të njerëzve të cilët nuk cilësohe-

---

[557] Aktgjykimi i datës 30 tetor 2010 në rastin KI 006/10. Parashtrues: Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë.

[558] Paragrafi 67 i Aktgjykimit. Cf. po ashtu paragrafët 68-74 të cilët flasin për atë se çdo kufizim duhet të bëhet përmes ligjit, përkatësisht "në pajtim me ligjin" (siç është formuluar me nenin 2.3 të Protokollit 4 të KEDNj-së).

shin si persona me të drejtë për pasur dokumente udhëtimi pa iu dhënë e drejta për mjet juridik efektiv për ta kontestuar një listë të tillë[559].

Ka disa parime të rëndësishme të sanksionuar me Kushtetutë kur bëhet fjalë për kufizimet e të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut. Kryesori në mesin e tyre është parimi që thotë se kufizimet nuk mund të mohojnë esencën e së drejtës së garantuar. Kjo është bërë e qartë në paragrafin e fundit të nenit 55 të Kushtetutës. Një parim tjetër me rëndësi është ai i proporcionalitetit i cili është i paraparë në paragrafin 4 të nenit të njëjtë, nen i cili është standard themelor në praktikën e GjEDNj-së.

Një aspekt tjetër me rëndësi sa i përket kufizimeve të të drejtave dhe lirive fundamentale të individit ka të bëjë me gjendjen e jashtëzakonshme. Kjo është shtjelluar në mënyrë të detajuar në Kushtetutën e Kosovës si në aspektin material ashtu dhe në aspektin e procedurës së kontrollit kushtetues të akteve të autoriteteve publike të cilat janë të involvuara në shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme. Paragrafi 1 i nenit 56 ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme"] të Kushtetutës shpalos bazat e aspekteve materiale dhe procedurale të gjendjes së jashtëzakonshme si dhe përjashtimet që mund të ndodhin gjatë gjendjes së tillë. Në këtë paragraf thuhet, *inter alia*, që derogimet mund të ndodhin vetëm nëse gjendja e jashtëzakonshme është shpallur sipas Kushtetutës dhe me kusht që derogimet e tilla janë të domosdoshme në rrethanat relevante. Aspekti material i gjendjes së jashtëzakonshme parashikohet me nenin 131 ["Gjendja e Jashtëzakonshme"], në ndërkohë që kontrolli i kushtetutshmërisë së zbatimit të këtij neni është i paraparë me paragrafin 3(3) të nenit 113 i cili rregullon juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe palët e autorizuara.

Paragrafi i parë i nenit 131 thekson se autoriteti kompetent për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme është Presidenti i Republikës dhe atë vetëm në rrethanat e kufizuara të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen, nëse ka një rrezik të brendshëm për rend e ligj, dhe, së fundi, në rastet e fatkeqësive natyrore. Duke ndjekur këtë rrugë, neni 131 në vijim më tutje shtjellon parimet mbi bazën e të cilave gjendja e jashtëzakonshme mund të shpallet. Në rend të parë rri parimi sipas të cilit Kushtetuta nuk mund të suspendohet gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Së dyti, kufizimet ndaj të drejtave dhe lirive fundamentale mund të ndodhin vetëm për aq sa është e domosdoshme dhe si një masë e fundit. Së treti është parimi që thotë se nuk mund të ketë ndryshime në ligjin mbi zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale gjatë kohës sa zgjat

[559] Cf. paragrafët 87-99 të Aktgjykimit.

gjendja e jashtëzakonshme. Së fundi është parimi që thotë se gjendja e jashtëzakonshme mund të shpallet vetëm nëse është e rregulluar me ligj, gjë që nënkupton se ajo nuk mund të futet në mënyrë arbitrare, por vetëm duke ndjekur dhe respektuar procedurat dhe kushtet specifike të paracaktuara më parë me anë të ligjit. Një gjë e tillë bëhet e qartë në paragrafin 2 të nenit 131 të Kushtetutës.

Në paragrafin 3(3) të nenit 113 të Kushtetutës është paraparë procedura e kontrollit kushtetues të dekretit të Presidentit të Republikës me të cilin shpallet gjendja e jashtëzakonshme. Kontrolli në fjalë konsiston në vërtetimin nëse një shpallje e tillë është në pajtim me Kushtetutën. Në kuadër të këtij kontrolli futen, gjykuar sipas këtij paragrafi, edhe veprimet e ndërmarra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

6.2. Parimi i proporcionalitetit dhe kufijtë e tjerë që kufizojnë të drejtat dhe liritë e individit

Përmbajtja e parimit të proporcionalitetit, një zbulim evropian që nuk njihet në vendet e tjera, si p.sh. në ShBA, elaborohet në paragrafin 4 të nenit 55 të Kushtetutës së Kosovës ku thuhet:

> 4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

Parimi i proporcionalitetit në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës zë një vend të rëndësishëm sepse paraqet një praktikë krejtësisht të re e cila u fut në sistemin kushtetues kosovar vetëm pas miratimit të Kushtetutës së vitit 2008[560].

---

[560] Për një shtjellim të shkëlqyer të testit të proporcionalitetit në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në dritën e precedentit të GjEDNj-së, shih më shumë në: Aktgjykimi i datës 20 korrik 2012 në rastin KO 29/12 dhe KO 48/12, Amendamentet e Propozuara Kushtetuese të Parashtruara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më datën 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012; dhe Aktgjykimi i datës 31 tetor 2012 në rastin 61/12. Konfirmimi i Amendamenteve të Propozuara të Parashtruara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më datën 22 qershor 2012 përmes letrës nr. 04-DO-1095.

7. Realizimi i të drejtave fundamentale

Në kuptimin praktik, realizimi i të drejtave të njeriut në Kosovë merr disa forma dhe modalitete të cilat, *grosso modo*, ndahen në mënyrat institucionale të realizimit të të drejtave dhe lirive fundamentale dhe në modalitetet e tjera që i takojnë vetë përmbajtjes së atyre të drejtave dhe lirive fundamentale. Në rastin e fundit bëhet fjalë për realizimin e të drejtave dhe lirive fundamentale *per force* konform dispozitave të Kushtetutës dhe ligjeve pozitive të cilat e definojnë përmbajtjen dhe caqet e realizimit të disa prej të drejtave dhe lirive fundamentale (p.sh., të a.q. "të drejtat negative", ruajtja e "esencës së të drejtës" etj., të cilat do të diskutohet më vonë).

7.1. Drejtësia kushtetuese

Siç u tha më sipër, drejtësia kushtetuese në Kosovë nuk është diçka e re sepse ka ekzistuar edhe më parë. Sa i përket mekanizmit institucional për realizimin e të drejtave dhe lirive fundamentale, gjendja është ndryshe.

Ish-Jugosllavia ka pasur një sistem të gjykatave kushtetuese që nga viti 1963. Me Kushtetutën e vitit 1963, në Jugosllavi u krijua Gjykata Kushtetuese Federale dhe gjykatat kushtetuese të republikave. Në ngarkesë të këtyre gjykatave kushtetuese ka qenë mbrojtja e "kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë" ashtu siç kuptohej nga doktrina komuniste e kohës. Premisat bazike të kësaj doktrine kanë qenë uniteti i pushtetit që ushtrohej nga ana e Partisë Komuniste Jugosllave si një avangardë e popullit punues, proletarëve, fshatarëve dhe i qytetarëve të vendit. Gjykata Kushtetuese e Jugosllavisë dhe gjykatat kushtetuese republikane kishin të njëjtën detyrë, përkatësisht mbrojtjen e vlerave të socializmit dhe komunizmit bazuar në paradigmën e unitetit të pushtetit. Asnjë fjalë për mbrojtjen institucionale të të drejtave dhe lirive fundamentale të garantuara me Kushtetutën e Jugosllavisë së vitit 1963 dhe me kushtetutat republikane të po atij viti. Ky realizim i kushtetutshmërisë në ish-Jugosllavi ka pasur për synim të bëhej jo sipas Kushtetutës por në pajtim më ligjin (i a.q. parimi i "ligjshmërisë socialiste").

Kosova fitoi një status të autonomisë gati të ngjashëm me atë të republikave federale jugosllave pasi ndodhën amendamentet kushtetuese të vitit 1971, të cilat morën epilogun e tyre përfundimtar në Kushtetutën e vitit 1974 të vendit. Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk ka qenë e ndryshme nga gjykata federale kushtetuese dhe gjykatat e ish-republikave jugosllave. Këto gjykata nuk kishin shërbyer si mekanizma institucionalë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive fundamentale. Kjo situatë

ka ndryshuar vetëm shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, njëjtë siç kishte ndodhur me ish-republikat jugosllave pas bërjes së tyre shtete sovrane dhe të pavarura gjatë viteve 1991-1992.

Gjyqësia kushtetuese kosovare u fokusua në të drejta dhe liri fundamentale vetëm pas miratimit të Kushtetutës së vitit 2008. Gjykata Kushtetuese, e krijuar në fillim të vitit 2009, punën më të madhe të saj ia ka kushtuar rasteve mbi të drejtat dhe liritë fundamentale, të cilat përbëjnë mbi 90 për qind të krejt punës së Gjykatës. Kjo gjendje është e pasojë vënies në jetë të nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parashikon procedurën e ankesës kushtetuese individuale të llojit të plotë, e cila mund të ushtrohet nga individët dhe personat juridikë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kur ato pohohet se janë cenuar përmes vendimeve individuale të autoriteteve publike kosovare. Kjo mund të bëhet, megjithatë, vetëm pasi palët e interesuara që pohojnë cenimin e të drejtave dhe lirive të tyre fundamentale t'i kenë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga sistemi juridiko-kushtetues kosovar.

7.2. Avokati i Popullit

Avokati i Popullit është po ashtu një fenomen i ri në sistemin juridik-kushtetues. Sidoqoftë, për dallim nga Gjykata Kushtetuese, ai ka ekzistuar para shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008. Menjëherë pas mbarimit të luftës në Kosovë në qershor 1999, bashkësia ndërkombëtare formoi institucionin e avokatit të popullit, i cili luajti një rol të rëndësishëm sepse ishte i vetmi institucion në kushtet e administrimit ndërkombëtar nga UNMIK-u që monitoronte zbatimin e të drejtave dhe lirive të individit. Si i tillë, ai u formua në bazë të Rezolutës 1244 të KS të OKB-së, dhe ka qenë në aspektin formal pjesë e strukturave institucionale të administratës ndërkombëtare nën udhëheqjen e UNMIK.[561]

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Kushtetuta në dispozitat e neneve 132-135 normoi vendin, funksionet, organizimin e brendshëm si dhe çështjet e tjera lidhur me avokatin e popullit[562]. Sipas nenit 132.1 ["Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit"] të Kushtetutës, Avokati i Popullit "mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike". Ai nuk mund të vepro-

[561] Cf. UNMIK/REG/2000/38 e datës 30 qershor 2000 mbi Themelimin e Institucionit të Avokatit të Popullit. Në rrjet: http://www.unmikonline.org/regulations /2000/reg38-00.htm.
[562] Çështjet të tjera janë rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-195 i datës 22 korrik 2010 mbi Avokatin e Popullit të Kosovës.

jë si zëvendësim i personave fizikë apo juridikë në rastet kur këta të fundit ushtrojnë ankesa individuale për mbrojtjen dhe realizmin e të drejtave të tyre. Roli dhe pozita e Avokatit të Popullit në Kosovë kufizohet në punën e tij pranë gjykatave të rregullta ku edhe mund t'i mbikëqyrë të gjitha procedurat dhe të ndërmarrë masa efektive kur bëhet fjalë për cenimin e të drejtave dhe lirive fundamentale në kuptimin e procedurës (p.sh., e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm).

Një rol mjaft i rëndësishëm është rezervuar për Avokatin e Popullit në fushën e kontrolli abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjeve, si preventiv ashtu dhe represiv, si dhe të akteve të tjera juridike të autoriteteve qendrore dhe të përputhshmërisë së statuteve komunale me Kushtetutën[563].

Ekzistojnë raste të kontrollit kushtetues të normës që janë iniciuar zyra e Avokatit të Popullit. Në dy raste, kjo zyrë ka qenë e suksesshme. Rasti që është shpallur i palejueshëm nga Gjykata Kushtetuese ka pasur të bëjë me mosrespektimin nga ana e Avokatit të Popullit të afatit kohor gjashtëmujor brenda të cilit duhet të paraqitet kërkesa[564]. Në rastin KO 119/10 të datës 8 dhjetor 2011, Gjykata ka dhënë aktgjykimin me të cilin deklaron se kërkesa e Avokatit të Popullit është e lejueshme dhe e bazuar; përkatësisht, deklaron se paragrafi 1.6 i nenit 14, neni 24, neni 25 dhe neni 27 i Ligjit mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Ligji Nr. 03/L 111 i datës 4 qershor 2010, nuk janë në pajtim më nenet 3.2 ["Barazia para Ligjit"], 7 ["Vlerat"] dhe 74 ["Ushtrimi i Funksionit"] të Kushtetutës së Kosovës[565]. Në mënyrë të njëjtë, Gjykata deklaroi si të lejueshëm dhe të bazuar kërkesën e Avokatit të Popullit në rastin KO 97/72, aktgjykimi i të cilit rast tha se nenet 90, 95.1.6, 110, 111

[563] Cf. neni 113.2 (pikat 1 dhe 2) ["Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës. Në një rast Gjykata Kushtetuese e ka bërë të qartë se Avokati i Popullit nuk mund të paraqesë ankesë kushtetuese as në emër të vet e as në emër të personave të tjerë apo personave juridikë. Cf. Aktvendimi për Papranueshmëri në rastin KI 98/10 i datës 4 prill 2012, që ka të bëjë me kërkesën e Avokatit të Popullit për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimeve 01 nr. 06/837 të datës 16 prill 2009, dhe Npi-01/132 të datës 30 prill 2009 të Kuvendit Komunal të Komunës së Shtimes.

[564] Cf. Aktvendimi për Papranueshmëri të datës 26 dhjetor 2012 në rastin Nr. KO 148/11. Parashtrues: Avokati i Popullit të Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 11, paragrafi 1, nenit 32, paragrafët 1 dhe 2, nenit 34, paragrafi 2 dhe neni 38 lidhur me nenet 11, 32 dhe 34 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 03/L-195 të datës 27 gusht 2010 dhe kërkesa për masë të përkohshme.

[565] Cf. Aktgjykimi i datës 8 dhjetor 2011 në rastin Nr. KO 119/10. Parashtrues: Avokati i Popullit të Kosovës. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafi 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit Nr. 03/L-111, të datës 4 qershor 2010.

dhe 116 të Ligjit mbi Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Jo Financiare, Ligji Nr. 04/L-093 i datës 12 prill 2012, nuk ishin në pajtim me nenet 10 ["Ekonomia"], 44 ["Liria e Asociimit"], dhe 46 ["Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Kosovës[566].

8. Përmbajtjet e ndryshme të konceptit mbi të drejtat fundamentale

Vetë natyra e disa të drejtave njerëzore, siç u tha më herët, ka një ndikim në mënyrën e realizimit të tyre në praktikë. Në përgjithësi, doktrina juridike prezumon se të drejtat natyrore, kryesisht ato civile dhe politike, nuk kërkojnë ndërhyrjen e autoritetit shtetëror për realizimin e tyre. Si të tilla, këto të drejta konsiderohen sikur nuk janë dhënë nga kushtetutat dhe tekstet e tjera juridike, por nga vetë fakti se iu takojnë qenieve njerëzore *qua* njerëz. Ndërsa kjo mund të jetë e vërtetë deri në njëfarë mase kur flitet për, ta zëmë, sistemin kushtetues të ShBA-së, në vendet e tjera të sistemit kontinental evropian, kjo nuk është kështu. Në shumicën e vendeve kontinentale, me ngritjen e shtetit administrativ gjatë shekullit të fundit, ekziston një nevojë dhe kërkesë çdoherë e më e shpeshtë e shtetit dhe e trupave të tjerë publikë për të ndërhyrë aktivisht në aspektet e caktuara të të drejtave dhe lirive fundamentale në mënyrë që t'u jepet një kuptim konkret realizimit të tyre të përditshëm. Nga kjo del se nëpër këto vende më nuk mjafton që shteti vetëm të garantojë në pikëpamje kushtetuese lirinë e shprehjes, ndërgjegjes dhe të drejtën për ushtrim të fesë, apo të drejtat e përfaqësimit, por më shumë se kaq: tani nga shteti dhe autoritetet kërkohet që aktivisht të angazhohen në realizimin praktik të këtyre të drejtave dhe lirive fundamentale të individit.

8.1. E drejta për mbrojtje dhe e drejta për përfaqësim

Ia vlen të përmenden dispozitat e Kushtetutës që flasin për aspektet materiale dhe procedurale të çështjeve penale. Si të tilla, këto dispozita kushtetuese të lëmisë penale janë më të shumtat dhe më të detajuarat[567]. Në mesin e

---

[566] Cf. Aktgjykimi i datës 12 prill 2013 në rastin KO 97/12. Parashtrues: Avokati i Popullit të Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 90, 95(1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit mbi Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Jobankare Financiare, Nr. 04/L-093, datë 12 prill 2012.

[567] Cf. Nenet: 29 ["E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë"], 30 ["Të Drejtat e të Akuzuarit"], 31[" E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm"], 33 ["Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale"] dhe 34 ["E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër"]

tyre janë ato që kanë të bëjnë me të drejtën e mbrojtjes, e cila, në esencë, në mënyrë besnike ka ripërsëritur dispozitat e natyrës së njëjtë të nenit 6.2 dhe 6.3 të KEDNj-së ["E Drejta për Gjykim të Drejtë"], dhe nenit 48 ["Prezumimi i Pafajësisë dhe e Drejta për Mbrojtje"] të Kartës mbi të Drejtat Fundamentale të Bashkimit Evropian. Shënojmë këtu se e drejta për gjykim të drejtë është shumë më e gjerë në praktikën e Gjykatës së Drejtësisë, siç vërehet nga rasti *Kadi*, krahasuar me praktikën e GjEDNj-së, siç vërehet nga rasti *Behrami & Saramati*. Në rastin e Kosovës, sidoqoftë, mesazhi i përmbajtur në dispozitat e sipërcekura të nenit 6 të KEDNj-së dhe të nenit 48 të Kartës mbi të Drejtat Fundamentale të Bashkimit Evropian është i shpërndarë nëpër pjesët e ndryshme të Kapitullit II ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore"] të Kushtetutës. Prezumimi i pafajësisë, ta zëmë, ashtu siç përmbahet në nenin 6.2 të KEDNj-së dhe në nenin 48.1 të Kartës mbi të Drejtat Fundamentale të Bashkimit Evropian përmblidhet në nenin 31.5 ["E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm"] të Kushtetutës. E njëjta vlen edhe për të drejtën e mbrojtjes në kuptimin e ngushtë të saj sepse përfshinë të gjitha situatat me apo pa aktakuzë (situatat e privimit të lirisë, ta zëmë). Situata e parë përfshihet në nenin 30, paragrafët 1-5 ["Të Drejtat e të Akuzuarit"] dhe neni 31.4 ["E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm"] të Kushtetutës, kurse situata e dytë gjendet e normuar me nenin 29, paragrafët 2 dhe 3 ["E Drejta e Lirisë dhe e Sigurisë] të Kushtetutës.

Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ka pasur disa ankesa kushtetuese që kanë bërë fjalë për paraburgimin dhe pas tij për fazën e ngritjes së aktakuzës. Në të gjitha këto raste, Gjykata nuk ka gjetur shkelje dhe i ka deklaruar rastet e tilla të palejueshme. Në lëminë e së drejtës për mbrojtje, rasti më interesant ka qenë rasti *Bajrush Xhemalji KI No. 78/12* [568]. Në këtë rast, Gjykata ka gjetur cenim të nenit 31 ["E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm"] të Kushtetutës dhe nenit 6 ["E Drejta për Gjykim të Drejtë"] të KEDNj-së. Cenimi ka konsistuar në atë se Gjykata Supreme dhe gjykatat e rregullta të cilat kanë gjykuar rastin nuk kanë siguruar të drejtën e ekspertizës së veçantë shtesë ("superekspertiza"). Duke bërë këtë, gjykatat e rregullta, përfshirë Gjykatën Supreme, kanë paragjykuar të drejtën për mbrojtje dhe drejtësinë e procedurave si tërësi, duke e privuar parashtruesin, Bajrush

të Kushtetutës (lidhur me nenet relevante të Kodit Penal të Kosovës Nr. 04/L-082 të datës 20 prill 2012 dhe Kodit të Procedurës Penale të Kosovës Nr. 04/L-123 të datës 13 dhjetor 2012).

[568] Aktgjykimi i 24 janarit 2013në rastin Nr. KI 78/12. Parashtrues: Bajrush Xhemajli. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. Nr. 70/2012, datë 22 korrik 2012.

Xhemajli, nga mundësia e ngritjes së argumenteve që shkojnë në favor të mbrojtjes së tij nën kushte të njëjta si organi i akuzës[569].

Sa i përket së drejtës për pjesëmarrje, Kushtetuta e Kosovës paraqet një risi krahasuar me kohët e tjera të mëhershme të zhvillimit të saj kushtetues. E drejta e pjesëmarrjes, *stricto sensu*, gjendet në nenin 45 ["Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes"]. Aspekti i parë, në këtë sens, ka të bëjë me të drejtën e pjesëmarrjes në procesin vendimmarrës të atyre që preken nga një vendimmarrje e tillë. Në këtë aspekt, është detyrë e institucioneve publike që të përkrahin pjesëmarrjen e secilit person në aktivitetet publike dhe të drejtën e secilit person që të ndikojë në mënyrë demokratike në vendimet e trupave politikë[570]. Aspekti i dytë i kësaj të drejte është më i ngushtë dhe ka të bëjë me të drejtën e secilit shtetas të moshës 18-vjeçare në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, përveç nëse kjo e drejtë i është kufizuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë[571]. Këto dy aspekte të së drejtës për pjesëmarrje nuk mund të kuptohen të ndara dy të drejta, përkatësisht dy liri të tjera të lidhura me këtë: liria e tubimit[572] dhe liria e asociimit[573].

Sa i përket realizimit efektiv të së drejtës për pjesëmarrje, vlen të theksohet se ajo varet nga qasja në informata të sakta dhe gjithëpërfshirëse lidhur me çështjet publike. Kjo varet më pastaj nga e drejta për të ditur, për qasje në informata dhe në lirinë e informimit[574].

Në shoqëritë në transicion, të cilat kanë kaluar një kohë të dhunës së gjatë, siç është rasti me Kosovën, e drejta e pjesëmarrjes mund të avancohet në kontekst të barazisë së përgjithshme dhe asaj grupore, diçka që duhet kuptuar si dhënie e mundësisë për pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë të individëve dhe grupeve në jetën publike. Kjo vlen edhe për grupet e tjera që mund të kenë trajtim të pabarabartë në shoqëri, siç janë personat me aftësi të kufizuar apo grupet e komunitetit "LGBT". Mbrojtja kushtetuese për të gjitha këto grupe gjendet në Kapitullin II dhe II të Kushtetutës së Kosovës.

---

[569] Paragrafët 68-106 ["Meritat"] e Aktgjykimit.
[570] Neni 45(3) ["Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes"] i Kushtetutës.
[571] Neni 45(1) ["Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes"] i Kushtetutës.
[572] Neni 43 ["Liria e Tubimit"] i Kushtetutës.
[573] Neni 44 ["Liria e Asociimit"] i Kushtetutës.
[574] Neni 40 ["Liria e Shprehjes"] dhe neni 41 ["E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike"] i Kushtetutës.

8.2. Mbi "të drejtat negative" (e drejta për të mos i takuar një religjioni ose e drejta për të marrë pjesë në një asociacion)

Shoqëritë njerëzore përgjatë historisë janë ndeshur me përcaktimin e rolit dhe pozitës së religjionit në shoqëri, marrëdhënien e tij me sferën publike dhe ndikimin në individin dhe autonominë e tij. Me qëllim të adresimit të këtij raporti, ne veçanti të rolit dhe rëndësisë së religjionit në sferën publike, tekstet kushtetuese të çdo vendi parashikojnë zgjidhje dhe qasje të nduarduarta. Këto, në kuptim të gjerë, mund të ndahen në zgjidhje e qasje që veçojnë një religjion të caktuar apo religjione, duke ua njohur një trajtim të veçantë, i cili mund të jetë preferencial apo paragjykues, dhe në zgjidhje e qasje që iu japin një trajtim të barabartë të gjitha religjioneve (nganjëherë edhe të gjitha besimeve dhe bindjeve)[575].

I asociuar me gjeneratën e parë të të drejtave, "e drejta negative" për mos t'i takuar asnjë religjioni është pjesë e lirisë së fesë në kuptimin e gjerë të fjalës. Gjatë kohës së komunizmit, liria e praktikimit të fesë në Kosovë nuk ka qenë e shtypur, sepse feja ka qenë e ndarë nga shteti dhe konsiderohej si një çështje tërësisht private. Jugosllavia komuniste, për dallim nga vendet e tjera, nuk ka ndaluar ushtrimin e fesë, duke iu njohur institucioneve fetare një autonomi që nuk ka qenë e njohur në vendet e tjera ish-komuniste në Evropë dhe më gjerë.

Aspektet e tjera të botës së brendshme njerëzore, megjithatë, nuk kanë qenë aq liberale sa janë sot. Liria individuale, sistemi i bindjeve dhe ndërgjegjes njerëzore nuk kanë pasur gjendjen që e kanë sot, të cilën ne e marrim si të mirëqenë. Individët dhe bota e tyre e brendshme në komunizëm kanë qenë të nënshtruara ndaj interesave të socializmit dhe universit komunist në përgjithësi. Autonomia individuale, me fjalë të tjera, nuk ka përfshirë krejt aspektet e botës së brendshme të individit të asaj kohe.

Në Kushtetutën e Kosovës ekzistojnë dy nene kryesore që kanë të bëjnë me këto "të drejta negative" që lidhen me religjionin. Neni 38 ["Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë"] ka katër paragrafë dhe, siç e bën të qartë vetë titulli, përfshin aspektet e aktivitetit njerëzor që lidhen me shpirtin dhe mendjen. Të gjitha këto diskutohen brenda këtyre paragrafëve të këtij neni.

---

[575] W. Cole Durham, Jr and Carolyn Evans, "Freedom of religion and religion–state relations", në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Routledge Handbook of Constitutional Law*, fq. 243-256; Jim Murdoch, *Protecting the right to freedom of though, conscience and religion under the European Convention on Human Rights* (Council of Europe: Strasbourg, 2012).

Në paragrafin e parë garantohet liria e besimit, ndërgjegjes dhe e fesë. Kjo liri mund të kufizohet, sipas paragrafit të fundit të këtij neni, vetëm me ligj dhe vetëm nëse paraqitet nevoja për ta mbrojtur sigurinë, rendin, shëndetin ose të drejtat e personave tjerë. Paragrafi i dytë i këtij neni thekson se liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë, *inter alia*, "ngërthen të drejtën për të pranuar dhe për të manifestuar fenë, të drejtën për të shfaqur bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar për të qenë anëtarë i një bashkësie ose grupi fetar". Në tërësinë e vet, neni 38, i cili reflekton në plotni aspektet kryesore të nenit 9 ["Liria e Mendimit, Ndërgjegjes dhe e Fesë"] të KEDNj-së, duhet parë në lidhje me parimet dhe vlerat e tjera kushtetuese. Njëra ndër to është edhe parimi i laicitetit.

Në Kosovë, sikundër në vendet e tjera ku ekziston ndarja e fesë nga shteti, ka një sanksionim të qartë kushtetues të parimit të laicitetit. Ky parim në thelb përfaqëson vlerat kyçe të sistemit kushtetues kosovar. Republika e Kosovës është një shtet laik dhe neutral në çështjet e bindjeve fetare, thotë neni 8 ["Shteti Laik"], nën kapitullin I ["Dispozitat e Përgjithshme"] të Kushtetutës. Kjo dispozitë nuk duhet parë ndaras nga neni 38, e në veçanti nuk duhet parë ndaras nga neni 39 ["Konfesionet Fetare"] i Kushtetutës. Në tre paragrafët e parë, ky nen iu garanton konfesioneve fetare një autonomi institucionale, fizike dhe tjetër. Konfesionet fetare rregullojnë në mënyrë të pavarur organizimin e tyre të brendshëm, aktivitetet fetare dhe ceremonitë, thuhet në paragrafin e dytë të këtij neni. Në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin, konfesionet fetare autorizohen që të krijojnë shkolla e fondacione bamirësie, konfirmohet në paragrafin e tretë të nenit në fjalë. Këto garanci kanë për qëllim që të forcojnë parimin e ndarjes së fesë nga shteti dhe ruajtjen e sferës publike nga ndikimi fetar. Si i tillë, ky nen është pjesë përbërëse e konceptit mbi Kosovën si shtet laik, siç parashikohet në nenin 8 të Kushtetutës. Kjo është në pajtim me praktikën e GjEDNj-së dhe praktikën e shumicës së vendeve evropiane, nisur nga fakti se gjëja më kontestuese në lëminë e religjionit ka të bëjë me manifestimin e tij në sferën publike, përfshirë në veçanti manifestimin e simboleve religjioze[576].

Në vija të përgjithshme, kjo që u tha më sipër ka qenë pjesë e praktikës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në një rast të vetëm dhe mjaft interesant — rastin KI 36 / 11 të datës 30 shtator 2011[577]. Në këtë rast, Gjykata deklaroi se

[576] Cf. më shumë lidhur me këtë në Malcolm D. Evans, *Manual on the wearing of religious symbols in public areas* (Council of Europe: Strasbourg, 2009).

[577] Aktvendim për Papranueshmëri në rastin KI 36/11. Parashtrues: Arjeta Halimi. Vlerësimi i kushtetutshmërisë të mospërmbarimit të pretenduar të Aktgjykimit CN. nr. 24/09, të 17

liria për manifestimin e simboleve fetare mund të kufizohet nëse një gjë e tillë është në interesin publik dhe ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve[578]. Përveç kësaj, në pajtim me praktikën e GjEDNj-së, Gjykata Kushtetuese ka deklaruar se veprimet e motivuara fetarisht nuk mbrohen nga liria e fesë në kuptim të nenit 38 të Kushtetutës[579]. Gjykata po ashtu deklaroi se parimi i laicitetit dhe neutralitetit në çështjet e fesë zbatohet pa asnjë dyshim kur bëhet fjalë për ushtrimin e lirisë së fesë dhe bartjes së simboleve fetare (shamisë) në vendet publike[580].

8.3. Të drejtat fundamentale si "garanci institucionale" (garanci siç janë ato lidhur me pronën private, qeverisjen lokale të komuniteteve, autonominë e universiteteve etj.)

Prona private dhe vetëqeverisja lokale rregullohen *expressis verbis* me nenin 12 ["Qeverisja Lokale"] lidhur me nenin 62 ["Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal"] dhe nenin 46 ["Mbrojtja e Pronës"], kurse neni 47 ["E Drejta për Arsimin"] në lidhje me nenin 48 ["Liria e Artit dhe e Shkencës"] shërbejnë si bazë për ruajtjen e autonomisë së universiteteve. Rastet që kanë të bëjnë me pronësinë përfshijnë gati 40 për qind të punës së Gjykatës Kushtetuese që nga themelimi i saj më 2009. Rastet që kanë të bëjnë me arsimimin janë më të rralla dhe kapin vetëm 0,4 për qind të krejt punës së Gjykatës.

Sa i përket qeverisjes lokale, Gjykata ka shqyrtuar vetëm një rast të tillë. Ky rast ka qenë kthesë në Kosovë sa i përket mbrojtjes së parimeve dhe vlerave kushtetuese që kanë të bëjnë me barazinë dhe mosdiskriminimin në përfaqësimin lokal të komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë. Rasti njihet si "Rasti Emblemës së Prizrenit"[581] dhe ka të bëjë me ruajtjen e barazisë së

---

nëntorit 2009, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan dhe shkeljes së pretenduar të të drejtave të njeriut të parashtruesit të kërkesës.

[578] Cf. Paragrafët 62 dhe 64 të Aktvendimit.

[579] Cf. Paragrafi 61 i Aktvendimit.

[580] Cf. Paragrafët 69-72 dhe 77 të Aktvendimit.

[581] Prizreni, qytet në jug të Kosovës, paraqet qytetin ku ka filluar aktiviteti politik dhe ushtarak i shqiptarëve kundër sundimit otoman, i cili më vonë ka kulmuar në një rezistencë të konsoliduar nacionale. Ky fakt është njohur dhe pranuar nga vetë Gjykata në paragrafin 43 të Aktgjykimit në të cilin, *inter alia*, është thënë që "Gjykat[a] është e vetëdijshme që shqiptarët identifikohen me '1878'-shin e shkruar në emblemën e Komunës së Prizrenit, ashtu siç thuhet me nenin 7 të Statutit të Komunës. Viti 1878 ka qenë viti i themelimit të Lidhjes së Prizrenit. Udhëheqësit shqiptarë u mblodhën në Prizren më 10 qershor të atij viti, duke kërkuar të arrijnë shtetin e pavarur shqiptar". Cf. Aktgjykimi i 18 marsit 2010 në rastin Nr. KO 01/09. Ćemailj Kurtiši vs Kuvendi Komunal i Prizerenit.

bashkësive pakicë dhe me mosdiskriminimin e tyre në nivel të qeverisjes lokale në çdo aspekt.[582] Çështja ka pasur të bëjë me emblemën e qytetit të Prizerenit, e cila nuk reflektonte përbërjen e ndryshme etnike të qytetit. Si e tillë, emblema reflektonte vetëm ndjenjat nacionale të shqiptarëve. Gjykata gjeti se neni 7 i Statutit të Komunës binte ndesh me vlerat dhe dispozitat kryesore kushtetuese që garantojnë barazinë dhe mosdiskriminimin, si dhe përfaqësimin e barabartë në organet e vetëqeverisjes lokale.

8.4. Të drejtat fundamentale si bazë e detyrimeve shtetërore (në rend të parë legjislativit) për të mbrojtur aktivisht (në mënyrë eficiente përmes legjislacionit) vlerat e garantuara me të drejtat fundamentale

Një nga detyrat e shtetit ka të bëjë me detyrimin për ligjvënie në një mënyrë që ruan dhe zgjeron më tutje vlerat dhe dispozitat kushtetuese që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë fundamentale. Në këtë drejtim, Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës kanë ndërmarrë një sërë iniciativash dhe masash legjislative sa i përket ruajtjes së të drejtave e lirive fundamentale nga Kapitulli II dhe të drejtave e lirive të komuniteteve nga kapitulli III i Kushtetutës.

Në nivelin qendror, në kuadër të Qeverisë së Kosovës, ekziston një zyrë e veçantë për qeverisje të mirë, e cila monitoron implementimin e standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë fundamentale. Në nivel të Kuvendit të Kosovës, po ashtu ekziston një kontroll i përhershëm i draft-legjislacionit për të shikuar nëse ai është në pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë fundamentale.

I një rëndësie të veçantë është paketa legjislative e cila është nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës dhe që ka të bëjë me të drejtat e komuniteteve kosovare dhe anëtarëve të tyre. Paketa në fjalë ka si pikë referimi jo vetëm Kushtetutën e Kosovës por edhe Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve të datës 1 shkurt 1995[583].

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese në këtë aspekt janë dy rastet që lidhen me dy ligje të cilat kanë qenë objekt kontrolli kushtetues sipas kërkesës së një grupi të deputetëve të Kuvendit me arsyetimin se këto ligje

---

[582] Cf. Paragrafët 12-13; 20-55 dhe pjesa operative nr. III e Aktgjykimit.

[583] Këto ligje janë si vijon: Ligji Nr. 03/L-047 i vitit 2008 mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre në Kosovë (13 mars 2008); Ligji Nr. 02/L-37 mbi Përdorimin e Gjuhëve (27 korrik 2007); Ligji Nr. 02/L-31 mbi Lirinë e Fesë në Kosovë (13 korrik 2006); dhe Ligji Nr. 02/L-88 mbi Trashëgiminë Kulturore në Kosovë (9 tetor 2006).

iu jepnin të drejta të mëdha të panevojshme dhe në mënyrë jokushtetuese anëtarëve të komuniteteve që jetojnë në *Komunën e Prizrenit* dhe në fshatin *Hoça e Madhe*. Në dy rastet Gjykata ka gjetur se aktiviteti legjislativ i Kuvendit ka pasur për qëllim promovimin e vlerave kushtetuese mbi barazinë dhe jodiskriminimin si dhe me vlerat e demokracisë kushtetuese ashtu siç garantohet me Kushtetutë[584].

8.5. Mbrojtja e të drejtave fundamentale përmes rregullave të procedurës së organizatave

Pas instalimit të administratës së UNMIK-ut në Kosovë u krijua një situatë e cila nuk ishte miqësore në kuptim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive fundamentale. Kjo ka qenë pasojë e faktit se administrimi i një territori nënkupton pak respekt për të drejtat dhe lirinë e individit. Me fjalë të tjera, administrata ka të bëjë me sendet, kurse qeverisja me individët. Kjo situatë pak a shumë ka zgjatur deri në pavarësimin e Kosovës më 17 shkurt 2008. Kjo situatë qe ligjësuar nga autoritetet e UNMIK-ut më datën 25 korrik 1999, kur u nxor Rregullorja Nr. 01 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë. Ky dokument theksonte që në paragrafin e vet të parë "se krejt autoriteti legjislativ dhe ekzekutiv në Kosovë, përfshirë gjyqësorin, ushtrohet nga UNMIK përmes Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm"[585].

Ka pasur një tentim nga ana e autoriteteve të UNMIK-ut për të zbutur këtë gjendje me rastin e krijimit të Panelit Këshillues për të Drejtat e Njeriut më 2006. Paneli shqyrtonte ankesat e shkeljeve të supozuara të të drejtave dhe lirive njerëzore që i atribuoheshin administratës së UNMIK-ut në Kosovë. Paneli më pastaj kishte të drejtë të bënte rekomandime për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së. Në fund doli se Paneli nuk kishte bërë ndonjë punë të mirë dhe të madhe në lëminë e mbrojtjes së të drejtave njerëzore dhe pati qenë shumë shpesh i kritikuar[586]. Përveç

---

[584] Aktgjykimi i 25 qershorit 2012në rastet KO 45/12 dhe KO 46/12. Kërkesa e Liburn Aliut dhe 11 Anëtarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Ligjit për Hoçën e Madhe dhe Ligjit mbi Qendrën Kulturore në Prizren. Cf. në veçanti paragrafët 47-69 të Aktgjykimit.

[585] Cf. UNMIK/REG/1999/1 të datës 25 korrik 1999 mbi Autoritetin e Administratës së përkohshme në Kosovë.

[586] Amnesty International, *Kosovo: Unmik's Legacy, The Failure to Deliver Justice and Reparation to the Relatives of the Abducted* (August 26, 2013). Një organ i ngjashëm ekziston në kuadër të Misionit EULEX, një trup i gjyqtarëve dhe prokurorëve evropianë të instaluar në

Panelit, në Kosovë kanë ekzistuar edhe disa trupa shtesë në kuadër të KFOR-it, krahut ushtarak të prezencës ndërkombëtare në Kosovë (i përberë nga ushtritë e vendeve të NATO-s). Kjo prezence ushtarake në Kosovë bazohet në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së së datës 10 qershor 1999. Këto trupa të KFOR-it janë krijuar me qëllim të zgjidhjes së ankesave individuale të qytetarëve të Kosovës që pohonin cenimin e të drejtave dhe lirive të tyre nga ana e trupave të KFOR-it. Efektiviteti i këtyre trupave të KFOR-it ka qenë i dobët dhe jo i ndonjë dobie të duhur, aq sa në disa raste qytetarët e Kosovës dërguan KFOR-in në GjEDNj në Strasburg, e cila krejt në mënyrë normale i shpalli si raste të papranueshme si pasojë e mungesës së juridiksionit *ratione personae* ndaj Kosovës dhe qytetarëve të saj [587].

Pasojat e kësaj situatë janë vërejtur gjithandej. Në rend të parë nuk ka pasur asnjë garanci procedurale ose tjetër për të drejtat e punëtorëve dhe të tjerëve që punonin nën ombrellën e UNMIK-ut, si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat. Më së hapuri kjo gjë është vërejtur në aspektin e procedurave disiplinore për realizmin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive njerëzore të të punësuarve. Punëdhënësi në këtë kohë kishte të drejtën e largimit të punëtorëve pa asnjë procedurë disiplinore apo pa ofruar asnjë garanci për sa i përket mbrojtjes së të drejtave e lirive individuale. Pas humbjes së autoritetit të UNMIK-ut, kur Kosova shpalli pavarësinë më 2008, gjykatat kosovare nuk kishin në fillim idenë si duhej t'i adresonin shkeljet e mëdha të të drejtave të punëtorëve në Kosovë. Ky hezitim dhe kjo kundërthënie i referohet Gjykatës Supreme të Kosovës si instanca e fundit për interpretimin uniform të ligjit në Kosovë. Gjykata Kushtetuese, ndërkaq, disa raste është prononcuar me vendimet e saj rreth kësaj çështjeje duke prishur vendimet e Gjykatës Supreme dhe duke kërkuar që ky institucion i lartë gjyqësor të përmirësonte gabimet e tilla dhe të ruante garancitë ekzistuese procedurale që ekzistojnë në të gjitha institucionet kosovare që nga shpallja e pavarësisë. Kjo pozitë e Gjykatës

---

Kosovë me fuqi ekzekutive për të monitoruar dhe mbikëqyrë gjendjen e sistemit të drejtësisë në Kosovë. Ky organ quhet "Human Rights Review Panel" dhe është formuar në vitin 2009 me mandat për të kontrolluar cenimet e pohuara të të drejtave të njeriut nga ana e Misionit EULEX gjatë ushtrimit të funksioneve të tij ekzekutive në Kosovë.

[587] Për një analizë juridike të shkurtër të rastit të Kosovës para GjEDNj-së, shih më shumë në Jasna Omejec, *Konvencija o Zaštitu Ljudskih Prava i Temeljnih Sloboda u Praksi Europskog Suda za Ljudska Prava: Strasbourški Acquis* (Novi Informator: Zagreb, 2013) fq. 660-662. Për një vendim të fundit lidhur me një aplikues nga Kosova dhe shtjellimin e mungesës së juridiksionit të GjEDNj-së ndaj territorit të Kosovës, shih në *Decision in the Case of Azemi v. Serbia* (Application No. 11209/09) (ECtHR: 2013).

Kushtetuese ka pasur për synim kryesor që të detyrojë Gjykatën Supreme që të kujdeset për interpretimin uniform të ligjit në tërë territorin e Kosovës[588].

8.6. Mbrojtja e ekzistencës së të drejtave fundamentale (garantimi i "përmbajtjes thelbësore" të të drejtave fundamentale) dhe kufijtë tjerë të kufizimit të të drejtave fundamentale

Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese nuk ka pasur akoma ndonjë rast që bën fjalë për garantimin e "përmbajtjes thelbësore" të një të drejte apo lirie fundametale. Në një rast të tillë do të diskutohej natyra dhe caqet e autorizimit kushtetues për të vënë disa kufij në ushtrimin e një të drejte apo lirie fundamentale. Koncepti i "përmbajtjes thelbësore", megjithatë, është mjaft mirë dhe gjerësisht i elaboruar në Kushtetutën e Kosovës.

Në nenin 55 të titulluar "Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore", në mënyrë të detajuar sqarohet esenca e doktrinë mbi "përmbajtjen thelbësore" të së drejtës njerëzore. Në fakt, vetë titulli i kësaj pjese të Kushtetutës flet për kufizimet që mund të vihen në ushtrimin e të drejtave dhe lirive fundamentale si dhe në mënyrën e realizimit të këtij kufizimi nga ana e ligjvënësit si dhe nga agjencitë e zbatimit të ligjit në Kosovë. Mesazhi i këtij neni konsiston në atë se, për të qenë kushtetuese kufizimet e të drejtave dhe lirive fundamentale, atëherë ato duhet të plotësojnë disa kritere kushtetuese. Në mesin e tyre, në rend të parë, është kushti që kufizimet duhet të jenë të caktuara me ligj[589] dhe, së dyti, kufizimet në fjalë duhet të ndjekin një qëllim që nuk bie ndesh me parimin e proporcionalitetit[590]. Esenca e parimit të proporcionalitetit është se të drejtat dhe liritë fundamentale mund të kufizohen për aq sa është e nevojshme me qëllim të arritjes së kufizimit në një shoqëri demokratike. Nga kjo del logjikisht, së treti, se kufizimet e tilla nuk mund të shërbejnë asnjë qëllim pos atij për të cilin janë vënë.

Dispozitat si më sipër lidhur me kufizimin e të drejtave dhe lirive fundamentale rregullojnë vetëm aspektet e përgjithshme dhe abstrakte të veprimit legjislativ të Kuvendit dhe kanë për qëllim që të shërbejnë si një udhërrëfyes për ligjvënësin kosovar në rastet kur vendosë për kufizimet e të drejtave dhe

---

[588] Aktgjykimi i datës 8 mars 2013 në rastin KI 120/10. Parashtrues: Zyma Berisha. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. 308/2007, datë 10 qershor 2010; dhe Aktgjykimi i datës 12 mars 2014 në rastin KI 89/13. Parashtrues: Arbresha Januzi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 74/2011, datë 12 mars 2013.

[589] Cf. Paragrafi 1 i nenit 55 ["Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore"] të Kushtetutës.

[590] Cf. Paragrafi 2 i nenit 55 ["Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore"] të Kushtetutës.

lirive fundamentale. Dy paragrafët që pasojë kanë për synim kodifikimin e parimet themelore që udhëheqin agjencitë administrative dhe gjyqësorin në punën e tyre. Në kuptimin gjuhësor, formulimi i këtyre dy paragrafëve bart mesazhin se këto agjenci dhe gjyqësori kanë për detyrim që të transformojnë këto kufizime të të drejtave dhe lirive fundamentale në kufizime në rastet konkrete jetësore në atë mënyrë që nuk bie ndesh me standardet kushtetuese të përcaktuara në tre paragrafët e parë të nenit 55. Me fjalë tjera, paragrafi i fundit ka për qëllim të udhëheqë agjencitë administrative dhe gjyqësorin përmes një procesi delikat të balancimit të vlerave dhe interesave kushtetues (të cilët nganjëherë bien ndesh me njëri-tjetrin) me qëllim të vetëm ruajtjen e esencës së të drejtave dhe lirive fundamentale të cilat kufizohen në jetën praktike[591]. Kjo bëhet në këtë mënyrë për shkak se, siç e thotë paragrafi i fundit i këtij neni, "kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar"[592].

9. Shteti social dhe transicioni

Një nga sfidat më të mëdha të të gjitha ish-vendeve komuniste të Evropës ka qenë si të ruhet dhe akomodohet sundimi i ligjit me cilësitë themelore të drejtësisë sociale në periudhën e transicionit. Kjo sfidë është shprehur në mënyrën më dramatike në rastet e pronësisë së marrë me dhunë nga pronarët nga ana e regjimit komunist dhe rastet e a.q. të ligjeve mbi lustrimin të cilat kishin për qëllim eliminimin nga jeta publike të ish-funksionarëve komunist dhe tjerëve që i kishin shërbyer atij sistemi[593]. Sfidat si këto, megjithatë, akoma nuk kanë trokitur në dyert e gjyqësisë kushtetuese kosovare. Së paku jo për këtë moment. Kjo në asnjë mënyrë nuk domethënë se në Kosovë nuk ka dispozita kushtetuese që flasin për drejtësinë sociale, njëjtë siç ka ndodhur në vendet e tjera ish-komuniste. Të tilla dispozita ka me bollëk në Planin Ahtisaari[594] dhe në Kushtetutën e Kosovës, siç ka edhe raste të vendosura nga

---

[591] Paragrafet 3 dhe 4 të nenit 55 ["Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore"] të Kushtetutës.

[592] Paragrafi 5 i nenit 55 ["Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore"] të Kushtetutës.

[593] Wojciech Sadurski, *Rights Before the Courts: A Study of Constitutional Courts in Post-communist States of Central and Eastern Europe* (Springer: Netherlands, 2008) fq. 223-262.

[594] Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës i datës 26 mars 2007. Propozimi është emërtuar sipas ish-presidentit të Finlandës Martti Ahtisaari, i cili ka draftuar këtë tekst të gjatë dhe të detajuar. Si i tillë, Propozimi ka synuar të shërbejë si bazë për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës nën patronatin e OKB-së dhe duke u shërbyer me Re-

vetë Gjykata Kushtetuese, ku reflektohet qartë zotimi i shoqërisë kosovare për të vënë në jetë parimet e drejtësisë sociale në transicion.

Dispozitat më të rëndësishme dhe më kontroverse të Planit Ahtisaari, të cilat nuk janë implementuar nga Kuvendi i Kosovës, kanë të bëjnë me restituimin e pronës. Në aneksin XII [2.13] të Planit Ahtisaari, i emërtuar si "Agjenda Legjislative", ekziston një ligj mbi restituimin e pronës, të cilin Kuvendi i Kosovës është dashur ta nxjerrë gjatë vitit të parë të pavarësisë së mbikëqyrur. Kjo nuk ka ndodhur asnjëherë deri më sot. Nuk ka pasur ndonjë presion ndaj Kosovës për të nxjerrë një ligj të tillë mbi restituimin e pronësisë. Së paku jo, për aq sa ka dijeni autori i këtyre rreshtave. Ka mundësi, megjithatë, që në kohën kur Kosova ofrohet në dyert e Bashkimit Evropian për t'u anëtarësuar, Evropa t'i bëjë presion për një gjë të tillë. Kështu ka ndodhur me të gjitha ish-vendet komuniste, të cilat kanë nxjerrë ligjet e tyre mbi restituimin e pronës. Kjo sërish dëshmon se ligji në shoqëritë në transicion, përfshirë Kosovën, i shërben qëllimeve krejt të tjera me ato që ligji iu shërben në demokracitë kushtetuese stabile.

Siç u cek më sipër, roli i ligjit në përgjithësi në Kosovë, përfshirë të drejtën kushtetuese, është i dyfishtë. Në të njëjtën kohë, ai është prodhim i një ndryshimi, dhe i shërben ndryshimit në situatat konkrete në transicion. Ky nuk është rasti në demokracitë stabile kushtetuese. Pjesë e këtij roli të dyfishtë është edhe drejtësia sociale, e cila si parim ka për qëllim që të shërbejë si korrektues i zbatimit të sundimit të ligjit në kuptimin e ngushtë të tij. Kjo nga shkaku se ekziston një tension konstant mes sundimit të ligjit dhe drejtësisë sociale. Kjo nuk vlen për demokracitë stabile, por vetëm për ato në transicion. Në shoqëritë stabile dispozitat mbi drejtësinë sociale janë pjesë e dispozitave kushtetuese që nuk mund të ndryshohen dhe përbëjnë pjesën kryesore të identitetit kushtetues respektiv[595]. Në raste si Kosova, ndërkaq, parimet

---

zolutën e KS të OKB 1244 të 10 qershorit 1999. KS i OKB nuk e ka miratuar për shkak të vetos ruse. Shumica shqiptare në Kosovë, megjithatë, e përdorën këtë dokument si bazë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008. Shtojcat e Propozimit janë përfshirë në tekstin e Kushtetutës së Kosovës, në veçanti sa i përket të drejtave dhe lirive të individit dhe të normave mbi demokracinë kushtetuese. Me përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur në shtator të vitit 2012, kanë pushuar së vlejturi në Kosovë në aspektin formal dispozitat e Propozimit.

[595] Këtu kemi të bëjmë më nenin 79.3 të Ligjit Themelor të Republikës Federative të Gjermanisë. Dispozita e nenit 79.3 ["amendamentimet e Ligjit Themelor"] thotë për si vijon: "3. Amendamentet në këtë Ligj Themelor që afektojnë ndarjen e Federatës në *Länder*, pjesëmarrjen e tyre në parim në procesin legjislativ ose në parimet e parapara në nenin 1 dhe 20 do të jenë të palejueshme". Përveç në Gjermani, dispozita të tilla ekzistojnë edhe në vendet

dhe dispozitat kushtetuese mbi shtetin social kanë për qëllim të shërbejnë si një balancues për imazhin publik të shtetit, jo për t'u marrë seriozisht në praktikë. Sikur të ishin marrë seriozisht në praktikë, atëherë shteti do të bankrotonte në dritën e papunësisë dhe të konfliktit social që ekziston në Kosovë. Kjo shpjegon rrethanën pse shteti social dhe drejtësia sociale përmenden vetëm në Preambulën e Kushtetutës së Kosovës dhe askund tjetër[596], kurse as vetë shteti nuk definohet me terma socialë[597]. Në të njëjtën mënyrë shpjegohet edhe rrethana që asnjë instrument, regjional apo ndërkombëtar, mbi të drejtat ekonomiko-sociale nuk përmendet në Kushtetutën e Kosovës[598]. Dispozitat e vetme kushtetuese që përmendin "shtetin social" gjenden në nenin 7 ["Vlerat"] të dispozitave të përgjithshme të Kushtetutës. Siç dihet botërisht, parimet dhe vlerat kushtetuese nuk mund të vihen në jetë dhe të zbatohen në mënyrë të ndarë nga dispozitat konkrete kushtetuese të cilat gjenden në pjesën operative. Kjo është reflektuar edhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Gjykata ka vënë në jetë premisat bazike të drejtësisë sociale vetëm në kontekstin kur ka qenë rasti i interpretimit të dispozitave konkrete të Kushtetutës që kanë të bëjnë me të drejta dhe liri fundamentale, kryesisht me rastin e interpretimit të të drejtave të pronës dhe së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm[599].

---

tjera në Evropë (Norvegji, Itali, Francë etj.), Afrikë (Afrika e Jugut, Maroku etj.) Azi (India etj.), Amerikë Latine (Çile etj.). Shih po ashtu më shumë në Enver Hasani, "Constitutional Protection of the Head of State: The Case of Kosovo", në *Vienna Journal on International Constitutional Law* vol. 7, no. 2 (2013) fq. 128-149.

[596] Cf. rreshtin i tretë i Preambulës "*Të zotuar që Kosova të jetë shtet i mirëqenies ekonomike dhe i prosperitetit social*".

[597] Neni 1 ["Përkufizimi i Shtetit"] i Kushtetutës: "1. Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm; 2. Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj; 3. Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti".

[598] Cf. Neni 22 ["Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare"] i Kushtetutës, i cili përsërit në thelb dispozitat e njëjta që kanë ekzistuar në Kornizën Kushtetuese.

[599] Rastet më të njohura që në mënyrë të tërthortë reflektojnë zotimin e shoqërisë së Kosovës dhe Gjykatës së saj Kushtetuese ndaj parimit të shtetit social, përkundër faktit që varfëria në vend është më e madhja në Evropë, janë ato që njihen si "rastet e KEK-ut", të vendosura gjatë viteve 2010-1013. Në këto raste, Gjykata Kushtetuese ka prishur me qindra aktgjykime të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe i ka rikthyer për rivendosje. Të gjitha këto raste kanë pasur të bëjnë me cenimin e të drejtave sociale të punëtorëve të dikurshëm të KEK-ut, përkatësisht të drejtave të tyre nga prona private. Një rast tjetër i rëndësishëm që ka të bëjë me

10. Natyra juridike e të drejtave fundamentale

Nga sa u tha më sipër, mjaft lehtë është të arrihet te përfundimi lidhur me natyrën e vërtetë juridike të të drejtave dhe lirive fundamentale të individit në rendin kushtetues kosovar. Kjo nuk do të thotë se ne kufizohemi vetëm në natyrën juridike të tyre. Në fakt, ky as që mund të jetë përfundimi në një shoqëri e cila pretendon të jetë shtet modern me demokraci kushtetuese. Në këtë aspekt, në rendin kushtetues të Kosovës të drejtat dhe liritë e individit mund të kuptohen në dy kuptime: ato konceptohen si të drejta natyrore të një karakteri subjektiv (të drejta natyrore subjektive) të cilat iu njihen qenieve njerëzore si të tilla dhe Kushtetuta ofron një mekanizëm për mbrojtjen e tyre legale;[600] dhe, së dyti, ato formojnë bazën e legjitimimit të rendit kushtetues dhe legal të vendit[601].

Në konceptimin e ngushtë kushtetues, disa nga të drejtat dhe liritë fundamentale definohen nga vetë teksti i Kushtetutës[602], kurse të tjerat definohen konceptualisht nga gjendja njerëzore dhe autonomia e tij (në parim këtu bëhet fjalë për të drejtat civile dhe politike)[603]. Në dy situatat, të drejtat dhe liritë fundamentale përmbajnë disa parime morale që nxisin sjelljet e caktuara njerëzore, ndërsa në të njëjtën kohë ato janë të mbrojtura nga sistemi juridik-kushtetues i Kosovës. Kjo qasje reflektohet përgjatë krejt dispozitave të Kushtetutës duke pasqyruar kështu në thelb qasjen liberale të një demokracie kushtetuese perëndimore.

---

aspektet sociale të gjendjes së ish-punëtorëve të punësuar në sektorin shoqëror është rasti i njohur si "rasti i Ferizajit". Cf. Aktgjykimi i datës 17 dhjetor 2010 në rastin Nr. KI 08/09. Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj, të përfaqësuar nga zt. Ali Azemi, kryetar i Sindikatës. Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, Vendimi C Nr. 340/2001, datë 11 janar 2002.

[600] Cf. për shembull, përveç dispozitave të kapitujve II dhe III, nenin 1 paragrafi 1 ["Përkufizimi i Shtetit"]; neni 3 ["Barazia para Ligjit"]; dhe neni 7 ["Vlerat"] të Kushtetutës.

[601] Cf. Paragrafi 1 i nenit 21 të Kapitullit II ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore: Parimet e Përgjithshme"] të Kushtetutës.

[602] Në parim, ky është rasti me të drejtat e gjeneratës së tretë dhe të katërt.

[603] Në parim, ky është rasti me të drejtat civile dhe të drejtat politike.

III. Aspekte komparative të identitetit kushtetues të Kosovës

Hyrje

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar më 9 prill 2008 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, lirisht mund të quhet Kushtetutë e tretë e Republikës së dytë të Kosovës. Kjo sepse Kosova për herë të parë në historinë e saj moderne ka nxjerrë një kushtetutë më 28 shkurt 1974, kur në kuadër të ish-Jugosllavisë fitoi disa të drejta që, për kohën, pa asnjë dyshim, kanë qenë progresive dhe kanë hapur një hapësirë për fillimin e një procesi iluminist ndër shqiptarët e Kosovës dhe të ish-Jugosllavisë në përgjithësi (meqë Kosova ishte pika gravituese e të gjitha viseve shqiptare nën ish-Jugosllavi). Kosova, për herë të parë, siç e ka thënë i ndjeri Iljaz Kurteshi, kryetar i Kuvendit të Kosovës, në ekspozenë e tij me rastin e miratimit të kësaj kushtetute më 27 shkurt 1974, aktin e vet më të lartë juridik po e sillte në formën e një kushtetute.[604] Sidoqoftë, të gjithë pajtohen se ai status dhe ajo kushtetutë (e vitit tanimë të largët 1974) kanë qenë të ngushta për aspiratat përfundimtare të shqiptarëve që jetonin nën pushtetin jugosllav.

Kur dekani i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, prof. Haxhi Gashi, më kërkoi që të jem një ndër panelistët e tryezës së debatit që do organizonte fakulteti më 9 prill 2016 për të shënuar 8-vjetorin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me kënaqësi pranova ftesën. Unë ftohesha në cilësinë e ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, si kryetar i parë i saj që nga themelimi. Jo vetëm kaq, por edhe sepse në kohën sa shërbeva si kryetar nismëtar i Gjykatës Kushtetuese (26 qershor 2009–26 qershor 2015), në dy mandate pa ndërprerë, botova me dhjetëra shkrime dhe libra, në vend dhe në botën e jashtme, në lëmin e të drejtës dhe të gjyqësisë kushtetuese, të cilat u cituan e citohen si në Kosovë ashtu dhe jashtë saj. Mbi të gjitha, vendimmarrja e guximshme dhe pafundësisht e hollë dhe profesionale e Gjykatës gjatë mandatit tim bëri që në Komision të Venecias me admirim të flasin dhe të debatojnë për finesat konkrete të kësaj vendimmarrje, e cila ngelet akoma për lakmi

[604] Teme Dana, *Ustav SR Srbije, Ustav SAP Kosova, Ustav SAP Vojvodine* (Beograd, aprila 1974) fq. 263.

ndër juristët evropianë dhe më gjerë. Këtë përshtypje ia kanë shprehur kolegët e Komisionit autorit të këtyre rreshtave, në të njëjtën kohë përfaqësues i Kosovës në Komision të Venecias që nga shtatori i viti 2014, si gjatë bisedave private ashtu edhe në diskutimet publike brenda në Komision.

Kur mora ftesën, dilemën kryesore e pata lidhur me temën për të cilën duhej të flisja. Mendova disa herë dhe vendosa: pse të mos flisja për identitetin kushtetues kosovar dhe për rolin e Gjykatës Kushtetuese, institucionit të cilin e kisha udhëhequr që nga dita e parë e punës së tij, në ravijëzimin dhe në etablimin përfundimtar të këtij identiteti kushtetues kosovar. Ashtu edhe veprova: vendosa të flisja për këtë çështje, e cila është thellësisht ekzistenciale për kosovarët sot dhe përbën kurrizin rreth të cilit përthyhen shtizat e diskursit politiko-kushtetues në Kosovë, duke filluar nga injorantët ordinerë e deri te ata që vërtet i kanë të qarta premisat themelore të konstitucionalizmit aktual kosovar që duhen ndjekur pa epur nëse duam që të jemi edhe ne sikur janë vendet e dy anëve të Atlantikut.

Meqë identiteti kushtetues i Kosovës paraqet një temë krejtësisht të re dhe të panjohur e të padiskutuar ndër akademikët e intelektualët, lëre më në diskursin publik kosovar, vendosa t'i qasem nga një këndvështrim sa komparativ aq edhe historik, në mënyrë që në kuadër të çdo seksioni ta paraqes vendin dhe rolin e Gjykatës Kushtetuese në ravijëzimin dhe në etablimin e këtij koncepti krejt të ri në Kosovë. Ndër ne është folur e flitet për identitete etnike, politike, nacionale, kulturore, ekonomike dhe kështu me radhë, por asnjëherë nuk ka pasur ndonjë diskutim për identitetin kushtetues të Kosovës dhe për rolin e aktorit shtetëror të quajtur Gjykatë Kushtetuese në ravijëzimin dhe në etablimin e këtij identiteti.

Këtë do provojmë ta bëjmë në këtë prezantim të sotëm dhe shpresojmë se, sikur çdo punë prej pionieri, edhe ky punim do të hapë debate dhe diskutime të tjera të kësaj natyre.

Në seksionin e parë, në fillim do të flasim e do të diskutojmë për definimin, për vendin dhe për rolin e identitetit kushtetues. Kjo përfshin diskutimin tonë për iluminizmin, si pikë kthyese që "lindi" identitetin kushtetues modern: nga iluminizmi u krijua ideja e tekstit kushtetues, si pikë themelore e dallimit ndërmjet njëjtësisë dhe të ndryshmes, pa marrë parasysh kontekstin social në të cilin ka operuar ky tekst kushtetues në kohën e lindjes së iluminizmit (1715-1789). Pas mbarimit të ciklit të iluminizmit, u themeluan një sërë praktikash e teorish kushtetuese, të cilat i paraprinë modeleve të ndryshme kushtetuese të bazuara kryesisht në tekstin kushtetues nacional. Këtu e kemi fjalën në veçanti për kristalizimet dhe për zhvillimet e këtyre modeleve

gjatë shekujve XIX dhe XX, siç janë modeli amerikan, francez, gjerman, postkolonial dhe kështu me radhë. Këto i diskutojmë në seksionin e dytë të këtij prezantimi. Modeli amerikan dhe ai francez, sado të vjetra, nuk kanë qenë të cilësuara si të tilla më herët, as në teori e as në praktikë, por vetëm pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, kur u bë ndarja polare e botës dhe kur u paraqit nevoja e gjetjes së modeleve kushtetuese adekuate dhe të sakta të zhvillimit të shoqërive njerëzore në dy anët e Atlantikut.

Identitetet kushtetuese nuk sajohen vetëm nga teksti kushtetues, por edhe nga vetë procesi i kushtetutëbërjes së tekstit nacional kushtetues, si në formë ashtu dhe në përmbajtje. Shoqëritë e ndryshme në të dy anët e Atlantikut kanë pasur përvoja të ndryshme dhe shumë interesante në këtë drejtim. Në disa raste, kanë qenë revolucionet e përmbysjet e thella sociale që kanë diktuar një identitet të caktuar kushtetues, në rastet e tjera kanë qenë ndryshime evolutive dhe krejt paqësore ato që kanë ravijëzuar e etabluar forma krejt të thella të identiteteve kushtetuese të cilat janë të krahasueshme me tjerat. Këto dhe problemet e tilla të identitetit kushtetues që krijohet gjatë kushtetutëbërjes diskutohen në seksionin e tretë të këtij prezantimi për t'i hapur rrugë prezantimit të pikëpamjeve tona në seksionin e fundit në vijim lidhur me identitetin më interesant kushtetues — identitetin që krijohet gjatë interpretimit nga ana e autoriteteve gjyqësore (gjykatave kushtetuese apo gjykatave të rregullta në vendet ku nuk ekzistojnë gjykatat kushtetuese të ndara nga gjyqësori i rregullt). Vetëm pasi të jenë elaboruar këto aspekte mund të kalojmë në pjesën përfundimtare të konkluzioneve rreth identitetit kushtetues dhe vendin e Kosovës, në këtë mes.

1. Definimi, vendi dhe roli i identitetit kushtetues në përgjithësi

Identiteti kushtetues, njësoj si ai nacional, ka të bëjë me komunitetet imagjinare ashtu siç i ka definuar Benedict Anderson, pra si një bashkësi ku përkatësia kolektive përcaktohet mbi bazën e disa cilësive imagjinare të secilit anëtar.[605] Si i tillë, identiteti kushtetues primar përcaktohet jo nga cilësitë fizike të komunitetit por nga veçoritë e tij dalluese në lëmin e qeverisjes dhe të sundimit të ligjit, të demokracisë dhe të respektit për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, si dhe nga veçoritë e tjera që lidhen me natyrën dhe me

[605] Cf. Benedict Anderson, *Imagined Communities: Reflections on the Origin and Spread of Nationalism* (Verso: New York, 2006), në veçanti kapitullin 3: "Origins of National Consciousness" (fq. 39-48).

rolin e shtetit në shoqëri si dhe marrëdhëniet e tij me individin. Thënë shkurt, identiteti kushtetues përcaktohet pikërisht ashtu siç e ka thënë Aristoteli, shekuj më parë, se "nuk janë përcaktues të identitetit cilësitë fizike të shtetit por forma dhe përmbajtja e sistemit qeverisës".[606] Nga kjo del se teksti kushtetues paraqet shenjën më të dukshme të identitetit kushtetues, i cili ankorohet në dispozita konkrete të këtij teksti, sikundër edhe në pjesën hyrëse (preambulë) të tij. Me tekst nënkuptohet edhe diskursi kushtetues që krijohet përgjatë shekujve në një vend ku nuk ka kushtetutë të shkruar, si p.sh. rasti i Britanisë së Madhe.

Identiteti kushtetues operon në një kontekst të dhënë material socio-kulturor dhe ekziston një marrëdhënie ndërmjet këtij konteksti dhe identitetit kushtetues, ndaras nga vetë teksti kushtetues. Sipas disa autorëve, ajo marrëdhënie është dialektike, në kuptimin që identiteti kushtetues i përcaktuar nga teksti kushtetues dhe nga përvoja e bazuar në të nuk bëjnë asgjë tjetër vetëm se reflektojnë strukturën e dhënë materiale socio-kulturore duke i dhënë rrugë dhe formë konkrete.[607] Kjo pikëpamje buron nga Hegeli[608] dhe Edmond Burke.[609] Sipas autorëve të tjerë, kjo marrëdhënie është dialoguese, në kuptimin që identiteti kushtetues i bazuar në tekst dhe përvoja fitojnë një identitet të ri konkret nëpërmjet jetësimit të tij në praktikë. Në rastin e fundit, kjo nënkupton se identiteti kushtetues nuk është i rrënjosur në strukturën materiale socio-kulturore të një shoqërie sepse teksti kushtetues dhe përvoja e bazuar në të ngërthejnë zotime dhe aspirata të cilat paraqesin manifestim të historisë së kaluar nacionale të një populli dhe janë shprehje e vendosmërisë së tij për të tejkaluar një të kaluar të tillë. Kjo pikëpamje, në literaturën moderne, fillon me Jurgen Habermasin.[610] Si autorët e parë, ashtu dhe të dytët, kanë shumëçka që pa asnjë dyshim mund të cilësohet si mendim i qëlluar i cili vlen për disa identitete kushtetuese. I pari, ta zëmë, do të ishte i qëlluar

---

[606] Aristotle, *The Politics*, Ernest Barker (ed. dhe përkth.) (Oxford UP: Oxford, 1962) fq. 98-99.

[607] Robert C. Post, "Foreword: Fashioning the Legal Constitution: Culture, Courts and Law", *Yale Law School Faculty Scholarship Series* Paper 179 (2003). Versioni elektronik gjendet në http://digitalcommons.law.yale.edu/fss_papers/179 (Shikuar së fundi më 12 korrik 2016).

[608] Friedrich G.W. Hegel, cituar sipas Andrew Arato, *Civil Society, Constitution and Legitimacy* (Rowman & Littlefield Publishers: Maryland, 2000) fq. 169.

[609] Edmond Burke, cituar sipas Gary J Jacobsohn, "Constitutional Identity", *The Review of Politics* vol. 68, no. 3 (Summer 2006) fq. 372.

[610] Jurgen Habermas, "Strugels for Recognition in the Democratic Constitutional State", në Charles Taylor, *Multiculturalism, Examining the Politics of Recognition* (Princeton UP: New Jersey, 1994) fq. 129-135.

kur flitet për identitetin kushtetues amerikan apo zviceran, kurse i dyti do të ishte shumë i qëlluar për identitetet kushtetuese të tipit francez, gjerman, austriak, të ish-vendeve komuniste të Evropës, përfshirë këtu Kosovën edhe më shumë se vendet e tjera të Lindjes komuniste,[611] pastaj Izraelin[612] etj., etj.

Roli i parë i identitetit kushtetues është definimi i vetvetes, definim ky imagjinar që mund të jetë i njëjtë me të tjerët dhe i ndryshëm. Quhet i njëjtë me tjerët ai identitet kushtetues i cili ka një botëkuptim të njëjtë sa i përket ndarjes së pushteteve, sundimit të ligjit, demokracinë, të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve, si dhe lidhur me çështjet e tjera fondamentale që kanë të bëjnë me pushtetin dhe me natyrën e tij, si dhe me rolin e individit në shoqëri. Në këtë kuptim, sot flitet për demokracitë kushtetuese të tipit perëndimor dhe për vendet e tjera që nuk i takojnë këtyre llojeve të demokracive kushtetuese. Në Evropë në veçanti, këto çështje fondamentale që përcaktojnë njëjtësinë e identitetit evropian vihen re në veçanti në proceset integruese evropiane, të cilat i synojnë të gjitha vendet. Ka shumë pak gjasa që integrimi evro-

---

[611] Kjo është qartë e shprehur jo vetëm në dispozitat konkrete kushtetuese por qysh në preambulën e Kushtetutës së Kosovës si dhe në vetë Deklaratën e Pavarësisë. Në dy këto tekste shprehet qartë synimi dhe zotimi i Kosovës për të ikur nga e kaluara e hidhur me qëllim të ndërtimit të një të ardhme krejt të veçantë krahasuar me historinë tragjike të vendit. Për më tepër, në Kushtetutën e Kosovës ka edhe dispozita konkrete që nuk lejojnë që të kontrabandohen amendamentet kushtetuese që do të shkonin kundër germës dhe frymës së Kushtetutës së Kosovës. Kosova, në këtë drejtim, bën pjesë në vendet e pakta që sanksionojnë të drejtën e Gjykatës Kushtetuese për të penguar miratimin e amendamenteve kushtetuese që shkojnë kundër identitetit të ri kushtetues kosovar. Cf. dispozitat e neneit 113.9 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] lidhur me nenin 144.3 [Amendamentimi] i Kushtetutës; Për shtjellime teorike komparative të kësaj problematike me pikë referimi rastin e Kosovës, Cf. Enver Hasani, "Constitutional Protection of the Head of State: The Case of Kosovo", botuar në *Vienna Journal on International Constitutional Law — ICL Journal* vol. 7, no. 2 (February 2013).

Për vendet e tjera të ish-Jugosllavisë, shih punimin e shkëlqyer të masterit të Vedrana Baričević, *Constitutional Identity in the Socialist Yugoslavia and the Successor States: Did the Break With the Past Really Occur?*, mbrojtur në Departamentin e Shkencave Politike të "Central European University", Budapest (2007). Autorja, në mënyrë interesante, shpjegon si janë krijuar gjatë ish-Jugosllavisë identitetet aktuale të ish-vendeve jugosllave duke u bazuar në analizën e nacionalizmave lokalë dhe në përgjigjen juridiko-kushtetuese që këta nacionalizma e kanë marrë gjatë kohës së ish-Jugosllavisë. Cf. kapitullin 2: "Ambiguities of Constitutional Identity in the Socialist Yugoslavia: Foundation for Ethno-Nationalist Politics in the Post Yugoslav States" (fq. 18-40).

[612] Për Izraelin, Cf. më shumë në Gary J. Jacobsohn, *Constitutional Identity* (Harvard UP: Harvard, 2010) fq. 150-168.

pian të shkojë kundër këtyre botëkuptimeve bazike të konstitucionalizmit evropian.[613]

Rrethanat, në të cilat operon teksti kushtetues, ndikojnë thellësisht në identitetin kushtetues. Zakonisht, marrëdhënia ndërmjet tekstit kushtetues dhe rrethanave në të cilat operon, është e dyllojshme: harmonike ose tensionuese. Është harmonike kur dallimi ndërmjet tekstit dhe kontekstit material sociokulturor nuk është i madh dhe kur arrin të integrohet në tekst, kurse tensionuese kur ka një drejtim të kundërt me këtë. Identiteti kushtetues tekstual i referohet situatës së fundit sepse, për nga vetë natyra e tyre, dispozitat kushtetuese janë të përgjithshme dhe shumë shpesh nuk reflektojnë cilësitë e tjera etnike, gjuhësore, fetare, rajonale, e kështu me radhë. Përveç kësaj, identiteti tekstual kushtetues mjaft shpesh definohet kundrejt dallimeve të tjera fetare, gjuhësore, kulturore, etnike, rajonale dhe të tjera, duke synuar që me kohë të bëjë shkrirjen e këtyre identiteteve në identitetin tekstual kushtetues.[614] Kosova është rast tipik i kësaj, pa harruar këtu rastin e Bosnjë-Hercegovinës.

Identititetet e para moderne kushtetuese u mbarësuan nga përgatitja mendore e shpirtërore e epokës së iluminizmit kurse morën formë konkrete në dy revolucionet e mëdha të fundshekullit XVIII. Ishin iluministët ata që shtjelluan deri në detaje çështjet e pushtetit dhe të legjitimitetit të tij, në rend të parë Jean-Jacques Rousseau dhe baroni Montesquieu, por edhe autorë të tjerë të shekullit XVII, si Thomas Hobbes e John Locke. Të gjithë këta autorë i dërrmuan konceptet e vjetra mbi pushtetin dhe mbi legjitimitetin politik e shtetëror, duke i mohuar pushtetit rrënjët hyjnore dhe duke vënë në spikamë rolin e arsyes dhe të individit si qenie e arsyeshme. Këto ide iluministe u materializuan në dy revolucionet e mëdha: në Revolucionin Amerikan (1776) dhe në Revolucionin Francez (1789). Në esencë, identiteti kushtetues, siç kuptohet në literaturën aktuale perëndimore, lidhet ngushtë me konstitucionalizmin, përkatësisht me faktin se të drejtat e njeriut dhe kufizimi i pushtetit janë elemente pa të cilat nuk ka asnjë kuptim diskutimi për identitetin kushtetues.[615] Këtu, dy aspekte të sundimit të ligjit, përkatësisht të konstitucionali-

---

[613] Pietro Faraguna, "A Living Constitutional Identity: The Contribution of Non-Judicial Actors", *Jean Monnet Working Paper* No. 10 (2015) fq. 31-32.

[614] Në literaturë, ky dallim shprehet si dallim ndërmjet identitetit të tekstit kushtetues dhe identitetit të popullit. Cf. Jose Luis Marti, "Two Different Ideas of Constitutional Identity: Identity of the Constitution v. Identity of the People", në Alejandro Saiz Arnais and Carina Alcoberro Llivina (eds.), *National Constitutional Identity and European Integration* (Intersentia: Cambridge, 2013) fq. 17-36.

[615] Andrew Arato, *Civil Society, Constitution and Legitimacy*, fq. 132

zmit modern perëndimor janë rezultat i këtyre dy revolucioneve perëndimore dhe i arsyetimit të bazuar në idetë iluministe.

Që nga kjo kohë, identiteti kushtetues ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërive perëndimore sepse në të shumtën e rasteve identiteti i përcaktuar nëpërmjet tekstit kushtetues ka qenë fare i ndryshëm nga identiteti social, kulturor, historik, etnik, gjuhës dhe tjetër. Thënë shkurt, ajo që ka përcaktuar teksti kushtetues ka qenë i ndryshëm nga struktura socio-politike, historike dhe kulturore e ambientit ku ka operuar një tekst i tillë. Ka qenë teksti kushtetues ai i cili në të shumtën e rasteve ka formësuar shoqëritë moderne perëndimore. Si rast i shpeshtë, në literaturë përmendet klauzola komerciale në Kushtetutën e ShBA-së, ku në fillim ishte paraparë e drejta e autoriteteve federale për të ndërhyrë butësisht vetëm në rregullimin e komunikimit ekonomik ndërmjet shteteve, për t'u bërë më vonë e njëjta klauzolë si bazë e pakontestueshme e të drejtës së autoriteteve federale për të rregulluar, ta zëmë, edhe qarkullimin e drithërave në nivel të krejt ShBA-së. Kjo klauzolë kushtetuese me kohë është shndërruar në levën kryesore mbi të cilën është mbështetur zhvillimi i hovshëm industrial i ShBA-së dhe transformimi i saje nga një shoqëri agrare në një shoqëri me industri jashtëzakonisht të zhvilluar.[616] Nga kjo shihet se forma e fillestare e identitetit kushtetues, e përcaktuar me rastin e krijimit të tekstit kushtetues amerikan, më vonë ka pësuar ndryshime me kalimin e kohës por, në të njëjtën kohë, duke mos u larguar shumë nga ideja fillestare.

Rrethanat në të cilat operon teksti kushtetues ndikon substancialisht në formësimin e identiteteve të tjera (si, p.sh., identiteti etnik, fetar, ideologjik etj.). Megjithatë, forma e identitetit kushtetues, e përcaktuar fillimisht, përcakton edhe përgjigjet në aspektet e tjera të organizimit të shtetit. Në rend të parë, lloji i shoqërisë së cilës i dedikohet teksti kushtetues duhet të reflektohet në tekst kushtetues (p.sh., shoqëri monoetnike apo shumetnike). Pas kësaj, e dyta, ky reflektim përcakton edhe dispozitat që duhet t'i përmbajë teksti kushtetues. Kjo sepse në disa raste ato dispozita janë abstrakte pikërisht për shkak se teksti nuk arrin në fillim t'i paraqesë guximshëm të gjitha diversitetet socio-kulture dhe materiale të shoqërisë. Ka raste, së fundi, kur, pikërisht si pasojë e këtij diversiteti, teksti kushtetues përmban dispozita që lejojnë një

---

[616] Vicki C. Jackson and Mark Tushnet, *Comparative Constitutional Law* (Foundation Press: New York, 2006) fq. 215-216; Për vendimet specifike që nga *Gibon v. Ogden*, 22 U.S. 1 (1824) deri në rastin *United States v. Morrison* 529 U.S. 598 (2000), shih më shumë në: *Historic Supreme Court Decisions: The Commerce Clause*, 2nd ed. (LandMark: Washington D.C., June 2012).

interpretim krejt konkret kontekstual në mënyrë që t'i përshtaten këtij diversiteti socio-kulturor e material të shoqërisë, siç është rasti me dispozitat e Kapitullit II të Kushtetutës së Kosovës mbi të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.[617]

Në të tri këto raste, identiteti kushtetues i ankoruar në dispozitat konkrete kushtetuese dhe në pjesën e saj hyrëse (preambula) ndikojnë në identitetin fillestar të një shoqërie të organizuar në shtet, më shumë se anasjelltas. Kjo vërehet lehtë nëse shikohet identiteti kushtetues socio-kulturor e material i shoqërisë amerikane para pavarësisë së saj më 1776, i asaj franceze para Revolucionit të vitit 1878, i shumicës së vendeve të Evropës së sotme, me përjashtim të Gjermanisë. Në rastin gjerman mund të thuhet se ka pasur një përputhje ndërmjet tekstit kushtetues gjerman të vitit 1848 me strukturën kulturore dhe materiale të shoqërisë gjermane të asaj kohe, përfshirë edhe unifikimin gjerman më 1870. Kjo nuk mund të thuhet për Kushtetutën e Vajmarit, e cila, shihet qartë, ka reflektuar një konstitucionalizëm krejt të kundërt me aspiratat e popullit gjerman të rrëzuara në Luftën e Parë Botërore. Ligji Themelor i Gjermanisë, i vitit 1949, iu ka rikthyer traditës gjermane të kohës së Vajmarit duke identifikuar shoqërinë gjermane me traditat me sublime evropiane të sanksionuara me Kushtetutën e Vajmarit që kanë të bëjnë me demokracinë kushtetuese.[618] Në rastin amerikan dhe francez, sistemi i vjetër ruan aty-këtu disa veti të vjetra: në rastin francez, ta zëmë, ruhet roli i kulturës dhe i gjuhës franceze ani se prishet rendi monarkik dhe proklamohet barazia e të gjithëve, kurse në rastin amerikan, po ashtu, prishet rendi i kaluar kolonial, proklamohet barazia e të gjithëve, e megjithatë ruhet skllavëria si institucion i vjetër për një kohë të gjatë. Nga kjo, si më sipër, shihet se nuk është e qëlluar pikëpamja që thotë se ka dy identitete kushtetuese që kanë si pikë referimi tekstin kushtetues: identiteti që bazohet në modelin amerikan, ku identiteti kushtetues paraprihet nga teksti kushtetues, dhe ai evropian, ku identiteti kushtetues nuk paraprihet nga teksti kushtetues sepse ai ekziston në momentin e miratimit të tekstit kushtetues.[619] Në kon-

---

[617] Një situatë e ngjashme stipulohet në nenin 6 [E Drejta për Identitet] të Kushtetutës së Rumanisë të vitit 1991, në fuqi aktualisht.

[618] Rasti gjerman dhe japonez në literaturë cilësohet si rasti i "ribërjes së demokracive", që nënkupton se në këto vende nuk pasur një traditë të gjatë demokratike në të kaluarën. Shih më shumë për këtë "Part II.: Constitutionalism in 'Remade' Democracies", te Daniel P. Franklin and Michael J. Baun (eds.), *Political Culture and Constitutionalism: A Comparative Approach* (M.E. Sharpe, Inc.: New York, 1995) fq. 77-116.

[619] Cf. Bernhard Schlink, "The Constitutional Subject and Its Identity", *Cardozo Law Review* vol. 33, no. 5 (2012) fq. 1869-1873.

tinentin evropian ka më shumë raste kur identitetit kushtetues aktual i ka paraprirë teksti kushtetues se anasjelltas, siç janë thuajse gati të gjitha vendet ish-komuniste të Evropës, por edhe të tjerat.

E përbashkëta me rastin amerikan dhe francez, megjithatë, konsiston në atë se, sikur te rasti gjerman pas Luftës së Dytë Botërore, ekziston një ndërprerje me të kaluarën, njësoj siç ka ndodhur edhe me rastin japonez dhe gjerman, me vendet e dala nga diktaturat nacionaliste në Evropën e Jugut (Spanja, Portugalia dhe Greqia). Në të gjitha këto raste, elitave të reja politike nëpër këto vende u është dashur të bëjnë prerje me të kaluarën për të ndërtuar një sistem juridiko-kushtetues i cili në të njëjtën kohë, me vetëdije, mohon të kaluarën por edhe rimerr diçka nga e kaluara dhe e fut në tekstin e ri kushtetues.[620] Vendet ish-komuniste në këtë aspekt dallojnë, përfshirë këtu edhe rastin e Kosovës, sepse vetëm aspekti i mohimit të gjendjes parakushtetuese luan rolin vendimtar duke mos rimarrë thuajse asnjë aspekt nga e kaluara me qëllim të futjes në tekstin e ri kushtetues.[621]

2. Llojet e identiteteve që bazohen në modelin e caktuar kushtetues dhe vendi i Kosovës në këtë aspekt

Në literaturë janë dhënë shtatë modele kushtetuese: modeli gjerman, modeli francez, modeli amerikan, modeli britanik, modeli spanjoll, modeli evropian, dhe, së fundi, modeli kolonial. Të gjitha këto modele bazohen në përvojat historike të disa kombeve apo të disa rajoneve marrë si tërësi.[622]

Modeli gjerman, ai francez dhe ai amerikan bazohen në raportin ndërmjet *etnosit* dhe *demosit* dhe në rolin e shtetit në këtë mes. Në rastin gjerman, shteti nuk ka asnjë rol në krijimin e kombit meqë ai, si i tillë, i dedikohet një kombi që veç ekziston dhe që ka një strukturë homogjene etnike, gjuhësore, kulturore, fetare dhe të ngjashme. Në aspektin filozofik, kjo situatë mund të cilësohet si qasje hegeliane. Në rastin e Francës është krejt e kundërta, sepse

---

[620] Akti i mohimit me vetëdije të së kaluarës, si vendimtar në procesin e kushtetutëbërjes shtjellohet shumë bukur nga Michael Rosenfled. Cf. më shumë për këtë në Vedrana Baričević, *Constitutional Identity in the Socialist Yugoslavia and the Successor States: Did the Break With the Past Really Occur?*, fusnotat 10-13 dhe teksti që i shoqëron; Gary J. Jacobsohn, *Constitutional Identity*, fq. 18 dhe fusnotën 69 në fq. 107.

[621] Cf. më shumë në Andrew Arato, *Civil Society, Constitution and Legitimacy*, fq. 171-172.

[622] Michel Rosenfeld, "Constitutional Identity", në Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford UP: Oxford, 2012) fq. 762-766.

etnosi gati bëhet i padukshëm shikuar në aspektin historik dhe bazohet në një lloj qeverisje të qytetarëve të barabartë sipas një kontrate sociale paraprake.[623] Në rastin e ShBA-së, situata është akoma më e ndryshme se në dy rastet e para sepse teksti kushtetues ka krijuar një komb të ri gjatë kalimit të kohës: në fillim nuk ka pasur një komb amerikan në kuptimin që sot e njohim, i cili u krijua dhe u formësua nga vetë teksti kushtetues dhe nga zbatimi i tij konstant në praktikë përgjatë shekujve ku Gjykata Supreme luajti një rol vendimtar nëpërmjet interpretimit të caktuar të këtij teksti.

Modeli britanik duhet të shikohet në sensin funksional. Ky vend nuk i ka të përmbledhura në një tekst të vetëm kushtetues të gjitha normat kushtetuese, e megjithatë ka një model kushtetues i cili bazohet në disa cilësi, siç janë qeverisja përfaqësuese, sundimi i ligjit dhe pragmatizmi i bazuar në sensin e përgjithshëm, të cilat e bëjnë të dallueshëm nga modelet e tjera kushtetuese.

Spanja ngelet si një shembull i asaj që do të vijë më vonë në krejt Evropën ish-komuniste: në këtë model, synim parësor është balancimi i unitetit nacional me autonominë dhe me diversitetin etnik, gjuhësor, fetar dhe tjetër, të pjesëve të caktuara të vendit. Kjo ka pasur për pasojë që Spanja, pas rënies së diktatorit Franko nga pushteti, t'i internalizojë normat evropiane mbi të drejtat e njeriut dhe demokracinë kushtetuese për të implementuar politikat multietnike në këtë vend, diçka që më vonë do ta bëjnë shumica e vendeve evropiane të cilat dolën nga komunizmi pas vitit 1990.

Ideali i një modeli evropian kushtetues ngelet ideal në letër, përderisa Evropa të mos arrijë të gjenerojë praktika dhe kultura kushtetuese unike për kontinentin. Rasti i reagimeve ndaj Traktatit të Lisbonës, në Gjermani dhe gjetiu, tregon më së miri për dilemat dhe për vështirësitë me të cilat ballafaqohet modeli kushtetues evropian dhe perspektiva e tij dubioze. Sidoqoftë, ajo që quhet "tradita e përbashkët kushtetuese" dhe praktika e gjykatave kushtetuese të disa prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian ngelen si një pikë referimi në modelimin e këtij ideali kushtetues në kontinentin e vjetër.[624] Askund më shumë se në rastin e Evropës, marrë si tërësi, nuk vërehet pamundësia e realizmit të një identiteti homogjen kushtetues në nivel evropian.

Modeli i fundit është modeli kolonial. Në kuptimin literal, kjo do të përfshinte të gjitha ish-kolonitë. Kjo, megjithatë, nuk është kështu sepse në këtë

---

[623] Michel Rosenfeld, *The Identity of the Constitutional Subject: Selfhood, Citizenship, Culture, and Community* (Routledge: London, 2010) fq. 152-158, 211-212, 216-217, 230.
[624] Cf. më shumë për këtë në Leonard F.M. Besselink, "National and Constitutional Identity Before and After Lisbon", *Utrecht Law Review* vol. 6, issue 3 (November 2010).

model nuk mund të futet ShBA-ja, Australia, Meksika dhe disa vende të tjera ish-koloniale. Në këtë model hyjnë kryesisht vendet e dekolonizuara pas Luftës së Dytë Botërore në Afrikë dhe në Azi, pra vendet që u çliruan nga procesi i dekolonizimit që formalisht sikur filloi me Konferencën e Bandungut, më 1955, kur u përligj në planin ndërkombëtar procesi i çlirimit të popujve dhe i vendeve koloniale. Në këtë model, identiteti kushtetues kryesisht fokusohet në një tekst kushtetues të modeluar sipas përvojës së ish-metropoleve, por që në të njëjtën kohë provon ta kundërshtojë modelin metropolitan dhe të ndahet nga ai model. Ky proces dialektik i identifikimit të vendeve dhe të popujve ish-kolonialë e bën të veçantë identitetin kushtetues të këtyre vendeve sepse ka një cilësi e cila është e përbashkët për të gjitha këto vende: miratimi i kushtetutave sipas modelit të metropolit, pra përqafim formal dhe nominal i modelit të konstitucionalizmit perëndimor ndërkohë që akoma vazhdohet me kultivimin e traditave lokale konservative të qeverisjes jashtë standardeve të demokracisë kushtetuese. Në rastin e ish-kolonive më së miri ravijëzohet tensioni i pafund ndërmjet identiteteve parakushtetuese dhe ekstrakushtetuese tradicionale të këtyre vendeve dhe të identiteteve kushtetuese që ankorohen në tekstin kushtetues.[625] Thënë shkurt, dilemat e këtyre vendeve edhe sot vazhdojnë akoma për sa i përket një ndër çështjeve kyç lidhur me identitetin kushtetues, siç e ka thënë Michel Rosenfeld, pra si të largohet dhe si të afrohet teksti i ri kushtetues nga identiteti paralel mbi të cilin qëndron në të njëjtën kohë dhe nga i cili varet për t'u bërë identitet kushtetues i ri dhe operativ në shërbim të nevojave aktuale në një kohë dhe hapësirë të caktuar.[626]

Kopjimi dhe kundërshtimi i njëkohshëm i përvojave koloniale të ish-metropolit ka qenë dhe ngelet cilësia themelore e këtyre vendeve edhe në sferat tjera, si në art, në letërsi, në kulturë dhe në aspektet e tjera që lidhen më zhvillimin ekonomik nisur nga fakti i prapambeturisë së këtyre vendeve.[627]

---

[625] Shih më shumë në Daniel P. Franklin and Michael J. Baun (eds.), *Political Culture and Constitutionalism: A Comparative Approach*, fq. 159-160.

[626] Michel Rosenfeld, *The Identity of the Constitutional Subject: Selfhood, Citizenship, Culture, and Community*, fq. 10; Për një analizë akademike të shkëlqyer të kësaj problematike, thuajse universale në praktikën e formimit të identiteteve kushtetuese, shih më shumë në Seyla Benhabib, "On Michel Roselnfeld's The Identity of the Constitutional Subject", *Cardozo Law Review* vol. 33, no. 5 (June 2012).

[627] Për fushën e letërsisë dhe në përgjithësi të kulturës, shih më shumë në Fransoa Šobe, Loren Marten, *Međunarodni Kulturni Odnosi* (CLIO: Beograd 2014), në veçanti kapitulli 6 "Kolonijalne i imperijalne kulture" (fq. 213-244); Për aspektet e tjera të kulturës, shih më shumë

Kosova, bazuar në dispozitat kryesore kushtetuese mbi ndarjen e pushtetit, definimin e shtetit, rolin e individit kundrejt pushtetit dhe kundrejt njëritjetrit, të drejtat e minoriteteve dhe grupeve të tjera vullnerabël, bie në mesin e modeleve kushtetuese spanjolle për sa i takon rolit dhe pozitës së komuniteteve joshumicë,[628] kurse sa i takon çështjeve të tjera për ndarjen e pushtetit dhe për rolin dhe pozitën e Gjykatës Kushtetuese në sistemin kushtetues, Kosova i takon modelit gjerman, sepse ekziston një ankesë e fuqishme kushtetuese e cila gjatë periudhës 6-vjeçare i ka vënë standardet kryesore lidhur me të drejtën për jetë, për pronë, si dhe lidhur me të drejtat e tjera kushtetuese që nuk kanë qenë të njohura më herët në shoqërinë kosovare të traumatizuar nga lufta dhe nga konflikti violent disavjeçar. Edhe në sistemin spanjoll ka një ankesë kushtetuese, por që edhe ajo modelohet sipas modelit gjerman.

Që nga shkurti i vitit 2009 e deri në tetor të vitit 2014, Gjykata ka pranuar 892 (tetëqind e nëntëdhjetedy) kërkesa. Prej tyre, janë zgjidhur 839 (tetëqind e tridhjetenëntë) kërkesa, ndërsa të tjerat janë në proces të vendosjes. Në përgjithësi, pothuajse 90 (nëntëdhjetë) për qind e kërkesave janë shpallur të papranueshme.[629] Gjykata ka nxjerrë aktgjykime vetëm në 10 (dhjetë) për qind të rasteve. Një gjendje e tillë është e ngjashme me vendet e tjera që kanë procedura të ankesës së plotë kushtetuese. Kjo është kështu për faktin se shumica dërrmuese e kërkesave, rreth 90 (nëntëdhjetë) për qind e tyre, kanë të bëjnë me ankesa individuale nga qytetarët dhe nga personat e tjerë juridikë.[630] Kjo sikur bie ndesh me konceptin themelor të Hans Kelsenit mbi rolin

---

në recensionin e shkëlqyer të Sa Smythe, "Postcolonialism and the Cultural Industry: Complicity and Resistance", *Postcolonial Studies* vol. 18, no. 4 (2015) fq. 453-455. Recensioni i referohet librit të Sandra Ponzanesi, *The Postcolonial Cultural Industry: Icons, Markets, Mythologies* (Houndsmill: Plagrave Macmillan, 2014).

[628] Cf. dispozitat e Kapitullit 3 [Komunitetet Vetëqeverisëse] të pjesës VIII [Organizimi Territorial i Shtetit] të Kushtetutës së Mbretërisë së Spanjës të vitit 1978 me dispozitat e Kapitullit III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës së Kosovës. Në literaturë, rasti spanjoll, kur bëhet fjalë për Kataloninë, si dhe ai kanadez, kur bëhet fjalë për Kuebekun, cilësohen si modele integruese. Kjo për faktin se teksti kushtetues në modelin integrues synon kohezionin nacional në një kohë kur ka fragmentime dhe konflikte serioze ndërmjet subjekteve kushtetuese. Cf. Wen-Chen Chang, "East Asian Foundations for Constitutionalism: Three Models Reconstructed", *National Taiwan University Law Review* vol. 3, no. 2 (2009) fq. 131-133.

[629] Ky numër mund të jetë dyfishuar në momentin e shkrimit të këtij teksti (korrik 2016), por proporcioni i rasteve për nga natyra, siç diskutohet këtu, nuk ndryshon substancialisht.

[630] Për këtë gjendje të gjërave, në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Cf. më shumë në hulumtimin e detajuar të ndërmarrë nga një studiues i ri, Jean-Marc Lacourcière, *Report on the Jurisprudence of the Constitutional Court of Kosovo on Human and Minority Rights* (Kosovo Law Center: Prishtinë, 2011). Për gjendjen në vendet e tjera ish-komuniste, cf. Wojciech

dhe pozitën e gjyqësisë kushtetuese, ku kontrolli abstrakt i normave juridike duhet të jetë i vetmi juridiksion i gjykatave kushtetuese. Kontrolli abstrakt akoma mbetet kryefjala e cila e identifikon gjyqësinë kushtetuese me llojet e tjera të gjyqësisë, por nuk është i vetmi juridiksion i saj. Kjo është kështu sepse ankesat individuale aktualisht përbëjnë ngarkesën dërrmuese të punës së gjykatave kushtetuese. Megjithatë, ne, siç e ka thënë një autor, sado që jemi shumë mirënjohës ndaj Hans Kelsenit, nuk jemi skllevër të mendimit të tij,[631] sepse kontrolli abstrakt i normave juridike në të gjitha kushtetutat nacionale akoma përbën definuesin e gjyqësisë kushtetuese, përkatësisht përcaktuesin e rolit dhe të funksionit të saj primar. Fakti se ankesat individuale përbëjnë ngarkesën primare të punës së gjykatave kushtetuese nuk ndryshon asgjë në këtë që thamë më sipër. Kjo praktikë tekstuale ka filluar, siç dihet, me lindjen e Kartës së të drejtave të njeriut, si kategori kushtetuese, në Kushtetutën e Vajmarit. Më vonë, pas Luftës së Dytë Botërore, futja e kësaj praktike tekstuale u bë normale në vendet perëndimore të Evropës, duke e bërë të domosdoshme nevojën e krijimit të një mekanizimi institucional për vënien në jetë të këtyre teksteve kushtetuese të cilat ngërthenin kartat mbi të drejtat e njeriut. Thënë shkurt, pas Luftës së Dytë Botërore, kushtetutat nacionale në mënyrë graduale kanë futur në dispozitat e tyre normat mbi të drejtat e njeriut si dhe mekanizmat përkatës institucionalë dhe instrumentet juridike, siç është ankesa kushtetuese, të cilat qytetarët mund t'i përdorin për realizimin e të drejtave e lirive të tyre të garantuara me tekstet kushtetuese.

3. Llojet e identiteteve që lindin gjatë kushtetutëbërjes dhe vendi i Kosovës në këtë mes

Ky lloj identiteti, pra identiteti kushtetues që bazohet në kushtetutëbërjen, përkatësisht në mënyrë si është krijuar (apo si ka lindur) teksti kushtetues përbën identitetin më interesant. Ky lloj identiteti lë gjurmë më afatgjate dhe përbën në fakt vetë emblemën e identitetit kushtetues përgjatë kohërave të gjata, ani se më kohë edhe ky identitet ndryshon. Esenca e këtij lloj identiteti

---

Sadurski, "Constitutional Justice, East and West: An Introduction", në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective*, fq. 1-18; John Ferejohn and Pasquale Pasquino, "Constitutional Courts as Deliberative Institutions: Towards an Institutional Theory of Constitutional Justice", në Sadurski (ed.), vep. cit., fq. 21-36.

[631] Allan R. Brewer-Carias, *Constitutional Courts as Positive Legislators: A Comparative Law Study* (Cambridge UP: Cambridge, 2011) fq. 31, fusnota nr. 74.

është se me gjithë kalimin e kohës së gjatë, mbase edhe pas shekujve, sërish në memorien kolektive qëndron ky lloj identiteti si një lloj hije që ndjek kolektivisht të gjithë anëtarët e shoqërisë së organizuar në shtet. Identiteti kushtetues, që bazohet në kushtetutëbërjen, thelbësisht e kornizon formimin dhe evoluimin e identitetit kushtetues përkatës.[632] Në literaturë, në këtë kuptim, bëhet dallimi ndërmjet kushtetutës, si një "konstitucionalizëm i vjetër", pra kur teksti kushtetues përmban dispozitat themelore mbi krijimin e kombit dhe mbajtjen e tij së bashku, dhe të kushtetutës si një "konstitucionalizëm i ri", pra kur teksti kushtetues përmban dispozitat e reja që normojnë marrëdhëniet e tregut kapitalist, respektimin e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe të ngjashme.[633] Këto dallime vlejnë edhe për Kosovën, sepse Kushtetuta e Kosovës aktualisht paraqet mishërim të një "konstitucionalizmi të ri" meqë përmban dispozita krejt të reja lidhur me demokracinë kushtetuese, të drejtat e njeriut dhe të drejtat e komuniteteve, marrëdhëniet kapitaliste të tregut të lirë dhe të hapur dhe kështu me radhë. Teksti kushtetues kosovar ka një qëndrim agresiv ndaj strukturave sociale të mishëruara në shoqëri, ngjashëm siç është rasti me kushtetutat e vendeve si Afrika e Jugut, India dhe Turqia.[634]

Ka disa lloje të këtij identiteti kushtetues. Në literaturë, klasifikimi më i zakonshëm është ai që bazohet në përvojën e shoqërive në të dy anët e Atlantikut dhe atë për sa vijon: identiteti i bazuar në revolucion; identiteti i bazuar në modelin britanik të padukshmërisë; identiteti i bazuar në luftë; identiteti i krijuar përmes një pakti paqësor; identiteti transnacional; dhe identiteti i bazuar në faktorët ndërkombëtarë.[635]

Identiteti i bazuar në revolucion paraqet atë lloj të identitetit në të cilin kushtetuta e re bëhet bazuar në rezultatet e prodhuara nga përmbysja revolutive. Nga thellësia e përmbysjes varet edhe natyra dhe përmbajtja e kushtetutës së re. Në rastet kur përmbysja është aq e thellë sa që nuk lejon mundësi për përfshirjen e strukturave dhe të elementeve të vjetra ekstrakushtetuese dhe kushtetuese, atëherë ndërprerja me të kaluarën është aq radikale sa nuk

---

[632] Michel Rosenfeld, "Constitutional Identity", fq. 766.

[633] Shih më shumë për këtë dallim, në kontesktin e diksutimit të kushtetutëberjes në Afrikën e Jugut, shikuar nga aspekti komparativ, në Peter Fitzpatrick, "'The New Constitutionalism': The Global, the Postcolonial and the Constitution of Nations", *Law, Democracy and Development* vol. 10, no. 2 (2006).

[634] Shih më shumë për këto vende në Gary J. Jacobsohn, "The Formation of Constitutional Identities", në Tom Ginsburg and Rosalind Dixon (eds.), *Comparative Constitutional Law* (Edward Elgar: Cheltenham, UK & Northampton, MA, USA, 2001); Gary J. Jacobsohn, *Constitutional Identity*, fq. 117-132; 327-337.

[635] Michel Rosenfeld, "Constitutional Identity", fq. 766-771.

ka asnjë mundësi për legjitimim mbi bazën e të vjetrës, por duke u bazuar në elemente dhe në struktura të reja revolucionare. Ky ka qenë rasti me Revolucionin Francez. Dhe, e kundërta, kur përmbysja nuk është aq e thellë dhe lejon mundësinë e përfshirjes së strukturave dhe elementeve të vjetra ekstrakushtetuese dhe kushtetuese, atëherë ndërprerja me të kaluarën nuk është aq radikale dhe lejon mundësinë e legjitimimit mbi bazën e të vjetrës duke u bazuar në strukturat dhe në elementet nga e kaluara. Ky ka qenë rasti me Revolucionin Amerikan, i cili ishte rezultat i emancipimit gradual të pushtetit kushtetues nëpër ish-kolonitë, ashtu që Kushtetuta e vitit 1878 u krijua si rezultat i natyrshëm i këtij emancipimi. Në kohët moderne, i kësaj natyre është rasti i kushtetutëbërjes në Hungari, pas vitit 1990, kur ra komunizmi, por që kushtetutëbërja hungareze edhe për disa vite u bazua në Kushtetutën e nxjerrë nga komunistët pas Luftës së Dytë Botërore.[636]

Identiteti kushtetues britanik cilësohet si i padukshëm, si pasojë e historikut të krijimit të këtij identiteti. Ky identitet është rezultat i formësimit të ngadalshëm të identitetit kushtetues britanik nga shkaku se kushtetuta britanike është rezultat i rritjes, jo i krijimit të njëhershëm. Revolucionet e gjysmës së dytë të shekullit XVII në Britani nuk çuan në shkatërrimin e monarkisë por në themelimin e një konstitucionalizmit krejtësisht të ri dhe të panjohur me vonë në të dy anët e Atlantikut. Në rend të parë, pushteti i mbretit, pas restaurimit më 1660, nuk buronte më nga e drejta hyjnore por nga populli. Së dyti, në vijim më këtë, populli u cilësua si vendi i legjitimitetit të pushtetit britanik në të ardhmen. Së treti, pushteti kushtetutëbërës, i definuar në këtë mënyrë, pra si diçka që i takon popullit, në mënyrë konstante u mohua duke e njohur parlamentin si përfaqësues suprem dhe të vetëm të popullit. Me këtë, në Britani, u krijua praktika e shkrirjes së pushtetit kushtetutëbërës me atë të pushtetit ligjvënës, d.m.th. humbi dallimi ndërmjet kushtetutës dhe ligjit, diçka që akoma qëndron në Britaninë e Madhe që nga ajo kohë. Një qasje e tillë, ani se flitet për një vend me truma revolucionare, siç ndodhi më vonë në Francë dhe në Amerikë, megjithatë ruajti kontinuitetin me të kaluarën sepse prodhimet e Parlamentit u cilësuan si arsye, kurse kushtetuta britanike si e padukshme, u konsiderua si diçka që gjendet në *common law*, pra në

[636] Radoslav Prochazka, *Mission Accomplished: On Founding Constitutional Adjudication in Central Europe* (CEU Press: Budapest, 2002) fq. 49-58; Catherine Dupre, *Importing the Law in Post-Communist Transitions: The Hungarian Constitutional Court and the Right to Human Dignity* (Hart Publishing: Portland, Oregon, 2003) fq. 1-12; 28-38.

vetë shpirtin e padukshëm të popullit britanik.[637] Edhe sot ndryshimet kushtetuese në Britani nuk kanë asnjë dallim me ndryshimet e legjislacionit të zakonshëm.

Identiteti kushtetues i bazuar në luftë, i cili zakonisht asocohet me rastet e Gjermanisë dhe të Japonisë pas Luftës së Dytë Botërore, është identitet i vendosur pas futjes nën okupim ushtarak të një vendi. I ngjason shumë identitetit kushtetues të krijuar pas revolucionit, në kuptim që në të dy rastet ekziston një ndërprerje radikale me të kaluarën. Megjithatë, ekzistojnë disa dallime thelbësore. Në rend të parë, pas revolucionit zakonisht shumica e popullsisë i shkon prapa revolucionarëve dhe identifikohet me ta, duke shërbyer kështu si një bazë e pakontestueshme legjitimiteti. Kështu ndodhi me francezët që identifikuan veten më Shtresën e Tretë, apo me amerikanët që identifikoheshin me Baballarët e Kombit që kishin bërë revolucionin. Në rastin e Gjermanisë dhe të Japonisë, ky nuk ishte rast, sepse të dy kombet ishin dorëzuar pa kushte dhe shumica e popullsisë në këto dy vende nuk identifikohej me okupuesit e vendeve të tyre. Së dyti, në vijim të kësaj, ndërprerja me të kaluarën në rastin e identitetit, që buron nga revolucioni, nuk është krejt e domosdoshme, ndërkohë që në rastin e identitetit të krijuar nga lufta kjo është si rregull, sepse bëhet fjalë për imponim të kushtetutëbërjes, ku si pushtet kushtetues paraqitet në esencë forca okupuese ushtarake. Këtu ka një dallim të vogël ndërmjet gjermanëve dhe japonezëve, sepse derisa në Gjermani elita gjermane ishte aktive në kushtetutëbërjen e re, në rastin e Japonisë Kushtetuta u hartua dhe u miratua nga një forcë okupuese që udhëhiqej nga një gjeneral amerikan, gjenerali MacArthur.[638]

Identiteti i krijuar nëpërmjet një pakti paqësor i referohet rastit spanjoll me nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1978. Dy kanë qenë aspekte më rëndësi për krijimin e këtij lloj identiteti. I pari, nxitja e brendshme që kishin spanjollët për t'i dhënë fund diktaturës së Frankos, në një kohë kur asnjëra palë,

---

[637] F.H. Lawson, "British Law and Government: Organization of Power", në J.L. Brierly (ed.), *Law and Government in Principle and Practice* (Odhams Press: London, 1948) fq. 47-76; De Smith, *Constitutional and Administrative Law*, 5th ed. by Harry Street and Rodney Brazier (Penguin Books: London, 1985) . Krahaso në veçanti pjesën e parë të librit të De Smith, ku autori i jep në mënyrë të shkëlqyer dallimet ndërmjet kushtetutës britanike dhe kushtetutave të tjera, origjinën e kushtetutës britanike, autoritetin e fundit sipas kushtetutës britanike dhe origjinën e lindjes së këtij autoriteti (fq. 13-119).

[638] Wen-Chen Chang, "East Asian Foundations for Constitutionalism: Three Models Reconstructed", fq. 116-119. Shih po ashtu pjesët e shkëlqyera të këtij punimi të cilat flasin për kushtetutëbërjen si promovuese të demokracisë, kushtetutëbërjen si pavarësi nacionale dhe, së fundi, kushtetutëbërjen si një përfshirje e diversiteteve të tjera.

as forcat e diktatorit Franko e as forcat politike civile, nuk mund t'i imponon-nin njëri-tjetrit vullnetin e vet. I dyti faktor jashtëzakonisht me rëndësi ka qenë rruga evropiane që synonin spanjollët pas tërë asaj diktature të stërzgjatur nëpër të cilën kishin kaluar. Ka qenë apeli evropian, i një Evrope të Bashkuar, që sot njihet si Bashkimi Evropian, ai që ka joshur tej mase spanjollët për të ridefinuar identitetin kushtetues, tani mbi bazën e një kushtetute krejtësisht të ndryshme dhe të bazuar në standardet e demokracive kushtetuese moderne të kohës.

Në rastin spanjoll, ndërprerja me të kaluarën më shumë ishte në aspektin e regjimit politik dhe formës së qeverisjes, duke e ruajtur kështu kontinuitetin me rendin juridik-kushtetues nga e kaluara. Kjo ishte pasojë imediate e faktit, siç e thamë, se asnjëra palë nuk mund t'ia imponente tjetrës vullnetin e vet. Nga kjo lindi kompromisi nëpërmjet një pakti të ri të lidhur në mes të forcave kryesore politike e ushtarake ku ruhej monarkia, por mbi baza krejtësisht të tjera nga sistemi pararendës.[639]

Identiteti transnacional lidhet me përpjekjet që dështuan në Evropë për miratimin e Kushtetutës së vitit 2004. Kjo kushtetutë ishte një kushtetutë-traktat në sensin që provonte të akomodonte praktikat nacionale të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian me një organizëm supranacional që mëtonte të fliste me një zë në arenën botërore për çështjet kushtetuese. Në rastin e këtij identiteti që duhej të buronte nga ky traktat-kushtetutë, fjala nuk ishte për tejkalimin apo për ndërprerjen radikale me të kaluarën, si në rastet e identiteteve të sipërcekura. Këtu, më shumë, bëhej fjalë për përpjekjet se si të akomodoheshin rendet kushtetuese nacionale me një rend supranacional që synohej nëpërmjet traktatit-kushtetutë të vitit 2004. Në fillim, preambula fliste për "ne, popujt e Evropës", për t'u ndryshuar më pastaj në "ne, shefat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian". Kjo, këtu, nuk kishte rëndësi, sa kishte substanca që synohej të rregullohej me traktatin-kushtetutë: marrëdhëniet e brendshme të vendeve anëtare që ishin prerogativë kushtetuese për një kohë të gjatë. Me një fjalë, pushteti kushtetutëbërës sikur synohej të bartej në një entitet supranacional që ruante identitetet nacionale por në të njëjtën kohë ankoronte vetveten në elementet bazike të identiteteve nacionale ekzistuese, në atë që u cilësua si "traditat e përbashkëta kushtetuese të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian".[640]

---

[639] W. Phillips Shively, *Power and Choice: Introduction to Political Science*, 8th ed. (McGrawHill: New York, 2003) fq. 179-180.

[640] Wojciech Sadurski, "European Constitutional Identity?", *European University Institute Department of Law Working Papers: Law No. 2006/33*; Francesco Belvisi, "The 'Common

Së fundi, identiteti i bazuar në faktorët ndërkombëtarë, si pjesë e përpjekjeve të tyre për ndërtimin e paqes, paraqet një identitet që prodhohet nga kushtetutëbërja e nisur, e udhëhequr dhe e mbikëqyrur nga faktori ndërkombëtar.[641] Më një fjalë, këtu kemi rastin kur pushteti kushtetutëbërës origjinal formësohet si pasojë e ndërhyrjes së faktorit ndërkombëtar në një kohë dhe hapësirë të caktuar. Ndërhyrja e faktorit ndërkombëtar në kushtetutëbërje, pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, zakonisht lidhet me vendet si Afganistani, Bosnjë-Hercegovina, Timori Lindor, Kosova, Sudani i Jugut etj. Për nga dinamika e kushtetutëbërjes dhe për nga pesha e ndërhyrjes ndërkombëtare, Bosnjë-Hercegovina, Iraku, Afganistani dhe Kosova paraqesin shembuj tipikë ku organizatat ndërkombëtare dhe aktorët e tjerë i kanë dhënë vulën procesit të kushtetutëbërjes dhe vetë produktit të dalë nga ai proces.[642] I tillë ka qenë rasti me Gjermaninë dhe me Japoninë, pas Luftës së Dytë Botërore.[643]

Arsyeja kryesore pse ndodh kjo ndërhyrje në këtë proces është se procesi i vërtetë i kushtetutëbërjes nuk mund të ndodhë pa ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar, si rezultat i luftës, i luftës civile, ose i ndërhyrjes nga jashtë. Cilësi kryesore dalluese e kësaj kushtetutëbërje është se teksti kushtetues ngërthen në vetvete disa norma dhe standarde ndërkombëtare lidhur me formën dhe përmbajtjen e qeverisjes, me rolin dhe vendin e të drejtave të njeriut, si dhe me formën e marrëdhënieve ekonomike dhe pronësore, si dhe lidhur me disa zgjidhje institucionale të cilat kanë qenë tërësisht të panjohura për shoqëritë e tilla në të cilat kushtetutëbërja kryhet nëpërmjet ndërhyrjes së

Traditions' and the Integration of the EU", *Diritto & Questioni Pubbliche* (2005). Versioni elektronik gjendet në: dirittoequestionipubbliche.org (shikuar së fundi më 7 korrik 2016).

[641] Michel Rosenfeld, "Constitutional Identity", fq. 770-771.

[642] Për pikëpamje të ngjashme, cf. më shumë në këto punime: Louis Aucoin, "Introduction", në Laurel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition: Case Studies in Constitution Making* (United States Institute of Peace Press: Washington, D.C., 2010); James C. O'Brien, "The Dayton Constituion of Bosnia and Herzegovina", në Laurel E. Miller (ed.), vep. cit.; J. Alexander Thier, "Big Tent, Small Tent: The making of a Constitution in Afganistan", në Miller (ed.), vep. cit.; Jonathan Morrow, "Deconstitution Mesopotamia: Cutting a Deal on the Regionalisation of Iraq", në Miller (ed.), vep. cit.; Laurel E. Miller, "Designing Constitution-Making Processes: Lessons from the Past, Questions for the Future", në Miller (ed.), vep. cit.; Markus Bokenforde and Daniel Sabsay, "Supranational organizations and their impact on national constitutions", në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Routledge Handbook of Constitutional Law* (Routledge: London, 2013); Anne Peters and Ulrich K. Preuss, "International relations and international law", në Tushnet, Fleiner and Saunders (eds.), vep. cit.

[643] Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law: A New Source of Inspiration?* (Routledge: New York, 2006) fq. 71-82.

faktorit ndërkombëtar. Në këto vende, faktori ndërkombëtar zakonisht ia lë një vend të konsiderueshëm vendimmarrjes vendore lidhur me çështjet e caktuara substanciale në të ardhmen.

4. Identiteti i lindur gjatë interpretimit kushtetues

Siç dihet, "kushtetuta" nuk është vetëm teksti juridik, sepse ai tekst, sikur edhe çdo tekst tjetër, paraqet një tërësi fjalësh të cilat, për t'u bërë normë, duhet të interpretohen. Dhe, është norma kushtetuese që del nga ky interpretim vetë esenca e kushtetutës së dhënë dhe e identitetit të prodhuar nga teksti i interpretuar. Kjo nënkupton se teksti i kushtetutës, plus praktikat e dhëna, interpretimet e caktuara dhe jurisprudenca e gjykatave se si duhet kryer interpretimi i tekstit kushtetues, supozimet bazike të komunitetit juridik, përfshirë këtu dhe vlerat dhe parimet e përbashkëta të këtij komuniteti, të marra së bashku, paraqesin esencën e identitetit kushtetues të një vendi dhe të një shoqërie.[644] Në këtë interpretim të tekstit kushtetues dhe kthimin e tij në norma konkrete, gjykatat luajnë rolin kryesor. Në botën perëndimore, literatura përmend disa raste si më kryesoret, të cilat reflektojnë këtë fakt: në ShBA rasti *Roe v. Wade*[645] dhe *Lunch v. Donnelly*,[646] kurse në Gjermani rasti i njohur si *Mohimi i Holokaustit*.[647]

Interpretimet gjyqësore nga ana e gjykatave kushtetuese apo të gjykatave ekuivalente me to kanë prodhuar identitete të caktuare kushtetuese, të cilat nganjëherë kanë qenë edhe më ndryshe se identiteti kushtetues tekstual. Në ShBA, në veçanti, me të drejtë është vërejtur se transformimi i shoqërisë amerikane ka ndodhur jo si rezultat i tekstit kushtetues por i interpretimit të tij nga ana e gjykatave, në veçanti nga ana e Gjykatës Supreme.[648] Në rastin *Roe v. Wade*, Gjykata Supreme vendosi lejimin e abortit, diçka që ishte tërësisht jashtë çdo norme kushtetuese apo botëkuptimi fetar, moral dhe politik të shoqërisë amerikane: asnjë dispozitë kushtetuese nuk fliste për abortin, lëre më për lejimin e tij. Kjo krijoi një identitet tjetër kushtetues amerikan dhe

---

[644] Jose Luis Marti, "Two Ideas of Constitutional Identity", fq. 5.
[645] 410 US 113 (1973).
[646] 465 US 668 (1984).
[647] 90 BFVerfGE 241 (1994).
[648] Cf. më shumë për këtë rol që ka luajtur Gjykata Supreme e ShBA-së përgjatë historisë në Mary Sarah Bilder, "Colonial Constitutionalism and Constitutional Law", në Alfred L. Brophy and Daniel W. Hamilton, (eds.), *Transformations in American Legal History: Essays in Honor of Morton J. Horwitz* (Harvard UP: Cambridge, MA, 2009).

provokoi debate të ashpra për një kohë të gjatë deri në përmbysjen e këtij vendimi. Në mënyrë të njëjtë, rasti *Lunch v. Donnelly* paraqet një rast që tregon se identiteti kushtetues tekstual ndikon në llojin e caktuar të interpretimit: në këtë rast, Gjykata Supreme gjeti se paraqitja e skenës së lindjes së Krishtit për Krishtlindje në një hapësirë tregtare në publik nuk cenonte dispozitat mbi sekularizmin dhe qëndrimin neutral të shtetit amerikan ndaj fesë sepse ishte bërë për qëllime komerciale dhe ishte i njëjtë me fjalinë "në Zot ne besojmë" që gjendet në dollarin amerikan.

Në vijim, si më sipër, as Gjermania nuk është larg sepse teksti kushtetues i Ligjit Themelor është krijuar në një klimë të traumatizimit të thellë të shoqërisë gjermane ku nacifikimi akoma ka pasur rrënjë të thella, e megjithatë Gjykata Kushtetuese ka arritur të imponojë një identitet tjetër gjerman, duke u bazuar në interpretimin e një teksti që qëndronte larg strukturës materiale, politike dhe kulturore të shoqërisë gjermane të kohës. Rasti i sipërcekur i mohimit të Holokaustit përbën treguesin më të mirë të kësaj: ndërkohë që dispozitat kushtetuese mbi lirinë e fjalës dhe të mendimit janë thuajse të njëjta me ato të Kushtetutës së ShBA-së, në Gjermani Gjykata Kushtetuese vendosi që ndalesa e mohimit të Holokaustit në legjislacionin penal përbënte një veprim krejtësisht kushtetues sepse ndryshe do të pengohej integrimi i tërësishëm i hebrenjve në shoqërinë gjermane.

Kosova bën pjesë në këtë grup, pra në grupin e atyre shteteve ku Gjykata Kushtetuese, me interpretimet e bëra gjatë këtyre gjashtë vjetëve të fundit, ka trasuar rrugën e një identiteti tjetër kushtetues nga traditat, nga zakonet dhe nga struktura materiale, kulturore e politike e shoqërisë kosovare. Në shumicën e rasteve ka një disharmoni ndërmjet tekstit të Kushtetutës dhe realiteteve në terren, disharmoni kjo që shërben si një impuls për formësimin e identitetit kushtetues.[649] Në pak vende, si në rastin e Kosovës, shihet aq mirë e shumë qartë kjo disharmoni, si pasojë e rrethanave historike dhe rolit që ka luajtur Gjykata Kushtetuese në interpretimin e kësaj disharmonie. Këtë rol që ka luajtur Gjykata Kushtetuese, në esencë, nuk ka qenë vështirë për ta luajtur, pikërisht falë tekstit të Kushtetutës, e cila në nenin e saj 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] ka parashikuar se çdo interpretim i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore të garantuara me Kushtetutë duhet të bëhet në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo dispozitë ia ka hapur dyert Gjykatës që të luajë një rol në miniaturë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përdorur

[649] Gary J. Jacobsohn, *Constitutional Identity*, fq. 335.

në të gjitha rastet, pa asnjë përjashtim, praktikën e saj gjyqësore me rastin e zgjidhjes së rasteve të paraqitura para saj. Ani që nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, Kosova ka integruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në sistemin e saj kushtetues,[650] duke e bërë normë kushtetuese të barabartë me çdo normë tjetër kushtetuese dhe, për pasojë, Kosova *de facto* është pjesë e regjimit transnacional kushtetues evropian me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e e Njeriut si një "gjykatë kushtetuese", siç e ka cilësuar Alec Stone Sweet.[651]

Ka shumë aspekte që lidhen me identitetin kushtetues kosovar siç është interpretuar nga Gjykata Kushtetuese. Në të shumtën e rasteve, fjala ka qenë për identitetin kushtetues kosovar në lëmin e sundimit të ligjit, të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, nisur nga fakti se mbi 90 për qind të rasteve të ngritura në Gjykatën Kushtetuese bëhet fjalë për ankesa kushtetuese individuale me të cilat pretendohet shkelja e të drejtave kushtetuese individuale dhe kolektive të qytetarëve, apo të personave juridikë. Lidhur me këtë të fundit, çdo gjë fillon me vendimin e njohur si "rasti i logos së Prizrenit". Ndër rastet më me rëndësi të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, sipas ankesës individuale, është rasti i njohur si "rasti i Diana Kastratit".

---

[650] Cf. neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] i Kushtetutës: "Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

(3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;

(4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;

(5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;

(6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;

(7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;

(8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese".

[651] Për regjimin kushtetues transnacional, identitetin kushtetues evropian, "patriotizmin e të drejtave të njeriut", rolin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në këtë regjim dhe në këtë identitet, shih më shumë në Alec Stone Sweet, "The European Convention on Human Rights and National Constitutional Reordering", *Cardozo Law Review* vol. 33, no. 5 (June 2012).

"Rasti i logos së Prizrenit"[652] paraqet një kërkesë me të cilën Gjykata u mor në ditët e saj të para kur filloi punën. Me siguri është një ndër aktgjykimet më elokuente dhe më të qarta që ka kontribuar jashtëzakonisht shumë në vënien e themeleve të sundimit të ligjit në Kosovë. Çështje në rrezik në këtë rast ishte pozita e komunitetit joshumicë në qytetin e vjetër të Prizrenit.[653] Më 22 prill 2009, Cemajl Kurtisi, zëvendëskryesues i Komunës së Prizrenit, parashtroi kërkesë në Gjykatë duke pretenduar se neni 7 i Statutit të Komunës së Prizrenit ishte në kundërshtim me nenet 3.1;[654] 6.1;[655] dhe 59.1[656] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në bazë të nenit 55.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-040, i 20 shkurtit 2008, në rast se Komuna vendosë të mos rishqyrtojë aktet dhe vendimet që shkelin të drejtat e komuniteteve të garantuara me Kushtetutë, e që i janë referuar asaj nga ana e Zëvendëskryesuesit, ai ose ajo mund ta parashtrojë çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese.[657] Kjo e drejtë e Zëvendëskryesuesit është e sanksionuar në nenin 62, paragrafët 3 dhe 4, të Kushtetutës, ashtu që nenet 54.1, 54.2 dhe 55.4 të Ligjit të lartpërmendur për Vetë-

---

[652] Aktgjykimi *në rastin nr. KO01/09. Cemajl Kurtishi kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit, 18 mars 2010.*

[653] Prizreni është qytet në jug të Kosovës, ku filluan aktivitetet politike dhe ushtarake të shqiptarëve kundër sundimit otoman që kulminuan në një lëvizje shumë të konsoliduar të rezistencës kombëtare. Këtë fakt e njeh edhe Gjykata, në paragrafin 43, ku, *inter alia*, thuhet: "Kjo Gjykatë është e vetëdijshme që shqiptarët identifikohen me '1878'-shin e shkruar në emblemën e Komunës së Prizrenit, ashtu siç thuhet me nenin 7 të Statutit të Komunës. Viti 1878 ka qenë viti i themelimit të Lidhjes së Prizrenit. Udhëheqësit shqiptarë u mblodhën në Prizren, më 10 qershor të atij viti, duke kërkuar të arrijnë shtetin e pavarur shqiptar."

[654] Neni 3.1 [Barazia para Ligjit]: "Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore".

[655] Neni 6.1 [Simbolet]: "Flamuri, stema dhe himni janë simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës të cilat pasqyrojnë karakterin shumetnik të saj".

[656] Neni 59.1 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre]: "Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet: 1. të shprehin, të mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre".

[657] [Zëvendëskryesuesi për komunitete] Neni 54.1 i Ligjit: "Në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve joshumicë, posti i zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve"; Neni 54.2 i Ligjit: "Postin e zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete e mban kandidati përfaqësues i popullatës joshumicë, që ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në kuvendin e komunës".

qeverisjen Lokale janë identike me të. Për më tepër, neni 113.10 i Kushtetutës thotë se "jurisdiksioni shtesë mund të rregullohet me ligj".

Përveç argumenteve materiale, duke theksuar se emblema e komunës duhet të simbolizojë dhe të përçojë porosinë e bashkëjetesës së komuniteteve dhe të pjesëtarëve të komuniteteve dhe ekzistimin e ambienteve multietnike, multikulturale, multireligjioze dhe shumëgjuhësore,[658] z. Cemajl Kurtisi po ashtu ngriti argumente të tjera të natyrës procedurale, duke këmbëngulur se emblema nuk ishte miratuar me shumicën e dy të tretave (2/3) të Kuvendit, siç kërkohet me nenin 7.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.[659] Kuvendi Komunal i mohoi këto pretendime.[660]

Pas një ekzaminimi dhe vlerësimi të gjatë, shumë të hollësishëm dhe të kujdesshëm të fakteve të rastit, si dhe të argumenteve të të dyja palëve,[661] Gjykata gjeti se Kuvendi Komunal, kur mori vendim për të miratuar nenin 7 të Statutit, kishte imponuar një emblemë që nuk mund të konsiderohej simbol i përbashkët i të gjithë njerëzve që jetojnë në Prizren dhe kishte mbipërfaqësuar identitetin e komunitetit etnik shqiptar në raport me identitetin e komuniteteve të tjera në Prizren.[662] Duke vepruar kështu, Kuvendi Komunal kishte shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës, më konkretisht nenet 3, 7.1, 58 dhe 59.[663] Sipas Gjykatës, kjo do të thotë se Kuvendi Komunal nuk kishte konsideratë apo nuk kishte konsideratën e duhur për të drejtat dhe liritë themelore që ua jep Kushtetuta komuniteteve joshumicë për të ruajtur, për të mbajtur dhe për të promovuar identitetet e tyre. Për këtë arsye, Gjykata, në pikën IV të pjesës operative, urdhëroi "... Komunën e Prizrenit që, brenda një periudhe prej tre muajsh nga dorëzimi i këtij aktgjykimi, të ndryshojë Statutin dhe emblemën e saj në mënyrë që ta sjellë atë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe të mos përjashtojë komunitetet joshumicë". Kjo në fakt edhe ndodhi më vonë: Komuna e Prizrenit e ndryshoi nenin 7 të Statutit të saj ashtu që emblema e tanishme e qytetit është plotësisht në pajtim me Kushtetutën.[664]

---

[658] Paragrafi 12 i Aktgjykimit.
[659] Paragrafi 13 i Aktgjykimit.
[660] Për argumentet e Kuvendit Komunal, cf. paragrafët 20-25 të Aktgjykimit.
[661] Cf. paragrafët 26-54.
[662] Cf. paragrafi 55 i Aktgjykimit.
[663] Cf. pjesa operative, pika III e Aktgjykimit.
[664] Më 18 qershor 2010, Kryetari i Prizrenit, dr. Ramadan Muja, i dërgoi një letër Gjykatës në të cilën kërkoi zgjatjen e afatit prej 3 muajsh të caktuar në Aktgjykimin nr. KI 01/09 edhe për gjashtëdhjetë (60) ditë të tjera. Me Urdhrin e saj të 21 qershorit 2010, Gjykata vendosi të lejonte këtë zgjatje të afatit. Komuna e Prizrenit përfundimisht veproi në përputhje me Aktgjy-

"Rasti i Diana Kastratit"[665] ka pasur të bëjë me mbrojtjen e të drejtës për jetë, diçka tërësisht e panjohur në praktikën gjyqësore kosovare dhe më gjerë. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në Serbi dhe në Rumani kanë pasur një vendim të ngjashëm me këtë të Kosovës. Në Aktgjykimin në rastin KI41/12, të 26 shkurtit 2013, Gjykata ka gjetur se cenimi i të drejtës për mjet efektiv juridik ka çuar në cenimin e të drejtës për jetë, si pasojë e pakujdesisë së gjykatave për të mbrojtur në mënyrë efektive viktimën e vrasjes (gruan e divorcuar). Parashtrues Gëzim dhe Makfire Kastrati, prindërit e viktimës, kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë.

Pjesa tjetër e rasteve zakonisht ka të bëjë me definimin dhe me kufizimin e pushtetit, lokal dhe atij qendror, diçka e panjohur në Kosovën e mëhershme, duke saktësuar se çfarë ka qenë *bouche de la loi* e ligjvënësit kosovar. Kontrolli abstrakt i ligjeve të Kuvendit të Kosovës përbën një risi në sistemin kushtetues kosovar që thelbësisht ka formësuar identitetin e politikës kosovare, ani se ka pasur dhe ka reagime shumë agresive nga politikanët kur flitet për legjitimitetin e kontrollit kushtetues të ligjeve, njësoj siç ka ndodhur me të gjitha vendet e ish-Lindjes Komuniste në Evropë. Rastet e tilla kanë qenë jo të rralla dhe kanë pasur të bëjnë me imunitetin e deputetëve,[666] pensionet e tyre,[667] të drejtën për punë,[668] amendamentet kushtetuese[669] dhe kështu me radhë.

---

kimin e Gjykatës, më 24 mars 2011, kur miratoi Vendimin nr. 01/011-3581 për Ndryshimin e Statutit të Komunës së Prizrenit.

[665] Aktgjykim në rastin KI 41/12. Parashtrues: Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Prishtine, më 26 shkurt 2013, nr. ref.: AGJ361j13.

[666] Aktgjykim në rastin KO 98/11. Parashtrues: Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 20 shtator 2011, nr. ref.: AGJ138/11.

[667] Aktgjykim në rastin KO119/10. Parashtrues: Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafit 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, nr. 03/L111, të 4 qershorit 2010. Prishtinë, më 8 dhjetor 2011, nr. ref.: AGJ165/11.

[668] Aktgjykim në rastin KO 131/12. Parashtrues: Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19,41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, nr. 04/L-125, të miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012. Prishtinë, më 15 prill 2013, nr. ref.: AGJ404/13.

[669] Reagimet më të mëdha kanë qenë në rastin e njohur si "rasti Jahjaga" dhe në rastin e amendamenteve kushtetuese që lidheshin me formimin e Gjykatës Speciale për Krimet e Luftës të kryera në Kosovë. Për rastin e parë cf. *Aktgjykimi në kërkesat KO29/12 dhe KO48/12. Amendamentet e propozuara kushtetuese të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të*

Në rastin e imunitetit të deputetëve, si dhe të gjithë funksionarëve të tjerë kosovarë në organet qendrore, Gjykata kishte gjetur se ata gëzonin vetëm imunitet funksional, pra për punët e kryera në kuadër të funksioneve të tyre. Kjo nënkupton organi që i ka veshur me imunitet funksional bartësit e tillë duhet ta përcaktoj qartë se cilat janë punët e kryera në kuadër të funksionit, përveç rasteve të veprave *in flagrantia*, për të cilat ekziston një dënim mbi pesë vjet burgim. Në rastin e gjyqtarëve të gjykatave të rregullta, ky organ është Këshilli Gjyqësor, në rastin e prokurorëve ky organ është Këshilli Prokurorial, në rastin e deputetëve ky organ është Kuvendi, në rastin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ky organ është Shefi i Shtetit, në rastin e Shefit të Shtetit ky organ është Kuvendi i Kosovës, dhe, së fundi, në rastin e ministrave ky organ është Qeveria e Kosovës.

Në rastin e pensioneve të deputetëve, Gjykata kishte konstatuar se një pension i tillë ishte diskriminues dhe jokushtetues sepse privilegjonte një strukturë të caktuar të qytetarëve të Kosovës pa ndonjë meritë të caktuar në mënyrë specifike. Gjykata ka vepruar njësoj edhe me rastin e të drejtës për punë, të cekur më sipër, duke konstatuar se me ligj nuk mund t'i ndalohej personave fizikë e drejta për punë jashtë orarit të punës, në rastet kur një gjë e tillë përkonte me natyrën e profesionit (mjek, avokat e kështu me radhë).

Amendamentet kushtetuese dhe kontrolli i tyre kushtetues kanë qenë dhe ngelin pjesa më kryesore e identitetit kushtetues të Kosovës. Nëpërmjet kontrollit të kushtetutshmërisë së tyre, Gjykata Kushtetuese ka mundësi të pengojë atë që në literaturë cilësohet si "vjedhje e identitetit kushtetues".[670] I tillë cilësohet çdo veprim i organit përfaqësues që synon ndryshimin e germës dhe frymës së tekstit kushtetues, duke e bërë esencialisht të ndryshëm nga identiteti fillestar kushtetues. Si ndryshim esencial i identitetit të përcaktuar me tekstin fillestar kushtetues do të ishte rasti, ta zëmë, i ndryshimit të rregullimit shtetëror nga ai republikan në një regjim monarkik qeverisës, apo nga një shtet laik në një shtet teokratik, dhe kështu me radhë. Dispozitat kushtetuese në Kushtetutën e Kosovës që flasin për kontrollin kushtetues të

Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe më 4 maj 2012. Prishtinë, më 20 korrik 2012, nr. ref.: AGJ284/12, kurse për rastin e Gjykatës Speciale, cf. *Aktgjykim në rastin KO 26/15. Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Shkresën nr. 05-433/DO-318. Prishtinë, më 15prill 2015, nr. ref.: AGJ788/15.* Në fakt, amendamentet kushtetuese lidhur me këtë u miratuan nga Kuvendi i Kosovës për herë të dytë dhe pas një presioni të jashtëzakonshëm ndërkombëtar.

[670] Gary J. Jacobsohn, *Constitutional Identity*, fq. 334.

amendamenteve kushtetuese, thënë shkurt, pamundësojnë që Kuvendi i Kosovës të abuzojë pushtetin e vet konstitutiv të cilin e posedon sipas Kushtetutës për të ndryshuar germën dhe frymën e Kushtetutës së Kosovës në drejtim të prishjes apo të ndryshimit radikal të identitetit aktual kushtetues kosovar, i cili ankorohet në dispozitat mbi republikanizmin, mbi shtetin laik, mbi sundimin e ligjit dhe kështu me radhë.

Kategoria e fundit e vendimmarjes së Gjykatës Kushtetuese, e cila ka lënë gjurmë të thella në identitetin kushtetuese kosovar si më sipër, janë vendimet që kanë pasur të bëjnë me gjyqësorin e pavarur dhe me kontrollin kushtetues të veprimit administrativ. Këtu, i rëndësisë së parë, është vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me lirinë e lëvizjes, i njohur ndryshe si "rasti i pasaportave".[671] Në këtë rast, Gjykata gjeti se liria e lëvizjes së qytetarëve kosovarë nuk mund të kufizohej veçse me vendim gjykate. Tri organe kushtetuese: Ministria e Brendshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë, kishin lidhur një memorandum mirëkuptimi me të cilin ua ndalonin në mënyrë automatike qytetarëve të Kosovës që kishin çfarëdo rasti në procedim gjyqësor, si p.sh. për mospagesë të rrymës apo për shkurorëzim, që të merrnin dokument udhëtimi. Këtë detyrë të ndalimit e kryenin gjykatat, si "detyrim" të marrë më vullnet përmes këtij memorandumi të lidhur ndërmjet këtyre tri organeve kushtetuese. Kjo jo vetëm që ishte kundër lirisë së lëvizjes së qytetarëve të Kosovës, por binte ndesh edhe me parimin e ndarjes së pushteteve, sepse gjykatat e Kosovës ishin bërë me këtë lloj memorandumi si servis i pushtetit ekzekutiv: Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë, kurse Këshilli Gjyqësor ishte shndërruar në një servis i të dyjave, në vend që të merrej me administrimin dhe me menaxhimin e shërbimeve për gjyqësorin kosovar.

Në të gjitha këto raste, Gjykata Kushtetuese ka bërë një interpretim qëllimor me synim arritjen e një uniteti dhe harmonie kushtetuese të të gjitha parimeve, normave dhe vlerave të cilat reflektojnë standardet e konstitucionalizmit perëndimor të cilin mëton ta arrijë shoqëria kosovare.

---

[671] Aktgjykim në rastin KI 06/10, Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë. Prishtinë, më 30 tetor 2010, nr. ref.: AGJ63/10.

Përfundim

Identiteti kushtetues, në përgjithësi, paraqet prodhim të mendjes së iluministëve të Evropës përgjatë shekujve XVII dhe XVIII. Më pastaj u krijuan praktika kushtetuese të cilat operacionalizuan idetë iluministe mbi natyrën e pushtetit dhe rolin e individit në një shoqëri. Në këtë kuptim, Kosova sikur akoma gjendet në fillet e operacionalizimit të ideve iluministe të shekujve të kaluar: për herë të parë në historinë kushtetuese të Kosovës ka një konstitucionalizëm kosovar që modelohet sipas standardeve perëndimore mbi ndarjen e pushtetit, të drejtat e njeriut dhe të pakicave, sundimin e ligjit dhe kështu me radhë. U mor vesh, në kuadër të modelit të konstitucionalizmit perëndimor ekzistojnë disa modele, ku bën pjesë edhe Kosova. Kështu, sa i përket ndarjes së pushteteve, rolit të individit në shoqëri, natyrës së marrëdhënieve ekonomike dhe kështu me radhë, Kosova nuk dallon shumë nga vendet e tjera ish-komuniste. Dallimi i Kosovës me vendet e tjera ka të bëjë më shumë me të drejtat e komuniteteve kosovare, me pamundësinë e ndryshimit të Kushtetutës pa pëlqimin e këtyre komuniteteve në çështjet që prekin interesat e tyre, natyrën dhe caqet e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, si dhe kur bëhet fjalë për sundimin e ligjit në sferën e krimit të organizuar dhe krimeve kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare. Në këto segmente, Kosova dallon jashtëzakonisht shumë nga vendet e tjera evropiane, ani se në disa prej tyre, ta zëmë në Spanjë dhe në Rumani, ekzistojnë dispozita kushtetuese që privilegjojnë pozitën e bashkësive nacionale joshumicë. Megjithatë, në asnjë vend tjetër në Evropë, pos Kosovës dhe Bosnje e Hercegovinës, nuk ka një ndërhyrje në sistemin nacional të drejtësisë të faktorit evropian për sundim të ligjit. Kjo ndërhyrje lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me pafuqinë e strukturave vendore të sistemit të drejtësisë, në rend të parë të prokurorisë dhe të gjyqësorit, për t'u ballafaquar paanshëm dhe me kompetencë profesionale me krimin e organizuar, si dhe me krimet kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare. Kjo do të thotë se Misioni evropian i sundimit të ligjit në Kosovë, EULEX, për një kohë të gjatë duhet të qëndrojë në Kosovë për të ndihmuar vendorët për t'u ballafaquar me vështirësitë ekzistuese në sistemin e drejtësisë. Kjo është pjesë e identitetit kushtetues kosovar, si dhe të atij të Bosnje e Hercegovinës. Kjo është kështu si pasojë e disharmonisë së theksuar ndërmjet tekstit kushtetues kosovar, i cili është hartuar kryesisht nga faktori ndërkombëtar, dhe realitetit socio-politik, ekonomik, kulturor dhe tjetër të shoqërisë kosovare në të cilin operon ky tekst.

Roli i gjykatave në zbritjen e kësaj disharmonie ndërmjet tekstit kushtetues dhe realitetit fizik në të cilin operon, ka qenë i madh. Kjo ka qenë kështu jo vetëm me rastin e Kosovës, por edhe gjetiu në vendet ish-komuniste. Kështu, si shembull tipik i këtij roli të madh të Gjykatës Kushtetuese, në literaturë përmendet Hungaria. Gjykata Kushtetuese e këtij vendi ka pasur rol vendimtar në trasimin e rrugës së integrimit evropian të këtij vendi. Një situatë e ngjashme ka ekzistuar edhe në vendet e tjera të Evropës Qendrore. Kosova nuk bën përjashtim nga kjo: Gjykata Kushtetuese e Kosovës, bazuar në dispozitën e artë nga neni 53 i Kushtetutës, e cila i detyron të gjitha autoritetet publike që të zbatojnë praktikat e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kur vendosin për të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, me përvojën e saj, që nga viti 2009, ka vënë standardet moderne kushtetuese mbi liritë dhe të drejtat njerëzore, mbi caqet e vendimmarrjes së Kuvendit të Kosovës, mbi ndarjen e pushteteve dhe të drejtat e komuniteteve joshumicë, si dhe mbi shumë çështje të tjera që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit dhe me demokracinë kushtetuese. Qasja e Gjykatës Kushtetuese ka qenë fare e re dhe kjo ka qenë arsyeja kryesore e keqkuptimeve në opinionin publik, i cili në të shumtën e rasteve nuk e ka pasur të qartë se cili ka qenë roli i gjykatave kushtetuese në integrimet evropiane të shoqërive të tjera të dala nga diktatura komuniste.

Nga ky ndërveprim i vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese dhe disharmonisë së tekstit kushtetues me realitetin kosovar në të cilin ka operuar, në mënyrë graduale ka filluar të identifikohet një identitet i ri kushtetues i Kosovës, i cili nuk ka qenë i njohur më parë gjatë historisë së saj. Edhe aktorët e tjerë politikë dhe kushtetues kanë luajtur një rol me rëndësi, por vetëm pasi kanë parë kufizimet e vëna nga Gjykata Kushtetuese sa i përket veprimit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor të organeve kushtetuese. Kështu, ta zëmë, Gjykata Kushtetuese disa herë ka shpallur si jokushtetuese dispozita të caktuara të amendamenteve kushtetuese dhe ligjeve të tjera të nxjerra nga Kuvendi i Kosovës, ka shfuqizuar vendimet e Kuvendit kur ato nuk kanë qenë në pajtim me Kushtetutën dhe kështu me radhë. Njësoj ka vepruar edhe me disa veprime të ekzekutivit kosovar, për të mos folur për gjyqësorin, në veçanti kur flitet për veprimin e gjyqësorit në sferën e të drejtave individuale (prona, e drejta për jetë, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e kështu me radhë). Të gjitha këto aktivitete të Gjykatës Kushtetuese, të ushtruara në kuadër të juridiksionit të njohur nga neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës, kanë qenë një risi për kulturën politike dhe juridiko-kushtetuese të elitës politike dhe të komunitetit juridik kosovar, duke hapur

kështu rrugën e procesit të dialogimit ndërmjet opinionit publik dhe Gjykatës Kushtetuese, ndërmjet aktorëve politikë e organeve kushtetuese dhe Gjykatës, me qëllim të uljes sa më shumë të disharmonisë që ekziston ndërmjet tekstit kushtetues dhe strukturës materiale (etnike, fetare, socio-politike, ekonomike, kulturore etj.) të shoqërisë kosovare.

Aktualisht, lirisht mund të thuhet se identiteti kushtetues i Kosovës, i dalë nga konflikti dhe i paracaktuar tekstualisht nga faktori ndërkombëtar, në mënyrë graduale po transformohet në një identitet kushtetues të një shoqërie që përqafon me vullnet premisat kryesore të konstitucionalizmit modern perëndimor që kanë të bëjnë me ndarjen e pushtetit, me sundimin e kushtetutës dhe të ligjit, si dhe me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të minoriteteve.

Literatura

1. Libra

Aalt Willem Heringa and Philip Kiiver, *Constitutions Compared: An Introduction to Comparative Constitutional Law*, 2d ed. (Intersentia: Antwerp, 2009).

Adam Czarnota, Martin Krygier and Wojciech Sadurski (eds.), *Rethinking the Rule of Law After Communism* (CEU Press: Budapest, 2005).

Alberto Predieri, *Carl Schmitt, un NAZISTA senza CORAGGIO* vol. I & II (La Nuova Italia Editrice: Firenze, 1998-1999).

Alejandro Saiz Arnais and Carina Alcoberro Llivina (eds.), *National Constitutional Identity and European Integration* (Intersentia: Cambridge, 2013).

Alfred L. Brophy and Daniel W. Hamilton, (eds.), *Transformations in American Legal History: Essays in Honor of Morton J. Horwitz* (Harvard UP: Cambridge, MA, 2009).

Alfrend North Whitehead, *The Organization of Thought* (Greenwood, 1974).

Alush Gashi, *The Denial of Human and National Rights of Albanian in Kosova* (Illyria: New York, 1991).

Allan R. Brewer-Carias, *Constitutional Courts as Positive Legislators: A Comparative Law Study* (Cambridge UP: Cambridge, 2011).

Andras Sajo, *Limiting Government: An Introduction to Constitutionalism* (CEU Press: Budapest, 1999).

Andrew Arato, *Civil Society, Constitution and Legitimacy* (Rowman & Littlefield: Maryland, 2000).

Andrew Harding and Peter Leyland (eds.), *Constitutional Courts: A Comparative Study* (Wildy, Simmonds & Hill: London, 2009).

Androkli Kostallari, *Fjalor gjuhës së sotme shqipe* (Rilindja: Prishtinë, 1981).

Anton Bebler and Jim Seroka (eds.), *Contemporary Political Systems: Classifications and Typologies* (Lynne Reinner: Boulder, 1990).

Antonio Cassese, *Self-Determination of Peoples: A Legal Reappraisal* (Cambridge UP: Cambridge, 1996).

Anthony Aust, *Modern Treaty Law and Practice* (Cambridge UP: Cambridge, 2000).

Arend Lijphart (ed.), *Parliamentary versus Presidential Government* (Oxford UP: Oxford, 1992).

Arend Lijphart, *Patterns of Democracy: Government forms and Performance in Thirty-Six Countries* (Yale UP: New Haven, 1999).

Aristotle, *The Politics*, Ernest Barker (ed. dhe përkth.) (Oxford UP: Oxford, 1962).
Arthur J. Jacobson and Benrhard Schlink (eds.), *Weimar: A Jurisprudence of Crisis* (Univ. of California Press: Berkley, 2000).
Arrigo Cavaglieri, *Lezioni di diritto internazionale*, parte generale (G. Maio: Roma, 1926).
Basil Kondis, *Greece and Albania: 1908-1914* (Institute for Balkan Studies: Thessaloniki, 1976).
Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law: A New Source or Inspiration?* (Routledge: London, 2006).
Benedict Anderson, *Imagined Communities: Reflections on the Origin and Spread of Nationalism* (Verso: New York, 2006).
Bernd Jurgen Fieber, *Mbreti Zog dhe pjekja për stabilitet në Shqipëri* (Toena: Tiranë, 1996).
Biancamaria Fontana (ed.), *Benjamin Constant: Political Writings* (Cambridge UP: Cambridge, 2010).
Carl Brown, *Imperial Legacy: The Ottoman Imprint in The Balkans and the Middle East* (Columbia UP: New York, 1996).
Carl Schmitt, *Constitutional Theory* (Duke UP: Durham, 2008). Titulli i origjinalit: Carl Schmit, *Varfassungslehre* (Duncker und Humblot: Munich, 1928).
Carl Schmitt, *Legality and Legitimacy* (Duke UP: Durham, 2004).
Carl Schmitt, *Political Romanticism* (MIT Press: Massachusetts, 1986).
Carl Schmitt, *Political Theology II: The Myth of the Closure of Any Political Theology* (Polity Press: USA, 2008).
Carl Schmitt, *Political Theology: Four Chapters on the Concept of Sovereignty* (Univ. Chicago Press: Chicago, 2005).
Carl Schmitt, *Roman Catholicism and Political Form* (Greenwood: Westport, 1996).
Carl Schmitt, *The Concept of the Political* (Univ. Chicago Press: Chicago, 1996, 2007).
Carl Schmitt, *The Crisis of Parliamentary Democracy* (MIT Press: Massachussets, 1988).
Carl Schmitt, *The Leviathan in the State Theory of Thomas Hobbes* (Univ. Chicago Press: Chicago, 2008).
Carl Schmitt, *Theory of the Partisan* (Telos Press: New York, 2007).
Cass R. Sunstein, *Designing Democracy: What Constitutions Do* (Oxford UP: Oxford, 2001).
Catherine Brolmann (ed.), *Peoples and Minorities in International Law* (Springer Verlag: New York, 1993).

Catherine Dupre, *Importing the Law in Post-Communist Transitions: The Hungarian Constitutional Court and the Right to Human Dignity* (Hart: Portland, Oregon, 2003).
Charles Taylor, *Multiculturalism, Examining the Politics of Recognition* (Princeton UP: New Jersey, 1994).
Christian Tomuschat, *Modern Law of Self-Determination* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1993).
Christopher F. Zurn, *Deliberative Democracy and Its Institutions of Judicial Review* (Cambridge UP: Cambridge, 2007).
Christopher Wolfe, *The Modern Rise of Judicial Review: From Constitutional Interpretation to Judge-Made Law* (Rowman & Littlefield: London, 1994).
Csongor Kuti, *Post-Communist Restitution and the Rule of Law* (Central European UP: Budapest, 2009).
Daniel P. Franklin and Michael J. Baun (eds.), *Political Culture and Constitutionalism: A Comparative Approach* (M.E. Sharpe: New York, 1995).
Daniel Patric O'Connell, *Succession in Municipal Law and International Law* vol. I (Cambridge UP: 1967).
David Dyzenhaus (ed.), *Law as Politics* (Duke UP: Durham, 1998).
David Dyzenhaus, *Legality and Legitimacy: Carl Schmitt, Hans Kelsen and Herman Heller in Weimar* (Oxford UP: Oxford, 1997).
David Weissbrodt and Connie de la Vega, *International Human Rights: An Introduction* (Univ. of Pennsylvania Press: Philadelphia, 2007).
Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds.), *How Constitutions Change: A Comparative Study* (Hart: Oxford, 2011).
De Smith, *Constitutional and Administrative Law*, 5th ed. by Harry Street and Rodney Brazier (Penguin Books: London, 1985).
Detlen Marten und Hans-Jürgen Papier (eds.), *Handbuch der Grundrechte in Deutschland und Europa: Band IX: Grundrechte in Osmittel und Osteuropa* (C.F. Muller: Heidelberg, 2016).
Dieter Fleck (ed.), *The Handbook of The Law of Visiting Forces* (Oxford UP: Oxford, 2001).
Dimitrije Kulić, *Ustavno sudstvo u svetu* (Gjyqësia Kushtetuese në Botë) (Naša Reč: Leskovac, 1972).
Dinah Shelton (ed.), *International Law and Domestic Legal Systems: Incorporation, Transformation, and Persuasion* (Oxford UP: Oxford, 2011).
Donald Clark & Robert Williamson (eds.), *Self-Determination: International Perspectives* (St. Martin's Press: New York, 1996).
Donald P. Kommers, *The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany*, 2nd ed. (Duke UP: Durham, 1997).
Edith P. Stckney, *Southern Albania or Vorio Epirus in European International Affairs: 1912-1913* (Stanford UP: California, 1926).

Enver Hasani, Peter Paczolay and Michael Reigner (eds.), *Constitutional Justice in Southeast Europe: Constitutional Courts in Kosovo, Serbia, Albania and Hungary between Ordinary Judiciaries and the European Court of Human Rights* (Nomos: Baden, 2012).
Ernest Baker (ed. dhe përkth.), *The Politics of Aristotle* (Oxford UP: Oxford, 1962).
Ernest Petrić, *Pravica do samoodločbe* (Založba Obzorja: Maribor, 1984).
Ernst H. Feilchenfeld, *Public Debts and State Succession* (Macmillan: New York, 1931).
Esat Stavileci, Blerim Reka dhe Arsim Bajrami, *Kosova: Political, Constitutional and International Law Arguments* (Kosovo Information Center: Prishtina, 1996).
Eyal Benvenisti, *The International Law of Occupation* (Princeton UP: N.J., 1993).
F.A. Hayek, *The Constitution of Liberty: The Definitive Edition* (Univ. Chicago Press: Chicago, 1960, 2011).
Franck C. Newman and David Wiessbrodt, *International Human Rights: Law, Policy, and Process* (Anderson: Cincinati, 1996).
Fransoa Šobe, Loren Marten, *Medjunarodni Kulturni Odnosi* (CLIO: Beograd 2014).
Frantz Despagnet, *Cours de droit international public* (Librairie de la Société du Recueil Gal. des Lois et des Arrêts: Paris 1910).
Friedrich A. Hayek, *The Constitution of Liberty* (Univ. Chicago Press: Chicago, 1978).
Gary Jeffrey Jacobsohn, *Constitutional Identity* (Harvard UP: Cambridge, Mass.: 2010).
Gavro Perazić, *Skadarsko jezero i rijeka Bojana u medjunarodnom pravu* (CID: Titograd, 1981).
Gerald R. Adams & Jay D. Schveneveldt, *Understanding Research Methods* (Longman: New York, 1985).
Gustavo Zagrebelsky, *La giustizia costituzionale* (il Mulino: Milano, 1989).
Hans Kelsen, *General Theory of Law and State* (Lawbook Exchange: Clark, New Jersey, 2007, 2009).
Hans Kelsen, *Pure Theory of Law* (Lawbook Exchange: Clark, New Jersey, 2002, 2009).
Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (Chicago UP: Chicago, 2002).
Hersch Lauterpacht, *Oppenheim's International Law* vol. II, 7th ed. (Longman: London, 1952).
Historic Supreme Court Decisions: The Commerce Clause, 2nd ed. (LandMark: Washington D.C., June 2012).
Ingolf Pernice and Jiří Zemánek (eds.), *A Constitution for Europe: The IGC, The Ratification Process and Beyond* (Nomos: Baden-Baden, 2005).

Instituti për Kërkime Juridike dhe Shoqërore i Fakultetit Juridik, *Diskutime për Amendamentet Kushtetuese në Kushtetutën e RS të Serbisë dhe KSA të Kosovës* II (Univ. Prishtinës: Prishtinë, tetor 1988).
Ivor Jennings, *The Approach to Self-Government* (Cambridge UP, 1956).
J. Roland Pennock and John W. Chapman (eds.), *Constitutionalism* (New York UP: New York, 1979).
J. Ronald Pennock and John W. Chapman (eds.), *Justification: Nomos XXVIII* (New York UP: New York, 1986).
J.L. Brierly (ed.), *Law and Government in Principle and Practice* (Odhams Press: London, 1948).
J.N. Pandey, *The Constitutional Law of India*, 47th ed. (CLA: Allahabad, India, 2010).
James Bryce, *Studies in History and Jurisprudence* (Clarendon Press: Oxford, 1901).
James Crawford, *The Creation of States in International Law* (Oxford UP: Oxford 1979).
James Summers (ed.), *Kosovo: A Precedent? The Declaration of Independence, the Advisory Opinion and Implications for Statehood, Self-Determination and Minority Rights* (Martinus Nijhoff: The Hague, 2011).
Jane Stromseth, David Wippman and Rosa Brooks, *Can Might Make Rights? Building the Rule of Law After Military Interventions* (Cambridge UP: Cambridge, 2006).
Janne Elisabeth Nijman, *The Concept of International Legal Personality: An Inquiry Into the History and Theory of International Law* (T.M.C. Asser: The Hague, 2004).
Jasna Omejec, *Konvencija o Zaštitu Ljudskih Prava i Temeljnih Sloboda u Praksi Europskog Suda za Ljudska Prava: Strasbourški Acquis* (Novi Informator: Zagreb, 2013).
Jean-Marc Lacourcière, *Report on the Jurisprudence of the Constitutional Court of Kosovo on Human and Minority Rights* (Kosovo Law Center: Prishtinë, 2011).
Jean-Pierre Massias, *Droit constitutionnel des États d'Europe de l'Est*, 2e ed. (Presses Universitaire de France: Paris, 2008).
Jim Murdoch, *Protecting the right to freedom of though, conscience and religion under the European Convention on Human Rights* (Council of Europe: Strasbourg, 2012).
John Williamson (ed.), *Latin American Readjustment: How Much Has Happened* (Institute for International Economics: Washington, 1989).
José María Beneyto / Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the Recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond* (Nomos: Baden-Baden, 2011).

Joseph Stiglitz, *Globalization and its Discontents* (W.W. Norton: New York, 2003).
Jovan Gjorgjeviq, *E Drejta Kushtetuese* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1972).
Jovan Gjorgjeviq, *Sistemi Politik: Kontribut shkencës mbi njeriun dhe vetëqeverisjen* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1978).
Karl J. Fridrih, *Kosntitucionalna demokratija* (CID: Podgorica, 2005).
Karl Šmit, *Tri vrste pravnonaučnog mišljenja* (Biblioteka Parerga: Beograd, 2003). Titulli i origjinalit: Carl Schmitt, *Über die drei Arten des rechtswissenschaftlichen Denkens* (Hanseatische Verlagsanstalt: Hamburg, 1934).
Karl Strupp, *Elements du droit international public* I (Les ed. internationales: Paris, 1930).
Kemal Gözler, *Judicial Review of Constitutional Amendments: A Comparative Study* (Ekin Press: Bursa, 2008).
Kurtesh Salihu, *Lindja, Zhvillimi, Pozita dhe Aspektet e Autonomitetit te Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste* (Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1984).
Kyriaki Topidi and Alezander H.E. Morawa (eds.), *Constitutional Evolution in Central and Eastern Europe* (Ashgate: Burlington, 2011).
L.C. Stavrianos, *The Balkans Since 1453* (New York UP: New York, 1958).
Larry Diamon and Marc F. Plattner (eds.), *Democracy After Communism* (John Hopkins UP: Baltimore, 2002).
Laura Silber & Alan Little, *The Death of Yugoslavia* (Penguin Books: London, 1995).
Laurel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition: Case Studies in Constitution Making* (United States Institute of Peace Press: Washington D.C., 2010).
Levent Gonenc, *Prospects for Constitutionalism in Post-Communist Countries* (Kluwer Law International: The Hague, 2002).
Lori Fisler Damrosch and David J. Scheffer (eds.) *Law and Force in the New International Order* (Westview Press: USA, 1991).
Louis Favoreu, *Droit constitutional*, 12e ed. (Dalloz: Paris, 2009).
Louis Prakke and Constantijn Kortmann (eds.), *Constitutional Law of 15 EU Member States* Kluwer: Deventer, 2004).
Luca Mezzeti, *Sistemi e Modeli di Giustizia Costituzionale*, Tomo II (CEDAM: Padova, 2011).
Lucio Pegoraro, Antonio Reposo, Angelo Rinella, Roberto Scarciglia et Mauro Volpi (eds.), *Diritto Costituzionale e Publico* (G. Giappichelli Editore: Milano: 2005).
M. Perry, M. Chase, J.R. Jacob, M.C. Jacob and Th.H. von Laue (eds.), *Western Civilisation: Ideas, Politics, and Society*, 10th ed. (Wadsworth Cengage Learning: Boston, 2013, 2009).

M.J.C. Ville, *Constitutionalism and the Separation of Powers* (Liberty Fund: Indianapolis, 1998).
Malcolm D. Evans, *Manual on the wearing of religious symbols in public areas* (Council of Europe: Strasbourg, 2009).
Marc Weller, *Shtetesia e kontestuar: Administrimi ndërkombetar i luftës së Kosovës për pavarësi* (Koha: Prishtinë, 2009).
Mark Almond, *Europe's Backyard War: The War in The Balkans* (Heinemann: London 1994).
Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Routledge Handbook of Constitutional Law* (Routledge: London, 2013).
Martin Loughlin and Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism: Constituent Power and Constitutional Form* (Oxford UP: Oxford, 2007).
Mauro Mazza, *L'ordinamento costituzionale del Kosovo* (Jovene Editore: Napoli, 2008).
Michael Stolleis, *A History of Public Law in Germany: 1914-1945* (Oxford UP: Oxford, 2004).
Michael Stolleis, *Public Law in Germany, 1800-1914* (Berghahn: New York, 2001)
Michel Rosenfeld (ed.), *Constitutionalism, Identity, Difference, and Legitimacy* (Duke UP: Durham, 1994).
Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford UP: Oxford, 2012).
Michel Rosenfeld, *The Identity of the Constitutional Subject: Selfhood, Citizenship, Culture, and Community* (Routledge: London, 2010).
Mikel Ndreca, *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja* (Rilindja: Prishtinë, 1986).
Milan Bulajić, *Pravo naroda na samoodredjenje u Društvu Naroda i Ujedinjeniin Nacijama: 1917-1962* (Naučna Knjiga: Beograd, 1963).
Noel Malcolm, *Kosovo: A Short History* (New York UP: New York, 1998).
Norman Dorsen, Michael Rosenfeld, Andras Sajo and Susanne Baer (eds.), *Comparative Constitutionalism: Cases and Materials* (West Group: Minneapolis, 2003).
P. Carrozza, A. Di Giovine & G.F. Ferrari (eds.), *Diritto costituzionale comparato* (GLF Editori Laterza: Roma-Bari, 2009).
P. Dallier & A. Pellet, *Droit international public* (Dalloz: Paris, 1994).
Paul Fauchille, *Traite de droit international public* tome 1, premier partie (Rousseau et Cie: Paris 1922).
Paul W. Darke, *Between Tyrany and Anarchy: A History of Democracy in Latin America, 1800-2006* (Stanford UP: Sanford, 2009).
Pietro Costa and Danilo Zolo (eds.), *The Rule of Law: History, Theory and Criticism* (Springer: Netherlands, 2010).
R.C. van Caenegem, *An Historical Introduction to Western Constitutional Law* (Cambridge UP: Cambridge, 1995).

Radomir Lukić, *Uvod u Pravo* (Naučna Knjiga: Beograd, 1981).
Radoslav Prochazka, *Mission Accomplished: On Founding Constitutional Adjudication in Central Europe* (CEU Press: Budapest, 2002).
Ray Murphy, *UN Peacekeeping in Lebanon, Somalia and Kosovo* (Cambridge UP: Cambridge, 2007).
Robert Jennings & Sir Arthur Watts, *Oppenheim's International Law*, 9th ed., vol. I (Longman: London, 1992).
Roderic H. Davidson, *Reform in the Ottoman Empire 1856-1876* (Princeton UP: Princeton, 1963).
Ronald St. John MacDonald (ed.), *Essays in Honour of Wang Tieya* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1994).
S. Albert Colliard, *Droit international et histoire diplomatique: Document choisis* (Dalloz: Paris, 1948).
S.E. Finer, *The History of Government* vol. I-III (Oxford UP: Oxford, 1999).
Sandra Ponzanesi, *The Postcolonial Cultural Industry: Icons, Markets, Mythologies* (Houndsmill: Plagrave Macmillan, 2014).
Sanford Levinson (ed.), *Responding to Imperfection: The Theory and Practice of Constitutional Amendment* (Princeton UP: Princeton, 1995).
Scott Gordon, *Controlling the State: Constitutionalism from Ancient Athens to Today* (Harvard UP: Harvard, 1999).
Slobodan Samardžić (ed.), *Norma i odluka: Karl Šmit i njegovi kritičari* (Filip Višnjić: Beograd, 2001).
Stevan Djordjević, *O kontinuitetu država sposebnim osvrtom na kontinuitet Kraljevine Jugoslavije i NDR Jugoslavije* (Naučna Knjiga: Beograd, 1963).
Stevan Djordjević, *Republike i pokrajine u medunardnim odnosima jugoslovenske federacije* (Naučna Knjiga: Beograd, 1985).
Susana Galera (ed.), *Judicial Review: A Comparative Analysis Inside the European Legal System* (Council of Europe: Strasbourg, 2010).
Shukri Rrahimi, *Vilajeti i Kosovës* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1969).
Thomas Risse, Kathryn Sikkink and Stephen C. Ropp (eds.), *The Power of Human Rights: International Norms and Domestic Change* (Cambridge UP: Cambridge, 1999).
Tom Bingham, *The Rule of Law* (Penguin Books: London, 2010).
Tom Campbell, K.D. Ewing, and Adams Tomkins, *The Legal Protection of Human Rights: Skeptical Essays* (Oxford UP: Oxford, 2011).
Tom Ginsburg and Rosalind Dixon (eds.), *Comparative Constitutional Law* (Edward Elgar: Cheltenham, 2001).
Tomas Joseph Lawrence, *Les principes de droit international* (Oxford UP: 1920).
V.I. Lenin, *The State and Revolution* (Penguin Books: London, 1992).

Vedrana Baričević, *Constitutional Identity in the Socialist Yugoslavia and the Successor States: Did the Break With the Past Really Occur?*, disertacion (CEU: Budapest, 2007).
Vicki C. Jackson and Mark Tushnet, *Comparative Constitutional Law* (Foundation Press: New York, 2006).
Vicki C. Jackson, *Constitutional Engagement in a Transnational Era* (Oxford UP: Oxford, 2010).
Vojin Dimitrijević & Dragoslav Stojanović, *Medjunarodni odnosi* (Naučna Knjiga: Beograd, 1979).
W. Phillips Shively, *Power and Choice: Introduction to Political Science*, 8th ed. (McGraw Hill: New York, 2003).
William Hooker, *Carl Schmitt's International Thought: Order and Orientation* (Cambridge UP: Cambridge, 2009).
Winder R. Bayly (ed.), *Near Eastern Round Table 1967-1968* (New York UP: New York, 1969).
Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010).
Wojciech Sadurski, *Rights Before Courts in Post-Communist States of Central and Eastern Europe* (Springer: Netherlands, 2005).
Wojciech Sadurski, *Rights Before Courts: A Study of Constitutional Courts in Postcommunist States of Central and Eastern Europe* (Springer: Netherlands, 2008).

2. Artikuj

A.S. Hershy, "The Succession of States", *American Journal of International Law* vol. 5, no. 2 (1911).
Adam Roberts, "Prolonged Military Occupation: The Israeli-Occupied Territories Since 1967", *American Journal of International Law* vol. 84 (1990).
Ahron Barak, "Unconstitutional Constitutional Amendments", *Israel Law Review* vol. 44, no. 3 (2012).
Alain Pellet, "The Opinions of the Badinter Arbitration Committee: A Second Breath for Self-Determination of Peoples", *European Journal of International Law* vol. 3, issue 1 (1992).
Alec Stone Sweet, "The European Convention on Human Rights and National Constitutional Reordering", *Cardozo Law Review* vol. 33, no. 5 (June 2012).
Aleksandar Magarašević, "O demokratizaciji spoljne politike u Jugoslaviji", *Anali Pravnog Fakulteta u Beogradu* nr. 2 (Beograd, 1973).
Alex Buchanan, "Self-Determination and the Right to Secede", *Journal of International Affairs* vol. 45, no. 2 (1992).

Alexander H.E. Morawa, "Kafka, Kelsen and Supremacy: How European Courts Interact with a View to Fostering Constitutionalism", në Kyriaki Topidi and Alezander H.E. Morawa (eds.), *Constitutional Evolution in Central and Eastern Europe* (Ashgate: Burlington, 2011).

Alexis Heraclides, "Secession, Self-Determination and Non-Intervention: In Quest of a Normative Symbiosis", *Journal of International Affairs* vol. 45, no. 2 (1992).

Amina El Messaoudi, "Il Modelo di Giustizia Costituzionale in Marocco", në Luca Mezzeti, *Sistemi e Modeli di Giustizia Costituzionale*, Tomo II (CEDAM: Padova, 2011).

Andrea Bonime-Blanc, "Constitution Making and Democratization: The Spanish Paradigm", në Laurel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition: Case Studies in Constitution Making* (United States Institute of Peace Press: Washington D.C., 2010).

Andrea Lorenzo Capussela, "A Critique of Kosovo's Internationalized Constitutional Court", *European Diversity and Autonomy Papers* (EDAP: 02/2014), në rrjet: http://www.eurac.edu/edap.

Andrew Arato and Zoltan Miklosi, "Constitution Making and Transitional Politics in Hungary", në Laurel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition: Case Studies in Constitution Making* (United States Institute of Peace Press: Washington D.C., 2010).

Andrew Harding, Peter Leyland, and Tania Groppi, "Constitutional Courts: Forms, Functions and Practice in Comparative Perspective", në Andrew Harding and Peter Leyland (eds.), *Constitutional Courts: A Comparative Study* (Wildy, Simmonds & Hill: London, 2009).

Anne Peters and Ulrich K. Preuss, "International relations and international law", në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Routledge Handbook of Constitutional Law* (Routledge: London, 2013).

Antonio Cassese, "Self-Determination of Peoples and the Recent Break-Up of USSR and Yugoslavia", në Ronald St. John MacDonald (ed.), *Essays in Honour of Wang Tieya* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1994).

Antonio López Pina, "The Spanish Constitutional Court, The European Law and the Constitutional Tradition Common to the Member States (art. 6.3 of the TEU): Lisbon and Beyond", në José María Beneyto / Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the Recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond* (Nomos: Baden-Baden, 2011).

Arne Mavčič, "The Applicant before the Constitutional Court with a Special Reference to the Individual Application: Access to the Court — The Applicant in the Constitutional Jurisdiction", paraqitur në Riga, Letoni, më 6 nëntor 2009. Venice Commission, CDL-JU (2009) 039.

Benedict Kingsbury, "Self-Determination and Indigeneous People", *American Society of International Law — Procedeengs of the 86th Meeting* (Washington DC, April 1-4, 1992).

Bernhard Schlink, "The Constitutional Subject and Its Identity", *Cardozo Law Review* vol. 33, no. 5 (2012).

Besnik Krasniqi, "Bajrami: Amendamenti 10 do të hidhet për votim në Kuvend", *Koha ditore* (e mërkurë, 26 shtator 2012).

Björn Arp, "The ICJ Advisory Opinion on the Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo and the International Protection of Minorities", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010).

Bruno Aguilera, "Law as Limit to Power: The Origins of the Rule of Law in the European Legal Tradition", në Susana Galera (ed.), *Judicial Review: A Comparative Analysis Inside the European Legal System* (Council of Europe: Strasbourg, 2010).

Brun-Otto Bryde, "The Constitutional Judge and the International Constitutionalist Dialogue", në Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law: A New Source or Inspiration?* (Routledge: London, 2006).

C. George Christie, "A model of Judicial Review of Legislation", *Southern California Law Review* vol. 48, no. 6 (1975).

Carlo Fusaro and Dawn Oliver, "Changing Constitutions", në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds.), *How Constitutions Change: A Comparative Study* (Hart: Oxford, 2011).

Carlo Fusaro and Dawn Oliver, "Towards a Theory of Constitutional Change", në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds.), *How Constitutions Change: A Comparative Study* (Hart: Oxford, 2011).

Carlo Fusaro, "Changing Constitutions", në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds), *How Constitutions Change: A Comparative Study* (Hart: Oxford, 2011).

Catherine Dupre and Jiunn-rong Yeh, "Constitutions and legitimacy over time", në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Routledge Handbook of Constitutional Law* (Routledge: London, 2013).

Charles Tilly, "National Self-Determination as a Problem for All of Us", *Daedalus* vol. 122, no. 3 (Summer 1993).

Christian Tomuchat, "Self-Determination in a Post-Colonial World", në Christian Tomuschat, *Modern Law of Self-Determination* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1993).

Christos L. Rozakis, "The European Judge as Comparatist", në Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law: A New Source or Inspiration?* (Routledge: London, 2006).

Clemens Jabloner, "Hans Kelsen: Introduction", në Arthur J. Jacobson and Bernhard Schlink (eds.), *Weimar: A Jurisprudence of Crisis* (Univ. of California Press: Berkeley, 2000).

Colin Warbrick, "Current Developments: Public International Law — Recognition of States", *International and Comparative Law Quarterly* vol. 42, part 2 (1992).

Daniel Smilov, "The Rule of Law and the Rise of Populism: A Case Study of Post-Accession Bulgaria", në Kyriaki Topidi and Alezander H.E. Morawa (eds.), *Constitutional Evolution in Central and Eastern Europe* (Ashgate: Burlington, 2011).

Daniel Thym, "From Ultra-Vires-Control to Constitutional-Identity-Review: The Lisbon Judgement and German Constitutional Court", në José María Beneyto / Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the Recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond* (Nomos: Baden-Baden, 2011).

Darko Petrović & Luiggi Condoreli, "L'ONU et la Crise Yugoslave", *Annuaire Français de Droit International* vol. XXXVIII (Paris, 1992).

David Dyzenhaus, "The Politics of the Question of Constituent Power", në Martin Loughlin and Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism: Constituent Power and Constitutional Form* (Oxford UP: Oxford, 2007).

Dawn Oliver and Carlo Fusaro, "Changing Constitutions: Comparative Analysis", në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds.), *How Constitutions Change: A Comparative Study* (Hart: Oxford, 2011).

Dawn Oliver and Carlo Fusaro, "Changing Constitutions: Comparative Analysis", Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds.), *How Constitutions Change: A Comparative Study* (Hart: Oxford, 2011).

Dawn Oliver and Carlo Fusaro, "Towards a Theory of Constitutional Change", Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds.), *How Constitutions Change: A Comparative Study* (Hart: Oxford, 2011).

Dinah Shelton, "International Law and Domestic Legal Systems: Introduction", në Dinah Shelton (ed.), *International Law and Domestic Legal Systems: Incorporation, Transformation, and Persuasion* (Oxford UP: Oxford, 2011).

Donald P. Kommers, "German Constitutionalism: A Prolegomenon", *Emory Law Journal* vol. 40, issue 1 (1991).

Dren Doli and Fisnik Korenica, "Kosovar Constitutional Courts Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010).

Dren Doli and Fisnik Korenica, "The Consociational System of Democracy in Kosovo: Questioning Ethnic Minorities Special Status in Kosovo's Constitutional Regime", *International Journal of Public Administration* vol. 36, issue 9 (2013).

Dren Doli dhe Fisnik Korenica, "Kosovar Constitutional Court's Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010).

"E godasin Gjykatën", *Gazeta Express* (e mërkurë, 29 gusht 2012) fq. 6.

Eivind Smith, "Courts of people, not of norms? Law and fact in constitutional review as performed by courts of general or administrative jurisdiction", konferenca ndërkombëtare *Law and Fact in Constitutional Jurisprudence*, Vilnius, Lituani, 30 qershor–1 korrik 2005. Venice Commission, CDL-JU (2005) 022.

Elena Cirkovic, "An Analysis of the ICJ Advisory Opinion on Kosovo's Unilateral Declaration of Independence", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010).

"Eliminuan nga lista Driton Muharremin", *Kosova sot* (e premte, 27 janar 2012).

Elke Luise Barnstedt, "Differences Between Constitutional Complaints That Challenge Court Rulings And Those That Challenge Statutes. European Commission For Democracy Through Law", në *Konferenca e Katërt e Sekretarëve të Përgjithshëm të Gjykatave Kushtetuese dhe Gjykatave të Juridiksionit Ekuivalent*, Ankara, Turqi, 1-2 tetor 2009. Venice Commission, CDL-JU (2009) 055.

Emilia Drumeva, "Evolutive Attitude of the Bulgarian Constitutional Court in EU Law Space", në José María Beneyto / Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the Recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond* (Nomos: Baden-Baden, 2011).

Enver Hasani, "Constitutional Protection of the Head of State: The Case of Kosovo", *Vienna Journal on International Constitutional Law — ICL Journal* vol. 7, no. 2 (February 2013).

Enver Hasani, "Constitutional Protection of the Head of State: The Case of Kosovo", *Vienna Journal on International Constitutional Law* vol. 7, no. 2 (2013).

Enver Hasani, "Constitutional Protection of the Head of State: The Case of Kosovo", *Vienna Journal on International Constitutional Law — ICL Journal* vol. 7, no. 2 (February 2013).

Enver Hasani, "Constitutionalism in Kosovo and the Relationship between Constitutional Justice and the Supreme Court", në Enver Hasani, Peter Paczolay and Michael Reigner (eds.), *Constitutional Justice in Southeast Europe: Constitutional Courts in Kosovo, Serbia, Albania and Hungary between Ordinary Judiciaries and the European Court of Human Rights* (Nomos: Baden, 2012).

Enver Hasani, "Disa çështje lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në dritën e ndryshimeve kushtetuese të RSFJ", në Instituti për Kërkime Juridike dhe Shoqërore, *Diskutime për Amendamentet Kushtetuese në Kushtetutën e RS të Serbisë dhe KSA të Kosovës* II (Univ. Prishtinës: Prishtinë, tetor 1988).

Enver Hasani, "Gabimet e një shkence juridike", *Rilindja*, botimi i Tiranës, fejton në 14 vazhdime, nga 1 korrik 1997 deri më 16 korrik 1997.

Enver Hasani, "Grundrechte im Kosovo", në Detlen Marten und Hans-Jürgen Papier (eds.), *Handbuch der Grundrechte in Deutschland und Europa: Band IX: Grundrechte in Osmittel und Osteuropa* (C.F. Muller: Heidelberg, 2016).
Enver Hasani, "Individual Complaint Mechanism as a Means to Protecting Fundamental Human Rights and Freedoms: The Case of the Constitutional Court of Kosovo", *European Yearbook on Human Rights* (Antwerp, 2012).
Enver Hasani, "Kontrolli Abstrakt dhe Preventiv (paraprak) i Amendamenteve Kushtetuese dhe Mbrojtja nga Shkarkimi i Shefit të Shtetit: Rasti i Kosovës", *E drejta/Law* nr. 1/2013 (botim special).
Enver Hasani, "Marrëdhënia ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme të Kosovës", *E drejta/Law* nr. 2 (2011).
Enver Hasani, "Një libër me rëndësi të veçantë", *E Drejta/Law* viti XXIII, nr. 4 (1997).
Enver Hasani, "Sovraniteti dhe Vetëvendosja", *Fjala* viti XXIII, nr. 24 (Prishtinë, tetor 1990).
Enver Hasani, "Two Chapters on Human Rights and Fundamental Freedoms in the Constitution of Kosovo", *Mediterranean Journal of Human Rights* vol. 19, issue 3 (2014).
Enver Hasani, "Ungvibus et Rostris", *Rilindja*, botimi i Tiranës (4 shtator 1997) fq. 10.
Enver Hasani, "Veçoritë Themelore të së Drejtës Kushtetuese Kosovare", *E drejta/Law* nr. 1-4 (2014).
Enver Hasani, "Vendimet kryesore që bënë historinë kushtetuese në Kosovë", në përmbledhjen e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë me titull *Ndarja dhe balancimi i pushteteve dhe roli i kontrollit kushtetues* (Hans Seidel Stiftung: Tiranë, 2012).
Enver Hasani, "Vetëvendosja dhe rasti i Kosovës", *E drejta/Law* viti XXIII, nr. 4 (1997).
Enver Hasani, Dren Doli dhe Fisnik Korenica, "Mekanizmi i ankesave si mjet për mbrojtjen e të drejtave themeloredhe lirive të njeriut: rasti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës", *E drejta/law* nr. 3-4 (2013).
Enver Robelli, "Doli prej zarfit, tash nuk del prej zyres!", *Koha Ditore* (e martë, 10 korrik 2012) fq. 10.
Eric Engle, "Third Party Effect of Fundamental Rights (*Drittwirkung*)", *Hanse Law Review* vol. 5, no. 2 (2009).
Esat Stavileci, Arsim Bajrami dhe Blerim Reka, "Pse nuk dëshirojmë të polemizojmë me Enver Hasanin" dhe "Shprehje e pikëpamjeve individuale", *Rilindja*, botimi i Tiranës (28 gusht 1997) fq. 11.
F.H. Lawson, "British Law and Government: Organization of Power", në J.L. Brierly (ed.), *Law and Government in Principle and Practice* (Odhams Press: London, 1948).

F.L. Kirgis, Jr., "The Degrees of Self-Determination in the United Nations Era", *American Journal of International Law* vol. 88, no. 2 (1994).
F. Michael, "Democracy and Dynamite: The Peoples' Right to Self-Determination", *Political Studies*, vol. XLIV, no. 4 (September 1996).
F. Victor Comella, "The European model of constitutional Review of legislation: Toward decentralization?", *International Journal of Constitutional Law* vol. 2, no. 3 (2004).
Fisnik Korenica dhe Dren Doli, "Calling Kosovo's Constitution: A Legal Review", *Denning Law Journal* vol. 22, no. 1 (2010).
Fisnik Korenica, "Pointing the Rule-of-Law in a Transnational Polity: The Case of Kosovos Law on the Constitutional Court", *Contemporary Issues in Law* vol. 10, no. 3 (2010).
"Foli Kushtetuesja: Presidentja ka mandat pesëvjeçar", *Epoka e re* (e shtunë, 7 korrik 2012) fq. 1 dhe 4-5.
Francesco Belvisi, "The 'Common Traditions' and the Integration of the EU", *Diritto & Questioni Pubbliche* (2005); në rrjet: dirittoequestionipubbliche.org (shikuar së fundi më 7 korrik 2016).
Gary J Jacobson, "Constitutional Identity", *The Review of Politics* vol. 68, no. 3 (Summer 2006).
Gary J. Jacobsohn, "The Formation of Constitutional Identities", në Tom Ginsburg and Rosalind Dixon (eds.), *Comparative Constitutional Law* (Edward Elgar: Cheltenham, UK & Northampton, MA, USA, 2001).
Gary Jeffrey Jacobsohn, "An unconstitutional constitution? A comparative perspective", *International Journal of Constitutional Law* vol. 4, no. 3 (Jul 2006).
Georg P. Fletcher, "Constitutional Identity", në Michel Rosenfeld (ed.), *Constitutionalism, Identity, Difference, and Legitimacy* (Duke UP: Durham, 1994).
George Schmitz, "Constitutional Court of the Republic of Austria 1918-1920", *Ratio Juris* vol. 16, no. 2 (2003).
Giancarlo Rolla and Tania Grappi, "Between Politics and the Law: The Development of Constitutional Review in Italy", në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010).
Gudmundur Alfredson, "Different Forms and Claims to the Right of Self-Determination", në Donald Clark & Robert Williamson (eds.), *Self-Determination: International Perspectives* (St. Martin's Press: New York, 1996).
"Gjykata Kushtetuese dhe Komisioni për ndryshime kushtetuese përplasen për amendamentet që i referohen presidentit", *Koha ditore* (e mërkurë, 29 gusht 2012) fq. 1 dhe 3.
Halil Matoshi, "Populizmi kushtetues dhe Zarifja", *Koha ditore* (e mërkurë, 25 korrik 2012) fq. 10.

Hanna Jamar & Mary Katherine Vigness, "Applying Kosovo: Looking to Russia, China, Spain and Beyond After the International Court of Justice Opinion on Unilateral Declarations of Independence", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010).

Hans Kelsen, "Judicial Review of Legislation: A Comparative Study of the Austrian and the American Constitution", *Journal of Politics* vol. 4, no. 2 (May 1942).

Hans Kelsen, "Ko treba da bude čuvar Ustava", në Slobodan Samardžić (ed.), *Norma i odluka*, fq. 256-297. Titulli i origjinalit: Hans Kelsen, *Wer soll der Hüter der Verfassung sein?* (Dr. Walther Rothschild, Berlin-GruNewald, 1931).

Hans Kelsen, "Ko treba da bude čuvar Ustava", në Slobodan Samardžić (ed.), *Norma i odluka*, fq. 256-297, në fq. 265. Titulli i origjinalit: Hans Kelsen, *Wer soll der huter der verfassung sein?* (Dr. Walther Rothschild: Berlin-Grunewald, 1931).

Hans Kelsen, "Legal Formalism and the Pure Theory of Law", në Arthur J. Jacobson and Bernhard Schlink (eds.), *Weimar: A Jurisprudence of Crisis* (Univ. of California Press: Berkeley, 2000).

Hans Kelsen, "On the Essence and Value of Democracy", në Arthur J. Jacobson and Bernhard Schlink (eds.), *Weimar: A Jurisprudence of Crisis* (Univ. of California Press: Berkeley, 2000).

Hans Lindahl, "Constituent Power and Reflexive Identity: Towards an Ontology of Collective Statehood", në Martin Loughlin and Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism: Constituent Power and Constitutional Form* (Oxford UP: Oxford, 2007).

Hans-Peter Gasser, "The Geneva Conventions and the Autonomous Territorieës in the Middle East", *Security Dialogue* vol. 26, no. 2 (June 1995) fq. 173-181.

Hanum Hurst, "Self-Determination in the Post-Colonial Era", në Donald Clark & Robert Williamson (eds.), *Self-Determination: International Perspectives* (St. Martin's Press: New York, 1996).

Haxhi Gashi, "Konflikti lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore: Ndryshimi i ligjit për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, i Ligjit për AKP-në dhe ligjet relevante" ("The Conflict of Laws Concerning the Socially Owned Enterprises"), *E drejta/Law* no. 2 (2011).

Helmut Steinberger, *Models of Constitutional Jurisdiction* (Venice Commission: Strasbourg, 1993). CDL-STD (1993) 002.

Henry Spruyt, "Decline Reconsidered: The Complex Nature of Modern Sovereinigty", *Harvard International Review* vol. XVII, no. 3 (1995).

Herman Schwartz, "Eastern Europe's Constitutional Courts", *Journal of Democracy* vol. 9, no. 4 (1998).

Igor I. Lukashuk, "The UN and Illegitimate Regimes: When to Intervene to Protect Human Rights", në Lori Fisler Damrosch and David J. Scheffer (eds.) *Law and Force in the New International Order* (Westview Press: USA, 1991).

Isaias Afewerki, "Challenge from Within: The Theory and Practice of Self-Determination, *Harvard International Review* vol. XVII, no. 3 (1995).

J. Alexander Thier, "Big Tent, Small Tent: The making of a Constitution in Afganistan", në Laurel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition: Case Studies in Constitution Making* (United States Institute of Peace Press: Washington D.C., 2010).

J.M. Sorel & R. Mehdi, "L'*uti possidetis* entre la consecration juridique et 1a pratique: essai de reactualisation", *Annuaire Français de Droit International* vol. XL (Paris, 1994).

"Jahjaga edhe katër vjet presidente", *Zëri* (e shtunë, 7 korrik 2012) fq. 1-2.

"Jahjaga: Mirupafshim në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016", *Bota sot* (e shtunë, 7 korrik 2012) fq. 1 dhe 4-5.

Jakup Krasniqi, "Për mandatin e presidentes të flasin Thaçi, Mustafa e Pacolli", intervistë, *Epoka e re* (e hënë, 9 korrik 2012) fq. 4-5.

James C. O'Brien, "The Dayton Constituion of Bosnia and Herzegovina", në Laurel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition: Case Studies in Constitution Making* (United States Institute of Peace Press: Washington D.C., 2010).

James E. Moliterno, "What the ICJ's Decision Means for Kosovars", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010).

Janet L. Hiebert, "Governing Like Judges?", në Tom Campbell, K.D. Ewing, and Adams Tomkins, *The Legal Protection of Human Rights: Skeptical Essays* (Oxford UP: Oxford, 2011).

Jasna Omejec, "Kontrola ustavnosti ustavnih normi (ustavnih amandmana i ustavnih zakona)", *Godišnjak Akademije pravnih znanosti Hrvatske* vol. 1, no. 1 (Prosinac, 2010).

Jeffrie G. Murphy, "Rationality and Constraints on Democratic Rule", në J. Ronald Pennock and John W. Chapman (eds.), *Justification: Nomos XXVIII* (New York UP: New York, 1986).

Jiri Priban, "Judicial Power vs. Democratic Representation: The Culture of Constitutionalism and Human Rights in Czech Legal System", në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010).

Jiři Zemánek, "The Two Lisbon Judgements of the Czech Constitutional Court", në José María Beneyto / Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the Recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond* (Nomos: Baden-Baden, 2011).

John Ferejohn and Pasquale Pasquino, "Constitutional Courts as Deliberative Institutions: Towards an Institutional Theory of Constitutional Justice", në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010).

John Williamson, "What Washington Means by Policy Reform", në John Williamson (ed.), *Latin American Readjustment: How Much Has Happened* (Institute for International Economics: Washington, 1989).

Jonathan Morrow, "Deconstitution Mesopotamia: Cutting a Deal on the Regionalisation of Iraq", në Laurel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition: Case Studies in Constitution Making* (United States Institute of Peace Press: Washington D.C., 2010).

Jonathan Morrow, "Deconstitution Mesopotamia: Cutting a Deal on the Regionalisation of Iraq", në Laurel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition: Case Studies in Constitution Making* (United States Institute of Peace Press: Washington D.C., 2010).

Jose Luis Marti, "Two Different Ideas of Constitutional Identity: Identity of the Constitution v. Identity of the People", në Alejandro Saiz Arnais and Carina Alcoberro Llivina (eds.), *National Constitutional Identity and European Integration* (Intersentia: Cambridge, 2013).

Juan E. Mendez, "Constitutionalism and Transitional Justice", në Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford UP: Oxford, 2012).

Jurg Steiner and Markus M.L. Crepaz, *European Democracies* (Pearson Education: USA, 2007).

Jurgen Habermas, "Strugels for Recognition in the Democratic Constitutional State", në Charles Taylor, *Multiculturalism, Examining the Politics of Recognition* (Princeton UP: New Jersey, 1994) fq. 129-135.

K. Shehadi, "Ethnic Self-Determination and the Break-Up of States", *Adelphi Paper* no. 283 (1993).

Kamal S. Shehadi, "Ethnic Self-Determination and the Break-Up of States", *Adelphi Papers* no. 283 (1993).

Karl Šmit, "Čuvar Ustava", në Slobodan Samardžić (ed.), *Norma i odluka: Karl Šmit i njegovi kritičari* (Filip Višnjić: Beograd, 2001). Titulli i origjinalit: Carl Schmitt, "Der Hüter der Verfasung", *Archiv des offentlichen Rechts*, Neue Folge 16 (1929).

Karl Šmit, "Legalnost i Legitimnost", në Slobodan Samardžić (ed.), *Norma i odluka: Karl Šmit i njegovi kritičari* (Filip Višnjić: Beograd, 2001).

Karl Strupp, "Les reg1es générales du droit de la paix", *RCADI* tome 47, I (Paris, 1934).

Kasia Lach and Wojciech Sadurski, "Constitutional Courts of Central and Eastern Europe: Between Adolescence and Maturity", në Andrew Harding and

Peter Leyland (eds.), *Constitutional Courts: A Comparative Study* (Wildy, Simmonds & Hill: London, 2009).
Konstandin Obradović, "Again on the Problem of Continuity — Is FR Yugoslavia 'Old' or 'New' State?", *Medjunarodni Problemi* nr. 3 (IMPP, 1994).
"Kryetari i Komisionit kushtetues, Arsim Bajrami, konteston vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me amendamentet për zgjedhjen e presidentit", *Koha ditore* (e shtunë, 7 korrik 2012) fq. 1 dhe 3.
"Kushtetuesja: I gjithë populli shpreson ta ketë Jahjagën 5 vjet në krye", *Koha ditore* (e shtunë, 21 korrik 2012) fq. 3.
"Kuvendi me Rezolutë antikushtetuese", *Koha ditore* (e diel, 8 korrik 2012) fq. 1 dhe 3.
"Kuvendi në hall me amendamentet jokushtetuese", *Koha ditore* (e shtunë, 11 gusht 2012) fq. 1 dhe 3.
Kyriaki Topidi and Alexander H.E. Morawa, "Prologue: Constitutional Transition in Central and Eastern Europe", në Kyriaki Topidi and Alexander H.E. Morawa (eds.), *Constitutional Evolution in Central and Eastern Europe* (Ashgate: Burlington, 2011).
Kyriaki Topidi, "Fundamental Rights in the EU's Post-Enlargement Landscape: An Exercise in Constitutional Translation", në Kyriaki Topidi and Alezander H.E. Morawa (eds.), *Constitutional Evolution in Central and Eastern Europe* (Ashgate: Burlington, 2011).
L. Stanley Paulson, "Constitutional Review in the United States and Austria: Notes on the Beginnings", *Ratio Juris* vol. 16, nr. 2 (2003).
Laura Montanari, "Le nuove democrazie dell'Europa centro-orientale", në P. Carrozza, A. Di Giovine & G.F. Ferrari (eds.), *Diritto costituzionale comparato* (GLF Editori Laterza: Roma-Bari, 2009).
Laurel E. Miller, "Designing Constitution-Making Processes: Lessons from the Past, Questions for the Future", në Laurel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition: Case Studies in Constitution Making* (United States Institute of Peace Press: Washington D.C., 2010).
Laurie W.H. Ackermann, "Constitutional Comparativism in South Africa. A Response to Sir Basil Markesinis and Dr. Jorg Fedke", në Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law: A New Source or Inspiration?* (Routledge: London, 2006).
"LDK ndihet e tradhtuar nga Thaçi, AKR shpreson në vullnetin e presidentes", *Koha ditore* (e martë, 10 korrik 2012) fq. 2.
Lech Garlicki (2007), "Constitutional Courts Versus Supreme Courts", *International Journal of Constitutional Law* vol. 5, nr. 1 (2007).
Lech Garlicki and Zofia A. Garlicka, "Constitution Making, Peace Building, and National Reconciliation: The Experience of Poland", në Laurel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition: Case Studies in Constitution Making* (United States Institute of Peace Press: Washington D.C., 2010).

Lech Garlicki and Zofia A. Garlicki, "External Review of Constitutional Amendments? International Law as a Norm of Reference", *Israel Law Review* vol. 44, no. 3 (2012).

Lech Garlicki and Zofia A. Gralicka, "Review of Constitutionality of Constitutional Amendments (An Imperfect Response to Imperfections)", *Jorurnal of Constitutional Law / Revue de droit constitutionnel* vol. I, issue 1 (Istanbul, 2012).

Lech Garlicki, "Constitutional Courts versus Supreme Courts", *International Journal of Constitutional Law* vol. 5, no. 1 (January 2007).

Leonard F.M. Besselink, "National and Constitutional Identity Before and After Lisbon", *Utrecht Law Review* vol. 6, issue 3 (November 2010).

Ljubivoje Ačimović, "Continuity of International Legal Personality of Yugoslavia and Its Membership in the United Nations", *Medjunarodni Problemi* nr. 3 (IMPP, 1994).

Louis Aucoin, "Introduction", në Laurel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition. Case Studies in Constitution Making* (United States Institute of Peace Press: Washington, D.C., 2010).

Louis M. Aucoin, "Judicial Review in France: Access of the Individual Under French and European Community Law in the Aftermath of France's Rejection of Bicentennial Reform", *Boston College International and Comparative Law Review* vol. 15, issue 2 (1992); në rrjet: http://Lawdigitalcommons.bc.edu/iclr/vol15/iss2/7.

Lucien Jaume, "Constituent Power in France", në Martin Loughlin and Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism: Constituent Power and Constitutional Form* (Oxford UP: Oxford, 2007).

Lucio Pegoraro, "Le garanzie costituzionali", në Lucio Pegoraro, Antonio Reposo, Angelo Rinella, Roberto Scarciglia et Mauro Volpi (eds.), *Diritto Costituzionale e Publico* (G. Giappichelli Editore: Milano: 2005).

Luis Lopez-Guerra, "The Role and Competences of the Constitutional Court", në Venice Commission, *The role of the constitutional court in the consolidation of the rule of law* [UniDem Seminar Bucharest, 8-10 June 1994], CDL-STD (1994) 010 (Council of Europe: Strasbourg, 1994).

Lung-chu Chen, "Self-Determination: An Important Dimension of the Demand for Freedom", *American Society for International Law Proceedings* 75 (April 1981).

M. Bothe & Ch. Schimdt, "Sur quelque question de succession posses par la dissolution de l'URSS et celle de la Yugoslavie", *Revue générale de droit international public* tome XCVI (Paris, 1992).

Malcolm Shaw, "State Succession Revisited", *Finish Year Book of International Law* vol. 5 (1994).

Marc Weller "Rambouillet Conference on Kosovo", *International Affairs* vol. 75, issue 2 (April 1999).

Mark Brzezinski and Leszek Garlicki (1995) "Judicial Review in Post-Communist Poland: The Emergence of a Rechtsstaat", *Stanford Journal of International Law* vol. 31, no. 1 (1995) fq. 13-60.
Mark F. Brzezinski, "The Emergence of Judicial Review in Eastern Europe: The Case of Poland", *American Journal of Comparative Law* vol. 41, no. 2 (1993).
Markus Bokenforde and Daniel Sabsay, "Supranational organizations and their impact on national constitutions", në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Routledge Handbook of Constitutional Law* (Routledge: London, 2013).
Martha Rady, "Self-Determination and the Dislotion of Yugosllavia", *Ethnic and Racial Studies* vol. 19, no. 2 (1996).
Mary Sarah Bilder, "Colonial Constitutionalism and Constitutional Law", në Alfred L. Brophy and Daniel W. Hamilton, (eds.), *Transformations in American Legal History: Essays in Honor of Morton J. Horwitz* (Harvard UP: Cambridge, MA, 2009).
Mattias Wendel, "Lisbon Before the Courts: Comparative Perspectives", në José María José María Beneyto / Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the Recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond* (Nomos: Baden-Baden, 2011).
Max M. Kampelman, "Secession and Self-Determination: New States and Old Problems", *Current* no. 357 (November 1993).
Michael Bothe, "Kosovo — So What? The Holding of the International Court of Justice Is Not the Last Word on Kosovo's Independence", në *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010).
Michael Krykov, "Self-Determination From Marx to Mao", *Ethnic and Racial Studies* vol. 19, no. 2 (April 1996).
Michel Rosenfeld, "Constitutional identity", në Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford UP: Oxford, 2012).
Michel Rosenfeld, "Modern Constitutionalism as Interplay Between Identity and Diversity", në Michel Rosenfeld (ed.), *Constitutionalism, Identity, Difference, and Legitimacy* (Duke UP: Durham, 1994).
Milenko Kreca, "A Few Remarks About the Continuity of FR Yugoslavia", *Medjunarodni Problemi* nr. 3 (IMPP, 1994).
Miroslav Cerar, "Slovenia's Constitutional Court within the Separation of Power", në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010).
Nannerl O. Keohane, "Claude de Syessel and Sixteenth Century Constitutionalism in France", në J. Roland Pennock and John W. Chapman (eds.), *Constitutionalism* (New York UP: New York, 1979).

Oliver Duhamel, "France's New Five-Year Presidential Term", *Brookings* (1 March 2001), në rrjet: https://www.brookings.edu/research/articles/2001/03/france-duhamel (herën e fundit shikuar në nëntor 2012).
Otto Kimminich, "A 'Federal' Right of Self-Determination?", në Christian Tomuschat, *Modern Law of Self-Determination* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1993).
Ove Bring, "Correspondents's Agora: UN Membership of the Former Yugosllavia — Letters to the Editor in Chief", *American Journal of International Law* vol. 87, no. 2 (1993).
Paolo Carrozza, "Il diritto socialista", në P. Carrozza, A. Di Giovine & G.F. Ferrari (eds.), *Diritto costituzionale comparato* (GLF Editori Laterza: Roma-Bari, 2009).
Patric Thornbery, "The Democratic or Internal Aspect of Self-Determination with some Remarks on Federalism", në Christian Tomuschat, *Modern Law of Self-Determination* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1993).
Payam Akhavan, "Self-Determination and the Desintegration of Yugosllavia: What Lessons for the International Community?", në Donald Clark & Robert Williamson (eds.), *Self-Determination: International Perspectives* (St. Martin's Press: New York, 1996).
Peter Fitzpatrick, "'The New Constitutionalism': The Global, the Postcolonial and the Constitution of Nations", *Law, Democracy and Development* vol. 10, no. 2 (2006).
Pietro Faraguna, "A Living Constitutional Identity: The Contribution of Non-Judicial Actors", *Jean Monnet Working Paper* No. 10 (2015).
"Presidente e plotë", *Gazeta Express* (e shtunë, 7 korrik 2012) fq. 1 dhe 4-5.
R. Shehadeh, "The Geneva Conventions and the Autonomous Territories in the Middle East", *Security Dialogue* vol. 26, no. 2 (June 1995).
Rein Mullerson, "The Continuity and Succession of States by Reference to the Former USSR and Yugoslavia", *International and Comparative Law Quarterly* vol. 42, part 3 (July 1993).
Riza Smaka, "Vendimi ka qenë korrekt", *Epoka e re* (e hënë, 9 korrik 2012) fq. 7.
Robert C. Post, "Foreword: Fashioning the Legal Constitution: Culture, Courts and Law", *Yale Law School Faculty Scholarship Series* Paper 179 (2003); në rrjet: http://digitalcommons.law.yale.edu/fss_papers/179 (shikuar së fundi më 12 korrik 2016).
Robert Howse & Ruti Teitel, "Delphic Dictum: How Has the ICJ Contributed to the Global Rule of Law by its Ruling on Kosovo?", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010).
Robert Muharremi, "A Note on the ICJ Advisory Opinion on Kosovo", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010).
Roberto Bin et Giovanni Pirtruzzella, *Diritto Costituzionale* (G. Giappichelli Editore: Milano, 2010).

Roberto Miccu, "Toward a (Real) Cooperative Constitutionalism? New Perspectives on the Italian Constitutional Court", në José María Beneyto / Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the Recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond* (Nomos: Baden-Baden, 2011).

Roberto Scarcglia, "L'organizzazione giudizaria", në Lucio Pegoraro, Antonio Reposo, Angelo Rinella, Roberto Scarciglia et Mauro Volpi (eds.), *Diritto Costituzionale e Publico* (G. Giappichelli Editore: Milano: 2005).

Rodolfo Stavenhagen, "Self-Determination: Right or Demon?" në Donald Clark & Robert Williamson (eds.), *Self-Determination: International Perspectives* (St. Martin's Press: New York, 1996).

Rosalyn Higgins, "Postmodern Tribalism and the Right to Secession", në Catherine Brolmann (ed.), *Peoples and Minorities in International Law* (Springer Verlag: New York, 1993).

Rudolf Smend, "Constitution and Constitutional Law", në Arthur J. Jacobson and Bernhard Schlink (eds.), *Weimar: A Jurisprudence of Crisis* (Univ. of California Press: Berkeley, 2000).

Ruti G. Teitel, "Reactionary Constitutional Identity", në Michel Rosenfeld (ed.), *Constitutionalism, Identity, Difference, and Legitimacy* (Duke UP: Durham, 1994).

Ruti Teitel "Transitional Rule of Law", në Adam Czamota, Martin Krygeier and Wojciech Sadurski (eds.), *Rethinking the Rule of Law After Communism* (CEU Press: Budapest, 2005).

Sa Smythe, "Postcolonialism and the Cultural Industry: Complicity and Resistance", *Postcolonial Studies* vol. 18, no. 4 (2015).

Scott N. Carlson, "The Drafting Process for the 1998 Albanian Constitution", në Laurel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition: Case Studies in Constitution Making* (United States Institute of Peace Press: Washington D.C., 2010).

"Serbs Opt for Own Constitution", *The Independent* (28 March 1992) fq. 15.

Seyla Benhabib, "On Michel Roselnfeld's The Identity of the Constitutional Subject", *Cardozo Law Review* vol. 33, no. 5 (June 2012).

Smilja Avramov, "Suverenost u suvremenoj doktrini i praksi", *Jugoslovenska Revija za Medjunarodno Pravo* nr. 1-3 (IMPP: Beograd, 1979).

Sokol Bylykbashi, "Kushtetuesja politike", *Tribuna shqiptare* (e mërkurë, 19 gusht 2012) fq. 13.

"Šta se menja u Ustavu SFRJ", *Borba* (Beograd, janar 1988) fq. 20.

Stanford J. Shaw, "The Origins of Representative Government in the Ottoman Empire: An Introduction to the Provincial Councils 1839-1878", në Winder R. Bayly (ed.), *Near Eastern Round Table 1967-1968* (New York UP: New York, 1969).

Stefan Korioth, "Rudolf Smend", në Arthur J. Jacobson and Bernhard Schlink (eds.), *Weimar: A Jurisprudence of Crisis* (Univ. of California Press: Berkeley, 2000).

Sharon Weintal, "The Challenge of Reconciling Constitutional Eternity Clauses with Popular Sovereignty: Toward Three-Track Democracy in Israel as a Universal Holisitic Constitutional System and Theory", *Israel Law Review* vol. 44, no. 3 (2012).

Sharon Weintal, "The Challenge of Reconciling Constitutional Eternity Clauses With Popular Sovereignty: Toward Three-Track Democracy in Israel as a Universal Holistic Constitutional System and Theory", *Israel Law Review* vol. 44, no. 3 (2012).

Taylor Cole, "Three Constitutional Courts: A Comparison", *The American Political Science Review* vol. 53, no. 4 (December 1959).

Toma Galli, "Kratka analiza Savjetodavnog mišljenja Medjunarodnog suda o proglaenju neovisnosti Kosova s medjunarodnim pravom", *Zbornik Pravnog Fakulteta u Zagrebu* vol. 61, no. 6 (prosinac 2011).

Theo Ohlinger, "The Genesis of the Austrian Model of Constitutional Review of Legislation", *Ratio Juris* vol. 16, nr. 2 (2003).

Thomas Buergenthal, "Modern Constitutions and Human Rights Treaties", *Columbia Journal of Transnational Law* vol. 36, no. 1 (1997).

Thomas Burri, "The Kosovo Opinion and Secession: The Sounds of Silence and Missing Links", *German Law Journal* vol. 11, no. 08 (2010).

Thomas Franck, "Intervention Against Illegitimate Regimes", Louis Damroch & Daniel Scheffer (eds.) *Law and Force in the New International Order* (Westview Press: USA, 1991).

Thomas Franck, "Legitimacy in the International System", *American Journal of International Law* vol. 82, no. 4 (1988).

Thomas Franck, "The Emerging Right to Democratic Governance", *American Journal of International Law* vol. 86, no. 1 (1992).

Thomas Risse and Kathryn Sikknik, "The Socialization of International Human Rights Norms Into Domestic Practices: Introduction", në Thomas Risse, Kathryn Sikkink and Stephen C. Ropp (eds.), *The Power of Human Rights: International Norms and Domestic Change* (Cambridge UP: Cambridge, 1999).

Ulrich K. Preuss, "The Implications of 'Eternity Clauses': The German Experience", *Israel Law Review* vol. 44, no. 3 (2012).

Valierie Bunce, "Comparing East and South", Larry Diamon and Marc F. Plattner (eds.), *Democracy After Communism* (John Hopkins UP: Baltimore, 2002).

Vaughan A. Lowe & Collin Wabrick, "Recognition of States", *International and Comparative Law Quarterly* vol. 41, part 2 (1992).

Victor F. Comella, "The European model of constitutional review of legislation: Toward decentralization?" *International Journal of Constitutional Law* vol. 2, nr. 3 (2004).
Vladimir D. Degan, "Correspondent's Agora: UN Membership of the Former Yugoslavia. Letters to the editor in Chief", *American Journal of International Law* vol. 87, no. 2 (April 1993).
Vladimir Ibler, "Pravo naroda na samoodredjenje i zloupotreba tog prava", *Politička Misao* vol. XIX, no. 2 (Zagreb, 1991).
Vladimir-Djuro Degan, "Samoodredjivanje naroda i teritorialna cjelovitost država u uvjetirna raspada Jugoslavije", *Naša zakonitost* no. 4 (Zagreb, 1992).
W. Cole Durham, Jr and Carolyn Evans, "Freedom of religion and religion–state relations", në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Routledge Handbook of Constitutional Law* (Routledge: London, 2013).
Wen-Chen Chang, "East Asian Foundations for Constitutionalism: Three Models Reconstructed", *National Taiwan University Law Review* vol. 3, no. 2 (2009).
Wojciech Sadurski, "Constitutional Justice, East and West: An Introduction", në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010).
Wojciech Sadurski, "Constitutional Review After Communism: Legitimacy and Reasons", në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010).
Wojciech Sadurski, "Constitutional Review in Europe and in the United States: Influences, Paradoxes, and Convergence", *Legal Studies Research Paper* (Sydney Law School) no. 11/15 (2011).
Wojciech Sadurski, "European Constitutional Identity?", *European University Institute Working Papers: Law* no. 33 (2006).
Wojciech Sadurski, "Postcommunist Constitutional Courts in Search of Political Legitimacy", *European University Institute Working Papers: Law* no. 11 (2011).
Wolfgang Zeidler, "The Federal Constitutional Court of the Federal Republic of Germany: Decisions on the Constitutionality of Legal Norms", *Notre Dame Law Review* vol. 62 (1987).
Yaniv Roznai, "The Theory and Practice of 'Supra-Constitutional' Limits on Constitutional Amendments", *International and Comparative Law Quarterly* vol. 62, issue 03 (July 2013).
Yoram Dinstein, "Collective Human Rights of Peoples and Minorities", *International and Comparative Law Quarterly* vol. 25, issue 1 (January 1976).
Yram Dinstein, "Autonomy and Legal Status: A Rejoinder", *Security Dialogue* vol. 26, no. 2 (June 1995).

Zdenek Kuhn, "Making a European Transnational Constitution: Some Central European Perspectives", në Ingolf Pernice and Jiri Zemanek (eds.), *A Constitution for Europe: The IGC, The Ratification Process and Beyond* (Nomos: Baden-Baden, 2005).
"Zgjedhjet e parakohshme presidenciale varen nga Jahjaga", *Koha ditore* (e shtunë, 7 korrik 2012) fq. 1 dhe 3.

3. Dokumente dhe materiale të tjera

Address of Dr. Borisav Jović in the Assembly of the SFRY, 19 March 1992. *Review of International Affairs* (1 July 1992).
Akti Final i Helsinkit, 1975.
Amnesty International, *Kosovo: Unmik's Legacy, The Failure to Deliver Justice and Reparation to the Relatives of the Abducted* (August 26, 2013).
Botimet Zyrtare të Kombeve të Bashkuara. *Treaty Series*, vol. 1155.
Carrington Conference. Treaty Provisions for the Convention (1991).
Chairman's Statement on the results of the Meeting of the Consultative Commitee of the Conflict Prevention Center. 1 July 1991.
Charter of Paris for a New Europe. UN Doc. A/45/859 (1990) fq. 20.
Conference for Peace in Yugoslavia. Arbitration Commision Avis. No. 1. 7 December 1991.
CSO Resolution: Support for UN Action on Yugoslavia. 29 November 1991.
Declaration on Principles of International Law Concerning Friendly Relations and Co-operation among States in accordance with the Charter of the United Nations. G.A. Res. 2625, Annex, 25 UN GAOR, Supp. (No. 28), U.N. Doc. A/5217 at 121 (1970).
Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, 17 shkurt 2008.
Deklarata e Vjenës. Vienna Declaration and Programme of Action. 1993.
e (në referim të Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë, Aktgjykimi i datës 16 shtator 1996; Raportime mbi aktgjykimet dhe vendimet 1996-IV, fq. 1210-1211, paragrafët 65-68).
EC COMM'N — Week in Europe. 7 November 1991.
Emisioni *Rubikon*, me Adriatik Kelmendin, KTV (Kohavizion). 2 tetor 2012, 20:00 CET.
Enver Hasani, "Roli i Gjykatës Kushtetuese në zhvillimin e sundimit të ligjit në Kosovë", ligjëratë në Akademinë Diplomatike të Vjenës, 29 shtator 2014; në rrjet: https://youtu.be/nNXRPrgg4pI.
EPC Declaration. EPC Press Release 82/91. Brusseles, 27 August 1991.
EPC Press Release 128/91 (16 December 1991).
EPC Press Release 129/91 (16 December 1991).

Extraordinary EPC Meeting: Declaration on Yugoslavia. Press Release. The Hague, 3 September 1991.
Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Nr. 26/83, 26/86, 11/88.
Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Nr. 29/1978, 39/1985, 45/1989, 57/1989.
GjEDNj. Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë. Aktgjykim. 16 shtator 1996.
GjEDNj. Amuur kundër Francës. 17/1995/523/609. Aktgjykim. Dhoma, 25 qershor 1996.
GjEDNj. Azemi kundër Serbisë. Kërkesa Nr. 11209/09. 2013. ECtHR, *Decision in the Case of Azemi v. Serbia* (Application No. 11209/09) (2013).
GjEDNj. Azinas kundër Qipros. Kërkesa Nr. 56679/00. 28 prill 2004.
GjEDNj. Castells kundër Spanjës. Kërkesa Nr. 11798/85. Aktgjykim. Dhoma, 23 prill 1992.
GjEDNj. D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke. Kërkesa Nr. 57325/00. Aktgjykim. Dhoma e Lartë, 13 nëntor 2007.
GjEDNj. Danyila Semenivna Prystavska kundër Ukrainës. Kërkesa Nr. 21287/02. Vendim mbi pranueshmërinë. Dhoma, 17 dhjetor 2002.
GjEDNj. Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët kundër Spanjës. Kërkesa nr. 62543/00. Aktgjykim. Dhoma, 27 prill 2004.
GjEDNj. Karner kundër Austrisë. Kërkesa nr.40016/98. Aktgjykim. Dhoma, GjEDNj, 24 korrik 2003.
GjEDNj. Keneth Lehitnen kundër Finlandës. Kërkesa nr. 39076/97. Vendimi në lidhje me pranueshmërinë. Aktgjykim. Dhoma, 13 shtator 2005.
GjEDNj. Kozacioğlu kundër Turqisë. Kërkesa nr.2334/03. Akgjykim. Dhoma e Lartë, 19 shkurt 2009.
GjEDNj. McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar. Kërkesa nr.18984/91. Aktgjykim. Dhoma, 27 shtator 1995.
GjEDNj. P.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar. Kërkesa nr.6638/03. Vendimi për Pranueshmërinë. Dhoma, 24 gusht 2004.
GjEDNj. Ruža Jeličić kundër Bosnjë-Hercegovinës. Kërkesa nr. 41183/02. Vendimi mbi Pranueshmërinë. Dhoma, 15 nëntor 2005.
GjEDNj. Scordino kundër Italisë (nr. 1). Kërkesa nr. 36813/97. Aktgjykim. Dhoma e Lartë, 29 mars 2006.
GjEDNj. Sejdić dhe Finci kundër Bosnjë-Hercegovinës. Kërkesat nr. 27996/06 dhe 34836/06. Aktgjykim. Dhoma e Plotë, 22 dhjetor 2009.
GjEDNj. Selmouni kundër Francës. Nr. 25803/94, Vendimi, 28 korrik 1999.
GjEDNj. Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar. Kërkesa nr.14038/88. Aktgjykim. Sesioni Plenar, 7 korrik 1989.
GjEDNj. Van Osterwijck kundër Belgjikës. Akgjykim. 6 nëntor 1980.
GjEDNj. Vijayanathan dhe Pusparajah kundër Francës. Kërkesa nr.17550/90, 17825/91. Aktgjykim. Dhoma, 27 gusht 1992.

GjEDNj. Yaşa kundër Turqisë. Kërkesa 63/1997/847/1054. Aktgjykim. Dhoma, 2 shtator 1998.

Gjykata e Lartë e ShBA-së, *Gibon v. Ogden*, 22 US 1 (1824)

Gjykata e Lartë e ShBA-së, *Lynch v. Donnelly*, 465 US 668 (1984).

Gjykata e Lartë e ShBA-së, *Roe v. Wade*, 410 US 113 (1973).

Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë, 90 BFVerfGE 241 (1994).

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 1 mars 2012. Rasti KO 4/11. Parashtrues: Gjykata Supreme e Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr. 03/L-139.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 12 prill 2013. Rasti KO 97/12. Parashtrues: Avokati i Popullit të Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 90, 95(1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit mbi Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Jobankare Financiare, Nr. 04/L-093, datë 12 prill 2012.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 13 mars 2014. Rasti KI89/13. Parashtrues: Arbresha Januzi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 74/2011, datë 12 mars 2013.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 15 prill 2013. Rasti KO 131/12. Parashtrues: Dr. Shaip Muja dhe 11 Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Shqyrtimi i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit mbi Shëndetësinë, Nr. 04/L-125, miratuar nga ana e Kuvendit më datën 13 dhjetor 2012.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 15 prill 2013. Rasti KO 131/12. Parashtrues: Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, nr. 04/L-125, të miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012. Nr. ref. AGJ404/13.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 15 prill 2015. Rasti KO 26/15. Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Shkresën nr. 05-433/DO-318. Nr. ref.: AGJ788/15.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 17 dhjetor 2010. Rasti KI 08/09. Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj, të përfaqësuar nga zt. Ali Azemi, kryetar i Sindikatës. Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, Vendimi C Nr. 340/2001, datë 11 janar 2002

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 18 mars 2010. Rasti KO 01/09. Ćemailj Kurtiši kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 20 korrik 2012. Rastet KO 29/12 dhe KO 48/12. Amendamentet e propozuara kushtetuese të dorëzuara nga Krye-

tari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012. Nr. ref.: AGJ284/12.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 20 shtator 2011. Rasti KO 98/11. Parashtrues: Qeveria e Republikës së Kosovës. Lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Nr. ref. AGJ138/11.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 22 dhjetor 2010. Rasti KI 56/09. Parashtrues: Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal i Prizrenit.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 24 janar 2013. Rasti KI 78/12. Parashtrues: Bajrush Xhemajli. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. Nr. 70/2012, datë 22 korrik 2012.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 24 mars 2011.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 26 shkurt 2013. Rasti KI 41/12. Parashtrues: Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Nr. ref.: AGJ361j13.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 27 qershor 2012. Rastet KO 45/12 dhe KO 46/12. Parashtrues: Liburn Aliu. Kërkesa e Liburn Aliut dhe 11 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit. Nr. ref. AGJ 255/12.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 28 shtator 2010. Rasti KI 47/10. Naim Rrustemi dhe 31 deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së Tij Fatmir Sejdiut, President i Republikës së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 3 shtator 2013. Rasti KO 108/13. Parashtrues: Albulena Haxhiu dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kontrolli kushtetues i Ligjit Nr. 04/L-209 mbi Amnistinë, i 11 korrikut 2013.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 30 mars 2011. Rasti KO 29/11. Sabri Hamiti dhe deputetët e tjerë. Vlerësimi Kushtetues i Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-04, përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës të 22 shkurtit 2011.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 30 tetor 2010. Rasti KI 006/10. Parashtrues: Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 30 tetor 2010. Rasti KI06/10. Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë. Nr. ref.: AGJ63/10.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 31 mars 2011. Rasti KI 25/10. Parashtrues: Agjencia Kosovare e Pronës kundër Gjykatës Supreme. Vlerësim i kushtetutshmërisë te Vendimit te Dhomës se Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-09-089, te 4 shkurtit 2010.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 31 tetor 2012. Rasti 61/12. Konfirmimi i Amendamenteve të Propozuara të Parashtruara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më datën 22 qershor 2012 përmes letrës nr. 04-DO-1095.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 4 shkurt 2010. Rasti KI 25/10. Parashtrues i kërkesës: Agjencia Kosovare e Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC 09-89. *Rasti AKP*.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 7 tetor 2010. Rasti KO 80/10. Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Tij, dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të Kompetencave në rastin e Kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska. Më 7 tetor 2010.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 8 dhjetor 2011. Rasti KO 119/10. Parashtrues: Avokati i Popullit të Kosovës. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafi 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit Nr. 03/L-111,të datës 4 qershor 2010.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 8 dhjetor 2011. Rasti KO 119/10. Parashtrues: Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafit 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, nr. 03/L111, të 4 qershorit 2010. Nr. ref.: AGJ165/11.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 8 mars 2013. Rasti KI 120/10. Parashtrues: Zyma Berisha. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. 308/2007, datë 10 qershor 2010.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 9 shtator 2013. Rasti KO 95/13. Parashtrues: Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-199 për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje. Nr. ref.: AGJ469/13.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim. Rasti 08/09. Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Fabrikës së Çelikut IMK në Ferizaj kundër AKP.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim. Rasti 55/09. NTSH Meteorit kundër Gjykatës Supreme.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim. Rasti KI 40/90. Imer Ibrahimi dhe të tjerët kundër Gjykatës Supreme. Rasti KI 40/90.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim. Rasti KI 68/09. Kastrati kundër Gjykatës Supreme.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktvendim për Papranueshmëri, 14 dhjetor 2011. Rasti KI 121/10. Parashtrues: Sitaram Chaulagai, Krishna Bandur Chamlagai, Chandra Kala Chauhan dhe Hom Bahadur Battarai. Vlerësim i

kushtetutshmërisë së vendimeve të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë GJL. nos. 1258/2010, 1259/2010, 1260/2010, 1261/2010, të 22 nëntorit 2010.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktvendim për papranueshmëri, 19 mars 2012. Rasti KO 05/12. Parashtruesit e kërkesës: Visar Ymeri dhe dymbëdhjetë deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-279 të 20 janarit 2012.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktvendim për papranueshmëri, 2 shtator 2013. Rasti KO 118/13. Parashtrues: Albana Fetoshi dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kontrolli kushtetues i Ligjit Nr. 04/L-201 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-165 mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktvendim për papranueshmëri, 20 mars 2012. Rasti KI 147/11. Parashtrues: Maria Strugari. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, GJL. nr. 1288/2011, të 28 tetorit 2011.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktvendim për papranueshmëri, 21 mars 2011. Rasti KI 02/10. Parashtrues: Roland Bartetzko. Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, AP-KZ 181/2002, të 12 nëntorit 2002.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktvendim për papranueshmëri, 26 dhjetor 2012. Rasti KO 148/11. Parashtrues: Avokati i Popullit të Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 11, paragrafi 1, nenit 32, paragrafët 1 dhe 2, nenit 34, paragrafi 2 dhe neni 38 lidhur me nenet 11, 32 dhe 34 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 03/L-195 të datës 27 gusht 2010 dhe kërkesa për masë të përkohshme.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktvendim për papranueshmëri, 30 qershor 2011. Rasti KI 22/11. Denić kundër Këshillit Zgjedhor për Ankesa.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktvendim për papranueshmëri, 4 prill 2012. Rasti KI 98/10. Kërkesa e Avokatit të Popullit për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimeve 01 nr. 06/837 të datës 16 prill 2009, dhe Npi-01/132 të datës 30 prill 2009 të Kuvendit Komunal të Komunës së Shtimes.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktvendim për papranueshmëri, 6 tetor 2011. Rasti KI 36/11. Parashtrues: Arjeta Halimi. Vlerësimi i kushtetutshmërisë të mospërmbarimit të pretenduar të Aktgjykimit CN. nr. 24/09, të 17 nëntorit 2009, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan dhe shkeljes së pretenduar të të drejtave të njeriut të parashtruesit të kërkesës.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktvendimi për papranueshmëri, 3 shkurt 2010. Rasti KI 41/09. Parashtrues: Universiteti AAB-Riinvest kundër Qeverisë së Kosovës, datë 27 janar 2010.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Kërkesa e Gjykatës Supreme të Kosovës për Vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, nenet 35, 36, 37 dhe 38, i 17 janarit 2011.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Masa e përkohshme. Rasti KI 11/09. Tomë Krasniqi kundër RTK-së dhetë tjerëve.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Mendim i përbashkët mospajtues i gjyqtarit Almiro Rodrigues dhe gjyqtares Snezhana Botusharova, 12 tetor 2010. Rasti KI 47/10. Parashtrues: Naim Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së Tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Mendimi konkurrues i gjyqtarit Almiro Rodrigues për aktgjykimin. Rasti 01/09.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Mendimi mospajtues i gjyqtares Gjyljeta Mushkolaj në lidhje me masën e përkohshme. Rasti KI 11/09. Tomë Krasniqi kundër RTK-së dhe KEK-ut.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Mendimi mospajtues i gjyqtarëve Robert Carolan dhe Almiro Rodrigues, 30 mars 2011. Rasti KO 29/11. Sabri Hamiti dhe deputetët e tjerë të Kuvendit të Kosovës. Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-04 përkitazi me Zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, të 22 shkurt 2011.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Mendimi mospajtues i gjyqtarit Almiro Rodrigues në lidhje me masën e përkohshme. Rasti KI 11/09. Tomë Krasniqi kundër RTK-së dhe KEK-ut.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Sqarimi i aktgjykimit. Rasti KO 29/11. Parashtrues: Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-04, në lidhje me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës të 22 shkurtit 2011. Sqarimi i kërkuar i Vendimit të shumicës të datës 30 mars 2011. Më 1 prill 2011.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Tomë Krasniqi kundër RTK dhe të tjerët, Rasti KI 11/09. Vendimi mbi Masën e Përkohshme. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Tomë Krasniqi kundër RTK dhe të tjerët. Rasti KI 11/09. Vendimi mbi Masën e Përkohshme. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Trashëgimtarët e Ymer Loxhës dhe Sehit Loxhës kundër Gjykatës Supreme. Rasti KI 14/09. Vendim mbi Pranueshmërinë. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Trashëgimtarët e Ymer Loxhës dhe Sehit Loxhës kundër Gjykatës Supreme. Rasti KI 14/09. Aktvendim. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Universiteti AAB sh.p.k. kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti 41/09, Vendimi mbi papranueshmërinë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Urdhër, 21 qershor 2010. Rasti KO 01/09. Për vazhdimin e afatit kohor të caktuar në Aktgjykimin e 18 marsit 2010. Nr. ref. URDH.27/10.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brandshme dhe të tjerët, Rasti KI 06110. Akgjykim. Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. *Vendim mbi Kërkesën për Masë të Përkohshme. Rasti KI22/09. Dode Gecaj kundër Vendimit PKL-KZZ 76/08 të Gjykatës Supreme të Kosovës* (Ref. Nr. MP 03/09). Prishtinë, 15 dhjetor 2009.

GjND. Pajtueshmëria me të Drejtën Ndërkombëtare e Shpalljes së Njëanshme të Pavarësisë në lidhje me Kosovën. Mendim Këshillëdhënës. 22 korrik 2010. — International Court of Justice. Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo (Request for Advisory Opinion). General List No. 141. 22 July 2010. *Në rrjet:* http://www.refworld.org/docid/4c5151002.html (qasur së fundi më 2 qershor 2016).

Haki Demolli, kryetar i Komisionit për Reformën Zgjedhore. Deklaratë dhënë autorit, 24 nëntor 2012.

Konventa e Vjenës mbi Trashëgimin e Shteteve në Raport me Marrëveshjet Ndërkombëtare, datë 22 gusht 1978.

Konventa e Vjenës mbi Trashëgimin e Shteteve në Raport me Pronat, Arkivat dhe Borxhet Shtetërore, datë 8 prill 1983.

Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve e vitit 1969 (e hyrë në fuqi me 27 janar 1980).

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e shpallur si Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 9/2001, më 15 maj 2001.

Kushtetuta e Bosnjë-Hercegovinës. Ustav Bosne i Hercegovine.

Kushtetuta e Koresë së Jugut, 17 korrik 1948. Constitution of the Republic of Korea, 17 July 1948.

Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1974.

Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Vojvodinës, 1974. Ustav Socijaličke Autonomne Pokrajine Vojvodine, 1974.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.

Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, 1974. Ustav Socijalističke Federativne Republike Jugoslavije, 1974.

Kushtetuta e Republikës Socialiste të Bosnjë-Hercegovinës, 1974. Ustav Socijalističke Republike Bosne i Hercegovine, 1974.

Kushtetuta e Republikës Socialiste të Kroacisë, 1974. Ustav Socijalističke Republike Hrvatske, 1974.

Kushtetuta e Republikës Socialiste të Malit të Zi, 1974. Ustav Socijalističke Republike Crne Gore, 1974.
Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë, 1974. Ustav Socijalističke Republike Makedonije, 1974.
Kushtetuta e Republikës Socialiste të Serbisë, 1974. Ustav Socijalističke Republike Srbije, 1974.
Kushtetuta e Republikës Socialiste të Sllovenisë, 1974. Ustav Socijalističke Republike Slovenije, 1974.
Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Lajmet e fundit: Reagim i Kabinetit të Kryetarit të Kuvendit", sajti i Kuvendit të Kosovës (e hënë, 20 shkurt 2012): http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,128,4462 (shikuar më 24 nëntor 2012).
Kuvendi Komunal i Prizrenit. Vendim nr. 01/011-3581 për ndryshimin e Statutit të Komunës së Prizrenit, datë 24 mars 2011.
Ligji mbi Gjykatat e rregullta i Kosovës i vitit 1978. *Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës* nr. 21/1978.
Ligji mbi konfliktet administrative. *Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë* Nr. 4/1977.
Ligji nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative. 22 korrik 2005.
Ligji nr. 02/L-31 mbi lirinë e fesë në Kosovë. 13 korrik 2006.
Ligji nr. 02/L-37 mbi përdorimin e gjuhëve. 27 korrik 2007.
Ligji nr. 02/L-88 mbi trashëgiminë kulturore në Kosovë. 9 tetor 2006.
Ligji nr. 03/L-034 mbi Shtetësinë e Kosovës. 20 shkurt 2008.
Ligji nr. 03/L-04 për vetëqeverisjen lokale. 20 shkurtit 2008.
Ligji nr. 03/L-047 mbi mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre në Kosovë. 13 mars 2008.
Ligji nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. 21 maj 2008.
Ligji nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. 5 qershorit 2008.
Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
Ligji nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme.
Ligji nr. 03/L-195 mbi Avokatin e Popullit të Kosovës. 22 korrik 2010.
Ligji nr. 03/L-199 mbi gjykatat e Republikës së Kosovës. 22 korrik 2010.
Ligji për gjykatat e rregullta. *Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës* nr. 14/1990.
Ligji Themelor [Kushtetuta] i Republikës Federale të Gjermanisë. Grundgesetz für die Bundesrepublik Deutschland.
Marrëveshja e Përgjithshme për Paqen në Bosnjë-Hercegovinë [Marrëveshja e Dejtonit]. General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina. 1995.
Marrëveshja e Përkohshme për Paqen dhe Vetëqeverisjen në Kosovë [Marrëveshja e Rambujesë]. Interim Agreement for Peace and Self-Government in

Kosovo [Rambouillet Agreement]. 1999. Në rrjet: https://en.wikisource.org/wiki/Kosovo_Rambouillet_Agreement_1999.
Mendimi i Nr. 1 i Komisionit Badinter për ish-Jugosllavinë, etj. etj.
Minerva Mills Ltd. v. Union of India (A.I.R. 1980, S.C. 1789) fq. 1798.
Offer of CSCE Good Offices Mission to Yugoslavia. Prague, 4 July 1991.
Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës [Plani i Ahtisaarit], datë 2 shkurt 2007.
Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës [Plani i Ahtisaarit], datë 26 mars 2007.
Rezolutë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-R-02, datë 7 prill 2011, në mbështetje të arritjes së marrëveshjes politike të 6 prillit 2011.
Rregullore e UNMIK-ut, nr. 1/1999, datë 25 korrik 1999, mbi autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë. UNMIK/REG/1999/1.
Rregullore e UNMIK-ut, nr. 1999/24, datë 12 dhjetor 1999, mbi ligjin në fuqi në Kosovë. UNMIK/REG/1999/24.
Rregullore e UNMIK-ut, nr. 2000/59, datë 2 tetor 2000, për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi ligjin në fuqi në Kosovë. UNMIK/REG/1999/59.
Rregullore e UNMIK-ut, nr. 2002/13, datë 13 qershor 2002, për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, me ndryshime. UNMIK/REG/2002/13.
Rregullore e UNMIK-ut, nr. 38/2000, datë 30 qershor 2000, mbi themelimin e institucionit të Avokatit të Popullit. UNMIK/REG/2000/38. Në rrjet: http://www.unmikonline.org/regulations/2000/reg38-00.htm.
Rregullorja e Punës e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.
"Statement of Principles for New Constitutional Arrangments for Bosnia and Hercegovina", *Review of International Affairs* (Belgrade, 1 April 1992) fq. 11.
Supplementary Documment to Give Effect to Certain Provisions Contained in the Charter of Paris for a New Europe. UN Doc. A/45/859 (1990) fq. 43, 47.
U.S. Embassy Pristina. Signing of Status of Forces Agreement between the United States of America and the Republic of Kosovo. 18 February 2012.
UN Secretary General, Letter, 6 November 1991. UN Doc. NS-41/91.
UN Security Council Resolution 1244 (1999) [on the deployment of international civil and security presences in Kosovo], 10 June 1999. S/RES/1244 (1999).
UN Security Council Resolution 713, 25 September 1991. S/RES/713, UN Doc. S/23169 (1991).
UN Security Council Resolution 721, 27 November 1991. S/RES/721, UN Doc. S/23239 (1991).
UN Security Council Resolution, 21 February 1992. S/RES/743, UN Doc. NS 11/92.
United States v. Morrison 529 U.S. 598 (2000).

US-EC Declaration on the Recognition of the Yugoslav Republics. Brussels, 10 March 1992.
Ustav SFRJ: Ustavi socialistickih republika i pokrajina (Slobodna Dalmacija: Beograd, 1974).
Vendim i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-04, datë 22 shkurt 2011, përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.
Vendim i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-11, datë 7 prill 2011, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.
Vendim i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-12, datë 22 prill 2011, për formimin e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-13, i datës 22 prill 2011, për formimin e Komisionit për amendamentimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
Vendim i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-436, datë 7 shtator 2012. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*, nr. 25/2012.
Venice Commission, *Draft outline of main elements for an agreement on Kosovo: Confidential* (Council of Europe: Strasbourg, 1998).
Venice Commission, *Models of constitutional jurisdiction* (Council of Europe: Strasbourg, 1994).
Venice Commission, *Report on Constitutional Amendment*, Study No. 469/2008, CDL-AD (2010) 001 (Council of Europe: Strasbourg, 2010).
Venice Commission, *Study on Individual Access to Constitutional Justice*, Study No. 538/2009, CDL-AD (2010) 039 (Council of Europe: Strasbourg, 2009).
Venice Commission, *The role of the constitutional court in the consolidation of the rule of law* (Council of Europe: Strasbourg, 1994).

Treguesi

AAK, 206
AKR, 216, 221, 226, 395
Alec Stone Sweet, 368, 385
amendamentet kushtetuese, viii, xii, 1, 2, 5, 6, 7, 45, 47, 147, 148, 194, 195, 208, 209, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 222, 223, 224, 225, 226, 227, 228, 229, 230, 231, 232, 236, 237, 238, 241, 255, 256, 257, 258, 259, 260, 261, 262, 263, 264, 284, 290, 291, 312, 324, 325, 330, 331, 352, 371, 372, 373, 375, 381, 382, 384, 385, 389, 390, 391, 396, 401, 404, 406, 412
Aristoteli, 284, 351
Arsim Bajrami, 59, 81, 82, 95, 100, 101, 117, 131, 132, 134, 226, 380, 390, 395
Atifete Jahjaga, 208, 209, 214, 215, 221, 222, 224, 225, 226, 227, 228, 233, 238, 258, 259, 260, 261, 371, 391, 393, 395, 402
AVNOJ, xxiii, 79, 82, 94, 95, 135, 140
Badinter. *Shih* Komisioni Badinter
BE, x, xxiii, xxiv, 19, 25, 29, 31, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 78, 112, 118, 119, 188
Behgjet Pacolli. *Shih* Rasti Pacolli
Benedict Anderson, 276, 350, 378, 380
Benjamin Constant, 218, 220, 243, 244, 263, 288, 378
Blerim Reka, 59, 81, 82, 84, 91, 95, 100, 101, 104, 105, 106, 107, 108, 117, 131, 132, 133, 134, 380, 390
Bosnjë-Hercegovina, x, 3, 28, 31, 38, 39, 72, 73, 75, 76, 77, 78, 79, 104, 106, 107, 113, 120, 136, 178, 269, 274, 293, 306, 353, 365, 403, 409, 410
BRSS, ix, xxiii, 19, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 36, 37, 64, 70, 71, 80, 90, 92, 98, 99, 104, 105, 112, 115, 118
Bujar Bukoshi, 57, 59, 81
Bunjaj. *Shih* Konferenca e Bunjajt
Carl Schmitt, 211, 214, 216, 217, 219, 223, 227, 239, 241, 242, 243, 244, 245, 247, 248, 249, 250, 251, 252, 253, 256, 263, 264, 287, 288, 377, 378, 379, 382, 384, 385, 394
Çeçenia, 24, 34, 79, 104
Çekosllovakia, 71, 90, 103, 104, 105, 115
Deklarata e Francës mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit, 18, 154
Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, 210, 402
Deklarata mbi Pavarësinë e ShBA-së, 18, 20
Dervish Dumi, 59
Djordjević. *Shih* Stevan Gjorgjeviq
Edmond Burke, 351
Elizabeth Rehn, 101
Esat Stavileci, 59, 81, 82, 84, 86, 89,

91, 94, 95, 96, 100, 101, 105, 117, 130, 131, 132, 134, 380, 390
Estonia, 26, 27, 104, 117, 231
EULEX, 193, 211, 341, 342, 374
Faik Brestovci, xix, 2
faktori ndërkombëtar, 271, 292, 295, 299, 365, 366, 374, 376
FMN, xxiii, 119
Franca, 18, 52, 64, 107, 136, 151, 153, 170, 174, 175, 180, 218, 238, 239, 245, 246, 257, 261, 263, 288, 304, 346, 350, 352, 353, 355, 356, 362, 403
GIZ, xxiii, 146
GjEDNj, xxiii, 174, 175, 176, 177, 178, 179, 180, 182, 188, 189, 190, 269, 285, 327, 329, 330, 335, 338, 339, 342, 403, 404
Gjermania, 21, 25, 36, 52, 59, 64, 75, 118, 136, 141, 142, 146, 149, 156, 174, 182, 223, 224, 236, 238, 241, 242, 244, 246, 248, 249, 250, 252, 256, 257, 259, 266, 267, 278, 279, 280, 281, 284, 285, 288, 293, 294, 295, 323, 326, 345, 355, 357, 363, 365, 366, 367, 404, 410
GjND, xxiii, 59, 105, 164, 212, 214, 237, 272, 409
Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë, 157, 238, 284
Gjykata Kushtetuese e Jugosllavisë, 47, 331
Gjykata Kushtetuese e Kosovës, viii, xi, xii, xiii, 47, 145, 146, 147, 149, 155, 157, 158, 159, 160, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 169, 170, 171, 172, 173, 174, 175, 176, 177, 178, 179, 180, 181, 182, 183, 184, 185, 186, 187, 188, 189, 190, 193, 194, 195, 198, 199, 201, 203, 204,208, 209, 211, 212, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 221, 224, 225, 226, 227, 228, 229, 234, 238, 241, 256, 258, 259, 260, 263, 264, 265, 266, 267, 269, 270, 271, 272, 273, 274, 278, 279, 281, 284, 285, 286, 287, 289, 290, 291, 292, 293, 296, 297, 298, 299, 300, 301, 302, 303, 311, 312, 313, 315, 321, 322, 324, 326, 327, 329, 330, 331, 332, 333, 335, 338, 339, 340, 342, 343, 345, 346, 348, 349, 352, 359, 367, 368, 369, 371, 372, 373, 374, 375, 376, 390, 391, 395, 402, 404, 405, 406, 407, 408, 409, 410, 411
Ligji për Gjykatën Kushtetuese, 172, 174, 179, 185, 187
Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, 147
Gjykata Supreme, viii, xi, 145, 146, 149, 157, 158, 159, 160, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 171, 173, 175, 183, 184, 186, 187, 192, 193, 209, 210, 211, 212, 214, 232, 240, 255, 297, 321, 326, 327, 335, 342, 343, 346, 357, 366, 390, 392, 404, 405, 406, 407, 408, 409,411
Hajredin Kuçi, 2, xix, xx
Hans Kelsen, 241, 244, 248, 249, 252, 287, 288, 289, 359, 360
Hegeli, 351
Hugo Groci, 83
Hugo Preuss, 9
Ibrahim Rugova, xvii, 303, 304
identiteti kushtetues, viii, xv, 41, 257, 265, 266, 267, 278, 280, 284,

299, 300, 301, 303, 345, 348, 349, 350, 351, 352, 353, 354, 355, 356, 358, 360, 361, 362, 363, 364, 366, 367, 368, 372, 374, 376
ish-Jugosllavia. *Shih* RSFJ
Izraeli, 116, 117, 118, 120, 231, 352
J.W. Garner, 9
Jakup Krasniqi, 222, 228, 229, 393
Jean Bodin, 10, 18
Jean-Jacques Rousseau, 20, 35, 49, 88, 109, 353, 383
Joaquim de Sousa Ribeiro, 265
John Locke, 20, 35, 49, 353
Jurgen Habermas, 351, 394
juridiksioni, xii, xiii, 2, 17, 22, 36, 85, 101, 109, 116, 125, 146, 149, 157, 158, 160, 161, 165, 168, 169, 170, 171, 172, 173, 174, 175, 177, 178, 180, 181, 182, 184, 186, 187, 188, 189, 190, 193, 194, 195, 211, 217, 224, 225, 230, 234, 269, 270, 281, 286, 287, 289,290, 291, 296, 300, 312, 315, 316, 324, 326, 327, 329, 342, 360, 374, 375
karta kosovare mbi të drejtat e njeriut, xiii, 281, 299, 321
KEDNj, xxiii, 161, 162, 163, 165, 166, 209, 269, 305, 306, 318, 327, 328, 335, 338
KFOR, xxiii, 342
Komisioni Badinter, x, 3, 19, 24, 30, 31, 32, 38, 73, 74, 75, 78, 79, 80, 102, 103, 105, 106, 107, 112, 119, 385, 411
Komonuelthi i Shteteve të Pavarura, 26
Konferenca e Bunjajt, xi, 79, 82, 85, 94, 137, 140, 141
Konferenca e Londrës, x, 73, 80
kontinuiteti, x, xi, 15, 63, 73, 84, 85, 90, 95, 98, 102, 105, 108, 109, 110, 111, 112, 116, 119, 125, 127, 129, 130, 131, 143, 220, 243, 262, 362, 364
kontrolli kushtetues, viii, xii, 147, 167, 214, 215, 225, 230, 232, 236, 241, 244, 255, 256, 258, 268, 278, 279, 280, 312, 324, 325, 326, 329, 330, 333, 340, 371, 372, 373, 390, 405, 407
Korniza Kushtetuese, 164, 307, 308, 309, 310, 313, 346, 409
Kosova, vii, viii, ix, x, xi, xii, xiii, xv, xvii, xviii, xix, xx, xxi, xxiii, xxiv, 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 11, 12, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 28, 32, 33, 34, 35, 38, 39, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 65, 73, 74, 75, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 88, 89, 90, 93, 94, 95, 96, 97, 98, 100, 101, 102, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 110, 113, 114, 116, 117, 118, 119, 120, 121, 122, 123, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130, 131, 132, 133, 134, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147, 148, 149, 155, 156, 157, 158, 159, 160, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 171, 173, 174, 175, 176, 182, 188, 189, 190, 191, 192, 193, 194, 195, 196, 197, 198, 199, 200, 201, 202, 203, 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224, 225, 226, 227, 228, 229, 230, 231,

232, 233, 234, 235, 236, 237, 238, 241, 247, 254, 255, 258, 259, 260, 261, 263, 265, 266, 267, 268, 269, 270, 271, 272, 273, 274, 275, 276, 277, 278, 279, 280, 281, 282, 283, 284, 285, 286, 287, 288, 289, 290, 291, 292, 293, 294, 295, 296, 297, 298, 299, 300, 301, 302, 303, 304, 305, 306, 307, 308, 309, 310, 311, 312, 313, 314, 315, 316, 317, 318, 319, 320, 321, 322, 323, 325, 326, 327, 328, 329, 330, 331, 332, 333, 334, 335, 336, 337, 338, 339, 340, 341, 342, 343, 344, 345, 346, 347, 348, 349, 350, 352, 353, 356, 359, 360, 361, 365, 367, 368, 369, 371, 372, 373, 374, 375, 376, 377, 380, 382, 383, 389, 390, 400, 402, 403, 404, 405, 406, 407, 408, 409, 410, 411, 412
Kritere për Njohje të Shteteve të Reja..., 29, 30, 70, 71, 73, 79
Kroacia, x, 2, 28, 31, 39, 60, 61, 63, 64, 65, 66, 68, 69, 70, 72, 73, 75, 77, 104, 106, 107, 113, 120, 132, 133, 134, 141, 142, 143, 181, 274, 409
KSAK, xxiii, 1, 7, 45, 47, 51, 85, 130, 155, 193, 270, 301, 302, 303, 381, 382, 384, 389
kufijtë, 15, 20, 22, 25, 28, 29, 30, 31, 33, 34, 38, 64, 65, 67, 68, 70, 72, 76, 91, 103, 104, 105, 106, 107, 110, 114, 118, 125, 139, 322, 346
kundërkushtetutshmëria. *Shih* kushtetutshmëria
Kushtetuta e Kaçanikut, 41, 42, 58, 79, 90, 94, 95, 104
Kushtetuta e Kosovës, xix, xx, xxiii, 32, 51, 52, 55, 56, 129, 149, 159, 161, 162, 163, 167, 170, 172, 176, 182, 188, 189, 199, 201, 206, 208, 211, 213, 215, 217, 218, 222, 223, 224, 225, 227, 230, 234, 235, 237, 247, 254, 258, 259, 260, 263, 266, 268, 272, 278, 280, 281, 284, 292, 293, 295, 300, 308, 309, 310, 311, 313, 315, 316, 319, 323, 325, 326, 329, 330, 333, 334, 336, 337, 340, 343, 344, 345, 346, 352, 355, 359, 361, 370, 372, 373
kushtetutshmëria, xi, xii, 47, 50, 53, 101, 102, 120, 124, 126, 129, 149, 150, 152, 153, 154, 155, 157, 159, 165, 166, 167, 170, 173, 185, 188, 191, 192, 194, 195, 200, 206, 207, 209, 214, 215, 217, 219, 221, 229, 232, 234, 236, 238, 240, 255, 259, 261, 262, 263, 264, 268, 270, 275, 278, 281, 287, 290, 291, 296, 297, 312, 313, 315, 318, 321, 324, 327, 329, 331, 333, 334, 335, 338, 343, 371, 372, 404, 405, 406, 407, 408
Kuvendi i Prizerenit, 82, 84, 86, 89, 94, 95, 97, 116, 118, 123, 126, 135, 140, 141
LDK, 200, 201, 206, 216, 217, 221, 223, 225, 226, 395
Lenini, 20, 35, 98, 99, 240, 384
Leon Duguit, 9
Letonia, 26, 27, 104, 117
Lituania, 26, 27, 104, 117, 231
Lufta e Dytë Botërore, xi, 14, 15, 21, 27, 28, 39, 46, 79, 82, 89, 93, 94, 96, 100, 104, 108, 109, 110, 111, 113, 118, 125, 126, 137, 140, 141,

142, 143, 144, 155, 156, 217, 223, 241, 245, 256, 264, 290, 293, 294, 301, 350, 356, 358, 360, 362, 363, 365
Lufta e Parë Botërore, 15, 20, 33, 85, 109, 110, 116, 139, 156, 355
Luftërat Ballkanike, 46, 88, 139
Luftërat Botërore, 214, 287
Mali i Zi, 2, 15, 28, 37, 80, 88, 105, 111, 113, 119, 121, 231, 303
Maqedonia, 15, 28, 35, 39, 71, 73, 85, 89, 99, 104, 107, 113, 269, 274, 282, 410
Marrëveshja e Dejtonit, 3, 108, 112, 119, 269, 306, 410
Marrëveshja e Londrës, 139
Marrëveshja e Rambujesë, 304, 305, 306, 307, 309, 310, 313, 410
marrëveshjet ndërkombëtare, xiii, 7, 57, 103, 111, 132, 133, 268, 269, 272, 273, 274, 275, 276, 277, 278, 279, 280, 296, 297, 299, 308, 311, 312, 313, 314, 409
Montesquieu, 353
NATO, xvii, xxiii, xxiv, 2, 57, 58, 164, 298, 304, 342
Noel Malcolm, 58, 97, 118, 136, 144, 301, 338, 383, 396
Norman Stone, 58
OKB, xxiv, 13, 21, 22, 34, 35, 60, 61, 64, 66, 67, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 78, 79, 107, 111, 113, 116, 119, 126, 128, 159, 164, 304, 308, 314, 341, 344
  Asambleja e Përgjithshme, 15, 21, 22, 35, 67, 72, 119, 139
  Karta, 8, 13, 22, 24, 35, 36, 61, 66, 67, 69, 70, 72, 79, 107, 113, 116, 308
  KS, x, xxiii, xxiv, 30, 37, 64, 66, 67, 69, 71, 72, 75, 94, 119, 164, 211, 237, 304, 307, 308, 332, 342
PDK, 216, 221
personat fizikë, 172, 173, 285, 320, 333, 372
personat juridikë, 5, 172, 173, 194, 285, 317, 320, 321, 322, 332, 333, 368
QIK, xxiv, 81
Rambuje. *Shih* Marrëveshja e Rambujesë
Rasti AKP, xii, 161, 163, 164, 173, 183, 186, 193, 209, 210, 211, 213, 296, 392, 406
Rasti KEK, xxiii, 160, 161, 162, 163, 196, 197, 346, 408
Rasti Pacolli, 191, 206, 207, 208, 213, 219, 220, 221, 222, 393
Rasti Qeska, 191, 406
Rasti RTK, xii, 177, 185, 192, 196, 197, 212, 213, 408
ratifikimi, 30, 132, 133, 268, 272, 273, 275, 276, 278, 279, 311, 312, 314, 315, 325, 406
Regensburg, 267, 268
Republikat Baltike, 26, 27, 37, 64, 72, 104
RFJ, xxiv, 29, 30, 34, 37, 75, 79, 102, 105, 107, 108, 109, 111, 112, 113, 119, 121, 125, 126, 127, 128, 164, 303, 304, 305
RSFJ, vii, ix, x, xi, xxiii, xxiv, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10, 15, 19, 23, 24, 25, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 37, 38, 41, 42, 49, 51, 53, 55, 57, 58, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69,

70, 71, 72, 73, 74, 75, 77, 78, 79, 80, 83, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95, 96, 97, 98, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 107, 108, 109, 110, 111, 112, 113, 115, 116, 117, 119, 120, 122, 123, 124, 125, 126, 127, 132, 133, 134, 135, 138, 139, 140, 143, 145, 155, 193, 269, 270, 280, 301, 302, 303, 331, 348, 352, 389, 409, 411
RSS, xxiv, 5, 6, 7, 8, 9, 11, 14, 42, 43, 45, 48, 93, 96, 410
Rui Moura Ramos, 265
Rumania, 44, 371, 374
Rusia, 26, 79, 112, 113
Serbia, xi, xvii, 1, 2, 5, 6, 7, 11, 14, 15, 28, 30, 31, 34, 35, 39, 41, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 58, 60, 64, 68, 72, 73, 75, 77, 78, 79, 80, 86, 89, 93, 94, 95, 96, 98, 101, 102, 105, 106, 107, 109, 110, 111, 112, 113, 116, 119, 121, 125, 126, 127, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 181, 192, 268, 269, 272, 273, 277, 278, 301, 303, 305, 312, 371, 381, 389, 403, 406
Serbia e Madhe, 35, 47
SKS, xxiv, 63, 79, 110
Sllobodan Millosheviq, xvii, xxiv, 1, 41, 58, 60, 270, 300, 303, 304
Sllovenia, 2, 12, 28, 44, 60, 61, 62, 63, 66, 70, 75, 104, 106, 107, 113, 181, 274, 410
sovraniteti, 2, 9, 10, 11, 13, 14, 17, 18, 20, 26, 32, 43, 44, 51, 76, 77, 84, 90, 91, 103, 104, 108, 109, 115, 116, 117, 118, 120, 121, 126, 129, 170, 239, 283, 315
Stalini, 98, 152, 301, 302
Stevan Gjorgjeviq, 33, 49, 111, 133, 134, 155, 193, 270, 302, 382, 384
suksedimi (trashëgimi), x, xi, 30, 70, 73, 80, 84, 98, 102, 104, 108, 111, 112, 121, 409
sundimi i ligjit, 25, 32, 70, 150, 151, 152, 153, 155, 156, 166, 197, 198, 213, 214, 216, 235, 252, 255, 257, 271, 293, 298, 299, 344, 345, 350, 352, 353, 357, 368, 369, 373, 374, 375, 402
ShBA, xxi, xxiv, 18, 20, 60, 75, 111, 119, 150, 152, 153, 227, 238, 240, 255, 256, 298, 330, 334, 354, 357, 358, 366, 367, 404
shtetasit, 5, 16, 18, 43, 44, 46, 140, 321, 336, 346
të huajt, 86, 97, 122, 123, 292, 321
Tito, 89
Thomas Hobbes, 252, 353, 378
UÇK, xvii, xxiv, 35, 38, 57, 58, 304
Universiteti Bilkent, 58
UNMIK, xxiv, 159, 163, 164, 210, 211, 304, 308, 310, 332, 341, 342, 409, 411
vetëvendosja, ix, x, xi, 2, 3, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 42, 57, 58, 59, 66, 68, 72, 73, 74, 77, 78, 80, 82, 83, 84, 89, 90, 91, 92, 94, 95, 96, 97, 98, 100, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 113, 114, 115, 116, 117, 118, 120, 121, 123, 124, 126, 127, 129, 133, 134, 138, 139, 140, 141, 143, 269
Vetëvendosje (lëvizja), 206
Vilajeti i Kosovës, x, 82, 83, 84, 85,

86, 87, 96, 121, 122, 135, 384
vlerësimi kushtetues, 191, 192, 200, 207, 209, 268, 297, 321, 327, 333, 334, 341, 343, 371, 404, 405, 406, 407, 408
Vojvodina, 6, 28, 29, 37, 301, 302, 303, 409
Wojciech Sadurski, 152, 155, 156, 158, 165, 169, 172, 183, 193, 204, 235, 270, 289, 292, 300, 303, 344, 360, 364, 377, 385, 391, 393, 394, 397, 399, 401

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

342(042.3)(075.8)

Hasani, Enver
Tema të zgjedhura nga e drejta kushtetuese / Enver Hasani. – Prishtinë ; Hjuston : Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ; "Jalifat Publishing", 2016. – 419 f. ; 24 cm. – (Biblioteka Besa)

Literatura : f. 377-412. – Treguesi : f. 413-419

ISBN 978-9951-00-185-4